



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Bashkinë Tiranë”

# **RAPORT PËRFUNDIMTAR**

## **MBI**

**(Auditimin Financiar dhe Përputhshmërisë)**

**“BASHKIA TIRANË”**

Tiranë, Qershor 2019

## **Përmbajtja**

<b>I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....</b>	<b>4</b>
<b>II.HYRJA.....</b>	<b>44</b>
<b>III.PËRSHKRIMI AUDITIMIT .....</b>	<b>46</b>
<b>IV.GJETJET DHE REKOMANDIMET .....</b>	<b>49</b>
<b>V.REKOMANDIMET .....</b>	<b>230</b>

## **SHKURTIME**

<b>KLSH</b>	Kontrolli i Lartë i Shtetit.
<b>MFK</b>	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.
<b>NA</b>	Nëpunës Autorizues.
<b>NZ</b>	Nëpunës Zbatues.
<b>GSM</b>	Grupi i Menaxhimit Strategjik.
<b>NJAB</b>	Njësia e Auditimit të Brendshëm.
<b>AB</b>	Auditi i Brendshëm
<b>MAB</b>	Manuali i Auditimit të Brendshëm.
<b>FZHR</b>	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
<b>AQT</b>	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.
<b>UMF</b>	Udhëzim i Ministrisë së Financave
<b>VKM</b>	Vendim i Këshillit të Ministrave.
<b>VKB</b>	Vendim i Këshillit Bashkiak.
<b>ISSAI</b>	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.
<b>INOTSAI</b>	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.
<b>ISA</b>	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
<b>IFAC</b>	Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve
<b>IPSAS</b>	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
<b>ALUIZNI</b>	Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave të Ndërtimeve Informale.
<b>IT</b>	Teknologjia e Informacionit.
<b>NJA</b>	Njësi Administrative.
<b>SHA</b>	Shoqëri Anonimë.
<b>BOE</b>	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë.
<b>OE</b>	Operator Ekonomik.

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

**I.a.** Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Bashkinë Tiranë në bazë të programit të auditimit, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr. 1268/2 prot, datë 18.12.2018, me afat auditimi nga data 19.12.2018 deri në datën 16.04.2019, për periudhën nga 01.01.2016 deri më 31.12.2018.

Auditimi u krye për pasqyrat financiare të vitit 2017-2018 si dhe veprimtarinë ekonomiko-financiare, mbi bazë materialiteti dhe vlerësim risku, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe monitorimi i tyre nga auditimi i brendshëm, mbajtja e kontabilitetit dhe hartimi i pasqyrave financiare, aplikimi i rregullave kontabël si dhe nëse transaksionet financiare janë në përputhje me kërkesat ligjore, rregullave të institucionit dhe parimeve për një qeverisje të mirë në përmbushje të objektivave të institucionit dhe ligjit nr. 139/15 dt. 17.12.15 “Për vetëqeverisjen vendore”, zbatimi i procedurave të prokurimit publik dhe të kontratave të lidhura, planifikimi, zhvillimi dhe mbrojtja e territorit. Për këto u analizuan pyetësorët e vetëvlerësimit, akt-rakordimet me thesarin, u krye analiza e posteve të bilancit dhe llogarive analitike me formatet shoqëruese të tyre.

-Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2017, janë konstatuar disa mangësi në mënyrën e paraqitjes të disa llogarive si dhe për disa llogari të tjera, janë konstatuar se mungojnë të dhënat e nevojshme kontabël analitike mbi përmbajtjen e tyre.

Në përfundim nga grupi i auditimit, është formuluar një opinion i kualifikuar me theksim të disa pasaktësive të cilat ngelen për tu sistemuar në të ardhmen nga Drejtoria e Financës së Bashkisë Tiranë. Materialiteti i llogarit, është 208,5014 mijë lekë. Disa nga gjetjet e konstatuara janë si vijon:

- Për vitin 2017, nga Drejtoria e Financës të Bashkisë Tiranë, ***nuk është ndjekur praktika e kontabilizimit të detyrimeve të angazhimit*** financiar bazuar në kontratat e lidhura me subjektet sipërmarrëse sipas procedurave të prokurimit si dhe ***nuk janë kontabilizuar detyrimet për shpenzimet e pa paguara të faturave të mbërritura për energjinë elektrike dhe për ujin e pijshëm.***

Mos kontabilizimi i detyrimeve të angazhimit dhe ato të konstatuara, janë në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, Kapitulli I - Mbajtja e kontabilitetit, pika 1-Parimet e përgjithshme.

- Në pasqyrat financiare, janë pasqyruar disa llogari të cilat nuk janë llogari bilanci dhe si të tilla ***duhej të ishin mbyllur në fund të vitit*** ushtrimor duke i sistemuar në llogari të tjera sipas përmbajtjes ekonomike të tyre, konkretisht:

***Llogaria 477 “Diferencë konvertimi aktive”*** për vlerën kontabël 1,563,808 lekë. Kjo vlerë është e trashëguar nga ish bilanci i Njesisë së Menaxhimit të Projekteve me Investime të Huaja (PIU) në vitin 2015. Për këtë llogari, nuk ka të dhëna analitike mbi përmbajtjen e saj.

***-Llogaria 45 “Marrëdhënia me institucionin brenda dhe jashtë sistemit”*** për vlerën kontabël 6,538,746 lekë. Edhe kjo vlerë është e trashëguar nga ish bilanci PIU në vitin 2015 por nga Drejtoria e Financës, nuk disponohen dokumente kontabël mbi përmbajtjen e kësaj llogarie.

Kjo praktikë është në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për Organet e Pushtetit Lokal, Institucionet Shtetërore, Qendrore dhe Lokale si dhe të Njësive që varen prej tyre” i ndryshuar dhe UMF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për Institucionet Qendrore, Organet e Pushtetit Vendor dhe Njësive që varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit /zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj” i ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007, Kap. II, pikat 1- Procedura të përgjithshme, pika 2- Funksioni i disa llogarive specifike të planit kontabël.

-Llogaria e bilancit 24 “*Aktive të qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara*” për vlerën kontabël 530,023,434 lekë, nga të cilat për vlerën 525,960,955 lekë përfaqëson vlera inventariale të identifikuara të vjedhura në periudhën e viteve paraardhëse, në ish Stacionin Hekurudhor të Tiranës. Për këto aktive të konsideruara të vjedhura, nga auditimi i kaluar nga KLSH-ja, është rekomanduar sistemimi i kësaj

llogarie duke nxjerrë edhe përgjegjësitë ndaj personave që i kanë pasur në administrim këto vlera inventariale.

Në këto kushte, pasqyrat financiare, nuk japin informacionin e nevojshëm mbi ekzistencën ose jo të aktiveve të pasqyruara në këtë llogari, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për Institucionet Qendrore, Organet e Pushtetit Vendor dhe Njësive që varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit /zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj” i ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007, Kap. II, pika 3- Procedurat e rakordimit dhe mbylljes së llogarive.

-Disa llogari të pasqyrave financiare janë marrë (trashëguar) nga bilanci i ish projektit PIU që nga viti 2015 por për këto llogari, mungojnë të dhënat analitike mbi përmbajtjen e tyre. Këto llogari, nuk janë sistemuar dhe prej vitesh mbahen në këtë gjendje në pasqyrat financiare, të Bashkisë Tiranë, konkretisht:

-Llogaria 409 “*Furnitorë (Debitorë), parapagime pagesa pjesore*” për vlerën kontabël 58,702,072 lekë, përfaqëson paradhënie të disbursuara për projekte me financim të huaj.

-Llogaria 511 “*Vlera për tu arkëtuar*” për vlerën kontabël 81,204,163 lekë, përfaqëson vlera për tu arkëtuar nga paradhënie të disbursuara për projekte me financim të huaj.

-Llogaria 512 “*Llogari në bankë*” për vlerën kontabël 24,651,518 lekë, nga të cilat për vlerën 13,950,271 lekë e trashëguar nga bilanci i PIU-t për të cilën nuk ka dokumentacion për përmbajtjen e saj e trashëguar që nga viti 2013, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për Institucionet Qendrore, Organet e Pushtetit Vendor dhe Njësive që varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit /zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj” i ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007, Kap. II, pika 3- Procedurat e rakordimit dhe mbylljes së llogarive dhe VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, Kapitulli I - Mbajtja e kontabilitetit, pikat 1-Parimet e përgjithshme dhe 2- Dokumentet kontabël, Kap. II, pika 1.1- Pasqyrat financiare vjetore.

-Nga analiza e llogarisë 467 “*Kreditorë të ndryshëm*” ku janë kontabilizuar detyrimet sipas vendimeve gjyqësore të formës së prerë për vlerën kontabël 468,746,202 lekë, konstatohet diferencë e madhe në kohë në disa raste mbi 5 vite, midis vendimit të formës së prerë të gjykatës dhe Urdhrit Ekzekutiv të Titullarit të Bashkisë, për kontabilizimin e detyrimit. Kjo gjë ka sjellë mos evidentimin në kohë të detyrimeve sipas vendimeve gjyqësore si dhe mos marrjen e masave për uljen e borxhit financiar ndaj të tretëve, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, Kapitulli I - Mbajtja e kontabilitetit, pika 1-Parimet e përgjithshme, UMF nr. 1, datë 4.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme në llogari të Thesarit” pikat 2, 3, 4, 6, UMF nr. 2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit” Kap. II, pika 102 dhe UMF nr. 8, datë 13.01.2017 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2017” pikat 81, 84.

Nga verifikimi rezultoi se Bashkia Tiranë (Autoritet Kontraktor), për vitin 2016, ka zhvilluar gjithsej 183 procedura prokurimi, me fondin limit pa TVSh në shumën 4,395,014,643 lekë, kontrata të lidhura pa TVSh në shumën 4,008,502,516 lekë, duke kursyer shumën prej 386,422,232 lekë ose në masën 9% të fondit limit pa TVSh të prokuruar, nga të cilat:

-“Blerje me vlerë të vogël”, 62 procedura, me fondin limit në total prej 18,379,289 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 16,631,324 lekë, duke kursyer shumën prej 1,747,966 lekë;

-“Kërkesë për propozim”, 18 procedura, me fondin limit në total prej 60,868,770 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 52,694,193 lekë, duke kursyer shumën prej 8,174,577 lekë.

-”Tender i Hapur”, 39 procedura, me fondin limit në total prej 3,702,209,125 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 3,373,301,231 lekë, duke kursyer shumën prej 328,907,231 lekë.

-”Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, 40 procedura, me fondin limit në total prej

596,558,305 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 550,558,305 lekë, duke kursyer shumën prej 45,910,767 lekë.

-”Shërbim konsulence”, 24 procedura, me fondin limit në total prej 16,999,154 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 15,317,463 lekë, duke kursyer shumën prej 1,681,691 lekë.

Për vitin 2017, ka zhvilluar gjithsej 294 procedura prokurimi, me fondin limit pa TVSh në shumën 7,644,513,342 lekë, kontrata të lidhura pa TVSh në shumën 7,297,394,093 lekë, duke kursyer shumën prej 347,119,249 lekë ose në masën 5% të fondit limit pa TVSh të prokuruar, nga të cilat:

-“Blerje me vlerë të vogël”, 49 procedura, me fondin limit në total prej 13,224,354 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 11,282,438 lekë, duke kursyer shumën prej 1,941,916 lekë;

-“Kërkesë për propozim”, 80 procedura, me fondin limit në total prej 154,277,161 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 131,040,362 lekë, duke kursyer shumën prej 23,236,799 lekë.

-”Tender i Hapur”, 59 procedura, me fondin limit në total prej 6,583,451,500 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 6,265,161,624 lekë, duke kursyer shumën prej 318,289,876 lekë.

-”Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, 91 procedura, me fondin limit në total prej 821,496,614 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 819,145,511 lekë, duke kursyer shumën prej 2,351,103 lekë.

-”Shërbim konsulence”, 15 procedura, me fondin limit në total prej 72,063,713 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 70,764,158 lekë, duke kursyer shumën prej 1,299,554 lekë.

Për vitin 2018, ka zhvilluar gjithsej 381 procedura prokurimi, me fondin limit pa TVSh në shumën 5,061,197,911 lekë, kontrata të lidhura pa TVSh në shumën 4,553,426,537 lekë, duke kursyer shumën prej 507,771,374 lekë ose në masën 10% të fondit limit pa TVSh të prokuruar, nga të cilat:

-“Blerje me vlerë të vogël”, 32 procedura, me fondin limit në total prej 15,840,854 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 12,972,950 lekë, duke kursyer shumën prej 2,867,904 lekë;

-“Kërkesë për propozim”, 46 procedura, me fondin limit në total prej 110,723,203 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 97,513,061 lekë, duke kursyer shumën prej 13,210,142 lekë.

-”Tender i Hapur”, 39 procedura, me fondin limit në total prej 4,260,166,969 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 3,771,292,724 lekë, duke kursyer shumën prej 488,874,245 lekë.

-”Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, 26 procedura, me fondin limit në total prej 466,778,979 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 466,342,963 lekë, duke kursyer shumën prej 436,016 lekë.

-”Shërbim konsulence”, 45 procedura, me fondin limit në total prej 123,991,549 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 121,608,482 lekë, duke kursyer shumën prej 2,383,067 lekë.

Janë realizuar gjithashtu blerje nëpërmjet sistemit dinamik të blerjes dhe minikontrata sipas marrëveshjeve kuadër në total 186 procedura në shumën prej 507,771,374 lekë

Në procedurat e zhvilluara gjatë vitit 2018, me përjashtim të blerjeve me vlerë të vogël, në 8 procedura ka patur vetëm 1 OE pjesëmarrës, në 15 procedura rezultojnë OE me ofertë më të ulët të s’kualifikuar dhe në procedurat e tjera, edhe pse mund të ketë OE të s’kualifikuar, ofertat e paraqitura prej tyre janë mbi atë të shpallur fituese dhe si të tilla nuk vlerësohen me risk nga pikëpamja materiale.

Për vitin 2017 u audituan gjithsej 24 procedura të prokurimit publik, nga të cilat 21 procedura të hapura dhe 3 procedura me negocim pa shpallje paraprake të botimit të kontratës. Vlera totale e fondit limit të procedurave të audituara është 3,775,613,808 lekë, ndërsa vlera e kontratave të lidhura është 3,375,935,246 lekë, ose 11% më e ulët se vlera e fondit limit.

Për gjetjet e konstatuara janë mbajtur 23 akte të cilat janë dorëzuar në protokollin e subjektit të auditimit brenda afatit të periudhës së auditimit datë 16.04.2019.

Me shkresën nr. 16455/2, datë 03.05.2019, nga subjekti Bashkia Tiranë janë paraqitur vërejtjet e akteve të mbajtura, ku pasi u lexuan me kujdes, paanshmëri dhe profesionalizim nga ana e grupit të auditimit të KLSH, u morën në konsideratë ato raste për të cilat kishin mbështetje ligjore me dokumentacion, ndërsa rastet e tjera të cilat nuk gjejnë argumentin e duhur ligjorë, gjejnë pasqyrim në këtë Projekt raport Auditimi, i cili i dërgohet subjektit për njohje dhe vërejtje të tjera nëse do kenë.

### I.b. Përmbledhje e gjetjeve kryesore

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin	Rëndësia	Rekomandimi
1	- Për vitin 2016 nuk është hartuar bilanc i konsoliduar, pasi mungon struktura e posaçme për pranimin, kontrollin dhe përpunimin të informacionit kontabël të sjellë nga 19 njësi të varësisë së Bashkisë Tiranë. Si rezultat i mungesës së strukturës edhe në rregulloren e brendshme të miratuar me vendimin e kryetarit nr.429 datë 08.01.2016 “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së institucionit të Bashkisë Tiranë”. Kjo detyrë nuk është përfshirë në përcaktimet e detyrave dhe përgjegjësi në rregulloren e organizimit dhe funksionimit të brendshëm të Bashkisë.		I lartë	Bashkia Tiranë të krijojë në organigramën e saj strukturë të veçantë me detyrat dhe përgjegjësitë të refektuar në Rregulloren e funksionimit për marrjen në dorëzim, kontrollin dhe hartimin e pasqyrave financiare të konsoliduar, të cilat të miratohen nga titullari i institucionit dhe të raportohen në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë në fund të çdo viti ushtrimor, duke respektuar afatet e miratuara në dispozitat ligjore në fuqi.
2	Kontabilizimi i veprimeve ekonomike për kontrata të lidhura blerje mallrash apo investimesh nuk është bërë për vlerë të plotë të kontratës, por në momentin e mbërritjes së faturave për blerje malli e shërbimesh dhe investime të shoqëruar me situacion për punime të kryera. Efektet e veprimeve ekonomike dhe të ngjarjeve të tjera ekonomike të kryera nuk janë marrë në llogari në kohën e kryerjes së veprimit apo të ndodhjes së ngjarjes, por me mbërritjen e faturës dhe çeljen e fondeve dhe jo thjesht kur ndërhyjnë pagesa ose marrja e likuiditeteve. Pra regjistrimet kontabël nuk janë kryer në kohën e lindjes të një detyrimi për t'u paguar nga njësi ekonomike, detyrime këto që sjellin pagesa, dhe që kanë sjellë për ushtrimin e dhënë shpenzime.		I mesëm	Drejtoria e Financës në Bashkinë Tiranë të kryejë veprimet e kontabilizimit për vlerë të plotë të kontratave për mallra e shërbime në momentin e nënshkrimit të tyre.
3	Njësi e Menaxhimit të Projekteve PIU deri në nëntor të vitit 2015 ka qenë njësi shpenzuese me vete dhe ka menaxhuar 3 projekte investimi me financim të huaj (kredi). Meqenëse në vitin 2015 kjo njësi është shkrirë në strukturat e Bashkisë Tiranë si Drejtori brenda Aparatit të bashkisë, edhe bilanci i mbylljes së llogarive të vitit 2015 nga PIU është bërë pjesë e pasqyrave financiare të Bashkisë Tiranë të mbyllje të vitit ushtrimor 2015. Ky bilanc u trashëguua me disa paqartësi në gjendjet e disa llogarive, llogari të cilat deri në fund të vitit 2018 nuk kanë funksionuar sipas parimeve e logjikës kontabël. Për këto gjendje llogarish nuk është ndërmarrë asnjë veprim rregullues kontabël, për arsye të mungesës së informacionit kontabël i shoqëruar me analiza si dhe mungesës së dokumentacionit bazë e justifikues. Në mënyrë të		I mesëm	Bashkia Tiranë të krijojë mundësinë me specialist të fushës të jashtëm dhe të brendshëm për gjetjen dhe përpunimin e të dhënave e dokumentacionin bazë e justifikues për shpjegimin dhe analizimin e gjendjeve të këtyre llogarive, si dhe kryerjen e veprimeve përkatëse sistemuese kontabël, duke i reflektuar ato në PF e mbylljes së vitit ushtrimor 2019.

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>detajuar këto llogari si pjesë të Bilancit të Aparatit të Bashkisë Tiranë në mbyllje të vitit ushtrimor 2016 paraqiten si më poshtë:</p> <p><b>a. Gjendja e llog. 232 “Shpenzime proces për transferime kapitale”</b> në vlerën <b>1,157,802,262 lekë</b>, për të cilën nuk ka analizë dhe mungon informacioni kontabël si dhe dokumentar, se çfarë ka të përfshirë dhe çfarë përfaqëson kjo shumë.</p> <p><b>b. Gjendja e llog. 409 “Furnitorë (debitorë), parapagime pagesa pjesore”</b> në vlerën <b>58,702,072 lekë</b>, për të cilën nuk ka analizë dhe mungon informacioni kontabël si dhe dokumentar, se çfarë ka të përfshirë dhe çfarë përfaqëson kjo shumë.</p> <p><b>c. Gjendja e llog. 45 “Marrëdhënie me institucione Brenda dhe jashtë sistemi”</b> në vlerën <b>6,538,746 lekë</b>, e cila duhet të ishte mbyllur, pasi nuk duhej të paraqitej në bilanc me gjendje. Për këtë gjendje nuk ka asnjë informacion kontabël se çfarë përfaqëson e për rrjedhim për këtë vlerë nuk ka analizë.</p> <p><b>d. Gjendja e llog. 511 “Vlera për t’u arkëtuar”</b> në vlerën <b>81,204,163 lekë</b>, për të cilën nuk ka asnjë informacion kontabël se çfarë përfaqëson, e cila sipas rregullit kontabël duhet të përfaqësojë vlerën e letrave të pagesave që janë të depozituara në bankë në pritje për t’u arkëtuar, si interesa të paguara ose të maturuara.</p> <p><b>e. Pjesë e gjendjes së llog. 512 “Llogari në bankë”</b> është edhe <b>vlera prej 13,950,271 lekë</b>, për të cilën Bashkia nuk disponon ekstrakt apo “dokument bankar që të konfirmojë këtë shumë. Për këtë shumë nuk ka informacion se çfarë është dhe si ka vazhduar ecuria e saj deri më tani, çfarë veprimesh janë kryer me këtë gjendje të trashëguar që nga viti 2013.</p> <p><b>ë. Gjendja e llog. 477 “Diferenca konvertime aktive”</b> në vlerën <b>1,563,808 lekë</b>, për të cilën nuk ka asnjë informacion kontabël se si ka rezultuar kjo shumë, që sipas funksionimit të kësaj llogarie kjo llogari duhej të ishte mbyllur me shpenzimet dhe jo me fondin themeltar, pasi pasqyron diferencat aktive që lidhen me konvertimet nga vlerësimi i kërkesave debitorë dhe detyrimet të shprehura në monedhe të huaj.</p> <p><b>f. Gjendja e llog. 17 “Huamarrje e huaj”</b> për vlerën pjesore prej <b>1.382.417.487 lekë</b> të trashëguar nga PIU, e cila përfaqëson vlerën e disbursimeve nga tre kreditë për pagesat e furnitorëve për faturat e investimeve në masën 80%. Për këtë shifër nuk ka analiza sipas projekteve të investimeve e disbursimeve (sipas burimeve të financimit të huaj) të kredive.</p>			
4	<p>Nga auditimi i programimit, aprovimit, realizimit dhe monitorimit të buxhetit për vitin 2016, u konstatua se:</p> <p><b>a.</b> Mungojnë metodologjitë e planifikimit sipas produkteve dhe qendrave të kostos, të cilat ndihmojnë subjektet publike që jo vetëm të përlllogarisin saktë nevojat për planifikim, por edhe të monitorojnë saktë dhe drejtë realizimin e objektivave të njësisë. Vetëm nëpërmjet aplikimit të këtyre metodave, Institucioni</p>		I mesëm	<p><b>a.</b> Strukturat drejtuese të këtij institucioni, në bashkëpunim me Grupet e Menaxhimit të Programeve dhe me strukturat që mbulojnë planifikimin dhe monitorimin e buxhetit, të përcaktojnë qartë në programimin e PBA, por dhe në planifikimin vjetor, mënyrat dhe metodologjinë e përlllogaritjes së kostos së</p>



Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>(dhe si pasojë palët e interesuara) mund të zbulojnë nëse aktivitetet e njësisë janë në linjë me qëllimet dhe objektivat strategjike të saj.</p> <p><b>b.</b> Buxheti për vitin 2016 paraqitet me një performancë jo të kënaqshme në lidhje me nivelin e ulët të realizimit të fondeve në masën 60 %, ndërkohë që në datë 31.12.2016 detyrimet e papaguara janë në nivel të lartë në shumën <b>3.374.968.459</b> lekë ose në masën 23% të shpenzimeve totale të planifikuara. Akumulimi i një borxhi të konsiderueshëm në fund të vitit 2015 në vlerën prej 5,504,207,407 lekë, ka ndikuar që edhe në fund të vitit 2016 niveli i borxhit të jetë në nivel të lartë, pavarësisht shlyerjes në masën 52% të detyrimeve të trashëguara nga viti 2015.</p> <p><b>c.</b> Nëpunësi autorizues ka paraqitur në mënyrë periodike, në Këshillin Bashkiak, raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit, për performancën financiare, aktivitetet dhe objektivat e realizuara për çdo projekt, të përcaktuara në vitin e parë të dokumentit përfundimtar të projektit buxhetor afatmesëm”, nga ku konstatohet se ka mangësi për sa i takon analizës së aktiviteteve në bazë produktesh për çdo program. Programimi i projekteve të reja të investimeve për vitin ushtrimor pa përfunduar financimin e projekteve të investimeve në vazhdim, duke zgjatur punimet dhe financimet e tyre përtej kontratave nga 1-3 vjet, realizimi në masën 21% i fondeve për investime nga FZHR si dhe ndryshimet e vazhdueshme nëpërmjet procedurave të sipërpërmendura janë tregues i planifikimeve jo të qëndrueshme, të mefshtësisë dhe mos efektivitetit në përdorimin e fondeve, të cilat gjatë vitit ushtrimor kanë rrisur dhe nxitur shkurtimin e mosrealizimit shpenzimeve të miratuara, ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke e kthyer procesin e buxhetimit, të përlogaritjes së kostos së produkteve dhe realizimin e tyre, në një mjet jo real, të paqëndrueshëm dhe jo efektiv.</p>			<p>aktiviteteve në bazë produktesh për çdo program me qëllim arritjen e objektivave dhe minimizimin e shmangieve nga këto objektiva. Procesi i planifikimit të buxhetit të kryhet në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme me qëllim rritjen e transparencës, përgjegjshmërisë në përdorimin e fondeve publike si dhe përmirësimin e planifikimit dhe ekzekutimit të buxhetit të vitit koherent në arritjen e objektivave. Shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve dhe të sigurojë një përdorim eficient të burimeve financiare, si dhe të ruajë stabilitetin makroekonomik e fiskal.</p> <p><b>b.</b> Nevojitet të gjurmohet saktë dhe drejtë konsumimi i burimeve të nevojshme, duke synuar shpërndarjen e shpenzimeve (kostove) sipas aktiviteteve që i “shkaktojnë” këto kosto, me qëllim ndjekjen e kujdesshme të kostove për efekte buxhetore duke synuar minimizimin e rishpërndarjeve mes zërave buxhetore brenda vitit ushtrimor. Të rritet performanca e realizimit të buxhetit në nivel të kënaqshëm në termat e produkteve, si dhe të merren angazhime për të marrë veprimet e duhura korrigjuese për të përmirësuar situatën dhe aty ku është e nevojshme të ndërhyhet.</p>
5	<p>Bashkia Tiranë ka akumuluar në fund të vitit 2018 <b>një borxh prej 2,538,930,790.37 lekë</b> ( i konvertuar 20.571.469,70EUR), kur në PBA dhe buxhetet e viteve 2009-2018 janë programuar fonde në artikullin 55 “Interesa, komisione dhe principal për t’u paguar” në mënyrë të pjesshme dhe realizim minimal për detyrimet për shërbimin e borxhit ndaj Ministrisë së Financave të Ekonomisë për nën-Huatë e marra:</p> <p>- Nga BERZH për <b>Projektin “Zhvillimi i Rrugëve të Tiranës”</b> me vlerë kredie 1,096,258,000 lekë (8,200,000 EUR), planifikuar në vitet 2009-2017 në shumën 1,004,116,826 lekë dhe realizuar në fakt në shumën 278,431,797 lekë ose në masën 28%, kur në fund të vitit 2018 rezulton <b>detyrimi i akumuluar 656,546,192.15 lekë</b> (5,319,609 EUR).</p> <p>- Nga CEB për Projektin <b>“Programi i Zhvillimit dhe Rehabilitimit të Shkollave”</b> me vlerë kredie 1,096,258,000 lekë (8,200,000 EUR), planifikuar në vitet 2011-2017 në shumën 384,200,000 lekë dhe i</p>		<b>I lartë</b>	<p><b>a.</b> Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar të marrë masa për përfshirjen në programimin e buxhetit të fondeve dhe të sigurojë likuiditetin e nevojshëm me qëllim shlyerjen e detyrimeve të lindura për borxhin vendor dhe shërbimin e tij në përputhje me kushtet dhe afatet e kontraktuara për 4 kreditë e nën-huazuara nga MFE me financim të huaj, për të ulur nivelin e këtij borxhi të akumuluar nga mos pagesat në vite me ndikim direkt në borxhin publik të Shtetit Shqiptar.</p>

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>realizuar në masën 0 %, kur në fund të vitit 2018 rezulton <b>detyrimi i akumuluar 776,723,195.88 lekë</b> (6,293,333 EUR).</p> <p>- Nga Abu Dhabi për Projektin “Ndërtimi i Bulevardit Verior dhe Rehabilitimi i Lumit të Tiranës” me vlerë kredie 7,367,928,000 lekë (240,000,000 AED ose 57,429,392.1 EUR ), planifikuar në vitet 2015 e 2018 në shumën 104,000,000 lekë, i cili është realizuar në masën 0 %, kur në fund të vitit 2018 rezulton <b>detyrimi i akumuluar 832,019,515.14 lekë</b> (28,172,175 AED ose 6,741,367 EUR).</p> <p>- Nga CEB për projektin “Ndërtimi i banesave me qellim social” me vlerë kredie 848,530,000 lekë (6,347,000 EUR), i pa planifikuar në asnjë vit buxhetor, kur në fund të vitit 2018 rezulton <b>detyrimi i akumuluar 273,641,887.2 lekë</b> (2,217,160 EUR).</p>			
6	<p>-Në Bashkinë Tiranë, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë elektronike sipas programit “Alfa” i cili mundëson regjistrimin e veprimeve kontabël në përputhje me planin kontabël të miratuar me VKM nr. 248, datë 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe të njëjstëve që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.1.2001.</p> <p>Për vitin 2017, nga Drejtoria e Financës të Bashkisë Tiranë, <b>nuk është ndjekur praktika e kontabilizimit të detyrimeve të angazhimit</b> financiar bazuar në kontratat e lidhura me subjektet sipërmarrëse sipas procedurave të prokurimit si dhe <b>nuk janë kontabilizuar detyrimet për shpenzimet e pa paguara të faturave të mbërritura për energjinë elektrike dhe për ujin e pijshëm.</b></p> <p>-Këto praktika pasi në kontabilitet, është ndjekur praktika e regjistrimit të tyre direkt me pagesën në debi të llogarive të klasës së VI pa i kontabilizuar më parë si detyrime në llogaritë kreditore.</p> <p>Referuar shpenzimeve për energji elektrike dhe për furnizim me ujë të pijshëm ta paguar në muajin e fundit të vitit 2017, konstatohet se janë paguar gjithsej 13,400,216 lekë nga të cilat:</p> <p>Për energjinë elektrike 26 faturime në shumën totale 9,787,636 lekë dhe furnizim me ujë nga UK Tiranë për 23 faturime në shumën 3,612,580 lekë.</p> <p>-Bashkia e Tiranës ka në vartësi 18 Institucione vartëse. Nga Drejtoria e Financës, <b>nuk janë përgatitur pasqyrat financiare të konsoliduara</b> të Bashkisë Tiranë për periudhën ushtrimore të vitit 2017, në kundërshtim me kërkesat ligjore.</p>		I lartë	<p>Drejtoria e Financës, të organizojë kontabilitetin me qëllim që në Pasqyrat Financiare të fund vitit, të pasqyrohen të gjitha detyrime financiare të pa paguara përfshi edhe ato të angazhimit sipas kontratave të lidhura me të tretët.</p> <p>Të përgatiten pasqyrat përmbledhëse të konsoliduara ku të përfshihet gjendja financiare të njëjstëve vartëse.</p>
7	<p>-Në pasqyrat financiare, janë pasqyruar disa llogari të cilat nuk janë llogari bilanci dhe si të tilla <b>duhej të ishin mbyllur në fund të vitit</b> ushtrimor duke i sistemuar në llogari të tjera sipas përmbajtjes ekonomike të tyre, konkretisht:</p> <p><b>-Llogaria 477 “Diferencë konvertimi aktive”</b> për</p>		I mesëm	<p>Drejtoria e Financës, të marrë masa dhe të analizojë përmbajtjen e këtyre llogarive mbi bazën e dokumenteve duke i kërkuar ato në arkivin e institucionit ose që i përkasin projektit PIU.</p> <p>Të procedojë sipas kërkesave ligjore për</p>

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>vlerën kontabël 1,563,808 lekë, nuk ka ndryshime gjatë vitit 2017.</p> <p>Kjo vlerë është e trashëguar nga ish bilanci PIU në vitin 2015. Kjo llogari nuk është mbyllur në fund të vitit ushtrimor, <b><i>nuk janë bërë veprimet e nevojshme për mbylljen e kësaj llogarie</i></b>, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për Organet e Pushtetit Lokal, Institucionet Shtetërore, Qendrore dhe Lokale si dhe të Njësive që varen prej tyre” i ndryshuar dhe UMF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore 2007, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor” i ndryshuar.</p> <p><b><i>-Llogaria 45 “marrëdhënie me institucionin brenda dhe jashtë sistemit”</i></b> për vlerën kontabël 6,538,746 lekë, nuk ka ndryshime gjatë vitit 2017.</p> <p>Kjo vlerë është e trashëguar nga ish bilanci PIU në vitin 2015 por nga Drejtoria e Financës, <b><i>nuk disponohen dokumente kontabël mbi përmbajtjen e kësaj llogarie</i></b> dhe për rrjedhojë, në fund të vitit ushtrimor, nuk janë bërë veprimet e nevojshme për mbylljen e kësaj llogarie, në kundërshtim me kërkesat ligjore.</p>			<p>sistemimin kontabël të këtyre llogarive duke krahasuar ato me gjendjet fizike reale të tyre dhe njëkohësisht të nxjerrë përgjegjësitë përkatëse nëse konstatohen këto përgjegjësi.</p>
8	<p>Llogaria e bilancit 24 “Aktive të qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara” për vlerën kontabël 530,023,434 lekë, <b><i>pakësuar</i></b> gjatë vitit 2017 për (576,207,855-530,023,434)= 46,184,421 lekë.</p> <p>Vlera prej 525,960,955 lekë është vlera e aktiveve të kaluara nga Hekurudha Shqiptare sh.a për Bashkinë Tiranë në vitet paraardhëse. Kontabilizimi i kësaj vlere në këtë llogari, është bërë në zbatim të rekomandimit të KLSH-së nga auditimi i kaluar me këtë formulim:</p> <p><b><i>“Bashkia e Tiranës të analizojë procedurat e ndjekura, lidhur me vjedhjen e aseteve në ish Stacionin Hekurudhor të Tiranës në vlerën 525,960,955 lekë.</i></b></p> <p><b><i>Të bëhet vlerësimi me komision i aseteve të tjera të konstatuara të vjedhura si: 276 ml gardh hekuri, 488 ml linjë hekurudhore dhe 22 copë ndërruese shinash dhe të nxirret përgjegjësia administrative dhe ligjore ndaj personave të ngarkuar për ruajtjen dhe marrjen në dorëzim.</i></b></p> <p><b><i>Të miratohen me vendim të Këshillit të Bashkisë diferencat për tu shkarkuar nga kontabiliteti në zbatim të kërkesave të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore” i ndryshuar neni 32, duke kryer veprimet e duhura në kontabilitetin e Bashkisë”.</i></b></p> <p>Lidhur me këtë rekomandim, nuk na u paraqitën dokumente për procedurat administrative dhe ligjore për sistemimin e kësaj llogarie duke nxjerrë edhe përgjegjësitë ndaj personave që i kanë pasur në administrim këto inventarë me argumentimin si vijon:</p> <p><b><i>“Nuk mund të bëhet vlerësim për aktive që nuk ekzistojnë që kapin vlerën 525,960,955 lekë, kurse</i></b></p>		I lartë	<p>-Drejtoria e Financës, të procedojë sipa kërkesave ligjore për sistemimin kontabël të këtyre llogarive duke i krahasuar ato me gjendjet fizike reale të tyre dhe njëkohësisht të nxjerrë përgjegjësitë përkatëse nëse konstatohen këto përgjegjësi.</p>

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin	Rëndësia	Rekomandimi
	<p><i>për pjesën tjetër ekzistente janë pjesë e inventarit dhe nuk përfshihen në këtë vlerë.</i></p> <p><i>Nuk mund të nxirret përgjegjësia administrative për ruajtjen e këtyre mungesave pasi nuk ka patur urdhër dhe strukturë të ngarkuar për ruajtjen e këtyre aktiveve nga momenti marrjes në dorëzim në vitin 2013.</i></p> <p><i>Nuk është nxjerrë përgjegjësia administrative ndaj komisionit të marrjes në dorëzim pasi në momentin e marrjes në dorëzim aktivet kanë qenë të plota dhe mungesat janë konstatuar në periudhat e mëvonshme për shkak të mos mundësisë së rruajtjes së këtyre aktiveve dhe shkatërrimit të pjesës ku sot është bërë bulevardi i ri i Tiranës ku janë bërë dhe shpronësime.</i></p> <p><i>Në momentin e konstatimit të humbjeve është bërë denoncim në polici dhe ka vazhduar për procedim në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë e cila ka hapur procedurën nr.180 datë 17.01.2014, nr. 2263 datë 11.07.2014 dhe nr. 3151 datë 17.10.2014.</i></p> <p><i>Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar (DPMF) nuk ka asnjë informacion zyrtar për rezultatin dhe se si është ndjekur ky problem, pas denoncimit në Polici dhe kalimit të çështjes në Prokurori, gjë që duhej të ndiqej nga strukturat përkatëse në Bashki. Për këtë arsye nuk është marrë asnjë veprim për futjen në KB për njohjen e humbjeve dhe dhënien e një vendimi për sistemim kontabël të kësaj llogarie.”</i></p> <p>-Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” për vlerën kontabël 332,981,900 lekë, <b>pakësuar</b> gjatë vitit 2017 për (335,387,732-332,981,900)= 2,405,832 lekë.</p> <p>Kjo llogari është e analizuar me të dhënat si më poshtë vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-86,724,972 lekë, janë kontabilizuar debitorë persona fizikë dhe juridikë sipas rekomandimeve nga auditimet e mëparshme të KLSH-së si dhe të tjera për mungesa inventariale etj.</li> <li>-35,603,512 debitorë të trashëguara nga njësitë administrative,</li> <li>-3,945,648 lekë debitorë për taksat e pullës për gjendjen civile dhe</li> <li>-206,707,769 lekë debitorë trashëguar nga ish komunat.</li> </ul> <p><b>Vlera për 206,707,769 lekë, përfaqësojnë debitorë për taksat dhe tarifa vendore të cilat i përkasin Njësive Administrative (Ish Komuna) deri më datën 31.07.2015, detyrime këto të trashëguara nga pasqyrat financiare në mbyllje të aktivitetit të ish komunave dhe të paraqitura në pasqyrat financiare të Bashkisë Tiranë.</b></p> <p>Për arkëtimin e këtyre detyrimeve ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme Menaxhimit Financiar në Bashkinë Tiranë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatim Taksave Vendore e ngarkuar për vjeljen e detyrimeve tatimore, nuk është hapur dhe mbajtur llogari ndërmjetëse ose transferimin e këtyre aktiveve.</p>			

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin	Rëndësia	Rekomandimi
9	<p>-Disa llogari të pasqyrave financiare janë marrë (trashëguar) nga bilanci i ish projektit PIU që nga viti 2015 por për këto llogari, mungojnë të dhënat analitike mbi përmbajtjen e tyre. Këto llogari, nuk janë sistemuar dhe prej vitesh mbahen në këtë gjendje në pasqyrat financiare, të Bashkisë Tiranë, konkretisht:</p> <p>-Llogaria 409 “Furnitorë (Debitorë), parapagime pagesa pjesore” për vlerën kontabël 58,702,072 lekë, nuk ka ndryshime gjatë vitit 2017. Përfaqëson paradhënie të disbursuara për projekte me financim të huaj. Trashëguar nga ish PIU në vitin 2015.</p> <p>-Llogaria 511 “Vlera për tu arkëtuar” për vlerën kontabël 81,204,163 lekë, nuk ka ndryshime gjatë vitit 2017. Përfaqëson vlera për tu arkëtuar nga paradhënie të disbursuara për projekte me financim të huaj. Trashëguar nga ish PIU (Njësia e Menaxhimit të Projekteve me Investime të Huaja) në vitin 2015. Për këtë llogari nuk ka të dhëna analitike mbi përmbajtjen e saj.</p> <p>-Llogaria 512 “Llogari në bankë” për vlerën kontabël 24,651,518 lekë, shtuar gjatë vitit 2017 për (24,651,518-23,564,926)= 1,086,592 lekë. Kjo llogari përbëhet nga:</p> <p>1. Pjesë e gjendje së kësaj llogarie për vitin në vitin 2017 është <b>shuma 10,701,247 lekë</b>, e cila përfaqëson vlerën e rimarrjes (arkëtuar) së kredisë nga 12 bizneset e mesme e të vogla të kredituar nga B... të garantuara nga Bashkia Tiranë sipas marrëveshjes në vitin 2013 të “Fondit të Garancisë” në vlerën 10,000,000 lekë të nënshkruar me BKT në kuadër të “Programit të Zhvillimit Ekonomik dhe Punësimit” të miratuar me VKB e asaj kohe. Gjendja në fund të vitit 2016 është në vlerën 9,614,655 lekë dhe diferenca prej 1,086,592 lekë është vlera shtesë për vitin 2017 e rimarrjes në vazhdim të kësteve të kredisë. Pra është kthim i fondi të garancisë.</p> <p>2. Pjesë e gjendjes së kësaj llogarie është edhe vlera prej 13,950,271 lekë që i përket bilancit të PIU-t për të cilën nuk ka informacion për përmbajtjen e saj gjendje e trashëguar që nga viti 2013.</p>		I lartë	<p>- Të merren masa për të saktësuar vërtetësinë e llogarive; 409 “Furnitorë (Debitorë), parapagime pagesa pjesore”, 511 “Vlera për tu arkëtuar” dhe 512 “Llogari në bankë” bazuar në dokumentacionin kontabël ligjor të bilancit të Njesisë së Menaxhimit të Projekteve me Investime të Huaja (PIU). Të bëhen sistemimet kontabël të nevojshme bazuar në procedurat ligjore dhe për çdo rast pasaktësie ose shkelke ligjore, të nxirren përgjegjësitë përkatëse ligjore.</p>
10	<p>-Për kryerjen e shpenzimeve janë ndjekur procedurat sipas rregullores së brendshme dhe të organizimit të strukturës organizative. Të gjitha shpenzimet e kryera në Bashkinë e Tiranës dorëzohen me shkresa përcjellëse me kërkesa për financim në Drejtorinë e Përgjithshme të Menaxhimit Financiar. Pas marrjes së praktikave sipas tipologjisë së tyre për shpenzime operative/kapitale, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar kryen kontrollin e nevojshëm financiar të praktikës si urdhër prokurimi/ Proces verbalet /njoftimet e fituesit/kontrata/ fatura/ situacione/ Proces verbale të marrjeve në dorëzim/ Fletë hyrje etj. Pas kontrollit kryhet kontabilizimi i praktikës dhe delegohet te sektori i pagesave për nisjen e hartimit të urdhër shpenzimit. Urdhër shpenzimi pasi përpilohet me të gjitha fushat</p>		I lartë	<p>- Të merren masa për të përmirësuar procedurat për kontrollin e financimit të investimeve sipas kontratave të lidhur me të tretët. Për këtë me urdhër të veçantë të Titullarit të Bashkisë ose duke e sanksionuar në rregulloren e funksionimit të brendshëm të institucionit, të parashikohet që për çdo rast, në përfundim të investimit, të bëhet rakordimi me midis Drejtorisë së Financës dhe Drejtorisë Përkatëse të Zbatimit të Kontratave për faturat e paraqitura dhe të paguara, vlerës së situacionit përfundimtar si dhe për llogaritjen e penaliteteve të mundshme ndaj sipërmarrësit të shërbimit apo punimeve.</p>

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>regjistrohet në sistemin SIFQ dhe përcillet te Nëpunësi Autorizues dhe Zbatues për firmosjen /aprovimin e tyre. Bashkëngjitur urdhër shpenzimet janë dokumentet justifikues të kryerjes së këtij shpenzimi.</p> <p>Pas firmosjes/ aprovimit urdhër shpenzimet së bashku me dokumentacionin justifikues dorëzohen te Dega e Thesarit Tiranë për ndjekjen e procedurave nga ana e tyre. Pas marrjes së konfirmimeve nga Dega e Thesarit, urdhër shpenzimet dhe dokumentacionet justifikuese arkivohen në dosjet përkatëse.</p> <p><b>Megjithatë, në praktikën e ndjekur për pagesën e fituarave të paraqitura në Drejtorinë e Financës, konstatohet se nga Drejtoritë përkatëse që ndjekin zbatimin e kontratave, në përfundim të investimit, nuk është deklaruar me shkrim për Drejtorinë e Financës, nëse ka pasuar mos zbatim në afat të kontratave dhe për rrjedhojë llogaritje të penaliteteve të mundshme.</b></p> <p>-Përgjithësisht bashkëngjitur urdhër shpenzimeve, janë bashkëngjitur dokumentet justifikues kontabël por në disa raste u konstatuan edhe mangësi:</p> <p>Gjatë vitit 2017, janë paguar shpenzime për telefonat celularë për punonjësit e administratës gjithsej në shumën <b>2,649,206 lekë</b>. Për këto pagesa nuk na u paraqitën urdhra nga Titullari i Bashkisë për personat përfitues të këtij shërbimi. Në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 864, datë 23.07.2010 “Për pajisjen me telefon celular të personave juridikë publikë” neni 11 “ Drejtuesit e organeve të pushtetit vendor kanë të drejtë të urdhërojnë pajisjen me numër telefoni celular të personave zyrtarë, bazuar në detyrën që kryejnë dhe brenda fondeve të parashikuara në buxhetin vjetor, sipas specifikimeve të mësipërme. Shpenzimet për këtë shërbim, në nivel vjetor, të jenë në çdo rast, jo më shumë se 2% e totalit të shpenzimeve për mallra dhe shërbime, të miratuara për çdo institucion në buxhetin vjetor përkatës.”</p> <p>Konkretisht përmendim si në rastet e pagesave me urdhër shërbimet:</p> <p>-Urdhër shpenzimi nr. 3189 datë 30.11.2017 paguar E... Nipt J.... për 2,500 lekë për limit telefoni celular për muajin Tetor 2017.</p> <p>-Me urdhër shpenzimi nr. 3415 datë 22.12.2017, paguar V.... limit telefon celulari për E... shuma 10,500 lekë muaji Nëntor 2017.</p> <p>-Me urdhër shpenzimi nr. 3416 datë 22.12.2017, paguar P... sha K...limit telefon celulari për K... shuma 3,628 lekë muaji Nëntor 2017.</p> <p>-Me urdhër shpenzimi nr. 3107 datë 22.11.2017, paguar T... sha J... limit telefoni Tetor 2017 për A... shuma 9,108 lekë etj. raste.</p>			Titullari i Bashkisë, të miratojë listën për personat që do të jenë përfitues të shpenzimeve për telefon celular sipas kërkesave të VKM nr. 864, datë 23.07.2010 “Për pajisjen me telefon celular të personave juridikë publikë”.
11	-Përgjithësisht gjendja e debitorëve dhe kreditorëve, janë të analizuara sipas përmbytjes së tyre dhe periudhës së krijimit. Konkretisht:		<b>I lartë</b>	- Nga Bashkia, të merren masa që në programet buxhetore, të programohen financimi i detyrimeve ndaj të tretëve me

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>-Llogaria 468 “<i>Debitorë të ndryshëm</i>” për vlerën kontabël 332,981,900 lekë, <b>pakësuar</b> gjatë vitit 2017 për (335,387,732-332,981,900)= 2,405,832 lekë.</p> <p>Kjo llogari është e analizuar me të dhënat si më poshtë vijon:</p> <p>-86,724,972 lekë, janë kontabilizuar debitorë persona fizikë dhe juridikë sipas rekomandimeve nga auditimet e mëparshme të KLSH-së si dhe të tjera për mungesa inventariale etj.</p> <p>-35,603,512 debitorë të trashëguara nga njësitë administrative,</p> <p>-3,945,648 lekë debitorë për taksat e pullës për gjendjen civile dhe</p> <p>-206,707,769 lekë debitorë trashëguar nga ish komunat.</p> <p><b>-Llogaritë 401-408 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to”.</b> Për vlerën kontabël 4,442,437,198 lekë. Kjo llogari për vitin 2017, është shtuar për vlerën (4,442,437,198- 3,045,844,648)= 1,396,592,550 lekë. Gjendja e kësaj llogarie është e analizuar sipas kreditorëve ku:</p> <p>-592,422,444 lekë i përkasin llogarisë 401 “<i>Furnitorë dhe llogari të lidhura me to</i>” për blerje mallra e shërbime dhe</p> <p>-3,850,014,754 lekë i përkasin llogarisë 404 “<i>Furnitorë dhe llogari të lidhura me to</i>” për investime.</p> <p>-Llogaria 467 “<i>Kreditorë të ndryshëm</i>” për vlerën kontabël 1,461,411,756 lekë, <b>pakësuar</b> gjatë vitit 2017 për (2,659,028,117- 1,461,411,756)= 1,197,616,361 lekë.</p> <p>Kjo llogari është e analizuar dhe ka në kredi të saj vlerat:</p> <p>-888,459,192 lekë detyrime për tu paguar për shpronësimet sipas VKM sipas të dhënave të pasqyrës që vijon,</p> <p>-22,136,362 lekë është kredituar llog. 467 “<i>Kreditorë të ndryshëm</i>” në debi të llogarive: 6061 “<i>Të tjera transferta tek individët për veteranet e luftës</i>” për detyrime për shpenzime varrimi veteranë lufte (LANÇ), “<i>Shpenzime për honorarë</i>”, shpenzime për ndihma dhe fatkeqësi etj. sipas të dhënave të pasqyrës që vijon,</p> <p>-82,070,000 lekë detyrime për tu paguar për bonus lindje fëmijë (nga BT në vlerën 29,060,000 lekë dhe Ministria e Brendshme në vlerën 53,010,000 lekë) në debi të llog. 6061 “<i>Transferte për fëmijë të lindur</i>” dhe</p> <p>-468,746,202 lekë në debitë të llog. 6027 “<i>Shpenzime për detyrime dhe kompensime legale</i>” lidhur me detyrime sipas vendimeve të gjykatave</p> <p>Nga të dhënat e database të Bashkisë Tiranë rezulton se të 106 vendimet gjyqësore janë detyrim të formës së prerë, ndërsa për çështjen në proces gjyqësor Drejtoria e Financës nuk ka të dhëna. Me daljen e titullit ekzekutiv nga Kryetari i Bashkisë, është bërë veprimi kontabël në debi të shpenzimeve 6027 “<i>Shpenzime për detyrime dhe kompensime legale</i>”</p>			<p>qëllim që të ulet borxhi financiar.</p> <p>Në programet buxhetore vjetore dhe afat mesëm, të parashikohen pagesat për detyrimet gjyqësore të formës së prerë si dhe të kontabilizohen këto detyrime në momentin e konstatimit.</p>

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>(sipas tipologjisë së v. gjyqësore) në kredi të llog. 467 “Kreditore te ndryshëm”.</p> <p>Për pagesën veprimi kontabël është bërë në debi të llog. 467 “Kreditorë të ndryshëm” në kredi të llog. 520 “Disponibilitete në thesar”.</p> <p>Sa më sipër, konstatohet diferencë e madhe në kohë midis vendimit të formës së prerë të gjykatës dhe Urdhrit Ekzekutiv të Titullarit të Bashkisë, për kontabilizimin e detyrimit për tu paguar.</p> <p><b>Për vitin 2016</b>, detyrimet kreditore, janë më të mëdha se kërkesat për arkëtime për diferencën 9,312,129,578 - 401,939,584 = 8,910,189,994 lekë.</p> <p><b>Për vitin 2017</b>, detyrimet kreditore, janë shumë më të mëdha se kërkesat për arkëtime, për diferencën 11,359,371,261-399,818,678 = <b>10,959,552,583</b> lekë.</p> <p>-Sipas të dhënave të SIFQ <b>Vlera totale e borxhit, është 4,224,560,436 lekë:</b></p> <p>Vlera 353,588,331 lekë- investime nga FZHR, janë regjistruar në SIFQ vetëm faturat pasi nuk regjistrohet në sistem vlera e kontratave pasi nuk ka buxhet për ti regjistruar ato.</p> <p>Vlera 539,644,461 lekë- TVSH dhe kosto lokale, gjithashtu nuk regjistrohen në SIFQ.</p> <p>Vlera 477,440,698 lekë- Vendime gjyqësore vlerë që nuk regjistrohet në SIFQ.</p> <p>Vlera 344,053,901 lekë- për mallra dhe shërbime, në këtë vlerë janë përfshirë detyrime për tu paguar rreth 104,440,000 lekë për të cilat nuk ka dokumentacion si fatura etj. ku një pjesë e tyre janë trashëguar nga ish komunat sot Njësi Administrative e Bashkisë Tiranë.</p> <p>Vlera 1,695,202,881 lekë- Investime dhe të tjera 814,630,165 lekë.</p>			
12	<p>Në një rast nga është kualifikuar dhe shpallur fitues operatori ekonomik i cili nuk plotëson kriteret e vendosura në DST: Në tenderin me objekt <i>“Rikualifikim urban i bllokut të kufizuar nga Rr.”Llambi Bonata”, Rr. “Haki Stermilli”, “Musine Kokalari” dhe rikonstruksion i rrugës “Zyber Zeneli”, vazhdim i rrugës “Ali Kelmendi”</i>, zhvilluar në datën 27.06.2017, me vlerë të fondit limit 101,887,644 lekë, është kualifikuar dhe shpallur fitues BOE “A...” &amp; “E...” SHPK, me vlerë të ofertës ekonomike 84,521,440 lekë, i renditur i katërti, nga 10 OE konkurrues, por që nuk plotëson kriteret e vendosura në dokumentet standarde të tenderit (DST). Edhe pse tre operatorët e tjerë, me vlerë më të vogël të ofertës, janë s’kualifikuar me të drejtë, por KVO duhet të kishte s’kualifikuar edhe BOE “A...” &amp; “E...” SHPK. Kualifikimi i OE që nuk plotësojnë kriteret e DST nuk japin garanci për realizimin</p>		E mesme	Autoriteti kontraktor të analizojë situatën e mësipërme me qëllim eliminimin e rasteve të kualifikimeve dhe shpalljes fitues të operatorëve ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DST.



Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>me sukses të kontratës, duke krijuar premisa për përdorim të fondeve publike pa efektivitet. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me neni 46 - “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1, neni 53 - “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 dhe pika 5 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.</p>			
13	<p>Në katër raste në strukturën e kostos së preventivit është aplikuar TVSH për pajisjet, duke rritur koston e preventivit. Kjo vlerë do të konsiderohet përdorim i fondeve publike pa eficientë, pasi nga AK për të njëjtën pajisje janë shpenzuar më shumë fonde publike në vlerën totale 10,164,504 lekë, e cila është vlera e TVSH. Rastet e konstatuara janë si më poshtë:</p> <p><b>1.</b> Në tenderin me objekt <i>“Rehabilitimi dhe instalimi i sistemit të ngrohjes në shkollën 9 – vjeçare “Vasil Shanto”</i>, me fond limit 53,108,324 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 18.4.2017, në preventivin e paraqitur nga Autoritetit Kontraktor dhe ofertën e operatorit ekonomik fitues “K...” SHPK, për pajisjet është llogaritur TVSH në vlerën <b>1,460,000 lekë</b>, duke i konsideruar pajisjet si punime ndërtimi e duke shtuar koston e preventivit total.</p> <p><b>2.</b> Në tenderin me objekt <i>“Furnizim vendosje me makineri e pajisje mekanike e të tjera, i ambienteve/godinave të Tirana Olimpik Park”</i>, me fond limit 153,421,354 lekë, zhvilluar në datën 30.11.2017, në preventivin e paraqitur nga Autoritetit Kontraktor dhe ofertën e BOE fitues “I...”&amp; “K...” &amp; “E...” SHPK, për pajisjet është llogaritur TVSH në vlerën <b>7,605,004 lekë</b>, duke i konsideruar pajisjet si punime ndërtimi e duke shtuar koston e preventivit total.</p> <p><b>3.</b> Në tenderin me objekt <i>“Ndërtim i sallës së koncerteve, pranë Auditorit të Liceut Artistik “Jordan Misja”</i>, me fond limit 98,206,643 lekë, zhvilluar në datën 30.10.2017, në preventivin e paraqitur nga Autoritetit Kontraktor dhe ofertën e BOE fitues “F...” &amp; “E...”&amp;” X...” SHPK, për pajisjet është llogaritur TVSH në vlerën <b>884,000 lekë</b>, duke i konsideruar pajisjet si punime ndërtimi e duke shtuar koston e preventivit total.</p> <p><b>4.</b>Në tenderin me objekt <i>“Rehabilitim i</i></p>		E mesme	<p>Për arsye se nuk ka përfunduar likuidimi total i vlerës së këtyre katër kontratave, nga Bashkia Tiranë të bëhet verifikimi nëse operatorët ekonomik fitues blerjen e pajisjeve e kanë me TVSH. Në rast se pajisjet janë blerë pa TVSH, nga ana e njësisë vendore në vlerën përkatëse të TVSH, situacioni dhe fatura për pajisjet (sipas listës në këtë Raport), të hartohet pa TVSH, duke bërë të mundur kursimin e fondeve të njësisë vendore prej 10,164,504 lekë.</p>

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin	Rëndësia	Rekomandimi
	<p><i>pjesëshëm dhe instalimi i sistemit të ngrohjes në shkollën 9-vjeçare "Dhura Leka" dhe ndërtimi i palestrës", me fond limit 63,254,523 lekë, zhvilluar në datën 25.08.2017, në preventivin e paraqitur nga Autoritetit Kontraktor dhe ofertën e OE fitues "K..." SHPK, për pajisjet është llogaritur TVSH në vlerën 215,500 lekë, duke i konsideruar pajisjet si punime ndërtimi e duke shtuar koston e preventivit total.</i></p> <p>Vlera e mësipërme, prej 10,164,504 lekë (1,460,000 + 7,605,004 + 884,000 + 215,500), konsiderohet përdorim i fondeve publike pa efikasitet, pasi për të njëjtën pajisje janë shpenzuar më shumë fonde publike, e cila është pjesa e TVSH.</p> <p>Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me:</p> <p>a) UKM nr. 2, datë 8.5.2003 "Për Klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit", Kreu I/I "Klasifikimi i punimeve të ndërtimit", germa "A", paragrafi i fundit;</p> <p>b) VKM nr. 514, datë 15/8/2007 "Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit", ndryshuar me VKM nr. 664, datë 26/9/2012, pika 8; c) UKM Nr. 1, datë 16.6.2011 "Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, pika 1, germa "c", paragrafi i fundit.</p>			
16	<p>Nga verifikimi i preventivit të ofertës, projektit të zbatimit, librit të masave, situacionit pjesor dhe verifikimit në terren të punimeve të ndërtimit për periudhën e auditimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor me pasojë efekt financiar negativ ndaj buxhetit të baskisë në vlerën <b>725,972 lekë pa TVSH.</b></p>		E lartë	<p>Të merren masa nga Bashkia e Tiranës, që t'i kërkojë sipërmarrësit të punimeve "G..." SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës <b>725,972 lekë pa TVSH</b>, të përfituar tepër për punime të pakryera në zbatimin e kontratës me objekt "Rikualifikim i aksit Mbikalim-Kombinat".</p>
	<p>Nga verifikimi i preventivit të rishikuar dhe projektit të zbatimit të ndryshuar, rezulton se nuk janë zbatuar procedurat sipas UKM Nr. 3, datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, pika 19.</p>		I mesëm	<p>Të merren masa nga Bashkia e Tiranës, që për rastin konkret dhe në vazhdimësi, t'i kërkojë sipërmarrësit të punimeve si dhe mbikëqyrësit të punimeve, për përdorimin e fondit rezervë ta mbështesin në procedurat e hartimit të, preventivit të fondit rezervë, relacionit teknik dhe procesverbalit të përdorimit të nënshkruar nga të gjitha palët.</p>

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin	Rëndësia	Rekomandimi
17				
18	Nga verifikimi i preventivit të rishikuar, projektit të zbatimit të rishikuar, librit të masave, situacionit përfundimtar dhe verifikimit në terren të punimeve të ndërtimit për periudhën e auditimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultojnë likuidime për punime të pa kryera dhe punime të realizuara në kundërshtim me specifikimet teknike të tenderit dhe të kontratës së zbatimit me pasojë efekt financiar negativ ndaj buxhetit të baskisë në vlerën <b>496,140 lekë pa TVSH</b> .		<b>E lartë</b>	Të merren masa nga Bashkia e Tiranës, që t'i kërkojë sipërmarrësit të punimeve "F..." SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative që, shuma prej <b>496,140 lekë pa TVSH</b> duhet të realizohet në objekt brenda periudhës së garancisë së defekteve. Realizimi i punimeve duhet të konfirmohet zyrtarisht nga AK, Bashkia e Tiranës, Mbikëqyrësi i punimeve si dhe Kolaudatori i punimeve të objektit (Në rast të kundërt, moskryerja e punimeve sipas Projektit të Zbatimit dhe specifikimeve teknike, do të konsiderohet efekt financiar negativ dhe duhet të zhdëmtohet nga sipërmarrësi i punimeve).
19	Nga verifikimi i preventivit të ofertës, projektit të zbatimit, librit të masave, situacionit pjesor dhe verifikimit në terren të punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan se zëri i punimeve, Transport dheu me auto deri në 5 km" në seksionin e preventivit (Punime të ndryshme, prishje, spostime, dhe punime asfaltimi), është likuiduar për punime të kryera dy herë, përkatësisht si zë punimi më vetë dhe nën zë punime në shumën <b>421,824 lekë pa TVSH</b> duke shkaktuar dëm ekonomik.		<b>E lartë</b>	Të merren masa nga Bashkia e Tiranës, që t'i kërkojë sipërmarrësit të punimeve "C..." SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës <b>421,824 lekë pa TVSH</b> , të përfituar tepër për punime të dubluar në zbatimin e kontratës me objekt "Rikonstruksion i rrugës së Dibrës (farmacia 10 - Oxhaku)".
20	Nga verifikimi i preventivit të ofertës, projektit të zbatimit, librit të masave, situacionit pjesor dhe verifikimit në terren të punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan se zëri i punimeve, Transport dheu me auto deri në 5 km" është likuiduar dy herë, përkatësisht si zë punimi më vetë dhe nën zë punime në shumën <b>233,722 lekë pa TVSH</b> duke shkaktuar efekt financiar negativ.		<b>E lartë</b>	Të merren masa nga Bashkia e Tiranës, që t'i kërkojë sipërmarrësit të punimeve "A..." SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative për arkëtimin e shumës <b>233,722 lekë pa TVSH</b> , të përfituar tepër për punime të dubluara në zbatimin e kontratës me objekt "Parkimi Nëntokësor te Sheshi Italia".
21	Nga verifikimi i preventivit të ripunuar, projektit të zbatimit, librit të masave, situacionit përfundimtar dhe verifikimit në terren të punimeve të ndërtimit për periudhën e auditimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor me pasojë efekt financiar negativ ndaj buxhetit të baskisë në vlerën <b>699,396 lekë pa TVSH</b> .		<b>E lartë</b>	Të merren masa nga Bashkia e Tiranës, që t'i kërkojë sipërmarrësit të punimeve "A..." SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës <b>699,396 lekë pa TVSH</b> , të përfituar tepër për punime të pakryera në zbatimin e kontratës me objekt "Ndërtimi dhe rikonstruksioni i rrugës "Selaudin Bekteshi".
22	Nga verifikimi i realizimit të punimeve në objekt, situacionit përfundimtar, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan punime me defekte të kangjellave metalike.		<b>I mesëm</b>	Të merren masa nga Bashkia e Tiranës, që t'i kërkojë sipërmarrësit të punimeve "A..." SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat dhe kërkesat e kontratës, riparimin dhe zëvendësimin e pjesëve të dëmtuara të

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin	Rëndësia	Rekomandimi
				kangjellave metalike deri në përfundim të periudhës së garancisë me datë 22.08.2019.
23	Nga verifikimi i preventivit të ofertës, projektit të zbatimit, librit të masave, situacionit pjesor nr. 1 dhe verifikimit në terren të punimeve të ndërtimit për periudhën e auditimit, lidhur me volumet e punës në këtë situacion si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan se mos vendosja e bordurës sipas projektit ka shkaktuar një efekt financiar negativ ndaj buxhetit të baskisë në vlerën <b>172,190 lekë pa TVSH</b> .		<b>I mesëm</b>	Autoriteti Kontraktor, Bashkia e Tiranës, t'i kërkojë sipërmarrësit të punimeve "A..." SHPK, të bëjë sistemimet në situacionet pjesore ose në situacionin përfundimtar të vlerës <b>172,190 lekë pa TVSH</b> , për zëvendësimin e bordurës nga 20 x 35 cm në 20 x 30 cm, brenda afatit kohor të përfundimit të punimeve të ndërtimit parashikuar në kontratë. Në rast të kundërt mos realizimi i punimeve sipas bordurës me seksion 20x30 cm, shuma 172,190 lekë pa TVSH do të konsiderohet dëm ekonomik si punim i kryer në kundërshtim me projektin e zbatimit dhe specifikimet teknike.
24	Nga verifikimi i preventivit të ndryshuar, projektit të zbatimit të azhurnuar, librit të masave, situacionit përfundimtar dhe verifikimit në terren të punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor me pasojë efekt financiar negativ ndaj buxhetit të baskisë në vlerën <b>1,289,110 lekë pa TVSH</b> .		<b>E lartë</b>	Të merren masa nga Bashkia e Tiranës, që t'i kërkojë sipërmarrësit të punimeve "A..." SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjyqimit arkëtimin e shumës <b>1,289,110 lekë pa TVSH</b> , të përfituar tepër për punime të pakryera në zbatimin e kontratës me objekt "Rikualifikim urban i bllokut të kufizuar nga rruga "Muhamet Gjollësja" – "Myslym Shyri" – "Rruga e Kavajës" me Kufirin e Njësisë Bashkiake Nr. 10".
25	Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt.		<b>I mesëm</b>	Bashkia e Tiranës, t'i kërkojë sipërmarrësit të punimeve "A..." SHPK, të marrë masa për riparimin e defekteve të konstatuara në punimet e sinjalistikës dhe rrjetin e K.U.Z në përputhje me specifikimet teknike brenda periudhës së garancisë së defekteve.
26	Në tenderin me objekt "Pastrimi i pjesës Perëndimore - 3 të Qytetit të Tiranës" zhvilluar në datën 29.03.2016, me vlerë të fondit limit 189,069,931lekë, është kualifikuar dhe shpallur fitues OE "A...", i cili nuk plotëson kriteret e vendosura në dokumentet standarde të tenderit (DST).		<b>E mesme</b>	Autoriteti kontraktor të analizojë situatën e mësipërme me qëllim eliminimin e rasteve të kualifikimeve dhe shpalljes fitues të operatorëve ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DST.
27	Në tenderin me objekt "Rikonstruksion i rrugës Herman Gmeiner" zhvilluar në datën 29.07.2016, me vlerë të fondit limit 32,420,453 lekë, është kualifikuar dhe shpallur fitues BOE "A..." & "N...", i cili nuk plotëson kriteret e vendosura në dokumentet standarde të tenderit (DST).		<b>E mesme</b>	Autoriteti kontraktor të analizojë situatën e mësipërme me qëllim eliminimin e rasteve të kualifikimeve dhe shpalljes fitues të operatorëve ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DST.
28	Në tenderin me objekt "Rikonstruksion i rrugëve të lagjeve Shirt-Pezëhelmës" zhvilluar në datën 07.11.2016, me vlerë të fondit limit 35,825,592 lekë, është kualifikuar dhe shpallur fitues BOE I...&C...", i cili nuk plotëson kriteret e vendosura në dokumentet standarde të tenderit (DST).		<b>E mesme</b>	Autoriteti kontraktor të analizojë situatën e mësipërme me qëllim eliminimin e rasteve të kualifikimeve dhe shpalljes fitues të operatorëve ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DST.
29	<i>1- Për tenderin me objekt "Ndërtim parkim</i>		<b>E mesme</b>	Të merren masa në hartimin e kriterëve të

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin	Rëndësia	Rekomandimi
	<p><u>nëntokësor, Sheshi Skënderbej””, zhvilluar në datën 17.10.2016.</u></p> <p>Në kërkesat për kualifikim të hartuara nga NJP dhe miratuara nga kryetari i AK përkatësisht kritere të veçanta për kualifikim</p> <p>4. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 9).</p> <p>Fabrikë prodhimi betoni 1 copë Pronësi ose me qera.</p> <p>Ky kriter është i pa nevojshme për realizimin e kontratës së punëve civile dhe të vendosura me qëllim mënjanimin e konkurrencës pasi këto fabrika nuk i disponojnë të gjitha shoqëritë në fushën e ndërtimit dhe nuk janë kritere licencimi për këto shoqëri. Këto kritere të panevojshme janë në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik“ i ndryshuar, Kreu II Informacione të veçanta për kontratat, neni 26 kontrata për punë publike , pika 5, “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.</p> <p>Për sa më sipër mban përgjegjësi NJP sipas përcaktimeve në vkm VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. neni 57 ku thuhet:</p> <p>2. Njësia e prokurimit është përgjegjëse për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme që u bashkëlidhen atyre, përfshirë hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specififikimet teknike, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme.</li> </ul> <p>Për sa më sipër, veprimet dhe mosveprimet për problematikat e trajtuara dhe qëndrimin strikt ndaj plotësimit të kriterëve duke mos u udhëhequr nga qëllimi kryesor i prokurimit publik ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të përdorimit të fondeve publike, janë objekt i veprimtarisë së Njesisë së Prokurimit dhe KVO sipas rastit trajtuar në procedurat e mësipërme.</p> <p>Argumentimi i kriterëve të vendosura nuk është dokumentuar në DST.</p> <p>Për veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e njesisë së prokurimit: znj. E.K., znj. A.N. dhe z. A.B.</p>			<p>DST, njësia e prokurimit të jap argumente për secilin kriter dhe këto argumente të bëhen pjesë e procesverbalit që mbahet prej saj dhe pjesë e DST.</p>
30	<p><u>L_ Në tenderin me objekt “Rikonstruksioni shkollës së mesme të bashkuar “Ymer Lala”, Surrel ”” zhvilluar në datën 12.11.2016, me vlerë të fondit limit 45,832,598 lekë, është kualifikuar dhe shpallur fitues BOE “D...” &amp; “A...” shpk.</u></p>		<b>E mesme</b>	<p>Në hartimin e kriterëve të DST, njësia e prokurimit të jap argumente për secilin kriter dhe këto argumente të bëhen pjesë e procesverbalit që mbahet prej saj dhe pjesë e DST.</p>

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>Në përcaktimet e kriterëve teknike të kualifikimit nga Njësia e Prokurimit, u konstatuan mangësi, të cilat duhet të ishin përcaktuar me qartë nga ana e njësisë, konkretisht:</p> <p>Në pikën 2.3, pika që përcakton mjetet që duhet të disponojnë operatorët dhe dokumentet që duhet të disponojnë për këto mjete, rezultojnë se Njësia e Prokurimit, ndryshe nga praktika të ngjashme, nuk ka përcaktuar në DST kërkesën që OE të paraqesin dokumentin “Certifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit.....” kërkesë e cila është kërkuar nga Njësia e Prokurimit për punët e ngjashme siç është praktika me nr. Reference 95208 për rehabilitimin e pjesshëm të shkollës Dhora Distria; Praktika me nr. Reference 94503 për Rehabilitimin e rrugës dhe qendrës së lagjes Sheheler, etj. Mos përcaktimi i kësaj pike në DST, ndryshe nga praktikat e ngjashme, rezultojnë favorizues për OE të kualifikuar dhe shpallur fitues, pasi nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur ofertës, rezultojnë se për një numër të caktuar mjetesh, mungon kjo certifikatë e nevojshme për mbarëvajtjen e punës dhe seriozitetin e operatorëve.</p> <p>Shënim: rezultojnë se operatori ekonomik N... shpk është skualifikuar në lidhje me shtojcën 10 për disponimin e makinerive, dhe konkretisht për ekzistencën e tyre në një procedurë tjetër prokurimi “Rikualifikim Urban i Bllokut që kufizohet nga rruga e Elbasanit-Stavri Vinjaku-Pjetër Budi dhe Ali Visha” të fituar nga ky operator në bashkinë e Tiranës ku ka deklaruar të njëjtat mjete. Kontrata është e lidhur në Maj të 2018 pra 6 muaj përpara shpalljes së tenderit për rikonstruksionin e shkollës Ymer Lala, Surrel. Gjithashtu KVO ka skualifikuar OE N... shpk pasi njëri nga mjetet e deklaruar është 700 kg më pak sesa kapaciteti i kërkuar në DST ku janë kërkuar 4 kamionçina. OE kanë plotësuar kriteret për 3 të tilla dhe vetëm njëri ka 700 kg me pak kapacitet. Megjithatë duke parë diferencën ndërmjet ofertës së këtij operatori dhe ofertës së operatorit fitues e cila është 6,346,674 lekë me pak, ky OE nuk duhet skualifikuar.</p>			
31	<p><u>1. Në tenderin me objekt: 1. “Rikonstruksion i plotë i shkollës Speciale Luigi Gurakuqi “Rehabilitimi i pjesshëm dhe instalimi i sistemit të ngrohjes në shkollën 9 – vjeçare Dh. Leka dhe ndërtim i palestrës – Faza II”</u>, zhvilluar në datën 24.12.2018, me vlerë të fondit limit 20,833,333 lekë, është kualifikuar dhe shpallur fitues OE “K...” shpk me ofertë 18,655,654 lekë.</p> <p>1. Nga auditimi i ofertës së OE “K...” shpk me vlerë 18,655,654 lekë pa tvsh, rezultoi se KVO e ka kualifikuar dhe shpallur fitues ofertën e këtij operatori megjithëse rezultojnë se nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e përcaktuara nga DST, konkretisht si më poshtë:</p> <p>a-Sipas kërkesave të pikës 2.3 të Kapacitetit Teknik të operatorëve, kërkohet që për punët e ngjashme, për</p>		E mesme	Autoriteti kontraktor të analizojë situatën e mësipërme me qëllim eliminimin e rasteve të kualifikimeve dhe shpalljes fitues të operatorëve ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DST.

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin	Rëndësia	Rekomandimi																																																								
	<p>kontratat e realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Deklaratën sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:</li> <li>2. Kontratë</li> <li>3. Situacionin përfundimtar;</li> <li>4. Certifikatën e marrjes ne dorëzim.</li> </ol> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se OE ka paraqitur si Kontratë të suksesshme punësh të ngjashme, kontratën Nr. 24576/10 datë 20.10.2016 e lidhur me Bashkinë e Tiranës për Rikonstruksionin e Shkollës Koreografike. Vlera e kontratës plotëson kushtet e përcaktuara nga NJP pasi është më shumë se 50% e vlerës, por në dokumentacionin mbështetës që kërkohet të paraqesë OE, mungon Certifikata e marrjes në dorëzim e objektit siç përcaktohet nga kërkesat e DST.</p> <p>b-Sipas kërkesave të DST (shtojca 10), kërkohet që OE të paraqesë listën e mjeteve sipas tabelës vijuese:</p> <table border="0"> <tr> <td>Mjetet</td> <td>Sasia</td> <td>Gjendja</td> <td></td> </tr> <tr> <td>Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 3.5 (tre pikë pesë) ton dhe maksimumi deri 5 ton(pesë)</td> <td>2 copë</td> <td>Pronësi ose me qera</td> <td></td> </tr> <tr> <td>Autovinç</td> <td>1 copë</td> <td>Pronësi ose me qera</td> <td></td> </tr> <tr> <td>Gjenerator</td> <td>1 copë</td> <td>Pronësi ose me qera</td> <td></td> </tr> <tr> <td>Ekskavator me goma 0.25 m3</td> <td>1 copë</td> <td>Pronësi ose me qera</td> <td></td> </tr> <tr> <td>Kamionçinë kapaciteti mbajtës për secilën kamionçinë nga 1.5 (një pikë pesë) ton deri në 2(dy) ton</td> <td>2 copë</td> <td>Pronësi ose me qera</td> <td></td> </tr> <tr> <td>Auto betonierë</td> <td>1 copë</td> <td>Pronësi ose me qera</td> <td></td> </tr> <tr> <td>Depozitë uji (5000)</td> <td>1 copë</td> <td>Pronësi ose me qera</td> <td></td> </tr> <tr> <td>Skela metalike (forme H) të kompletuara me parapet mbrojtës, shkallë me rrytë mbrojtëse për punime në fasadë)</td> <td>1000 m2</td> <td>Pronësi ose me qera</td> <td></td> </tr> <tr> <td>Matrapik</td> <td>2 cope</td> <td>Pronësi ose me qera</td> <td></td> </tr> <tr> <td>Vibrator</td> <td>1 copë</td> <td>Pronësi ose me qera</td> <td></td> </tr> <tr> <td>Asfalto shtruese</td> <td>1 cope</td> <td>Pronësi ose me qera</td> <td></td> </tr> <tr> <td>Auto pompë betoni</td> <td>1 copë</td> <td>Pronësi ose me qera</td> <td></td> </tr> <tr> <td>Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës deri minimum 7(shtatë) Ton dhe maksimumi 12(dymbëdhjetë) ton për secilin kamion</td> <td>2 copë</td> <td>Pronësi ose me qera</td> <td></td> </tr> </table> <p>Si dhe</p> <p>a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme) Certifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qerave/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i</p>	Mjetet	Sasia	Gjendja		Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 3.5 (tre pikë pesë) ton dhe maksimumi deri 5 ton(pesë)	2 copë	Pronësi ose me qera		Autovinç	1 copë	Pronësi ose me qera		Gjenerator	1 copë	Pronësi ose me qera		Ekskavator me goma 0.25 m3	1 copë	Pronësi ose me qera		Kamionçinë kapaciteti mbajtës për secilën kamionçinë nga 1.5 (një pikë pesë) ton deri në 2(dy) ton	2 copë	Pronësi ose me qera		Auto betonierë	1 copë	Pronësi ose me qera		Depozitë uji (5000)	1 copë	Pronësi ose me qera		Skela metalike (forme H) të kompletuara me parapet mbrojtës, shkallë me rrytë mbrojtëse për punime në fasadë)	1000 m2	Pronësi ose me qera		Matrapik	2 cope	Pronësi ose me qera		Vibrator	1 copë	Pronësi ose me qera		Asfalto shtruese	1 cope	Pronësi ose me qera		Auto pompë betoni	1 copë	Pronësi ose me qera		Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës deri minimum 7(shtatë) Ton dhe maksimumi 12(dymbëdhjetë) ton për secilin kamion	2 copë	Pronësi ose me qera				
Mjetet	Sasia	Gjendja																																																										
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 3.5 (tre pikë pesë) ton dhe maksimumi deri 5 ton(pesë)	2 copë	Pronësi ose me qera																																																										
Autovinç	1 copë	Pronësi ose me qera																																																										
Gjenerator	1 copë	Pronësi ose me qera																																																										
Ekskavator me goma 0.25 m3	1 copë	Pronësi ose me qera																																																										
Kamionçinë kapaciteti mbajtës për secilën kamionçinë nga 1.5 (një pikë pesë) ton deri në 2(dy) ton	2 copë	Pronësi ose me qera																																																										
Auto betonierë	1 copë	Pronësi ose me qera																																																										
Depozitë uji (5000)	1 copë	Pronësi ose me qera																																																										
Skela metalike (forme H) të kompletuara me parapet mbrojtës, shkallë me rrytë mbrojtëse për punime në fasadë)	1000 m2	Pronësi ose me qera																																																										
Matrapik	2 cope	Pronësi ose me qera																																																										
Vibrator	1 copë	Pronësi ose me qera																																																										
Asfalto shtruese	1 cope	Pronësi ose me qera																																																										
Auto pompë betoni	1 copë	Pronësi ose me qera																																																										
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës deri minimum 7(shtatë) Ton dhe maksimumi 12(dymbëdhjetë) ton për secilin kamion	2 copë	Pronësi ose me qera																																																										

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>këtij prokurimi.. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jene aktet e ç'doganimit ose faturat tatimore të blerjes.</p> <p>b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentet që vërtetojnë pronësinë e tyre.</p> <p>c) Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.</p> <p>d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.</p> <p>e) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës Nr. 9. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).</p> <p>Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruar në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tirane. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi).</p> <p>-Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se OE fitues nuk ka plotësuar të gjitha pikat e kërkesave të DST pasi rezulton se për disa nga mjetet e mësipërme janë konstatuar mangësi dhe më konkretisht:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Autobetonierja me targë AA8...A nuk është e pajisur me Certifikatën për transport mallrash për të tretët dhe me qera brenda vendit siç përcakton pika a e kërkesës së mësipërme.</li> <li>2. Autoboti me targa AA...HL nuk është e pajisur me Certifikatën për transport mallrash për të tretët dhe me qera brenda vendit siç përcakton pika a e kërkesës së mësipërme.</li> <li>3. Autopomëbetoni me targë AA...KX nuk është e pajisur me Certifikatën për transport mallrash për të tretët dhe me qera brenda vendit siç përcakton pika a e kërkesës së mësipërme.</li> <li>4. Kamionçina deri 2 ton me targa AA...BX nuk është e pajisur me Certifikatën për transport mallrash për të tretët dhe me qera brenda vendit siç përcakton pika a e kërkesës së mësipërme.</li> <li>5. Kamioni me vinç me targa AA...OK nuk është e pajisur me Certifikatën për transport mallrash për të tretët dhe me qera brenda vendit siç përcakton pika a e kërkesës së mësipërme.</li> <li>6. Asfaltbetoni i paraqitur nga OE, nuk ka bashkëlidhur kontratën e qerave me subjektin "V..." shpk siç kërkohet nga pika c e kërkesës së mësipërme.</li> </ol> <p>-Rezulton se KVO, për të njëjtat shkelje të konstatuara nga grupi i auditimit për subjektin K..., ka s'kualifikuar OE "E..." shpk me ofertë 15,482,024 lekë ose 3,173,630 lekë më të ulët se sa operatori fitues. Më konkretisht ky OE është skualifikuar për</p>			



Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>dëshminë e mjeteve e pajisjeve teknike që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion OE që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (shtojca 10).</p> <p>1.Sipas vlerësimit të KVO, OE “E...” shpk nuk ka paraqitur certifikatën për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit..... për kamionçinën me targa AA...JJ duke e konsideruar të paplotë dokumentacionin lidhur me këtë mjet.</p> <p>2. 1.Sipas vlerësimit të KVO, OE “E...” shpk nuk ka paraqitur certifikatën për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit..... për mjetin Autovinç me targa AA...FJ duke e konsideruar të paplotë dokumentacionin lidhur me këtë mjet.</p> <p>3.Kamioni me targa AA...GY me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 2.6 Ton.</p> <p>Kamionçina me targa AA...NS me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1.15 Ton. Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihen në dispozicion dy kamionçina me kapacitet mbajtës nga 1.5 deri 2 Ton dhe OE rezulton se këto dy mjete i ka paraqitur me diferenca që lëvizin nga 0.35 Ton më pak njëra dhe 0.6 Ton më tepër kamionçina tjetër, dhe sipas AK OE nuk ka përmbushur kapacitetin teknik të kërkuar.</p> <p>Siç vihet re, KVO nuk ka ndjekur të njëjtin standard në vlerësimin e ofertave, pasi për të njëjtat kritere për të cilat është s’kualifikuar OE “E...”, Operatori tjetër është kualifikuar.</p> <p>KVO duke kualifikuar OE “K...” shpk dhe s’kualifikuar OE “E...” shpk duke mos siguruar efektivitetin e shpenzimeve në shumën 3,173,630 lekë, gjithashtu KVO mund të anulonte tenderin dhe praktika të prokurohej edhe një herë nga fillimi deri në plotësimin e kushteve të kërkuara nga Operatorët e interesuar.</p> <p><u>2. Në tenderin me objekt: “Rehabilitim i rrugës dhe qendrës së lagjes Sheheler”, zhvilluar në datën 19.12.2018, me vlerë të fondit limit 25,725,518 lekë, është kualifikuar e shpallur fitues OE “B...” shpk me ofertë 21,253,476 lekë ose 4,472,042 lekë më pak se FL ofertë e cila duhet të ishte skualifikuar për arsyet si më poshtë:</u></p> <p>1.Në pikën 7 të kërkesave për Kapacitetin Teknik në DST kërkohet si më poshtë:</p> <p>5. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve, si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 1 (një) punonjës elektrikist</li> <li>• 1 (një) punonjës teknik ndërtimi</li> <li>• 6 (gjashtë) punonjës hekurkthyes</li> </ul> <p>-Nga shqyrtimi i dokumentacionit të OE fitues, rezulton se njëra nga pikat e kësaj kërkesë,</p>			

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>konkretisht ajo që kërkon 6 (gjashtë) punonjës hekurthyes, nuk është plotësuar nga ana e këtij operatori pasi janë paraqitur dokumente vetëm për dy punonjës të tillë. Për të njëjtën mangësi, atë të mos plotësimin të numrit të punonjësve me profesion hekur thyes, janë s’kualifikuar edhe operatorët e tjerë në këtë procedurë prokurimi, si “E...” shpk, “I...” shpk etj. Në këto kushte, KVO duhej të s’kualifikonte edhe ofertën e këtij operatori për mos plotësimin e kërkesave të kërkuara në DST.</p> <p>2.Në pikën 16 të kërkesave në DST kërkohet nga operatorët fitues të paraqesin mjetin tip Autobitumatriçe. OE fitues ka paraqitur mjetin me targa AA...FA, i cili rezulton të jetë mjet i montuar kamion + bitumatriçe. KVO, për të njëjtin kriter të ngjashëm, ka s’kualifikuar operatorin ekonomik “E...” shpk për mjetin Autobot, pasi ky mjet ishte montim kamion + bot uji. Duke përdorur kritere të njëjta vlerësimi, KVO duhej të s’kualifikonte edhe OE “B...” shpk për mos plotësim të kritereve teknike të përcaktuara në DST.</p> <p>-Ky kriter për mos kualifikimin e mjetit Autobitumatriçe me Targa AA...FA, është ndjekur edhe ne procedura të mëvonshme nga KVO, konkretisht procedurën me numër reference 92943 Për Rikonstruksionin e rrugëve “Kel Kodheli” dhe “Skënder Shtylla”, ku KVO e ka s’kualifikuar këtë operator pikërisht mjetin Autobitumatriçe me Targa AA...FA.</p> <p>Nga sa u pasqyrua më sipër, KVO duhej të anulonte tenderin për “Rehabilitim e rrugës dhe qendrës së lagjes Sheheler”, dhe procedura të fillonte sërish nga fillimi. Kualifikimi dhe shpallja fitues e OE “B...” shpk ka sjell shpenzime duke mos siguruar efektivitetin e duhur.</p> <p><u>3. Në tenderin me objekt: “Sistemim asfaltim i rrugës “Haxhi Brari”</u>, zhvilluar në datën 16.08.2018, me vlerë të fondit limit 11,666,659 lekë, është kualifikuar e shpallur fitues OE “K...” shpk me ofertë 10,374,735 lekë ose 1,291,924 lekë më pak se FL ofertë e cila duhet të ishte skualifikuar për arsyet si më poshtë:</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit që OE “K...” shpk ka paraqitur, rezulton se nuk ka përmbushur të gjitha pikat e kërkuara në pikës 15, shtojca 10 e kritereve mbi Kapacitetin Teknik që duhet të përmbushin OE ofertues.</p> <p>1.OE “K...” shpk, rezulton se nuk ka përmbushur kriteret sipas kërkesave të DST për mjetin Autobitumatriçe me Targa AA...MM i marrë me qira nga operatori. Ky rezulton të jetë mjet i montuar Kamion + Bitumatriçe. Gjithashtu këtij mjeti i mungon edhe certifikata për transport lëndësh të rrezikshme, e nevojshme për kategorinë e këtyre mjeteve. KVO e këtij Autoriteti Kontraktor, në mënyrë përsëritëse, ka s’kualifikuar operatorët e tjerë në mënyrë të vazhdueshme në procedura të tjera prokurimi, përfshirë edhe këtë procedurë, si p.sh</p>			

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>operatori “S...” shpk etj. KVO, duhej të s’kualifikonte këtë operator për mos përmbushje të Kriterëve mbi Kapacitetin Teknik të përcaktuara në DST.</p> <p>Në këto kushte, duke qenë se asnjëri nga Operatorët Ekomomik, nuk përmbushte kriteret e përcaktuara në DST, duke përfshirë edhe OE “K...” shpk, <b><u>KVO duhej të anulonte këtë praktikë prokurimi</u></b>, dhe ta shpallte atë nga fillimi.</p>			
32	<p><i>1. Në tenderin me objekt: “Ndërtimi i rrugëve “Migjeni dhe Kadri Roshi, Në Njësinë Administrative Kashar, Faza II”.</i> Në tender kanë marrë pjesë 8 operatorë ekonomik, nga të cilët është kualifikuar dhe shpallur fitues OE “B...”, me vlerë të ofertës ekonomike 32,594,589 lekë, ose 7,245,040 lekë më pak se vlera e fondit limit. Nga auditimi konstatohet se OE shpallur fitues, nuk i plotëson kriteret e vendosura në DST dhe duhej të s’kualifikohej nga KVO. Nga auditimi është konstatuar se arsyet pse OE, nuk plotëson kriteret për kualifikim dhe shpalljen fitues janë si më poshtë:</p> <p>-Në lidhje me pikën 16 të kriterëve mbi Kapacitetin Teknik të operatorëve ofertues, është kërkuar në DST disponueshmëria e Autobitumatriçes. OE i kualifikuar dhe shpallur fitues, ka paraqitur mjetin me Targa AA...FA, në pronësi të tij, i cili është mjet i modifikuar Kamion + Bitumatriçe. Këtij mjeti i mungon certifikata e nevojshme për mjetet që kryejnë transport materialesh të rrezikshme brenda vendit, e nevojshme për sigurinë. Vlen të theksohet, se 2 prej anëtareve të kësaj KVO-je, vetëm pak muaj më mbrapa në procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksioni i rrugëve “Kel Kodheli” dhe “Skënder Shtylla”, për të njëjtin mjet transporti Autobitumatriçe, e ka s’kualifikuar OE “B...” shpk pikërisht me argumentin se ky mjet nuk mund të kualifikohet për shkak të këtyre cilësive. Dhe në këto kushte, KVO duhej të s’kualifikonte këtë operator për shkeljen e konstatuar.</p> <p>2.Nga auditimi i ofertës së OE “A...” shpk, me vlerë 27,111,821, rezulton se KVO e ka s’kualifikuar këtë ofertë për arsyen e mëposhtme:</p> <p>•Shoqëria “A...” shpk për të vërtetuar përvojën e suksesshme ka paraqitur kontratat me objekt: “Rikonstruksion i plotë + sistemim i ngrohjes për dy godinat e shkollës 9-vjeçare “Pjetër Arbnori”, Fushë Arrëz” dhe “Kapanon 2-3 kat për prodhim tenda dielli”. Këto kontrata nuk janë punime të ngjashme për faktin se këto kontrata hyjnë në kategorinë e punëve të infrastrukturës së objekteve dhe jo të infrastrukturës rrugore referuar situacioneve përfundimtare të punimeve ku zërat e punimeve të përcaktuar në bazë të preventivit nuk janë të ngjashme me zërat e preventivit të objektit që prokurrohet. Më tej shoqëria “A...” shpk ka paraqitur edhe disa kontrata të tjera të ngjashme me objektin e prokurimit si më poshtë vijon:</p> <p>1-Kontratë nën sipërmarrje me objekt: “Asfaltim</p>		E mesme	<p>Autoriteti kontraktor të analizojë situatën e mësipërme me qëllim eliminimin e rasteve të kualifikimeve dhe shpalljes fitues të operatorëve ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DST.</p>

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>rruga Pistull – Pacran – Rrugë nacionale” me vlerë të kontratës 18,124,268 lekë pa TVSH;</p> <p>2-Kontratë nën sipërmarrje me objekt: “Sistemim i lagjes mbrapa Pallatit të Kulturës” me vlerë të kontratës 2,062,832 lekë pa TVSH;</p> <p>3-Kontratë nën sipërmarrje me objekt: “Rikonstruksion i rrugës “25- Nëntori”, Elbasan” me vlerë të kontratës 19,482,749 lekë pa TVSH;</p> <p>4-Kontratë nën sipërmarrje me objekt: “Ri veshje asfalti në rrugën “Elbasan, Tregan” me vlerë të kontratës 7,047,160 lekë pa TVSH.</p> <p>•Sa më sipër konkludohet se Operatori ekonomik “A...” shpk në lidhje me kontratat e mësipërme të paraqitura për të vërtetuar përvojën e suksesshme nuk plotëson Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 1/a për një objekt të vetëm në vlerën 19,919,814.74 lekë pa TVSH si edhe pikën 1/b ku shumatorja e të gjitha kontratave të ngjashme duhet të jetë në vlerën 79,679,258.96 lekë pa TVSH.</p> <p>•Në këtë mënyrë, shoqëria “A...” shpk nuk plotëson Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 1 çka bie në kundërshtim me Ligjin Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) Neni 46, pika 1 germa “b” si dhe me VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 6.</p> <p>Siç konstatohet nga shqyrtimi i dokumentacionit, OE “A...” shpk ka paraqitur kontratën e ngjashme të nën sipërmarrjes me objekt “Rikonstruksion i rrugës “25 Nëntori, Elbasan” me vlerë të kontratës 19,482,749 lekë pa TVSH. Vlera e kësaj kontrate është 437,065 lekë pa TVSH më e vogël se sa vlera e kërkuar për një kontratë të vetme të ngjashme sa gjysma e vlerës së fondit limit, ku vlera e kërkuar duhej të jetë 19,919,814 lekë pa TVSH.</p> <p>Diferenca prej 437,065 lekë duhej konsideruar si shmangie e vogël nga e KVO, pasi oferta OE plotësonte të gjitha kriteret tjera të kërkuara nga NJP dhe gjithashtu kishte eksperiencë të ndryshme të ngjashme. Oferta e këtij OE është dukshëm më e favorshme se ofertat tjera në këtë praktikë prokurimi, duke përfshirë edhe atë të shpallur fituese.</p> <p>Si rezultat i s’kualifikimit të ofertës së OE “A...” shpk me vlerë 27,111,821 lekë pa TVSH, dhe kualifikimin dhe shpalljen fituese të ofertës së OE “B...” shpk me vlerë 32,594,589, nuk është siguruar efektiviteti i fondeve të prokuruar në vlerën 5,482,768 lekë pa TVSH.</p> <p><u>2. Në tenderin me objekt: “Ndërtimi i rrugëve Rikonstruksioni i rrugës “Fatmir Haxhiu”,</u> Në tender kanë marrë pjesë 9 operatorë ekonomik, nga të cilët është kualifikuar dhe shpallur fitues OE “B...”, me vlerë të ofertës ekonomike 25,563,746 lekë, ose 3,592,708 lekë më pak se vlera e fondit limit. Nga auditimi konstatohet se OE shpallur fitues, nuk i plotëson kriteret e vendosura në DST dhe duhej të s’kualifikohej nga KVO. Nga auditimi është</p>			

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>konstatuar se arsyet pse OE, nuk plotëson kriteret për kualifikim dhe shpalljen fitues janë si më poshtë: Nga shqyrtimi i dokumentacionit që OE “B...” shpk ka paraqitur, rezulton se nuk ka përmbushur të gjitha pikat e kërkuara në pikës 15, shtojca 10 e kriterëve mbi Kapacitetin Teknik që duhet të përmbushin OE ofertues.</p> <p>Mjetet sipas (shtojcës 10).</p> <p>1.OE “B...” shpk, rezulton se nuk ka përmbushur kriteret sipas kërkesave të DST për mjetin Kamionçinë me kapacitet mbajtës 3.5 – 5 Ton (2 copë), pasi mjeti me Targa AA...RZ del sipas lejes së qarkullimit me kapacitet 6 Ton, pra 1 Ton më tepër se sa kapaciteti i kërkuar në DST. Gjithashtu, fotot treguese të këtij mjeti, janë bërë në pozicion anësor, çka nuk pasqyron targën e mjetit.</p> <p>IV. Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.</p> <p>-Në këto kushte, KVO nuk duhej të kualifikonte dhe shpallur fitues këtë operator pasi nuk përmbushte kriterin e kërkuar në DST për kamionçinën me kapacitet nga 3.5 – 5 Ton.</p> <p>2. OE “B...” shpk, ka paraqitur sipas kërkesave të DST 1 Fadromë Fiat Hitachi E 170. Për këtë mjet operatori ka paraqitur deklaratën doganore për zhdoganimin e saj, dhe disa dokumente teknike bashkëlidhur, por mungon siguracioni i këtij mjeti si dhe dokumentet e paraqitura janë të panoterizuara.</p> <p>c) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit; b)leje qarkullimi; c)certifikatën e kontrollit teknik; d)siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e)certifikatën për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme). Për mjetet e marra me qera duhet të paraqitet: a)dokumenti qe vërteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c)certifikatën e kontrollit teknik, d)siguracionin e mjetit,(i vlefshëm); e) certifikatën e për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme). Mjetet të shoqërohen me kontratën përkatëse të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jene aktet e ç’doganimit ose faturat tatimore të blerjes.</p> <p>Të gjithë dokumentet duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për shkualifikim.</p> <p>3.OE “B...” shpk, ka paraqitur sipas kërkesave të DST mjetin Autobot Uji me Targa AA...SM. Dokumentet e paraqitura për këtë mjet, rezultojnë se kemi të bëjmë më një mjet të modifikuar Kamion + Bot Uji. KVO, për mjete të ngjashme të modifikuara në këtë procedurë, siç është Autobitumatriçja, ka vlerësuar se është në shkelje të kërkesave të DST duke s’kualifikuar operatorët e tjerë si “V...” shpk, “A...” shpk. Duke përdorur këtë kriter, KVO duhej të</p>			

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>s'kualifikonte edhe OE B... pasi mjeti i paraqitur Autobot Uji, duket qartë edhe nëpërmjet fotografive të paraqitura se është një mjet i modifikuar.</p> <p>2.Nga shqyrtimi i BOE "L..." shpk &amp; "C..." shpk, me ofertë ekonomike me vlerë 23,559,853 lekë pa TVSH, rezulton se KVO e ka s'kualifikuar për arsyet e mëposhtme:</p> <p>•Bashkimi i Operatoreve ekonomik "L..." shpk dhe "C..." shpk nuk plotëson Piken 6 te Kriteve te Veçanta te Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, ku përcaktohet qe ofertuesit duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diplomë, CV, librezë pune dhe të figurojnë në listë pagesa, 1 (një) mjek të përgjithshëm. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se ky bashkim operatorësh, ka paraqitur dokumentacion vetëm për Mjekun e shoqërisë "L..." shpk, T.M. dhe dokumentacionin bashkëlidhur i cili është konform kërkesave të Njësisë. Është e vërtetë që Operatori tjetër nuk ka paraqitur dokumente për mjekun siç përcaktohet në DST, por KVO, duke analizuar ofertën më të favorshme të këtij bashkimi operatorësh, dhe duke qenë se edhe operatori fitues kishte të paktën 3 mangësi të konstatuara nga shqyrtimi i dokumentacionit mbi kapacitetin teknik, duhej të vlerësonte ofertën e këtij bashkimi operatorësh e cila është 2,003,893 lekë më e ulët se sa vlera e kontratës fituese duke mos siguruar efektivitetin e fondeve të prokuruar në këtë vlerë.</p> <p><u>3. Në tenderin me objekt: "Ndërtimi i rrugëve "Kel Kodheli" dhe "Skënder Shylla, Në tender kanë marrë pjesë 14 operatorë ekonomik, nga të cilët është kualifikuar dhe shpallur fitues BOE "L..." &amp; "M...", me vlerë të ofertës ekonomike 35,062,302 lekë, ose 6,237,698 lekë më pak se vlera e fondit limit. Nga auditimi konstatohet se BOE shpallur fitues, nuk i plotëson kriteret e vendosura në DST dhe duhej të s'kualifikohej nga KVO. Nga auditimi është konstatuar se arsyet pse BOE, nuk plotëson kriteret për kualifikim dhe shpalljen fitues janë si më poshtë:</u></p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorëve të kualifikuar nuk konstatohen mangësi sipas kërkesave të DST. KVO ka bërë vlerësimet e duhura në raport me ofertat e mësipërme dhe ka shpallur fituese ofertën më të favorshme e cila është oferta me e ulët e BOE "L..." shpk &amp; "M..." shpk.</p> <p><b>2.Nga auditimi i ofertës së OE "B..." shpk, me vlerë 32,123,884 pa tvsh, rezulton se KVO e ka s'kualifikuar për arsyet e mëposhtme:</b></p> <p>1.Operatori ekonomik "B..." shpk nuk plotëson kushtin: <i>"Të gjithë dokumentet duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për</i></p>			

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin	Rëndësia	Rekomandimi
	<p><i>skualifikim</i>” pasi për mjekun, diploma është paraqitur fotokopje e pashoqëruar me vërtetimin e njësisimit të fotokopjes me kopjen origjinale.</p> <p>2.Operatori ekonomik “B...” shpk nuk plotëson pikën 16 të Kapacitetit Teknik të Dokumenteve Standarde të Tenderit: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10)/ Kamionçinë me kapacitet mbajtës 3.5 -5 ton” , pasi kamionçina me targë TR .... U ka kapacitet mbajtës 0,99 Ton, kamionçina me targe AA ... N ka kapacitet mbajtës 0,99 Ton, kamionçina me targe AA ... HK ka kapacitet mbajtës 3,475 Ton, kamionçina me targë AA ... DH ka kapacitet mbajtës 3,760 Ton dhe kamionçina me targë VL ... C ka kapacitet mbajtës 1,2 Ton.</p> <p>3.Operatori ekonomik “B...” shpk nuk plotëson pikën 16 të Kapacitetit Teknik të Dokumenteve Standarde të Tenderit: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10)/ Autobitumatrice” , pasi mjeti me targë AA ... FA i deklaruar në Shtojcën 10, si autobitumatrice, nga verifikimi i dokumentacionit rezulton mjet i montuar, kamion + bitumatrice.</p> <p>Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, germa “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, germa “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për aftësinë teknike të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik “B...” shpk, referuar Shtojcës 10 nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.</p> <p>-Nga shqyrtimi i dokumentacionit për ofertën e OE “B...”, me ofertë 32,123,884 lekë pa tvsh, rezulton se KVO nuk ka bërë një vlerësim objektiv të ofertës së këtij operatori dhe dokumentacionit bashkëlidhur.</p> <p>1.Në lidhje me pikën 1 të arsyeve të s’kualifikimit, për paraqitjen e diplomës së mjekut fotokopje të panoterizuar, nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se diploma e paraqitur nga OE është dukshëm me vulë të njomë, dhe krahas diplomës bashkëlidhur është edhe Licenca e lëshuar nga Urdhri i Mjekëve të Shqipërisë për ushtrimin individual të profesionit për mjekë, origjinale, si dhe mjeku pasqyrohet edhe në lis pagesat e shoqërisë. Shkaku i mësipërm nuk duhej të përbënte kusht për s’kualifikimin e këtij operatori.</p>			

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>2. Në lidhje me pikën 2 të arsyeve të s'kualifikimit, sipas të cilës OE nuk plotëson pikën 16 të Kapacitetit Teknik të DST, nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se KVO nuk ka bërë vlerësimin e duhur të kësaj pike. Në DST kërkohej konkretisht:</p> <p>Siç konstatohet edhe në tabelën bashkëlidhur, janë kërkuar 2 kamionçina me kapacitet nga 3.5 Ton deri në 5 Ton. OE ka paraqitur disa të tilla. Kamionçina me Targa AA...HK në pronësi të operatori ofertues ka kapacitet mbajtës prej 3.475 Ton, pra 25 kg poshtë kapacitetit të kërkuar, si dhe mjeti me Targa AA...DH ka kapacitet mbajtës prej 3.8 Ton. Siç konstatohet, të dy mjetet kamionçina plotësojnë kushtet teknike, dhe diferenca prej 25 kg e njërit mjet nuk përbën shkak për skualifikimin e tij, vlerësim i cili është ndjekur edhe në praktika të tjera prokurimesh ku për diferenca edhe më të mëdha se sa kjo, mjetet janë kualifikuar.</p> <p>3. Në lidhje me pikën 3 të arsyeve të s'kualifikimit për mos plotësimin e pikës 16 të Kapacitetit Teknik të DST për mjetin Autobitumatriçe, KVO e ka vlerësuar mjetin të pa kualifikueshëm pasi rezulton se mjeti me Targa AA...FA është mjet i montuar kamion + bitumatriçe.</p> <p>-Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se ky mjet është i montuar kamion + bitumatriçe, por ky mjet ka <b><i>Certifikatë Miratimi për mjetet (vetëm brenda vendit) që transportojnë disa mallra të rrezikshme</i></b>, si dhe pasaportën e verifikimit të Autobotit të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë e cila ka certifikuar bitumatriçen bashkë me mjetin me Targa AA...FA. Gjithashtu, rezulton se të paktën 2 prej anëtarëve të kësaj KVO-je, në praktikën e prokurimit me nr. reference 81993 për <i>“Ndërtimin e rrugëve “Migjeni dhe Kadri Roshi” në Njësinë Administrative Kashar, Faza II”</i>, kanë kualifikuar dhe shpallur fitues OE “B...” shpk duke pasur pjesë të makinerive të deklaruara të njëjtin mjet Autobitumatriçe me Targa AA...FA, të cilës në atë praktik i mungonte madje edhe certifikata për transportin e mallrave të rrezikshme. Siç konstatohet kemi 2 vlerësime të ndryshme nga e njëjta KVO për të njëjtin mjet. Sa rezulton nga këto dokumente që ka paraqitur OE, ky mjet plotëson kushtet teknike për kryerjen e punëve të kërkuara, dhe në këto kushte ky mjet duhej të kualifikohej nga ana e KVO në praktikën e këtij prokurimi.</p> <p>KVO, duke s'kualifikuar OE “B...” shpk, me ofertë ekonomike 32,123,884 pa TVSH, nuk ka mundur të siguroj efektivitetin e fondeve të prokuruar prej <b>2,938,418 lekë</b> si diferencë mes ofertës së këtij operatori dhe ofertës së BOE të kualifikuar dhe shpallur fitues.</p> <p>4. Në tenderin me objekt: <i>“Rikonstruksioni shkollës</i></p>			



Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin	Rëndësia	Rekomandimi
	<p><u>Sabaudin Gabrani I'</u>, Në tender kanë marrë pjesë 10 operatorë ekonomik, nga të cilët është kualifikuar dhe shpallur fitues BOE "K..." &amp; "E..." shpk, me vlerë të ofertës ekonomike 45,453,275 lekë, ose 5,166,085 lekë më pak se vlera e fondit limit. Nga auditimi konstatohet se BOE shpallur fitues, nuk i plotëson kriteret e vendosura në DST dhe duhej të s'kualifikohej nga KVO. Nga auditimi është konstatuar se arsyet pse BOE, nuk plotëson kriteret për kualifikim dhe shpalljen fitues janë si më poshtë: Sipas kërkesave të DST (shtojca 10), kërkohet që OE të paraqesë listën e mjeteve sipas tabelës vijuese:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10).</li> </ul> <p>Te paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kokore minimumi 60 copë</li> <li>- Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 5 copë</li> <li>- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 5 copë</li> <li>- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 copë</li> <li>- Kulle ndriçimi – 1 cope</li> <li>- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5 copë</li> <li>- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 15 copë</li> </ul> <p><b>a)</b> Për mjetet që shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (te vlefshme) Certifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qerave/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jene aktet e ç doganimit ose faturat tatimore të blerjes.</p> <p><b>b)</b> Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentet që vërtetojnë pronësinë e tyre.</p> <p><b>c)</b> Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.</p> <p><b>d)</b> Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.</p> <p><b>e)</b> Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në</p>			

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin	Rëndësia	Rekomandimi
	<p><i>përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 9. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).</i></p> <p><i>Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tirane. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qellim verifikimi).</i></p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se BOE të kualifikuar dhe shpallur fitues nuk kanë paraqitur listën e mjeteve bashkëlidhur me dokumentacionin e kërkuar pasi rezulton me mangësi.</p> <p>Konkretisht:</p> <p>1. Autobetonierja me Targa AA...MA e marr me kontratë qiraje nga subjekti "L..." shpk, rezulton pa certifikatën për transport mallrash për të tretë sipas kërkesave të vendosura në DST. Gjithashtu, Siguracioni i këtij mjeti rezulton se ka skaduar 1 javë përpara përfundimit të dorëzimit të dokumenteve. Si rrjedhojë e këtyre mangësive KVO nuk duhet ta kualifikonte operatorin dhe shpallur fitues.</p> <p>2. Autopompa e betonit me targa AA...KX, e marrë me kontratë qiraje nga subjekti "L..." shpk, i mungon certifikata për transport mallrash për të tretë sipas kërkesave të DST, dhe si rrjedhojë KVO nuk duhet ta kualifikonte operatorin dhe shpallur fitues.</p> <p>3. Kamioni Autovinç me kapacitet nga 7.5 – 12 Ton me Targa AA...OK, i marrë me kontratë qiraje nga shoqëria "M..."shpk, i mungon certifikata për transport mallrash për të tretë sipas kërkesave të DST, dhe si rrjedhojë KVO nuk duhet ta kualifikonte operatorin dhe shpallur fitues.</p> <p>4. Kamionçina me kapacitet nga 1.5 – 2 Ton me Targa AA...BX, e marrë me kontratë qiraje nga shoqëria "M..."shpk, i mungon certifikata për transport mallrash për të tretë sipas kërkesave të DST, dhe si rrjedhojë KVO nuk duhet ta kualifikonte operatorin dhe shpallur fitues.</p> <p>5. Kamioni me kapacitet 3.5 deri 5 ton me targa AA...LN, marrë me kontratë qiraje nga shoqëria "G..." shpk, ka certifikatën për transport mallrash për të trete jashtë afateve të vlefshmërisë së saj. Kjo certifikate ka skaduar me 02.09.2017 pra 15 muaj përpara hapjes së tenderit. Si rrjedhojë KVO nuk duhet ta kualifikonte operatorin dhe shpallur fitues.</p> <p>6. Për mjete të kërkuara nga NJP si Rrul me Vibrim, Grajder, Alfaltoshtruese, në sistem ato janë të ngarkuara brenda parametrave të kërkuar, por subjekti posedues i tyre, nuk ka kontrate qiraje me operatorët fitues për këto mjete sipas kërkesës së pikës c të kriterëve të mësipërme i cili kërkon që: <i>Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj. Si rrjedhojë KVO nuk duhet ta kualifikonte operatorin dhe shpallur</i></p>			

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>fitues.</p> <p><b>2.Nga auditimi i ofertës së BOE “I...” shpk &amp; “K...” shpk me vlerë 38,049,235 lekë pa tvsh, rezultoi se KVO e ka s’kualifikuar ofertën e këtyre operatorëve për të njëjtat shkelje të konstatuara edhe tek operatori fitues.</b></p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se:</p> <p>KVO ka s’kualifikuar BOE “I...” shpk &amp; “K...” shpk me argumentin se:</p> <p><i>a)</i> Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion pesë kamionçina, <b>kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 1.5 ton dhe maximum 2 ton secila kamionçinë</b> për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomik ka paraqitur katër kamionçina me kapacitetin mbajtës të kërkuar nga AK nga pesë të kërkuara.</p> <p><i>b)</i> Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion tre kamiona vetshkarkues <b>kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 7 ton dhe maximum 12 ton secili kamion</b> për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomik ka paraqitur në përmbushje të këtij kriteri dy kamiona me kapacitetin e duhur nga tre të kërkuar në shtojcën 10/Kriteret e Veçanta të Kualifikimit.</p> <p><i>c)</i> Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion katër kamiona vetshkarkues <b>kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 3.5 ton dhe maximum 5 ton secili kamion</b> për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomik ka paraqitur në përmbushje të këtij kriteri tre kamiona me kapacitetin e duhur nga katër të kërkuar në shtojcën 10/Kriteret e Veçanta të Kualifikimit.</p> <p>Për pikën <i>a</i>, rezulton se operatorët ekonomik kanë paraqitur pesë kamionçina me kapacitet nga 1.5 ton deri në 2 ton sipas kërkesës së DST, konkretisht mjetet me Targa AA...IU, AA...BK, AA...PP, AA...PP, AA...PP. Këto mjete plotësojnë kushtet dhe kapacitet e kërkuara nga DST.</p> <p>Për pikën <i>b</i>, rezulton se operatorët ekonomik kanë paraqitur 3 kamiona vetshkarkues me kapacitet nga 7 ton deri në 12 ton maksimumi sipas kërkesës së DST, dhe konkretisht mjetet me Targa AA...VA, AA...AG dhe AA...AG. Këto mjete plotësojnë kushtet dhe kapacitetet e kërkuara nga DST.</p> <p>Për pikën <i>c</i>, rezulton se operatorët ekonomik kanë paraqitur 4 kamionë vetshkarkues me kapacitet nga 3.5 ton deri në 5 ton maksimumi sipas kërkesës së DST, dhe konkretisht mjetet me Targa AA...GX, AA...GR, AA...JC dhe DR..2E. Këto mjete plotësojnë kushtet dhe kapacitetet e kërkuara nga DST.</p> <p>Mangësitë e konstatuara për 3 nga këto mjete, për 1 kamionçinë me kapacitet nga 1.5-2 Ton, kamionin vetshkarkues me kapacitet nga 3.5-5 Ton dhe</p>			

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin	Rëndësia	Rekomandimi
	kamionin vetshkarkues me kapacitet nga 7-12 Ton, janë mangësi që lidhen me mungesën e certifikatës për transport mallrash për të tretë, mangësi e cila duhet të ishte konstatuar edhe tek vlerësimi i ofertës së operatorëve ekonomik “K...” shpk dhe “E...” shpk. Duke qenë para kushteve të tilla, KVO duhej të anulonte tenderin deri në plotësimin e kushteve nga operatorët. Në kushtet e vlerësimit të dhënë, rezultoi se <b><i>KVO për mangësi me natyrë të njëjtë dhe me pak të përhapura, duke s’kualifikuar ofertën e BOE “I...” shpk dhe “K...” shpk nuk ka siguruar efektivitet të fondeve të prokuruar prej 7,404,040 lekë pa TVSH, si rezultat i diferencës mes ofertës së Operatorëve fitues dhe ofertës së më të favorshme.</i></b>			
33	<p>-Raportohet se strukturat drejtuese janë përfshirë në vendimmarrje në masën 49% të të intervistuarve; kanë marrë pjesë në trajnime të ndryshme rreth 69% e të intervistuarve; janë njohur me strategjitë e B. Tiranë për periudhën 2018-2022 80% e të intervistuarve nga të cilët 29% raportojnë se strategjia është reflektuar tek buxheti vjetor, 42% tek plani strategjik, 20% tek përshkrimi i kompetencave dhe përgjegjësi dhe 9% nuk e kanë plotësuar; në procesin e rekrutimit janë përfshirë vetëm 26% e drejtuesve dhe, pyetjes “Në cilën pjesë të analizës SËOT gjatë vitit 2018 keni kontribuar?” 26% kanë komentuar rubrika të ndryshme dhe pjesa tjetër nuk e ka plotësuar.</p> <p>-Raportohet gjithashtu nga niveli i mesëm specialist se kanë qenë pjesë e trajnimeve të ndryshme për rritjen profesionale gjatë vitit 2018 vetëm 61% e të intervistuarve dhe, pyetjes “A jeni njohur me strategjinë e B. Tiranë për vitin 2018?” raportojnë pozitivisht 61% e të intervistuarve, 28% nuk janë njohur, 7% janë njohur pjesërisht dhe 4% vetëm çfarë kanë dëgjuar. Gjithashtu pyetjes “Nëse përgjigja e pikës më sipër është po ose pjesërisht ku është reflektuar strategjia për vitin 2018?” raportojnë 44% tek buxheti, 17% tek përshkrimi i punës për çdo vend pune, 44% tek plani strategjik dhe 13% nuk e kanë plotësuar.</p>		<b>E lartë</b>	Drejtorja e Përgjithshme për Planifikimin dhe Menaxhimin Strategjik të marrë masa në bashkëpunim me Burimet Njerëzore për rivlerësimin e situatës në bazë të rishikimit të menaxhimit dhe kontrollit të riskut për shkallën e realizimit të objektivave sipas strategjisë, përfshirjen e strukturave drejtuese në vendimmarrjet relevante, plotësimin në masë më të madhe të nevojave për trajnime si të stafit drejtues dhe ai i nivelit specialist.
34	Nga KLSH është konstatuar se në Drejtorinë IMTV Tiranë nuk ka të hartuar dhe të miratuar një Rregullore të Brendshme për funksionimin e saj. Për të gjitha vitet e auditimit sipas programit të KLSH nr.1268/2 prot, datë 18.12.2018 nga ana e Drejtorisë IMTV Tiranë nuk ka të hartuar dhe të miratuar një Rregullore të Brendshme për funksionimin e brendshëm të saj.		<b>E lartë</b>	K/Inspektori i IMTV të marrë masa të menjëhershme duke hartuar e miratuar një rregullore të brendshme për organizimin e funksionimin e Drejtorisë së IMTV në përputhje me ligjet përkatëse.
35	Nga verifikimi rezultoi se një pjesë e konsiderueshme e personelit ka një nivel të ulët arsimor.		<b>E Lartë</b>	K/Inspektori i IMTV në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore të ndërmarr të gjitha masat për të siguruar që klasifikimi i vendit të punës sipas arsimit përkatës të përputhet me përcaktimin e ligjit në fuqi .

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>ndryshuar, neni 11, arsimimi i kryeinspektorëve dhe inspektorëve të inspektoratit të mbrojtjes së territorit. Kryeinspektorët dhe inspektorët në nivel kombëtar dhe qeverisjeje vendore duhet të kenë arsimin e lartë të nevojshëm profesional në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogeologjisë dhe mjedisit.</p> <p>Një pjesë e personelit përbërës të kësaj drejtorie vihet re se janë me arsim të mesëm dhe kanë kryesisht rolin e specialistit pranë kësaj njësie. Punonjësit pjesë e drejtorive kryesore të kësaj njësie siç janë: Drejtoria e Kontrollit, Sektori i kontrollit të veprave të mëdha apo dhe Drejtoria e koordinimit të projekteve etj., nuk mund të kenë në përbërje të tyre pozicione me emërtimin “specialist” për vetë natyrën e punës së kryer. Si rezultat i këtij veprimi janë shkelur përcaktimet e bëra në ligjin nr. 183/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime” në ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, neni 11 ku përcaktohet qartë arsimi i inspektorëve dhe kryeinspektorëve në nivel qendror ose vendor.</p>			
36	<p>Për periudhën e auditimit ka rezultuar se nga ana e IMT nuk janë përgatitur plane strategjike për vendosjen e objektivave të punës së kryer, nuk janë përgatitur plane përmbledhëse vjetore për veprimtarinë. Gjatë periudhës 2016-2018 nga IMTV nuk janë hartuar raporte, analiza periodike, vlerësim performance si dhe mungon një strategji për identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin e riskut. Nga ana e IMT dërgohet periodikisht informacion pranë IKMT mbi vendimet e mara e cila nga ana e saj në kontrollet e ushtruara pranë IMT ka konstatuar në disa raste mos kthim përgjigje dhe mos veprime nga ana e IMT për shkresa dhe praktika të kryera nga IMTV Bashkia Tiranë.</p>		E Lartë	K/Inspektori i IMTV duhet të marrë masa që çdo vit të përgatisë planet strategjike e vjetore të veprimtarisë së drejtorive në varësi, ku të jenë të përcaktuar objektivat kryesore të veprimtarisë së IMTV.
37	<p>Në lidhje me detyrat funksionale të strukturës së IMTV (ish INUV), nga kryeinspektori i IMT nuk u paraqitën të dhëna dokumentare mbi plane pune javore dhe vjetore mbi aktivitetin e kësaj strukture, për kryerjen e kontrollit në territorin administrativ të bashkisë, për periudhën objekt auditimi.</p> <p>Në lidhje me auditimin e kryer të dokumenteve të vëna në dispozicion nga zyra e IMT, për ushtrimin e kontrollit në terren të kontrollit mbi territorin e bashkisë, nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Bashkia Tiranë për periudhën 01.01.2016 deri 31.12.2018 rezultoi se janë marrë gjithsej 1598 “Vendime për Gjopa” nga të cilat 284 për vitin 2016, për vitin 2017 janë 678 dhe 636 për vitin 2018. Janë</p>		E Lartë	K/Inspektori i IMTV duhet të marrë masa për çdo drejtori të varësisë për hartimin e raporteve periodike e vjetore të veprimtarisë mbi realizimin detyrave përkatëse dhe performancës në përmbushjen e objektivave të IMTV.

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin	Rëndësia	Rekomandimi
	marrë gjithsej 809 “Vendime Prishje“ nga të cilat 353 vendime për vitin 2016, për vitin 2017 janë 205 vendime dhe 251 vendime për vitin 2018, në zbatim të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, për të cilat kanë vijuar procedurat e mëtejshme ligjore.			
38	Nga KLSH është konstatuar në të gjitha dosjet e dokumenteve të audituara nga auditimi i brendshëm janë të inventarizuara, por nuk janë të arshivuara në arshivë. Për të gjitha vitet e auditimit sipas programit të KLSH nr.1268/2 prot, datë 18.12.2018 nga ana e sektorit të Auditit të Brendshëm të gjitha dosjet e auditimit nuk janë të arshivuara në arshivë, por mbahen në ambientet e brendshme të Drejtorisë së Auditit të Brendshëm.		E lartë	Drejtori i Auditit të Brendshëm të marrë masa të menjëhershme duke ju drejtuar Titullarit të Institucionit të Bashkisë Tiranë në përmirësimin e gjendjes, duke u arshivuar të gjitha dosjet e kryera nga Auditimi i Brendshëm në arshivë dhe jo në ambientet e auditit të brendshëm.
39	Nga KLSH është konstatuar në të gjitha dosjet e audituara nga auditimi i brendshëm në auditimet financiare ose të kombinuara (përputhshmëri dhe financiar), nuk kanë dalë me opinion për pasqyrat financiare. Për të gjitha vitet e auditimit sipas programit të KLSH nr.1268/2 prot, datë 18.12.2018 nga ana e sektorit të Auditit të Brendshëm të gjitha dosjet e auditimit në auditimet financiare ose të kombinuara (përputhshmëri dhe financiar), nuk kanë dalë me opinion për pasqyrat financiare sipas kërkesave të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe manualit të auditimit të brendshëm të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 Kap. II, pika 2.4.2. ku citohet: “Gjatë kryerjes së auditimit financiar duhet t’i kushtohet rëndësi faktit, nëse pasqyrat financiare janë hartuar në mbështetje të dokumenteve të sipërcituar dhe në përputhje me kërkesat specifike për raportimin financiar. Nëse arrihet në përfundimin se pasqyrat financiare kanë gabime materiale, audituesit duhet të kenë evidencë të mjaftueshme për ta provuar këtë gjetje. Nxjerra e bilancit kontabël në afat dhe plotësimi i pasqyrave financiare përkatëse”.		E lartë	Auditimi i Brendshëm në auditimet financiare ose të kombinuara (përputhshmëri dhe financiar), të dalë me opinion për pasqyrat financiare.

### I.c. Opinioni i auditimit

#### Opinioni i auditimit mbi pasqyrat financiare.

#### Për drejtimin e Bashkisë Tiranë.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Tiranë për vitin ushtrimor 2017, 2018 të cilat përfshijnë pasqyrën e gjendjes ekonomike, pozicionit financiar (*hyrjeve dhe daljeve (pagesave)*) në para, pasqyra e amortizimit, shënimet shpjeguese që shoqëronin këto pasqyra.

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi sipas parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare. Në Bashkinë Tiranë, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë elektronike sipas programit “Alfa” i cili mundëson regjistrimin e veprimeve kontabël në përputhje me planin kontabël të miratuar me VKM nr. 248, datë 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe të njësive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.1.2001.

### **Opinionit i kualifikuar.**

Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, mbështetur në standardet ISSAI 1700 dhe ISSAI 1200 shprehim një **opinion të kualifikuar** për llogaritë vjetore të Bashkisë Tiranë, duke arritur në përfundimin se anomali të apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në periudhën nën auditim dhe mbi të gjitha, janë të korigjueshme, i njëjti opinion vlen edhe për pasqyrën e realizimit të buxhetit.

Në opinionin tonë, Pasqyrat Financiare të Bashkisë Tiranë, përveç çështjeve të trajtuara në bazën për kualifikimin e opinionit, paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar në 31 Dhjetor 2018, performancën e tij financiare dhe fluksin e parasë për vitin respektiv në përputhje me Kuadrin e Raportimit Financiar të Sektorit Publik.

### **Baza për Opinionin**

Duke marrë në konsideratë faktin se subjekti audituar mund të mos arrijë në kuptimin e saktë të opinionit mbi pasqyrat financiare, duam të tërheqim vëmendjen për çështje specifike që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare të cilat nuk janë materiale, dhe nuk kanë ndikim të dukshëm mbi nivelin e materialitetit dhe në vendimmarrjen e përdorueseve të pasqyrave financiare.

Kemi konstatuar se në disa llogari të pasqyrave financiare, janë kryer veprime kontabël të gabuara duke natyruar përmbajtjen e tyre dhe duke pakësuar vlera kontabël, çka i bëjnë ato të pa sakta.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se:

- Kontabilizimi i veprimeve ekonomike për kontrata të lidhura blerje mallrash apo investimesh nuk është bërë për vlerë të plotë të kontratës, por në momentin e mbërritjes së faturave për blerje malli e shërbimesh dhe investime të shoqëruar me situacion për punime të kryera.

- Nga analiza e kartelës kontabël për llog. 219 rezulton se nuk janë përfshirë dhe nuk janë kontabilizuar përlllogaritjet e amortizimit të aktiveve të NJA-ve, pavarësisht se ishin përlllogaritur nga vetë NJA-të por për efekt kontrolli saktësie të shifrave janë rillogaritur në janar të vitit 2017 dhe janë përfshirë në kontabilitet në mbylljen e bilancit të këtij viti. Këtë e tregon krahasimi i totalit të amortizimit të akumuluar i vitit 2016 në vlerën 1,519,574,854 lekë me totalin e amortizimit të akumuluar të vitit 2015 në vlerën 1,484,354,519 lekë, ku diferenca prej 35,220,335 lekë është vetëm amortizim i vitit ushtrimor 2016 për Bashkinë e Tiranës.

- Për vlerën 35,603,512 lekë pjesë e gjendjes së llogarisë 468 që i përfaqësojnë detyrime për taksa dhe tarifa vendore të ish-komunave të trashëguar në PF e tyre në mbyllje të vitit 2015 Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar në Bashkinë Tirane nuk ka hapur dhe mbajtur llogari ndërmjetëse me nën varësitë pra në këtë rast Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimit Taksave Vendore, nën varësi e Bashkisë. Meqenëse arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore e kryen DPTTV, atëherë dhe ky detyrim duhet të shkarkohet nga bilanci i Aparatit dhe të ngarkohet Bilanci i kësaj drejtorie.

- Njësia e Menaxhimit të Projekteve PIU deri në nëntor të vitit 2015 ka qenë njësi shpenzuese me vete dhe ka menaxhuar 3 projekte investimi me financim të huaj (kredi). Meqenëse në vitin 2015 kjo njësi është shkrire në strukturat e Bashkisë Tiranë si Drejtori brenda Aparatit të bashkisë, edhe bilanci i mbylljes së llogarive të vitit 2015 nga PIU është bërë pjesë e pasqyrave financiare të Bashkisë Tiranë në mbyllje të vitit ushtrimor 2015. Ky bilanc u trashëguua me disa paqartësi në gjendjet e disa llogarive, llogari të cilat deri në fund të vitit 2018 nuk kanë funksionuar sipas parimeve e logjikës kontabël. Për këto gjendje llogarish nuk është ndërmarrë asnjë veprim rregullues kontabël, për arsye të mungesës së informacionit kontabël i shoqëruar me analiza si dhe mungesës së dokumentacionit bazë e justifikues. Si pjesë PF të Aparatit të Bashkisë Tiranë në mbyllje të vitit ushtrimor 2016 janë dhe PF të mbylljes së vitit 2015 e trashëguara nga PIU, ku gjendjet e disa llogarive paraqiten të paqarta e të pa analizuar për të cilat mungojnë shpjegimet sqaruese dhe dokumentacioni mbështetës bazë e justifikues, gjë që ka sjellë ndikim në realitetin e informacionit kontabël që ofrojnë PF. Në mënyrë të detajuar paraqiten më poshtë:

a. *Gjendja e llog. 232* në vlerën 1,157,802,262 lekë, për të cilën nuk ka analizë dhe mungon informacioni kontabël si dhe dokumentar, se çfarë ka të përfshirë dhe çfarë përfaqëson kjo shumë.

b. *Gjendja e llog. 409* në vlerën 58,702,072 lekë, për të cilën nuk ka analizë dhe mungon informacioni kontabël si dhe dokumentar, se çfarë ka të përfshirë dhe çfarë përfaqëson kjo shumë.

c. *Gjendja e llog. 45* në vlerën 6,538,746 lekë, e cila duhet të ishte mbyllur, pasi nuk duhej të paraqitej në bilanc me gjendje. Për këtë gjendje nuk ka asnjë informacion kontabël se çfarë përfaqëson e për rrjedhim për këtë vlerë nuk ka analizë.

d. *Gjendja e llog. 511* në vlerën 81,204,163 lekë, për të cilën nuk ka asnjë informacion kontabël se çfarë përfaqëson, e cila sipas rregullit kontabël duhet të përfaqësojë vlerën e letrave të pagesave që janë të depozituara në bankë në pritje për t'u arkëtuar, si interesa të paguara ose të maturuara.

e. *Pjesë e gjendjes së llog. 512* është edhe vlera prej 13,950,271 lekë, për të cilën Bashkia nuk disponon ekstrakt apo “dokument bankar që të konfirmojë këtë shumë. Për këtë shumë nuk ka informacion se çfarë është dhe si ka vazhduar ecuria e saj deri më tani, çfarë veprimesh janë kryer me këtë gjendje të trashëguar që nga viti 2013.

ë. *Gjendja e llog. 477* në vlerën 1,563,808 lekë, për të cilën nuk ka asnjë informacion kontabël se si ka rezultuar kjo shumë, që sipas funksionimit të kësaj llogarie kjo llogari duhej të ishte mbyllur me shpenzimet dhe jo me fondin themeltar, pasi pasqyron diferencat aktive që lidhen me konvertimet nga vlerësimi i kërkesave debitorë dhe detyrimet të shprehura në monedhe të huaj.

f. *Gjendja e llog. 17* për vlerën pjesore prej 1,382,417,487 lekë të trashëguar nga PIU, e cila përfaqëson vlerën e disbursimeve nga tre kreditë për pagesat e furnitorëve për faturat e investimeve në masën 80%. Për këtë shifër nuk ka analiza sipas projekteve të investimeve e disbursimeve (sipas burimeve të financimit të huaj) të kredive.

- Bashkia Tiranë ka akumuluar në fund të vitit 2018 një borxh prej 2,538,930,790.37 lekë ( i konvertuar 20.571.469,70 EUR) i cili nuk ka gjetur pasqyrim në PF për shkak të moskryerjes së veprimeve ekonomike për shlyerjen e këtyre detyrimeve, kur në PBA dhe buxhetet e viteve 2009-2018 janë programuar fonde në artikullin 55 “Interesa, komisione dhe principal për t'u paguar” në mënyrë të pjesshme dhe realizim minimal për detyrimet për shërbimin e borxhit ndaj Ministrisë së Financave të Ekonomisë për nën-Huatë e marra:

a. Nga BERZH për Projektin “Zhvillimi i Rrugëve të Tiranës” me vlerë kredie 1,096,258,000 lekë (8,200,000 EUR), planifikuar në vitet 2009-2017 në shumën 1,004,116,826 lekë dhe realizuar



në fakt në shumën 278,431,797 lekë ose në masën 28%, kur në fund të vitit 2018 rezulton *detyrimi i akumuluar 656,546,192.15 lekë (5,319,609 EUR)*.

b. Nga CEB për Projektin “Programi i Zhvillimit dhe Rehabilitimit të Shkollave” me vlerë kredie 1,096,258,000 lekë (8,200,000 EUR), planifikuar në vitet 2011-2017 në shumën 384,200,000 lekë dhe i realizuar në masën 0 %, kur në fund të vitit 2018 rezulton *detyrimi i akumuluar 776,723,195.88 lekë (6,293,333 EUR)*.

c. Nga Abu Dhabi për Projektin “Ndërtimi i Bulevardit Verior dhe Rehabilitimi i Lumit të Tiranës” me vlerë kredie 7,367,928,000 lekë (240,000,000 AED ose 57,429,392.1 EUR ), planifikuar në vitet 2015 e 2018 në shumën 104,000,000 lekë, i cili është realizuar në masën 0 %, kur në fund të vitit 2018 rezulton *detyrimi i akumuluar 832,019,515.14 lekë (28,172,175 AED ose 6,741,367 EUR)*.

d. Nga CEB për projektin “Ndërtimi i banesave me qellim social” me vlerë kredie 848,530,000 lekë (6,347,000 EUR), i pa planifikuar në asnjë vit buxhetor, kur në fund të vitit 2018 rezulton *detyrimi i akumuluar 273,641,887.2 lekë (2,217,160 EUR)*.

- Për vitin 2017-2018 *nuk është ndjekur praktika e kontabilizimit të detyrimeve të angazhimit financiar bazuar në kontratat e lidhura me subjektet sipërmarrëse sipas procedurave të prokurimit si dhe nuk janë kontabilizuar detyrimet për shpenzimet e pa paguara të faturave të mbërritura për energjinë elektrike dhe për ujin e pijshëm.*

Mos kontabilizimi i detyrimeve të angazhimit dhe ato të konstatuara, janë në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, Kapitulli I - Mbajtja e kontabilitetit, pika 1-Parimet e përgjithshme.

- Në pasqyrat financiare, janë pasqyruar disa llogari të cilat nuk janë llogari bilanci dhe si të tilla duhej të ishin mbyllur në fund të vitit ushtrimor duke i sistemuar në llogari të tjera sipas përmbajtjes ekonomike të tyre, konkretisht:

-Llogaria e bilancit 24 për vlerën kontabël 530,023,434 lekë, nga të cilat për vlerën 525,960,955 lekë përfaqëson vlera inventariale të identifikuara të vjedhura në periudhën e viteve paraardhëse, në ish Stacionin Hekurudhor të Tiranës. Për këto aktive të konsideruara të vjedhura, nga auditimi i kaluar nga KLSH-ja, është rekomanduar sistemimi i kësaj llogarie duke nxjerrë edhe përgjegjësitë ndaj personave që i kanë pasur në administrim këto vlera inventariale.

Në këto kushte, pasqyrat financiare, nuk japin informacionin e nevojshëm mbi ekzistencën ose jo të aktiveve të pasqyruara në këtë llogari, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për Institucionet Qendrore, Organet e Pushtetit Vendor dhe Njësive që varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit /zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj” i ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007, Kap. II, pika 3- Procedurat e rakordimit dhe mbylljes së llogarive.

-Disa llogari të pasqyrave financiare janë marrë (trashëguar) nga bilanci i ish projektit PIU që nga viti 2015 por për këto llogari, mungojnë të dhënat analitike mbi përmbajtjen e tyre. Këto llogari, nuk janë sistemuar dhe prej vitesh mbahen në këtë gjendje në pasqyrat financiare, të Bashkisë Tiranë, konkretisht:

-Llogaria 409 për vlerën kontabël 58,702,072 lekë, përfaqëson paradhënie të disbursuara për projekte me financim të huaj.

-Llogaria 511 për vlerën kontabël 81,204,163 lekë, përfaqëson vlera për tu arkëtuar nga paradhënie të disbursuara për projekte me financim të huaj.

-Llogaria 512 për vlerën kontabël 24,651,518 lekë, nga të cilat për vlerën 13,950,271 lekë e trashëguar nga bilanci i PIU-t për të cilën nuk ka dokumentacion për përmbajtjen e saj e trashëguar që nga viti 2013, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për Institucionet Qendrore, Organet e Pushtetit Vendor dhe Njësive që varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit /zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj” i ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007, Kap. II, pika 3-

Procedurat e rakordimit dhe mbylljes së llogarive dhe VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, Kapitulli I - Mbajtja e kontabilitetit, pikat 1-Parimet e përgjithshme dhe 2- Dokumentet kontabël, Kap. II, pika 1.1- Pasqyrat financiare vjetore. -Nga analiza e llogarisë 467 ku janë kontabilizuar detyrimet sipas vendimeve gjyqësore të formës së prerë për vlerën kontabël 468,746,202 lekë, konstatohet diferencë e madhe në kohë në disa raste mbi 5 vite, midis vendimit të formës së prerë të gjykatës dhe Urdhrit Ekzekutiv të Titullarit të Bashkisë, për kontabilizimin e detyrimit. Kjo gjë ka sjellë mos evidentimin në kohë të detyrimeve sipas vendimeve gjyqësore si dhe mos marrjen e masave për uljen e borxhit financiar ndaj të tretëve, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, Kapitulli I - Mbajtja e kontabilitetit, pika 1-Parimet e përgjithshme, UMF nr. 1, datë 4.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme në llogari të Thesarit” pikat 2, 3, 4, 6, UMF nr. 2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit” Kap. II, pika 102 dhe UMF nr. 8, datë 13.01.2017 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2017” pikat 81, 84.

Këto veprime nuk përputhen me parimet e kontabilitetit të pranura të ligjit organik të buxhetit, si kërkesat: e VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël” Kapitulli I, pika 1 dhe UMF nr.14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore 2007, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe të njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donator të huaj” Kapitulli IV “Disa veçori për llogaritë vjetore të njësive të menaxhimit / zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatore të huaj”, ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 58,59 dhe 60 “Shërbimi i borxhit”, me ligjin nr.9869 datë 04.02.2009 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore “neni 9 pikat 2,5; neni 2 pika 4; neni 12 pika 1; me ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 41 “Buxheti i njësive të vetëqeverisjes vendore dhe programi buxhetor afatmesëm” pika 2 nënpika (ç/iii).

Ne besojmë se auditimi ynë ofron baza të arsyeshme për opinionin tonë.

### **Opinion i kualifikuar.**

Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, mbështetur në standardet ISSAI 1700 dhe ISSAI 1200 shprehim një **opinion të kualifikuar** për llogaritë vjetore të Bashkisë Tiranë, duke arritur në përfundimin se anomali të apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në periudhën nën auditim dhe mbi të gjitha, janë të korigjueshme, i njëjti opinion vlen edhe për pasqyrën e realizimit të buxhetit.

Në opinionin tonë, Pasqyrat Financiare të Bashkisë Tiranë, përveç çështjeve të trajtuara në bazën për kualifikimin e opinionit, paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar në 31 Dhjetor 2016, performancën e tij financiare dhe fluksin e parasë për vitin respektiv në përputhje me Kuadrin e Raportimit Financiar të Sektorit Publik.

### **Opinion i kualifikuar mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë Tiranë**

Ne kemi audituar përputhshmërinë e subjektit sa i takon shkallës së zbatueshmërinë të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë).

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që vërtetojnë veprimtarinë e Bashkisë Tiranë, gjatë periudhave ushtrimore të vitit 2016, 2017 dhe 2018.

### **Opinion i kualifikuar.**

Sipas mendimit tonë, gjatë auditimit të veprimtarisë së Bashkisë Tiranë, u evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin e Kualifikuar”, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale.

### **Baza për opinion e kualifikuar:**

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se; u konstatuan devijime nga kuadri rregullator përsa i përket, menaxhimit financiar dhe kontrollit, transaksionet e kryera për zbatimin e buxhetit dhe prokurimeve, nuk kanë qenë plotësisht në përputhje me kuadrin ligjor financiar në fuqi.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se:

Në Bashkinë Tiranë, sistemi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen jo plotësisht. Nuk ka konsolidim të tërësisë së rregullave, procedurave për çdo aktivitet të veprimtarisë, pavarësisht se këtë e realizon referuar kompetencave dhe akteve nënligjore në fuqi, duke reflektuar kështu nivel mesatar të riskut të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Detyrimet e faturuara të pa likuiduara për fondet e bashkisë, buxhetit të shtetit dhe të rajoneve në fund të vitit 2018 janë në vlerën **3,864,223,325 lekë**.

Përpara zbatimit të vendimit gjyqësor, nuk janë nxjerrë përgjegjësitë administrative dhe nuk është nxjerrë akti që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi.

Në hartimin e kërkesave të veçanta për kualifikim, u konstatua se në 4 (katër) procedura, nuk kanë gjetur zbatim aktet ligjore e nënligjore të fushës së prokurimit publik, duke mos i argumentuar këto kërkesa në lidhje të ngushtë me objektin e kontratës, veprim në kundërshtim me nenin 26, pika 5, nenin 61, pika 2, paragraf i të VKM nr.914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshime.

Në zbatimin e punimeve të 7 (shtatë) kontratave, u konstatuan devijime materiale në zërat e matshëm, fakt që tregon se mbikëqyrja e punimeve të investimeve është një zonë me risk në menaxhimin e investimeve publike, duke evidentuar një dëm ekonomik në vlerën **4,038 mije lekë**.

Në zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, janë konstatuar veprime që nuk përputhen me kërkesat dhe kriteret e kuadrit rregullator në fuqi në 21 procedura të shoqëruar me shpenzime jo sipas 3-E në shumën 60,532 mijë lekë.

### **Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Tiranë.**

Drejtimi i Bashkisë Tiranë, është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe kontrollin e brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

### **Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

## II.HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 1268/2, datë 18.12.2018 miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 19.12.2018 deri në datë 16.04.2019, në subjektin Bashkia Tiranë, për periudhën nga 01.01.2016 deri në 31.12.2018, u krye auditimi “Auditim financiar dhe përputhshmërie” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. A.T., Përgjegjës Grupi
2. B.M., Auditues
3. I.S., Auditues
4. J.L., Auditues
5. G.H., Auditues
6. A.G., Auditues
7. Ing. S.M., Auditues

**Titulli:** Auditim financiar dhe përputhshmërie në Bashkinë Tiranë.

**Marrësi:** Bashkia Tiranë

**Objektivat dhe qëllimi:** Dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare të Bashkisë Tiranë për vitet 2016, 2017, 2018 dhe dhënia e opinionit të përputhshmërisë në lidhje me kuadrin rregullator në fuqi.

**Procedura e ndjekur:** Projekt Raport auditimi i dërgohet subjektit Bashkia Tiranë, pasi nga grupi i auditimit janë dorëzuar në protokoll aktet e mbajtura në lidhje me problematikat e konstatuara dhe nga subjekti me shkrësat përcjellëse janë paraqitur kundërshtitë, të cilat pasi janë analizuar me kujdes, profesionalizim dhe paanshmëri, janë marrë në konsideratë ato raste të cilat kishin mbështetje ligjore, ndërsa për rastet e tjera të cilat kundërshtitë nuk mbështeteshin me argumente ligjore, nuk janë marrë në konsideratë dhe janë trajtuar në këtë projekt raport auditimi, i cili i përcillet subjekti për vërejtje.

**Objektivat dhe qëllimi i auditimit:**

- **Qëllimi i auditimit:**

Qëllimi i auditimit: është dhënia e opinionit financiar dhe përputhshmërinë apo hartimi i Projekt Raport auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime.

- **Objektivat e auditimit synojnë:**

Dhënien e vlerësimeve të pavarura mbi funksionimin e sistemeve dhe nënsistemeve të kontrollit të brendshëm dhe komponentëve të menaxhimit financiar të subjektit, nëpërmjet përcaktimit nga ana e audituesve:

- nëse pasqyrat financiare janë hartuar në përputhje me rregullave dhe ligjeve të kontabilitetit;
- nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik;
- nëse të ardhurat dhe shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik;
- verifikimin e përgjegjësisë financiare të subjekteve përgjegjëse, nëpërmjet ekzaminimit dhe vlerësimit të dhënave financiare;
- auditimin e sistemeve financiare dhe transaksionet, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret.

### **Identifikimi i çështjes:**

#### **Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim (në vartësi të llojit të auditimit).**

Strukturat drejtuese të Bashkisë Tiranë janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare dhe në të njëjtën kohë janë përgjegjës për aktivitetin financiar të Bashkisë në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë por pa u kufizuar në Ligjin e Buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, Ligjin e Prokurimeve dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, Ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për Planifikimin, Zhvillimin dhe Mbrojtjen e Territorit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, Ligjin për Auditin e Brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

**Përgjegjësitë e audituesve.** Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare të aparatit të Bashkisë Tiranë dhe një opinion në lidhje me përputhshmërinë e aktivitetit të subjektit të audituar në lidhje me aktet ligjore dhe nënligjore për prokurimin, menaxhimin financiar dhe kontrollin, auditimin e brendshëm, planifikimin, zhvillimin dhe mbrojtjen e territorit. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së mbledhur të auditimit.

**Kriteret e vlerësimit.** Legjislacioni bazë e dytësor, dhe dispozita të tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe iu jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit:

- ✓ Kushtetuta dhe Ligji nr. 154/2014 “Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.
- ✓ Ligjin nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.
- ✓ Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; i ndryshuar
- ✓ Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.
- ✓ Ligji nr. 130/2016, datë 15.12.2016 “Për buxhetin e vitit 2017”, ligji nr. 109/2017, datë 18.12.2017 “Për buxhetin e vitit 2018” dhe aktet normative që e ndryshojnë këto ligje.
- ✓ Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar,

- ✓ Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, etj.
  - ✓ UMF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor...”, i ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007.
  - ✓ MF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.
  - ✓ Urdhri i MF nr. 54, datë 15.07.2010 “Për miratimin e manualit të MFK”.
- Standardet e auditimit** Auditimi është kryer sipas standardeve ndërkombëtare të auditimit të hartuara nga INTOSAI.
- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik“ që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
  - ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë“ që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
  - ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200;
  - Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC;
  - Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”; etj.
  - Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”; etj.

### III.PËRSHKRIMI AUDITIMIT

**Informacioni i Përgjithshëm:** Auditimi në Bashkinë Tiranë u krye në kuadër të planifikimit fillestar vjetor të subjekteve të përzgjedhura për tu audituar. Në këtë subjekt, u evidentuan shmangie përse i përket detyrimeve të mbartura dhe të krijuara gjatë periudhës objekt i auditimit pa gjetur një rrugëzgjidhje nga pikëpamja e raportimit financiar si dhe të meta e dobësi në drejtim të përputhshmërisë me kërkesat dhe kriteret e vlerësimit sipas kuadrit rregullator në fuqi të shoqëruara me shpenzime jo sipas 3-E në fushën e prokurimeve si dhe me dëm ekonomik në disa projekte zbatimi në fushën e investimeve për punë publike. Ky auditim ka rëndësi për KLSH duke qenë se është njësia më e madhe e vetëqeverisjes vendore.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren, Akteve të Konstatimeve të mbathura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit ky raporti i Auditimit.

**Parimet e auditimit financiar:** Në punën tonë audituesve jemi mbështetur në parimet e mëposhtme:

- Etika dhe pavarësia;
- Kontrolli i cilësisë
- Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre

- Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

*Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim:*

**Përkatësia:** Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

**Plotësia:** Te gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

**Saktësia:** Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e regjistruara dhe ngjarjet janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme.

**Periudha:** Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël.

**Klasifikimi:** Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura.

**Ligjshmëria dhe rregullsia:** Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion.

*Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës*

**Ekzistenca:** asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto ekzistojnë.

**Të drejtat dhe detyrimet:** Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet, detyrimet dhe janë obligimet e subjektit.

**Plotësia:** Të gjitha asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

**Vlerësimi dhe alokimi:** Aktivet, pasivet dhe interesat e kapitali janë të përfshira në pasqyrat financiare dhe shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

*Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese*

**Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet:** Ngjarjet e shpalosura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.

**Plotësia:** Te gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.

**Klasifikimi dhe kuptueshmëria:** Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe të përshkruara dhe shënimet e kanë shprehur qartë.

**Saktësia dhe vlerësimi:** Informacioni financiar dhe të tjera është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasi të duhur.

### **Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit.**

Mbështetur në **ISSAI 1315**, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i rrisqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit e njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt rrisqeve të vlerësuara të gabimeve materiale. Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialiteti në përputhje me **ISSAI 1320** dhe **ISSAI 1450**, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesit konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për përlllogaritjen e materialiteti janë marrë shpenzimet. Nën gjykimin profesional të audituesit, për institucionin Bashkia Tiranë grupi i punës ka marrë në konsideratë faktorët e riskut prej 0.7 % për shpenzimet dhe 2% për investimet. Për rrjedhojë niveli i precizonit për materialitetin pranohet në vlerën 7,057 mijë lekë për vitin 2017 dhe vlerën 7,949 mijë lekë për vitin 2018<sup>1</sup>, dhe gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët deri në të moderuar. Pas përcaktimit të nivelit të materialiteti grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm kryhet nëpërmjet testeve të kontrolleve. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të ulët deri të moderuar.

---

<sup>1</sup> Shiko aneksin 1

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm u administrua dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar vlerësimin përmes skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH<sup>2</sup>.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (**ISSAI 1520**) dhe testeve thelbësore të kryera.

Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në analiza të marrëdhënieve mes informacionin financiar dhe jo financiar si p.sh krahasimet mes buxheteve dhe realizimit faktik; *inspektime* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në letër ose elektronike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur; dhe së fundi *kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit të personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë.

## **Metodat dhe Teknikat e Kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit:**

### 1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*)

### 2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) konstatoi se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar në bazë të UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

### 3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por probleme u konstatuan mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu u krye mbikëqyrje fizike e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

### 4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

### 5. Konfirmim nga të tretët.

Transaksionet e përzgjedhura për t’ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

### 6. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsisë kontabël. Mund të përmendim nëse ka: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

---

<sup>2</sup> Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm \* Risku i kontrollit \* Risku i Zbulimit



## 7. Intervistimi

## 8. Raporte dhe Informacione

### 9. Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm

**Objekti i këtij auditimi** është raportimi financiar dhe paraqitja e drejtë dhe e sinqertë e pasqyrave financiare për vitet 2017, 2018. Gjithashtu, sipas programit të auditimit, objekt i këtij auditimi është edhe vlerësimi i përputhshmërisë së aktivitetit të subjektit të audituar me kriteret e vlerësimit.

**Qëllimi i auditimit** është dhënia e opinionit për pasqyrat financiare dhe dhënia e opinionit të përputhshmërisë në lidhje me aktivitetin dhe operacionet për efekt të ligjit të prokurimit dhe menaxhimit financiar dhe kontrollit.

**Fushëveprimi i këtij auditimi** përfshin të gjithë aktivitetin e aparatit të Bashkisë Tiranë. Në këtë mënyrë nuk është vlerësuar raportimi në pasqyrat financiare përsa i përket konsolidimit si pasojë e kërkesave të kuadrit rregullator në fuqi për vitin 2018 pasi, gjatë ushtrimit të auditimit në terren, konsolidimi ishte në proces dhe brenda afateve të përcaktuara.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, duke vlerësuar evidencat e grumbulluara përsa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të Bashkisë Tiranë.

**Misioni** për njësinë që auditohet është Kryerja e funksioneve të veta, të përbashkëta dhe të deleguara në interes të komunitetit, duke përdorur në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme burimet natyrore dhe financiare (*të ardhurat e veta, grandin dhe fondet e dhëna nga buxheti i shtetit me synim krijimin e kushteve të sigurisë dhe mirëqenies për komunitetin*).

**Objektivat** burojnë nga ligji “Për vetëqeverisjen vendore”.

*Ndërsa administrata (aparati) i këtij institucioni ka si qëllim: përmirësimin e kushteve të punës, rritjen e nivelit të drejtimit dhe rishikimin funksional të Bashkisë, zhvillimin e politikave dhe strategjive, identifikimin, koordinimin dhe monitorimin e programeve, rritjen e efektivitetit të përdorimit të burimeve.*

*Bashkia siguron qeverisjen në një nivel sa më afër shtetasve nëpërmjet: njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësisë; respektimit i të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera; zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësirave të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë; ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga Bashkia; realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme dhe nxitjes efektive të pjesëmarrjes së bashkësisë në qeverisjen vendore.*

*Organi përfaqësues i Bashkisë është Këshilli Bashkiak.*

*Organi ekzekutiv i Bashkisë është Kryetari i Bashkisë*

*Ushtrimi i autoritetit me interes publik vendor: krijon, mbledh të ardhura dhe bën shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre, vendos taksa e tarifa për shërbimet si dhe nivelin e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe interesat e bashkësisë, harton, miraton dhe ndjek zbatimin e buxhetit tyre.*

Bashkia kryen funksione të veta, të përbashkëta dhe funksione të deleguara.

## **IV.GJETJET DHE REKOMANDIMET**

### **IV/A. PLANIFIKIMI DHE IDENTIFIKIMI I RISKUT; STRATEGJIA DHE VLERËSIMI I RISKUT; EKZEKUTIMI I PROCEDURAVE TË TESTIMIT; PËRGATITJA E**

## DOKUMENTEVE STANDARDE TË AUDITIMIT DHE KOMUNIKIMI I TYRE NË MËNYRË TË VAZHDUESHME ME SUBJEKTIN E AUDITUAR.

***A/3.1. Testimi i funksionimit të kontrolleve kryesore të entitetit, përfshirë zbatimin e kuadrit rregullator për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Vlerësimi si janë vendosur, përmbushur qëllimet dhe objektivat e njësisë publike, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, nëpërmjet veprimtarive efektive, eficientë dhe me ekonomi, pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat, informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota dhe mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.***

Në zbatim të pikës A, 3.1 të programit të auditimit u grumbullua dhe u shqyrtua evidenca e mjaftueshme nga ana sasiore dhe cilësore si më poshtë:

-Rregulloret e brendshme të organizimit dhe funksionimit të Njësisë.

-Strategjitë e përgjithshme dhe sektoriale.

-Informacione me shkrim nga drejtuesit e nivelit të lartë mbi veprimtarinë e sektorëve që mbulojnë si dhe objektivat e planet periodike të punës.

-Projektbuxhetet dhe buxhetet vjetore të miratuara.

-Raportet periodike mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin.

-Vendime të Këshillit Bashkiak, 2018.

-Intervista dhe raporte me shkrim të punonjësve të administratës.

Për qëllim të verifikimit sa më sipër u përdorën teknika auditimi për grumbullimin e evidencës dhe auditimin si fizike, dokumentare, verbale dhe analitike.

Nga auditimi i evidencës së grumbulluar rezulton se veprimtaria e Bashkisë Tiranë për periudhën objekt i auditimit është orientuar nga Strategjia e zhvillimit të qëndrueshëm 2015-2018 miratuar me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 22409, datë 24.12.2015; Strategjia e zhvillimit të qëndrueshëm të bashkisë Tiranë 2018-2022; Planet e veprimit në zbatim të strategjive si Plani i veprimit për zhvillimin e komunitetit rom dhe Egjiptian miratuar me VKB nr. 4, datë 31.01.2018; Plani i veprimit për barazinë gjinore 2018-2020, miratuar me VKB nr. 69, datë 7.6.2018; Plani i veprimit për përfshirjen sociale e miratuar me VKB nr. 96, datë 26.07.2018; Plani lokal social 2018-2020 miratuar me VKB nr. 97, datë 26.07.2018; Plani i veprimit qyteti i gjelbër miratuar me VKB nr. 70, datë 07.06.2018 dhe në bazë dhe zbatim të Rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës miratuar me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë nr. 429, datë 08.01.2016 e rifreskuar me Rregulloren për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës miratuar me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë nr. 25661, datë 02.07.2018. Gjithashtu politikat, objektivat dhe plani i aktiviteteve janë reflektuar në PBA 2016-2018, miratuar me VKB nr. 58, datë 30.12.2015; PBA 2017-2019 miratuar me VKB nr. 84, datë 29.12.2016 dhe PBA 2018-2020 miratuar me VKB nr. 132, datë 21.12.2018 me ndryshimet respektive të miratuara të konfirmuara me VKB nr. 104, datë 28.09.2017 për miratimin e treguesve të realizimit të buxhetit të bashkisë për vitin 2016 dhe VKB nr. 75, datë 07.06.2018 për miratimin e treguesve për vitin 2017.

Për të verifikuar funksionimin e kontrolleve të vendosura, të raportuara nga komunikimi me grupin e auditimit, për qëllim të auditimit u kërkua me shkrim drejtorive informacion të shoqëruar me dokumentacion për çështjet e mëposhtme:

*“Mbështetur në Programin e Auditimit nr. 1268/2, datë 18.12.2018, protokolluar në Bashkinë Tiranë me nr. 42739/2, datë 20.12.2018, drejtimi i auditimit II,a/3 kërkojmë të vini në dispozicion të Grupit të Auditimit, dokumente dhe informacione mbi:*

- 1. Mbikëqyrjen dhe menaxhimin efektiv të punonjësve të strukturës që Ju drejtoni dhe ruajtjen e nivelit të tyre profesional.*
- 2. Objektivat dhe Prioritetet e funksionit që ju ushtroni për vitin 2018.*
- 3. Rrisqet e identifikuar në punën tuaj për vitin 2018 dhe vlerësimin, kontrollin e rrisqeve që mund të kenë vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që Ju drejtoni.*
- 4. Kontributi juaj në garantimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit në strukturat që Ju drejtoni, bazuar në rregullat e vendosura nga Titullari i Institucionit, si dhe raportet tuaja periodike tek nëpunësi autorizues për çdo dobësi të sistemit. Raportet periodike mbi zbatimin e strategjisë 2018-2022, për vitin 2018.*
- 5. Informacionin në formën e kërkuar për rezultatet e arritura gjatë përmbushjes së përgjegjësive, për rrisqet dhe defektet serioze në veprimtarinë e strukturave që Ju drejtoni, si dhe për masat e marra e të zbatuara për riparimin e të metave.*
- 6. Ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësisë kundrejt humbjeve vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar.*
- 8. Ndarja e detyrave dhe përgjegjësive si dhe kontrollet e vendosura dhe funksionimi i tyre për çdo përgjegjës sektori dhe specialist, referenca e akteve ku mbështeten.*
- 9. Informacion mbi ngarkesën e strukturës që Ju drejtoni në drejtim të aktiviteteve, burimeve njerëzore, aseteve dhe buxhetit pas reformës territoriale administrative.”*

dhe përgjigjet respektive, të cilat administrohen nga Grupi i Auditimit, janë reflektuar në akt verifikimin e mbajtur për këtë qëllim.

Gjithashtu u përpiluan dhe u plotësuan në bashkëpunim me burimet njerëzore të Bashkisë Tiranë pyetësor dhe u plotësuan nga 76 drejtues të nivelit të lartë dhe të mesëm, me arsim të lartë, të moshës mesatare 38 vjeç dhe nga përgjigjet rezultoi se:

Pyetjes “Në vlerësimin tuaj si është impakti i zbatimit të reformës territoriale administrative?” iu përgjigjën për impakt pozitiv 86% e të intervistuarve, 3% për impakt negativ; 1% nuk ka impakt, 8% nuk kanë vlerësim dhe 3% nuk e kanë plotësuar.

Pyetjes “Si paraqitet ngarkesa në punë gjatë vitit 2018 në krahasim me vitin 2016?” u përgjigjën për ngarkesë më të lartë në punë 96% e të intervistuarve dhe 4% pa ndryshime.

Pyetjes “Sa të motivuar jeni në punën tuaj të përditshme?” iu përgjigjën që ishin shumë të motivuar 88% e të intervistuarve, 8% presin më shumë, 3% nuk bëjnë dallimin dhe 1% nuk e kanë plotësuar.

Pyetjes “Si paraqiten të ardhurat tuaja nga paga, shpërblimet dhe benefice të tjera nga natyra në vitin 2018 në raport me vitin 2016?” iu përgjigjën 84% për të ardhura më të larta, 8% raportojnë se të ardhurat e tyre janë në të njëjtin nivel dhe 8% nuk kanë një përgjigje.

Pyetjes “Në pozicionin e drejtuesit a jeni të përfshirë në vendimmarrjen e B. Tiranë?” raportojnë se janë përfshirë në vendimmarrje 49% e të intervistuarve, 20% nuk janë përfshirë, 29% kur ju kërkohet, 1% kanë dhënë vetëm mendim dhe 1% nuk e kanë plotësuar.

Pyetjes “A jeni njohur zyrtarisht me përgjegjësitë dhe kompetencat e pozicionit që mbani?” janë përgjigjur pozitivisht 97% e të intervistuarve, 1% janë njohur në mënyrë rastësore dhe 1% nuk e kanë plotësuar.

Pyetjes “A keni qenë pjesë e trajnimeve të ndryshme për rritjen profesionale gjatë vitit 2018?” janë përgjigjur pozitivisht 69% e të intervistuarve, 27% nuk kanë kryer trajnime dhe 4% jashtë programit të bashkisë.

Pyetjes “A jeni njohur me strategjitë e B. Tiranë për periudhën 2018-2022?” janë përgjigjur pozitivisht 80% e të intervistuarve, 15% nuk janë njohur me strategjinë dhe 5% janë njohur pjesërisht.

Pyetjes “Nëse përgjigja e pikës më sipër është po ose pjesërisht ku është reflektuar strategjia e B. Tiranë për vitin 2018 e në vazhdim?” 29% raportojnë tek buxheti vjetor, 42% tek plani strategjik, 20% tek përshkrimi i kompetencave dhe përgjegjësi dhe 9% nuk e kanë plotësuar.

Pyetjes “Për realizimin e objektivave të njësisë që drejtoni sa mendoni se ushtroni kompetencat tuaja?” 89% raportojnë plotësisht, 4% raportojnë formalisht, 4% nuk kanë kompetenca të mjaftueshme dhe 3% në varësi të dinamikës së përditshme.

Pyetjes “A jeni përfshirë në procesin e rekrutimit përsa i përket plotësimit të stafit në njësinë që drejtoni?” 26% përgjigjen pozitivisht, 34% përgjigjen negativisht dhe 38% me raste.

Pyetjes “Në cilën pjesë të analizës SËOT gjatë vitit 2018 keni kontribuar?” 26% kanë komentuar rubrika të ndryshme dhe pjesa tjetër nuk e ka plotësuar.

Gjithashtu u përpiluan dhe u plotësuan në bashkëpunim me burimet njerëzore të Bashkisë Tiranë pyetësor dhe u plotësuan nga 325 specialist, me arsim të lartë, të moshës mesatare 36 vjeç dhe nga përgjigjet rezultoi se:

Pyetjes “Në vlerësimin tuaj si është impakti i reformës territoriale administrative?” iu përgjigjën 85% për impakt pozitiv, 2% për impakt negativ, 3% nuk ka impakt, 8% nuk kanë vlerësim dhe 2% nuk e kanë plotësuar.

Pyetjes “Si paraqitet ngarkesa në punë gjatë vitit 2018 në krahasim me vitin 2016?” u përgjigjën për ngarkesë më të lartë 78% e të intervistuarve, 18% pa ndryshime, 1% më e ulët, 1% e papërbalueshme dhe 2% nuk e kanë plotësuar.

Pyetjes “Sa të motivuar jeni në punën tuaj të përditshme?” raportojnë për shumë të motivuar 75%, 3% të pamotivuar, 17% presin më shumë, 4% nuk e dallojnë dot dhe 1% nuk e kanë plotësuar.

Pyetjes “Si paraqiten të ardhurat tuaja nga paga, shpërblimet dhe benefice të tjera nga natyra në vitin 2018 në raport me vitin 2016?” 72% i kanë më të larta, 24% në të njëjtin nivel, 1% më të ulëta, 6% nuk kanë një përgjigje dhe 1% nuk e kanë plotësuar.

Pyetjes “Si është raporti i marrëdhënieve të eprorit tuaj me JU?” raportojnë 94% për marrëdhënie korrekte, 2% për marrëdhënie jo korrekte, 2% nuk kanë marrëdhënie fare dhe 2% për shkak të detyrës.

Pyetjes “A jeni njohur zyrtarisht me detyrat e vendit të punës dhe të drejtat tuaja?” 83% raportojnë se janë njohur me detyrat dhe të drejtat në punë, 9% nuk janë njohur, 5% raportojnë se iu janë komunikuar verbalisht, 1% çfarë ju kërkohet dhe 2% nuk e kanë plotësuar.

Pyetjes “A keni qenë pjesë e trajnimeve të ndryshme për rritjen profesionale gjatë vitit 2018?” raportojnë pozitivisht 61% e të intervistuarve, 31% përgjigjen negativisht, 3% jashtë programit të institucionit dhe 4% nuk kanë kryer asnjë trajnim.

Pyetjes “A jeni njohur me strategjinë e B. Tiranë për vitin 2018?” raportojnë pozitivisht 61% e të intervistuarve, 28% nuk janë njohur, 7% janë njohur pjesërisht dhe 4% vetëm çfarë kanë dëgjuar.

Pyetjes “Nëse përgjigja e pikës më sipër është po ose pjesërisht ku është reflektuar strategjia për vitin 2018?” 44% tek buxheti, 17% tek përshkrimi i punës për çdo vend pune, 44% tek plani strategjik dhe 13% nuk e kanë plotësuar.

Pyetjes “Ku mbështeten marrëdhëniet tuaja të punës në B. Tiranë?” 88% tek statusi i nëpunësit civil, 10% tek kodi i punës, 1% tek kontrata individuale e punës dhe 1% tek kontrata kolektive e punës.

Pyetjes “A keni dijeni dhe a keni nënshkruar formularin për vlerësimin periodik të punës tuaj?” 94% përgjigjen pozitivisht, 3% negativisht, 2% nuk kanë dijeni dhe 1% nuk e kanë plotësuar.

Sa trajtuar më sipër janë objekt i veprimtarisë dhe përgjegjësisë së nivelit të lartë e të mesëm drejtues të Bashkisë Tiranë.

**1. Titulli Gjetjes**                      Funksionimi i kontroleve të vendosura reflekton mangësi nga testimi i përgjigjeve me shkrim të strukturave drejtuese me përgjigjet e pyetësorëve në disa rubrika.

**Situata:**                      -Raportohet se strukturat drejtuese janë përfshirë në vendimmarrje në masën 49% të të intervistuarve; kanë marrë pjesë në trajnime të ndryshme rreth 69% e të intervistuarve; janë njohur me strategjitë e B. Tiranë për periudhën 2018-2022 80% e të intervistuarve nga të cilët 29% raportojnë se strategjia është reflektuar tek buxheti vjetor, 42% tek plani strategjik, 20% tek përshkrimi i kompetencave dhe përgjegjësive dhe 9% nuk e kanë plotësuar; në procesin e rekrutimit janë përfshirë vetëm 26% e drejtuesve dhe, pyetjes “Në cilën pjesë të analizës SËOT gjatë vitit 2018 keni kontribuar?” 26% kanë komentuar rubrika të ndryshme dhe pjesa tjetër nuk e ka plotësuar.

-Raportohet gjithashtu nga niveli i mesëm specialist se kanë qenë pjesë e trajnimeve të ndryshme për rritjen profesionale gjatë vitit 2018 vetëm 61% e të intervistuarve dhe, pyetjes “A jeni njohur me strategjinë e B. Tiranë për vitin 2018?” raportojnë pozitivisht 61% e të intervistuarve, 28% nuk janë njohur, 7% janë njohur pjesërisht dhe 4% vetëm çfarë kanë dëgjuar. Gjithashtu pyetjes “Nëse përgjigja e pikës më sipër është po ose pjesërisht ku është reflektuar strategjia për vitin 2018?” raportojnë 44% tek buxheti, 17% tek përshkrimi i punës për çdo vend pune, 44% tek plani strategjik dhe 13% nuk e kanë plotësuar.

<b>Kriteri</b>	Kërkesat që burojnë nga ligji dhe aktet në zbatim për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm.
<b>Ndikimi/Efekti</b>	Në monitorimin dhe ndjekjen e veprimtarisë së strukturave për njohjen, planifikimin dhe kontributin përveç realizimit të funksioneve të ngarkuara në arritjen e objektivave të bashkisë.
<b>Shkaku</b>	Shmangie nga monitorimi rigoroz dhe kontrolli sipas varësisë të strukturave drejtuese në dinamikën e përditshme të punës së stafit të bashkisë.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandimi</b>	Drejtoria e Përgjithshme për Planifikimin dhe Menaxhimin Strategjik të marrë masa në bashkëpunim me Burimet Njerëzore për rivlerësimin e situatës në bazë të rishikimit të menaxhimit dhe kontrollit të riskut për shkallën e realizimit të objektivave sipas strategjisë, përfshirjen e strukturave drejtuese në vendimmarrjet relevante, plotësimin në masë më të madhe të nevojave për trajnime si të stafit drejtues dhe ai i nivelit specialist.

#### **A/4.2. Auditim mbi organizimin, mbajtjen e kontabilitetit, hartimin dhe saktësia e veprimeve rregulluese dhe mbyllëse për paraqitjen e pasqyrave financiare.**

##### ***-Pasqyrat Financiare viti 2016***

*Për organizimin, mbajtjen e kontabilitetit, hartimin dhe saktësinë e veprimeve rregulluese dhe mbyllëse për paraqitjen e pasqyrave financiare për vitin 2016.*

Për auditimin e pikës 3.2 të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Pasqyrat financiare të viteve 2016 të shoqëruar me formatet 1-9.
2. Dokumente kontabël si: ditarët e bankës, magazinës, pagave, të veprimeve të ndryshme, debitorëve, kreditorëve, furnitorëve, etj., centralizatori, bilanci vërtetues.
3. Dokumentacioni i kryerjes së inventarëve të aktiveve 2016, libri i aktiveve.
4. Miratimet e buxhetit vjetor për vitin 2016 dhe PBA (2016-2018), shkresat e ndryshimeve, raporti i monitorimit dhe realizimi faktik i buxhetit të vitit 2016
5. Urdhër-shpenzimet dhe dokumentacioni bashkëlidhur për vitin 2016
6. Akordimet me Degën e Thesarit Tiranë në mbyllje të vitit buxhetor 2016.
7. Korrespondencat me Ministrinë e Financave për 4 projektet me financim të huaj (kreditë e BT)
8. Të tjera dokumente mbështetëse (databaze të ndryshme si: për vendimet gjyqësore, për investimet, programi ALFA, programi SIFQ, Sistemi elektronik i APP etj.).

***Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:***

- ***Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:***

Për vitin 2016 nga njësia shpenzuese “Aparati i Bashkisë Tirane” hartimi i pasqyrave financiare dhe përgatitja e llogarive vjetore është mbështetur në ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të ndryshuar, VKM nr.248, datë 10.04.1998 pika 3, ndryshuar me VKM nr.25, datë 20.01.2001, UMF nr.26, datë 27.12.2007 “Për disa shtesa e ndryshime në UMF nr.14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore 2007, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe të njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donator të huaj”, VKM Nr.783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”. Lidhur me operacionet buxhetore, është i rakorduar dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Tiranë dhe nuk ka patur në asnjë rast kontestime.

- ***Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara për të gjitha njësitë shpenzuese të varësisë nuk është kryer.***

**Konkluzion:** Për vitin 2016 nuk është hartuar bilanc i konsoliduar, pasi mungon struktura e posaçme për pranimin, kontrollin dhe përpunimin të informacionit kontabël të sjellë nga 19 njësi të

varësisë së Bashkisë Tiranë. Si rezultat i mungesës së strukturës edhe në rregulloren e brendshme të miratuar me vendimin e kryetarit nr.429 datë 08.01.2016 “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së institucionit të Bashkisë Tiranë”. Kjo detyrë nuk është përfshirë në përcaktimet e detyrave dhe përgjegjësi në rregulloren e organizimit dhe funksionimit të brendshëm të Bashkisë. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 62 “Përgatitja e llogarive vjetore të buxhetit”, me UMF nr.26, datë 27.12.2007 “Për disa shtesa e ndryshime në UMF nr.14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore 2007, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësi që varen prej tyre si dhe të njësi të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donator të huaj “pika 5 “Për Konsolidimin e Pasqyrave Financiare”

- **Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare**

Pasqyrat financiare janë të firmosura nga NA dhe NZ si dhe janë të dërguara në Degën e Thesarit Tiranë me shkresë përcjellëse nr.7783 prot., datë 27.02.2017

Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues është Kryetari Bashkisë Tiranë dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues është Drejtori i Përgjithshëm i Menaxhimit Financiar. Pra në këtë rast nuk ka delegime të këtyre detyrave.

- **Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.**

**Për vitin 2016** nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrate banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve në kartelat e llogarive të librit të madh.

Nga verifikimi i akt rakordimit vjetor të thesarit për treguesit e realizimit të buxhetit dhe krahasuar këto me veprimet kontabël në llogarinë e 520 “Disponibilitete në Thesar “dhe në ditarin e bankës rezultojnë të jenë rakorduara , veprime të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

<b>Llog.520"Disponibilitete ne Thesar"</b>			
	<b>Debi</b>	<b>Kredi</b>	
Gjendje Thesar 01.01.2016	<b>62.226.511</b>		
Çelje fonde	11.089.393.790	8.485.690.480	Pagesa USH
Kthim USH 2015	147.266	270.449.687	Pakësim fonde
Kthim USH 2016	12.430.191	2.319.413.339	Derdhje ne buxhet fonde papërdorur
Arkëtime pulla BT	51.721.856	51.810.258	Pagesa pulla GJ. Civile
	<b>11.215.919.614</b>	<b>11.127.363.764</b>	
<b>Gjendje Thesar 31.12.2016</b>	<b>88.555.850</b>	8,485,690,480-12,430,191+26,417,730 = <b>8,499,677,991</b>	
<b>Analiza e gjendjes llog.520 ne date 31.12.2016</b>		Gjendja 01.01.2016 (llog.520)	<b>62.226.511 nga:</b>
Pulla dhjetor 2016	4,294,400	Pagese pulla janar 2016	(4,382,791)
Ngurtësime 2016	26,417,730	Ngurtësime <b>2015</b>	57,843,720
Ngurtësime viti 2015	57,843,720		
<b>Totali</b>	<b>88.555.850</b>		

<b>Llogaria 520 ( përputhja me evidencën e thesarit)</b>			
<b>DEBI</b>		<b>KREDI</b>	
<b>Banka totali Debi(Çelje)</b>	<b>11.089.393.790</b>	<b>Banka totali Kredi</b>	<b>11.127.363.764</b>
Pakësim fonde	(270.449.687)	Kthim ne buxhet	(2.319.413.339)

		Pakësim fonde	(270.449.687)
		Pagesa pulla	(51.810.258)
		Kthim viti 2015	147.266
		Kthime 2015+2016	(12.577.485)
		Ngurtësime 2016	26.417.730
<b>Totali Debi</b>	<b>10.818.944.103</b>	<b>Totali Kredi</b>	<b>8.499.677.991</b>
<b>Sipas Akt-Rakordimit të Degës së Thesarit vjetor 2016</b>			
	<b>Plan përfundimtar Buxheti</b>	<b>Celje</b>	<b>Fakti</b>
Thesari evidenca 31.12.2016	14,080,888,696	10.818.944.102	<b>8.499.677.991</b>

Këto veprime janë përfshirë edhe me formatin nr.5 “Pasqyrë e lëvizjes në cash viti 2016” të paraqitur më poshtë:

Nr.	EMERTIMI	Disponibilitet në Thesar		Likuiditete në Banke	
		Debi	Kredi	Debi	Kredi
a	b	c	d	e	f
<b>1</b>	<b>I.TEPRICA NE CELJE TE USHTRIMIT</b>	<b>62,226,511.00</b>		<b>20,624,948.38</b>	
<b>2</b>	<b>II.ARKETIMET E VITIT "CASH"</b>	<b>10,897,083,687.80</b>	<b>0.00</b>	<b>2,939,978.54</b>	<b>0.00</b>
<b>3</b>	<b>1. Fonde nga buxheti</b>	<b>10,818,944,101.80</b>		<b>0.00</b>	
4	- Fonde buxhetore korente(Plani me ndryshimet)	5,985,350,645.80			
5	- Fonde buxhetore kapitale(Plani me ndryshimet)	4,833,593,456.00			
<b>6</b>	<b>2. Te ardhura e te hyra gjate vitit ne "Cash"</b>	<b>78,139,586.00</b>	<b>0.00</b>	<b>2,939,978.54</b>	<b>0.00</b>
7	- Te ardhura tatimore ne "Cash"				
8	- Kontribute te sigurimeve shoq. e shendets. ne "Cash"				
9	- Te ardhura jo tatimore ne "Cash"	26,417,730.00		0.00	
10	- Te ardhura nga interesat "Cash"				
11	- Sponsorizime, grante e te ardhura te tjera "Cash"				
12	- Kredi dhe huamarrje te ndryshme				
13	- Te hyra nga mjetet ne ruajtje "Cash"	51,721,856.00		2,939,978.54	
<b>14</b>	<b>III.PAGESAT E VITIT "CASH"</b>	<b>0.00</b>	<b>8,551,341,009.36</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
15	1, Pagesa nga buxheti për shpenzime korente		5,873,989,117.30		
16	2, Pagesa nga buxheti për shpenzime kapitale		2,625,541,634.06		
17	3, Pagesa nga te ardhurat për shpenzime korente				
18	4, Pagesa nga te ardhurat për shpenzime kapitale				
19	5, Pagesa nga mjetet ne ruajtje				
20	6, Pagesa te tjera		51,810,258.00		
<b>21</b>	<b>IV. TRANSFERTA</b>	<b>0.00</b>	<b>2,319,413,339.44</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
22	1, Derdhe te ardhurave buxhet		2,067,864,498.20		
23	2, Autorizime buxhetore te pa përdorura(korente e kapitale)		251,548,841.24		
24	3, Lëvizje te brendshme e transfertat te tjera				
<b>25</b>	<b>V. SHUMA E LEVIZJEVE ( I deri IV )</b>	<b>10,959,310,198.80</b>	<b>10,870,754,348.80</b>	<b>23,564,926.92</b>	<b>0.00</b>
<b>26</b>	<b>VI. TEPRICA NE MBYLLJE TE USHTRIMIT</b>	<b>88,555,850.00</b>		<b>23,564,926.92</b>	

➤ **Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.**

Për tu siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testimet në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.



➤ ***Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Aparatit Bashkisë***

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike me programin ALFA.
- Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj. si dhe janë mbajtur partitarët për llogaritë kreditore e debitorë. Përsa i përket sistemimeve janë evidentuar në kartelat kontabël të llogarive përkatëse dhe artikujve kontabël të prerë për veprime të ndryshme janë evidentuar në librin e veprimeve të ndryshme. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.
- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundur nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.
- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu : Dokumentet vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si Memot-kërkesë për financim për veprimet ekonomike të kryera nga drejtoritë përkatëse të miratuar sipas shkallës së hierarkisë, detyrave e përgjegjësisë, duke argumentuar shkakun e veprimit të shoqëruar me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, lis pagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.
- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

**Konkluzion:** Kontabilizimi i veprimeve ekonomike për kontrata të lidhura blerje mallrash apo investimesh nuk është bërë për vlerë të plotë të kontratës, por në momentin e mbërritjes së faturave për blerje malli e shërbimesh dhe investime të shoqëruar me situacion për punime të kryera. Efektet e veprimeve ekonomike dhe të ngjarjeve të tjera ekonomike të kryera nuk janë marrë në llogari në kohën e kryerjes së veprimit apo të ndodhjes së ngjarjes, por me mbërritjen e faturës dhe çeljen e fondeve dhe jo thjesht kur ndërhyr pagesa ose marrja e likuiditeteve. Pra regjistrimet kontabël nuk janë kryer në kohën e lindjes të një detyrimi për t'u paguar nga njësi ekonomike, detyrime këto që sjellin pagesa, dhe që kanë sjellë për ushtrimin e dhënë shpenzime.

Përsa trajtuar më sipër, këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël “Kapitulli I, pika 1.

**2# Gjetje nga auditimi:**

➤ ***Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.***

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiarë të Bashkisë për aktivitetin ekonomik - financiar 01.01.2016 deri më datën 31.12.2016.

*Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim*

**Përkatësia:** Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

**Plotësia:** Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar

**Saktësia:** Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e regjistruara dhe ngjarjet janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme.

**Periudha:** Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël

**Klasifikimi:** Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura.

**Ligjshmëria dhe rregullsia:** Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion  
*Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës*

**Ekzistenca:** Asetet, detyrimet dhe fondet e veta ekzistojnë

**Të drejtat dhe detyrimet:** Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet, detyrimet dhe janë obligimet e subjektit

**Plotësia:** Të gjitha asetet, detyrimet dhe fondet e veta që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar

**Vlerësimi dhe alokimi:** Aktivitet, pasivitet dhe fondet e veta janë të përfshira në pasqyrat financiare me shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, si dhe rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

*Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese*

**Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet:** Ngjarjet e shpalosura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.

**Plotësia:** Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.

**Klasifikimi dhe kuptueshmëria:** Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe të përshkruara dhe shënimet e kanë shprehur qartë.

**Saktësia dhe vlerësimi:** Informacioni financiar dhe të tjera është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasi të duhur.

Pasqyrat financiare janë përparë nga Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar. **Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatua se, janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2016 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2015.**

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2016 rezulton se, llogaritë e Aktivitet dhe të Pasivitet kundrojnë me formatet anekse pjese e PF, si dhe llogaritë sintetike kundrojnë me ato analitike;

Totali i Aktivitet për vitin 2016 është **51,206,894,961 lekë**, i paraqitur në formatin 1 dhe i zbrëthyer në llogari si më poshtë:

AKTIVI I BILANCIT KONTABEL 2016			<i>(ne leke)</i>	
Nr .	Nr.llog.	EMERTIMI I LLOGARIVE TE AKTIVIT	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi i Paraardhës
1	12	Rezultate te mbartura(saldo debitorë)		
2	A	AKTIVE TE QENDRUESHME	44,529,944,051	39,330,035,263
3	20, 230	I.Te pa trupëzuara	541,186,891	481,166,042
4	201	Prime te emisionit dhe rimbursimit te huave		
5	202	Studime dhe kërkime	213,191,884	213,191,884
6	203	Koncesione, patenta, licenca e tjera ngjashme	168,000	168,000
7	209	Amortizimi i aktiveve qëndrueshme te pa trupëzuara(-)	(13,732,382)	(13,732,382)
8	230	Shpenzime për rritjen e aktiv.qendr.patrupezuara	341,559,389	281,538,540
9	21,23,24,28	II.Akt.Qendr.te Trupezuara	35,575,819,160	30,451,420,221
10	210	Toka,troje,Terene	6,488,105,847	5,754,684,278
11	211	Pyje, Kullota Plantacione	67,511,391	67,511,391
12	212	Ndërtime e Konstruksione	3,008,347,642	3,008,347,642
13	213	Rruge,rrjete,vepra ujore	9,490,665,231	9,490,665,231
14	214	Instalime teknike,makineri,paisje,vegla pune	255,366,394	235,947,634
15	215	Mjete transporti	312,697,291	287,256,681
16	216	Rezerva shtetërore	0	0

17	217	Kafshe pune e prodhimi	0	0
18	218	Inventar ekonomik	384,420,123	343,728,071
19	219	Amortizimi aktiv,Qendr.te trupezuar(-)	(1,505,842,472)	(1,470,622,137)
20	231	Shpenzime proces per rritjen e AQT	15,340,537,596	10,999,873,312
21	232	Shpenzime proces per transferime kapitale	1,157,802,262	1,157,802,262
22	24	Aktive te Qend.te trupezuar te dëmtuara	576,207,855	576,225,855
23	28	Caktime		0
<b>24</b>	<b>25</b>	<b>III.Aktive Financiare</b>	<b>8,412,938,000</b>	<b>8,397,449,000</b>
25	25	Huadhënie e nën huadhënie	27,239,000	13,739,000
26	26	Pjesëmarrje ne kapitalin e vet	8,385,699,000	8,383,710,000
<b>27</b>	<b>B</b>	<b>AKTIVE QARKULLUESE</b>	<b>6,675,387,102</b>	<b>5,721,368,873</b>
<b>28</b>	<b>Klasa 3</b>	<b>I. Gjendja e Inventarit</b>	<b>163,687,040</b>	<b>111,535,126</b>
29	31	Materiale	68,430,733	17,721,819
30	32	Objekte inventari	95,256,307	93,813,307
31	33	Prodhime, punime e shërbime ne proces		
32	34	Produkte		
33	35	Mallra		
34	36	Gjë e gjalle ne rritje e majmëri		
35	37	Gjendje te pambritura ose prane te treteve		
36	38	Diferenca nga cmimet e magazinimit		
37	39	Shuma te parashikuara per zhvleresim te inventarit(-)		
<b>38</b>	<b>Klasa 4</b>	<b>II.Kerkesa arketimi mbi Debitoret</b>	<b>6,316,040,807</b>	<b>5,439,207,831</b>
39	409	Furnitore(Debitore),parapagime pagesa pjesore	58,702,072	58,702,072
40	411-418	Kliente e llogari te ngjashme		
41	423	Personeli, paradhenie, deficite e gjoba	1,311,034	1,514,190
42	431	Te drejta e taksa per t'u derdhur ne shtet		
43	432	Tatime mbledh nga shteti per llog.Pushtetit Lokal		
44	433	Shenz.fatkeqesi natyrore qe mbulon shteti		
45	4,342	Te tjera operacione me shtetin(debitor)	5,914,101,222	5,038,211,452
46	435	Sigurime Shoqerore		
47	436	Sigurime Shendetesore		
48	437	Organizma te tjere shoqerore		
49	44	Institucione te tjera publike		
50	45	Mardhenie me instit.brenda dhe jasht sistemit	6,538,746	6,538,746
51	465	Efekte per t'u arketuar nga shitja let.vlere vendosjes		
52	468	Debitore te ndryshem	335,387,733	334,241,371
53	49	Shuma te parashikuara per zhvleresim(-)		
<b>54</b>	<b>51</b>	<b>III.Llogarite financiare</b>	<b>195,659,255</b>	<b>169,062,108</b>
55	50	Letra me vlere te vendosjes		
56	511	Vlera per tu arketuar	81,204,163	81,204,163
57	512	Llogari ne banke	23,564,927	20,624,948
58	520	Disponibilitete ne thesar	88,555,850	62,226,511
59	531	Llogari ne arke		161,203
60	532	Vlera te tjera	1,544,400	1,319,400
61	54	Akreditiva dhe paradhenie		
62	56	Llogari ne organizma krediti	789,915	3,525,883
63	59	Provigjone zhvlersimi letra me vlere vendosjes(-)		
<b>64</b>	<b>C</b>	<b>LLOGARI TE TJERA AKTIVE</b>	<b>1,563,808</b>	<b>1,563,808</b>
65	477	Diferenca konvertimi aktive	1,563,808	1,563,808
66	481	Shpenz.per tu shpernd.ne disa ushtrime		
67	486	Shpenzime te periudhave te ardheshme		
68	<b>85</b>	<b>REZULTATI I USHTRIMIT(saldo debitore)</b>		
<b>69</b>	<b>X</b>	<b>TOTALI I AKTIVIT</b>	<b>51,206,894,961</b>	<b>45,051,404,136</b>

## **I. AKTIVE TË QËNDRUESHME TË PATRUPËZUARA**

Në formatin nr. 1 “Aktivet e Qëndrueshme të Patrupëzuara” në vlerën 554,919,273 lekë janë të pasqyruara sipas zërave “Studime dhe Kërkime”.

- Gjëndja e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime” paraqitet në vlerën 213,191,884 lekë, dhe nuk ka ndryshime si për vitin 2015 dhe për vitin 2016. Studim projektimet si për Bashkinë e Tiranës dhe

NJA janë pjesë e inventarëve fizike të kryera, të cilat rezultojnë të arkivuara në Drejtoritë përkatëse dhe në NJA.

Sipas të dhënave kontabël, kjo llogari është e analizuar si vijon:

Emërtimi	Vlera 31.12.2016
Bashkia Tirane	22,139,402
NJA Nr.2	80,000
NJA4	1,233,995
NJA5	596,880
NJA Nr.6	2,299,800
NA07	164,800
NA08	116,700
NA12 Petrele	22,290,900
NA14 Dajt	12,850,500
NA16 Berzhite	1,057,750
NA19 Shengjergj	1,797,400
NA20 Vaqarr	12,491,859
NA21 Kashar	136,071,898
<b>Totali</b>	<b>213,191,884</b>

- **Gjendja e llog. 203 “Koncesione, patenta, licenca e tjera ngjashme”** paraqitet në vlerën 168,000 lekë si në vitin 2015 dhe në vitin 2016. Kjo vlerë i përket programit Alpha në inventarin e NJA nr.5.

- **Gjendja e llogarisë 230 “Shpenzime per rritjen e AQ të patrupëzuara”** në vitin 2016 paraqitet në vlerën 341,559,389 lekë. Nga viti 2015 janë bërë shtesa në vlerën 60,020,849 lekë, të cilat konsistojnë kryesisht në studim projektive së bashku me oponencat e tyre në infrastrukturën rrugore dhe ujësjellësa e KUZ në vlerën 25,525,809 lekë, program informatik në vlerën 23,600,000 lekë me objekt kontrate “Sistem i qendëruar për menaxhimin e hoteleve dhe taksave të qëndrimit në Bashkinë e Tiranës”, si dhe shërbime konsulence me financim të huaj sipas kontratës me objekt : “Projekt i detajuar dhe hartimi i dokumenteve te tenderit per zgjerimin e bulevardit te Tiranës dhe Rehabilitimi i Lumit të Tiranës” në vlerën 10,895,040 lekë.

Emërtimi llogarisë	Gjendja me 31.12.2015	Shtesa 2016	Gjendja me 31.12.2016
Shpenz. - studime ose kerkime	243,727,485	25,525,809	269,253,294
Shpenz. - konces, patenta, licenca, marka, te drejta e tjera		23,600,000	23,600,000
Shpenz. - studime ose kerkime NJA	14,566,452		14,566,452
Shpenz. per rritjen e AA jo materiale per PIU	23,244,603	10,895,040	34,139,643
<b>Totali</b>	<b>281,538,540</b>	<b>60,020,849</b>	<b>341,559,389</b>

Me ardhjen e faturave për realizimin e projekteve për këto vlera janë bërë veprimet kontabël: në debi të llog. 230 “Shpenzime per rritjen e AQ të patrupëzuara” në kredi të llog. 404 “Furnitor për investime”.

## **II. AKTIVET TË QËNDRUESHME TË TRUPËZUARA**

### **Auditimi i aktiveve të qëndrueshme:**

**1. Objektivat e auditimit të aktiveve të qëndrueshme**, janë që të sigurohemi se:

Aktivet ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.

**2. Kontrollë të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:**

- Për auditimin e aktiveve të qëndrueshme, u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme si:

- U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve të qëndrueshme në raport me gjëndjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;

- U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhur ndonjë variacion anormal mbi aktivet e qëndrueshme;

- U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;

- U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranuar dhe udhëzimeve përkatëse.
- U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;
- U krahasuan investimet e realizuara gjate ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet.

### **3. Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e aktiveve të qëndrueshme:**

**a.** Gjatë hyrjes se aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se veprimet janë kryer në zbatim të kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Për Aktivet e blera janë kryer teste për 4 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabël nëse janë kontabilizuar sipas vlerës së tyre të marrjes. (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë);
- Për Aktivet e marra falas janë kryer teste për 3 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabël nëse janë kontabilizuar duke i vlerësuar ato me vlerën e shitjes;
- Aktivet e sjella në subjekt (kalim kapital) janë kryer teste për 2 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabël nga të tretët nëse kontabilizohen me vlerën e tyre të sjelljes.

**b.** Për inventarin, janë kryer teste për tu siguruar që subjekti:

- Procedon për regjistrimin dhe vlerësimin e aktiveve të saj të qëndrueshme sipas rregullave kontabël përgjithësisht të pranuar;
- Përdor referencat ose teknikat më të përshtatshme për natyrën e pasurisë (çmimi i tregut, tabelat e publikuara, treguesit specifike, etj.);
- Ka ruajtur të njëjtat rregulla vlerësimi nga një inventar në tjetrin.

**Në formatin nr. 1 (Aktiv i bilancit) “Aktivet e Qëndrueshme të Trupëzuara”** paraqiten në shumën totale prej 20,007,113,919 lekë. Për këto aktive janë kryer inventarë fizike nga komisionet e inventarizimit, kjo sipas fletëve të inventarizimit të paraqitura dhe të konfirmuara nga këto komisione si për NJA dhe Bashkinë Tiranë. Kjo llogari sintetike e analizuar paraqitet në llogaritë e mëposhtme:

- **Gjendja e llog. 210 “Toka, Troje, Terrene”** për vitin 2016 paraqitet në vlerën 6,488,105,847 lekë. Kjo vlerë përbëhet nga: gjendja në vitin 2015 në vlerën 5,754,684,278 lekë e cila përfshin 5,684,535,780 lekë troje Bashkia Tiranë, 70,148,498 lekë troje NJA si dhe shtesat për vitin 2016 në vlerën 733,421, 568 lekë truall përfituar nga shpronësimet me VKM. Për këto vlera për çdo VKM janë kryer veprimet kontabël debi llog. 231 “Shpenzime ne proces për toka, troje e terrene” në kredi të llog. 467 “Kreditorë të ndryshëm”. Për kapitalizmin e këtyre aktiveve janë kryer veprimet kontabël në debi të llog. 210 “Toka, Troje, Terrene” në kredi të llog. 231 “Shpenzime ne proces për toka, troje e terrene” dhe njëkohësisht pritet artikulli kontabël në debi të llog. 115 “Te ardhura te funksionit te caktuara per investime” në kredi të llog. 1011”Shtesa të fondeve bazë”.

- **Gjendja e llogarisë 211 “Pyje, kullota plantacione”** paraqitet vlerën kontabël 67,511,391 lekë dhe nuk ka ndryshime si për vitin 2015 dhe për vitin 2016. Kjo vlerë përfshin kostot e mbjelljes së pemëve dekorative dhe frutore në territorin e NJA-ve si dhe pemëve dekorative në Selitë në Liqenin e Farkës për të cilat ekzistonte ne inventarin fizik në numër drurësh.

Sipas përmbledhësës së inventarizimit fizik dhe kontabël kjo llogari është e analizuar sipas Njësive Administrative si më poshtë:

1. NJA nr.7 në vlerën 563,400 lekë,
2. NJA nr.10 në vlerën 4,394,721 lekë,
3. NJA Zall-Bastar në vlerën 388,000 lekë,
4. NJA Farkë në vlerën 60,738,470 lekë,
5. NJA Baldushk në vlerën 480,000 lekë,
3. NJA Zall-Herr në vlerën 946,800 lekë.

- **Gjendja e Llogarisë 212 “Ndërtime konstruksione”** në datë 31.12.2016 është në vlerën kontabël 3,008,347,642 lekë dhe nuk ka ndryshime si për vitin 2015 dhe për vitin 2016, për të cilat ka

inventar fizik si për Bashkinë Tiranë dhe për NJA e verifikuar me fletët e inventarit të konfirmuara nga komisioni.

Të dhënat e mësipërme kontabël të krahasuara dhe me inventarët paraqiten në mënyrë më të detajuar në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emërtimi NJA	Vlera e llog.212 me 31.12.2016	Nr.	Emërtimi NJA	Vlera e llog.212 me 31.12.2016
1	NJA01	4,921,853	13	NJA13 Farke	295,940,268
2	NJA02	41,198,324	14	NJA14 Dajt	175,189,947
3	NJA03	2,612,821	15	NJA15 Zall Bastar	83,045,880
4	NJA04	2,184,853	16	NJA16 Berzhite	82,158,081
5	NJA05	8,772,247	17	NJA17 Krrabe	20,597,822
6	NJA06	88,412,186	18	NJA18 Baldushk	211,429,486
7	NJA07	14,591,391	19	NJA19 Shengjergj	26,720,947
8	NJA08	19,029,733	20	NJA20 Vaqarr	61,910,654
9	NJA09	37,198,929	21	NJA21 Kashar	424,992,941
10	NJA10	14,113,107	22	NJA22 Peze	22,932,022
11	NJA11	24,378,147	23	NJA23 ndroq	112,496,690
12	NJA12 Petrele	164,242,551	24	NJA24 Z.herr	121,638,683
		<b>421,656,142</b>			<b>1,639,053,421</b>
					<b>421,656,142</b>
<b>Shuma e NJA per llog.212</b>					<b>2,060,709,563</b>
	Bashkia Tirane	947,638,079			947,638,079
<b>Totali I llog.212 me 31.12.2016 sipas bilancit</b>					<b>3,008,347,642</b>

- **Gjendja e Llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”** në datë 31.12.2016 është në vlerën kontabël 9,490,665,231 lekë dhe nuk ka ndryshime si për vitin 2015 dhe për vitin 2016, për të cilat ka inventar fizik si për Bashkinë Tiranë dhe për NJA e verifikuar me fletët e inventarit të konfirmuara nga komisioni.

Të dhënat e mësipërme kontabël të krahasuara dhe me inventarët paraqiten në mënyrë më të detajuar në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emërtimi NJA	Vlera e llog.213 me 31.12.2016	Nr.	Emërtimi NJA	Vlera e llog.213 me 31.12.2016
1	NJA01	-	13	NJA13 Farke	1,807,759,053
2	NJA02	33,440,196	14	NJA14 Dajt	946,423,764
3	NJA03	700,000	15	NJA15 Zall Bastar	95,846,183
4	NJA04	45,000	16	NJA16 Berzhite	315,132,312
5	NJA05	-	17	NJA17 Krrabe	60,895,203
6	NJA06	321,815,989	18	NJA18 Baldushk	235,601,733
7	NJA07	8,237,724	19	NJA19 Shengjergj	104,493,169
8	NJA08	10,604,540	20	NJA20 Vaqarr	382,830,763
9	NJA09	1,294,356	21	NJA21 Kashar	3,608,603,373
10	NJA10	1,491,135	22	NJA22 Peze	55,310,743
11	NJA11	238,525,792	23	NJA23 ndroq	163,784,626
12	NJA12 Petrele	620,902,891	24	NJA24 Z.herr	211,177,621
		<b>1,237,057,623</b>			<b>7,987,858,543</b>
					<b>1,237,057,623</b>
<b>Shuma e NJA per llog.213</b>					<b>9,224,916,166</b>
	Bashkia Tirane	265,749,065			265,749,065
<b>Totali I llog.213 me 31.12.2016 sipas bilancit</b>					<b>9,490,665,231</b>

- **Gjendja e llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”** në datën 31.12.2016 është në vlerën kontabël 255,366,394 lekë, ndërsa në datë 31.12.2015 është në vlerën 235,947,634 lekë. Diferenca prej 19,418,760 lekë konsiston në ndryshimet e kryera në gjendjen e kësaj llogarie për Bashkinë e Tiranës, ku janë bërë shtesa në vlerën 19,805,160 lekë nga të cilat 192,000 lekë janë blerje me pagesë për radio makinash dhe në vlerën 19,613,160 lekë dhurime. Mallrat pa pagesë janë: “Dekodera” nga Shërbimi Social Shtetëror për invalidët dhe të paafët në vlerën 19,273,320 lekë dhe sirena makinash për policinë bashkiake në vlerën 339,840 lekë.

Ndërsa paksimet në vlerën 386,400 lekë janë vlera të arkëtuara nga Policia Bashkiake për zhdëmtim e bllokuesve të makinave.

Të dhënat e mësipërme kontabël të krahasuara dhe me inventarët paraqiten në mënyrë më të detajuar në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emërtimi NJA	Vlera e llog.214 me 31.12.2016	Nr.	Emërtimi NJA	Vlera e llog.214 me 31.12.2016
1	NJA01	311,853	13	NJA13 Farke	17,410,677
2	NJA02	6,907,449	14	NJA14 Dajt	15,205,371
3	NJA03	3,251,049	15	NJA15 Zall Bastar	2,037,951
4	NJA04	411,985	16	NJA16 Berzhite	2,095,025
5	NJA05	4,539,151	17	NJA17 Krrabe	893,026
6	NJA06	6,665,836	18	NJA18 Baldushk	1,628,788
7	NJA07	5,392,810	19	NJA19 Shengjergj	3,222,722
8	NJA08	5,158,180	20	NJA20 Vaqarr	4,277,356
9	NJA09	9,344,663	21	NJA21 Kashar	43,962,403
10	NJA10	1,649,760	22	NJA22 Peze	7,893,387
11	NJA11	3,657,832	23	NJA23 ndroq	9,191,997
12	NJA12 Petrele	4,650,386	24	NJA24 Z.herr	7,356,151
		<b>51,940,954</b>			<b>115,174,854</b>
					<b>51,940,954</b>
<b>Shuma e NJA per llog.214</b>					<b>167,115,808</b>
	Bashkia Tirane				
	<b>Gjendja 31.12.2015</b>	<b>Shtesa</b>		<b>Paksime</b>	<b>Gjendja 31.12.2016</b>
	68,831,826	19,805,160		386,400	88,250,586
<b>Totali I llog.214 me 31.12.2016 sipas bilancit</b>					<b>255,366,394</b>

- **Gjendja e llogarisë 215** “Mjete Transporti” në datën 31.12.2016 është në vlerën kontabël 312,697,291 lekë, ndërsa në datën 31.12.2015 në vlerën 287,256,681 lekë. Në këtë llogari janë bërë shtesa për 18 automjete për Bashkinë Tiranë në vlerën 25,440,610 lekë dhurime nga subjekte private.

Të dhënat e mësipërme kontabël të krahasuara dhe me inventarët paraqiten në mënyrë më të detajuar në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emërtimi NJA	Vlera e llog.215 me 31.12.2016	Nr.	Emërtimi NJA	Vlera e llog.215 me 31.12.2016
1	NJA01	3,019,800	13	NJA13 Farke	19,592,600
2	NJA02	3,408,000	14	NJA14 Dajt	44,309,970
3	NJA03	665,000	15	NJA15 Zall Bastar	8,767,500
4	NJA04	2,535,000	16	NJA16 Berzhite	7,459,300
5	NJA05	1,992,000	17	NJA17 Krrabe	2,200,000
6	NJA06	1,794,000	18	NJA18 Baldushk	12,264,860
7	NJA07	-	19	NJA19 Shengjergj	420,000
8	NJA08	1,080,000	20	NJA20 Vaqarr	2,675,500
9	NJA09	690,000	21	NJA21 Kashar	27,615,918
10	NJA10	4,800,000	22	NJA22 Peze	6,495,000
11	NJA11	1,384,500	23	NJA23 ndroq	1,628,000
12	NJA12 Petrele	8,830,000	24	NJA24 Z.herr	4,066,000
		<b>30,198,300</b>			<b>137,494,648</b>
					<b>30,198,300</b>
<b>Shuma e NJA per llog.215</b>					<b>167,692,948</b>
	Bashkia Tirane				
	<b>Gjendja 31.12.2015</b>	<b>Shtesa</b>		<b>Paksime</b>	<b>Gjendja 31.12.2016</b>
	119,563,733	25,440,610			145,004,343
<b>Totali I llog.215 me 31.12.2016 sipas bilancit</b>					<b>312,697,291</b>

- **Gjendja e llogarisë 218** “Inventar Ekonomik” në datën 31.12.2016 është në vlerën kontabël 384,420,123 lekë, ndërsa në datën 31.12.2015 në vlerën 343,728,071 lekë. Në këtë llogari janë bërë shtesa me pagesë në vlerën 135,387,550 lekë dhe me donacione në vlerën 4,157,502 lekë. Paksimet janë në vlerën 98,853,000 lekë, aktive transferuar pa pagesë me kalim kapital nga Bashkia Tiranë në ndërmarrjet e varësisë që janë njësi shpenzuese me llogari më vehte.

Të dhënat e mësipërme kontabël të krahasuara dhe me inventarët paraqiten në mënyrë më të detajuar në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emërtimi NJA	Vlera e llog.218 me 31.12.2016	Nr.	Emërtimi NJA	Vlera e llog.218 me 31.12.2016
1	NJA01	5,282,885	13	NJA13 Farke	19,439,945
2	NJA02	6,113,637	14	NJA14 Dajt	16,876,982
3	NJA03	3,718,714	15	NJA15 Zall Bastar	3,952,469
4	NJA04	9,342,425	16	NJA16 Berzhite	10,704,444
5	NJA05	6,737,543	17	NJA17 Krrabe	3,870,566
6	NJA06	4,617,739	18	NJA18 Baldushk	4,307,428
7	NJA07	8,444,925	19	NJA19 Shengjergj	3,909,369
8	NJA08	5,977,191	20	NJA20 Vaqarr	6,823,031
9	NJA09	572,846	21	NJA21 Kashar	60,565,749
10	NJA10	12,855,424	22	NJA22 Peze	-
11	NJA11	4,914,328	23	NJA23 ndroq	-
12	NJA12 Petrele	1,243,455	24	NJA24 Z.herr	8,733,430
		<b>69,821,112</b>			<b>139,183,413</b>
					<b>69,821,112</b>
<b>Shuma e NJA per llog.218</b>					<b>209,004,525</b>
	Bashkia Tirane				
	<b>Gjendja 31.12.2015</b>	<b>Shtesa</b>		<b>Paksime</b>	<b>Gjendja 31.12.2016</b>
	134,723,546	139,545,052		98,853,000	175,415,598
<b>Totali I llog.215 me 31.12.2016 sipas bilancit</b>					<b>384,420,123</b>

**Konkluzion:** Gjendja kontabël e aktiveve të patrupëzuara në vlerën 213,359,884 lekë dhe gjendjen e aktiveve të trupëzuara në vlerën prej 20,007,113,919 lekë është paraqitur drejt për vitin 2016, pasi janë pasqyruar të gjitha shtesat dhe pakësimet për çdo aktiv si dhe është kryer procesi i inventarizimit i cili rakordon me gjendjen kontabël për çdo aktiv, gjë që “certifikon” vlerat e aktiveve, duke ofruar siguri të arsyeshme rreth vlerës fizike dhe kontabël të tyre, të njohura dhe regjistruara në pasqyrat financiare të njësisë.

Për aktivet e krijuara pas viteve 2011 në kartelat kontabël për çdo aktiv ekzistojnë të gjitha të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur. Ndërsa për aktivet e krijuara para viteve 2011 si për shtesat dhe pakësimet të rezultuara nga veprimet ekonomike të kryera për aktivet ekzistuese para viteve 2011 mungojnë të dhënat kontabël, për vlerat fillestare të hyrjes dhe për shtesat apo pakësimet që kanë ndikuar në arritjen e vlerës së aktivitetit të paraqitur në vitin 2011 duke e kthyer këtë vit si vitin fillestar.

Në vitin 2016 është kërkuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë regjistri aktiveve gjendje deri në fund të vitit 2015, për regjistrimin në sistemin informatik financiar të qeverisë (SIFQ). Ky database është plotësuar sipas formatit të kërkuar nga MF me të dhënat aktiv për aktiv vetëm për Aparatin e Bashkisë Tiranë, ndërsa për NJA ky informacion është plotësuar në vitin 2017. Ky proces informatizimi nuk u bë i mundur, pasi në të dhënat e aktiveve duhet të përfshiheshin dhe të dhënat aktiveve të NJA.

#### **Inventarizimi i aktiveve për vitin 2016 Bashkia Tiranë**

Në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore për kryerjen e procedurave të inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe qarkulluese rezultoi se:

Në bazë të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Bashkia Tiranë ka kryer procesin e inventarizimit të aktiveve për vitin 2016. Në fund të vitit 2016 është kryer procesi i inventarizimit për Bashkinë Tiranë dhe 24 Njësitë Administrative.

Strukturat e nëpunësit zbatues pasi kanë përpiluar listën e aktiveve për inventarizim për Bashkinë Tiranë dhe 24 Njësitë Administrative i janë drejtuar Kryetarit të Bashkisë Tiranë me memon nr. 39886, datë 27.12.2016 për ngritjen e komisioneve të inventarizimit të aktiveve me qëllim vërtetimin e saktësisë së gjendjes fizike të objekteve të inventarëve në raport me të dhënat e sistemit



kontabël si dhe të sigurojë që aktivet në përdorim janë ngarkuar tek personat përgjegjës konform procedurave ligjore.

Me urdhrin nr. 39886/1, datë 27.12.2016 është ngritur komisioni inventarizimit dhe vlerësimit për pajisjet e inventarit ekonomik dhe pajisjeve teknike, mjeteve të transportit, trojeve ndërtesave në pronësi të aparatit të Bashkisë Tiranë i përbërë nga 5 anëtarë, si dhe Urdhri nr. 39886/2, datë 27.12.2016 “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit për pajisjet e inventarit ekonomik dhe pajisjeve teknike, mjeteve të transportit, trojeve ndërtesave në përdorim dhe përgjegjësi materiale të punonjësve të Njësive Administrative” për 24 Njësitë Administrative i përbërë nga 5 anëtarë për çdo njësi.

Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur për kryerjen e inventarizimit rezultoi se komisionet e inventarizimit kanë hartuar fletët e inventarëve me gjendjen fizike të aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara e të trupëzuara dhe gjendjen kontabël sipas llogarive si për Bashkinë Tiranë dhe për Njësitë Administrative. Në kolonën shënime është vendosur gjendja për jashtë përdorimit për ato aktive që do të vlerësohen. Fletët e inventarëve janë të konfirmuara nga këto komisione dhe përgjegjësit material brenda muajit janar 2017.

Gjithashtu është kryer inventarizimi në dy magazinat e institucionit. Nga komisioni i inventarizimit për të dy magazinat para fillimit të inventarit është fiksuar numri rendor i fletë hyrjes dhe fletë daljes nëpërmjet një proces verbali të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit. Nga komisioni është hartuar lista e artikujve gjendje në magazina, e cila rezultoi të jetë e barabartë me gjendjen në kontabilitet. Nga auditimi i dokumentacionit për të dy magazinat rezultoi se janë kryer veprimet për inventarin fizik të gjithë artikujve dhe janë krahasuar me gjendjen kontabël dhe nuk kanë rezultuar diferenca. Fletët e inventarizimit janë firmosur nga komisioni i inventarizimit dhe përgjegjësit material, si dhe është hartuar relacioni i rezultatit të inventarit për secilën magazinë më datën 31.12.2016.

Nga procesi inventarizimit komisionet kanë identifikuar aktivet të cilat duhet të vlerësohen dhe që aktualisht nuk janë në gjendje pune dhe nuk përdoren nga përgjegjësit material. Komisionet e vlerësimeve të ngritur me këto urdhra në bazë të gjendjes faktike të aktiveve të rezultuar nga inventarizimi, normave të amortizimit, afatit të skadencës, vitit të vënies në punë, vlerës së shtuar ndër vite, mundësitë për riaftësimin e aktiveve në raport me kosto/përfitim, informacionit zyrtar të marrë mbi dobishmërinë e aktiveve nga punonjësit dhe drejtuesit e njësisë, kanë hartuar listat për Bashkinë Tiranë dhe NJA të atyre aktiveve që do të vlerësohen. Listat janë të nënshkruara nga komisionet e vlerësimeve dhe përgjegjësit material. Për çdo aktiv të vlerësuar është bërë verifikimi fizik si dhe është bërë procesi verbal vlerësimit në të cilën janë vendosur: emërtimi i aktivitetit, llogaria kontabël të cilës i përket, vlera fillestare e aktivitetit, viti vënies në punë, amortizimi akumuluar, vlera e mbetur. Vlerësimi i aktiveve është bërë në bazë të pikës 103/a,b,c,d “Kriteret e vlerësimit”. Vlera e aktiveve të vlerësuara është 232,748,795 lekë, aktive që i përkasin Aparatit të Bashkisë Tiranë dhe Njësive Administrative.

Me memot nr. 12495/1, datë 27.07.2017 të komisionit të vlerësimit të aktiveve të Bashkisë Tiranë, memot nr. 33911, nr. 33911/1 deri në memon nr. 33911/22, datë 20.09.2017 të komisioneve të vlerësimit të 22 Njësive Administrative, komisionet në përfundim të vlerësimit aktiv për aktiv kanë miratuar te nëpunësi autorizues Kryetari Bashkisë Tiranë Relacionet për përfundimin e procesit të vlerësimit të aktiveve të cilat përmbajnë procedurën e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës për nxjerrjen e tyre përfundimisht jashtë përdorimit.

Sipas relacionit të inventarizimit të datës 31.12.2016 gjendja fizike për aktivet e Bashkisë Tiranë dhe NJA paraqitet me tabelën më poshtë:

Llog.Kontabel	Inventari Fizik i Aktiveve	Bashkia Tirane	NJA	Gjendja fizike me 31.12.2016
203	Aktive ne përdorim personal (program Alpha)		168,000	168,000
214	Aktive ne përdorim personal	88,250,586	167,115,808	255,366,394
218	Aktive ne përdorim personal	175,415,597	209,004,525	384,420,122

215	Aktive ne përdorim	145,004,343	167,692,948	312,697,291
312	Aktive gjendje ne magazine	56,861,731	11,569,002	68,430,733
327	Aktive ne përdorim personal	1,461,000	93,795,307	95,256,307
202	Aktive Studim Projektme	22,139,402	191,052,482	213,191,884
210	Troje, Trene	6,417,957,349	70,148,498	6,488,105,847
211	Bime dekorative		67,511,391	67,511,391
212	Ndërtesa	947,638,079	2,060,709,563	3,008,347,642
213	Rruge kanalizime	265,749,065	9,224,916,166	9,490,665,231
242	Aktive te dëmtuara	525,960,955	50,246,900	576,207,855
	<b>Shuma</b>	<b>8,646,438,107</b>	<b>12,313,930,590</b>	<b>20,960,368,697</b>

Referuar të dhënave kontabël më datë 31.12.2017 gjendja e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara si ndërtesa, drurë dekorativ, troje, studim projektme, dhe rrugë kanalizime, rezulton si më poshtë vijon:

Llog.Kontabel	Inventari Kontabël i Aktiveve	Bashkia Tirane	NJA	Gjendja fizike me 31.12.2016
202	Studime dhe kerkime	22,139,402	191,052,482	213,191,884
203	Koncesione, patenta, licenca e tjera ngjashme		168,000	168,000
210	Toka,troje,Terene	6,417,957,349	70,148,498	6,488,105,847
211	Pyje, Kullota Plantacione		67,511,391	67,511,391
212	Ndërtime e Konstruksione	947,638,079	2,060,709,563	3,008,347,642
213	Rruge,rrjete,vepra ujore	265,749,065	9,224,916,166	9,490,665,231
214	Instalime teknike,makineri,paisje,vegla pune	88,250,586	167,115,808	255,366,394
215	Mjete transporti	145,004,343	167,692,948	312,697,291
218	Inventar ekonomik	175,415,597	209,004,525	384,420,122
312	Materiale	56,861,731	11,569,002	68,430,733
327	Objekte inventari	1,461,000	93,795,307	95,256,307
242	Aktive te Qend.te trupezuara te dëmtuara	525,960,955	50,246,900	576,207,855
	<b>Shuma</b>	<b>8,646,438,107</b>	<b>12,313,930,590</b>	<b>20,960,368,697</b>

**Vlerësimet e aktiveve ne Bashkinë Tiranë dhe NJA në gjendje jashtë përdorimi, për të cilat procedurat për nxjerrje jashtë përdorimi dhe tjetërsimin e tyre janë kryer gjatë vitit 2017.**

**Vlerësim i aktiveve jashtë përdorimi nga inventarizimi i vitit 2015.**

Me memon nr. 27965, datë 16.09.2016 Drejtoria e Financës si strukturë e Nëpunësit Zbatues në bazë të gjendjes faktike të aktiveve të rezultuar nga inventarizimi i vitit 2015 ka propozuar Kryetarit të Bashkisë Tiranë ngritjen e komisionit të vlerësimit të një pjese të tyre të propozuara nga komisioni inventarizimit dhe të identifikuar në shënimet e fletëve të inventarizimit se cilat aktive do të vlerësohen. Me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë Nr. 27965/1 datë 24.10.2016 është miratuar “Ngritja e komisionit të vlerësimit për pajisjet e inventarit ekonomik dhe pajisjeve teknike, në pronësi të Aparatit të Bashkisë Tiranë, të propozuara për të dalë jashtë përdorimit” komision ky i përbërë nga 5 anëtarë, për aktivet e identifikuar dhe të propozuara nga komisioni i inventarizimit të vitit 2015.

Komisioni i vlerësimit i ngritur me këtë urdhrë në bazë të gjendjes faktike të aktiveve të rezultuar nga inventarizimi, normave të amortizimit, afatit të skadencës, vitit të vënies në punë, vlerës së shtuar ndër vite, mundësitë për riaftësimin e aktiveve në raport me kosto/ përfitimin për një veprim të tillë, informacionit zyrtar të marrë mbi dobishmërinë e aktiveve nga punonjësit dhe drejtuesit e njësisë, ka hartuar listën e atyre aktiveve që do të vlerësohen. Lista është e nënshkruar nga komisioni i vlerësimit dhe përgjegjësit material. Për çdo aktiv të vlerësuar është bërë verifikimi fizik si dhe është bërë procesi verbal i vlerësimit në të cilën janë vendosur: emërtimi i aktivit, llogaria kontabël të cilës i përket, vlera fillestare e aktivit, viti i vënies në punë, amortizimi akumuluar, vlera e mbetur. Vlerësimi i aktiveve është bërë në bazë të pikës 103/a,b,c,d “Kriteret e vlerësimit”. Vlera e aktiveve të vlerësuara është 39,356,930 lekë, aktive që i përkasin Aparatit të Bashkisë Tiranë.

Me memon nr. 12651, datë 03.04.2017 komisioni në përfundim të vlerësimit aktiv për aktiv ka miratuar te nëpunësi autorizues Kryetari Bashkisë Tiranë Relacionin për përfundimin i cili përmban procedurën e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës për nxjerrjen e tyre përfundimisht jashtë

përdorimit. Aktivet e vlerësuara nga komisioni i vlerësimit jashtë përdorimi, të identifikuar dhe te propozuara nga komisioni i inventarizimit të vitit 2015 janë ne vlerën 39,356,930 lekë. Këto aktive i përkasin vetëm Bashkisë Tiranë pa përfshirë NJA, të cilat në mënyrë të detajuar sipas llojit sipas memos përkatëse të vlerësimit paraqiten në tabelën e mëposhtme:

EMERTIMI	Shkresa e vlerësimit		Llog. Kontabël te prekura nga JP		Totali
	Nr.	Date	214	218	
Bashkia Tirane	12651	4/3/2017	8,292,608	31,064,314	
<b>Totali</b>			<b>8,292,608</b>	<b>31,064,314</b>	<b>39,356,922</b>

### ***Vlerësim i aktiveve jashtë përdorimi nga inventarizimi i vitit 2016.***

Vlerësimi i aktiveve për përcaktimin e atyre që janë jashtë përdorimi është bërë nga komisionet prej 5 anëtarë të krijuara veç për Bashkinë e Tiranës dhe veç për NJA me Urdhrat e Kryetarit nr. 39886/1 dhe nr. 39886/2 të datës 27.12.2016 për ngritjen e komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve.

Aktivitet e vlerësuara nga komisioni i vlerësimit jashtë përdorimi, të identifikuar dhe te propozuara nga komisioni i inventarizimit të vitit 2016 janë ne vlerën 232,748,795 lekë. Këto aktive në mënyrë të detajuar sipas llojit, sipas njësive dhe sipas memove përkatëse të vlerësimit paraqiten ne tabelën e mëposhtme:

NJESIA	MEMO e vlerësimit përfundimtar për aktivet e propozua për JP në inventarin e vitit 2016		Llogari ekonomike								Totali
	Nr.	Date	202	211	24	212	214	218	327	312	
Bashkia Tirane	12495/1	27/07/2017				60,486,697	6,289,438	19,473,393			<b>86,249,528</b>
Proj.Inv.Huaj(PIU)	12495/1	27/07/2017					287,886	91,000			<b>378,886</b>
PMNZSH	12495/1	27/07/2017						17,500		122,936	<b>140,436</b>
NJA 1	33911	20/09/2017						899,815	175,673		<b>1,075,488</b>
NJA 2	33911/1	20/09/2017			19,758,161		63,620	516,625	71,400		<b>20,409,806</b>
NJA 3	33911/2	20/09/2017					1,381,449	1,901,254	127,295		<b>3,409,998</b>
NJA 4	33911/3	20/09/2017			29,117,432			2,688,710	463,053		<b>32,269,195</b>
NJA 5	33911/4	20/09/2017					2,139,200	1,098,802	180,240		<b>3,418,242</b>
NJA 6	33911/5	20/09/2017					583,782	328,354	484,820		<b>1,396,956</b>
NJA 7	33911/6	20/09/2017	164,800				3,546,481	1,607,284	255,558		<b>5,574,123</b>
NJA 8	33911/7	20/09/2017					1,150,476	816,335	5,450		<b>1,972,261</b>
NJA 9	33911/8	20/09/2017				17,963,600	2,839,808	51,768	175,170		<b>21,030,346</b>
NJA 10	33911/9	20/09/2017			2,074,400		841,900	1,509,251	158,260		<b>4,583,811</b>
NJA 11	33911/10	20/09/2017					244,355	341,503	42,500		<b>628,358</b>
NJA 12 (Petrele)	33911/11	20/09/2017					1,263,048		1,424,437		<b>2,687,485</b>
NJA 13 (Farke)	33911/12	20/09/2017						5,701,103			<b>5,701,103</b>
NJA 14 (Dajt)	33911/13	20/09/2017					8,145,578	848,266	407,814		<b>9,401,658</b>
NJA 15 (Z-Bastar)	33911/14	20/09/2017					1,990,000	2,397,571	4,427,836		<b>8,815,407</b>
NJA 16 (Berzhite)	33911/15	20/09/2017					778,929	976,767			<b>1,755,696</b>
NJA 17 (Krabe)	33911/16	20/09/2017					404,646	1,930,659	1,846,090		<b>4,181,395</b>
NJA 19 (Shengjër)	33911/18	20/09/2017					2,916,246	187,168	228,756		<b>3,332,170</b>
NJA 20 (Vaqarr)	33911/19	20/09/2017					253,713	665,887	1,344,365		<b>2,263,965</b>
NJA 21 (Kashar)	33911/20	20/09/2017					360,000	2,330,300	1,465,795	812,830	<b>4,968,925</b>
NJA 22 (Peze)	33911/21	20/09/2017					1,843,078		762,557		<b>2,605,635</b>
NJA 22 (Z-Herr)	33911/22	20/09/2017		378,500		849,442	1,284,325		1,985,655		<b>4,497,922</b>
<b>Totali</b>			<b>164,800</b>	<b>378,500</b>	<b>50,949,993</b>	<b>79,299,739</b>	<b>38,607,958</b>	<b>46,379,315</b>	<b>16,032,724</b>	<b>935,766</b>	<b>232,748,795</b>

- ***Gjëndja e llogarisë 219 “Amortizimi i AQ të Trupëzuara dhe të Patrupëzuara”*** paraqitet në bilanc në vlerën 1,519,574,854 lekë e cila kuadron me pasqyrën e amortizimit të bilancit në formatin nr. 7, kolona 9.

“Amortizimi i AQ të Trupëzuara dhe të Patrupëzuara” është llogaritur sipas normave ligjore të miratuara në përputhje me UMF nr.14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore 2007, kreu II pika 1, paragrafi “Amortizimi vjetor”. Përlllogaritja është bërë për çdo aktiv si dhe për çdo artikull mbi vlerën e mbetur. U bënë sondazhe në llogari të ndryshme për aktive të veçanta në tabelat e detajuara të aktiveve dhe llogaritjes së amortizimit sipas normave ligjore të amortizimit të përcaktuara, nga ku rezultoi se përlllogaritjet ishin bërë të sakta. ishin zbatuar drejt . Vlerat e akumuluar të amortizimit sipas llogarive dhe veprimeve në kontabilitet paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Llog. Kontabël	Total Aktive 31.12.2015	Total amortizim 31.12.2015	Vlere e mbetur 31.12.2015	Total Aktive 31.12.2016	Total amortizim 2016	Vlere e mbetur 31.12.2016
	Bashki+NJA	Bashki+NJA	Bashki+NJA	Bashki+NJA	Bashki+NJA	Bashki+NJA
202 "Studim-Projekti"	213,191,884	13,624,581	199,567,303	213,191,884	13,624,581	199,567,303
203 "Program inform"	168,000	107,800	60,200	168,000	107,800	60,200
211"Pyje,kullot,plantac"	67,511,391	1,443,241	66,068,150	67,511,391	1,443,241	66,068,150
212"Ndertime e konst"	3,008,347,642	310,033,128	2,698,314,514	3,008,347,642	313,648,975	2,694,698,667
213 "Rruge,kanaliz"	9,490,665,231	700,612,703	8,790,052,528	9,490,665,231	700,612,703	8,790,052,528
214 "Paisje e vegla pun"	235,947,634	102,926,161	133,021,473	255,366,394	106,828,648	148,537,746
215 "Mjete transporti"	287,256,681	215,423,895	71,832,786	312,697,291	239,890,641	72,806,650
218 "Inventar Ekonom"	343,728,071	140,183,010	203,545,061	384,420,122	143,418,265	241,001,857
<b>Total</b>	<b>13,646,816,534</b>	<b>1,484,354,519</b>	<b>12,162,462,015</b>	<b>13,732,367,955</b>	<b>1,519,574,854</b>	<b>12,212,793,101</b>

**Konkluzion:** Nisur nga tabela e mësipërme si dhe analiza e kartelës kontabël për llog. 219 "Amortizimi i AQ të Trupëzuara dhe të Patrupëzuara" rezulton se për mbylljen e bilancit më 31.12.2016 nuk janë përfshirë dhe nuk janë kontabilizuar përlllogaritjet e amortizimit të aktiveve të NJA-ve, pavarësisht se ishin përlllogaritur nga vetë NJA-të por për efekt kontrolli saktësie të shifrave janë rillogaritur në janar të vitit 2017 dhe janë përfshirë në kontabilitet në mbylljen e bilancit të këtij viti. Këtë e tregon krahasimi i totalit të amortizimit të akumuluar i vitit 2016 në vlerën 1,519,574,854 lekë me totalin e amortizimit të akumuluar të vitit 2015 në vlerën 1,484,354,519 lekë, ku diferenca prej 35,220,335 lekë është vetëm amortizim i vitit ushtrimor 2016 për Bashkinë e Tiranës.

Për vlerën 35,220,335 lekë është debituar Llog. 1013 "Konsumi i aktiveve te qëndrueshme" në debi të llogarive:llog.2192 "Amortizim Ndërtesa" për vlerën 3,615,847 leke, llog. 2194 "Amortizim Makineri e pajisje, instrumente e vegla" në vlerën 3,902,487 lekë, llog. 2195 "Amortizim Mjete transporti" në vlerën 24,466,746 lekë dhe llog. 2198 "Amortizim Inventar ekonomik" në vlerën 3,235,255 lekë.

Në fund të vitit ushtrimor për vlerën 35,220,335 lekë është kryer veprimi kontabël mbyllës: në debi të llog. 1012 "Paksime te fondeve baze "dhe në kredi 1013 "Konsumi i aktiveve te qëndrueshme".

- **Gjendja e llog. 231 "Shpenzime në proces për rritjen e AQT"** në mbyllje të bilancit të vitit 2016 paraqitet në vlerën 15,340,537,596 lekë. Kjo gjendje e analizuar paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Llog. Kontab. Analitike	Emërtimi llogarive	Gjendja 31.12.2015	Shtesa viti ushtrimor 2016	Likuidime nga Bashkia Min. Financave + MZHU (paksime)	Kalime tek llog. e aktiveve sipas destinacionit (paksime)	Gjendja 31.12.2016
23101	Shp. rrit e AAM - troje nga shpron VKM	2,438,693,332	840,286,748	1,119,671,629		2,159,308,450
231201	Shp. rrit e AAM - ndërtesa administrative	31,032,419	7,905			31,040,324
231001	Shp. rrit e aktiveve te qendrueshme PIU	2,985,801,929	2,351,318,418			5,337,120,347
231203	Shp. rrit itjen e AAM - ndërtesa shkollore	705,252,388	483,589,731			1,188,842,119
2312032	Shp. rrit e AAM - ndërtesa kopshte	260,270,792	36,871,508			297,142,300
2312033	Shp. rrit e AAM - ndërtesa çerdhet	124,114,144	7,446,984			131,561,128
2312034	Shp. rrit e AAM - ndërtes çerdhe -kopshte	129,503,052				129,503,052
231204	Shp. rrit e AAM - ndërtesa social-kulturo	25,309,837				25,309,837
231214	Shpenz. per rritjen e AAM - varrezat	93,026,979	67,691,565			160,718,544
23131	Shp. rrit e AAM – konstruks.e rrugëve	3,926,222,713	1,673,123,055			5,599,345,768
2313602	Shp. rrit e AAM - Njesi Administrative	280,645,727				280,645,727
231427	Shp. rrit e AAM - paisje per policine		192,000		192,000	0
23181	Shp. rrit e AAM - orendi zyre		28,727,280		28,727,280	0
23184	Shp. rrit e AAM - fotokopje		84,360		84,360	0
23186	Shp. rrit e AAM - paisje kompjuterike		25,120,897		25,120,897	0
23187	Shp. rrit e AAM - te tjera paisje zyre		81,455,012		81,455,012	0
		<b>10,999,873,311</b>	<b>5,595,915,463</b>	<b>1,119,671,629</b>	<b>135,579,549</b>	<b>15,340,537,596</b>

Kjo llogari ka pësuar rritje për investime në proces për vitin 2016 për vlerën 5,595,915,463 lekë e cila përbëhet nga 840,286,748 lekë që i përkasin VKM –ve për shpronësime për troje dhe vlera prej 4,755,628,715 lekë me mbërritjen e faturave për punime të kryera për investime dhe furnizime aktive (inventar ekonomik).

Për vlerën 4,755,628,715 lekë është debituar llog. 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” sipas analizës së llogarive të tabelës së mësipërme në kredi të llog. 404 “Furnitor e llogari lidhur me to për investime”.

Për vlerën 840,286,748 lekë është debituar llog. 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT troje nga shpronësimet me VKM ” në kredi të llog. 467 “Kreditorë të ndryshëm për shpronësimet”.

Për paksimet në vlerën 1,255,251,179 lekë, e cila përbëhet nga 1,119,671,629 lekë likuidime për shpronësimet nga Bashkia, Ministria e Financave dhe MZHU dhe vlera 135,579,549 lekë blerje aktive nga Bashkia të bëra hyrje.

Për vlerën 1,119,671,629 lekë janë kryer veprimet kontabël: debi llog.467“Kreditorë të ndryshëm për shpronësimet “dhe në kredi të llog llog. 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT troje nga shpronësimet me VKM ”.

Për vlerën 135,579,549 lekë janë kryer këto veprime kontabël: debi llog. 218 “Inventar ekonomik” në kredi të 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT”.

- **Gjendja e llogarisë 24 “Aktive të Qend.te trupezuara të dëmtuara”** paraqitet në bilanc pa ndryshime si për vitin ushtrimor 2015 dhe për vitin ushtrimor 2016 në vlerën 576,207,855 lekë. Kjo vlerë e analizuar paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Emërtimi i Aktiveve	Vlera
Çantë pune e në punonjësi NJA 9	18,000
Automjete te NJA Berzhite	3,999,300
Rrënimet te rrethimeve te tregjeve NJA 2, 4 dhe 10	46,247,600
Objekte të hekurudhës stacioni Tirane -Treni	525,960,955
Shuma	<b>576,225,855</b>

Kjo vlerë është trashëguar dhe në mbyllje të bilancit në vitin 2017 me një diferencë prej 18000 lekësh, pasi punonjësi ka arkëtuar vlerën e aktivitetit të dëmtuar (çantës).

Gjendja në mbyllje të ushtrimit në formatin nr. 6 “Gjendja edhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme të pa trupëzuara” kolona 14 është e pasqyruar në formatin nr. 1 në zërin “Aktive të qëndrueshme të pa trupëzuara” dhe “Aktive të qëndrueshme të trupëzuara” në të njëjtat vlera.

**Konkluzion:** Njësia e Menaxhimit të Projekteve PIU deri në nëntor të vitit 2015 ka qenë njësi shpenzuese me vete dhe ka menaxhuar 3 projekte investimi me financim të huaj (kredi). Meqenëse në vitin 2015 kjo njësi është shkrirë në strukturat e Bashkisë Tiranë si Drejtori brenda Aparatit të bashkisë, edhe bilanci i mbylljes së llogarive të vitit 2015 nga PIU është bërë pjesë e pasqyrave financiare të Bashkisë Tiranë në mbyllje të vitit ushtrimor 2015. Ky bilanc u trashëguar me disa paqartësi në gjendjet e disa llogarive, llogari të cilat deri në fund të vitit 2018 nuk kanë funksionuar sipas parimeve e logjikës kontabël. Për këto gjendje llogarish nuk është ndërmarrë asnjë veprim rregullues kontabël, për arsye të mungesës së informacionit kontabël i shoqëruar me analiza si dhe mungesës së dokumentacionit bazë e justifikues. Kjo situatë nga ndodhur për arsye se nuk është bërë i mundur dorëzimi i detyrës për arsye fatkeqësie nga punonjësi përgjegjës për atë periudhë. Në mënyrë të detajuar këto llogari si pjesë të Bilancit të Aparatit të Bashkisë Tiranë në mbyllje të vitit ushtrimor 2016 paraqiten si më poshtë:

- **Gjendja e llogarisë 232 “Shpenzime proces per transferime kapitale”** paraqitet në bilanc pa ndryshime si për vitin ushtrimor 2015 dhe për vitin ushtrimor 2016 në vlerën **1,157,802,262 lekë**. Kjo shifër në bilancin e PIU-t për vitin 2015 është e pa analizuar dhe nuk ka informacion kontabël si dhe dokumentar, se çfarë ka të përfshirë dhe çfarë përfaqëson kjo shumë.

Në fund të vitit kostoja e AQT te blera për nevojat e funksionimit të PIU-t kalon në koston direkte të projektit po në llog.232, por me analiza sipas llojit të investimit. Kostoja direkte e investimit për projektet përkatëse, gjatë periudhës së zbatimit të tij pasqyrohet në analizat respektive të llogarive të grupit 232”Aktive të qëndrueshme të trupezuara në proces” me kundër parti kreditin e llogarive të detyrimeve apo dhe llogarive financiare. Fondet e përdorura për krijimin e tyre janë evidentuar në debi të llogarive financiare me kundër parti kreditin e llogarive respektive 105,106,16,17.

- **Gjendja e llogarisë 409 “Furnitorë (debitorë), parapagime pagesa pjesore”** paraqitet në bilanc pa ndryshime si për vitin ushtrimor 2015 dhe për vitin ushtrimor 2016 në vlerën **58,702,072 lekë**.

Kjo shifër në bilancin e PIU-t për vitin 2015 është e pa analizuar dhe nuk ka informacion kontabël, se çfarë ka të përfshirë dhe çfarë përfaqëson kjo shumë.

Llog. 409" Furnitore(debitore), parapagime e pagesa pjesore" debitohet për furnitorë për parapagime dhe pagesa pjesore (që rezultojnë si kërkesa debitore).

- **Gjendja e llogarisë 45 "Marrëdhënie me institucione Brenda dhe jashtë sistemi"** paraqitet në bilanc pa ndryshime si për vitin ushtrimor 2015 dhe për vitin ushtrimor 2016 në vlerën **6,538,746 lekë**. Për këtë gjendje nuk ka asnjë informacion kontabël se çfarë përfaqëson e për rrjedhim për këtë vlerë nuk ka analizë.

Llogaria 45" Marrëdhënie me institucionet brenda dhe jashtë sistemit" në fund të periudhës ushtrimore duhet të rakordohet dhe si rregull, duhet të jete e mbyllur. Përrjashtimisht përfshihen tepricat kreditore lidhur me lëvizjet e mjeteve materiale nga qendra në njësi dhe anasjelltas, për të cilat nuk është realizuar përfundimisht mbyllja në baze të konfirmimeve. Shifrat në këtë post kërkojnë shpjegime në pyetësor dhe të dhëna sqaruese.

- **Gjendja e llogarisë 511 "Vlera për t'u arkëtuar"** paraqitet në bilanc pa ndryshime si për vitin ushtrimor 2015 dhe për vitin ushtrimor 2016 në vlerën **81,204,163 lekë**. Për këtë gjendje nuk ka asnjë informacion kontabël se çfarë përfaqëson e për rrjedhim për këtë vlerë nuk ka analizë.

Llogaria 511 "Vlera për arkëtim apo për skontim debitohet në kredit të llogarive të interesuara" (413). Kjo llogari kreditohet në bazë të njoftimit të bankës për arkëtimin e tyre në debi të llogarisë 512 ose 531. Shuma e zbritjes (skontos) kalohet në debit të llogarisë 661 "Shpenzime për interesa". Në debit të llog. 661 "Shpenzime për interesa" regjistrohet tërësia e interesave të paguara ose të maturuara që u përkasin ushtrimit kontabël të dhënë për huatë, detyrimet dhe veprimet financiare të kryera, duke u kredituar llogaritë e interesuara (168, 451, 455, 511, 518, 519).

Mbetja debitore e llogarisë 511 "Vlera për arkëtim apo për skontim debitohet në kredi të llogarive të interesuara" në mbyllje të ushtrimit dhe përfaqëson vlerën e letrave të pagesave që janë të depozituara në bankë në pritje për t'u arkëtuar (si llogaritë për ceqet dhe efektet e dorëzuara në bankë për t'u arkëtuar në datën e caktuar ose për t'u skontuar para kësaj date).

- **Pjesë e gjendjes së llogarisë 512 "Llogari në bankë"** në mbyllje të vitit ushtrimor 2016 është edhe **vlera prej 13,950,271 lekë**, për të cilën Bashkia nuk disponon ekstrakt apo statement bankar që të konfirmojë këtë shumë. Për këtë shumë nuk ka informacion se çfarë është dhe si ka vazhduar ecuria e saj deri më tani, çfarë veprimesh janë kryer me këtë gjendje të trashëguar që nga viti 2013.

- **Gjendja e llogarisë 477 "Diferenca konvertime aktive"** paraqitet në bilanc pa ndryshime si për vitin ushtrimor 2015 dhe për vitin ushtrimor 2016 në vlerën **1,563,808 lekë**. Për këtë gjendje nuk ka asnjë informacion kontabël se si ka rezultuar kjo shumë, por sipas funksionimit të kësaj llogarie kjo llogari duhet mbyllur me shpenzimet dhe jo me fondin themeltar.

Kjo llogari sipas kontabilitetit pasqyron diferencat aktive që lidhen me konvertimet nga vlerësimi (për kërkesat debitore dhe detyrimet të shprehura në monedhe të huaj) me kurset e këmbimit në mbyllje të ushtrimit.

- **Gjendja e llogarisë 17 "Huamarrje e huaj"** për vlerën pjesore prej **1.382.417.487 lekë** të trashëguar nga PIU, e cila përfaqëson vlerën e disbursimeve nga tre kreditë për pagesat e furnitorëve për faturat e investimeve në masën 80%. Për këtë shifër nuk ka analiza sipas projekteve të investimeve e disbursimeve (sipas burimeve të financimit të huaj) të kredive.

Përsa trajtuar më sipër, mungesa e informacionit kontabël dhe dokumentacionit mbështetës (bazë e justifikues) për veprimet ekonomike që kanë sjellë këto veprime kontabël si dhe pozicionet e paqarta të këtyre llogarive në bilancin e PIU-t të vitit 2015 trashëguar në PF e Aparatit të Bashkisë Tiranë është në kundërshtim me UMF nr. 14 date 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe të njësitë të menaxhimit /zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatore të huaj" Kapitulli IV "Disa veçori për llogaritë vjetore të njësitë të menaxhimit / zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatore të huaj".

**Në grupin III "Aktive financiare"** paraqiten në bilanc me gjendje llogaritë:

- **Gjendja e llogarisë 25 “Huadhënie e nën huadhënie”** në mbyllje të vitit ushtrimor 2016 paraqitet në vlerën 27,239,000 lekë, ndërsa në mbyllje të vitit ushtrimor 2015 paraqitet në vlerën 13,739,000 lekë. Vlera 27,239,000 lekë përfaqëson vlerën e derdhur nga Bashkia Tiranë sipas detyrimit nga “Marrëveshja e Kredisë së Varur e Pa garantuar” të datës 30.12.2015 të nënshkruar me Shoqërinë e përbashkët “C.... ”shpk, ku kreditori është Bashkia Tiranë dhe huamarrësi të “C....” shpk.

Për këto vlera janë kryer veprimet kontabël në debi të llog. 25 “Huadhënie e nën huadhënie” dhe në kredi të llog.101”Fonde bazë”

- **Gjendja e llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”** në mbyllje të vitit ushtrimor 2016 paraqitet në vlerën 8,385,699,000 lekë, ndërsa në mbyllje të vitit ushtrimor 2015 paraqitet në vlerën 8,383,710,000 lekë. Gjendja e kësaj llogarie në vlerën 8,383,710,000 lekë përfaqëson derdhjet për pjesëmarrje në kapitalet e veta në masën prej 25% të zotërimit të aksioneve të Bashkisë Tiranë në Shoqërinë “C...” shpk në vlerën 13,750,000 lekë, derdhjet për pjesëmarrje në kapitalet e veta sipas përqindjes së aksioneve që zotëron në Klub Futboll Tirana në vlerën 6,525,263,000 lekë dhe vlera prej 1,844,697,000 pjesëmarrja në kapitalet e veta në Ujësjetllës sha Tiranë.

Përshkrimi i Veprimit	Gjendja 31.12.2016
Pjesëmarrje ne kapitale te veta per Klub Futboll Tirana sh.a	6,525,263,000
Pjesëmarrje ne kapitale te veta per Ujësjetllës Kanalizime sh.a Tirane	1,844,697,000
Pjesë ne kapital veta -Proj. SME-te me AADF e Norfund C... sh.p.k	13,750,000
Pjesmarje ne Kapitale te veta Eco Tirana	1,989,000
<b>Shuma</b>	<b>8,385,699,000</b>

Shtesa prej 1,989,000 lekë në vitin 2016 është vlera e aksioneve të Bashkisë Tiranë që përbëjnë 51% të kapitalit themeltar të Shoqërisë së përbashkët “E... “SHA ndërmjet dy ortakëve Shoqëria “E...” dhe Bashkia Tiranë.

Për këto vlera janë kryer veprimet kontabël: në debi të llog.26“Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe në kredi të llog.101 “Fonde bazë”.

**Në klasën 3 “Gjendja e inventarit”** të aktiveve qarkulluese paraqiten në mbyllje të bilancit të vitit 2016 në vlerën 163,687,039 lekë dhe në mbyllje të bilancit të vitit 2015 në vlerën 111,535,126 lekë, ku diferenca e tyre në rritje për vitin ushtrimor prej 52,151,913 lekë është gjendja e llogarisë 63 “Ndryshimi I gjendjeve të inventarit” në formatin nr.3/1 “Shpenzime të ushtrimit”. Këto vlera në mënyrë analitike paraqiten në gjendjet e llogarive:

- **Gjendja e llogarisë 31 “Materiale”** në mbyllje të vitit ushtrimor 2016 paraqitet në vlerën 68,430,733 lekë, ndërsa në mbyllje të vitit ushtrimor 2015 paraqitet në vlerën 17,721,819 lekë me një diferencë në rritje për vitin ushtrimor prej 50,708,914 lekë e cila përfaqëson blerje mallrash për vitin 2016. Kjo llogari është e analizuar për gjendjen datë 31.12.2016 në shumën 68,430,733 lekë, duke bërë sondazhe me inventarin fizik.

- **Gjendja e llogarisë 32 “Objekte inventari (inventari i imët ne përdorim)”** në mbyllje të vitit ushtrimor 2016 paraqitet në vlerën 95,256,307 lekë, ndërsa në mbyllje të vitit ushtrimor 2015 paraqitet në vlerën 93,813,307 lekë me një diferencë në rritje për vitin ushtrimor prej 1,443,000 lekë. Për vlerën 95,256,307 lekë u bënë krahasime me inventarët fizike të kryera në magazinë.

- **Gjendja e llogarisë 423 “Personeli,paradhënie,defiçite dhe gjoba”** në mbyllje të vitit ushtrimor 2016 paraqitet në vlerën 1,311,034 lekë, ndërsa në mbyllje të vitit ushtrimor 2015 paraqitet në vlerën 1,514,190 lekë me një diferencë në ulje për vitin ushtrimor prej 203,156 lekë. Në mënyrë analitike lëvizjet e gjendjeve të kësaj llogarie paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr. llog.	Përshkrimi i veprimeve	Detyrime 31.12.2015	Ndalesa nga paga dhjetor 2015	Shtesa detyrime 2016	Pakësim detyrime 2016 per ndalesa	Detyrime 31.12.2016	Ndalesa nga paga dhjetor 2016
4231	Personeli paradhënie te vitit ne vazhdim	5,293		1,205,050	1,198,050	12,293	
4271	Ndalesa per detyrime ndaj te treteve, te vitit ne vazhdim	1,422,456			1,200	1,421,256	
42710	shërbimi i telefonisë celulare per Vodafone sha	2,675		35,749	25,157	13,267	

42712	Ndalesa per detyrime ndaj te treteve gjate vitit 2012	30,294				30,294	
42713	sherbim telefoni celulare Eagle Mobile		16,138		3,246		19,384
42714	sherbimi i telefonise celulare per Plus Communicat. sh.a			3,313		3,313	
4274	Ndalesa nga paga per detyrime gjyqesore		79,944	487,856	612,168		204,256
4291	Deficite e gjoba te vitit ne vazhdim	149,554		6,513	101,816	54,251	
<b>Totali</b>		<b>1,610,272</b>	<b>96,082</b>	<b>1,738,481</b>	<b>1,941,637</b>	<b>1,534,674</b>	<b>223,640</b>
<b>Gjendja sipas bilancit 31.12.2015</b>		<b>1,514,190</b>	<b>Gjendja sipas bilancit 31.12.2016</b>		<b>1,311,034</b>		

- **Gjendja e llogarisë 4342** “Të tjera operacione me shtetin (debitor datë 31.12.2016)” me shumën 5,914,101,222 lekë përbëhet nga detyrimet afatshkurtra për muajin dhjetor 2016 të cilat trashëgohen në vitin 2017, e cila në analizë përfshin gjëndjet e llogarive në pasivin e bilancit: llog.401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” për vlerën 3,045,844,648 lekë, llog.42 “Personeli e llogari të lidhura me to” për vlerën 85,822,293 lekë, llog.431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” për vlerën 47,655,982 lekë, llog.435 “Sigurime shoqërore” për vlerën 70,227,946 lekë, llog.436 “Sigurime shëndetësore” për vlerën 5,522,234 lekë dhe llog.467 “Kreditorë të ndryshëm” për vlerën 2,659,028,117 lekë.

- **Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”** paraqitet në vlerën prej **335,367,732.72 lekë**, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët. Kjo vlerë ka të përfshirë debitorë të tjerë të Bashkisë Tiranë në vlerën 86,671,607 lekë të paraqitura në tabelat e mëposhtme:

	Përmbledhje te Debitorëve te tjere te Bashkisë Tirane (Aparati)	Gjendja 31.12.2015	Arketuar 2016	Detyrimi i mbetur 31.12.2016
1	Detyrimet e Automjeteve	1,464,970	-	1,464,970
2	Debitorëve te bllokuesve te automjeteve	1,746,484	55,000	1,691,484
3	Detyrim per debitori Y. G. UK nr.8995/1 dt. 11.11.2013 detyrat KLSH	118,029	33,072	84,957
4	Detyrime per debitorin V.G. detyrim UK nr.14432/1, dt.01.12.2015	1,710	1,710	-
5	Debitor Investime nga KLSH, U. K Bashkisë nr. 672, datë 12.04.2011	12,093,995	-	12,093,995
6	Debitor Investime nga KLSH, U.K Bashkisë nr. 8995/1, datë 11.11.2013	2,133,446	-	2,133,446
7	U.K Bashkisë nr. 8995/1, datë 11.11.2013, tejkallim te tarifës ligjore per fjetje	69,600	-	69,600
8	U.K Bashkisë nr. 8995/1, datë 11.11.2013, shpenz të pa argument udhet dieta	507,150	-	507,150
9	U.K Bashkisë nr. 8995/1, datë 11.11.2013, pushime pakryera leje te zakons	123,810	-	123,810
10	U.K Bashkisë nr. 8995/1, datë 11.11.2013, paradhënie leje te zakonshme	20,000	-	20,000
11	Urdheri 8178/61 dt.02.07.2015, Detyrime KLSH per OE per blerje sherbime	14,722,760	-	14,722,760
12	Debitor firma pastrimi KLSH, Urdheri 8178/76 dt.23.07.2015	48,088,228	-	48,088,228
13	Debitor Investime nga KLSH, Urdheri 8178/76 dt.23.07.2015	929,919	-	929,919
14	Debitor nder vite automjete 31.12.2013	2,894,684	-	2,894,684
15	Debitor prefektore vitit 2000	857,176		857,176
16	Debitor prefektore vitit 2001	730,741		730,741
17	Debitor valute viti 2000-2003	312,052		312,052
	<b>Vlera Totale</b>	<b>86,814,754</b>	<b>89,782</b>	<b>86,724,972</b>

Në kredi të kësaj llogarie është kontabilizuar gabim vlera totale prej 53,365 lekë, nga e cila në vitin 2015 vlera prej 38,365 lekë dhe në vitin 2016 në vlerën 15,000 lekë. Kjo vlerë ka pakësuar detyrimin real duke figuruar si arkëtim por në fakt nuk ka qënë pjesë e debitorve por në fakt është ndalesë për detyrim celular dhe pagë. Këto vlera janë sistemuar në vitin 2017 në debi të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” duke kredituar llogaritë përkatëse për 4 veprime kontabël të kryera si: në një rast në vlerën 20,000 lekë për detyrim për telefoni celular kredi të llogarisë 427 “Ndalesa nga paga për detyrime ndaj të tretëve”, ndërsa në tre raste në vlerën 33,365 lekë ndalesa për paga të dhëna tepër në kredi të llogarisë 4342 “Te tjera operacione me shtetin(debitor)” pasi ky detyrim ka kaluar në mbyllje të vitit ushtrimor në këtë llogari.

**Debitorët të trashëguar nga Njësitë Administrative** në vlerën **35,603,512 lekë** të paraqitur në tabelën e mëposhtme:

	Përshkrimi i veprimit	Detyrimi i mbetur 31.12.2015	Arketuar 2016	Detyrimi i mbetur 31.12.2016
<b>1</b>	<b>Debitor Individ NJA</b>			
	Debitor njësia 5, (vjedhje arke me proces gjyqësor te mbyllur)	12,813,725	82,000	12,731,725



	Debitor njesia 6, Detyrime nga auditi Bashkise Tirane date 31.07.2007 dhe KLSH 2011	815,281	-	815,281
	Debitor njesia 10, Detyrime KLSH 2011	508,287		508,287
	Debitor njesia 14 Dajt, sipas KLSH nr.708/8, dt.23.12.2013	898,484		898,484
	Debitor njesia 16 Berzhite, detyrime KLSH nr.1160/14, dt.31.12.2012	400,000		400,000
<b>2</b>	<b>Debitor Investime NJA</b>			-
	Debitor njesia 14 Dajt, sipas KLSH nr.708/8, dt.23.12.2013	6,362,675		6,362,675
	Debitor njesia 16 berzhite, KLSH nr.1160/14, dt.31.12.2012	11,424,611		11,424,611
	Debitor njesia 20 Vaqar, KLSH	413,449		413,449
<b>3</b>	<b>Debitor NJA - Kontrata qiraje per pyje kullota</b>			-
	Debitor njesia 16 Berzhite, detyrime KLSH nr.1160/14, dt.31.12.2012	2,049,000		2,049,000
	<b>Vlera Totale</b>	<b>35,685,512</b>	<b>82,000</b>	<b>35,603,512</b>

Debitorë për pulla të tërhequra nga punonjës të Gjendjeve Civile në Bashkinë Tiranë dhe 24 Njësi Administrative për gjëndjet e mbetura në datën 31.12.2016 derdhjet e të cilave janë bërë në vitin pasardhës.

	Emertimi	Detyrimi i mbetur 31.12.2015	Furnizimi BT + NJA 2016	Derdhje ne Banke nga BT + NJA 2016	Detyrimi i mbetur 31.12.2016
<b>1</b>	Debitor Bashki + NJA –pulla Gjendja civile	4,701,848	53,055,000	51,721,856	6,034,992
	<b>Vlera Totale</b>	<b>4,701,848</b>	<b>53,055,000</b>	<b>51,721,856</b>	<b>6,034,992</b>

Debitor për taksa dhe tarifa vendore në vlerën 207,077,622 lekë të cilat i përkasin Njësi Administrative deri më datën 31.07.2015, detyrime këto të trashëguara nga PF në mbyllje të aktivitetit të ish komunave dhe të paraqitura në PF të Bashkisë Tiranë sipas tabelës së mëposhtme:

	Emertimi	Detyrimi i mbetur 31.12.2015	Arketuar 2016	Detyrimi i mbetur 31.12.2016
	<b>Debitor NJA - Tatime</b>			
1	Njesia Petrele	8,774,330		8,774,330
2	Njesia Farke	1,564,053		1,564,053
3	Njesia Berzhite	2,581,990		2,581,990
4	Njesia Vaqarr	10,377,559		10,377,559
5	Njesia Kashar	183,779,690		183,779,690
	<b>Vlera Totale</b>	<b>207,077,622</b>	<b>-</b>	<b>207,077,622</b>

Vlera prej 207,077,622 lekë është zbritur për shumën 369,853 lekë, vlerë e hedhur gabim në transportimin e bilancit të ish-komunës Farkë. Për këtë vlerë është bërë sistemin në mbyllje te vitit ushtrimor 2017, duke e zbritur gjendjen e llog.468 “Debitorë të ndryshëm” në shumën 206,707,281 lekë. Për këtë sistemin janë kryer veprimet kontabël: kredi llog.468 “Debitorë të ndryshëm” dhe debi llog. 4341 “Të tjera operacione me shtetin (kreditor)” për vlerën 369,853 lekë. Gjithashtu për këtë vlerë është debituar llog.4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)” në kredi të llog.467 “Kreditorë të ndryshëm”.

Për arkëtimin e këtyre detyrimeve ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme Menaxhimit Financiar në Bashkinë Tiranë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatim Taksave Vendore, nën varësi e Bashkisë nuk ka është hapur dhe mbajtur llogari ndërmjetëse me nën varësitë. Meqenëse arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore e kryen DPTTV, atëherë dhe ky detyrim duhet të shkarkohet nga bilanci i Aparatit dhe të ngarkohet Bilanci i kësaj drejtorie me shkresë zyrtare. Kështu nga Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar me shkresat nr. prot. 29204 datë 03.08.2017 dhe nr.prot.3076 datë 22.01.2018 drejtuar DPTTV është kërkuar marrja në ngarkim e debitorëve të këtyre NJA nga kjo Drejtori dhe shkarkimi nga kontabiliteti i Aparatit të Bashkisë Tiranë, për të cilat nuk kishte informacion për ecurinë vjeljes së këtyre detyrimeve , prandaj kjo vlerë është e pandryshuar që në vitin 2015-2016 e 2017. Por njëkohësisht DPMF ka marrë informacion që këto detyrime janë dërguar nga NJA me kërkesë të DPTTV dhe janë futur në sistemin informatik të taksave dhe tarifave vendore. Për këtë nga DPTTV është kthyer përgjigje me shkresën nr. 8336/1,

prot. datë 18.02.2019, e cila konfirmon marrjen në ngarkim të këtyre detyrimeve dhe regjistrimin në kontabilitetin e tyre si hedhjen e tyre në sistem. Veprimet kontabël për shkarkimin dhe sistemimin e vlerës prej 206,707,769 lekë është bërë në mbylljen e pasqyrave financiare të Bashkisë për vitin 2018 të cilat hartohen deri në fund të marsit të vitit 2019.

### Klasa 5 rubrika III. Llogaritë Financiare

- **Gjendja e llogarisë 512 “Llogari në bankë”** në mbyllje të vitit ushtrimor 2016 paraqitet në vlerën 23,564,926 lekë, e cila përbëhet nga vlera 13,950,271 lekë që i përket bilancit të PIU-t, trajtuar më lart dhe nga vlera 9,614,655 lekë që i përket “Fondit të Garancisë” për Programin e Zhvillimit Ekonomik dhe Punësimit”. Bashkia në këtë program është në cilësinë e garantuesit të kredisë të akorduar 12 bizneseve, sipas Marrëveshjes nr.prot.8090 datë 22.08.2013 ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe Bankës Tregtare Tiranë. Të dhënat e veprimeve të kryera me fondin e garancisë të derdhur në Bankën Tregtare Tiranë dhe shpërndarë bizneseve si dhe veprimet e kryera për rimarrjen e kredisë nga bizneset paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Rimarrja e garancisë së kredisë së subjekteve për çdo muaj

Analiza e llogarisë	Pershkrimi i veprimit	Gjendja e llogarisë 01.01.2014 31.12.2016	Shuma e Kredise ne Lek	Shuma e Garancise Bashkise		Shuma e Ripaguar e Garancise muaji janar '14 - dhjetor'16 (progresive)	Shuma e Ripaguar e Garancise muaji dhjetor 2016	Gjendja e llog. 512 "Llog. ne banke" me date 31.12.2016	Gjendja e llog.56 "Llog. ne organizma krediti" me 31.12.2016
				Ne %	Ne Lek				
1	2	3	4	5	6	7	8	9=3-6+7	10=6-7
	Gjendja në 31.12.2013	10,000,000							
7101200	Interesa bankare 01.01.2014	548							
7101200	Interesa bankare 31.12.2014	81,647							
7101200	Interesa bankare 31.12.2014	118,364							
7101200	Interesa bankare deri 29.01.2016	98,015							
7101200	Interesa bankare deri 29.01.2016	105,997							
5650000	Fond garant kredi subjekti "T..."sh.p.k		4,000,000	50%	2,000,000	1,940,237	59,473		59,763
5650000	Fond garant kredi subjekti "V..."sh.p.k		960,000	50%	480,000	465,394	14,535		14,606
5650000	Fond garant kredi subjekti "N..."sh.p.k		1,000,000	50%	500,000	484,956	14,977		15,044
5650000	Fond garant kredi subjekti "P..."sh.p.k		800,000	50%	400,000	387,653	12,258		12,347
5650000	Fond garant kredi subjekti "V..."sh.p.k		1,000,000	50%	500,000	484,990	14,962		15,010
5650000	Fond garant kredi subjekti "Z..."sh.p.k		3,000,000	50%	1,500,000	1,500,006	-		-
5650000	Fond garant kredi sub. "F..."sh.p.k		2,000,000	30%	600,000	564,232	17,757		35,762
5650000	Fond garant kredi sub. "B..."p.fizik		430,000	50%	215,000	90,745	-		124,255
5650000	Fond garant kredi subjekti "E..." sh.p.k		3,000,000	30%	900,000	711,835	26,352		188,165
5650000	Fond garant kredi subjekti "B..." sh.p.k		3,000,000	20%	600,000	458,369	17,326		141,631
5650000	Fond garant kredi subjekti "G.F." p. fizik		300,000	50%	150,000	150,000	-		-
5650000	Fond garant kredi subjekti "K.S." p. fizik		400,000	50%	200,000	16,667	-		183,333
	<b>TOTALI</b>	<b>10,404,570</b>	<b>19,890,000</b>		<b>8,045,000</b>	<b>7,255,085</b>	<b>177,640</b>	<b>9,614,655</b>	<b>789,915</b>

Kontabilizimet janë kryer në këtë mënyrë:

**Për derdhjen e Fondit të Garancisë në shumën 10,000,000 lekë nga Bashkia Tiranë**, për këtë vlerë është kryer veprimi kontabël në debi të llog.512“Llogari në bankë” në kredi të llog.101”Fonde bazë”

**Për pagesat e kryera nga fondi në favor të kredi marrësve në shumën 8,045,000 lekë** është kryer veprimi kontabël në debi të llog.565 “Mjete monetare në organizma financiarë krediti” në kredi të llog. 512“Llogari në bankë”.

**Për vlerat e kthyera nga kredimarrësit në shumën 7,255,091 lekë** (progresiv), pra rimarrje nga kredimarrësit të kësteve të kredive deri në fund të vitit 2016 është kryer veprimi kontabël në debi të llog. 512“Llogari në bankë” dhe në kredi të llog.56 “Llogari në organizma krediti”.

**Për të ardhurat nga interesat të derdhura nga BKT në shumën 404,570 lekë** deri në fund të vitit 2016 është kryer veprimi kontabël në debi të llog. 512“Llogari në bankë” dhe në kredi të llog.765 “Te ardhura nga interesat e depozitave”.

- **Gjendja e llogarisë 56 “Llogari në organizma krediti”** në mbyllje të vitit ushtrimor 2016 paraqitet në vlerën 789,915 lekë, ndërsa në mbyllje të vitit ushtrimor 2015 paraqitet në vlerën 3,525,882 lekë. Këto vlera përfaqësojnë gjendjet e kredive të pashlyera nga huamarrësit( paraqitur në tabelën e mësipërme për kreditë e kthyera nga e 12 bizneset huamarrëse) Për këto vlera janë kryer veprimet kontabël ne debi të llog.512 “Llogari në bankë në kredi të llog.565 “Mjete monetare në organizma financiarë krediti”

- Gjendja e llogarisë 532 “Vlera të tjera” në mbyllje të vitit ushtrimor 2016 paraqitet në vlerën 1,544,400 lekë e ndarë: vlera prej 1,319,400 lekë paraqet gjendjen në vlerë të pullave në arkë në datën 31.12.2016, e cila është verifikuar dhe me procesverbalin e mbajtur në arkë për rakordimin gjendjes fizike me kontabël të letrave me vlerë në datë 31.12.2016 dhe 50,400 lekë e cila përfaqëson vlerën për bileta tregu të NJA nr.4 të mbetura gjendje që nga viti 2012 në këtë njësi.

### Analiza e Llogarive të Pasivit të Bilancit Kontabël:

PASIVI I BILANCIT KONTABEL 2016			(ne leke)	
Nr.	Nr.llog.	EMERTIMI I LLOGARIVE TE PASIVIT	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi i Paraardhes
<b>1</b>	<b>A</b>	<b>FONDE TE VETA</b>	<b>41,466,722,352.33</b>	<b>37,749,051,489.03</b>
<b>2</b>	<b>10</b>	<b>I. Fonde te veta</b>	<b>30,347,991,662.69</b>	<b>29,498,991,494.43</b>
3	101	Fonde baze	18,875,332,609.97	18,368,309,218.06
4	105	Grante te brendshme kapitale	10,298,804,842.72	9,956,828,066.37
5	106	Grante te huaja kapitale	1,173,115,910.00	1,173,115,910.00
6	107	Vlera Akt.Qend.te caktuara ne perdorim	738,300.00	738,300.00
7	109	Rezerva nga rivlersimi aktiveve te qendrushme		
<b>8</b>	<b>11</b>	<b>II.Fonde te tjera te veta</b>	<b>11,118,730,689.64</b>	<b>8,250,059,994.60</b>
9	111	Fonde rezerve		
10	115	Caktim nga rezultati i vitit per investime	11,118,730,689.64	8,250,059,994.60
11	116	Te ardhura nga shitja e Ak.Qendrushme		
<b>12</b>	<b>12</b>	<b>III.Rezultati i mbartur</b>		
<b>13</b>	<b>13</b>	<b>IV.Subvecione te jashtezakonshme( - )</b>		
<b>14</b>	<b>14</b>	<b>V.Pjesemarrje te instit.ne invest.per te trete</b>		
<b>15</b>	<b>15</b>	<b>VI.Shuma parashikuara per rreziqe e shpenz.</b>		
<b>16</b>	<b>B</b>	<b>D E T Y R I M E</b>	<b>9,740,172,608.56</b>	<b>7,302,352,646.67</b>
<b>17</b>	<b>16,17,18</b>	<b>I.Borxhe afatgjate</b>	<b>3,397,947,958.89</b>	<b>1,386,726,800.00</b>
18	16	Huamarrje e brendshme dhe te ngjashme	1,975,947.00	4,309,313.00
19	17	Huamarrje e huaj	3,395,972,011.89	1,382,417,487.00
<b>20</b>	<b>Klasa 4</b>	<b>II.Detyrime afatshkurter</b>	<b>6,342,224,649.67</b>	<b>5,915,625,846.67</b>
21	419	Kliente(Kreditore), parapagese pjesore		
22	401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	3,045,844,648.30	2,475,870,069.30
23	42	Personeli e llogari te lidhura me to	85,822,293.70	77,875,479.70
24	431	Detyrime ndaj Shtetit per tatim-taksa	47,655,982.00	39,090,132.00
25	432	Tatime mbedhura nga shteti per llog.Pusht.Lokal	0.00	
26	433	Shteti fatkeqesi natyrore	0.00	
27	4,341	Te tjera operacione me shtetin(kreditor)	343,811,577.69	344,021,571.69
28	435	Sigurime shoqerore	70,227,946.00	66,501,630.00
29	436	Sigurime shendetsore	5,522,234.00	5,013,223.00
30	437	Organizma te tjere shoqerore	0.00	
31	44	Institucione te tjera publike	0.00	
32	45	Marrdhenie me institucione brenda e jasht sistemit	0.00	
33	460	Huadhenes	0.00	
34	464	Detyrime per t'u paguar per blerjen e letr,vlere	50,400.00	50,400.00
35	466	Kreditore per mjete ne ruajtje	84,261,450.00	57,843,720.00
36	467	Kreditore te ndryshem	2,659,028,117.98	2,849,359,620.98
<b>37</b>	<b>C</b>	<b>LLOGARI TE TJERA</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
38	475	Te ardhura per tu regjist.vitet pasardhese		
39	478	Diferenca konvertime pasive		
40	480	Te ardhura per tu klasifikuar ose rregulluar		
41	487	Te ardhura te arketuara para nxjerrjes titullit		
<b>42</b>	<b>85</b>	<b>REZULTATI I USHTRIMIT(Saldo kreditore)</b>		
<b>43</b>	<b>X</b>	<b>TOTALI PASIVIT</b>	<b>51,206,894,960.89</b>	<b>45,051,404,135.70</b>

- Gjendja e llogarisë 101 “Fonde bazë” në mbyllje të vitit ushtrimor 2016 paraqitet në vlerën 18,875,332,609lekë, ndërsa në mbyllje të vitit ushtrimor 2015 paraqitet në vlerën 18,368,309,218 lekë. Diferenca prej 507,023,391 lekë është rritja e fondeve nga viti 2015 në vitin 2016. Të dhënat e lëvizjeve të fondeve në mënyrë më të detajuar paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Pershkrimi i Veprimit	Gjendja 31.12.2015	Paksime	Shtesa	Gjendja 31.12.2016
	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4=1+3-2</b>
Gjendja fillestare ne 01.01.2016	18,368,309,218			
Transferim ndryshim gjendje inventari 31.12.2016			52,151,913	
Crimson Financë Fund Albania, VKB 1, dt.26.02.14			13,500,000	
Shtesa fondi themeltar per hyrje troje nga shpronese viti 2016			440,656,063	
Shtese fondi themeltar per blerje me pagese			36,340,150	

Amortizimin deri ne 31.12.2016		35,624,735		
<b>Totali</b>	<b>18,368,309,218</b>	<b>35,624,735</b>	<b>542,648,127</b>	<b>18,875,332,610</b>
<b>Shtesa gjate vitit 2016</b>			<b>507,023,392</b>	

Për këtë vlerë janë kryer veprimet kontabël:

Për shtesat e aktiveve në debi të aktiveve sipas llojit dhe në kredi të llog.101 “Fonde bazë”. Për shtesat e ndryshimit të gjendjeve të inventarëve që janë me efekt pozitiv është debituar llog. 8423 “Transferim i ndryshimit të gjendjeve” në kredi të llog.101 “Fonde bazë”. Ndërsa për amortizimin e aktiveve llog.1012 “Pakësim i fonde bazë” është debituar në kredi të llog. 1013 “Konsumi i aktiveve te qendrueshme”,

- **Gjendja e llogarisë 105 “Grante te brendshme kapitale”** në mbyllje të vitit ushtrimor 2016 paraqitet në vlerën 10,298,804,842 lekë, ndërsa në mbyllje të vitit ushtrimor 2015 paraqitet në vlerën 9,956,828,066.37 lekë. Diferenca prej 341,976,776 lekë është rritja e fondeve nga viti 2015 në vitin 2016. Të dhënat e lëvizjeve të fondeve në mënyrë më të detajuar paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Pershkrimi i Veprimit	Gjendja 31.12.2015	Shtesa	Gjendja 31.12.2016
Gjendja fillestare ne 01.01.2016	9,956,828,066		9,956,828,066
Grante te brendeshme ne natyre, per terrene e troje		292,765,505	292,765,505
Grante te brendeshme ne natyre, instalime teknike, makineri, paisje e vegla pune		19,613,160	19,613,160
Grante te brendeshme ne natyre per, mjete transporti		25,440,610	25,440,610
Grante te brendeshme ne natyre, inventar ekonomik		4,157,501	4,157,501
<b>Totali</b>	<b>9,956,828,066</b>	<b>341,976,776</b>	<b>10,298,804,843</b>

Për këto shtesa në natyrë janë kryer veprimet kontabël: Në debi të aktiveve (AQT) sipas llojit në kredi të llogarive respektive 1059 “Grante të brendshme kapitale në natyre”.

- **Gjendja e llogarisë 107 “Vlera Aktiveve të Qendrueshme te caktuara ne perdorim”** paraqitet në bilanc pa ndryshime si për vitin ushtrimor 2015 dhe për vitin ushtrimor 2016 në vlerën 738,300 lekë. Kjo vlerë përfaqëson shpenzime për ndërhyrje riparim kanali në lagjen Don Bosko NJA nr.9, kërkuar dhe paguar nga qytetarët në vitin 2008. Kjo vlerë është trashëguar nga bilanci i NJA 9 në vitin 2015 dhe e transportuar në bilancin e 2016 të Bashkisë Tiranë. Kjo vlerë është kontabilizuar gabim në këtë llogari, pasi nuk kemi shpenzime për rritje të AQT por mirëmbajtje. Për këtë arsye në vitin 2018, ky veprim është sistemuar , duke prerë artikullin kontabël në debi të llog. 107 “Vlera Aktiveve të Qendrueshme të caktuara në përdorim” në kredi të llog. 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT”.

- **Gjendja e llogarisë 115 “Caktim nga rezultati i vitit per investime”** në mbyllje të vitit ushtrimor 2016 paraqitet në vlerën 11,118,730,689 lekë, ndërsa në mbyllje të vitit ushtrimor 2015 paraqitet në vlerën 8,250,059,994 lekë. Diferenca prej 2,868,670,695 lekë është rritja e fondeve nga viti 2015 në vitin 2016. Të dhënat e lëvizjeve të fondeve në mënyrë më të detajuar paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Pershkrimi i Veprimit	Gjendja 31.12.2015	Blerje aktive të marra dorzim (Debi)	Cakt.fondi per investime (Kredi)	Gjendja 31.12.2016
	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4=1+3-2</b>
Gjendja fillestare ne 01.01.2016	<b>8,250,059,994</b>			
Blerje AQT		135,193,150		
Hyrje troje viti 2016		440,656,063		
Caktim fondi per investime viti 2016			3,444,519,908	
<b>Totali</b>	<b>8,250,059,994</b>	<b>575,849,213</b>	<b>3,444,519,908</b>	<b>11,118,730,689</b>
<b>Shtesa gjate vitit 2016</b>			<b>2,868,670,695</b>	

Për shtesat e krijuara nga blerja e aktiveve është debituar llog. 115 “Caktim nga rezultati i vitit per investime” në kredi të 1011 “Shtesa të fondit bazë”. Ndërsa për fatura të mbërritura për realizimin e investimeve, financimi i të cilave bëhet nëpërmjet transferimit të ardhurave të krijuara në vitin ushtrimor për përdorim nga seksioni i funksionimit në seksionin e investimeve, ku kryhet veprimi kontabël: në debi të llog. 831 “Transferim për caktimin e të ardhurave për investime” në kredi të llog.115 “Caktim fondi për investime nga rezultati i vitit”.

- **Gjendja e llogarisë 16 “Huamarrje e brendshme dhe të ngjashme”** në mbyllje të vitit ushtrimor 2016 paraqitet në vlerën 1,975,947 lekë, ndërsa në mbyllje të vitit ushtrimor 2015 paraqitet në vlerën 4,309,313 lekë. Këto vlera në këtë llogari paraqesin gjendjen e kredisë së marrë nga ish-komuna Petrelë për financimin e projektit të investimit me objekt “Sistemim asfaltim rruga Petrelë Zaranikë në vlerën 15,000,000 lekë bazuar në urdhrin e MF nr. Prot. 857, datë 27.01.2010 me afat 6 vjet nga dita e disbursimit të parë.

Kjo kredi në mënyrë të detajuar sipas disbursimeve dhe pagesave në vite paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Viti	Disbursuar sipas bankes	Komision disbursimi	Hyrje thesar	ne	Pagesat sipas thesarit	Stoku	
						Sipas bilancit (detyrimi progresiv)	Sipas thesarit (detyrimi progresiv)
2010	6,000,000	30,000	5,970,000		166,666	5,833,334	5,803,334
2011	3,000,000	15,000	2,985,000		1,333,332	7,500,002	7,455,002
2012	3,000,000	15,000	2,985,000		1,875,003	8,624,999	8,564,999
2013	3,000,000	15,000	2,985,000		2,333,340	9,291,659	9,216,659
2014					2,500,008	6,791,651	6,716,651
2015					2,482,338	4,309,313	4,234,313
2016					2,333,366	<b>1,975,947</b>	1,900,947
<b>Kom.Disbursimit</b>							75,000
	<b>15,000,000</b>	<b>75,000</b>	<b>14,925,000</b>		<b>13,024,053</b>	<b>1,975,947</b>	<b>1,975,947</b>

Investimi financiar nga kjo kredi është realizuar para viteve 2015 dhe është bërë hyrje në aktiv të NJA. Për pagesat e kësteve të kredisë janë kryer veprimet kontabël në debi të llog. 16 “Hua afatshkurtër” në kredi llog. 520 “Disponibilitete në thesar”.

- **Gjendja e llogarisë 17 “Huamarrje e huaj”** në mbyllje të vitit ushtrimor 2016 paraqitet në vlerën 3,395,972,011 lekë, ndërsa në mbyllje të vitit ushtrimor 2015 paraqitet në vlerën 1,382,417,487 lekë. Diferenca në rritje prej 2,013,554,524 lekë, paraqet investimet e kryera me financim të huaj gjatë vitit ushtrimor (disbursimet), për të cilin informacioni I detajuar paraqitet më poshtë:

**Për vitin 2016** Bashkia Tiranë ka kryer shpenzime kapitale me financim të huaj për projektin “Bulevardi Verior dhe Rehabilitimit të Lumit të Tiranës” nga Abu Dhabi (marrëveshje nënhuaje). Ky investim financohet për 80% të vlerës nga kreditori Abu Dhabi nëpërmjet disbursimeve dhe 20% e vlerës financohet nga buxheti i Bashkisë. Bashkia me fondet e veta përballon vetëm kostot lokale (20% TVSH). Për këto shpenzime nga Drejtoria e Financës janë kryer këto veprime kontabël:

**Me mbërritjen e situacionit të shoqëruar me faturën e sipërmarrësit të punimeve për vlerën 20% është kryer veprimi kontabël debi llog.231 “Shpenzime investime në proces për kosto lokale”** në kredi të llog.404 “Furnitor për investime” në vlerën 433,776,635 lekë.

**Për konfirmimet** nga Drejtoria e Projekteve të Investimeve të Huaja dhe Ministria e Financave për disbursimet është kryer veprimi kontabël debi llog. 231 “Shpenzime investime në proces” në kredi të llog.17 “Huamarrje e huaj” për vlerën 2,013,554,525 lekë. Të dhënat paraqiten në tabelën më poshtë:

Operatorët Ekonomik sipërmarrës të punimeve viti 2016	Objekti i Kontratës	Kosto lokale e faturave per Bashkinë (20%)	Disbursimet (shpenzime direkte nga Abu Dhabi për 80% faturat e sipërmarrësve të punimeve)
JV “P...Srl” Rome, Itali (lider) & “H... SpA” & “A...Srl” & “T... SpA”, Itali	Supervizimi i punimeve per projektin e Bulevardit Verior të Tiranës dhe Rigjenerimi i Lumit të Tiranës - Abu Dhabi	19,929,173	115,837,282
C...Ë.L.L. S... C.H.)	Ndërtimi i Bulevardit Verior Tiranës e punimcivile - Abu Dhabi	96,012,742	471,666,105
"T... " A. & "S...", Austria	Punim Rehabil Lum Tiranës, të bankina e pun ndërt - Abu Dhabi	284,271,538	1,418,471,438
M....sh.p.k	Rigjallërim i Sheshit "Skenderbej" Faza II/Punime civile - Kuvajt	20,166,262	
S....r Albania	Ndërtim i qendres se kontrollit te trafikut - BERZH		7,579,699

S.... sh.p.k	Shkolla shishtufina & fonderia mekanike CEB	13,396,920	
<b>Totali</b>		<b>433,776,635</b>	<b>2,013,554,525</b>

- **Gjendja e llogarisë 401-408 “Furnitor e llogari të lidhura me to”** në mbyllje të vitit 2016 paraqitet në shumën **3,045,844,648 lekë**. Kjo gjendje përfshin:

- Gjendjen e llogarisë 401 “Furnitor e llogari të lidhura me to (blerje mallra e shërbime)”, ku sipas kartelës kontabël është në vlerën 487,290,791 lekë, vlerë e cila në mënyrë analitike paraqitet në tabelën bashkëlidhur Akt-konstatimit.

Sipas tabelës detyrimet e krijuara për fatura të palikujduara për blerje mallrash dhe shërbimesh në vitin 2015 e përpara janë në vlerën 513,073,851 lekë, në vitin 2016 janë shtuar detyrime në vlerën 1,789,912,515 lekë, pra në total në vlerën 2,302,986,366 lekë. Nga këto në vitin 2016 janë likuiduar fatura të prapambetura në vlerën 1,815,695,575 lekë, duke mbetur në fund të vitit me datë 31.12.2016 detyrime ndaj furnitorëve për fatura të palikujduara për blerje mallrash e shërbimesh në vlerën 487,290,791 lekë.

Nga këto për 58 furnitorë, faturat e prapambetura janë trashëguar që nga viti 2015 me vlerë **44,277,721 lekë**, për të cilat nuk janë kryer as në vitin 2016, dhe në vitin 2017 në një rast është kryer likuidim pjesor e në dy raste likuidim total, ndërsa për 56 furnitorë detyrimet e prapambetura vazhdojnë të jenë të palikujduara deri në datën 31.12.2017 në vlerën **23,031,370 lekë**, pasi nuk është ndjekur radha FIFO e pagesave në kundërshtim me UMF nr.2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit” pika 101. Rastet paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Kodi	Emertimi i Furnitorit	Gjendja 31.12.2015	Shtesa 2016	Gjendja 31.12.2015 + shtesa 2016	Pagesa 2016	Detyrimi 31.12.2016	Pagesa 2017	Detyrimi 31.12.2017
F0253	Viktoria Invest shpk	31465909	0	31465909	0	31465909	17568982	13896927
F0607	Mandi-2k	3368640	0	3368640	0	3368640	3368640	0
F0154	Albatlas shpk, Alma Kraja	451751	0	451751	0	451751		451751
F0328	Shoqata e Kerkimeve Urbane	380000	0	380000	0	380000		380000
F0026	Gazeta "Shqip" sh.p.k.	285000	0	285000	0	285000		285000
FO0350	Focus Press sh.p.k	278729	0	278729	0	278729	278729	0
F0010	Albanian Consortium sh.a	251118	0	251118	0	251118		251118
F0139	Alba Global sh.p.k	238000	0	238000	0	238000		238000
F0076	AL&GI SHPK	218000	0	218000	0	218000		218000
FA21	Aulivia sh.p.k	205400	0	205400	0	205400		205400
F0028	Shekulli Media Group sh.p.k.	204100	0	204100	0	204100		204100
FASH13	A & SH sh.p.k	154000	0	154000	0	154000		154000
F0213	Restorant Piazza	45360	79150	124510	0	124510	79150	45360
F0079	Adion Gorani	120000	0	120000	0	120000		120000
FI15	Intergrafika	78000	0	78000	0	78000		78000
F0047	AMC	77931	0	77931	0	77931		77931
F0078	Gentian Shkullaku	60000	0	60000	0	60000		60000
F0188	GSM Klimare ( Genci Muçaj )	60000	0	60000	0	60000		60000
F0448	Shoqa "Gjimnastika Aerobi"	30000	30000	60000	0	60000	60000	0
FHSH006	Hatixhe Shaba	51520	0	51520	0	51520		51520
FSHH11	Shaban Hoxha	51300	0	51300	0	51300		51300
F0069	Panorama group sh.a	36000	0	36000	0	36000		36000
F0027	Edisud spa, Gazeta Shqiptare	24000	0	24000	0	24000		24000
F0140	Arjana Xamo	18000	0	18000	0	18000		18000
F0136	Koço Morava	15000	0	15000	0	15000		15000
F0280	Euro Gers	6600	0	6600	0	6600		6600
FP	Mond Oficce shpk	640620	0	640620	0	640620		640620
FP	ZENIT-06	60000	0	60000	0	60000		60000
FP	OSHEE	286000	0	286000	0	286000		286000
FP	ELEKTROSEK shpk	48000	0	48000	0	48000		48000
FP	SIGAL	49000	0	49000	0	49000		49000
FP	Arbana sh.a	376540	0	376540	0	376540		376540
FP	APA ( Abania Partneres Absorbes)	45300	0	45300	0	45300		45300
FP	Helios Catering shpk.	50000	0	50000	0	50000		50000
FP	Sofra e Ariut	35000	0	35000	0	35000		35000
FP	D.&D	35000	0	35000	0	35000		35000
FP	TT (Tirana Teknologji ) shpk	200000	0	200000	0	200000		200000
FP	Koço Morava	29000	0	29000	0	29000		29000
FP	Abissnet	223983	0	223983	0	223983		223983
FP	AlbaGlobal shpk	64770	0	64770	0	64770		64770

FP	Insig Sha	38400	0	38400	0	38400		38400
FP	Hyundai Auto Albania	1022754	0	1022754	0	1022754		1022754
FP	Top Channel	12896	0	12896	0	12896		12896
FP	Besim Sukthi	50,000	0	50,000	0	50,000		50,000
FP	Albana Haka	54000	0	54000	0	54000		54000
FP	Kujtim Metaj	17000	0	17000	0	17000		17000
FP	Ciceroni shpk	72900	0	72900	0	72900		72900
FP	Laureta Kokona	41500	0	41500	0	41500		41500
FP	Shaban Hoxha	84800	0	84800	0	84800		84800
FP	Valbona Mehmeti	18000	0	18000	0	18000		18000
FP	Hatixhe Shaba	27000	0	27000	0	27000		27000
FP	Diplomat HY shpk	14000	0	14000	0	14000		14000
FP	Taivan Shpk	14850	0	14850	0	14850		14850
FP	Drejtorja e Pergjith. Arkiva	1500	0	1500	0	1500		1500
FP	Gazeta RD	122500	0	122500	0	122500		122500
FP	Gazeta Koha Jone	210000	0	210000	0	210000		210000
FP	Shekulli Media Group shpk	732000	0	732000	0	732000		732000
FP	Gazeta Shqip	1476000	0	1476000	0	1476000		1476000
	<b>TOTALI</b>	<b>44277721</b>	<b>109150</b>	<b>44386871</b>	<b>0</b>	<b>44386871</b>	<b>21355501</b>	<b>23031370</b>

Për 10 furnitorë të marrë si kampion nisur nga kartelat kontabël të tyre u kryen teste të detajeve për faturat e secilit furnitor nga ku rezultoi se ekzistojnë dokumentacioni bazë dhe justifikues.

• **Gjendjen e llogarisë 404“Furnitor e llogari të lidhura me to (për investime)”**, ku sipas kartelës kontabël është në vlerën **2,558,553,858** lekë, vlerë e cila në mënyrë analitike paraqitet në tabelën në **Aneksin nr.2** bashkëlidhur Akt-konstatimit.

Sipas tabelës në **Aneksin nr.2** detyrimet e krijuar për fatura të palikujduara për investime të kryera në vitin 2015 e përpara janë në vlerën **1,962,796,218** lekë, në vitin 2016 janë shtuar detyrime në vlerën **2,852,714,783** lekë, pra në total në vlerën **4,815,511,001** lekë Nga këto në vitin 2016 janë likujduar fatura në vlerën **2,256,957,143** lekë, duke mbetur në fund të vitit me datë 31.12.2016 detyrime ndaj furnitorëve për fatura të palikujduara për investime të kryera në vlerën **2,558,553,858** lekë.

Nga këto për 11 furnitorë, faturat e prapambetura janë trashëguar që nga viti 2015 me vlerë **186,918,445** lekë, për të cilat nuk janë kryer likujdime as në vitin 2016, dhe as në vitin 2017, pasi nuk është ndjekur radha FIFO e pagesave, duke mbetur kështu si detyrime të prapambetura të palikujduara deri në datën 31.12.2017 në kundërshtim me UMF nr.2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit” pika 101. Rastet paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Kodi	Emertimi i Furnitorit	Gjendja 31.12.2015	Gjendja 31.12.2015 + shtesa 2016	Pagesa 2016	Detyrimi 31.12.2016	Pagesa 2017	Detyrimi 2017
K26.5	Ndertim i rrugës Gramoz Pashko - BE - IS shpk	45,549,836	45,549,836	-	45,549,836		45,549,836
K82.5	Rikostruksion Rr.Agush Gjergjevica - Fusha shpk	45,108,263	45,108,263	-	45,108,263		45,108,263
K30.6	Rikualifikim urban i bllokut nr.91- Bean sh.p.k	26,599,558	26,599,558	-	26,599,558		26,599,558
K77.5	Ndertimi kanalit & rruges Rr.DalipTopi-Bami shpk	18,169,887	18,169,887	-	18,169,887		18,058,726
K76.5	Ndertimi i bulevardit Petro Nini Luarasi - Ermiku	13,567,168	13,567,168	-	13,567,168		13,567,168
K118.5	M991221-Ndertimi i Rr. Pandi Stilla - Curri shpk	10,807,367	10,807,367	-	10,807,367		10,807,367
F0492	Kirberger Albania sh.p.k	9,385,020	9,385,020	-	9,385,020		9,385,020
K80.5	Ndertim i rruges Brigada VIII - Everesti shpk	6,009,273	6,009,273	-	6,009,273		6,009,273
F0336	Al Projekt Group	5,868,000	5,868,000	-	5,868,000		5,868,000
K78.5	Ndertim i rruges Pjeter Bogdani - Ndertuesi shpk	4,965,234	4,965,234	-	4,965,234		4,965,234
FA85	Apenin sh.p.k	1,000,000	1,000,000	-	1,000,000		1,000,000
	<b>Totali:</b>	<b>186,918,445</b>	<b>186,918,445</b>		<b>186,918,445</b>		<b>186,918,445</b>

Për 8 furnitorë të marrë si kampion nisur nga kartelat kontabël të tyre u kryen teste të detajeve për faturat e secilit furnitor rezultoi se per to ekzistojnë dokumentacioni bazë dhe justifikues.

Nga testimi dhe analiza e detajuar të kartelave kontabël të llogarive të furnitorëve rezultoi se :

Në fund të vitit ushtrimor 2015 nga reforma territoriale në Bashkinë Tiranë , janë trashëguar nga ish-komunat detyrime të konstatuara për energji dhe ujë të paraqitura dhe në Bilanc e të shoqëruara me dokumentacion vërtetues (fatura) e akt-rakordime me institucionet përkatëse, të cilat deri në fund të vitit ushtrimor 2016 janë likujduar, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Emertimi i Debitorve (NJA + Bashki) per UKT	Gjendja 31.12.2015	Likujduar detyrime te NJA dhe Bashkise Tirane	Gjendje me detyrim i papaguar 31.12.2016
1	NJ17 Ujësjetllës Kanalizime Janar-Korrik 2015 Njesia Krrabe	896,039	896,039	
2	NJ10 Ujësjetllësi kanalizime qershor -korrik 2015 njesia 10	104,280	104,280	
3	NJ16 - Ujësjetllës Kanalizime sha janar - dhjetor 2013 nj.admin.Berzhite	2,005,920	2,005,920	
4	NJ16 - Ujësjetllës Kanalizime sha janar - dhjetor 2014 nj.admin.Berzhite	2,815,200	2,815,200	
5	NJ16 - Ujësjetllës Kanalizime sha janar - maj 2015 nj.admin.Berzhite	1,117,872	1,117,872	
6	NJ22 - sherbim uji njesia Pezë viti 2013-2014	129,990	129,990	
7	NJ16 - Ujësjetllës Kanalizime shtator 2015 njesia Berzhite	265,536	265,536	
8	Nj17 - Ujësjetllës per gusht 2015, tetor 2015 njesia Krrabe	249,106	249,106	
9	NJ10 - Ujësjetllës kanalizime diference muaji qershor korrik gusht 2015	41,340	41,340	
10	NJ13 ujë muaji korrik-dhjetor 2015 njesia Farke	5,805,216		5,805,216
11	NJ22 sherbim uji detyrime 2015 njesia Peze	86,490	86,490	
12	NJ10 sherbim uji Qershor -Gusht 2015 njesia 10	16,740	16,740	
13	Nj14 Ujësjetllës Kanalizime sh.a ,ujë njesia Dajt	2,498,400	2,498,400	
14	NJA + BASHKIA nëntor , dhjetor 2015	8,680,095	8,680,095	
15	NJ10 sherbim uji muaji prill njesia 10			7,321
16	Nj26 ( P.M.N.Z.SH ) UKT sh.a, ujë dhjetor 2016			3,698,800
	<b>Totali</b>	<b>24,712,224</b>	<b>18,907,008</b>	<b>9,511,337</b>

Gjendja në fund të vitit 2016 për detyrime për ujësjetllësin është në shumën 9,511,337 lekë, e cila paraqet detyrimin për muajin dhjetor të vitit 2016 të Bashkisë dhe NJA, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Emertimi i Debitorve (NJA + Bashki) per OSHEE	Gjendja 31.12.2015	Likujduar detyrime te NJA dhe Bashkise Tirane	Gjendje me detyrim i papaguar 31.12.2016
1	Njesia Berzhite te prapambetura	72,856	72,856	
2	Njesia Krrabe	0	-	
3	Detyrim Bashkia nëntor 2015	660,498	660,498	
4	Detyrim Bashkia + NJA dhjetor 2015	17,794,476	17,794,476	
5	Detyrim Bashkia + NJA dhjetor 2016			11,234,587
6	Oshee, lidhje e re energjie shkolla 9- vjecare, Rr. Selaudin Bekteshi			888,437
	<b>Totali</b>	<b>18,527,830</b>	<b>18,527,830</b>	<b>12,123,024</b>

Gjendja në fund të vitit 2016 për detyrime ndaj OSHEE është në vlerën 12,123,024 lekë e cila përfaqëson detyrimet e muajit dhjetor të vitit 2016 për Bashkinë Tiranë dhe NJA dhe një detyrim për shtesë fuqie për energji elektrike në shkollën 9-vjecare në rrugën “Selaudin Bekteshi” në NJA nr.4

Për detyrimet e energjisë dhe ujësjetllësit janë kryer veprimet kontabël: në debi të llog.6022 “Sherbime nga te trete për ujë dhe energji” në kredi të llog. 401 “Furnitorë për shërbime” dhe për pagesat në debi të llog. 401 “Furnitorë për shërbime“ në kredi të llog.520 “Disponibilitete në thesar”.

- **Gjendja e llogarisë 42 “Personeli e llogari të lidhura me to”** në vlerën kontabël 85,822,293 lekë, paraqet vlerën sipas listë pagesave të punonjësve të muajit dhjetor 2016 për pagat që do të paguhen në janar të vitit pasardhës.

- **Gjendja e llogarisë 431 “Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksat”** në bilanc paraqitet në vlerën kontabël 47,655,982 lekë, e cila e analizuar paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Pershkrimi i Veprimit	Gjendja 31.12.2015	Paksime (Debi)	Shtesa (Kredi)	Gjendja 31.12.2016
Tatimi mbi paga për listpagesat e muajit dhjetor 2016	4,621,212	67,168,515	69,167,538	6,620,235
Tatime te tjera, nga pagesa individesh, honorare,etj.	4,243,310	15,639,703	21,240,355	9,843,962
Takse pulle Bashkia Tirane + NJA	9,664,550	51,121,158	53,415,000	11,958,392
Tat. mbi te Ardhurat nga Punesimi (detyrim + Gjoha + Interes)	17,507,239			17,507,239
Taksa kombetare te papaguara (Detyrim + gjoha + interesa)	815,724			815,724
Tatim i Mbajtur ne Burim (detyrim + gjoha + interesa)	910,430			910,430



<b>Totali</b>	<b>37,762,465</b>	<b>133,929,376</b>	<b>143,822,893</b>	<b>47,655,982</b>
---------------	-------------------	--------------------	--------------------	-------------------

- **Gjendja e llogarisë 435 "Sigurime shoqërore"** paraqitet në bilanc në vlerën kontabël 70,227,946 lekë, e cila përbëhet nga detyrime për sigurimet e pa derdhura për muajin dhjetor 2016 për vlerën 24,997,461 lekë dhe detyrimeve prej 45,230,485 lekë të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të pa derdhura nga ish komunat dhe njësitë bashkiake para viteve 2015. Analiza e tyre paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Pershkrimi i Veprimit	Gjendja 31.12.2015	Paksime (Debi)	Shtesa (Kredi)	Gjendja 31.12.2016
Sigurime shoqërore, te vitit ne vazhdim	21,351,085	267,295,883	270,942,259	24,997,461
Sig. shoq.e shendet. te papaguar (Detyrim + gjoba + interesa)	45,150,545	25,073	105,013	45,230,485
<b>Totali</b>	<b>66,501,630</b>	<b>267,320,956</b>	<b>271,047,272</b>	<b>70,227,946</b>

- **Gjendja e llogarisë 436 "Sigurime shëndetësore"** paraqitet në bilanc në vlerën kontabël 5,522,234 lekë, e cila përbëhet nga detyrime për sigurimet shëndetësore të pa derdhura për muajin dhjetor 2016 për vlerën 3,490,187 lekë dhe detyrimeve prej 2,032,047 lekë të kontributeve të sigurimeve shëndetësore të pa derdhura nga ish komunat dhe njësitë bashkiake para viteve 2015. Analiza e tyre paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Pershkrimi i Veprimit	Gjendja 31.12.2015	Paksime (Debi)	Shtesa (Kredi)	Gjendja 31.12.2016
Sigurime shëndetësore, te vitit ne vazhdim	2,996,045	36,963,781	37,457,923	3,490,187
Sigurime shëndetësore (Detyrim + gjoba + Intersa)	2,017,178		14,869	2,032,047
	<b>5,013,223</b>	<b>36,963,781</b>	<b>37,472,792</b>	<b>5,522,234</b>

**Konkluzion:** Nga testimi i llogarive të detyrimeve afatshkurtra në lidhje me derdhjen e kontributeve rezultoi se janë trashëguar detyrime në vlera të konsiderueshme për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe të tatimit mbi ardhurat personale, të cilat nuk ishin të pasqyruara nga ish-komunat dhe ish-Njësitë bashkiake në bilanc. Këto detyrime në fund të vitit 2015 me konsolidimin e bilancit të Aparatit të Bashkisë bashkë me njësitë e shkrira janë azhurnuar në kontabilitet dhe janë pasqyruar në bilanc si detyrime në vlerën 66,401,116 lekë. Në vitin e 2016 ndryshimet për paksime e shtesa është në vlerën 94,809 lekë dhe gjendja e tyre më 31.12.2016 paraqitet në vlerën 66,495,925 lekë. Të dhënat në mënyrë të detajuar sipas llogarive dhe NJA+ Bashki paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Emertimi programeve	Llog.4314 "Tatim mbi te Ardhurat nga Punesimi"	Llog.4315 "Taksa kombetare" (pulla Gj.Civile)	Llog.4316 "Tatim i Mbajtur ne Burim"	Llog. 4354 "Sigurime shoqërore e shendet."	Llog. 4364 "Sigurime shendet"	Total Gjendja 01.01.2016	Total Pakesime 2016	Total Shtesa 2016	Total Gjendja 31.12.2016
	Gjendja 31.12.2016	Gjendja 31.12.2016	Gjendja 31.12.2016	Gjendja 31.12.2016	Gjendja 31.12.2016				
Bashkia	207,357	60,878	-	607,983	14,869	796,278	25,073	119,882	891,087
NJ01	1,723,488	144,540	30,000	4,018,594	10,944	5,927,566			5,927,566
NJ02	42,169	31,492	99,945	7,165	12,722	193,493			193,493
NJ03	5,830	10,000	86,786		10,000	112,616			112,616
NJ04		147,832	79,623	9,369	10,511	247,335			247,335
NJ05	6,178,908			16,727,632	10,000	22,916,540			22,916,540
NJ06	11,532			77,949	10,000	99,481			99,481
NJ07	46,189	40,000	30,000	44,706	10,000	170,895			170,895
NJ08			74,024	30,689	10,912	115,625			115,625
NJ09	84,951	20,000		142,300	11,001	258,252			258,252
NJ10	10,000	10,000	52,257	7,220	10,996	90,473			90,473
NJ11		30,000	30,000		10,000	70,000			70,000
NJA Baldushk	21,602	73,911	90,000	295,838	20,514	501,865			501,865
NJA Berzhite	29,703	10,000	20,568		11,161	71,432			71,432
NJA Dajt		10,000	10,000	629,588	12,036	661,624			661,624
NJA Farke		32,226	50,000	153,512	1,008	236,746			236,746
NJA Kashar	158,509	10,220	10,000	331,265	21,807	531,801			531,801
NJA Krrabe	21,834	10,000	20,000	247,678	31,294	330,806			330,806
NJA Ndroq	7,513,999	50,000	70,000	21,173,732	1,750,145	30,557,876			30,557,876
NJA Petrele	1,418,873	-	-		-	1,418,873			1,418,873

NJA Peze	11,113	50,000	74,369	99,170	10,576	245,228			245,228
NJA Shengjegj	1,217	40,000	37,417	223,894	10,218	312,746			312,746
NJA Vaqarr	19,965	2,088		86,469	10,801	119,323			119,323
NJA Zall-Bastar		30,000	35,441	10,299		75,740			75,740
NJA Zall-Herr		2,537	10,000	305,433	20,532	338,502			338,502
<b>Total</b>	<b>17,507,239</b>	<b>815,724</b>	<b>910,430</b>	<b>45,230,485</b>	<b>2,032,047</b>	<b>66,401,116</b>	<b>25,073</b>	<b>119,882</b>	<b>66,495,925</b>

- **Gjendja e llogarisë 464 “Detyrime për t’u paguar për blerjen e letrave me vlerë”** paraqitet në bilanc pa ndryshime si për vitin ushtrimor 2015 dhe për vitin ushtrimor 2016 në vlerën 50,400 lekë e cila përfaqëson vlerën për bileta tregu të NJA nr.4 të mbetura gjendje që nga viti 2012 në këtë njësi.

Për këtë vlerë janë kryer veprimet kontabël:

- **Gjendja e llogarisë 4341 “Te tjera operacione me shtetin (kreditor)”** në fund të vitit 2016 paraqitet në vlerën 343,811,578 lekë, e cila në analizë paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Pershkrimi i Veprimit	Gjendja 31.12.2016
Ndalesa per detyrime te punonjësve te viteve te mëparshme	1,717,046
Debitore ndryshem - viti ne vazhdim	329,352,741
Programi ZHEP	10,000,000
Debitor per detyrime PIU	2,741,791
<b>Totali</b>	<b>343,811,578</b>

- **Gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”**, sipas bilancit në fund të vitit 2016 paraqitet në shumën **84,261,447 lekë**, e cila e analizuar paraqitet në tabelën në **Aneksin nr.3** të bashkëlidhur këtij Akt-konstatimi.

U përzgjedhën 3 raste pagesash në muajin dhjetor të vitit 2016 për pagesa garanci 5 % të punimeve nga ku rezultoi se pagesat ishin kryer në bazë dokumentacioni të plotë si aktit të kolaudimit dhe aktit të marrjes në dorëzim të objektit të investimit.

- **Gjendja e llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”** më datë 31.12.2016 është në vlerën **2,659,028,118 lekë**. Analizat e gjendjes së kësaj llogarie dhe veprimet kontabël paraqiten më poshtë:

- Gjendja e llog.467 “Kreditorë të ndryshëm “është në vlerën **vlerën 289,846,290 lekë Sipas** e kartelës kontabël të kësaj llogarije për **vendimet e gjykatave** është kredituar llog.467 “Kreditorë të ndryshëm” në debi të llog.6027 “Shpenzime per detyrime e kompensime legale”

Nga të dhënat e analizave të kontabilitetit rezulton se janë 123 vendimet gjyqësore të formës së prerë, si detyrim për tu paguar, për të cilat ka dalë Urdhri I Kryetarit të Bashkisë për ekzekutim. Analiza e llog.467 “Kreditorë të ndryshëm” për Vendimet e Gjykatave gjendje të palikujduara të marrë nga databazë e hartuar sipas formatit të miratuar nga MFE paraqitet në tabelën në **Aneksin.4** bashkëlidhur këtij Akt-konstatimi.

Në bazë të urdhrave lind detyrimi dhe bëhet kontabilizimi.

**Për urdhrin e kryetarit** është bërë veprimi kontabël në debi të shpenzimeve 6027 “Shpenzime per detyrime dhe kompensime legale” (sipas tipologjisë së v.gj.) dhe në kredi të llog.467 “Kreditorë te ndryshem”.

**Për pagesën e kësteve** është kryer veprimi kontabël: në debi të llog.467 “Kreditorë te ndryshem” në kredi të llog.520 “Disponibilitete në thesar”

Likuidimet e vendimeve gjyqësore janë bërë sipas urdhrave të Kryetarit të bashkisë, duke ndjekur radhën e vitit të krijimit të detyrimit (momenti i daljes së Urdhrit). Në fund të vitit 2016, Urdhrat e Titullarit të viteve 2012 edhe 2013 për vendimet gjyqësore pothuajse janë në përfundim likuidimi.

Nga testet analitike të kryera për përlllogaritjet e detyrimeve për 6 kampionë të përzgjedhur nga databaze, ku 3 raste për pagesa të kryera dhe 3 raste për detyrime të lindura por të papaguara, nga ku dhe rezultoi se dokumentacioni është i plotë dhe detyrimi është vendosur sipas V.Gj. e në rastet e detyrimeve për dëmshpërblim me paga ishin bërë llogaritjet e sakta si dhe ishin respektuar tarifat e miratuara ligjore per pagesat e studiove përmbarimore.

**Konkluzion:** Detyrimet për vendimet e gjykatave janë në vlerë të konsiderueshme prej **289,846,290 lekë** dhe janë krijuar në harkun kohor vitet 2007-2016. Nga të dhënat e tabelës analitike të paraqitur në Aneksin nr.4 sipas formatit të miratuar nga MFE për detyrimet për vendimet e gjykatave rezulton se dalja e urdhrave nga Titullari i Bashkisë në 23 raste në vlerën 38,053,801 lekë nxjerrja e urdhrat për pagesë është bërë me dy e tre vjet vonesë nga Urdhri i ekzekutimit të përbarimit, pa llogaritur datën e Vendimit Gjyqësor në kundërshtim me Udhëzimin e Këshillit të Ministrisë nr.1 datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të Njësive të Qeverisjes së përgjithshme në llogari të Thesarit”. Kështu p.sh.:

TABELA E VENDIMEVE GJYQESORE DERI NE DATEN 31.12.2016												
	Emri i kreditorit	TIPO LOGJIA	URDHERI KRYETARIT BASHKISE		i VENDIMI I GJYKATES SE APELIT OSE TE LARTE		URDHER EKZEKUTIMI		Zyra Perbarimore	VLERA MBETUR	VLERA PERMBARUESIT	TOTAL DETY+PERMB DT.31.12.2016
			NR	DATE	NR	DATE	NR	DATE				
3	ZYBER KAMBERI	D.pasuror	5025	23.09.2013	3216	02.05.2007	2235	29-07-2008	Suana Anamali	4.528.315	0	4,528,315
4	Familja "Degjoni"	D.pasuror	440	11.04.2013	5094	29.06.2007	2183	17-07-2008	Anastas Kote	1.450.000	283.303	1,733,303
5	ARJAN SUKNIQI	page	681	25.05.2013	13	11.01.2008	4252	23-11-2009	Julian Ahmeti	-	41.760	41,760
3	ZYBER KAMBERI	D.pasuror	5025	23.09.2013	3216	02.05.2007	2235	29-07-2008	Suana Anamali	4.528.315	0	4,528,315
4	Familja "Degjoni"	D.pasuror	440	11.04.2013	5094	29.06.2007	2183	17-07-2008	Anastas Kote	1.450.000	283.303	1,733,303
5	ARJAN SUKNIQI	page	681	25.05.2013	13	11.01.2008	4252	23-11-2009	Julian Ahmeti	-	41.760	41,760
17	GEZIM SEITI	page	11392	11.11.2013	4182	24.05.2010	5092	30-09-2011	E.P.S.A.shpk	101.000	45.424	146,424
22	PETRIT PECANI	Shp. demi	12704/1	13.12.2013	756	27.02.2011	7318	16-12-2011	Pa Permbarues		50.950	50,950
25	Petraq Salavaci	Dorz sendi	12771/1	24.09.2014	4990	10.06.2011	587	05-02-2013	Alketa Tanushi	-	96.768	96,768
32	REXHEP ÇOKAJ	page	6448	02.05.2014	8695	24.07.2012	9547	24-11-2011	Rigels Bejko	-	31.200	31,200
41	S. e B.BAJRO	Sh.trualli	554/1	14.01.2015	461	04.03.2008	1305	07.05.2008	Anastas Kote	1.050.000	172.304	1,222,304
42	MEMO MALAJ	Sh.demi	2086/1	06.02.2015	381	16.10.2014	3567	11-06-2013	Dorian Skenderi	-	39.090	39,090
43	K. Grillo J. Varfi	K.sendi	2087/1	06.02.2015	2560	24.09.2013	5141	02.07.2007		20.640.261	1.350.284	21,990,545
46	ERORDA SH.P.K	Anul.Adm	2092/1	06.02.2015	5/6	07.12.2012	10014	18-10-2012	Ilir S.Dervishaj	-	10.000	10,000
53	Vodafone Albania	kontrat	6499/2	22.07.2015	183	22.04.2015	3601	06-06-2013	Enuar Merko	19.681	64.009	83,690
59	NERTIL JOLE	page	15078/1	16.10.2015	1294	29.04.2015	82	07-06-2012	Alban Ruli (ARB)	-	123.283	123,283
62	Bujar Tafani	page	36201	24.11.2016	5989	11.06.2012	11287	23.11.2012	Ermir Godaj	392.300	37.456	429,756
63	Hamza Peci	page	36201	24.11.2016	9976	23.10.2012	994	26.02.2013	Bailiff Services	210.000	24.000	234,000
109	Arjan Fagu	page	28564/2	22.11.2016	2287	20.10.2011			Igli Gugashi	-	18.000	18,000
110	Muharrem Rama	page	27802/3	22.11.2016	1670	19.07.2013			Helidon Xhindi	-	38.583	38,583
116	Artan Hasanaj	page	34908/2	20.12.2016	1633	17.07.2013	5445	19.09.2013	Debit Collectio	822.000	51.293	873,293
93	KRENAR REXHEP	page	12846	27.04..2016	3139	17.07.2014	6698	17.12.2014	Kodra Bailiff Serv	-	574	574
94	ALMA KOSTURI	page	7661/1	23.03.2016	437	20.11.2014	230	28.01.2014	Z Perm Tirane	-	58.585	58,585

Nga të dhënat e databaze të Drejtorisë Juridike, dokument ky I cili nuk ishte mbajtur sipas formatit të miratuar, rezultojnë edhe 124 Vendime Gjyqësore të formës së prerë që presin ndjekjen e procedurave për ekzekutim, trajtuar në raportimin financiar të vitit 2018.

- Llogarija 467 është kredituar për shpronësimet publike në vlerën **2,152,738,073 lekë** në debi të llog. 2310 “Shpenzime, Troje”.

Tabela analitike e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm për shpronësime”

Pershkrimi VKM	Gjendja 31.12.2015	Shtesa në vitin 2016	Likujdime nga Bashkia	Likujdime nga Min.Fin e MZHU	Vlera e mbetur 31.12.2016
V.K.M 752, dt 5.9.2013 Bul. Veri e Rehab. Lum Tiran (Faz E I, ne B. Tirane) Truall Nr. 752, dt. 5.9.2013	844,853,879	140,189,434	10,140,276	185,380,044	789,522,993
V.K.M 752, dt.5.9.2013 Bul. Veri e Rehab. Lum Tiran (Faza E I, ne B. Tirane) Objekt Nr. 752, Dt5.9.2013	776,243,677	40,570,190	122,842,161	357,601,470	336,370,236
V.K.M Nr 785 Dt 14.11.2012 Lik. Shpron Publ Shtrat Lanës e Nd.					

Rr. Paralele(Seg.nga Matern.Ri në Gjat. 400 M Kundër Lanës)	33,908,055		15,000,000		18,908,055
V.K.M Nr 761 Dt 07.11.2012 Lik. Shpron, Interes Publ, Preken nga Sist. Rr.e Lulisht.në dyja anët E Rr. Kombinat, në BashkiTiranë	51,488,426		20,000,000		31,488,426
V.K.M Nr 152 Dt 19.03.2014 Rehab. Zgjer.Varrez Tufin Faza III	4,851,798				4,851,798
V.K.M Nr 152 Dt 19.03.2014 Rehab. Zgjer.Varrez Tufin Faza IV	5,187,840				5,187,840
V.K.M Nr 152 Dt 19.03.2014 Rehab. Zgjer.Varrez Sharre Faza IV	2,236,416				2,236,416
V.K.M Nr 408 Dt 27.06.2012 Shpron Trualli Nd. E Seg Rr. e Bulev B. Curri - Rr. A. Demi	5,102,229		4,875,529		226,700
V.K.M Nr 767 Dt 16.09.2015 Lik. Shpron, Interes Publ, Pronarë të Pasuri Paluajt, Preken nga Nd. Rr. " B Allaraj "Në B. Tiranës	10,859,100				10,859,100
V.K.M Nr 793 Dt 22.09.2015 Lik. Shpron, Interes Publ, Pronarë të Pasuri Paluajt, Preken nga Rik.I Rr. Te Bllokut Nr51 Rr. D. Bosk	223,311,325				223,311,325
V.K.M Nr 665 Dt 22.07.2015 Lik. Shpron, Interes Publ, Pronarë të Pasuri Paluajt, Preken nga Nd. Rr. "Robert Shvarc " Në B. Tiranë	944,706		854,734		89,972
V.K.M Nr 665 Dt 22.07.2015 Lik. Shpron, Interes Publ, Pronarë të Pasuri Paluajt, Preken nga Nd. Bllokut Nr 46 Në B. Tiranës	6,683,742		6,683,742		-
V.K.M Nr 665 Dt 22.07.2015 Lik. Shpron, Interes Publ, Pronarë të Pasuri Paluajt, Preken nga Nd. Rr. Kosovar " Në B. Tiranës	83,403,960		65,000,000		18,403,960
V.K.M Nr 768 Dt 16.09.2015 Shpron, Interes Publ, Pronarë të Pasuri Paluajt, Preken nga Rik.I Rrugës "Pasho Hysa " Në B. Tira	53,024,076		20,000,000		33,024,076
V.K.M Nr 771 Dt 16.09.2015 Shpron, Interes Publ, Pronarë Paluajt, Preken nga Nd. I Bulev "Petro N.Luarasi " Në B.Tiranës	2,867,725		2,749,903		117,822
V.K.M Nr 769 Dt 16.09. 2015 Shpron, Interes Publ, Pronarë Paluajt, Preken nga Rik. Rr. Se "Filantos " Në B.Tiranës	2,110,017				2,110,017
V.K.M Nr 1041 Dt 16.12.2015 Shpron, Interes Publ, Pronarë Paluajt, Prek nga Nd. I Infrac Bllok 61 Kufiz Rr. "Q. Stafa" e Rr.E Pl. Rreg e Nd. e Mob Urb i Sip. Zon 61/1 Në B. Tiranës	222,520,451		92,044,000		130,476,451
V.K.M Nr 1040 Dt 16.12.2015 Shpr, Interes Publ, Pronarë Paluajt, Prek Rik . bllok 59 , kufiz B.Curri e Rr A. demi e Rr.PL.RR	44,059,821		22,000,000		22,059,821
VKM 770 dt 16.09.2015 Shpron, Interes Publ, Pronarë Paluajt, Prek Sist Rik infrast, mes Rr."S.Themel", "B. Rexha" e "N.Mjed", BT		583,380			583,380
VKM 236 dt. 30.3.2016 shpronësime detyrim i MZHU		572,997,987		126,005,130	446,992,857
VKM 286, datë 13.4.2076/1 shpron 16 per vlera pa konf MZHU		85,945,757		10,028,922	75,916,835
<b>TOTAL</b>	<b>2,373,657,242</b>	<b>840,286,748</b>	<b>382,190,345</b>	<b>679,015,566</b>	<b>2,152,738,079</b>

Nga verifikimi i kartelave kontabël për llogarinë 467 "Kreditorë të ndryshëm për shpronësime" rezulton se janë bërë veprime sistemimi për kontabilizime gabim si më poshtë:

Për VKM 752, dt 5.9.2013 "Për Shpronësimin Publik të Pronarëve që preken nga ndërtimi objektit Bulevardi Verior e Rehabilitimi i Lumit të Tiranës" vlera 290,142,599 lekë (shpronësim trull) është kontabilizuar më tepër dy herë në vitin 2015, ndërsa vlera 181,589,896 lekë (shpronësim objekti) është kontabilizuar dy herë në vitin 2016. Po kështu dhe vlera 2,702,631 lekë për VKM Nr. 1041 dt 16.12.2015 "Për Shpronësimin Publik të Pronarëve që preken nga ndërtimi i Infrastrukturës se Bllokut 61 që kufizohet nga rruga "Q. Stafa "dhe Nderim-Mobilimi Urban i Sipërfaqes të Zonës 61/1" është kontabilizuar gabim dy here në vitin 2016. Për këto vlera që janë pjesë e gjendjes kreditore të llog.467 "Kreditorë të ndryshëm" në 31.12.2016 (në debi të llog.231 "Shpenzime në proces për rritjen e AQT-ve për shpronësime) janë kryer sistemimet me fletë

kontabël në mbyllje të vitit 2017, duke kryer veprimet kontabël për secilën nga vlerat: Në debi të llog. 467 “Kreditorë të ndryshëm për shpronësime” në kredi të llog.231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT-ve për shpronësime” për vlerën në total 474,435,126 lekë.

Nga testimi i katër transaksioneve të kryera për shpronësim të dy VKM nr.785 dhe VKM nr.152 të marra si kampion për qytetarë të ndryshëm që përfitojnë fonde për shpronësim u verifikuan dosjet e dokumentacionit, nga ku rezultoi se dokumentacioni ishte plotësuar sipas kërkesave të vendimeve dhe pagesat ishin kryer konform rregullave financiare.

- **Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”** është kredituar për **bonus fëmijë të sapolindur në vlerën 211,200,000 lekë** (nga BT në vlerën 111,105,000 lekë dhe Ministria e Brendshme në vlerën 100,095,000 lekë) në debi të llog. 6061 “Transferte per fëmijë te lindur”,. detyrime të akumuluar nga Bashkia Tiranë dhe NJA për një periudhë 2012-2016, për moslikujdime për mungesë fondesh.

Tabela e llogarisë 467 për “Kreditorë të tjerë”:

Nr.	Pershkrimi veprimit	Gjendja 31.12.2016
7	Detyrim Bashkia Tirane :Bonuse te porsalindurve nga 2012 deri 2016	111,105,000
8	Detyrim Ministria e Brendshme Bonuset e bebeve per NJA viti 2012-2016	100,095,000
<b>Totali</b>		<b>211,200,000</b>

- Ndërsa për **vlerën 5,243,755 lekë të kreditorëve të tjerë** është kredituar llog. 467 “Kreditorë të ndryshëm” në debi të llogarive: 6061 “Te tjera transferta tek individët per veteranet e luftës” për detyrime për shpenzime varrimi veteranë luftime (LANÇ), llog. 6029 “Shpenzime per honorarë” shpërblim për ndërlidhja me komunitetin (kryepelq) të NJA, llog. 6061 “Shpenzime per situata te vështira dhe per fatkeqësi” për ndihmë për fatkeqësi për punonjës të bashkisë, etj.

Tabela e llogarisë 467 për “Kreditorë të tjerë”:

Nr.	Pershkrimi veprimit	Gjendja 31.12.2016
1	Honorar nderlidhja detyrime vitet 2011, 2012, 2013 dhe 2014 NJA - Berzhite	2,498,684
2	Honorare keshilli bashkiak viti 2016	895,900
3	Nderlidhjes me komunitetin dhjetor 2016	1,511,841
4	Detyrime Sig.shoqerore per Libreze e sigurimeveviti 2011+2012	7,330
5	Veterane luftime (shpenzime varrimi per LANÇ)	300,000
6	Ndihme ekonomike ne rast fatkeqesie A. Ymeri, Uk 38734/1 dt 23.12.2016	30,000
	<b>Shuma</b>	<b>5,243,755</b>
7	Detyrim Bashkia Tirane :Bonuse te porsalindurve nga 2012 deri 2016	111,105,000
8	Detyrim Ministria e Brendshme Bonuset e bebeve per NJA viti 2012-2016	100,095,000
<b>Totali</b>		<b>216,443,755</b>

- Në formatin nr.3/1 “Shpenzime të ushtrimit 2016” në rubrikën operacionet e korrigjimit të rezultatit llogaritë paraqiten:

61	82,83,84	D. OPERAC.KORIGJ.REZULTATIT	5,816,085,161.36	5,095,411,116.03
62	828	Tituj te ardhurash te anuluar		
63	831	Caktim te ardh.funks.per investime	3,444,519,908.49	3,386,420,318.80
64	8,420	Derdhje te ardhura ne buxhet		169,489,121.00
65	8,421	Derdhje buxhet te ardhurave pa perdorura	2,067,864,498.20	373,849,766.50
66	8,422	Transferim te ardhurave brenda sistemit	251,548,841.20	1,079,244,202.00
67	8,423	Transferime per ndrysh gjendje	52,151,913.47	86,407,707.73
68	8,424	Transferim per debitore te konstatuar e te ngjashme		
<b>69</b>	<b>Klasa 6 e 8</b>	<b>TOTALI OPERACIONEVE</b>	<b>11,669,423,790.50</b>	<b>8,646,067,193.92</b>

- Llogaria 8421 “Transferim ne buxhet te ardhurave te pa perdorura” në vlerën 2,067,864,498 lekë e përbërë nga fonde të papërdorura, të kushtëzuara në vlerën 69,948,341 lekë plus tre transfertat të pakushtëzuara, specifike dhe FZHR në vlerën 1,997,916,157 lekë që përfaqësojnë atë pjesë të ardhurave që i përket institucionit për t’u përdorur deri në fund të vitit por nuk e ka përdorur për

vitin buxhetor 2016. Për këto vlera është bërë veprimi kontabël debi llog.8421 “Transferim ne buxhet te te ardhurave te pa perdorura” dhe kredi të llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar”.

- Llogaria 8422 “Transferim të të ardhurave brenda sistemit” në vlerën 251,548,841 lekë është e përbërë nga kthimi të ardhurave të autorizuar të bashkisë Tiranë të papërdorura nga Aparati Bashkisë si njësi vartëse. Pra evidenton transferimin e të ardhurave nga institucioni i vartësisë për qendrën që përbën diferencën e te ardhurave te autorizuar nga qendra dhe të ardhurave të përdorura për shpenzim. Kontabilizimi ka filluar me autorizimin për përdorim të fondeve për shpenzime duke debituar llog. 520 “Disponibilitete ne thesar” në kredi të lloga. 476 “Të ardhura të caktuara për t’u përdorur”, Gjatë vitit ushtrimor llogaria 520 “Disponibilitete ne thesar” është kredituar për gjithë pagesat e kryera (pra përdorimi fondeve) në debi të llogarive të shpenzimeve sipas destinacionit. Në mbyllje kjo llogari është debituar për diferencën e fondeve të autorizuar me fondet e përdorura, pra për gjendjen e fondeve të pa përdorura duke debituar llogaritë 8421 “Transferim ne buxhet te te ardhurave te pa perdorura” dhe 8422 “Transferim të të ardhurave brenda sistemit”.

Shuma e papërdorur nga granti i pakushtëzuar që trashëgohet për autorizimet buxhetore për përdorim si për shpenzimet buxhetore korente dhe ato kapitale, janë bërë transfertë nga njësia në buxhet, konstatuar nga verifikimi i akt rakordimit vjetor të thesarit për treguesit e realizimit të buxhetit në Formatin nr. 3/1 “Shpenzime te ushtrimit 2016” në operacionet e korrigjimit të rezultatit” si dhe krahasuar me formatin nr.5 “Pasqyra e lëvizjes në cash viti 2016” rubrika IV “Transferta” të paraqitur më lart.

Kontabilizimet në këtë format janë kryer në bazë të përmbledhëses së hartuar në fund të vitit mbështetur në aktrakordimet me degën e Thesarit Tiranë në fund të vitit ushtrimor. Mbi bazën e tabelës së mëposhtme janë prerë artikujt kontabël të përshkruara më lart.

<b>Për llogaritjet e kryera</b>	
<i>Për tu transferuar ne Buxhet (F.te Kushtezuara)</i>	69,948,341
<i>Për tu mbartur në Bashki ( Transfeta e Pakushtezuar)</i>	10,877,434
<i>Për tu mbartur ne Bashki (Transferta specifike)</i>	134,453,547
<i>Për tu mbartur nga Ministria e Financave (Transferta e FZHR infrastruktura rrugore)</i>	1,852,585,176
<b>Shuma (F.Kushtëzuara + Transferta specifike + FZHR)</b>	<b>2,067,864,498</b>
<i>Për tu mbartur ne Bashkia (të Ardhurat e veta)</i>	251,345,948
<i>Për tu mbarur në Bashki (Të ardhurat jashte limitit)</i>	55,664
Memo kredi Bashkia Tirane Kthim paga nentor 2015	147,229
<b>Shuma e të ardhurave të veta të pa përdorura derdhur në buxhet</b>	<b>251,548,841</b>
<b>Totali</b>	<b>2,319,413,339</b>

Me mbylljen e vitit buxhetor 2016 është hartuar dhe dërguar ne Ministrinë e financave raportimit vjetor mbi përdorimin e fondeve për vitin 2016, I cili paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Emertimi	Plani	Çelja	Fakti	Diferenca
<i>Fonde të kushtëzuara</i>	2,788,623,488	2,788,623,488	2,718,675,147	69,948,341
Fonde te Kushtezuara Ministria 04	3,874,524	3,874,524	3,154,825	719,699
Fonde te Kushtezuara Ministria 06	990,913	990,913	-	990,913

Fonde te Kushtezuara Ministria 11	276,879,355	276,879,355	218,453,063	58,426,292
Fonde te Kushtezuara Ministria 16	183,729,114	183,729,114	174,314,811	9,414,303
Fonde te Kushtezuara Ministria 25	2,319,746,742	2,319,746,742	2,319,349,608	397,134
Fonde te Kushtezuara Ministria 94	3,402,840	3,402,840	3,402,840	-
<b>Fonde të pakushtëzuara</b>	<b>1,236,572,591</b>	<b>1,231,341,957</b>	<b>1,220,464,523</b>	<b>10,877,434</b>
<b>Fonde të pakushtëzuara- FZHR*</b>	<b>2,149,281,099</b>	<b>2,149,281,099</b>	<b>296,695,923</b>	<b>1,852,585,176</b>
<b>Fonde nga transfertat specifike</b>	<b>224,207,069</b>	<b>224,207,069</b>	<b>89,753,522</b>	<b>134,453,547</b>
<b>Fonde nga te ardhurat e Bashkisë</b>	<b>7,679,196,275</b>	<b>4,423,382,315</b>	<b>4,172,036,367</b>	<b>251,345,948</b>
<b>Fonde nga te ardhurat jashte limitit</b>	<b>2,108,174</b>	<b>2,108,174</b>	<b>2,052,510</b>	<b>55,664</b>
<b>Shuma</b>	<b>14,079,988,696</b>	<b>10,818,944,102</b>	<b>8,499,677,992</b>	<b>2,319,266,110</b>
Memo kredi: Kthim paga mentor 2015 PIU, kaluar gabim dy herë nga Dega e Thesarit Tiranë të njëjtin urdhërshpenzim. Ky shpenzim është kthyer në vitin 2016 Bashkisë Tiranë në të ardhura, duke mos prekur shpenzimet e vitit 2016, pasi ky kthim nuk i përket buxhetit të këtij viti, por buxhetit të vitit 2015				147,229
<b>Shuma</b>	<b>14,079,988,696</b>	<b>10,818,944,102</b>	<b>8,499,677,992</b>	<b>2,319,413,339</b>

• **Fondet e përfituara nga FZHR** janë fonde të alokuara për projekte investimesh dhe janë kontabilizuar sipas kohës së realizimit. Kontabilizimi ka filluar me mbërritjen e faturave të shoqëruara me situacione për punime pjesore të shtrira sipas afatit të realizimit të kontratave. Investimet e Bashkisë Tiranë me burim financimi fondet e Fondit të Zhvillimit të Rajoneve (FZHR) për vitin 2016 janë projekte në infrastrukturën rrugore, ku deri me datë 31.12.2016 janë financuar 14 kontrata që i përkasin vitit 2012 në vlerë të plotë 833,855,587 lekë nga të cilat ka mbetur pa u palikujtuar vlera prej 251,329,156 lekë, 6 kontrata që i përkasin viteve 2013-2014-2015 në vlerë të plotë 314,046,041 lekë nga të cilat ka mbetur pa u palikujtuar vlera e garancisë së punimeve prej 13,340,698 lekë dhe 11 kontrata i përkasin vitit 2016 në vlerën 1,759,503,263 lekë nga të cilat ka mbetur pa u likujtuar vlera e garancisë së punimeve prej 80,460,664 lekë. Në mënyrë të detajuar projektet e investimeve të financuara nga fondet e FZHR paraqiten në tabelën në **Aneksin nr.5** të bashkëlidhur këtij Akt-konstatimi.

**Me konstatimin e shpenzimit** (mbërritja e faturës shoqëruar me situacion) është bërë veprimi kontabël në debi të llogarisë 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT-ve” në kredi të llogarisë 404 “Furnitor për investime”.

**Me mbërritjen e shkresës** së dërguar nga Ministria e Financave për alokimin e fondit pjesor të vitit ushtrimor të detajuar sipas projekteve të investimeve është kryer veprimi kontabël për shumat përkatëse në debi të llog. 520 “Disponibilitete në thesar” në kredi të llog. 476 “Të ardhura të caktuara për t’u përdorur”.

**Në momentin e pagesave** të faturave është kryer kontabilizimi për çdo pagesë në debi llogarisë 404 “Furnitorë për investime” dhe në kredi të llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar”.

**Në fund të vitit ushtrimor** për fondet e investimeve në proces të pa përfunduar të përdorura është kryer veprimi kontabël në debi të llog.476 “Të ardhura të caktuara për t’u përdorur” në kredi të llog. 720 “Grant korrent i brendshëm” dhe në kredi të llog. 4342, “Operacione me shtetin (të drejta)” për pjesën e fondeve të përdorura gjatë vitit ushtrimor, për llogari të shpenzimeve të realizuara vitin e mëparshëm, por të financuara me fondet buxhetore të vitit ushtrimor raportues.

**Me përfundimin e investimit** të konfirmuar me aktin e marrjes në dorëzim të investimit dhe likuidimit total të vlerës së kontratës është bërë kapitalizimi aktivitet (hyrje sipas llojit të AQT), për të cilat është prerë artikulli kontabël në debi të llogarisë 21 “Aktive afatgjata materiale” në kredi të llogarisë 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT-ve”.

**Me kapitalizimin e aktivitet** njëkohësisht janë prerë artikujt kontabël:

-në debi të llog. 476, "Të ardhura të caktuara për t'u përdorur" në kredi të llog.720 "Grant korrent i brendshëm" dhe

-në debi të llog.720 "Grant korrent i brendshëm" në kredi të llog. 1011 "Shtesa në fondet bazë".

Në fakt për kapitalizimin e aktivitet sipas UMF nr.14 datë 28.12.2006 "Per përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore te vitit 2006 per institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësite qe varen prej tyre si dhe te njësite te menaxhimit / zbatimit te projekteve e marrëveshjeve me donatore te huaj" duheshin kryer veprimet kontabël:

- në debi të llogarisë 476 "te ardhura te caktuara per t'u përdorur" në kredi llog. 105"Grante te brendeshme kapitale" per fondet buxhetore te perdorura per investime" dhe

- në kredi të llogarisë 1011"Shtesa te fondit baze" në debi të llogarisë 105"Grante te brendeshme kapitale" për vleren e aktiveve te blera apo te krijuara ne institucion (per aktivet e marra ne dorzim)

➤ **Auditimi i procedurave të zbatimit të buxhetit viti 2016, i menaxhimit të detyrimeve të prapambetura të papaguara dhe të detyrimeve të krijuara nga shërbimi i borxhit i kredive të nën huazuara për investime me financim të huaj.**

• **Mbi procedurat e zbatimit buxhetit viti 2016.**

Buxheti i vitit 2016 dhe PBA 2016-2018 është miratuar me Vendim te Këshillit Bashkiak Nr.58 datë 30.12.2015. Buxheti është miratuar i detajuar sipas programeve buxhetore, njësite shpenzuese dhe klasifikimit ekonomik.

Burimet e financimit	Buxheti 2016	
	Plan	Fakt
Tr pakushtezuar	3.700.743,69	1.815.562,04
Tr Specifike	977.800,93	800.142,19
Tr Kushtezuar	2.800.885,72	2.730.044,71
Te ardhura BT	11.194.000,03	7.119.603,36
Te ardh.e veta	4.669,12	893,55
Jasht limitit	2.811,16	2.663,51
<b>TOTAL</b>	<b>18.680.910,65</b>	<b>12.468.909,36</b>

Gjatë vitit 2016 kanë ndodhur ndryshime në buxhet me shtesa e pakësime të fondeve në 5 raste ndërmjet programeve të miratuara me VKB dhe 10 raste rishpërndarje fondesh ndërmjet projekteve të investimeve, ndërmjet zërave të shpenzimeve korrente brenda të njëjtit program të miratuar nga NA

Planifikimi, ndryshimet dhe realizimi i buxhetit të Aparatit të Bashkisë Tiranë sipas klasifikimit buxhetor për vitin 2016 me burim financimi transferta e pakushtezuar dhe të ardhurat e veta paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Emërtimi i artikujve sipas klasifikimit buxhetor	2016				
	Plan Fillestar	Ndryshimet +/-	Plani fund viti	Realizimi	Realizimi %
600 (Shp. për paga e shperblime)	1.266.500.000	12.219.700	1.278.719.700	986.986.995	77%
601 (Shp. për kontrib. sig.shoq e shendet)	192.400.000	8.400.000	200.800.000	160.916.121	80%
602 (Shpenzime operative)	2.711.000.000	24.124.500	2.735.124.500	1.982.485.259	72%
604-609 (Shp.për transfert tek individet)	195.644.000	- (50.694.200)	289.949.800	134.079.237	46%
230-255 (Shp për investime e detyrime kredi)	4.812.561.707	218.718.289	4.428.448.274	2.128.033.278	48%
<b>TOTAL</b>	<b>9.178.105.707</b>	<b>212.768.289</b>	<b>8.933.042.274</b>	<b>5.392.500.890</b>	<b>60%</b>

**Plani i fondeve nga të gjitha burimet e financimit**

Art	Plani fillstar me burim FZHR	Ndryshimet e fondeve të FZHR	Plani perfundimatar me Burim fondet e FZHR	Plani perfundimtar me burim transferta e pakushtezuar dhe te ardhurat	Plani me burim fondet nga transferta e kushtezuar	Plani me burim fondet nga Transferta Specifike	Plani me burim fonde nga Donatorë	Plani i fondeve nga të gjitha burimet e financimit



				e veta				
600				1.278.719.700	45.302.636	81.209.471		<b>1.405.231.807</b>
601				200.800.000	7.538.888	13.661.402		<b>222.000.290</b>
602				2.735.124.500	39.946.778	12.670.069		<b>2.789.849.521</b>
604-609				289.949.800	2.436.379.374	18.863.800		<b>2.745.192.974</b>
230-255	317.964.899	-59.500.000	2.408.645.998	4.411.174.866	990.913	97.802.327		<b>6.918.614.104</b>
<b>TOTAL</b>	<b>317.964.899</b>	<b>59.500.000</b>	<b>2.408.645.998</b>	<b>8.915.768.866</b>	<b>2.530.158.589</b>	<b>224.207.069</b>	<b>2.108.174</b>	<b>14.080.888.696</b>

Realizimi në fakt i fondeve paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Artikulli	Realizimi ne fakt i fondeve me burim FZHR (infrastruktura rrugore)	Realizimi ne fakt i fondeve me burim tarnsferten e pakushtezuar dhe të Ardthurat e veta	Realizimi në fat i fondeve me burim transferta e kuzhtezuar	Realizimi i fondeve me birim Transfertën specifike	Realimi i fondeve me burim donatore	Plani i fondeve nga të gjitha burimet e financimit	Realizimi i fondeve nga të gjitha burimet e financimit	Realizimi në %
600		986.986.995	43.673.504	75.617.925,00		1.405.231.807	1.106.278.424	78.9
601		160.916.121	6.742.051	12.013.910,00		222.000.290	179.672.082	80.9
602		1.982.485.259	36.330.859	2.121.691,00	2.052.510,00	2.789.849.521	2.022.990.319	72.5
604-609		134.079.237	2.428.782.929	-		2.745.192.974	2.562.862.166	93.3
230-255	499.841.722	2.128.033.278	-	-		6.918.614.104	2.627.875.000	37.9
<b>TOTAL</b>	<b>499.841.722</b>	<b>5.392.500.890</b>	<b>2.515.529.343</b>	<b>89.753.526,00</b>	<b>2.052.510,00</b>	<b>14.080.888.696</b>	<b>8.499.677.991</b>	<b>60.3</b>

Buxhetit për vitin 2016 paraqitet me një nivel të ulët realizimi në masën 60 %, ndërkohë që detyrimet e papaguara janë në nivel të lartë në datë 31.12.2016 në shumën **3.374.968.459** lekë.

Nisur nga analiza faktoriale mbi realizimin faktik të buxhetit e miratuar në këshillin bashkiak, si dhe raportet e monitorimit, ky mosrealizim shpjegohet se, në 3 programet qe zënë peshën me te madhe të shpenzimeve paraqiten me një masë realizimi deri në 55% Kështu:

1. Programi “Shërbimet publike vendore” i programuar në shumën 959,434,084 lekë dhe realizuar në shumën 525,050,306 lekë ose në masën 55%
2. Programi “Menaxhimi i rrugëve dhe transportit publik” i programuar në shumën 1,722,075,182 lekë dhe realizuar në shumën 671,938,067 lekë ose në masën 39%.
3. Programi “Arsimi para universitar dhe edukimi” i programuar në shumën 890,545,024 lekë dhe realizuar në shumën 494,138,542 lekë ose në masën 55%.

- Pjese e planit te investimeve per vitin 2016, janë dhe investimet e mbartura nga ish komunat qe ende sot vijojnë te kenë problematika ne likuidim, pasi kane mungesa ne dokumentacion etj.

- Shtesat e fondeve ne planin e buxhetit te investimeve ne programin e menaxhimit te rrugeve me një plan përfundimtar ne vleren 309 milion leke ka ndikuar ne mos realizimin e planit te investimeve. Në këtë program rreth 150 milion leke të fondeve të planifikuara përbehet nga garancitë 5 % te objekteve, për të cilat ndiqet një procedurë e tillë, ku 5% e vlerës së kontratës çelet si pjese e situacionit në llog.231 dhe ngurtësohen në llog.466 ne Thesar dhe likuidohen me përfundimin e kontratës.

- Në Programin e Menaxhimit të Rrugëve dhe Transportit Publik, janë bërë ndryshme gjatë vitit, duke shtuar investime të reja për të cilat gjatë vitit 2016 ka përfunduar procesi i projektimit dhe i prokurimit, për të cilat ka filluar procesi i zbatimit në 3-mujorin e fundit të vitit, çka ka ndikuar në realizimin e ulët të fondeve për vitin buxhetor.

- Investimet e reja 2016 per te tre programet qe zënë peshën me te madhe janë ne vlerat 127,963,487 leke programi i shërbimeve publike, 654,254,410 leke programi i menaxhimit te rrugeve dhe 178,993,097 leke programi i arsimit, investime per te cilat realizimi i prokurimeve nuk është mundur te behet brenda vitit buxhetor.

- Me realizim shumë të ulët paraqiten dhe investimet në infrastrukturën rrugore me burim financimi fondet e miratuar nga FZHR, ku masa e realizimit paraqitet 21% edhe pse kemi pakësim fondesh nga planifikimi fillestar.

- Një tjetër arsye e mosrealizimit të fondeve të prokuruar të investimeve ka qene dhe ndryshimi i shpeshte i buxhetit ne vitin 2016. Kërkesat per ndryshime kane qene te mëdha, ndryshime qe janë bere si me VKB ashtu dhe me Urdhra Kryetari te cilat kanë ndikuar ne vonesa te procesit te prokurimit.

Nga sa më sipër konstatojmë se ndryshimet e vazhdueshme nëpërmjet procedurave të sipërpërmendura tregojnë qartë për planifikime optimiste të cilat gjatë vitit ushtrimor nxisin shkurtimin e shpenzimeve, ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke e kthyer procesin e planifikimit dhe buxhetimit si edhe atë të përlllogaritjes së kostos së produkteve, në një mjet joreal, të qëndrueshëm dhe efektiv.

Mosrealizimet dhe ndryshimet e mëdha dhe të shpeshta të investimeve në 3 programet kryesore të veprimtarisë së bashkisë tregon se, planifikimi i tyre duhet të bëhet më i argumentuar dhe duke mbajtur parasysh përcaktimin e drejtë të kostos së produkteve në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më reale dhe ndryshimet të jenë sa më të vogla dhe vetëm për raste të domosdoshme.

- Detyrimet e prapambetura te vitit 2015 në vlerën 5,504,207,407 lekë kanë qenë prioritet në buxhetim dhe në radhën e likuidimit, me përjashtim te detyrimeve te cilat per shkak te problematikave ne dokumentacion kanë mbetur pa likuiduar. Bashkia Tirane deri në fund të vitit 2016 ka arritur te shlyeje rreth 52% te totalit te detyrimeve të akumuluar nga te cilat 80% të detyrimeve të trashëguara nga viti 2015. Detyrimet e mbetura të pashlyera me datë 31.12.2016 në tabelën e mëposhtme të raportuar dhe në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë.

Detyrimet e nj.v.q.v (leke)	(1) Ne fillim te vitit (detyrim I mbartur deri ne 31.12.2015	(2)Detyrimet e krijuara rishtazi(deri 31 dhjetor 2016	(3=1+2) Totali I detyrimeve	(4) detyrimet e prapambetura te shlyera (deri ne 31 dhjetor 2016	(5) Detyrimi I shlyer nr %	(6=3-4) Detyrimi I mbetur me 31.12.2016
<b>Vlera Totale</b>	<b>5.504.207.307</b>	<b>1.476.413.930</b>	<b>6.980.621.237</b>	<b>3.605.652.778</b>	<b>51,65%</b>	<b>3.374.968.459</b>
Investime	1.647.247.117	493.854.109	2.141.101.226	1.286.936.279	60,11%	854.164.947
Investime nga FZHR	393.812.721	122.293.555	516.106.276	198.289.460	38,42%	317.816.816
TVSH e Kosto lokale	675.688.210	299.257.448	974.945.658	234.411.544	24,04%	740.534.114
Mallra dhe Sherbime	506.358.579	508.678.588	1.015.037.167	792.470.868	78,07%	222.566.299
Vendime gjyqesore	442.063.596	17.315.230	459.378.826	165.052.768	35,93%	294.326.058
te tjera	1.839.037.084	35.015.000	1.874.052.084	928.491.859	49,54%	945.560.225

Vlera e detyrimeve të pashlyera të raportuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në fund të vitit 2016 nuk rakordon me detyrimet ndaj furnitorëve llog 401-404, pasi në këtë tabelë janë përfshirë dhe detyrimet për ekzekutimin e vendimeve të gjykatave të cilat janë pjesë e gjendjes së llogarisë 467 “kreditorë të ndryshëm” si dhe diferenca që krijohet si rezultat i afatit 30 ditor që një shpenzim i papaguar të quhet detyrim i prapambetur.

- Ne datën 29.05.2016 Bashkia Tirane ka filluar si institucion pilot per azhornimin në Sistemin Financiar Qeverisës (SIFQ). Gjate 6-mujorit te dyte te vitit 2016 kane nisur regjistrimet e kontratave te mbetura dhe te paregjistruara me pare, qe ne momentin e prokurimit. Si rezultat i kësaj, këto janë regjistruar ne vleren e mbetur te kontratës dhe jo ne kuptimin e fondit limit dhe vleren e plote te kontratës .

- Me buxhetin e vitit 2016 janë regjistruar 189 fatura te vitit paraardhës 2015 në vlerën 91.824.621 lekë.

- Ka kontrata te regjistruara me copëzime per vitin 2016 per shkak te mbartjes se te dhënave ne SIFQ për kontrata. Per vitin 2016 janë migruar te dhëna per 196 kontrata te lidhura ne vitet paraardhëse per vleren e mbetur te kontratës.

- Për vitin 2016 per shkak te akumulimit te detyrimeve te prapambetura nga ish-NJA dhe ish-komunat dhe futjes se sistemit pilot te thesarit ka regjistrime te shpenzimeve jashte afatit 30 ditor nga data e faturës në 250 raste, për rrjedhojë ka thyerje te radhës FIFO. Per vitin 2016 përqendrimi i pagesave paraqitet si me poshtë:

Tremujori I	Tremujori i II	Tremujori III	Tremujore IV
1.188.674.480 leke	2.007.034.170	2.156.508.130	3.147.461.210

- Përqendrimi me i madh ashtu siç vihet re edhe nga raporti është në tremujorin e tretë dhe të katërt. Kjo vjen si rezultat i vjeljes së të ardhurave pas 4 muajve të parë të vitit buxhetor .

- Nga auditimi me përzgjedhje të regjistrimeve të angazhimeve në program nuk rezultoi që të jenë regjistruar fatura për pagesë pa patur fonde buxhetore, pasi këtë e konfirmon thesari me aprovimin e kërkesave për çelje fondesh para marrjes së angazhimit, por ka kufizim të limitit sipas të ardhurave të realizuara. Në momentin mbërritjes së faturës ka fonde buxhetore në dispozicion, por jo detyrimisht ka likuiditet të mjaftueshëm për të paguar fatura dhe për këtë arsye ka copëzime faturash.

**Konkluzion :** Nga auditimi i programimit, aprovimit, realizimit dhe monitorimit të buxhetit për vitin 2016, u konstatua se:

**a.** Mungojnë metodologjitë e planifikimit sipas produkteve dhe qendrave të kostos, të cilat ndihmojnë subjektet publike që jo vetëm të përlllogarisin saktë nevojat për planifikim por edhe të monitorojnë saktë dhe drejtë realizimin e objektivave të njësisë. Vetëm nëpërmjet aplikimit të këtyre metodave, Institucioni (dhe si pasojë palët e interesuara) mund të zbulojnë nëse aktivitetet e njësisë janë në linjë me qëllimet dhe objektivat strategjike të saj.

**b.** Buxhetit për vitin 2016 paraqitet me një performancë jo të kënaqshme në lidhje me nivelin e ulët të realizimit të fondeve në masën 60 %, ndërkohë që në datë 31.12.2016 detyrimet e papaguara janë në nivel të lartë në shumën **3.374.968.459** lekë ose në masën 23% të shpenzimeve totale të planifikuara. Akumulimi i një borxhi të konsiderueshëm në fund të vitit 2015 në vlerën prej 5,504,207,407 lekë, ka ndikuar që edhe në fund të vitit 2016 niveli i borxhit të jetë në nivel të lartë, pavarësisht shlyerjes në masën 52% të detyrimeve të trashëguara nga viti 2015.

**c.** Nëpunësi autorizues ka paraqitur në mënyrë periodike, në Këshillin Bashkiak, raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit, për performancën financiare, produktet dhe objektivat e realizuara për çdo projekt, të përcaktuara në vitin e parë të dokumentit përfundimtar të projektit buxhetor afatmesëm”, nga ku konstatohet se ka mangësi për sa i takon analizës së produkteve për çdo program. Programimi i projekteve të reja të investimeve për vitin ushtrimor pa përfunduar financimin e projekteve të investimeve në vazhdim, duke zgjatur punimet dhe financimet e tyre përtej kontratave nga 1-3 vjet, realizimi në masën 21% i fondeve për investime nga FZHR si dhe ndryshimet e vazhdueshme nëpërmjet procedurave të sipërpërmendura janë tregues i planifikimeve jo të qëndrueshme, të mefshtësisë dhe mos efektivitetit në përdorimin e fondeve, të cilat gjatë vitit ushtrimor kanë rrisur dhe nxitur shkurtimin e mosrealizimit shpenzimeve të miratuara, ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke e kthyer procesin e buxhetimit, të përlllogaritjes së kostos së produkteve dhe realizimit të tyre, në një mjet jo real, të paqëndrueshëm dhe jo efektiv;

Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit” i ndryshuar, pikat 253,354.

➤ ***Mbi procedurat të buxhetimit, e rakordimeve për disbursimet e fondeve dhe shlyerjes së detyrimeve që lindin nga kreditë e nën huazuar për financimin e huaj të investimeve.***

Për realizimin e 4 projekteve të investimeve Bashkia Tiranë ka lidhur 4 marrëveshje nen-Huaje me ish-Ministrinë e Financave për kredi të marra nga organizma ndërkombëtare sipas marrëveshjeve të ratifikuara në parlament. Këto marrëveshje paraqiten në mënyrë të detajuar më poshtë:

❖ Marrëveshja e nën-Huasë midis MOF dhe Bashkisë së Tiranës për projektin “**Programi i Zhvillimit dhe Rehabilitimit të Shkollave**” të financuar nga Banka e Këshillit të Evropës (CEB), lidhur 04 Gusht 2005 në vlerën **12,400,000 EUR**

**Investimi:**

- Projekti konsiston ne ndërtimit e 4 shkollave fillore dhe 3 gjimnaze dhe rehabilitimin e 10 shkollave fillore dhe 2 gjimnazeve

- Të 19 shkollat qe do te përfitojnë janë ne Tirane

Kosto totale e projekti është 18,667,400 EUR

#### **Shpërndarja e kostove :**

- Punime civile në vlerën 16.919.200 EUR

- Mobilim i shkollave në vlerën 518.200 EUR

- Sherbimi arkitekt-inxhinieri në vlerën 900.000 EUR

- Shpenzime operative në vlerën 330000 EUR

#### **Plani financimit:**

Nga CEB në vlerën 12.400.000 EUR ose në masën 66.4% dhe

Nga Qeveria Shqiptare në vlerën 6. 267,400 EUR ose në masën 33.6%

#### **Kushtet e Marrëveshjes së nën-Huasë:**

- Çdo pjese e kështit te kredisë do te përdoret nga huamarrësi per financimin e projektit brenda 12 muajve pas disbursimit nga CEB. Pjesa e kredisë e papërdorur ose e pushpërndarë brenda kësaj periudhe do ti paguhet CEB -it jo me vonë se 30 dite

- Monedha e kësteve do te jete ne EURO ose US Dollar

- Norma e interesit per secilin kësht te kredisë do te subvencionohet nëpërmjet llogarise selektive te besimit te CEB. ky subvencion nuk mund te kaloje 2,976,000 euro per shumen totale te projektit te miratuar nga CEB. Subvencionimi do te zbatohet proporcionalisht ne çdo kësht te huase. Subvencioni është llogaritur ne 300 pikë bazë në vit (3%) në baze te kredisë 10 vjecare duke përfshire një periudhe mospagimi prej 5 vitesh.

- Disbursimi do te behet ne baze te progresit te projektit.

- Te gjitha kostot shtese si taksa,detyrime,shpenzime do te përballohen nga huamarrësi

#### **Shlyerja e Nen-huase:**

- Bashkia e Tiranës merr përsipër te shlyej nen huane qe përbën vetëm principalin e kredisë

- Bashkia e Tiranës nuk do te paguaj asnjë interes, komision apo kontribut apo detyrim financiar qe parashikohet ne marrëveshje

- Ministria e financave do te njoftoje BT per shumen e principalit qe do te paguaje , kohen si dhe numrin e llogarise ku do te behet derdhja

- Skeduli i shlyerjes së kredisë përbëhet nga 6 Transhe të shpërndara në 18 vite,

#### **Raportimet :**

- PIU duhet ti dërgojë CEB-it ne baze katër mujore një raport progresiv

- Auditimi i projektit do te kryhet çdo vit

- Qeveria shqiptare do te akordojë kontributin e saj per projektin ku përfshihen kosto lokale dhe tvsh-ja.

❖ Marrëveshja e nen-Huase midis MOF dhe Bashkise se Tiranës për projektin “**Zhvillimi i rrugëve të Tiranës**” të financuar nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (**B.E.R.ZH**), lidhur 04 Shtator 2006 në vlerën **8,200,000 EUR i cili përfshin:**

1. Rehabilitimin dhe përmirësimin e Unazës se Tiranës midis Zogut te zi dhe Stacionit te trenit në vlerën 1.000.000 EUR

2. Rehabilitimin dhe përmirësimin e Unazës se Tiranës midis Stacionit te trenit dhe Rruges se Dibrës në vlerën 1.500.000 EUR

3. Rehabilitimin dhe përmirësimin e Unazës se Tiranës midis Rruges se Dibrës dhe Bulevardit Zhan Dark në vlerën 2.000.000 EUR

4. Rehabilitimin dhe përmirësimin i Rruges se Kavajës dhe Rruges se Unazës se madhe ne Kryqëzim në vlerën 2.500.000 EUR

5. Pajisje per pjesën e pikave (1,2,3,4) te projektit në vlerën 500.000 EUR

6. Sherbime projektimi , supervisioni dhe konsulence teknike per pikat (1,2,3,4) te projektit në vlerën 425.000 EUR

7. Konsulence teknike per monitorimin e pikave (1,2,3,4) te projektit në vlerën 144.000 EUR

8. Komision bankar në vlerën 131.000 EUR

**Kushtet e nën huasë:**

- Bashkia Tirane merr përsipër te shlyej interesat e huase sipas një norme te ndryshueshme interesi. Pavarësisht nga sa me sipër Bashkia e Tiranës me miratimin e Ministrisë mund te zgjedhe si një alternative ndaj pagesës se interesit me një Norme Interesi te Ndryshueshëm mbi te gjithë apo një pjese te huase qe kërkohet ne atë moment, qe te paguaje interesin me një Norme Fikse. Interesi mbi një pjese te tille te Huase ne përputhje me Termat dhe Kushtet Standarde, Pagesat e interesit do te bëhen çdo 6 Qershor dhe 6 Dhjetor te çdo viti.

- Norma e Tarifës se Angazhimit është 0.5% ne vit

- Pagesat e interesit dhe te principalit do te kryen ne llogarinë "Depozite e Qeverise" ne Bankën e Shqipërisë.

- BT do ti dërgojë MOF informacion mbi disbursimet nga kredia çdo tremujor si dhe do te dërgojë prane BERZH raporte periodike te kërkuara

- Ri pagimit te principalit te huase do të bëhet në bazë të skedulit të amortizimit të kredisë.

- Amendim i vlerës qe do disbursohet /Albania - Tirana Municipal Roads Development Project Operation No.36228 per 200694.31 eu, nga ku BT I ulet disbursimi ne vleren 155828.21 eu

- Ndryshimi i vlerës se disbursuar, i stokut si edhe efektet ne përlllogaritjen e interesit do te reflektohen krahas te tjerave me përfundimin e rakordimit të MFE me Bashkinë Tirane

- Interesi i kërkuar bashkisë Tirane nga Ministria e Financave

- Periudha 2018-2020 -interes është subjekt ndryshimi ne varësi te normës se interesit dhe stokut (pagesat e principalit qe mund te realizoje bashkia Tirane)

❖ Marrëveshja e nen-Huase midis MFE dhe Bashkise se Tiranës për projektin “**Ndertimi i banesave me qellim social**” të financuar nga Banka e Këshillit të Evropës (CEB), lidhur 13 Shkurt 2008 në vlerën **6,347,000 EUR**

**Kushtet e nen-Huasë**

- Huadhënësi bie dakord per këtë shume per ndërtimin e 350 apartamenteve

- Disbursimi i huase ne këste te veçanta do te behet ne përputhje me progresin e punimeve te projektit

- Te ardhurat nga nen-huaja asnjëherë nuk do te kalojnë 60% te kostos totale per ndërtimin e 350 apartamenteve përjashtuar TVSH

**Shlyerja e nen-huase:**

- Bashkia merr përsipër shlyerjen e principalit te nenhuase

- Ne rast se BT nuk i përdor fondet e nen-huazuar brenda 12 muajve nga disbursimi i tyre duhet tja ktheje MOF brenda 30 ditëve kalendarike

- Ne rast se BT nuk shlyen detyrimet atëherë MOF do te zbresë vleren e detyrimeve nga granti i kushtezuar ne periudhat pasardhese

- Te gjitha kostot shtese si taksa, detyrime shpenzime do te përballohen nga vete huamarrësi.

**Skedula e shlyerjes se principalit :** vjen here pas here me një format "letër premtimi" nga CEB Sipas shkresës nr. prot 18262 dt 29.12.2014 të MFE skeduli i shlyerjes së kredisë përbëhet nga 5 Transhe të shpërndara në 13 vite.

**Raportime:**

- Bashkia duhet ti dërgojë Ministrisë se Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit ne baze katër mujore një raport progresiv

- MOF merr përsipër te përballoje pagesat e interesave per fondet e kredisë te disbursuara

❖ Marrëveshja e nen-Huase midis MOF dhe Bashkise se Tiranës për projektin “**Bulevardi Verior dhe Rehabilitimit te Lumit te Tiranës**” nga **Fondi per Zhvillim Abu Dhabi**, lidhur 20 Maj 2013 në vlerën 240,000,000 AED ( e konvertuar 65,341,682.54 USD ose 57,429,392.1 EUR)

-Programi i investimit :

-Rehabilitimi i shtratit te lumit , bankat dhe zona per rreth në vlerën 90,000,000 AED në masën 50%

-Ndertimi i zonës se Bulevardit dhe punimet civile te lidhura me te në vlerën 120.000.000 AED në masën 50%

-Shërbimet teknike dhe konsulence në vlerën 10.000.000 AED

-Kontingjenti i projektit në vlerën 20.000.000 AED

#### **Kushtet e pagesës së nën-Huasë:**

- Huamarrësi do te paguaj një norme interesi prej 3,5 % per vit ne vit per shumen e principalit te huase te tërhequr dhe te papaguar. Bashkia Tirane merr përsipër te shlyeje interesat e huase ne normën 3.5 % ne vit, ne baze te shumes se principalit te huase te tërhequr dhe te papaguar. Interesi rritet nga datat përkatëse ne te cilat do te tërhiqen shumat. Pagesat e interesit do te bëhen çdo 30 Prill dhe 30 Tetor te çdo viti.

- Huamarrësi do te paguaje një pagesë administrative te kredisë ne vleren 0.5 % ne vit per shumen e principalit te huase. Bashkia Tirane do te paguaje një tarife te administrimit te huase ne normën 0.5% ne vit mbi shumen e principalit te huase se tërhequr dhe te papaguar.

- Interesi dhe pagesa te tjera do te llogariten mbi bazën e një viti 360-ditor te dymbëdhjetë muajve 30-ditor per çdo periudhe

- Bashkia e Tiranës paguan te gjitha taksat , tarifat dhe detyrimet nëse ka sipas ligjeve ne fuqi

- Huamarrësi do te paguaj pricipalin ne mbështetje te skedules se amortizimit.

- Pagesat e interesit dhe principalit do te krye ne llogarinë "Depozite e qeverise" ne BOA ne këto data me sipër

- PIU është përgjegjëse per administrimin dhe ekzekutimin e projektit.

- E drejta e BT per te bere tërheqje nga huaja është 31.12.2016 ose një

#### **Mbi bazën e :**

- Marrëveshjes se huase me 21.04.2013

- Njoftimit te kreditorit date 25.02.2016 per shtyrjen e afatit te disbursimit te kredisë deri me datën 31.12.2018

- Përgjigjes se kreditorit date 18.08.2016 per dakortesine lidhur me amendimin e marrëveshjes se nenhuase te MOF me BT

#### **Është rënë dakord për ndryshimet si më poshtë:**

- E drejta e BT per te bere disbursimin e fondeve nga huaja përfundon me datën 31.12.2018

- Bashkia Tirane do te ri paguajë principalin e huase sipas skedulit të përcaktuar të kësteve

- **Përmbledhje e përlllogaritjeve të disbursimeve të realizuara dhe të detyrimeve të akumuluarra për shlyerjen e shërbimit të borxhit nga Bashkia Tiranë për 4 nën-Huatë.**

Për 3 projektet: “Zhvillimi i rrugëve të Tiranës” financuar nga BERZH në vlerën 8.200.000 EUR; “Ndertimi i banesave me qellim social” financuar nga CEB në vlerën 6,347,000 EUR dhe “Programi i Zhvillimit dhe Rehabilitimit te Shkollave” të financuar CEB, në vlerën 12,400,000 EUR kanë përfunduar para viteve 2015 dhe janë administruar e menaxhuar nga Njësia e Menaxhimit të projekteve e cila ka qenë njësi shpenzuese më vete në varësi të Bashkisë. Për këto projekte Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar nuk disponon të dhëna financiarë të sakta dhe dokumentacion për ecurinë e këtyre projekteve për financimin si dhe disbursimet e kryera për to.

Disbursimet janë të analizuara vetëm për projektin “Bulevardi Verior e Rehabilitimi i Lumit te Tiranës” i financuar nga Abu Dhabi, në vlerën 240,000,000 AED ( e konvertuar 65,341,682.54 USD ose 57,429,392.1 EUR), marrëveshja e secilës është në 30 maj 2013, ku të dhëna të sakta ka vetëm për vitet 2016-2018, ndërsa për vitet 2013-2015 vlera e disbursimeve e trashëguar nga bilanci i PIU-t nuk është e analizuar dhe nuk ka siguri për saktësi të saj. Për vitet 2016-2018 sipas të dhënave të kontabilitetit disbursimet e kryera nëpërmjet pagesave të faturave të sipërmarrësve të punimeve për projektin e investimeve në masën 80% të vlerës së faturave e

situacioneve dhe TVSH në masën 20% nga fondet e Bashkisë Tiranë paraqiten në tabelat e mëposhtme:

**Kreditë e paraqitura ne bilanc PIU deri 31.12.2015** **1.382.417.487**

<b>Shtuar kreditë 2016</b>		
<b>Operatorët Ekonomik sipërmarrës të punimeve</b>	<b>Objekti i Kontratës</b>	<b>Disbursimet (shpenzime direkte nga Abu Dhabi 80% për fakturat e sipërmarrësve të punimeve)</b>
JV "Planarch Srl" Rome, Itali (lider) & "Hydeas SpA" & "Abacus Srl" & "Tecnic Consulting Engineers SpA", Itali	Supervizimi i punimeve per projektin e Bulevardit Verior të Tiranës dhe Rigjenerimi i Lumit të Tiranës - Abu Dhabi	115.837.282
Copri Constr Enterp Ë.L.L. Safat Kuëait Charlie Haider)	Ndërtimi i Bulevardit Verior Tiranës e punime civile - Abu Dhabi	471.666.105
"Trema Engineering 2 " Albani & "Strabag AG", Austria	Punim Rehabil Lum Tiranës, të bankina e pun ndërt - Abu Dhabi	1.418.471.438
Sëarco Mizar Albania	Ndertim i qendres se kontrollit te trafikut - BERZH	7.579.699
<b>Totali viti 2016</b>		<b>2.013.554.525</b>
Baker Tilly Grimshaë	"Projekt i detajuar dhe hartimi i dokumenta te tenderit per zgjerimin e bulevardit te Tiranes e Rehabil Lum Tirane" - Abu Dhabi	72.019.125
Copri Construction Enterprises Ë.L.L. Safat Kuëait Charlie Haider)	Ndërtimi i Bulevardit Verior Tiranës dhe punimet civile përkatëse - Abu Dhabi	934.188.033
"Trema Engineering 2 sh.p.k." Albania & "Strabag AG", Austria	Punime Rehabilitimi në Lumin e Tiranës, të bankinave dhe përfshirë të gjitha punimet ndërtimore - Abu Dhabi	700.181.423
JV "Planarch Srl" Rome, Itali (lider) & "Hydeas SpA" & "Abacus Srl" & "Tecnic Consulting Engineers SpA", Itali	Supervizimi i punimeve per projektin e Bulevardit Verior të Tiranës dhe Rigjenerimi i Lumit të Tiranës - Abu Dhabi	162.215.501
<b>Totali viti 2017</b>		<b>1.868.604.083</b>
Baker Tilly Grimshaë	"Proj. i detajuar dhe hartimi i dok. te tenderit per zgjerimin e bulev. te Tiranes dhe Rehabilitimi i Lumit te Tiranes" - Abu Dhabi	17.000.550
Copri Construction Enterprises Ë.L.L. Safat Kuëait Charlie Haider)	Ndërtimi i Bulevardit Verior Tiranës dhe punimet civile përkatëse - Abu Dhabi	603.549.278
"Trema Engineering 2 sh.p.k." Albania & "Strabag AG", Austria	Punime Rehabilitimi në Lumin e Tiranës, të bankinave dhe përfshirë të gjitha punimet ndërtimore - Abu Dhabi	317.739.558
JV "Planarch Srl" Rome, Itali (lider) & "Hydeas SpA" & "Abacus Srl" & "Tecnic Consulting Engineers SpA", Itali	Supervizimi i punimeve per projektin e Bulevardit Verior të Tiranës dhe Rigjenerimi i Lumit të Tiranës - Abu Dhabi	106.521.758
<b>Totali viti 2018</b>		<b>1.044.811.144</b>
<b>Totali i disbursimeve te kryera deri me 31.12.2018 i paraqitur ne bilanc 31.12.2018 gjendje e llog.17"Huamarrje e huaj"</b>		<b>6.309.387..239</b>

Sipas shkresës nr. prot 3308 datë 26.02.2019 të Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë të dhënat për vlerën e disbursuar dhe detyrim shlyerje nga Bashkia Tiranë për 4 kreditë e nën-huazuara të shprehur në valutë dhe në lekë paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Emertimi I Projekteve	Mon	Stoku (disbursuar)	Detyrimet e prapambetura të Bashkisë Tiranë deri me datë 31.12.2018				Total i detyrimit të Bashkisë Tiranë deri me date 31.12.2018 Në valutë	Total i detyrimit të Bashkisë Tiranë deri me date 31.12.2018 konvertuar Në lekë
			Interesa (a)	Komision (b)	Principal (c)	Total detyrimi d=(a+b+c)		
Zhvillim Rrugëve në B. Tiranë	EUR	6,036.836,41	527.146,52	36.852,38	4.755.650,50	5.319.609,40	656.546.192,15	
Bulev. Veri e Rehabil Lum Tiran	AED	193.092.065,81	15.172174,69		13.000.000,00	28.172.174,69	832.019.515,14	
Zhvill dhe Rehabil Shkolla Tiran	EUR	12.400.000,00			6.293.333,30	6.293.333,30	776.723.195,88	
Ndert.Bbanesa me qellim Social	EUR	6.347.000,00			2.217.160,00	2.217.160,00	273.641.887,2	
							<b>2,538,930,790,37</b>	

Kursi i këmbimit i marrë si referencë për konvertim në fund të vitit 2017 është: 1USD=112.76 lekë dhe 1 EUR =133.69 lekë  
 Kursi i këmbimit i marrë si referencë për konvertim në fund të vitit 2018 është: 1 EUR=123.42 lekë dhe 1 USD=107.82 lekë  
 Konvertim në fund të vitit 2018 është 1 EUR = 4,179 AED pra detyrimi 28,172,174.69 AED = 6,741,367 EUR = 832,019,515.14 lekë  
 Konvertim në fund të vitit 2018 është 1 EUR = 4,179 AED pra disbursimi 193.092.065.81 AED = 46.205.328 EUR = 5,702,661,584,65 lekë

Bashkia Tiranë në Buxhetet vjetore ka programuar në mënyrë të pjesshme në artikullin 255 "Shpenzime për pagesa interesa e principal" fonde për shlyerjen e detyrimeve për interesa, komisione dhe principal, planifikimi dhe realizimi në vite paraqitet si më poshtë:

Viti	Projekti: "Zhvillimi I Rrugëve të Tiranës" nga BERZH	Projekti "Programi I Zhvillimit dhe rehabilitimit të Shkollave" nga CEB	Projekti: "Bulevardi Verior dhe rehabilitimi I Lumit të Tiranës
------	--	---	---

	Kodi i Programit -04530		Kodi i Programit -09120		Kodi i Programit -09120	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
2009	84,178,219	45,749,613				
2010	104,428,000	47,321,295	86,800,000			
2011	144,000,000	47,560,464	28,000,000			
2012	229,645,100	88,872,425	20,400,000			
2013	230,541,228	48,928,000	139,000,000			
2014	80,332,253		20,000,000			
2015	34,992,026		30,000,000		5,000,000	
2016	48,000,000		30,000,000			
2017	48,000,000		30,000,000			
2018					99,000,000	
<b>Totali</b>	<b>1,004,116,826</b>	<b>278,431,797</b>	<b>384,200,000</b>		<b>104,000,000</b>	

**Konkluzion:** Bashkia Tiranë ka akumuluar në fund të vitit 2018 një borxh prej **2,538,930,790.37 lekë** ( i konvertuar 20.571.469,70EUR), kur në PBA dhe buxhetet e viteve 2009-2018 janë programuar fonde në artikullin 55 “Interesa, komisione dhe principal për t’u paguar” në mënyrë të pjesshme dhe realizim minimal për detyrimet për shërbimin e borxhit ndaj Ministrisë së Financave të Ekonomisë për nën-Huatë e marra:

- Nga BERZH për Projektin “**Zhvillimi i Rrugëve të Tiranës**” me vlerë kredie 1,096,258,000 lekë (8,200,000 EUR), planifikuar në vitet 2009-2017 në shumën 1,004,116,826 lekë dhe realizuar në fakt në shumën 278,431,797 lekë ose në masën 28%, kur në fund të vitit 2018 rezulton **detyrimi i akumuluar 656,546,192.15 lekë** (5,319,609 EUR).

- Nga CEB për Projektin “**Programi i Zhvillimit dhe Rehabilitimit të Shkollave**” me vlerë kredie 1,096,258,000 lekë (8,200,000 EUR), planifikuar në vitet 2011-2017 në shumën 384,200,000 lekë dhe i realizuar në masën 0 %, kur në fund të vitit 2018 rezulton **detyrimi i akumuluar 776,723,195.88 lekë** (6,293,333 EUR).

- Nga Abu Dhabi për Projektin “**Ndertimi i Bulevardit Verior dhe Rehabilitimi i Lumit të Tiranës**” me vlerë kredie 7,367,928,000 lekë (240,000,000 AED ose 57,429,392.1 EUR ), planifikuar në vitet 2015 e 2018 në shumën 104,000,000 lekë, i cili është realizuar në masën 0 %, kur në fund të vitit 2018 rezulton **detyrimi i akumuluar 832,019,515.14 lekë** (28,172,175 AED ose 6,741,367 EUR).

- Nga CEB për projektin “**Ndertimi i banesave me qellim social**” me vlerë kredie 848,530,000 lekë (6,347,000 EUR), i pa planifikuar në asnjë vit buxhetor, kur në fund të vitit 2018 rezulton **detyrimi i akumuluar 273,641,887.2 lekë** (2,217,160 EUR).

Përsa trajtuar më lart, procedurat e ndjekura janë në kundërshtim me ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 59-60 “Shërbimi i borxhit”, me ligjin nr.9869 datë 04.02.2009 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore “neni 9 pikat 2,5; neni 2 pika 4; neni 12 pika 1; me ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 41 “Buxheti i njësisve të vetëqeverisjes vendore dhe programi buxhetor afatmesëm” pika 2 nënpika (ç/iii)

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi znj.Jonida Halili me detyrë Drejtore e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe në cilësinë e nëpunësit zbatues (NZ), me z.M.D. me detyrë ish-Drejtor i Financës (për periudhen 01.01.2016-29-01.2018), me znj.B.P. me detyrë ish-Përgjegjëse e Sektorit të Pagesave në Drejtorinë e Financës (për periudhen 2016 - janar 2018), aktualisht Drejtore Finance për periudhen 29.06.2018 e në vazhdim, me znj. V.C. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Kontabilitetit dhe Kontrollit Financiar në Drejtorinë e Financës.

*(Sa trajtuar më sipër, janë pasqyruar në akt-konstatimin nr. 6, datë 16.04.2019, prot subjekti nr. 16375, datë 16.4.2019)*



**Gjetjet kryesore që u konstatuan në auditimin e pasqyrave financiare dhe pozicionet e llogarive përmbledhurazi janë si vijon:**

<b>1.Titulli Gjetjes Situata:</b>	<p>-Mos hartim të pasqyrave financiare të konsoliduara nga Bashkia Tiranë, duke qenë një institucion kompleks që ka 19 njësi vartësie.</p> <p>- Për vitin 2016 nuk është hartuar bilanc i konsoliduar, pasi mungon struktura e posaçme për pranimin, kontrollin dhe përpunimin të informacionit kontabël të sjellë nga 19 njësi të varësisë së Bashkisë Tiranë. Si rezultat i mungesës së strukturës edhe në rregulloren e brendshme të miratuar me vendimin e kryetarit nr.429 datë 08.01.2016 “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së institucionit të Bashkisë Tiranë”. Kjo detyrë nuk është përfshirë në përcaktimet e detyrave dhe përgjegjësiive në rregulloren e organizimit dhe funksionimit të brendshëm të Bashkisë.</p>
<b>Kriteri</b>	<p>Përsa trajtuar më sipër, këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 62 “Përgatitja e llogarive vjetore të buxhetit”, me UMF nr.26, datë 27.12.2007 “Për disa shtesa e ndryshime në UMF nr.14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore 2007, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësiive që varen prej tyre si dhe të njësiive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donator të huaj “pika 5 “Per Konsolidimin e Pasqyrave Financiare”</p>
<b>Ndikimi/Efekti</b>	<p>-Me pasojë mos raportim financiar të konsoliduar pranë Ministrisë së Financave në nivel institucioni bashkë më nën varësitë e saj.</p>
<b>Shkaku</b>	<p>-Mos pasqyrimi i plotë i angazhimit, për arsye të rritjes në vlerë të lartë të detyrimeve në bilanc</p>
<b>Rëndësia:</b>	<p>-I lartë.</p>
<b>Rekomandimi</b>	<p>Bashkia Tiranë të krijojë në organogramën e saj strukturë të veçantë me detyrat dhe përgjegjësitë të refkeltuar në Rregulloren e funksionimit për marrjen në dorëzim, kontrollin dhe hartimin e pasqyrave financiare të konsoliduara, të cilat të miratohen nga titullari i institucionit dhe të raportohen në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë në fund të çdo viti ushtrimor, duke respektuar afatet e miratuara në dispozitat ligjore në fuqi.</p>
<b>2.Titulli Gjetjes Situata:</b>	<p>-Mos kontabilizim i kontratave për mallra e shërbime në momentin e lidhjes së tyre.</p> <p>- Kontabilizimi i veprimeve ekonomike për kontrata të lidhura blerje mallrash apo investimesh nuk është bërë për vlerë të plotë të kontratës, por në momentin e mbërritjes së faturave për blerje malli e shërbimesh dhe investime të shoqëruar me situacion për punime të kryera. Efektet e veprimeve ekonomike dhe të ngjarjeve të tjera ekonomike të kryera nuk janë marrë në llogari në kohën e kryerjes së veprimit apo të ndodhjes së ngjarjes, por me mbërritjen e faturës dhe çeljen e fondeve dhe jo thjesht kur ndërhyjnë pagesa ose marrja e likuiditeteve. Pra regjistrimet kontabël nuk janë kryer në kohën e lindjes të një detyrimi për t'u paguar nga njësi ekonomike, detyrime këto që sjellin pagesa, dhe që kanë sjellë për ushtrimin e dhënë shpenzime.</p>

<b>Kriteri</b>	Përsa trajtuar më sipër, këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël “Kapitulli I, pika 1.
<b>Ndikimi/Efekti</b>	- me pasojë mos pasqyrim në kontabilitet në vlerë të plotë të kontratave të lidhura për mallra dhe shërbime me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare.
<b>Shkaku</b>	- Mos pasqyrimi i plotë i angazhimit, për arsye të rritjes në vlerë të lartë të detyrimeve në bilanc
<b>Rëndësia:</b>	-I mesëm.
<b>Rekomandimi</b>	Drejtoria e Financës në Bashkinë Tiranë të kryejë veprimet e kontabilizimit për vlerë të plotë të kontratave për mallra e shërbime në momentin e nënshkrimit të tyre.

**3.Titulli Gjetjes** -Mungesa e analizave dhe shpjegimeve në pyetësorin e PF të gjendjeve të 7 llogarive në mbyllje të vitit ushtrimor 2015 nga Njësia e menaxhimit të Projekteve (PIU) , veprimtaria financiare e së cilës është mbyllur në këtë vit dhe ,ku PF të saj janë bërë pjesë e PF të Aparatit të Bashkisë Tiranë.

**Situata:** Njësia e Menaxhimit të Projekteve PIU deri në nëntor të vitit 2015 ka qenë njësi shpenzuese me vete dhe ka menaxhuar 3 projekte investimi me financim të huaj (kredi). Meqenëse në vitin 2015 kjo njësi është shkrirë në strukturat e Bashkisë Tiranë si Drejtori brenda Aparatit të bashkisë, edhe bilanci i mbylljes së llogarive të vitit 2015 nga PIU është bërë pjesë e pasqyrave financiare të Bashkisë Tiranë në mbyllje të vitit ushtrimor 2015.Ky bilanc u trashëguua me disa paqartësi në gjendjet e disa llogarive, llogari të cilat deri në fund të vitit 2018 nuk kanë funksionuar sipas parimeve e logjikës kontabël. Për këto gjendje llogarish nuk është ndërmarrë asnjë veprim rregullues kontabël, për arsye të mungesës së informacionit kontabël i shoqëruar me analiza si dhe mungesës së dokumentacionit bazë e justifikues. Në mënyrë të detajuar këto llogari si pjesë të Bilancit të Aparatit të Bashkisë Tiranë në mbyllje të vitit ushtrimor 2016 paraqiten si më poshtë:

**a. Gjendja e llog. 232 “Shpenzime proces per transferime kapitale”** në vlerën **1,157,802,262 lekë**, për të cilën nuk ka analizë dhe mungon informacioni kontabël si dhe dokumentar, se çfarë ka të përfshirë dhe çfarë përfaqëson kjo shumë.

**b. Gjendja e llog. 409 “Furnitorë (debitorë), parapagime pagesa pjesore”** në vlerën **58,702,072 lekë**, për të cilën nuk ka analizë dhe mungon informacioni kontabël si dhe dokumentar, se çfarë ka të përfshirë dhe çfarë përfaqëson kjo shumë.

**c. Gjendja e llog. 45 “Marrëdhënie me institucione Brenda dhe jashtë sistemi”** në vlerën **6,538,746 lekë**, e cila duhet të ishte mbyllur, pasi nuk duhej të paraqitej në bilanc me gjendje. Për këtë gjendje nuk ka asnjë informacion kontabël se çfarë përfaqëson e për rrjedhim për këtë vlerë nuk ka analizë.

**d. Gjendja e llog. 511 “Vlera për t’u arkëtuar”** në vlerën **81,204,163 lekë**, **për të cilën nuk** ka asnjë informacion kontabël se çfarë përfaqëson, e cila sipas rregullit kontabël duhet të përfaqësojë vlerën e letrave të pagesave që janë të depozituara në bankë në pritje për t’u arkëtuar, si interesa të paguara ose të maturuara.

*e. Pjesë e gjendjes së llog. 512 “Llogari në bankë”* është edhe **vlera prej 13,950,271 lekë**, për të cilën Bashkia nuk disponon ekstrakt apo “dokument bankar që të konfirmojë këtë shumë. Për këtë shumë nuk ka informacion se çfarë është dhe si ka vazhduar ecuria e saj deri më tani, çfarë veprimesh janë kryer me këtë gjendje të trashëguar që nga viti 2013.

*ë. Gjendja e llog. 477 “Diferenca konvertime aktive”* në vlerën **1,563,808 lekë**, për të cilën nuk ka asnjë informacion kontabël se si ka rezultuar kjo shumë, që sipas funksionimit të kësaj llogarie kjo llogari duhej të ishte mbyllur me shpenzimet dhe jo me fondin themeltar, pasi pasqyron diferencat aktive që lidhen me konvertimet nga vlerësimi i kërkesave debitore dhe detyrimet të shprehura në monedhe të huaj.

*f. Gjendja e llog. 17 “Huamarrje e huaj”* për vlerën pjesore prej **1.382.417.487 lekë** të trashëguar nga PIU, e cila përfaqëson vlerën e disbursimeve nga tre kreditë për pagesat e furnitorëve për faturat e investimeve në masën 80%. Për këtë shifër nuk ka analiza sipas projekteve të investimeve e disbursimeve (sipas burimeve të financimit të huaj) të kredive.

**Kriteri** Përsa trajtuar më sipër, këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr.14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore 2007, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësisive që varen prej tyre si dhe të njësisive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donator të huaj” Kapitulli IV “Disa veçori për llogarite vjetore të njësisive të menaxhimit / zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatore të huaj”.

**Ndikimi/Efekti** Pozicionet e paqarta të këtyre llogarive në bilancin e PIU-t të vitit 2015 trashëguar në PF e Aparatit të Bashkisë Tiranë si dhe mungesa e analizave të këtyre vlerave, ka sjellë ndikim në realitetin e informacionit kontabël që ofrojnë PF.

**Shkaku** - Ndryshimi i shpeshtë i specialistëve të financës dhe mungesa e përgjegjshmërisë së stafit menaxhues të PIU-t ka sjellë një konfuzion në mbajtjen e kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e vërtetues të përveprimet ekonomike të kryera nga kjo njësi.

**Rëndësia:** -I mesëm.

**Rekomandimi** Bashkia Tiranë të krijojë mundësinë me specialist të fushës të jashtëm dhe të brendshëm për gjetjen dhe përpunimin e të dhënave e dokumentacionin bazë e justifikues për shpjegimin dhe analizimin e gjendjeve të këtyre llogarive, si dhe kryerjen e veprimeve përkatëse sistemuese kontabël, duke i reflektuar ato në PF e mbylljes së vitit ushtrimor 2019.

**4.Titulli Gjetjes** -Performance jo e kënaqshme e programimit dhe realizimit të buxhetit, mungesa e analizave faktoriale të tij si dhe mangësi në monitorimin e buxhetit.

**Situata:** Nga auditimi i programimit, aprovimit, realizimit dhe monitorimit të buxheti për vitin 2016, u konstatua se:

**a.** Mungojnë metodologjitë e planifikimit sipas produkteve dhe qendrave të kostos, të cilat ndihmojnë subjektet publike që jo vetëm të përlllogarisin saktë nevojat për planifikim, por edhe të monitorojnë saktë dhe drejtë realizimin e objektivave të njësisë. Vetëm nëpërmjet aplikimit të këtyre metodave, Institucioni (dhe si pasojë palët e interesuara) mund të zbulojnë

nëse aktivitetet e njësisë janë në linjë me qëllimet dhe objektivat strategjike të saj.

**b.** Buxheti për vitin 2016 paraqitet me një performancë jo të kënaqshme në lidhje me nivelin e ulët të realizimit të fondeve në masën 60 %, ndërkohë që në datë 31.12.2016 detyrimet e papaguara janë në nivel të lartë në shumën **3.374.968.459** lekë ose në masën 23% të shpenzimeve totale të planifikuara. Akumulimi i një borxhi të konsiderueshëm në fund të vitit 2015 në vlerën prej 5,504,207,407 lekë, ka ndikuar që edhe në fund të vitit 2016 niveli i borxhit të jetë në nivel të lartë, pavarësisht shlyerjes në masën 52% të detyrimeve të trashëguara nga viti 2015.

**c.** Nëpunësi autorizues ka paraqitur në mënyrë periodike, në Këshillin Bashkiak, raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit, për performancën financiare, aktivitetet dhe objektivat e realizuara për çdo projekt, të përcaktuara në vitin e parë të dokumentit përfundimtar të projektit buxhetor afatmesëm”, nga ku konstatojmë se ka mangësi për sa i takon analizës së aktiviteteve në bazë produktesh për çdo program. Programimi i projekteve të reja të investimeve për vitin ushtrimor pa përfunduar financimin e projekteve të investimeve në vazhdim, duke zgjatur punimet dhe financimet e tyre përtej kontratave nga 1-3 vjet, realizimi në masën 21% i fondeve për investime nga FZHR si dhe ndryshimet e vazhdueshme nëpërmjet procedurave të sipërpërmendura janë tregues i planifikimeve jo të qëndrueshme, të mefshtësisë dhe mos efektivitetit në përdorimin e fondeve, të cilat gjatë vitit ushtrimor kanë rriskuar dhe nxitur shkurtimin e mosrealizimit shpenzimeve të miratuara, ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke e kthyer procesin e buxhetimit, të përlllogaritjes së kostos së produkteve dhe realizimit të tyre, në një mjet jo real, të paqëndrueshëm dhe jo efektiv.

**Kriteri** Përsa trajtuar më sipër, këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë“ nenet 42,43,47,50 dhe 65, me UMF nr.2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit” i ndryshuar, pikat 253,354

**Ndikimi/Efekti** - Performancë e jo kënaqshme në lidhje me nivelin e ulët të realizimit të fondeve në masën 60 %, ndërkohë që në datë 31.12.2016 detyrimet e papaguara janë në nivel të lartë në shumën **3.374.968.459** lekë ose në masën 23% të shpenzimeve totale të planifikuara.

**Shkaku** - Akumulimi i një borxhi të konsiderueshëm në fund të vitit 2015 në vlerën prej 5,504,207,407 lekë, ka ndikuar që edhe në fund të vitit 2016 niveli i borxhit të jetë në nivel të lartë, pavarësisht shlyerjes në masën 52% të detyrimeve të trashëguara nga viti 2015.

- Programimi i projekteve të reja të investimeve për vitin ushtrimor pa përfunduar financimin e projekteve të investimeve në vazhdim, duke zgjatur punimet dhe financimet e tyre përtej kontratave nga 1-3 vjet, realizimi në masën 21% i fondeve për investime nga FZHR si dhe ndryshimet e vazhdueshme nëpërmjet procedurave të sipërpërmendura janë tregues i planifikimeve jo të qëndrueshme, të mefshtësisë dhe mos efektivitetit në përdorimin e fondeve, të cilat gjatë vitit ushtrimor kanë rriskuar dhe nxitur shkurtimin e mosrealizimit shpenzimeve të miratuara, ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke e kthyer procesin e buxhetimit, të përlllogaritjes së kostos së produkteve dhe

	realizimin e tyre, në një mjet jo real, të paqëndrueshëm dhe jo efektiv.
<b>Rëndësia:</b>	-I mesëm.
<b>Rekomandimi</b>	<p><b>a.</b> Strukturat drejtuese të këtij institucioni, në bashkëpunim me Grupet e Menaxhimit të Programeve dhe me strukturat që mbulojnë planifikimin dhe monitorimin e buxhetit, të përcaktojnë qartë në programimin e PBA, por dhe në planifikimin vjetor, mënyrat dhe metodologjinë e përlllogaritjes së kostos së aktiviteteve në bazë produktesh për çdo program me qëllim arritjen e objektivave dhe minimizimin e shmangieve nga këto objektiva. Procesi i planifikimit të buxhetit të kryhet në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme me qëllim rritjen e transparencës, përgjegjshmërisë në përdorimin e fondeve publike si dhe përmirësimin e planifikimit dhe ekzekutimit të buxhetit të vitit koherent në arritjen e objektivave. Shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve dhe të sigurojë një përdorim eficient të burimeve financiare, si dhe të ruajë stabilitetin makroekonomik e fiskal.</p> <p><b>b.</b> Nevojitet të gjurmohet saktë dhe drejtë konsumimi i burimeve të nevojshme, duke synuar shpërndarjen e shpenzimeve (kostove) sipas aktiviteteve që i “shkaktojnë” këto kosto, me qëllim ndjekjen e kujdesshme të kostove për efekte buxhetore duke synuar minimizimin e rishpërndarjeve mes zërave buxhetore brenda vitit ushtrimor. Të rritet performanca e realizimit të buxhetit në nivel të kënaqshëm në termat e produkteve, si dhe të merren angazhime për të marrë veprimet e duhura korrigjuese për të përmirësuar situatën dhe aty ku është e nevojshme të ndërhyhet.</p>
<b>5.Titulli Gjetjes</b>	Borxhi i akumuluar i Bashkisë Tiranë për 4 kreditë e nën-huazuara nga MFE të marra për financimin e investimeve për periudhen 2009-2018, planifikimi i dhe realizimi i fondeve për shlyerjen e detyrimeve për to.
<b>Situata:</b>	<p>Bashkia Tiranë ka akumuluar në fund të vitit 2018 <b>një borxh prej 2,538,930,790.37 lekë</b> ( i konvertuar 20.571.469,70EUR), kur në PBA dhe buxhetet e viteve 2009-2018 janë programuar fonde në artikullin 55 “Interesa, komisione dhe principal për t’u paguar” në mënyrë të pjesshme dhe realizim minimal për detyrimet për shërbimin e borxhit ndaj Ministrisë së Financave të Ekonomisë për nën-Huatë e marra:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Nga BERZH për <b>Projektin “Zhvillimi i Rrugëve të Tiranës”</b> me vlerë kredie 1,096,258,000 lekë (8,200,000 EUR), planifikuar në vitet 2009-2017 në shumën 1,004,116,826 lekë dhe realizuar në fakt në shumën 278,431,797 lekë ose në masën 28%, kur në fund të vitit 2018 rezulton <b>detyrimi i akumuluar 656,546,192.15 lekë</b> (5,319,609 EUR).</li> <li>- Nga CEB për Projektin <b>“Programi i Zhvillimit dhe Rehabilitimit të Shkollave”</b> me vlerë kredie 1,096,258,000 lekë (8,200,000 EUR), planifikuar në vitet 2011-2017 në shumën 384,200,000 lekë dhe i realizuar në masën 0 %, kur në fund të vitit 2018 rezulton <b>detyrimi i akumuluar 776,723,195.88 lekë</b> (6,293,333 EUR).</li> <li>- Nga Abu Dhabi për Projektin “Ndertimi i Bulevardit Verior dhe Rehabilitimi i Lumit të Tiranës” me vlerë kredie 7,367,928,000 lekë (240,000,000 AED ose 57,429,392.1 EUR ), planifikuar në vitet 2015 e 2018 në shumën 104,000,000 lekë, i cili është realizuar në masën 0 %, kur në fund të vitit 2018 rezulton <b>detyrimi i akumuluar 832,019,515.14 lekë</b> (28,172,175 AED ose 6,741,367 EUR).</li> </ul>

- Nga CEB për projektin “Ndertimi i banesave me qellim social” me vlerë kredie 848,530,000 lekë (6,347,000 EUR), i pa planifikuar në asnjë vit buxhetor, kur në fund të vitit 2018 rezulton **detyrimi i akumuluar 273,641,887.2 lekë** (2,217,160 EUR).

<b>Kriteri</b>	Përsa trajtuar më lart, procedurat e ndjekura janë në kundërshtim me ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 58,59 dhe 60 “Shërbimi i borxhit”, me ligjin nr.9869 datë 04.02.2009 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore” neni 9 pikat 2,5; neni 2 pika 4; neni 12 pika 1; me ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 41, “Buxheti i njësisve të vetëqeverisjes vendore dhe programi buxhetor afatmesëm” pika 2 nëpika (ç/iii)
<b>Ndikimi/Efekti</b>	Akumulimi në fund të vitit 2018 i <b>një borxhi prej 2,538,930,790.37 lekë</b> ( i konvertuar 20.571.469,70EUR) nga mos shlyerja e detyrimeve për principal, komisione e interesa në vite.
<b>Shkaku</b>	Në PBA dhe buxhetet e viteve 2009-2018 janë programuar fonde në artikullin 55 “Interesa, komisione dhe principal për t’u paguar” në mënyrë të pjesshme dhe realizim minimal për detyrimet për shërbimin e borxhit ndaj Ministrisë së Financave të Ekonomisë për nën-Huatë e marra
<b>Rëndësia:</b>	-I lartë.
<b>Rekomandimi</b>	<b>a.</b> Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar të marrë masa për përfshirjen në programimin e buxhetit të fondeve dhe të sigurojë likuiditetin e nevojshëm me qëllim shlyerjen e detyrimeve të lindura për borxhin vendor dhe shërbimin e tij në përputhje me kushtet dhe afatet e kontraktuara për 4 kreditë e nën-huazuara nga MFE me financim të huaj, për të ulur nivelin e këtij borxhi të akumuluar nga mos pagesat në vite me ndikim direkt në borxhin publik të Shtetit Shqiptar.

### ***-Pasqyrat Financiare viti 2017***

*Për organizimin, mbajtjen e kontabilitetit, hartimin dhe saktësinë e veprimeve rregulluese dhe mbyllëse për paraqitjen e pasqyrave financiare për vitin 2017.*

Hartimi i pasqyrave financiare, është bazuar në legjislacionit në fuqi; ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, VKM nr. 248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për Organet e Pushtetit Lokal, Institucionet Shtetërore, Qendrore dhe Lokale si dhe të Njësive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001, UMF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore 2007, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor” i ndryshuar, VKM Nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël” etj. legjislacion rregullues.

#### **Nxjerrja e pasqyrave financiare.**

Për vitin 2017, nga Aparati i Bashkisë Tiranë, me NIPT K11729002L, Kodi i Qeverisjes 101, Kodi i Institucionit 2101001, janë nxjerrë pasqyrat financiare në vitin 2017 për periudhën 1 Janar deri më 31.12.2017.

Pasqyrat financiare, i janë dërguar Degës së Thesarit Tiranë, me shkresën përcjellëse Nr. 8711 prot., datë 28.02.2018 mbi: “Dorëzim bilanci viti 2017” të firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm i Menaxhimit Financiar zj. J.H.

Pasqyrat financiare janë të firmosura nga V.C.- hartuesi i llogarive vjetore, B.P.- Drejtore e Financës dhe J.H.- Drejtore e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, në cilësinë e nëpunësit zbatues.

Pasqyrat financiare, nuk janë firmosur nga nëpunësi autorizues.

Në përputhje me kërkesat e UMF nr. 14 datë 28.12.2006 i ndryshuar me nr. 26, datë 27.12.2007, janë përgatitur pasqyrat financiare të përbëra si vijon:

Format nr. 1 –Aktivi i Bilancit.

Format nr. 2 –Pasivi i Bilancit.

Format nr. 3/1 –Shpenzime të ushtrimit.

Format nr. 3/2 –Të ardhura të ushtrimit.

Format nr. 4 –Burimet dhe Shpenzimet të lidhura me investimet.

Format nr. 5 –Pasqyra e Lëvizjes në “Cash”.

Format nr. 6 –Gjendja dhe ndryshimi i Aktiveve të Qëndrueshme.

Format nr. 7 –Pasqyra e Amortizimit të Aktiveve të Qëndrueshme.

Format nr. 8 –Pasqyra e Lëvizjes së Fondeve.

Format nr. 9- Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

Në përbërje të pasqyrave financiare, është bashkëngjitur formulari i pyetësorit dhe shënimeve shpjeguese por i cili nuk është plotësuar me shpjegimet përkatëse nga hartuesit e pasqyrave financiare.

-Bashkia e Tiranës ka në vartësi 18 Institucione vartëse. Sipas Drejtorisë së Financës, u përgatitën pasqyrat financiare të konsoliduara të Bashkisë Tiranë por ato nuk u miratuan nga Këshilli i Bashkisë Tiranë pasi për disa llogari mungonin analizat dhe dokumentet kontabël justifikues.

Institucionet vartëse të Bashkisë së Tiranë, janë si vijon:

1. Bashkia Tiranë.
2. Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore.
3. Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorëve.
4. Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve.
5. Drejtoria e Përgjithshme Nr. 1 e Punëtorëve të Qytetit.
6. Drejtoria e Përgjithshme Nr. 2 e Punëtorëve të Qytetit.
7. Drejtoria Nr. 3 e Punëtorëve të Qytetit.
8. Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.
9. Tirana Parking.
10. Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme.
11. Qendra Kulturore "Tirana".
12. Klubi Sportiv "Tirana".
13. Qendra "Të qëndrojmë së bashku".
14. Qendra Sociale Multidisiplinare.
15. Qendra Sociale "Shtëpia e Përbashkët".
16. Qendra Komunitare "Shkozë".
17. Funeral Tirana.
18. Shkolla "Luigj Gurakuqi".
19. Agjencia e Tregjeve.

Në këtë rast, mos përgatitja e pasqyrave përmbledhëse të konsoliduar për gjendjen financiare të njësive vartëse (Formati nr. 10) dhe pasqyrat përmbledhëse të konsoliduar e të ardhurave dhe shpenzimeve të funksionimit (Formati nr. 11), bie ndesh me kërkesat e UMF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për Institucionet Qendrore, Organet e Pushtetit Vendor dhe Njësive që varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit /zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj” i ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007, pika 3.

**Pagesa të kryera në vitin pasardhës:**

Në pasqyrat financiare të vitit 2017, janë përfshirë edhe 4 raste të pagesave të kryera në Janar të vitit 2018 por që janë shpenzime që i përkasin muajit Dhjetor 2017 të bllokuara nga Dega e Thesarit. Vlera e këtyre shpenzimeve është për 6 raste në shumën 32,202,206 lekë.

Më hollësisht të dhënat janë pasqyruar si në tabelën Nr. 1 bashkëngjitur.

#### **- Llogaritë e Pasqyrave financiare.**

U analizuan llogaritë kryesore të pasqyrave financiare; Formati Aktivi i bilancit dhe Formati Pasivi i bilancit. Bashkëngjitur Pasqyrat 2 dhe 3 Aktivët dhe pasivët e bilancit.

#### **Llogaritë e Aktivit.**

Për verifikimin e llogarive inventariale të aktivit të bilancit, u audituan rezultatet e inventarizimit fizik të tyre sipas inventarëve të kryera në vitin 2017. Sipas dokumentacionit që na u vu në dispozicion, konstatohet se:

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 46150/1, datë 21.12.2017 “Për ngritjen e komisionit të inventarizimit për toka, troje, terrene, pyje, kullota, plantacione, ndërtime e konstruksione, instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune, inventar ekonomik si dhe mjetet e transportit në pronësi të aparatit të Bashkisë dhe Njësi Administrative”, janë ngritur 26 komisionet për inventarizimin e aktiveve në Bashkinë Tiranë, Zjarrfikëset (PMNZSH) dhe Njësitë Administrative, komisione të cilat janë të përbëra nga pesë anëtarë për çdo njësi.

Njësitë inventarizuese, në fund të inventarizimit kanë përgatitur relacionin mbi kryerjen e inventarizimit. Sipas këtyre relacioneve të firmosura nga komisionet e inventarizimit, inventarizimet kanë filluar datë 22.12.2017 dhe kanë përfunduar më datën 31.01.2018.

Është përgatitur datë 31.01.2018, përmbledhësja e inventarizimit fizik të kryer në Bashkinë Tiranë, zjarrfikëset dhe Njësitë Administrative të firmosur nga zj. V.C. –P/Sektorit të Kontabilitetit Financiar dhe zj. A.Ç.- Specialiste e Sektorit të Kontabilitetit dhe Kontrollit Financiar.

Sipas këtij relacioni, nga inventarizimi rezultoi se gjendja fizike për aktivet e Bashkisë Tiranë dhe NJA më datën 31.12.2017, është si në pasqyrën nr. 4 bashkëngjitur.

Referuar të dhënave të pasqyrave financiare, gjendja kontabël e aktiveve të qëndrueshme më datën 31.12.2017, është si në pasqyrën nr. 5 bashkëngjitur.

Diferenca 21,740,250,115- 21,214,289,160= 525,960,955 lekë përfaqëson gjendjen e llogarisë 24 “Aktive të qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara” e analizuar si vijon:

-Llogaria 24 “Aktive të qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara” për vlerën kontabël 530,023,434 lekë, ***pakësuar*** gjatë vitit 2017 për (576,207,855-530,023,434)= 46,184,421 lekë.

Ndryshimi i gjendjes së llogarisë 24 “Aktive të qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara” në mënyrë tabelore paraqitet si në pasqyrën nr. 6 bashkëngjitur.

Vlera prej 3,999,300 lekë është vlera e tre automjeteve të NJA Bërzhitë të cilat janë jashtë përdorimit (të dëmtuara që në vitin 2016).

Vlera 63,179 lekë është vlera e një kompjuteri i cili është jashtë funksionit në NJA Kashar, konstatuar në inventarët e vitit 2017.

Vlera prej 525,960,955 lekë është vlera e aktiveve të kaluara nga Hekurudha Shqiptare sh.a për Bashkinë Tiranë. Sipas shpjegimeve të subjektit Bashkia Tiranë, kontabilizimi i kësaj vlere në këtë llogari, është bërë në zbatim të rekomandimit të KLSH-së nga auditimi i kaluar me këtë formulim:

#### **Analiza e llogarive të tjera të Aktivit të Bilancit:**

-Llogaria 202 “Studime dhe kërkime” për vlerën kontabël 297,488,423 lekë, shtuar gjatë vitit 2017 për (297,488,423-213,191,884)= 84,296,539 lekë.

-Llogaria 203 “Koncesione, patenta, licenca e të tjera të ngjashme” për vlerën kontabël 168,000 lekë, nuk ka shtesë gjatë vitit 2017.

Vlera Kontabël prej 168.000 lekë, përfaqëson Instalimin e një programi Alpha në Njësinë Administrative Nr. 5.

-Llogaria 209 “Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të pa trupëzuara” për vlerën kontabël 14,245,205 lekë.



-Llogaria 230 “Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të pa trupëzuara” për vlerën kontabël 486,069,598 lekë, shtuar gjatë vitit 2017 për (486,069,598- 341,559,389)= 144,510,209 lekë.

-Llogaria 210 “Toka, troje, terrene” për vlerën kontabël 6,930,105,214 lekë, shtuar gjatë vitit 2017 për (6,930,105,214-6,488,105,846)= 441,999,368 lekë.

-Llogaria 211 “Pyje, kullota, plantacione” për vlerën kontabël 68,732,981 lekë, shtuar gjatë vitit 2017 për (68,732,981-67,511,391)= 1,221,590 lekë.

-Llogaria 212 “Ndërtime dhe konstruksione” për vlerën kontabël 3,018,192,677 lekë, shtuar gjatë vitit 2017 për (3,018,192,677-3,008,347,641)= 9,845,036 lekë.

-Llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” për vlerën kontabël 9,479,792,151 lekë, **pakësuar** gjatë vitit 2017 për (9,490,665,231-9,479,792,151)= 18,873,080 lekë.

-Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri, paisje, vegla pune” për vlerën kontabël 265,954,714 lekë, shtuar gjatë vitit 2017 për (265,954,714-255,366,394)= 10,588,320 lekë.

-Llogaria 215 “Mjete transporti” për vlerën kontabël 711,941,486 lekë, shtuar gjatë vitit 2017 për (711,941,486-312,697,291)= 399,244,1945 lekë.

-Llogaria 218 “Inventar ekonomik” për vlerën kontabël 346,773,139 lekë, **pakësuar** gjatë vitit 2017 për (384,420,122-346,773,139)= 37,646,983 lekë.

-Llogaria 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” për vlerën kontabël 20,805,647,477 lekë, shtuar gjatë vitit 2017 për (20,805,647,477-15,340,537,596)= 5,465,109,881 lekë.

-Llogaria 232 “Shpenzime në proces për transferime kapitale” për vlerën kontabël 1,157,802,262 lekë, nuk ka ndryshime gjatë vitit 2017.

-Llogaria 25 “Huadhënie e nën huadhënie” për vlerën kontabël 92,120,765 lekë, shtuar gjatë vitit 2017 për (92,120,765-27,239,000)= 64,881,765 lekë.

Llogaria 25 “Huadhënie e nën huadhënie” përfaqëson veprimet e mëposhtme:

Pershkrimi i Veprimit	Gjendja 31.12.2016	Shtesa	Gjendja 31.12.2017
Kontribut Në kuadër të Projektit të SME-ve është nënshkruar nga Bashkia Tiranë "marrëveshja e kredive te ndërvarura" me shoqërinë Norfund Crimson Finance Fund dt.30.12.2015 të miratuar me VKB	27,239,000	24,920,300	52,159,300
Kontribut me Klub Futboll Tirana sh.a sipas VKB nr.18, dt.25.6.14		39,961,465	39,961,465
<b>Shuma</b>	<b>27,239,000</b>	<b>64,881,765</b>	<b>92,120,765</b>

-Llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” për vlerën kontabël 8,385,699,000 lekë, nuk ka ndryshim gjatë vitit 2017.

Është e analizuar si më poshtë vijon:

Pershkrimi i Veprimit	Gjendja 31.12.2017
Pjesëmarrje ne kapitale te veta per Klub Futboll Tirana sh.a	6,525,263,000
Pjesëmarrje ne kapitale te veta per Ujësjetllës Kanalizime sh.a Tirane	1,844,697,000
Pjesmarje ne kapitale të veta -Proj. SME-të me AADF dhe Norfund CRIMSON FINANCE FUND ALBANIA	13,750,000
Pjesmarje në Kapitale të veta Eco Tirana	1,989,000
<b>Shuma</b>	<b>8,385,699,000</b>

-Llogaria 31 “Materiale” për vlerën kontabël 20,045,651 lekë, **pakësuar** gjatë vitit 2017 për (68,430,732-20,045,651)= 48,385,081 lekë.

-Llogaria 32 “Objekte inventari” për vlerën kontabël 71,032,244 lekë, **pakësuar** gjatë vitit 2017 për (95,256,307-71,032,244)= 24,224,063 lekë.

-Llogaria 409 “Furnitorë (Debitorë), parapagime pagesa pjesore” për vlerën kontabël 58,702,072 lekë, nuk ka ndryshime gjatë vitit 2017.

Përfaqëson paradhënie të disbursuara për projekte me financim të huaj. Trashëguar nga ish PIU në vitin 2015.

-Llogaria 423 “Personeli, paradhënie, deficite e gjoba” për vlerën kontabël 1,595,960 lekë, shtuar gjatë vitit 2017 për (1,595,960-1,311,034)= 284,926 lekë. Përfaqëson pagat e pa paguara të personelit për fund vitin 2017.

-Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” për vlerën kontabël 332,981,900 lekë, **pakësuar** gjatë vitit 2017 për (335,387,732-332,981,900)= 2,405,832 lekë.

Kjo llogari është e analizuar me të dhënat si më poshtë vijon:

-86,724,972 lekë, janë kontabilizuar debitorë persona fizikë dhe juridikë sipas rekomandimeve nga auditimet e mëparshme të KLSH-së si dhe të tjera për mungesa inventariale etj.

-35,603,512 debitorë të trashëguara nga njësitë administrative,

-3,945,648 lekë debitorë për taksat e pullës për gjendjen civile dhe

-206,707,769 lekë debitorë trashëguar nga ish komunat.

Bashkëngjitur pasqyra nr. 7 analiza e llog. 468 për vlerën 86,724,972 lekë dhe pasqyra nr. 8 analiza e llog. 468 për vlerën 35,603,512 lekë.

*Debitorë për pulla të tërhequra nga punonjës të Gjendjeve Civile në Bashkinë Tiranë dhe 24 Njësi Administrative për gjëndjet e mbetura në datën 31.12.2017 derdhjet e të cilave janë bërë në vitin pasardhës për vlerën e debisë 3,945,648 lekë si më poshtë vijon:*

Nr.	Emertimi	Detyrimi i mbetur 31.12.2016	Furnizimi BT + NJA 2017	Derdhje ne Banke nga BT + NJA 2017	Detyrimi i mbetur 31.12.2017
1	Debitor Bashki + NJA - pulla Gj.Civile	6,034,992	50,139,000	52,228,344	3,945,648
	<b>Vlera Totale</b>	<b>6,034,992</b>	<b>50,139,000</b>	<b>52,228,344</b>	<b>3,945,648</b>

*Debitor për taksa dhe tarifa vendore në vlerën 206,707,769 lekë të cilat i përkasin Njësie Administrative deri më datën 31.07.2015, detyrime këto të trashëguara nga PF në mbyllje të aktivitetit të ish komunave dhe të paraqitura në PF të Bashkisë Tiranë sipas tabelës së mëposhtme:*

Nr.	Emertimi	Detyrimi i mbetur 31.12.2016	Sistemim 2017	Detyrimi i mbetur 31.12.2017
	<b>Debitor NJA - Tatime</b>			
1	Njesia Petrele	8,774,330		8,774,330
2	Njesia Farke	1,564,053	369,853	1,194,200
3	Njesia Berzhite	2,581,990		2,581,990
4	Njesia Vaqarr	10,377,559		10,377,559
5	Njesia Kashar	183,779,690		183,779,690
	<b>Vlera Totale</b>	<b>207,077,622</b>	<b>369,853</b>	<b>206,707,769</b>

Për arkëtimin e këtyre detyrimeve ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme Menaxhimit Financiar në Bashkinë Tiranë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatim Taksave Vendore, nën varësi e Bashkisë nuk është hapur dhe mbajtur llogari ndërmjetëse me nën varësitë.

**Pretendim i Drejtorisë së Financës, është se:**

Meqenëse arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore e kryen DPTTV, atëherë dhe ky detyrim duhet të shkarkohet nga bilanci i Aparatit dhe të ngarkohet bilanci i kësaj drejtorie. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar me shkresat nr. 29204 prot., datë 03.08.2017 dhe nr. 3076 prot., datë 22.01.2018 drejtuar DPTTV është kërkuar marrja në ngarkim e debitorëve për tarifa dhe taksa vendore të këtyre NJA nga kjo Drejtori dhe shkarkimi nga kontabiliteti i Aparatit të Bashkisë Tiranë, pasi DPMF nuk disponon asnjë informacion për ecurinë vjeljes së këtyre detyrimeve, prandaj kjo vlerë është e pandryshuar që në vitin 2015-2016 e 2017. Nga DPTTV është kthyer përgjigje me shkresën nr. 8836/1 prot., datë 18.02.2019, e cila konfirmon marrjen në ngarkim të këtyre detyrimeve dhe regjistrimin në kontabilitetin e tyre si hedhjen e tyre në sistem për vitin 2018. Veprimet kontabël për shkarkimin dhe sistemimin e vlerës prej 206,707,769 lekë, DPMF e ka kryer për vitin 2018.

**5-Llogaria 520 “Disponilite në thesar”** për vlerën kontabël 230,321,576 lekë, shtuar gjatë vitit 2017 për (230,321,576-88,555,850)= 141,765,726 lekë.

Kjo vlerë është e njëjtë sipas gjendjes pasqyruar në Formatin 5 -Pasqyra e lëvizjes në “CASH” për vitin 2017.

Nga verifikimi i akt rakordimit vjetor të thesarit për treguesit e realizimit të buxhetit dhe krahasuar këto me veprimet kontabël në llogarinë e 520 “Disponibilitete në Thesar” dhe në ditarin e bankës, rezultojnë të jenë rakorduara, veprime të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

<b>Llog.520"Disponibilitete në Thesar"</b>			
	<b>Debi</b>	<b>Kredi</b>	
Gjendje Thesar 01.01.2016	<b>88,555,850</b>		
Çelje fonde	13,607,752,209	10,271,441,145	Pagesa USH
Kthim USH 2016	4,045,256	501,989,824	Pakësim fonde
Arkëtime pulla BT	52,228,344	2,680,059,785	Derdhje ne buxhet fonde
		53,501,300	papërdorur
		15,268,029	Pagesa pulla GJ. Civile
			Pagesa ngurtësime
	<b>13,752,581,659</b>	<b>13,522,260,083</b>	
<b>Gjendje Thesar 31.12.2017</b>	<b>230,321,576</b>	10,271,441,145-4,045,256+158,306,711= 10,425,702,601	
<b>Analiza e gjendjes llog. 520 në datë 31.12.2017</b>		Gjendja 01.01.2017 (llog.520)	<b>88,555,850 nga:</b>
Pulla dhjetor 2017	3,021,444	Pagese pulla janar 2017	(4,294,400)
Ngurtësime 2017	158,306,711	Pagesa ngurtësime	(15,268,029)
Ngurtes. Viti 2015+2016	68,993,421	Ngurtesime 2015+2016	<b>68,993,421</b>
<b>Totali</b>	<b>230,321,576</b>		

<b>Llogaria 520 ( përputhja me evidencën e thesarit)</b>			
<b>DEBI</b>		<b>KREDI</b>	
<b>Banka totali Debi(Çelje)</b>	<b>13,607,752,208</b>	<b>Banka totali Kredi</b>	<b>13,522,260,083</b>
Pakësim fonde	(501,989,824))	Kthim ne buxhet	(2,680,059,785)
		Pakësim fonde	(501,989,824)
		Pagesa pulla	(53,501,300)
		Kthime - USH 2017	(4,045,256)
		Pagesa garanci nga 466	(15,268,029)
		Ngurtesime 2017	158,306,712
<b>Totali Debi</b>	<b>10.818.944.103</b>	<b>Totali Kredi</b>	<b>10,425,702,601</b>
<b>Sipas Akt-Rakordimit te Degës se Thesarit vjetor 2017</b>			
	<b>Plan përfundimtar Buxheti</b>	<b>Çelje</b>	<b>Fakti</b>
Thesari evidenca 31.12.2017	15,861,305,440	13,105,762,384	<b>10,425,702,601</b>

Këto veprime janë të paraqitura edhe me formatin pasqyra nr. 9 mbi “Pasqyrë e lëvizjes në cash viti 2017” bashkëngjitur.

-Llogaria 532 “Vlera të tjera” për vlerën kontabël 455,400 lekë, **pakësuar** gjatë vitit 2017 për (1,544,400-455,400)= 1,089,000 lekë.

Përfaqëson gjendjen e pullave në arke për Gjendjen Civile

-Llogaria 56 “Llogari në organizma krediti” për vlerën kontabël 124,249 lekë, **pakësuar** gjatë vitit 2017 për (789,915-124,249)= 665,666 lekë.

Në mbyllje të vitit ushtrimor 2017 paraqitet në vlerën 124,249 lekë e cila përfaqëson vlerën që ka mbetur pa u kthyer nga kredimarrësit për fondin e garancisë të trajtuar në llogarinë 512 pika 1.

-Llogaria 477 “Diferencë konvertimi aktive” për vlerën kontabël 1,563,808 lekë, nuk ka ndryshime gjatë vitit 2017.

Kjo vlerë është e trashëguar nga ish bilanci PIU në vitin 2015 dhe për këtë vlerë nga ish PIU është prekur në pasiv fonde bazë. Kjo llogari nuk është mbyllur në fund të vitit ushtrimor, nuk janë bërë veprimet e nevojshme për mbylljen e kësaj llogarie, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për Organet e Pushtetit Lokal, Institucionet Shtetërore, Qendrore dhe Lokale si dhe të Njësive që varen prej tyre” i ndryshuar dhe UMF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore 2007, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor” i ndryshuar.

**Llogaritë e Pasivit të Bilancit.**

-Llogaria 101 “Fonde bazë” për vlerën kontabël 19,837,757,946 lekë, shtuar gjatë vitit 2017 për (19,837,757,946-18,875,332,609)= 962,425,337 lekë.

-Llogaria 105 “Grande të brendshme kapitale” për vlerën kontabël 10,286,598,234 lekë, **pakësuar** gjatë vitit 2017 për (10,298,804,842-10,286,598,234)= 12,206,608 lekë.

-Llogaria 106 “Grande të huaja kapitale” për vlerën kontabël 1,173,115,910 lekë, nuk ka ndryshime gjatë vitit 2017.

-Llogaria 107 “Vlera e aktiveve të qëndrueshme të caktuara në përdorim” për vlerën kontabël 738,300 lekë, nuk ka ndryshime gjatë vitit 2017.

-Llogaria 115 “Caktimi nga rezultati i vitit për investime” për vlerën kontabël 14,519,495,005 lekë, shtuar gjatë vitit 2017 për (14,519,495,005-11,118,730,689)= 3,400,764,316 lekë.

-Llogaria 16 “Huamarrje e brendshme dhe e njëshme” për vlerën kontabël 934,296 lekë, **pakësuar** gjatë vitit 2017 për (1,975,947-934,296)= 1,041,651 lekë.

Kjo vlerë në këtë llogari paraqet gjendjen e kredisë së marrë nga ish-komuna Petrelë për financimin e projektit të investimit me objekt “Sistemim asfaltim rruga Petrelë Zaranikë”.

Pakësimi është pagesë e kësteve të kredisë.

-Llogaria 17 “Huamarrje e huaj”. Për vlerën kontabël 5,264,576,094 lekë. Kjo llogari për vitin 2017, është shtuar për vlerën (5,264,576,094- 3,395,972,011)= 1,868,604,083 lekë.

Për vitin 2017, Bashkia Tiranë ka kryer shpenzime kapitale me financim të huaj për projektin “Bulevardi Verior dhe Rehabilitimit të Lumit të Tiranës” nga Abu Dhabi (marrëveshje nënhuaje).

Ky investim financohet për 80% të vlerës nga kreditori Abu Dhabi nëpërmjet disbursimeve dhe 20% e vlerës financohet nga Buxheti i Bashkisë, pra Bashkia Tiranë me fondet e veta përballon vetëm kostot lokale. Për këto shpenzime nga Drejtoria e Financës janë kryer këto veprime kontabël: Me mbërritjen e situacionit të shoqëruar me faturën e sipërmarrësit të punimeve për vlerën 20% është kryer veprimi kontabël debi llog. 231 “Shpenzime investime në proces për kosto lokale” në kredi të llog.404 “Furnitor për investime” në vlerën 406,810,477 lekë.

Për konfirmimet nga Drejtoria e Projekteve të Investimeve të Huaja dhe Ministria e Financave për disbursimet, është kryer veprimi kontabël debi llog. 231 “Shpenzime investime në proces” në kredi të llog. 17 “Huamarrje e huaj” për vlerën 1,868,604,083 lekë. Të dhënat paraqiten në tabelën më poshtë:

Operatorët sipërmarrës të punimeve viti 2017	Ekonomik	Objekti i Kontratës	Kosto lokale e faturave për Bashkinë 20%.	Disbursimet (shpenzime direkte nga Abdu Dhabi 80% për faturat e sipërmarrësve të punimeve)
Baker Tilly Grimshaë		"Projekt i detajuar dhe hartimi i dokument. te tenderit per zgjerimin e bulevardit te Tiranës dhe Rehabilitimi i Lumit te Tiranës" - Abu Dhabi	14,403,825	72,019,125
Copri Construction Enterprises Ë.L.L. Safat Kuëait Charlie Haider)		Ndërtimi i Bulevardit Verior Tiranës dhe punimet civile përkatëse - Abu Dhabi	215,133,072	934,188,033
"Trema Engineering 2 sh.p.k." Albania & "Strabag AG", Austria		Punime Rehabilitimi në Lumin e Tiranës, të bankinave dhe përfshirë të gjitha punimet ndërtimore - Abu Dhabi	140,036,286	700,181,423
JV "Planarch Srl" Rome, Itali (lider) & "Hydeas SpA" & "Abacus Srl" & "Tecnic Consulting Engineers SpA", Itali		Supervizimi i punimeve per projektin e Bulevardit Verior të Tiranës dhe Rigjenerimi i Lumit të Tiranës - Abu Dhabi	25,324,423	162,215,501
CMS Adomino Ascoli (Italfer)		Studim fizibiliteti dhe dokumentet e tenderit per ndert. e "Terminali transportit urban T-UTC" - Abu Dhabi	1,284,397	
Fusha sh.p.k		Ndërtimi i Banesave me Qëllim Social - CEB	10,628,474	
<b>Totali</b>			<b>406,810,477</b>	<b>1,868,604,083</b>

**7-Llogaritë** 401-408 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to”. Për vlerën kontabël 4,442,437,198 lekë. Kjo llogari për vitin 2017, është shtuar për vlerën (4,442,437,198- 3,045,844,648)= 1,396,592,550 lekë. Gjendja e kësaj llogarie është e analizuar sipas kreditorëve ku:

-592,422,444 lekë i përkasin llogarisë 401 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to” për blerje mallra e shërbime dhe

-3,850,014,754 lekë i përkasin llogarisë 404 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to” për investime.

Në vijim janë pasqyrat analitike të detyrimeve të këtyre llogarive për mbylljen e bilancit financiar të vitit 2017.

Bashkëngjitur është pasqyra nr. 10. Analiza e llogarisë 401 dhe pasqyra nr. 11 Analiza e llogarisë 404.

-Llogaria 42 “*Personeli e llogari të lidhura me to*” për vlerën kontabël 98,093,547 lekë, shtuar gjatë vitit 2017 për (98,093,547-85,822,293)= 12,271,254 lekë.

-Llogaria 431 “*Detyrime ndaj shtetit për tatim taksat*” për vlerën kontabël 33,585,507 lekë, **pakësuar** gjatë vitit 2017 për (47,655,982-33,585,507)= 14,070,475 lekë.

-Llogaria 4341 “*Të tjera operacione me shtetin (kreditor)*” për vlerën kontabël 343,552,468 lekë.

-Llogaria 435 “*Sigurime shoqërore*” për vlerën kontabël 61,034,090 lekë, **pakësuar** gjatë vitit 2017 për (70,227,946-61,034,090)= 9,193,856 lekë.

-Llogaria 436 “*Sigurime shëndetësore*” për vlerën kontabël 7,248,373 lekë, shtuar gjatë vitit 2017 për (7,248,373-5,522,234)= 1,726,139 lekë.

-Llogaria 464 “*Detyrime për tu paguar për blerjen e letrave me vlerë*” për vlerën kontabël 50,400 lekë, nuk ka ndryshime gjatë vitit 2017.

-Llogaria 466 “*Kreditorë për mjete në ruajtje*” për vlerën kontabël 227,300,132 lekë, shtuar gjatë vitit 2017 për (227,300,132-84,261,450)= 143,038,682 lekë.

Kjo llogari është në të njëjtën vlerë sipas aktit të rakordimit me degën e thesarit.

Vlera e kësaj llogarie, është e kontabilizuar dhe e analizuar sipas Urdhër Shpenzimit për ngurtësimin e fondeve si garanci për cilësinë e punimeve të kryera nga subjektet sipërmarrëse dhe kontratave të lidhura me Bashkinë Tiranë, data e ngurtësimit të fondeve, subjekti përfitues (Kreditor) etj.

Më hollësisht analiza e kësaj llogarie, jepet sipas të dhënave të pasqyrës që vijon:

Bashkëngjitur pasqyra nr. 12 analiza e llogarisë 466 “*Mjete në ruajtje*”.

Sipas të dhënave të pasqyrës më sipër, konstatohet se gjatë vitit 2017, janë bërë ngurtësime të fondeve si garanci të punimeve në masën 5% të vlerës së punimeve **në 101 raste për vlerën totale 158,306,711 lekë** që përfaqësojnë shpenzime për investime të përfunduara në masën 3,166,134,200 lekë, vlerat e tjera të ngurtësimeve, janë të trashëguara nga vitet 2016 dhe 2015 ndërkohë që gjatë vitit, janë bërë edhe cngurtësime të fondeve të garancisë së punimeve.

-Llogaria 467 “*Kreditorë të ndryshëm*” për vlerën kontabël 1,461,411,756 lekë, **pakësuar** gjatë vitit 2017 për (2,659,028,117- 1,461,411,756)= 1,197,616,361 lekë.

Kjo llogari është e analizuar dhe ka në kredi të saj vlerat:

-888,459,192 lekë detyrime për tu paguar për shpronësimet sipas VKM sipas të dhënave të pasqyrës që vijon,

-22,136,362 lekë është kredituar llog. 467 “*Kreditorë të ndryshëm*” në debi të llogarive: 6061 “*Të tjera transfertat tek individët për veteranët e luftës*” për detyrime për shpenzime varrimi veteranë luftime (LANÇ), “*Shpenzime për honorarë*”, shpenzime për ndihma dhe fatkeqësi etj. sipas të dhënave të pasqyrës që vijon,

-82,070,000 lekë detyrime për tu paguar për bonus lindje fëmijë (nga BT në vlerën 29,060,000 lekë dhe Ministria e Brendshme në vlerën 53,010,000 lekë) në debi të llog. 6061 “*Transferte për fëmijë të lindur*” dhe

-468,746,202 lekë në debitë të llog. 6027 “*Shpenzime për detyrime dhe kompensime legale*” lidhur me detyrime sipas vendimeve të gjykatave

Bashkëngjitur pasqyrat nr. 13. Analiza e llogarisë 467 “*Kreditorë të ndryshëm për shpronësime*”, nr. 14 analiza e llogarisë 467 për “*Kreditorë të tjerë*” për ndihma ekonomike, bonus për lindje fëmijësh etj. dhe pasqyra nr. 15 analiza e detyrimeve gjyqësore.

Nga të dhënat e databaze të Bashkisë Tiranë rezulton se të 106 vendimet gjyqësore janë detyrim të formës së prerë, ndërsa për çështjen në proces gjyqësor Drejtoria e Financës nuk ka të dhëna. Me daljen e titullit ekzekutiv nga Kryetari i Bashkisë, është bërë veprimi kontabël në debi të

shpenzimeve 6027 “Shpenzime per detyrime dhe kompensime legale” (sipas tipologjisë së v. gjyqësore) në kredi të llog. 467 “Kreditorë të ndryshëm”.

Për pagesën veprimi kontabël është bërë në debi të llog. 467 “Kreditorë të ndryshëm” në kredi të llog. 520 “Disponibilitete në thesar”.

Sa më sipër, konstatohet diferencë e madhe në kohë midis vendimit të formës së prerë të gjykatës dhe Urdhrit Ekzekutiv të Titullarit të Bashkisë, për kontabilizimin e detyrimit për tu paguar.

#### **-Mbi financimet nga FSHZH**

Fondet e përfituara nga FZHR janë fonde të alokuara për projekte investimesh dhe janë kontabilizuar sipas kohës së realizimit. Kontabilizimi ka filluar me mbërritjen e faturave të shoqëruara me situacione për punime pjesore të shtrira sipas afatit të realizimit të kontratave.

**Me konstatimin e shpenzimit** (mbërritja e faturës shoqëruar me situacion) është bërë veprimi kontabël në debi të llogarisë 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT-ve” në kredi të llogarisë 404 “Furnitor për investime”.

**Me mbërritjen e shkresës** së dërguar nga Ministria e Financave për alokimin e fondit pjesor të vitit ushtrimor të detajuar sipas projekteve të investimeve është kryer veprimi kontabël për shumat përkatëse në debi të llog. 520 “Disponibilitete në thesar” në kredi të llog. 476 “Të ardhura të caktuara për t’u përdorur”.

**Në momentin e pagesave** të faturave është kryer kontabilizimi për çdo pagesë në debi llogarisë 404 “Furnitorë për investime” dhe në kredi të llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar”.

**Në fund të vitit ushtrimor** për fondet e investimeve në proces të pa përfunduara të përdorura është kryer veprimi kontabël në debi të llog. 476 “Të ardhura të caktuara për t’u përdorur” në kredi të llog. 720 “Grant korrent i brendshëm” dhe në kredi të llog. 4342, “Operacione me shtetin (të drejta)” për pjesën e fondeve të përdorura gjatë vitit ushtrimor, për llogari të shpenzimeve të realizuara vitin e mëparshëm, por të financuara me fondet buxhetore të vitit ushtrimor raportues.

**Me përfundimin e investimit** të konfirmuar me aktin e marrjes në dorëzim të investimit dhe likuidimit total të vlerës së kontratës është bërë kapitalizimi aktivitet (hyrje sipas llojit të AQT), për të cilat është prerë artikulli kontabël në debi të llogarisë 21 “Aktive afatgjata materiale” në kredi të llogarisë 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT-ve”.

Bashkëngjitur pasqyra nr. 16 Investimet me burim nga FSHZH.

**Mbi krahasimin e gjendjeve debi-kredive** të vitit paraardhës 2016 dhe krahasimi me gjendjen në vitin 2017, sipas pasqyrave financiare paraqitet si në pasqyrën që vijon:

Nr.	Vlera në debi. Lekë			Vlera në kredi. Lekë		
	Llogaritë debitore	Viti 2016	Viti 2017	Llogaritë kreditore	Viti 2016	Viti 2017
1	409	58,702,072	58,702,072	16	1,975,947	934,296
2	423	1,311,034	1,595,960	17	3,395,972,011	5,264,576,094
3	45	6,538,746	6,538,746	401-408	3,045,844,648	4,442,437,198
4	468	335,387,732	332,981,900	42	85,822,293	98,093,547
5				431	47,655,982	33,585,507
6				435	70,227,946	51,034,090
7				436	5,552,234	7,248,373
8				464	50,400	50,400
9				467	2,659,028,117	1,461,411,756
<b>Shuma</b>		<b>401,939,584</b>	<b>399,818,678</b>		<b>9,312,129,578</b>	<b>11,359,371,261</b>

**Për vitin 2016**, detyrimet kreditore, janë më të mëdha se kërkesat për arkëtime për diferencën 9,312,129,578 - 401,939,584 = 8,910,189,994 lekë.

**Për vitin 2017**, detyrimet kreditore, janë shumë më të mëdha se kërkesat për arkëtime, për diferencën 11,359,371,261 - 399,818,678 = **10,959,552,583** lekë.

#### **Mbi fondet e pa përdorura në fund të periudhës ushtrimore:**

Në formatin nr. 3/1 “Shpenzime të ushtrimit 2017” në rubrikën Operacionet e Korrigjimit të Rezultatit llogaritë paraqiten:

**-Llogaria 8421** “Transferim në buxhet të të ardhurave të pa përdorura” në vlerën 1,972,835,475 lekë e përbërë nga:

-71,748,780 lekë- fonde të papërdorura plus tre transfertat të pakushtëzuara dhe

-1,901,086,695 lekë nga FSHZH që përfaqësojnë atë pjesë të të ardhurave që i përket institucionit për t’u përdorur deri në fund të vitit por nuk e ka përdorur për vitin buxhetor 2017. Për këto vlera është bërë veprimi kontabël debi llog. 8421 “Transferim në buxhet të të ardhurave të pa përdorura” dhe kredi të llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar”.

**-Llogaria 8422** “Transferim të të ardhurave brenda sistemit” në vlerën 707,224,310 lekë është e përbërë nga kthimi të ardhurave të autorizuar të Bashkisë Tiranë të papërdorura nga Aparati Bashkisë si njësi vartëse. Pra evidenton transferimin e të ardhurave nga institucioni i vartësisë për qendrën që përbën diferencën e të ardhurave të autorizuar nga qendra dhe të ardhurave të përdorura për shpenzim. Kontabilizimi ka filluar me autorizimin për përdorim të fondeve për shpenzime duke debituar llog. 520 “Disponibilitete ne thesar” në kredi të lloga. 476 “Të ardhura të caktuara për t’u përdorur”. Gjatë vitit ushtrimor llogaria 520 “Disponibilitete ne thesar” është kredituar për gjithë pagesat e kryera (pra përdorimi fondeve) në debi të llogarive të shpenzimeve sipas destinacionit. Në mbyllje kjo llogari është debituar për diferencën e fondeve të autorizuar me fondet e përdorura, pra për gjendjen e fondeve të pa përdorura duke debituar llogaritë 8421 “Transferim në buxhet të ardhurave të pa përdorura” dhe llogarinë 8422 “Transferim të të ardhurave brenda sistemit”.

Shuma e papërdorur nga granti i pakushtëzuar që trashëgohet për autorizimet buxhetore për përdorim si për shpenzimet buxhetore korente dhe ato kapitale, janë bërë transfertat nga njësia në buxhet, konstatuar nga verifikimi i akt rakordimit vjetor të thesarit për treguesit e realizimit të buxhetit në Formatin nr. 3/1 “Shpenzime të ushtrimit 2017” në operacionet e korigjimit të rezultatit” si dhe krahasuar me formatin nr. 5 “Pasqyra e lëvizjes në cash viti 2017” rubrika IV “Transferta” të paraqitur më lart. Bashkëngjitur pasqyra nr. 17.

**-Sipas të dhënave të Sistemit Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ)**

**1-Buxheti i vitit 2017** dhe PBA 2017-2019 është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr. 84 datë 29.12.2016 bazuar në ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar); ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen vendore”; Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 8, datë 29.03.2012 për “Procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” si dhe ligjit nr. 130/2016 datë 15.12.2016 për buxhetin e vitit 2017.

Buxheti është miratuar i detajuar sipas programeve buxhetore, njësive shpenzuese dhe klasifikimit ekonomik. Realizimi I tregueseve të Buxhetit të Bashkisë (pa njësitë vartëse dhe **me fondet e veta**) për vitin 2017, janë miratuar me Vendim të Këshillit të Bashkisë nr. 75, datë 07.06.2018, paraqitet si në pasqyrën nr. 19 bashkëngjitur.

**2-Gjatë vitit 2017 janë bërë ndryshime të buxhetit** bazuar në Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë ” i ndryshuar:

-Me 6 Vendime të Këshillit Bashkiak duke zbatuar nenin 44 pika “a” ku citohet “Për njësitë e qeverisjes vendore, kur buxheti miratohet në nivel programi rishpërndarjet ndërmjet programeve miratohen nga Këshilli i Njesisë së Qeverisjes Vendore”

-Me 3 Urdhra të Kryetari duke zbatuar nenin 43 dhe nenin 44 pikat b, c, ç ku citohet “rishpërndarjet e projekteve të investimeve; ndërmjet zërave të shpenzimeve korrente; zërit të shpenzimeve korrente ndërmjet njësive të ndryshme shpenzuese, brenda të njëjtit program, miratohen nga nëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes vendore (kryetari i njësisë së qeverisjes vendore), nga e cila varet njësia shpenzuese.

**5-Ndikimet në krijimin e detyrimeve nga shkurtimet e buxhetit apo bllokimi nga MFE në fund të vitit.**

Me shkresën me nr prot 15973 datë 09.11.2017 Ministria e Financave dhe Ekonomisë njoftoi mbi limitimin e përdorimit të cash-it për Njësitë e vetëqeverisjes vendore duke vendosur dhe priorizim

të rradhës së pagesave: shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore, shpenzime operative, pagesat për shërbimin e borxhit dhe pjesa e mbetur për investime. Ky limit nisi të aplikohet nga data 10.11.2017 deri në fund të vitit buxhetor 2017. Vlera e limitit të vendosur për Bashkinë e Tiranës ka qenë 251,398,479 lekë për periudhën 10.11 -30.11.2017. Ndërsa për periudhën 01.12.2017-31.12.2017 vlera e limitit të vendosur ishte 552,619,128 lekë.

Pavarësisht se Bashkia e Tiranës i dërgoi të dhëna të vazhdueshme Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë duke i argumentuar se limiti i vendosur i përdorimit të cashit ishte shumë i vogël kundrejt të ardhurave të arkëtuara të Bashkisë së Tiranës, me shkresën me nr prot 15973/9 datë 21.11.2017 u akordua një shtesë në limitin e vendosur por vetëm për periudhën 10.11-30.11.2017. Shtesa e akorduar ishte në vlerën 300,000,000 lekë, njoftuar në datë 21.11 dhe mundësi për ta përdorur deri në 30.11.2017.

Duke qenë se dhe për muajin Dhjetor, kërkesat nga ana e Bashkisë ishin të vazhdueshme duke pritur dhe parashikuar një tjetër rritje limiti nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, rritje e cila nuk u bë, shumë pagesa shpenzimesh dhe investimesh që ishin parashikuar të likuidoheshin brenda vitit 2017 nuk u realizuan. Kjo situatë solli problematika duke rritur në mënyrë të konsiderueshme detyrimet e prapambetura nga viti 2017 të cilat u planifikuan në një moment të dytë në buxhetin e vitit 2018.

Me VKB Nr. 41 date 29.03.2018 u miratuan fondet e papërdorura nga viti 2017 (me burim financimi të ardhura dhe granti) dhe u detajuan si një shtesë në buxhetin e vitit 2018. Nga totali i rakorduar me Degën e Thesarit për mbartje në vlerën 2,462,421,325 lekë, vetëm detyrime të prapambetura shpenzime operative të buxhetuara nga kjo mbartje kapën vlerën e 1,274,093,740 lekë.

#### ***7-Afatet në miratimin e buxhetit.***

Bazuar në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), neni 32 ku citohet se “Këshilli i qeverisjes vendore, brenda datës 31 dhjetor, miraton buxhetin vendor në bazë të vlerësimit të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor”, buxheti i vitit 2017 është miratuar në datën 29.12.2016.

Ndryshimet gjatë vitit janë bërë në përputhje me ligjet e sipërcituara dhe sipas nenit 48 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), E drejta e njësisë të qeverisjes së përgjithshme për rishpërndarjen e fondeve, të miratuara për vitin buxhetor, ushtrohet deri në datën 15 nëntor të çdo viti buxhetor, janë respektuar detyrimet ligjore duke depozituar brenda afatit materialet për shqyrtim dhe miratim nga Këshilli Bashkiak.

Mbështetur në ligjin Nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar) si dhe Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2016 për “Vetëqeverisjen Vendore” me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr. 75 datë 07.06.2018 janë miratuar treguesit e realizimit të Buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2017.

#### ***8-Procedurat e ndjekura për realizimin e shpenzimeve.***

Për realizimin e shpenzimeve dhe kryerjen e shpenzimeve janë ndjekur të gjitha hapat e domosdoshme për kryerjen e pagesave. Të gjitha shpenzimet e kryera në Bashkinë e Tiranës dorëzohen me shkresa përcjellëse me kërkesa për financim në Drejtorinë e Përgjithshme të Menaxhimit Financiar. Pas marrjes së praktikave sipas tipologjisë së tyre për shpenzime operative/kapitale, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar kryen kontrollin e nevojshëm financiar të praktikës si urdhër prokurimi/ Proces verbalet /njoftimet e fituesit/kontrata/ fatura/ situacione/ Proces verbale të marrjeve në dorëzim/ Fletë hyrje etj. Pas kontrollit kryhet kontabilizimi i praktikës dhe delegohet te sektori i pagesave për nisjen e hartimit të urdhër shpenzimit. Urdhër shpenzimi pasi përpilohet me të gjitha fushat regjistrohet në sistemin SIFQ dhe përcillet te Nëpunësi Autorizues dhe Zbatues për firmosjen /aprovimin e tyre. Bashkëngjitur urdhër shpenzimet janë të gjitha dokumentet justifikues të kryerjes së këtij shpenzimi.



Pas firmosjes/aprovimit urdhër shpenzimet së bashku me dokumentacionin justifikues dorëzohen te Dega e Thesarit Tiranë për ndjekjen e procedurave nga ana e tyre. Pas marrjes së konfirmimeve nga Dega e Thesarit, urdhër shpenzimet dhe dokumentacionet justifikuese arkivohen në dosjet përkatëse.

Megjithatë, në praktikën e ndjekur për pagesën e faturave të paraqitura në Drejtorinë e Financës, konstatohet se nga Drejtoritë përkatëse që ndjekin zbatimin e kontratave dhe të projektit, në përfundim të investimit, nuk është bërë shumatorja e faturave të paraqitura për pagesë të krahasuara me vlerën e situacionit përfundimtar të miratuar si dhe nuk janë prononcuar nëse ka pasur mos zbatim në kohë të kontratave dhe llogaritje të penaliteteve të mundshme.

#### **9-Regjistrimi i urdhri prokurimit në vlerë të plotë në sistemin e thesari (për BI online).**

Në përputhje me Ligjin nr. 9936 dt.26.6.2008 “Mbi zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 149 i tij, çdo institucion shpenzues duhet të paraqitet në Degën e Thesarit për të marrë vulën e konfirmimit të fondeve disponibël përpara se të fillojë procesin e prokurimit. Bashkia Tirane është institucion Bi-Online dhe struktura përkatëse e zbatimit të buxhetit në momentin që drejtorja e prokurimeve depoziton një urdhër prokurimi nis regjistrimin e tij në SIFQ. Ky proces është i domosdoshëm për kontrollin dhe shmangien e marrjes së angazhimeve pa fonde buxhetore dhe rrjedhimisht krijimin e stokut të ri të faturave të prapambetura. Aktualisht, Drejtorja e Thesarit nuk ushtron kontroll, nuk mbledh informacion për prokurimet e shpallura dhe kontratat e pritshme, informacion që duhet raportuar në zbatim të Nenit 37, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8 datë 13.01.2017. Ky informacion do të shërbente për monitorimin e zbatimit të buxhetit, menaxhimin e likuiditetit, planifikimin koherent të programeve buxhetore të ardhshme dhe shmangien e rishpërndarjeve buxhetore të shumta gjatë vitit.

Në regjistrimin e një urdhër prokurimi nuk ka kutiza në të cilën të shënohet Nr. i urdhër prokurimit dhe data e tij por automatikisht sistemi merr datën e regjistrimit.

Pamja e regjistrimit të një urdhër prokurimi ku nuk lë gjurmë për datën e urdhër të prokurimit por për datën e regjistrimit.

Gjithashtu, është konstatuar disa raste se regjistrimet e urdhër-prokurimeve janë formale pasi ato janë regjistruar pas firmosjes së kontratës, pra urdhër- prokurimi është regjistruar në SIFQ formalisht vetëm për efekt të plotësimit të fushave që lejojnë më pas krijimin e dokumentit kontratë dhe pagesë respektive.

Si Bi-Online, Bashkia Tiranë nuk ka raport nga sistemi SIFQ për të treguar një database mbi urdhër prokurimet me data të urdhrave të prokurimit por sipas të dhënave të vendosura në dispozicion rezulton se janë regjistruar gjithsej rreth 451 veprime me urdhër prokurimi përfshirë edhe rastet kur janë regjistruar të tilla për efekt plotësimi dhe krijimi të një dokumenti kontrate apo pagese

Institucioni	Nr i regjistrimeve te Urdhër Prokurimeve	Vlera Lekë
<b>Bashkia Tirane</b>	<b>451</b>	<b>10.412.676.235</b>

#### **10-Regjistrimi i kontratave në vlerë të plotë në sistemin e thesari në momentin e lidhjes së tyre dhe brenda afateve të përcaktuar në ligj.**

Në zbatim të pikës 17 të Udhëzimit specifik nr. 26 dt. 20/11/2012 “Pas miratimit nga nëpunësi zbatues dhe nëpunësi autorizues i njësisë brenda pese ditëve pune nga nënshkrimi i tyre, dokumentacioni fizik si me sipër paraqitet në gjuhën shqipe (në rastin e kontratave të lidhura në gjuhë të huaj) bashkë me njoftimin përfundimtar zyrtar për shpalljen e fituesit, në strukturën përgjegjëse për thesarin në degë”. Në vijim janë analizuar dhe grupuar data të kontratave të regjistruara me datën e krijimit në sistem dhe rezulton se gjatë vitit 2017 janë regjistruar edhe kontrata te vjetra. Kontratat regjistrohen nga struktura e Nëpunësit Zbatues në momentin që delegohen nga struktura përkatëse. Janë regjistruar 229 kontrata të viteve të mëparshme dhe 85 kontrata të vitit 2017. Regjistrimi i kontratës bëhet sipas planit trevjeçar të miratuar për Bashkinë Tiranë. Ka pas raste kur për shkak të ndryshimeve gjatë viti të buxhetit bëhen spostime të

kontratave në shpërndarjen e viteve dhe kjo sjell në disa raste obligime të cilat të çojnë më pas në copëzime për kontratës.

Sipas të dhënave të sistemit janë regjistruar kontratat si në pasqyrën nr. 20 bashkëngjitur.

***Nga sistemi SIFQ, nuk mund të merren të dhëna se sa janë detyrimet e pa paguar në mënyrë progresivë për një vit të caktuar.***

***11-Rregjistrimi I urdhër pagesat per fatura dhe shpenzime brenda afatit ligjore*** prej 30 ditësh nga data e faturës ne sistemin e thesarit.

Per shkak të akumulimit të detyrimeve të prapambetura nga ish njësitë dhe komunat dhe futjes së sistemit pilot të thesarit ka regjistrime të shpenzimeve jashtë afatit 30 ditor nga data e faturës. Detyrimi lind në momentin që kërkesat për financim vijnë nga drejtorisë respsketive. Në momentin që vjen kërkesa për financim së bashku me dokumentacionin justifikues përfshirë dhe faturën bëhet regjistrimi në kontabilitet të kësaj kërkesë për financim. Faturat janë të copëtuara sepse në Bashkinë e Tiranës punohet me të ardhura dhe me transferte të pakushtezuar e cila shpërndahet në limite mujore për të ardhurat dhe tre mujore për të pakushtezuarën. Arsyeja është ndjekja e limitit të të ardhurave. Në momentin e faturës ka fonde buxhetore por jo detyrimisht ka likuiditet të mjaftueshëm për të paguar fatura dhe për këtë arsye ka copëzime faturash.

Nga analiza e faturave të ekzekutuara gjatë vitit 2017, konstatohet se janë likuiduar me një urdhër shpenzim disa fatura njëkohësisht kur duhet që çdo faturë të regjistrohet në sistem në periudhën përkatëse, në mënyrë që shpenzimi të njihet në periudhën në të cilën ai është kryer dhe lind detyrimi. Kjo ka ndodhur për rastet e faturave të energjisë elektrike, ujit dhe shërbimit postar duke qenë se janë shumë kontrata dhe fatura për këto tipologji shpenzimesh.

***12-Pagesa të faturave në vitin 2017 por që kanë datë të vitit paraardhës.***

Me buxhetin e vitit 2017 janë regjistruar 189 fatura të viteve pasardhese .

Sipas sistemit të thesarit dhe raportit me filtër “Datë Furnitori” me buxhetin e vitit 2017 janë regjistruar 577 fatura të vitit paraardhës. Duhet të saktësojmë se datë furnitori në sistem jo detyrimisht është datë fature tatimore, por regjistrohet edhe data e një listë pagesë, data e një vkb/vkm. Pra raporti i mëposhtëm nuk pasqyron shifrat e datës së një fature tatimore por edhe të rasteve të sipërcituara.

Periudha	Shuma e Faturave
2016	1,610,815,514
2017	7,529,647,187

***Pra sipas të dhënave të sistemit, vlera 7,529,647,187 lekë, përfaqëson vetëm regjistrimet e sistemit.***

***13-Fatuara të ardhura në vitin aktual dhe që duhen shlyer e raportuar këtë vit janë lënë pa regjistruar në sistemin e thesarit për tu regjistruar dhe paguar në vitet pasardhese.***

Për shkak se Bashkia Tiranë është njoftuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën me nr. prot., 15973 datë 09.11.2017 mbi limitimin e përdorimit të cash-it për Njësitë e vetëqeverisjes vendore duke vendosur dhe prioritizim të rradhës së pagesave: shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore, shpenzime operative, pagesat për shërbimin e borxhit dhe pjesa e mbetur për investime ka sjelle akumulim të detyrimeve.

Në kategorinë Mallra dhe Sherbime llogaria 401 rezultojnë detyrime në shumën 592.422.444 leke . Numri i faturave të ardhura në vitin aktual 2017 të papaguara është 55 . Në kategorinë Investime llogaria 404 rezultojnë detyrime në shumën 3.850.014.754 lekë. Numri i faturave të ardhura në vitin aktual 2017 të papaguara është 227 fatura .

***14-A ka patur gjatë vitit (veçanërisht në fund të vitit) raste që mund të përbejnë realizim fiktiv të shpenzimeve dhe faturim të tyre për të mos djegur fondet buxhetore apo trajtim preferencial.***

Në fund të vitit 2017 nuk paraqitet asnjë rast realizimi fiktiv të shpenzimeve. Për shkak se Bashkia Tirane është njoftuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën me nr. prot 15973 datë 09.11.2017 mbi limitimin e përdorimit të cash-it për Njësitë e vetëqeverisjes vendore duke vendosur dhe prioritizim të rradhës së pagesave: shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore, shpenzime operative, pagesat për shërbimin e borxhit dhe pjesa e mbetur për investime ka kryer

pagesa per shpenzime dieta, investime me fonde te deleguara, shpenzime, energjie, honorarë etj. Ne regjistrin e pagesave nuk figuron asnjë rast ne muajin dhjetor qe të jetë paguar me distance datë kontrate me date fature.

**15-A ka patur ne kryerjen e pagesave sipas zërave buxhetor thyerje te radhës FIFO, duke mos i regjistruar ne kohe faturat ne sistemin e thesarit?**

Sipas Udhëzimit të përhershëm nr. 2 dt. 6.2.2012, pika 166 “Në fillim të çdo dite struktura përgjegjëse për thesarin procedon me vendosjen e limitit ditor të pagesave në funksion të menaxhimit efektiv dhe transparent të likuiditeteve të llogarisë së unifikuar të thesarit në Bankën e Shqipërisë dhe pika 167 “Me pas, struktura përgjegjëse për thesarin vijon me procedurën e grupimit të kërkesave për pagesë sipas rregullit të regjistrimit kronologjik të urdhër-shpenzimeve në sistemin informatik financiar (hyrje e parë -dalje e parë)”. Për shkak te akumulimit te detyrimeve të prapambetura dhe dorëzimit te kërkesave për financim nga drejtoritë përkatëse me vonese, ka raste të thyerjes se radhës. Kjo për shkak edhe te limitit te të ardhurave.

**16-A paguhen shumica e faturave ne fund te vitit apo ka shpërndarje në kohë.**

Përqendrimi i pagesave te faturave paraqitet si me poshtë:

Tipologjia	3-M1	3-M2	3-M3	3-M4
Shpenzime korrente	1,235,612,149	1,829,830,776	1,561,460,674	1,621,940,336
Shpenzime kapitale	348,443,803	1,566,441,421	1,113,115,736	1,147,238,991

Si vërehet edhe nga tabela e mësipërme përqendrimi me i larte është ne tremujorin e dyte si rrjedhoje e realizimit te te ardhurave ne këtë tremujor duke krijuar kështu mundësinë e likuidimeve ne kohe. Duhet bërë dallimi ndërmjet fondeve buxhetore dhe fonde cash për likuidim. Bashkia Tirane per çdo shpenzim ne momentin qe prokurohet ka fonde buxhetore ne dispozicion referuar dhe vendimit te miratuar te buxhetit, por likuidimi i tyre kryhet referuar limitit te miratuar per çdo muaj te te ardhurave ashtu dhe transfertes se pakushtezuar. Gjate muajit dhjetor dorëzimi i kërkesave per financim është me i larte. Per fondet e deleguara nga FZHR dhe Ministria e Arsimit përqendrimi i faturave paraqitet si në pasqyrën nr. 21 bashkëngjitur.

**18-Si është raportuar në thesar, stoku i detyrimeve të prapambetura në cilën klasë të buxhetit? A është e saktë vlera e stokut të detyrimeve të prapambetura duke marrë në konsideratë të dhënat e nxjerra nga analiza e pikave të mësipërme?**

Të dhënat jepen si në pasqyrën që vijon:

**Tabela nr. 2: Zhvillimi i shumës së detyrimeve të prapambetura deri në tremujorin e katërt 2017**

Detyrimet e nj.v.q.v (lekë)	(1) Në fillim të Vitit (Detyrimi i mbartur deri në 31.12.2015)	(2) Detyrimi i krijuar (01.01.2016 deri në 31.12.2016)	Viti 2017				(7=1+2+3+4+5+6) Totali i detyrimeve	(8) Detyrimet e prapambetura të shlyera (nga viti 2015 deri në 31.12.2017)	(9) Detyrimi i shlyer në %	(10=7-8) Detyrimi i mbetur
			(3) Detyrimet e krijuara nga 1 Janar- 31 Mars 2017	(4) Detyrimet e krijuara nga 1 Prill- 30 Qershor 2017	(5) Detyrimet e krijuara rishtas 1 Korrik- 30 Shtator 2017	(6) Detyrimet e krijuara rishtas 1 Tetor- 31 Dhjetor 2017				
<b>Vlera Totale</b>	<b>5,504,207,307</b>	<b>1,476,413,930</b>	<b>989,316,170</b>	<b>1,250,148,025</b>	<b>914,337,668</b>	<b>1,511,978,176</b>	<b>11,646,401,277</b>	<b>7,421,840,841</b>	63.73%	<b>4224560436</b>
Investimet	1,647,247,117	493,854,109	607,833,307	680,271,585	468,368,224	619,090,553	4,516,664,895	2,821,462,014	62.47%	1,695,202,881
Investimet nga FZHR	393,812,721	122,293,555	80,824,552	211,269,211	133,676,978	166,357,483	1,108,234,500	754,646,169	68.09%	353,588,331
TVSH dhe Kosto lokale	675,688,210	299,257,448	14,588,891	124,371,596	74,679,071	23,100,505	1,211,685,722	672,041,261	55.46%	539,644,461
Mallra dhe Shërbime	506,358,579	508,678,588	280,624,249	218,928,404	37,843,708	324,923,996	1,877,357,523	1,533,303,622	81.67%	344,053,901
Vendime Gjyqësore	442,063,596	17,315,230	2,440,171	6,777,230	173,596,151	124,614,038	766,806,416	289,365,718	37.74%	477,440,698
Të tjera	1,839,037,084	35,015,000	3,005,000	8,530,000	26,173,536	253,891,602	2,165,652,222	1,351,022,057	62.38%	814,630,165

Në zbatim të udhëzimit plotësues Nr. 8 datë 13.01.2017 ”Për zbatimin e buxhetit të vitit 2017 detyrime të prapambetura konsiderohen detyrimet financiare të përcaktuara në ligj/kontrate /marrëveshje/vendim gjykate të formës së prerë që mbeten te papaguara 60 dite pas datës se specifikuar ne kontrate apo me ligj, duke përfshirë edhe periudhen kontraktuale te shtyrjes se pagesës, të cilat kane lindur. Ky raportim per pushtetin vendor është i detyrueshëm, sipas formatit te përcaktuar nga Ministria e Financave.

Ne pasqyrat financiare pasqyrohen te gjitha detyrimet qe lindin pavarësisht faktit nëse i ka ardhë afati i maturimit per klasifikim si detyrim i prapambetur. Pra ne pasqyrat financiare detyrimi i raportuar ne klasën 4, nuk ka se si te jete ne te njëjtat shifra qe pasqyrohen ne raportin e detyrimeve te prapambetura.

**Vlera totale e borxhit, është 4,224,560,436 lekë:**

Vlera 353,588,331 lekë- investime nga FZHR, janë regjistruar në SIFQ vetëm faturat pasi nuk regjistrohet në sistem vlera e kontratave pasi nuk ka buxhet për ti regjistruar ato.

Vlera 539,644,461 lekë- TVSH dhe kosto lokale, gjithashtu nuk regjistrohen në SIFQ.

Vlera 477,440,698 lekë- Vendime gjyqësore vlerë që nuk regjistrohet në SIFQ.

Vlera 344,053,901 lekë- për mallra dhe shërbime, në këtë vlerë janë përfshirë detyrime për tu paguar rreth 104,440,000 lekë për të cilat nuk ka dokumentacion si fatura etj. ku një pjesë e tyre janë trashëguar nga ish komunat sot Njësi Administrative e Bashkisë Tiranë.

**Gjetjet kryesore që u konstatuan në auditimin e pasqyrave financiare dhe pozicionet e llogarive përmbledhurazi janë si vijon:**

**6.Titulli Gjetjes** -Për vitin 2017, nga Drejtoria e Financës të Bashkisë Tiranë, nuk është ndjekur praktika e kontabilizimit të detyrimeve të angazhimit financiar bazuar në kontratat e lidhura me subjektet sipërmarrëse sipas procedurave të prokurimit si dhe nuk janë kontabilizuar detyrimet për shpenzimet e pa paguara të faturave të mbërritura për energjinë elektrike dhe për ujin e pijshëm.  
-Nuk janë përgatitur pasqyrat financiare të konsoliduara të Bashkisë Tiranë përfshi njësitë vartëse.

**Situata:** -Në Bashkinë Tiranë, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë elektronike sipas programit “Alfa” i cili mundëson regjistrimin e veprimeve kontabël në përputhje me planin kontabël të miratuar me VKM nr. 248, datë 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe të njëjstëve që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.1.2001.

Për vitin 2017, nga Drejtoria e Financës të Bashkisë Tiranë, **nuk është ndjekur praktika e kontabilizimit të detyrimeve të angazhimit** financiar bazuar në kontratat e lidhura me subjektet sipërmarrëse sipas procedurave të prokurimit si dhe **nuk janë kontabilizuar detyrimet për shpenzimet e pa paguara të faturave të mbërritura për energjinë elektrike dhe për ujin e pijshëm.**

Konkretisht, detyrimet për vlerën e kontratave të lidhura me subjektet sipërmarrëse, referuar të dhënave të pasqyrës mbi realizimin e prokurimeve faktike për vitin 2017, janë ..... **lekë** me tvsh.

-Këto praktika pasi në kontabilitet, është ndjekur praktika e regjistrimit të tyre direkt me pagesën në debi të llogarive të klasës së VI pa i kontabilizuar më parë si detyrime në llogaritë kreditore.

Referuar shpenzimeve për energji elektrike dhe për furnizim me ujë të pijshëm ta paguar në muajin e fundit të vitit 2017, konstatohet se janë paguar gjithsej 13,400,216 lekë nga të cilat:

Për energjinë elektrike 26 faturime në shumën totale 9,787,636 lekë dhe furnizim me ujë nga UK Tiranë për 23 faturime në shumën 3,612,580 lekë.

-Bashkia e Tiranës ka në vartësi 18 Institucione vartëse. Nga Drejtoria e Financës, **nuk janë përgatitur pasqyrat financiare të konsoliduara** të Bashkisë Tiranë për periudhën ushtrimore të vitit 2017, në kundërshtim me kërkesat ligjore.

**Kriteri:** -Mos kontabilizimi i detyrimeve të angazhimit dhe ato të konstatuara, janë në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, Kapitulli I - Mbajtja e kontabilitetit, pika 1-Parimet e përgjithshme.

Mos përgatitja e pasqyrave përmbledhëse të konsoliduar ku të përfshihet gjendja financiare për 18 njësitë vartëse, (Formati nr. 10) dhe pasqyrat përmbledhëse të

konsoliduar e të ardhurave dhe shpenzimeve të funksionimit (Formati nr. 11), është në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për Institucionet Qendrore, Organet e Pushtetit Vendor dhe Njësive që varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit /zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj” i ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007, pika 3.

**Impakti:** -Parregullsitë e mësipërme në mënyrën e evidentimit kontabël dhe të ndërtimit të pasqyrave financiare, paraqesin risk për besueshmërinë dhe përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara.

Evidentimi i saktë i detyrimeve ndaj të tretëve është i domosdoshëm për njohjen reale të borxhit dhe marrjen e masave për zvogëlimin gradual të tij.

**Shkaku:** -Nga Drejtoria e Financës, nuk janë marrë masat e nevojshme për organizimin e evidencës kontabël në përputhje me parimet e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** -Drejtoria e Financës, të organizojë kontabilitetin me qëllim që në Pasqyrat Financiare të fund vitit, të pasqyrohen të gjitha detyrime financiare të pa papaguara përfshi edhe ato të angazhimit sipas kontratave të lidhura me të tretët. Të përgatiten pasqyrat përmbledhëse të konsoliduara ku të përfshihet gjendja financiare të njësive vartëse.

**7.Titulli gjetjes:** Për disa llogari të pasqyrave financiare, nuk janë bërë veprimet kontabël të mbylljes së tyre në fund të vitit ushtrimor.

**Situata:** -Në pasqyrat financiare, janë pasqyruar disa llogari të cilat nuk janë llogari bilanci dhe si të tilla ***duhej të ishin mbyllur në fund të vitit*** ushtrimor duke i sistemuar në llogari të tjera sipas përmbajtjes ekonomike të tyre, konkretisht:

-***Llogaria 477 “Diferencë konvertimi aktive”*** për vlerën kontabël 1,563,808 lekë, nuk ka ndryshime gjatë vitit 2017.

Kjo vlerë është e trashëguar nga ish bilanci PIU në vitin 2015. Kjo llogari nuk është mbyllur në fund të vitit ushtrimor, ***nuk janë bërë veprimet e nevojshme për mbylljen e kësaj llogarie***, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për Organet e Pushtetit Lokal, Institucionet Shtetërore, Qendrore dhe Lokale si dhe të Njësive që varen prej tyre” i ndryshuar dhe UMF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore 2007, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor” i ndryshuar.

-***Llogaria 45 “marrëdhënie me institucionin brenda dhe jashtë sistemit”*** për vlerën kontabël 6,538,746 lekë, nuk ka ndryshime gjatë vitit 2017.

Kjo vlerë është e trashëguar nga ish bilanci PIU në vitin 2015 por nga Drejtoria e Financës, ***nuk disponohen dokumenta kontabël mbi përmbajtjen e kësaj llogarie*** dhe për rrjedhojë, në fund të vitit ushtrimor, nuk janë bërë veprimet e nevojshme për mbylljen e kësaj llogarie, në kundërshtim me kërkesat ligjore.

**Kriteri:** -Kërkesat ligjore: VKM nr. 248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për Organet e Pushtetit Lokal, Institucionet Shtetërore, Qendrore dhe Lokale si dhe të Njësive që varen prej tyre” i ndryshuar dhe UMF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për Institucionet Qendrore, Organet e Pushtetit Vendor dhe Njësive që varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit /zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj” i ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007, Kap. II, pikat 1- Procedura të përgjithshme, pika 2- Funkzioni i disa llogarive specifike të planit kontabël.

**Impakti:** -Këto mangësi kanë impakt në përdorimin e pasqyrave financiarë nga subjekte të tjera të interesuara.

Mos mbyllja e këtyre llogarive sipas kërkesave ligjore, përbën risk lidhur me

saktësinë e aktiveve të bilancit ose në gjendjen e burimeve të pasivit të pasqyrave financiare.

**Shkak:** -Nga Drejtoria e Financës të Bashkisë Tiranë, nuk disponohen të dhënat e nevojshme kontabël mbi përmbajtjen e këtyre llogarive të cilat janë trashëguar në këtë gjendje financiare për periudha disa vjecare, nga viti 2015 sipas projektit PIU.

**Rëndësia:** I mesëm.

**Rekomandimi:** Drejtorie e Financës, të marrë masa dhe të analizojë përmbajtjen e këtyre llogarive mbi bazën e dokumenteve duke i kërkuar ato në arkivin e institucionit ose që i përkasin projektit PIU.

Të procedojë sipas kërkesave ligjore për sistemimin kontabël të këtyre llogarive duke i krahasuar ato me gjendjet fizike reale të tyre dhe njëkohësisht të nxjerrë përgjegjësitë përkatëse nëse konstatohen këto përgjegjësi.

**8.Titulli gjetjes:** Llogaria 24 “Aktive të qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara”, paraqet gjendje inventariale të rrisuar përsa I përket vërtetësisë së vlerës së saj për shkak të mungesës së inventarizimit fizik, kurse llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” për vlerën 206,707,769 lekë nuk duhej të ishte pjesë e aktivitetit të pasqyrave financiare të Bashkisë Tiranë, pasi përfaqësojnë detyrime për tatim taksat lokale të trashëguara nga ish Komunitat (Sot Njësi Administrative). Kjo vlerë duhej të ishte sistemuar në pasqyrat financiare të Drejtorisë së Tatim Taksave të Bashkisë Tiranë.

**Situata:** -Llogaria e bilancit 24 “Aktive të qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara” për vlerën kontabël 530,023,434 lekë, **pakësuar** gjatë vitit 2017 për  $(576,207,855 - 530,023,434) = 46,184,421$  lekë.

Vlera prej 525,960,955 lekë është vlera e aktiveve të kaluara nga Hekurudha Shqiptare sh.a për Bashkinë Tiranë në vitet paraardhëse. Kontabilizimi i kësaj vlere në këtë llogari, është bërë në zbatim të rekomandimit të KLSH-së nga auditimi i kaluar me këtë formulim:

*“Bashkia e Tiranës të analizojë procedurat e ndjekura, lidhur me vjedhjen e asetëve në ish Stacionin Hekurudhor të Tiranës në vlerën 525, 960,955 lekë.*

*Të bëhet vlerësimi me komision i asetëve të tjera të konstatuara të vjedhura si: 276 ml gardh hekuri, 488 ml linjë hekurudhore dhe 22 copë ndërruese shinash dhe të nxirret përgjegjësia administrative dhe ligjore ndaj personave të ngarkuar për ruajtjen dhe marrjen në dorëzim.*

*Të miratohen me vendim të Këshillit të Bashkisë diferencat për tu shkarkuar nga kontabiliteti në zbatim të kërkesave të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore” i ndryshuar neni 32, duke kryer veprimet e duhura në kontabilitetin e Bashkisë”.*

Lidhur me këtë rekomandim, nuk na u paraqitën dokumenta për procedurat administrative dhe ligjore për sistemimin e kësaj llogarie duke nxjerrë edhe përgjegjësitë ndaj personave që i kanë pasur në administrimi këto inventarë me argumentimin si vijon:

*“Nuk mund të bëhet vlerësim për aktive që nuk ekzistojnë që kapin vlerën 525,960,955 lekë, kurse për pjesën tjetër ekzistente janë pjesë e inventarit dhe nuk përfshihen në këtë vlerë.*

*Nuk mund të nxirret përgjegjësia administrative për ruajtjen e këtyre mungesave pasi nuk ka patur urdhër dhe strukturë të ngarkuar për ruajtjen e këtyre aktiveve nga momenti marrjes në dorëzim në vitin 2013.*

*Nuk është nxjerrë përgjegjësia administrative ndaj komisionit të marrjes në dorëzim pasi në momentin e marrjes në dorëzim aktivet kanë qënë të plota dhe mungesat janë konstatuar në periudhat e mëvonshme për shkak të mos mundësisë së ruajtjes së këtyre aktiveve dhe shkatërrimit të pjesës ku sot është bërë bulevardi i ri i Tiranës ku janë bërë dhe shpronësime.*

Në momentin e konstatimit të humbjeve është bërë denoncim në polici dhe ka vazhduar për procedim në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë e cila ka hapur procedurën nr.180 datë 17.01.2014, nr. 2263 datë 11.07.2014 dhe nr. 3151 datë 17.10.2014.

Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar (DPMF) nuk ka asnjë informacion zyrtar për rezultatin dhe se si është ndjekur ky problem, pas denoncimit në Polici dhe kalimit të çështjes në Prokurori, gjë që duhej të ndiqej nga strukturat përkatëse në Bashki. Për këtë arsye nuk është marrë asnjë veprim për futjen në KB për njohjen e humbjeve dhe dhënien e një vendimi për sistemim kontabël të kësaj llogarie.”

-Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” për vlerën kontabël 332,981,900 lekë, **pakësuar** gjatë vitit 2017 për (335,387,732-332,981,900)= 2,405,832 lekë.

Kjo llogari është e analizuar me të dhënat si më poshtë vijon:

-86,724,972 lekë, janë kontabilizuar debitorë persona fizikë dhe juridikë sipas rekomandimeve nga auditimet e mëparshme të KLSH-së si dhe të tjera për mungesa inventariale etj.

-35,603,512 debitorë të trashëguara nga njësitë administrative,

-3,945,648 lekë debitorë për taksat e pullës për gjendjen civile dhe

-206,707,769 lekë debitorë trashëguar nga ish komunitat.

**Vlera për 206,707,769 lekë, përfaqësojnë debitorë për taksat dhe tarifën vendore të cilat i përkasin Njësive Administrative (Ish Komuna) deri më datën 31.07.2015, detyrime këto të trashëguara nga pasqyrat financiare në mbyllje të aktivitetit të ish komunave dhe të paraqitura në pasqyrat financiare të Bashkisë Tiranë.**

Për arkëtimin e këtyre detyrimeve ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme Menaxhimit Financiar në Bashkinë Tiranë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatim Taksave Vendore e ngarkuar për vjeljen e detyrimeve tatimore, nuk është hapur dhe mbajtur llogari ndërmjetëse ose transferimin e këtyre aktiveve.

**Kriteri:**

-Kërkesat ligjore; UMF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për Institucionet Qendrore, Organet e Pushtetit Vendor dhe Njësive që varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit /zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj” i ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007, Kap. II, pika 3- Procedurat e rakordimit dhe mbylljes së llogarive

**Impakti:**

-Këto mangësi kanë impakt në përdorimin e pasqyrave financiare nga subjekte të tjera të interesuara.

Mos mbyllja e këtyre llogarive sipas kërkesave ligjore, përbën risk lidhur me saktësinë e aktiveve të bilancit ose në gjendjen e burimeve të pasivit të pasqyrave financiare.

**Shkaku:**

-Nga Bashkia Tiranë, nuk është proceduar sipas kërkesave ligjore për saktësimin dhe sistemimin e këtyre llogarive.

**Rëndësia:**

-I lartë

**Rekomandimi:**

-Drejtorie e Financës, të procedojë sipas kërkesave ligjore për sistemimin kontabël të këtyre llogarive duke i krahasuar ato me gjendjet fizike reale të tyre dhe njëkohësisht të nxjerrë përgjegjësitë përkatëse nëse konstatohen këto përgjegjësi.

**9.Titulli gjetjes:**

Disa llogari të pasqyrave financiare janë marrë (trashëguar) nga ish projekti PIU nga viti 2015 për të cilat nuk mungojnë dokumentet kontabël mbi përmbajtjen e tyre. Këto llogari, nuk janë sistemuar prej vitesh dhe mbahen gjendje në pasqyrat financiare.

**Situata:**

-Disa llogari të pasqyrave financiare janë marrë (trashëguar) nga bilanci i ish projektit PIU që nga viti 2015 por për këto llogari, mungojnë të dhënat analitike mbi përmbajtjen e tyre. Këto llogari, nuk janë sistemuar dhe prej vitesh mbahen

në këtë gjendje në pasqyrat financiare, të Bashkisë Tiranë, konkretisht:  
-Llogaria 409 “Furnitorë (Debitorë), parapagime pagesa pjesore” për vlerën kontabël 58,702,072 lekë, nuk ka ndryshime gjatë vitit 2017.

Përfaqëson paradhënie të disbursuara për projekte me financim të huaj. Trashëguar nga ish PIU në vitin 2015.

-Llogaria 511 “Vlera për tu arkëtuar” për vlerën kontabël 81,204,163 lekë, nuk ka ndryshime gjatë vitit 2017. Përfaqëson vlera për tu arkëtuar nga paradhënie të disbursuara për projekte me financim të huaj. Trashëguar nga ish PIU (Njësia e Menaxhimit të Projekteve me Investime të Huaja) në vitin 2015.

Për këtë llogari nuk ka të dhëna analitike mbi përmbajtjen e saj.

-Llogaria 512 “Llogari në bankë” për vlerën kontabël 24,651,518 lekë, shtuar gjatë vitit 2017 për (24,651,518-23,564,926)= 1,086,592 lekë.

Kjo llogari përbëhet nga:

1. Pjesë e gjendje së kësaj llogarie për vitin në vitin 2017 është **shuma 10,701,247 lekë**, e cila përfaqëson vlerën e rimarrjes (arkëtuar) së kredisë nga 12 bizneset e mesme e të vogla të kredituar nga Banka Kombëtare Tregtare të garantuara nga Bashkia Tiranë sipas marrëveshjes në vitin 2013 të “Fondit të Garancisë” në vlerën 10,000,000 lekë të nënshkruar me BKT në kuadër të “Programit të Zhvillimit Ekonomik dhe Punësimit” të miratuar me VKB e asaj kohe. Gjendja në fund të vitit 2016 është në vlerën 9,614,655 lekë dhe diferenca prej 1,086,592 lekë është vlera shtesë për vitin 2017 e rimarrjes në vazhdim të kësteve të kredisë. Pra është kthim i fondi të garancisë.

2. Pjesë e gjendjes së kësaj llogarie është edhe vlera prej 13,950,271 lekë që i përket bilancit të PIU-t për të cilën nuk ka informacion për përmbajtjen e saj gjendje e trashëguar që nga viti 2013.

**Kriteri:**

- Kërkesat ligjore; UMF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për Institucionet Qendrore, Organet e Pushtetit Vendor dhe Njësive që varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit /zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj” i ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007, Kap. II, pika 3- Procedurat e rakordimit dhe mbylljes së llogarive dhe VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, Kapitulli I - Mbajtja e kontabilitetit, pikat 1-Parimet e përgjithshme dhe 2- Dokumentet kontabël, Kap. II, pika 1.1- Pasqyrat financiare vjetore

**Impakti:**

-Në saktësinë dhe besueshmërinë e pasqyrave financiare si dhe ndikim në treguesit e gjendjes financiare të Institucionit.

**Shkaku:**

-Mungesa e dokumentacionit kontabël për detyrimet debitorë të trashëguara nga ish projekti PIU.

**Rëndësia:**

-I lartë

**Rekomandimi:**

- Të merren masa për të saktësuar vërtetësinë e llogarive; 409 “Furnitorë (Debitorë), parapagime pagesa pjesore”, 511 “Vlera për tu arkëtuar” dhe 512 “Llogari në bankë” bazuar në dokumentacionin kontabël ligjor të bilancit të Njesisë së Menaxhimit të Projekteve me Investime të Huaja (PIU).

Të bëhen sistemimet kontabël të nevojshme bazuar në procedurat ligjore dhe për çdo rast pasaktësie ose shkelke ligjore, të nxiren përgjegjësitë përkatëse ligjore.

**10.Titulli gjetjes:**

Për disa lloje shpenzimesh si për financimin e shpenzimeve për telefon celulari të punonjësve si dhe në rastet e financimit të investimeve të kontraktuara, duhet të përmirësohen procedurat e kontrollit dhe administrimit, me qëllim për të zvogëluar riskun.

**Situata:**

-Për kryerjen e shpenzimeve janë ndjekur procedurat sipas rregullores së brendshme dhe të organizimit të strukturës organizative. Të gjitha shpenzimet e kryera në Bashkinë e Tiranës dorëzohen me shkresa përcjellëse me kërkesa për



financim në Drejtorinë e Përgjithshme të Menaxhimit Financiar. Pas marrjes së praktikave sipas tipologjisë së tyre për shpenzime operative/kapitale, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar kryen kontrollin e nevojshëm financiar të praktikës si urdhër prokurimi/ Proces verbalet /njoftimet e fituesit/kontrata/ fatura/ situacione/ Proces verbale të marrjeve në dorëzim/ Fletë hyrje etj. Pas kontrollit kryhet kontabilizimi i praktikës dhe delegohet te sektori i pagesave për nisjen e hartimit të urdhër shpenzimit. Urdhër shpenzimi pasi përpilohet me të gjitha fushat regjistrohet në sistemin SIFQ dhe përcillet te Nëpunësi Autorizues dhe Zbatues për firmosjen /aprovimin e tyre. Bashkëngjitur urdhër shpenzimet janë dokumentet justifikues të kryerjes së këtij shpenzimi.

Pas firmosjes/ aprovimit urdhër shpenzimet së bashku me dokumentacionin justifikues dorëzohen te Dega e Thesarit Tiranë për ndjekjen e procedurave nga ana e tyre. Pas marrjes së konfirmimeve nga Dega e Thesarit, urdhër shpenzimet dhe dokumentacionet justifikuese arkivohen në dosjet përkatëse.

***Megjithatë, në praktikën e ndjekur për pagesën e faturave të paraqitura në Drejtorinë e Financës, konstatohet se nga Drejtoritë përkatëse që ndjekin zbatimin e kontratave, në përfundim të investimit, nuk është deklaruar me shkrim për Drejtorinë e Financës, nëse ka pasuar mos zbatim në afat të kontratave dhe për rrjedhojë llogaritje të penaliteteve të mundshme.***

-Përgjithësisht bashkëngjitur urdhër shpenzimeve, janë bashkëngjitur dokumentet justifikues kontabël por në disa raste u konstatuan edhe mangësi:

Gjatë vitit 2017, janë paguar shpenzime për telefonat celularë për punonjësit e administratës gjithsej në shumën **2,649,206 lekë**. Për këto pagesa nuk na u paraqitën urdhra nga Titullari i Bashkisë për personat përfitues të këtij shërbimi. Në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 864, datë 23.07.2010 “Për pajisjen me telefon celular të personave juridikë publikë” neni 11 “ *Drejtuesit e organeve të pushtetit vendor kanë të drejtë të urdhërojnë pajisjen me numër telefoni celular të personave zyrtarë, bazuar në detyrën që kryejnë dhe brenda fondeve të parashikuara në buxhetin vjetor, sipas specifikimeve të mësipërme. Shpenzimet për këtë shërbim, në nivel vjetor, të jenë në çdo rast, jo më shumë se 2% e totalit të shpenzimeve për mallra dhe shërbime, të miratuara për çdo institucion në buxhetin vjetor përkatës.*”

Konkretisht përmendim si në rastet e pagesave me urdhër shërbimet:

-Urdhër shpenzimi nr. 3189 datë 30.11.2017 paguar Egle Mobile Nipt J 61824053 N për 2,500 lekë për limit telefoni celular për muajin Tetor 2017.

-Me urdhër shpenzimi nr. 3415 datë 22.12.2017, paguar Vodafon Albania K 11715005 L limit telefon celulari për E.M. shuma 10,500 lekë muaji Nëntor 2017.

-Me urdhër shpenzimi nr. 3416 datë 22.12.2017, paguar Plus Communication sha K 91811014 B limit telefon celulari për K.L. shuma 3,628 lekë muaji Nëntor 2017.

-Me urdhër shpenzimi nr. 3107 datë 22.11.2017, paguar Telekom Albania sha J 61814094 Ë limit telefoni Tetor 2017 për A.D. shuma 9,108 lekë etj. raste.

- Kërkesat e VKM nr. 864, datë 23.07.2010 “Për pajisjen me telefon celular të personave juridikë publikë” neni 11 “ *Drejtuesit e organeve të pushtetit vendor kanë të drejtë të urdhërojnë pajisjen me numër telefoni celular të personave zyrtarë, bazuar në detyrën që kryejnë dhe brenda fondeve të parashikuara në buxhetin vjetor, sipas specifikimeve të mësipërme. Shpenzimet për këtë shërbim, në nivel vjetor, të jenë në çdo rast, jo më shumë se 2% e totalit të shpenzimeve për mallra dhe shërbime, të miratuara për çdo institucion në buxhetin vjetor përkatës.*”

**Kriteri:**

-Në rregullshmërinë e shpenzimeve për disiplinuar pagesat për shpenzime telefonit celular si dhe për shpenzimet për investime për të minimizuar riskun e

pagesave të pa ligjshme në objektet e investuara.

**Impakti:**

**Shkaku:**

**Rëndësia:**

**Rekomandimi:**

-Mungesa e rregullave të mire përcaktuara për objektet e kontraktuara me sipërmarrje.

-I lartë

- Të merren masa për të përmirësuar procedurat për kontrollin e financimit të investimeve sipas kontratave të lidhur me të tretët.

Për këtë me urdhër të veçantë të Titullarit të Bashkisë ose duke e sanksionuar në rregulloren e funksionimit të brendshëm të institucionit, të parashikohet që për çdo rast, në përfundim të investimit, të bëhet rakordimi me midis Drejtorisë së Financës dhe Drejtorisë Përkatese të Zbatimit të Kontratave për faturat e paraqitura dhe të paguara, vlerës së situacionit përfundimtar si dhe për llogaritjen e penaliteteve të mundshme ndaj sipërmarrësit të shërbimit apo punimeve.

Titullari i Bashkisë, të miratojë listën për personat që do të jenë përfitues të shpenzimeve për telefon celular sipas kërkesave të VKM nr. 864, datë 23.07.2010 “Për pajisjen me telefon celular të personave juridikë publikë”.

**11. Titulli gjetjes:**

Krahasuar me vitin 2016, në vitin 2017, gjendja financiare e Institucionit, është përkeqësuar për shkak të rritjes të raportit midis detyrimeve kreditore ndaj debitorëve.

**Situata:**

-Përgjithësisht gjendja e debitorëve dhe kreditorëve, janë të analizuar sipas përmbajtjes së tyre dhe periudhës së krijimit. Konkretisht:

-Llogaria 468 “*Debitorë të ndryshëm*” për vlerën kontabël 332,981,900 lekë, **pakësuar** gjatë vitit 2017 për  $(335,387,732-332,981,900)= 2,405,832$  lekë.

Kjo llogari është e analizuar me të dhënat si më poshtë vijon:

-86,724,972 lekë, janë kontabilizuar debitorë persona fizikë dhe juridikë sipas rekomandimeve nga auditimet e mëparshme të KLSH-së si dhe të tjera për mungesa inventariale etj.

-35,603,512 debitorë të trashëguara nga njësitë administrative,

-3,945,648 lekë debitorë për taksat e pullës për gjendjen civile dhe

-206,707,769 lekë debitorë trashëguar nga ish komunat.

-**Llogaritë** 401-408 “*Furnitorë dhe llogari të lidhura me to*”. Për vlerën kontabël 4,442,437,198 lekë. Kjo llogari për vitin 2017, është shtuar për vlerën  $(4,442,437,198- 3,045,844,648)= 1,396,592,550$  lekë. Gjendja e kësaj llogarie është e analizuar sipas kreditorëve ku:

-592,422,444 lekë i përkasin llogarisë 401 “*Furnitorë dhe llogari të lidhura me to*” për blerje mallra e shërbime dhe

-3,850,014,754 lekë i përkasin llogarisë 404 “*Furnitorë dhe llogari të lidhura me to*” për investime.

-Llogaria 467 “*Kreditorë të ndryshëm*” për vlerën kontabël 1,461,411,756 lekë, **pakësuar** gjatë vitit 2017 për  $(2,659,028,117- 1,461,411,756)= 1,197,616,361$  lekë.

Kjo llogari është e analizuar dhe ka në kredi të saj vlerat:

-888,459,192 lekë detyrime për tu paguar për shpronësimet sipas VKM sipas të dhënave të pasqyrës që vijon,

-22,136,362 lekë është kredituar llog. 467 “*Kreditorë të ndryshëm*” në debi të llogarive: 6061 “*Të tjera transferata tek individët për veteranet e luftës*” për detyrime për shpenzime varrimi veteranë lufte (LANÇ), “*Shpenzime për honorarë*”, shpenzime për ndihma dhe fatkeqësi etj. sipas të dhënave të pasqyrës që vijon,

-82,070,000 lekë detyrime për tu paguar për bonus lindje fëmijë (nga BT në vlerën 29,060,000 lekë dhe Ministria e Brendshme në vlerën 53,010,000 lekë) në debi të llog. 6061 “*Transferate për fëmijë të lindur*” dhe

-468,746,202 lekë në debit të llog. 6027 “*Shpenzime për detyrime dhe kompensime legale*” lidhur me detyrime sipas vendimeve të gjykatave

Nga të dhënat e data bazës të Bashkisë Tiranë rezulton se të 106 vendimet

gjqësore janë detyrim të formës së prerë, ndërsa për çështjen në proces gjyqësor Drejtoria e Financës nuk ka të dhëna. Me daljen e titullit ekzekutiv nga Kryetari i Bashkisë, është bërë veprimi kontabël në debi të shpenzimeve 6027 “Shpenzime per detyrime dhe kompensime legale” (sipas tipologjisë së v. gjyqësore) në kredi të llog. 467 “Kreditore te ndryshëm”.

Për pagesën veprimi kontabël është bërë në debi të llog. 467 “Kreditore të ndryshëm” në kredi të llog. 520 “Disponibilitete në thesar”.

Sa më sipër, konstatohet diferencë e madhe në kohë midis vendimit të formës së prerë të gjykatës dhe Urdhrit Ekzekutiv të Titullarit të Bashkisë, për kontabilizimin e detyrimit për tu paguar.

**Për vitin 2016**, detyrimet kreditore, janë më të mëdha se kërkesat për arkëtime për diferencën  $9,312,129,578 - 401,939,584 = 8,910,189,994$  lekë.

**Për vitin 2017**, detyrimet kreditore, janë shumë më të mëdha se kërkesat për arkëtime, për diferencën  $11,359,371,261 - 399,818,678 = 10,959,552,583$  lekë.

-Sipas të dhënave të SIFQ **Vlera totale e borxhit, është 4,224,560,436 lekë:**

Vlera 353,588,331 lekë- investime nga FZHR, janë regjistruar në SIFQ vetëm faturat pasi nuk regjistrohet në sistem vlera e kontratave pasi nuk ka buxhet për ti regjistruar ato.

Vlera 539,644,461 lekë- TVSH dhe kosto lokale, gjithashtu nuk regjistrohen në SIFQ.

Vlera 477,440,698 lekë- Vendime gjyqësore vlerë që nuk regjistrohet në SIFQ.

Vlera 344,053,901 lekë- për mallra dhe shërbime, në këtë vlerë janë përfshirë detyrime për tu paguar rreth 104,440,000 lekë për të cilat nuk ka dokumentacion si fatura etj. ku një pjesë e tyre janë trashëguar nga ish komunitat sot Njësi Administrative e Bashkisë Tiranë.

Vlera 1,695,202,881 lekë- Investime

dhe të tjera 814,630,165 lekë.

-Kërkesat ligjore që në programimin buxhetor të vitit, të programohet pagesat e borxhit të vitit paraardhës, në zbatim të kërkesave të VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, Kapitulli I -Mbajtja e kontabilitetit, pika 1-Parimet e përgjithshme, UMF nr. 1, datë 4.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme në llogari të Thesarit” pikat 2, 3, 4, 6, UMF nr. 2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit” Kap. II, pika 102 dhe UMF nr. 8, datë 13.01.2017 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2017” pikat 81, 84.

-Në treguesit ekonomike dhe financiare të Institucionit. Njohja e borxhit dhe detyrimet me qëllim zvogëlimin e borxhit financiar.

-Nuk janë zbatuar kërkesat ligjore në programimin buxhetor por edhe në evidentimin në kohë të detyrimeve kreditore.

I lartë.

Nga Bashkia, të merren masa që në programet buxhetore, të programohen financimi i detyrimeve ndaj të tretëve me qëllim që të ulet borxhi financiar.

Në programet buxhetore vjetore dhe afat mesëm, të parashikohen pagesat për detyrimet gjyqësore të formës së prerë si dhe të kontabilizohen këto detyrime në momentin e konstatimit.

### ***Pasqyrat Financiare viti 2018***

*Për organizimin, mbajtjen e kontabilitetit, hartimin dhe saktësinë e veprimeve rregulluese dhe mbyllëse për paraqitjen e pasqyrave financiare për vitin 2018.*

Për auditimin, sa më sipër, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Pasqyrat financiare të vitit 2018 të shoqëruar me formatet 1-8.
2. Dokumente kontabël si: ditarët e bankës, magazinës, pagave, të veprimeve të ndryshme, debitorëve, kreditorëve, furnitorëve, etj., centralizatori, bilanci vërtetues.
3. Dokumentacioni i kryerjes së inventarëve të aktiveve 2018, libri i aktiveve.
4. Urdhër-shpenzimet dhe dokumentacioni bashkëlidhur për vitin 2018
5. Aktrakordimet me Degën e Thesarit Tiranë në mbyllje të vitit buxhetor 2018.
6. Të tjera dokumente mbështetëse (databaze të ndryshme si: për vendimet gjyqësore, për investimet, programi ALFA, programi SIFQ, Sistemi elektronik i APP etj.).

Për qëllim të auditimit sa më sipër u përdorën teknika për grumbullimin e evidencës dhe auditimin si fizike, dokumentare, elektronike, verbale dhe analitike.

Nga auditimi rezulton se veprimtaria e Drejtorisë së Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, për periudhën 2016-2018, është orientuar nga Strategjia e zhvillimit të qëndrueshëm 2015-2018 miratuar me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 22409, datë 24.12.2015; Strategjia e zhvillimit të qëndrueshëm të bashkisë Tiranë 2018-2022; Planet e veprimit në zbatim të strategjive dhe rregullave të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të B. Tiranë kryesisht duke qëndruar strikt në zbatimin e kuadrit rregullator në fuqi dhe VKB në fushën e menaxhimit financiar të bashkisë.

Drejtorja e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar përbëhet nga Drejtorja e Buxhetit me Drejtor Drejtorie, katër Përgjegjës Sektori dhe 12 specialistë; Drejtorja e Koordinimit me Donatorët me Drejtor Drejtorie dhe 4 specialistë; Drejtorja e Financës me Drejtor Drejtorie, dy Përgjegjës Sektori dhe 12 specialistë dhe Drejtorja e Monitorimit të ndërmarrjeve dhe SHA me Drejtor Drejtorie, dy Përgjegjës Sektori dhe 6 specialistë.

Në Rregulloren e ndryshuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë nr. 25661, datë 02.07.2018 për organizimin, Funkcionimin, Detyrat dhe Përgjegjësitë e Administratës së Institucionit të Bashkisë Tiranë janë përcaktuar qartë dhe në mënyrë koncize misioni dhe detyrat në bazë të kompetencave ligjore të Drejtorisë së Përgjithshme e Menaxhimit Financiar për çdo drejtori vartëse dhe sektor në faqet 76-84 të rregullores ku ndër të tjera janë përcaktuar dhe linjat e varësisë, raportimit dhe komunikimit si horizontalisht ashtu dhe sipas hierarkisë në strukturë. Janë vendosur saktë kontrollet e brendshme dhe është testuar funksionimi i tyre nga i cili nuk janë evidentuar mospërputhje materiale.

Baza ligjore ku mbështetet veprimtaria e Drejtorisë së Përgjithshme e Menaxhimit Financiar është kryesisht kuadri rregullator në fuqi në fushën Drejtorisë së Përgjithshme e Menaxhimit Financiar të cilin kjo drejtori e ka bërë transparente për publikun dhe subjektet e interesuara në faqen zyrtare të bashkisë në internet.

- ***Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:***

Për vitin 2018 nga njësia shpenzuese “Aparati i Bashkisë Tirane” hartimi i pasqyrave financiare dhe përgatitja e llogarive vjetore është mbështetur në ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të ndryshuar, VKM nr.248, datë 10.04.1998 pika 3, ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001, UMF nr. 26, datë 27.12.2007 “Për disa shtesa e ndryshime në UMF nr.14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore 2007, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësite që varen prej tyre si dhe të njësite të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donator të huaj”, VKM Nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”; Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe kryesisht Udhëzimin nr. 08, datë 09.03.2018 “Per procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit te pasqyrave financiare vjetore ne njësitë e qeverisjes se përgjithshme”. Lidhur me operacionet buxhetore, treguesit janë rakorduar dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Tiranë dhe nuk ka patur në asnjë rast kontestime.

- **Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara për të gjitha njësitë shpenzuese të varësisë nuk është kryer ende.**

**Konkluzion:** Për vitin 2018 po punohet për hartimin e bilancit të konsoliduar nga Sektori Konsolidimit Financiar i krijuar me strukturën edhe në rregulloren e brendshme të miratuar me vendimin e kryetarit nr. 13963, date 29.03.2019 “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së institucionit të Bashkisë Tiranë”. Përgatitja e llogarive vjetore po hartohet mbështetur në ligjin nr. 25/2018, datë 10.5.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, VKM nr. 248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për Organet e Pushtetit Lokal, Institucionet Shtetërore, Qendrore dhe Lokale si dhe të Njësite që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001, Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 62 “Përgatitja e llogarive vjetore të buxhetit”, UMF Nr. 8, date 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, VKM Nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël” etj. Informacioni i llogarive vjetore, lidhur me operacionet buxhetore, është i rakorduar dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Tiranë për çdo institucion. Ky proces në zbatim të pikës 120 të UMF nr. 8, datë 09.03.2018 përfundon brenda muajit prill 2019.

- **Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare**

Pasqyrat financiare janë të firmosura nga NA dhe NZ si dhe janë depozituar në Degën e Thesarit Tiranë me nr. 2380 prot., datë 29.03.2018.

Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues është Kryetari Bashkisë Tiranë dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues është Drejtori i Përgjithshëm i Menaxhimit Financiar. Pra në këtë rast nuk ka delegime të këtyre detyrave.

- **Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.**

Për vitin 2018 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrate banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve në kartelat e llogarive të librit të madh.

Nga verifikimi i akt rakordimit vjetor të thesarit për treguesit e realizimit të buxhetit dhe krahasuar këto me veprimet kontabël në llogarinë e 520 “Disponibilitete në Thesar” dhe në ditarin e bankës rezultojnë të jenë rakorduara, veprime që paraqiten në projektraportin e auditimit.

Këto veprime janë përfshirë edhe me formatin nr. 5 “Pasqyrë e lëvizjes në cash viti 2018”. *Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.*

Për tu siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testimet në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

➤ ***Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Aparatit Bashkisë***

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike me programin ALFA.
- Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj. si dhe janë mbajtur partitarët për llogaritë kreditore e debitorë. Përsa i përket sistemeve janë evidentuar në kartelat kontabël të llogarive përkatëse dhe artikujve kontabël të prerë për veprime të ndryshme janë evidentuar në librin e veprimeve të ndryshme. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.
- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundur nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.
- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu: Dokumentet vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumenta autorizues si Memot–kërkesë për financim për veprimet ekonomike të kryera nga drejtoritë përkatëse të miratuar sipas shkallës së hierarkisë, detyrave e përgjegjësisë, duke argumentuar shkakun e veprimit të shoqëruar me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.
- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

Kontabilizimi i veprimeve ekonomike për kontrata të lidhura blerje mallrash apo investimesh nuk është bërë për vlerë të plotë të kontratës, por në momentin e mbërritjes së faturave për blerje malli e shërbimesh dhe investime të shoqëruar me situacion për punime të kryera. Efektet e veprimeve ekonomike dhe të ngjarjeve të tjera ekonomike të kryera nuk janë marrë në llogari në kohën e kryerjes së veprimit apo të ndodhjes së ngjarjes, por me mbërritjen e faturës dhe çeljen e fondeve dhe jo thjesht kur ndërhyjnë pagesa ose marrja e likuiditeteve. Pra regjistrimet kontabël nuk janë kryer në kohën e lindjes të një detyrimi për t'u paguar nga njësi ekonomike, detyrime këto që sjellin pagesa, dhe që kanë sjellë për ushtrimin e dhënë shpenzime.

Përsa trajtuar më sipër, këto veprime nuk përputhen me kërkesat e me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël" Kapitulli I, pika 1.

➤ ***Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.***

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë për aktivitetin ekonomik - financiar 01.01.2018 deri më datën 31.12.2018.

*Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhen nën auditim*

**Përkatësia:** Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

**Plotësia:** Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar

**Saktësia:** Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e regjistruara dhe ngjarjet janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme

**Periudha:** Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhen e saktë kontabël

**Klasifikimi:** Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura.

**Ligjshmëria dhe rregullsia:** Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion

*Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës*

**Ekzistenca:** Asetet, detyrimet dhe fondet e veta ekzistojnë

**Të drejtat dhe detyrimet:** Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet, detyrimet dhe janë obligimet e subjektit

**Plotësia:** Të gjitha asetet, detyrimet dhe fondet e veta që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar

**Vlerësimi dhe alokimi:** Aktivitet, pasivet dhe fondet e veta janë të përfshira në pasqyrat financiare me shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, si dhe rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

*Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese*

**Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet:** Ngjarjet e shpalosura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.

**Plotësia:** Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.

**Klasifikimi dhe kuptueshmëria:** Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe të përshkruara dhe shënimet e kanë shprehur qartë.

**Saktësia dhe vlerësimi:** Informacioni financiar dhe të tjera është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasi të duhur.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar. **Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatua se, janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2018 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2017.**

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2018 rezulton se, llogaritë e Aktivitet dhe të Pasivit kundrojnë me formatet anekse pjese e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike. Në pasqyrën e pozicionit financiar pasqyrohen totali Aktivitet dhe Pasivit për vitin 2018 i cili është 62,023,813,034 lekë, i zberthyer në llogari si më poshtë:

Nr. Reshti	Referenca e Llogarive	E M E R T I M I	Ushtrimi I Mbyllur	Ushtrimi Paraardhes
1	A	<b>A K T I V E T</b>	<b>62,023,813,034</b>	<b>57,747,929,259</b>
2		<b>I. Aktivet Afat shkurtra</b>	<b>5,573,040,375</b>	<b>6,923,078,162</b>
3		<b>1.Mjete monetare dhe ekujalent te tyre</b>	<b>594,799,762</b>	<b>336,756,907</b>
4	531	Mjete monetare ne Arke		
5	512,56	Mjete monetare ne Banke	24,989,789	24,775,768
6	520	Disponibilitete ne Thesar	488,555,410	230,321,576
7	50	Letra me vlere		
	511	Vlera per t'u arketuar	81,204,163	81,204,163
8	532	Vlera te tjera	50,400	455,400
9	54	Akreditiva dhe paradhenie		
10	59	Provigjone zhvlersimi letra me vlere (-)		
11		<b>2.Gjendje Inventari qarkullues</b>	<b>97,294,915</b>	<b>91,077,896</b>
12	31	Materiale	26,192,232	20,045,651
13	32	Inventar I imet	71,102,683	71,032,244
14	33	Prodhim nre proces		
15	34	Produkte		
16	35	Mallra		
17	36	Kafshe ne rritje e majmeri		
18	37	Gjendje te pa mbritura,ose prane te treteve		
19	38	Diferenca nga cmimet e magazinimit		
20	39	Provigjone perzhvlersimin e inventarit (-)		
21		<b>3.Llogari te Arketushme</b>	<b>4,820,679,818</b>	<b>6,434,977,479</b>
22	411	Kliente e llogari te ngjashme		
23	423,429	Personeli, paradhenie, deficite, gjoba	1,727,448	1,595,961
24	431	Tatim e Taksa		
25	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
26	433	Fatkeqsi natyrore qe mbulohe nga shteti		
27	435	Sigurime Shoqerore		
28	436	Sigurime Shendetsore		
29	437,438,	Organizma te tjere shteterore		
30	44	Institucione te tjera publike		
31	465	Efekte per tu arketuar nga shitja e letrave me vlere		
32	468	Debitore te ndryshem	133,192,418	332,981,901
33	4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	4,679,221,206	6,093,860,872
34	45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike	6,538,746	6,538,746
35	49	Shuma te parashikuara per xhvlersim(-)		
36		<b>4.Te tjera aktive afatshkurtra</b>	<b>60,265,880</b>	<b>60,265,880</b>
37	409	Parapagime	58,702,072	58,702,072
38	473	Llogari e pritjes te mardhenieve me thesarin		
39	477	Diferenca konvertimi aktive	1,563,808	1,563,808
40	481	Shpenzime per t'u shperndare ne disa ushtrime		
41	486	Shpenzime te periudhave te ardhshme		
42		<b>II.Aktivt Afat gjata</b>	<b>56,450,772,658</b>	<b>50,824,851,097</b>
43	<b>20</b>	<b>1.Aktive Afatgjata jo materiale</b>	<b>263,352,129</b>	<b>283,411,218</b>
44	201	Prime te emisionit dhe Rimbursimit te huave		
45	202	Studime dhe kerkime	263,293,799	283,352,216
46	203	Koncesione,Patenta,Licenca e te ngjashme	58,330	59,002
47	<b>21</b>	<b>2.Aktive Afatgjata materiale</b>	<b>19,655,153,218</b>	<b>19,614,100,777</b>
48	210	Toka, T,roje, Terene	7,044,321,379	6,930,105,214
49	211	Pyje, Plantacione	57,073,107	67,179,134
50	212	Ndertesa e Konstruksione	2,697,497,729	2,672,347,241
51	213	Rruge, rrjete, vepra ujore	8,531,167,122	8,763,953,764
52	214	Iinstalime teknike, makineri e paisje	293,551,646	175,738,663
53	215	Mjete Transporti	263,382,722	258,300,896
54	216	Rezerva Shteterore		



55	217	Kafshe pune e prodhimi		
56	218	Inventar ekonomik	238,136,079	216,452,431
57	24	Aktive afatgjata te demtuara	530,023,434	530,023,434
58	28	Caktime te Aktiveve Afatgjata		
59	25-26	<b>3.Aktive Afatgjata Financiare</b>	<b>8,518,242,995</b>	<b>8,477,819,765</b>
60	25	Huadhenie e Nenhuadhenie	132,543,995	92,120,765
61	26	Pjesmarrje ne kapitalin e vet	8,385,699,000	8,385,699,000
62		<b>4.Investime</b>	<b>28,014,024,316</b>	<b>22,449,519,337</b>
63	230	Per Aktive Afatgjata jo materiale	652,416,976	486,069,598
64	231	Per Aktive Afatgjata materiale	27,361,607,340	21,963,449,739
<b>65</b>	<b>B</b>	<b>PASIVET(DETYRIMET)</b>	<b>11,763,611,405</b>	<b>11,930,223,863</b>
66		<b>I.Pasivet Afat shkurtra</b>	<b>5,453,941,246</b>	<b>6,664,713,473</b>
67		<b>1. Llogari te Pagushme</b>	<b>5,453,941,246</b>	<b>6,664,713,473</b>
68	401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	3,864,223,325	4,442,437,198
69	42	Detyrime ndaj personelit	101,587,508	98,093,548
70	16,17,18	Hua Afat shkurtra		
71	460	Huadhenes		
72	431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	37,155,098	34,224,074
73	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
74	433	Detyrime, shteti fatkeqesi natyrore		
75	435	Sigurime Shoqerore	53,039,492	51,034,090
76	436	Sigurime Shendetsore	7,039,480	7,248,373
77	437,438,	Organizma te tjere shteterore		
78	44	Institucione te tjera publike		
79	45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
80	464	Det.per tu paguar per bl.letrave me vlere	50,400	50,400
81	466	Kreditore per mjete ne ruajtje	488,555,410	227,300,132
82	467	Kreditore te ndryshem	766,604,917	1,460,773,189
83	4341	Operacione me shtetin( detyrime	135,685,616	343,552,469
84	49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
85		<b>2.Te tjera pasive afatshkurtra</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
86	419	Kreditore, Parapagime		
87	475	Te ardhura per t'u regjistruar vitet pasardhese		
88	478	Diferenca konvertimi pasive		
89	480	Te ardhura per tu klasifikuar ose rregulluar		
90	487	Te ardhura te arketuara para nxjerrjes se titullit		
91		<b>II.Pasivet Afat Gjata</b>	<b>6,309,670,159</b>	<b>5,265,510,390</b>
92	Klase 4	Llogari te pagushme		
93	16.17,18	Huate Afat gjata	6,309,670,159	5,265,510,390
94		Provigjonet afatgjata		
95	Klasa 4	Te tjera		
96	<b>C</b>	<b>AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)</b>	<b>50,260,201,629</b>	<b>45,817,705,396</b>
97	<b>D</b>	<b>FONDI I KONSOLIDUAR :</b>	<b>50,260,201,629</b>	<b>45,817,705,396</b>
98	101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	19,188,713,453	19,837,757,946
99	12	Rezultatet e mbartura		
100	85	Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore		0
101	111	Rezerva	0	0
102	115	Nga Fondet e veta te investimeve	19,395,330,912	14,519,495,006
	15	Shuma te parashikuara per rreziqe e Zhvleresime	0	0
103	105	Teprica e Granteve kapitale Te Brendshmne	10,503,041,354	10,286,598,235
104	106	Teprica e Granteve kapitale Te Huaja	1,173,115,910	1,173,115,910
105	107	Vlera e mjeëteve te caktuara ne perdorim	0	738,300
106	109	Rezerva nga Rivlersimi I Aktiveve Afatgjata	0	0
107		Te Tjera	0	0
108	<b>E</b>	<b>TOTALI I PASIVEVE(B+C)</b>	<b>62,023,813,034</b>	<b>57,747,929,259</b>

## A. AKTIVET

### I. Aktivet Afat shkurtra

### 1. Mjete monetare dhe ekuivalent te tyre

- **Gjendja e llogarisë 512 “Llogari në bankë”** në mbyllje të vitit ushtrimor 2018 paraqitet në vlerën 24,989,789 lekë, e cila është shtuar gjatë vitit për 214,021 lekë. Pjesë e gjendje së kësaj llogarie për vitin në vitin 2018 është vlera 10,915,267 lekë, e cila përfaqëson vlerën e rimarrjes (arkëtuar) së kredisë nga 12 bizneset e mesme e të vogla të kredituara nga Banka Kombëtare Tregtare të garantuara nga Bashkia Tiranë sipas marrëveshjes në vitin 2013 të “Fondit të Garancisë” në vlerën 10,000,000 lekë të nënshkruar me B... në kuadër të “Programit të Zhvillimit Ekonomik dhe Punësimit” të miratuar me VKB e asaj kohe. Gjendja në fund të vitit 2017 është në vlerën 10,701,247 lekë, dhe diferenca prej 214,021 lekë është vlera shtesë për vitin 2018 e rimarrjes në vazhdim të kësteve të kredisë.

- Pjesë e gjendjes së llogarisë 512 “Llogari në bankë” është edhe **vlera prej 13,950,271 lekë**, për të cilën Bashkia nuk disponon ekstrakt apo statement bankar që të konfirmojë këtë shumë. Për këtë shumë nuk ka informacion se çfarë është dhe si ka vazhduar ecuria e saj deri më tani, çfarë veprimesh janë kryer me këtë gjendje të trashëguar që nga viti 2013.

- **Gjendja e llogarisë 56 “Llogari në organizma krediti”** në mbyllje të vitit ushtrimor 2018 paraqitet në vlerën 124,249 lekë. Kjo vlerë përfaqësojnë gjendjen e kredisë së pashlyera nga një huamarrës. Për këto vlera janë kryer veprimet kontabël në debi të llog.512 “Llogari në bankë në kredi të llog.565 “Mjete monetare në organizma financiarë krediti”.

- **Gjendja e llogarisë 511 “Vlera për t’u arkëtuar”** paraqitet në bilanc pa ndryshime si për vitin ushtrimor 2017 dhe për vitin ushtrimor 2018 në vlerën **81,204,163 lekë**. Për këtë gjendje nuk ka asnjë informacion kontabël se çfarë përfaqëson e për rrjedhim për këtë vlerë nuk ka analizë, trashëguar nga ish PIU (Njësia e Menaxhimit të Projekteve me Investime të Huaja) në vitin 2015 (*Trajtuar në analizën e PF të viteve 2016-2017, më sipër në këtë projektraport*).

- **Gjendja e llogarisë 532 “Vlera të tjera”** në mbyllje të vitit ushtrimor 2018 paraqitet në vlerën 50,400 lekë e cila përfaqëson vlerën për bileta tregu të NJA nr.4 të mbetura gjendje që nga viti 2012 në këtë njësi.

### 2. Gjendje Inventari qarkullues

**Në klasën 3 “Gjendja e inventarit”** të aktiveve qarkulluese paraqiten në mbyllje të bilancit të vitit 2018 në vlerën 97,294,916 lekë dhe në mbyllje të bilancit të vitit 2017 në vlerën 91,077,896 lekë, ku diferenca e tyre në rritje për vitin ushtrimor prej 6,217,020 lekë është gjendja e llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” në formatin nr. 2 “Pasqyra e Performancës Financiare”. Këto vlera në mënyrë analitike paraqiten në gjendjet e llogarive:

- **Gjendja e llogarisë 31 “Materiale”** në mbyllje të vitit ushtrimor 2018 paraqitet në vlerën 26,192,232 lekë, ndërsa në mbyllje të vitit ushtrimor 2017 paraqitet në vlerën 20,045,651 lekë me një diferencë në rritje për vitin ushtrimor prej 6,146,581 lekë e cila përfaqëson blerje mallrash për vitin 2018. Kjo llogari është e analizuar për gjendjen datë 31.12.2018 në shumën 26,192,232 lekë, duke bërë sondazhe me inventarin fizik.

- **Gjendja e llogarisë 32 “Objekte inventari (inventari i imet ne perdorim)”** në mbyllje të vitit ushtrimor 2018 paraqitet në vlerën 71,102,683 lekë, ndërsa në mbyllje të vitit ushtrimor 2017 paraqitet në vlerën 71,032,244 lekë me një diferencë në rritje për vitin ushtrimor prej 70,439 lekë për të cilën u bënë krahasime me inventarët fizike të kryera në magazinë.

### 3. Llogari të Arketushme

- **Gjendja e llogarive 423-429 “Personeli,paradhënie,defiçite dhe gjoba”** në mbyllje të vitit ushtrimor 2018 paraqitet në vlerën 1,727,448 lekë, ndërsa në mbyllje të vitit ushtrimor 2017 paraqitet në vlerën 1,595,961 lekë me një diferencë në rritje për vitin ushtrimor prej 131,487 lekë. Në mënyrë analitike lëvizjet e gjendjeve të kësaj llogarie paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr. llog.	Pershkrimi i veprimeve	Detyrime 31.12.2017	Ndalesa nga paga dhjetor 2017	Shtesa detyrime 2018	Pakësim detyrime 2018 per ndalesa	Detyrime 31.12.2018	Ndalesa nga paga dhjetor 2018
4231	Personeli paradhenie te vitit ne vazhdim	12,296		7,285,451	7,285,434	12,313	
4271	Ndalesa per detyrime ndaj te treteve, te vitit ne vazhdim	1,384,254			277	1,383,977	
42710	sherbimi i telefonise celulare per Vodafone sha		2479	909,243	873,991	32,773	
42711	sherbimi i telefonise celulare per AMC	87		35,639	35,726		
42712	Ndalesa per detyrime ndaj te treteve gjate vitit 2012	30,294				30,294	
42713	sherbim telefoni celulare Eagle Mobile		19,662	8148	7,871		19,385
42714	sherbimi i telefonise celulare per Plus Comm. sh.a	3313				3,313	
4274	Ndalesa nga paga per detyrime gjyqesore		174,256	890,874	970,110		253,492
4291	Deficite e gjoba te vitit ne vazhdim	362,114		662,442	486,901	537,655	
<b>Totali</b>		<b>1,792,358</b>	<b>196,397</b>	<b>9,791,797</b>	<b>9,660,310</b>	<b>2,000,325</b>	<b>272,877</b>
<b>Gjendja sipas bilancit 31.12.2017</b>		<b>1,595,961</b>	<b>Gjendja sipas bilancit 31.12.2018</b>			<b>1,727,448</b>	

Shuma e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët është kontabilizuar në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” në aktivin e bilancit të vitit 2018 paraqitet në gjendjen prej 123,958,168 lekë. Kjo vlerë ka të përfshirë debitorë të tjerë të bashkisë Tiranë në vlerën 86,522,498 lekë dhe të njëjsete administrative të trashëguara të paraqitura në tabelat e mëposhtme:

Përmbledhje te Debitorve te tjere te Bashkise Tirane (Aparati)	Gjendja 31.12.2017	Arketuar 2018	Detyrimi i mbetur 31.12.2018
Detyrimet e Automjeteve date 31.12.2011	1,464,970	-	1,464,970
Debitorëve te bllokuesve te automjeteve date 31.12.2012	1,691,484	180,474	1,511,010
Dety per debitorin Ylli Galanxha UK nr.8995/1 dt. 11.11.2013 per detyrat KLSH	84,957		84,957
Debitor Investime nga KLSH, U. K Bashkisë nr. 672, datë 12.04.2011	12,093,995	-	12,093,995
Debitor Investime nga KLSH, U.K Bashkisë nr. 8995/1, datë 11.11.2013	2,133,446	-	2,133,446
U.K Bashkisë nr. 8995/1, datë 11.11.2013, tejkallim te tarifes ligjore per fjetje	69,600	-	69,600
U.K Bashk nr. 8995/1, datë 11.11.2013, shp të pa argumentuara per udhetim e dieta	507,150	-	507,150
U.K Bashkisë nr. 8995/1, datë 11.11.2013, per pushime te pakryera per leje te zako	123,810	-	123,810
U.K Bashkisë nr. 8995/1, datë 11.11.2013, paradhënie leje te zakonshme	20,000	-	20,000
Urdheri 8178/61 dt.02.07.2015, Detyrime KLSH per OE per blerje sherbime	14,722,760	22,000	14,700,760
Debitor firma pastrimi KLSH, Urdheri 8178/76 dt.23.07.2015	48,088,228	-	48,088,228
Debitor Investime nga KLSH, Urdheri 8178/76 dt.23.07.2015	929,919	-	929,919
Debitor nder vite automjete	2,894,684	-	2,894,684
Debitor prefekturë vitit 2000	857,176		857,176
Debitor prefekturë vitit 2001	730,741		730,741
Debitor valute viti 2000-2003	312,052		312,052
<b>Vlera Totale</b>	<b>86,724,972</b>	<b>202,474</b>	<b>86,522,498</b>

Në debi të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” janë kontabilizuar detyrimet e lindura nga urdhërat e titullarit në zbatim të rekomandimeve të KLSH duke kredituar llog. 4341 “Të tjera operacione me shtetin (kreditor)”. Gjatë vitit 2018 janë arkëtuar detyrime në vlerën 202,474 lekë duke prerë artikullin kontabël debi llog. 4341 “Të tjera operacione me shtetin (kreditor)” për vlerën 202,474 lekë në kredi të llog. 468 “Debitorë të ndryshëm”.

	<b>Emertimi</b>	<b>Detyrimi</b>	<b>Transferuar detyrime 2018</b>	<b>Detyrimi i mbetur 31.12.2018</b>
<b>1</b>	<b>Debitor Individ NJA</b>			
	Debitor njesia 5, (vjedhje arke me proces gjyqesor te mbyllur)	12,731,725	-	12,731,725
	Debitor njesia 6, Detyrime nga auditi bashkise Tirane date 31.07.2007 dhe KLSH 2011	645,378	-	645,378
	Debitor njesia 14 Dajt, sipas KLSH nr.708/8, dt.23.12.2013	898,484	-	898,484
	Debitor njesia 16 Berzhite, detyrime KLSH nr.1160/14, dt.31.12.2012	400,000		400,000
<b>2</b>	<b>Debitor Investime NJA</b>	-		-
	Debitor njesia 14 Dajt, sipas KLSH nr.708/8, dt.23.12.2013	6,362,675		6,362,675
	Debitor njesia 16 berzhite, KLSH nr.1160/14, dt.31.12.2012	11,424,611		11,424,611
	Debitor njesia 20 Vaqar, KLSH	413,449		413,449
	DeBitor njesia Zall - Herr deb.klsh dt.12.11.2013	194,212		194,212
<b>3</b>	<b>Debitor NJA - Kontrata qiraje per pyje kullota</b>	-		-
	Debitor njesia 16 Berzhite, detyrime KLSH nr.1160/14, dt.31.12.2012	2,049,000		2,049,000
	DeBitor njesia Zall - Herr per ujin e pishem dt.2011-2015	2,316,136		2,316,136
<b>4</b>	<b>Debitor NJA - Tatime</b>	-		-
	Njesia Petrele	8,774,330	8,774,330	-
	Njesia Farke	1,194,200	1,194,200	-
	Njesia Berzhite	2,581,990	2,581,990	-
	Njesia Vaqarr	10,377,559	10,377,559	-
	Njesia Kashar	183,779,690	183,779,690	-
	<b>Vlera Totale</b>	<b>244,143,439</b>	<b>206,707,769</b>	<b>37,435,670</b>

Për arkëtimin e këtyre detyrimeve ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme Menaxhimit Financiar në Bashkinë Tirane dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatim Taksave Vendore, nën varësi e Bashkisë nuk është hapur dhe mbajtur llogari ndërmjetëse me nënvarësite. Meqenëse arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore e kryen DPTTV, atëherë dhe ky detyrim duhet të shkarkohet nga bilanci i Aparatit dhe të ngarkohet Bilanci i kësaj drejtorie me shkresë zyrtare. Kështu nga Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar me shkresat nr. prot. 29204 datë 03.08.2017 dhe nr.prot.3076 datë 22.01.2018 drejtuar DPTTV është kërkuar marrja në ngarkim e debitorëve të këtyre NJA nga kjo Drejtori dhe shkarkimi nga kontabiliteti i Aparatit të Bashkisë Tiranë, për të cilat nuk kishte informacion për ecurinë vjeljes së këtyre detyrimeve, prandaj kjo vlerë është e pandryshuar që në vitin 2015-2016 e 2017. Por njëkohësisht DPMF ka marrë informacion që këto detyrime janë dërguar nga NJA me kërkesë të DPTTV dhe janë futur në sistemin informatik të taksave dhe tarifave vendore. Për këtë nga DPTTV është kthyer përgjigje me shkresën nr. 8336/1, prot. datë 18.02.2019, e cila konfirmon marrjen në ngarkim të këtyre detyrimeve dhe regjistrimin në kontabilitetin e tyre si hedhjen e tyre në sistem. Veprimet kontabël për shkarkimin dhe sistemimin e vlerës prej 206,707,769 lekë është bërë në mbylljen e pasqyrave financiare të Bashkisë për vitin 2018 për të cilën është bërë veprimi kontabël debi llog. 4341 “Të tjera operacione me shtetin (kreditor)” për vlerën 206,707,769 lekë në kredi të llog. 468 “Debitorë të ndryshëm”.

Lidhur me këto detyrime nuk ka provigjione për zhvlerësimin e llogarive te arketueshme, pasi këto provigjione do të përlllogariten kur Bashkia Tiranë të ketë të dhëna se nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha të drejtat sipas kushteve fillestare të tyre.

**- Gjendja e llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor datë 31.12.2018)” me shumën 4,679,221,206 lekë përbëhet nga detyrimet afatshkurtra për muajin dhjetor 2018 të cilat**

trashëgohen në vitin 2019, e cila në analizë përfshin gjëndjet e llogarive në pasivin e bilancit: llog.401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” për vlerën **3,722,746,041 lekë** (pa detyrimin e llogarisë furnitor PIU në vlerën 141,477,284 lekë, detyrim i cili disbursohet nga Abu Dhabi për projektin Ndërtimi Bulevardit Verior dhe Rehabilitimi Lumit të Tiranës), llog.42 “Personeli e llogari të lidhura me to” për vlerën **101,587,508 lekë**, llog.431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” për vlerën **27,920,848 lekë** (minus detyrimin për pulla gjendja civile në vlerën 9,234,250 lekë, detyrim që pasqyrohet në llogarinë 468 “Debitorë punonjës të Gjendjes Civile për pulla”), llog.435 “Sigurime shoqërore” për vlerën **53,039,492 lekë**, llog.436 “Sigurime shëndetësore” për vlerën **7,039,480 lekë**, llog.16 “Hua Afat shkurtra Kredia Petrelë” në vlerën **282,920 lekë** dhe llog.467 “Kreditorë të ndryshëm” për vlerën **766,604,917 lekë**.

- **Gjendja e llogarisë 45** “Marrëdhënie me institucione Brenda dhe jashtë sistemi” paraqitet në bilanc pa ndryshime si për vitin ushtrimor 2017 dhe për vitin ushtrimor 2018 në vlerën 6,538,746 lekë. Kjo shifër është e trashëguar në bilancin e PIU-t për vitin 2015 është e pa analizuar dhe nuk ka informacion kontabël, se çfarë ka të përfshirë dhe çfarë përfaqëson kjo shumë.

- **Gjendja e llogarisë 409** “Furnitorë (debitorë), parapagime pagesa pjesore” paraqitet në bilanc pa ndryshime si për vitin ushtrimor 2017 dhe për vitin ushtrimor 2018 në vlerën 58,702,072 lekë. Kjo shifër në bilancin e PIU-t për vitin 2015 është e pa analizuar dhe nuk ka informacion kontabël, se çfarë ka të përfshirë dhe çfarë përfaqëson kjo shumë.

- **Gjendja e llogarisë 477** “Diferenca konvertime aktive” paraqitet në bilanc pa ndryshime si për vitin ushtrimor 2017 dhe për vitin ushtrimor 2018 në vlerën 1,563,808 lekë. Kjo shifër në bilancin e PIU-t për vitin 2015 është e pa analizuar dhe nuk ka informacion kontabël, se çfarë ka të përfshirë dhe çfarë përfaqëson kjo shumë.

## **B. II. Aktivet Afat gjata**

### **1. Aktive Afatgjata jo materiale**

Në formatin nr.1 “**Pasqyra e pozicionit financiar**” aktivet afatgjata jo material paraqiten në pasqyrat financiare vjetore me koston e tyre historike minus amortizimin e akumuluar në vlerën 263,352,129 lekë, pra me vlerën e mbetur.

Në formatin nr.7/a “Pasqyra mbi gjëndjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike” AQ e patrupëzuara paraqiten me koston e tyre historike dhe në formatin nr.7/b “Pasqyra mbi gjëndjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me vlerën neto” AQ e patrupëzuara paraqiten aktivet me ndryshimet përkatëse me koston e tyre historike minus amortizimin pra me vlerën neto. Në fund të materialit, formati nr.7/a dhe 7/b.

- **Gjendja e llogarisë 202** “Studime dhe Kërkime” në formatin 7/a paraqitet me koston historike në vlerën 300,382,903 lekë për vitin 2018. Nga viti 2017 janë bërë shtesa në vlerën 2,726,480 lekë të cilat konsistojnë në kapitalizimin e aktiveve afatgjata jo materiale kryesisht studim projektive. Për këtë është kryer veprimi kontabël debi llog. 202 “Studime dhe Kërkime” në kredi të llog.230 “Shpenzime per rritjen e AQ të patrupëzuara”.

Në formatin nr.1 “Pasqyra e pozicionit financiar” dhe formatin nr.7/b paraqiten me vlerën neto 263,293,799 lekë.

Studim projektimet si për Bashkinë e Tiranës dhe NJA janë pjesë e inventarëve fizike të kryera, të cilat rezultojnë të arkivuara në Drejtoritë përkatëse dhe në NJA.

- **Gjendja e llog. 203** “Koncesione, patenta, licenca e tjera ngjashme” në formatin 7/a paraqitet me koston historike në vlerën 168,000 lekë si në vitin 2017 dhe në vitin 2018. Kjo vlerë i përket

programit Alpha në inventarin e NJA nr.5. Në formatin nr.1 “Pasqyra e pozicionit financiar” dhe formatin nr.7/b paraqiten me vlerën neto 58,330 lekë.

## 2. Aktive Afatgjata materiale

Në formatin nr.1 “**Pasqyra e pozicionit financiar**” aktivet afatgjata materiale paraqiten në pasqyrat financiare vjetore me koston e tyre historike minus amortizimin e akumuluar në vlerën 19,655,153,218 lekë, pra me vlerën e mbetur.

Në formatin nr.7/a “Pasqyra mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike” AQT paraqiten me koston e tyre historike dhe në formatin nr.7/b “Pasqyra mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me vlerën neto” paraqiten aktivet me ndryshimet përkatëse me koston e tyre historike minus amortizimin pra me vlerën neto.

**Në formatin nr. 7/a “Aktivet e Qëndrueshme të Trupëzuara”** paraqiten në shumën totale prej 21,351,515,799 lekë. Për këto aktive janë kryer inventarë fizike nga komisionet e inventarizimit, kjo sipas fletëve të inventarizimit të paraqitura dhe të konfirmuara nga këto komisione si për NJA dhe Bashkinë Tiranë. Kjo llogari sintetike e analizuar paraqitet në llogaritë e mëposhtme:

- **Gjendja e llog. 210 “Toka, Troje, Terrene”** për vitin 2018 paraqitet në vlerën 7,044,321,379 lekë. Kjo vlerë përbëhet nga: gjendja në vitin 2017 në vlerën 6,930,105,214 lekë e cila përfshin 6,859,956,716 lekë troje Bashkia Tiranë, 70,148,498 lekë troje NJA si dhe shtesat për vitin 2018 në vlerën 114,216,165 lekë truall përfituar nga shpronësimet me VKM. Për këto vlera për çdo VKM janë kryer veprimet kontabël debi llog. 231 “Shpenzime ne proces për toka, troje e terrene” në kredi të llog. 467 “Kreditorë të ndryshëm”. Për kapitalizimin e këtyre aktiveve janë kryer veprimet kontabël në debi të llog. 210 “Toka, Troje, Terrene” në kredi të llog. 231 “Shpenzime në proces për toka, troje e terrene” dhe njëkohësisht pritet artikulli kontabël në debi të llog. 115 “Te ardhura te funksionit te caktuara per investime” në kredi të llog. 1011”Shtesa të fondeve bazë”.

- **Gjendja e llogarisë 211 “Pyje, kullota plantacione”** për vitin 2018 paraqitet në vlerën kontabël 71,863,438 lekë. Kjo vlerë përbëhet nga: gjendja në vitin 2017 në vlerën 68,732,981 lekë e cila përfshin kostot e mbjelljes së pemëve dekorative dhe frutore në territorin e NJA-ve si dhe shtesa pa pagesë për vitin 2018 në vlerën 3,693,857 lekë Bashkia Tiranë. Kjo llogari është pakësuar në kredi për vlerën 563,400 lekë kontabilizim lulishte NJA7 në debi të llogarisë 212 “Ndërtime e konstruksione lulishte”.

- **Gjendja e Llogarisë 212 “Ndërtime konstruksione”** për vitin 2018 është në vlerën kontabël 3,107,010,434 lekë. Kjo vlerë përbëhet nga: gjendja në vitin 2017 në vlerën 3,018,192,678 lekë e cila përfshin 945,596,250 lekë ndërtime e konstruksione Bashkia Tiranë, 2,072,596,428 lekë ndërtime e konstruksione NJA si dhe shtesat për vitin 2018 në vlerën 104,232,745 lekë ndërtime e konstruksione përfituar nga blerjet me pagesë për 45,414,989 lekë, shtesat me VKM në vlerën 58,142,880 lekë si dhe vlera 674,876 lekë shtesa nga kreditimi llogarive 212 “Ndërtime konstruksione” dhe llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” të njësive administrative. Ndërsa pakësimi në vlerën prej 15,414,989 lekë, janë aktive transferuar pa pagesë me kalim kapital nga Bashkia Tiranë në ndërmarrjet e varësisë që janë njësi shpenzuese me llogari më vehte

- **Gjendja e Llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”** për vitin 2018 është në vlerën kontabël 9,487,708,651 lekë. Kjo vlerë përbëhet nga: gjendja në vitin 2017 në vlerën 9,479,792,151 lekë e cila përfshin 265,771,015 lekë rrugë, rrjete, vepra ujore Bashkia Tiranë, 9,214,021,136 lekë rrugë, rrjete, vepra ujore NJA si dhe shtesat për vitin 2018 në vlerën 7,016,500 lekë rrugë, rrjete, vepra ujore përfituar nga shtesat me VKM, si dhe vlera 900,000 lekë shtesa të cilat konsistojnë në kapitalizimin e aktiveve afatgjata materiale të njësive administrative.

- **Gjendja e llogarisë 214** “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” për vitin 2018 është në vlerën kontabël 449,479,082 lekë, ndërsa për vitin 2017 është në vlerën 265,954,714 lekë. Diferenca prej 183,524,368 lekë konsiston në ndryshimet e kryera në gjendjen e kësaj llogarie për Bashkinë e Tiranës, ku janë bërë shtesa në vlerën 227,760,497 lekë nga të cilat 227,248,930 lekë janë blerje me pagesë dhe në vlerën 511,567 lekë dhurime.

Ndërsa paksimet në vlerën 44,236,129 lekë janë vlera prej 39,393,144 lekë aktive transferuar pa pagesë me kalim kapital nga Bashkia Tiranë në ndërmarrjet e varësisë që janë njësi shpenzuese me llogari më vehte dhe vlera 4,842,985 lekë nxjerrje jashtë përdorimit sipas urdhrimit të kryetarit nr. 25000, datë 27.06.2018.

- **Gjendja e llogarisë 215** “Mjete Transporti” për vitin 2018 është në vlerën kontabël 775,703,656 lekë, ndërsa për vitin 2017 në vlerën 711,941,486 lekë. Në këtë llogari janë bërë shtesa për vlerën 63,762,170 lekë nga të cilat 52,530,470 lekë për blerje me pagesë automjete për Bashkinë Tiranë dhe në vlerën 11,231,700 lekë dhurime nga subjekte private.

- **Gjendja e llogarisë 218** “Inventar Ekonomik” për vitin 2018 është në vlerën kontabël 416,295,632 lekë, ndërsa për vitin 2017 në vlerën 346,773,140 lekë. Në këtë llogari janë bërë shtesa me pagesë në vlerën 190,046,639 lekë, me donacione në vlerën 22,136,182 lekë, si dhe vlera 4,817,053 lekë transferim nga kreditimi llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”. Paksimet janë në vlerën 147,095,454 lekë, aktive transferuar pa pagesë me kalim kapital nga Bashkia Tiranë në ndërmarrjet e varësisë që janë njësi shpenzuese me llogari më vehte, vlera 381,928 lekë nxjerrje jashtë përdorimit sipas urdhrimit të kryetarit nr. 25000, datë 27.06.2018.

GJENDJA DHE NDRYSHIMET E AKTIVEVE AFATGJATA( KOSTO HISTORIKE)

VITI 2018

Formati nr.7/a

NE / LEKE

Nr.	Nr. Ref. Llog.	E M E R T I M I	Gjendje ne Fillim vit te vitit	Shtesa gjate vitit ushtrimo, Kosto Historike					Pakesime gjate vitit , Kosto Historike				Gjendja mbyllje te ushtrimit
				Blerje e krijuar me pagese	Shtesa pa pagese		Levizje brenda aktiveve	Gjithe sej	Shitje	Nx.jasht perdor.	Pakesime te Tjera	Gjithe sej	
					Jashte sistemit	Brenda sistemit							
a	b	c	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
<b>1</b>	<b>20</b>	<b>I. AAGJ/JO MATERIALE</b>	<b>297,656,423</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>2,726,480</b>	<b>2,726,480</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>300,382,903</b>
2	201	Prime te emisionit dhe rimbursimit te huave						0		0		0	0
3	202	Studime dhe kerkime	297,488,423				2,726,480	<b>2,726,480</b>				0	300,214,903
4	203	Koncesione, patenta,licenca e tjera ngjashme	168,000					0				0	168,000
<b>5</b>	<b>21-28</b>	<b>II. TAAGJ/ MATERIALE</b>	<b>21,351,515,799</b>	<b>515,241,028</b>	<b>216,948,851</b>	<b>0</b>	<b>6,391,929</b>	<b>738,581,808</b>	<b>0</b>	<b>5,224,913</b>	<b>202,466,987</b>	<b>207,691,900</b>	<b>21,882,405,707</b>
6	210	Toka,troje,Terene	6,930,105,214		114,216,165			<b>114,216,165</b>				0	7,044,321,379
7	211	Pyje,Kullota Plantacione	68,732,981		3,693,857			<b>3,693,857</b>			563,400	563,400	71,863,438
8	212	Ndertime e Konstruksione	3,018,192,678	45,414,989	58,142,880		674,876	<b>104,232,745</b>			15,414,989	15,414,989	3,107,010,434
9	213	Rruge,rrjete,vepra ujore	9,479,792,151		7,016,500		900,000	<b>7,916,500</b>				0	9,487,708,651
10	214	Instalime teknike,makineri,paisje,vegla pune	265,954,714	227,248,930	511,567			<b>227,760,497</b>		4,842,985	39,393,144	44,236,129	449,479,082
11	215	Mjete transporti	711,941,486	52,530,470	11,231,700			<b>63,762,170</b>			0	0	775,703,656
12	216	Rezerva shtetore						0				0	0
13	217	Kafshe pune e prodhimi						0				0	0
14	218	Inventar ekonomik	346,773,140	190,046,639	22,136,182		4,817,053	<b>216,999,874</b>		381,928	147,095,454	147,477,382	416,295,632
15	24	Aktive te Qend.te trupezuara te demtuara	530,023,434					0				0	530,023,434
16	28	Caktime						0				0	0
<b>17</b>		<b>T O T A L I ( I + II )</b>	<b>21,649,172,222</b>	<b>515,241,028</b>	<b>216,948,851</b>	<b>0</b>	<b>9,118,409</b>	<b>741,308,288</b>	<b>0</b>	<b>5,224,913</b>	<b>202,466,987</b>	<b>207,691,900</b>	<b>22,182,788,610</b>



Nr.	Nr. Reference Llogarije	E M E R T I M I	Teprica ne fillim			Shtesat gjate vitit		Paksimet gjate vitit		Teprica ne Fund		
			Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amort	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto
			1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1	20	I. AAGJ/JO MATERIALE	297,656,423	14,245,205	283,411,218	2,726,480	22,785,569	0	0	300,382,903	37,030,774	263,352,129
2	201	Prime te emisionit dhe rimbursimit te huave			0					0	0	0
3	202	Studime dhe kerkime	297,488,423	14,136,207	283,352,216	2,726,480	22,784,897			300,214,903	36,921,104	263,293,799
4	203	Koncesione, patenta,licenca e tjera ngjashme	168,000	108,998	59,002		672			168,000	109,670	58,330
5	21- 28	II. AAGJ/ MATERIALE	21,351,515,799	1,737,415,021	19,614,100,777	738,581,808	489,837,467	207,691,900	0	21,882,405,707	2,227,252,488	19,655,153,218
6	210	Toka,troje,Terene	6,930,105,214		6,930,105,214	114,216,165				7,044,321,379	0	7,044,321,379
7	211	Pyje,Kullota Plantacione	68,732,981	1,553,847	67,179,134	3,693,857	13,236,484	563,400		71,863,438	14,790,331	57,073,107
8	212	Ndertime e Konstruksione	3,018,192,678	345,845,437	2,672,347,241	104,232,745	63,667,268	15,414,989		3,107,010,434	409,512,705	2,697,497,729
9	213	Rruge,rrjete,vepra ujore	9,479,792,151	715,838,387	8,763,953,764	7,916,500	240,703,142			9,487,708,651	956,541,529	8,531,167,122
10	214	Instalime teknike,makineri,paisje,vegla pune	265,954,714	90,216,051	175,738,663	227,760,497	65,711,385	44,236,129		449,479,082	155,927,436	293,551,646
11	215	Mjete transporti	711,941,486	453,640,590	258,300,896	63,762,170	58,680,344			775,703,656	512,320,934	263,382,722
12	216	Rezerva shtetore			0					0	0	0
13	217	Kafshe pune e prodhimi			0					0	0	0
14	218	Inventar ekonomik	346,773,140	130,320,709	216,452,431	216,999,874	47,838,844	147,477,382		416,295,632	178,159,553	238,136,079
15	24	Aktive te Qend.te trupezuara te demtuara	530,023,434		530,023,434					530,023,434	0	530,023,434
16	28	Caktime			0					0	0	0
17		T O T A L I ( I + II )	21,649,172,222	1,751,660,226	19,897,511,995	741,308,288	512,623,036	207,691,900	0	22,182,788,610	2,264,283,262	19,918,505,347

(Trajtuar në akt-konstatimin nr. 17, datë 16.04.2019, prot subjekti nr. 16460, datë 16.4.2019)

**IV/B. Mbi planifikimin dhe zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 797 datë 29.12.2017.**

Në zbatim të pikës B, 1.5/1.6 të programit të auditimit “Nr. 1268/2, datë 18/12/2018”, u grumbullua dhe u shqyrtua evidenca e mjaftueshme nga ana sasiore dhe cilësore si më poshtë:-

-Regjistri i parashikimit dhe realizimit të prokurimeve publike

-Evidenca nga sistemi informatik i APP për menaxhimin e procedurave të prokurimit.

-Dosjet e procedurave të prokurimit për periudhën 2016-2018.

Nga verifikimi rezultoi se Bashkia Tiranë (Autoritet Kontraktor), për vitin 2016, ka zhvilluar gjithsej 183 procedura prokurimi, me fondin limit pa TVSh në shumën 4,395,014,643 lekë, kontrata të lidhura pa TVSh në shumën 4,008,502,516 lekë, duke kursyer shumën prej 386,422,232 lekë ose në masën 9% të fondit limit pa TVSh të prokuruar, nga të cilat:

-“Blerje me vlerë të vogël”, 62 procedura, me fondin limit në total prej 18,379,289 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 16,631,324 lekë, duke kursyer shumën prej 1,747,966 lekë;

-“Kërkesë për propozim”, 18 procedura, me fondin limit në total prej 60,868,770 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 52,694,193 lekë, duke kursyer shumën prej 8,174,577 lekë.

-”Tender i Hapur”, 39 procedura, me fondin limit në total prej 3,702,209,125 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 3,373,301,231 lekë, duke kursyer shumën prej 328,907,231 lekë.

-”Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, 40 procedura, me fondin limit në total prej 596,558,305 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 550,558,305 lekë, duke kursyer shumën prej 45,910,767 lekë.

-”Shërbim konsulence”, 24 procedura, me fondin limit në total prej 16,999,154 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 15,317,463 lekë, duke kursyer shumën prej 1,681,691 lekë.

Sa më sipër nuk janë reflektuar blerjet për nevoja emergjence.

Për vitin 2017, ka zhvilluar gjithsej 294 procedura prokurimi, me fondin limit pa TVSh në shumën 7,644,513,342 lekë, kontrata të lidhura pa TVSh në shumën 7,297,394,093 lekë, duke kursyer shumën prej 347,119,249 lekë ose në masën 5% të fondit limit pa TVSh të prokuruar, nga të cilat:

-“Blerje me vlerë të vogël”, 49 procedura, me fondin limit në total prej 13,224,354 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 11,282,438 lekë, duke kursyer shumën prej 1,941,916 lekë;

-“Kërkesë për propozim”, 80 procedura, me fondin limit në total prej 154,277,161 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 131,040,362 lekë, duke kursyer shumën prej 23,236,799 lekë.

-”Tender i Hapur”, 59 procedura, me fondin limit në total prej 6,583,451,500 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 6,265,161,624 lekë, duke kursyer shumën prej 318,289,876 lekë.

-”Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, 91 procedura, me fondin limit në total prej 821,496,614 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 819,145,511 lekë, duke kursyer shumën prej 2,351,103 lekë.

-”Shërbim konsulence”, 15 procedura, me fondin limit në total prej 72,063,713 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 70,764,158 lekë, duke kursyer shumën prej 1,299,554 lekë.

Për vitin 2018, ka zhvilluar gjithsej 381 procedura prokurimi, me fondin limit pa TVSh në shumën 5,061,197,911 lekë, kontrata të lidhura pa TVSh në shumën 4,553,426,537 lekë, duke

kursyer shumën prej 507,771,374 lekë ose në masën 10% të fondit limit pa TVSh të prokuruar, nga të cilat:

-“Blerje me vlerë të vogël”, 32 procedura, me fondin limit në total prej 15,840,854 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 12,972,950 lekë, duke kursyer shumën prej 2,867,904 lekë;

-“Kërkesë për propozim”, 46 procedura, me fondin limit në total prej 110,723,203 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 97,513,061 lekë, duke kursyer shumën prej 13,210,142 lekë.

-”Tender i Hapur”, 39 procedura, me fondin limit në total prej 4,260,166,969 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 3,771,292,724 lekë, duke kursyer shumën prej 488,874,245 lekë.

-”Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, 26 procedura, me fondin limit në total prej 466,778,979 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 466,342,963 lekë, duke kursyer shumën prej 436,016 lekë.

-”Shërbim konsulence”, 45 procedura, me fondin limit në total prej 123,991,549 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 121,608,482 lekë, duke kursyer shumën prej 2,383,067 lekë.

Janë realizuar gjithashtu blerje nëpërmjet sistemit dinamik të blerjes dhe minikontrata sipas marrëveshjeve kuadër në total 186 procedura në shumën prej 507,771,374 lekë.

***Nga auditimi mbi përputhshmërinë e procedurave të prokurimit të realizuara gjatë viteve 2016-2018 me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi rezultoi për disa procedura të përzgjedhura gjetjet dhe rekomandimet si më poshtë vijon:***

#### **TVSH për pajisjet**

Nga auditimi u konstatua se në strukturën e kostos së preventivit në katër raste është aplikuar TVSH për pajisjet, duke rritur koston e preventivit dhe duke shpenzuar për të njëjtën paisje më shumë fonde publike nga AK në vlerën totale 10,164,504 lekë. Rastet e konstatuara janë si më poshtë:

<b>Titulli Gjetjes:</b>	<b>i</b>	Aplikim i TVSH për pajisjet në strukturën e kostos së preventivit, vlerë e cila duhet të mos ishte llogaritur. Mos ndarja në preventiv e vlerës së pajisjes (furnizimit) nga vlera e montimit (vendosjes), për zërat të cilët nuk janë të përfshirë në manualët përkatëse.					
<b>Situata:</b>		<p>1- <u><i>Për tenderin me objekt: "Rehabilitimi dhe instalimi i sistemit të ngrohjes në shkollën 9 – vjeçare "Vasil Shanto", me fond limit 53,108,324 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 18.4.2017.</i></u></p> <p>Nga auditimi i preventivit të paraqitur nga Autoritetit Kontraktor dhe ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik, konstatohet se për pajisjet është llogaritur TVSH, duke i konsideruar pajisjet si punime ndërtimi. Vlera e të gjithë zërit “Paisje” në ofertën e paraqitur nga OE fitues “K...” SHPK është si më poshtë:</p>					
		Nr	Emërtimi	Njësia	Çmimi	Sasia	Vlera
		1	F.V Pompë e mbrojtjes kundër zjarrit	copë	1,250,000	1	1,250,000
		2	F.V. Grupi i furnizimit me ujë + paneli elektrik (INVERTER)	copë	1,500,000	1	1,500,000
		3	F.V Pompa dranazhimit	copë	1,500,000	1	1,500,000

	F.V Kaldaje çeliku (grup termik), lënda e djegshme ashkla druri element 150 Ë, interaksi 600 mm, ΔT=50 °C.	copë	2,500,000	1	2,500,000
4	F.V Pompe qarkullimi binjake për terminalet ngrohëse te palestrës dhe katit përdhe (Inverter).	copë	250,000	1	250,000
5	F.V Pompe teke e kaldajës (Inverter)	copë	300,000	1	300,000
	Shuma pa TVSH				7,300,000
	<b>TVSH</b>				<b>1,460,000</b>
	<b>Vlera totale me TVSH</b>				<b>8,760,000</b>

Vlerës së mësipërme prej 7,300,000 lekë i është llogaritur TVSH në vlerën prej **1,460,000 lekë**, kjo vlerë padrejtësisht i është shtuar kostos së preventivit total. Pra, për të njëjtat paisje, AK duhet të shpenzonte vlerën 7,300,000 lekë, por në fakt ka shpenzuar 8,760,000 lekë, ose 1,460,000 lekë më shumë, e cila është pjesa e TVSH së paisjeve.

Gjithashtu nga auditimi i preventivit të paraqitur nga autoriteti kontraktor, konstatohet se në zërat të preventivit, ku ka edhe furnizim edhe vendosje, nuk është ndarë zëri furnizim nga zëri vendosje, duke e llogaritur në një të vetme vlerën e paisjes edhe vlerën e montimit.

Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi shoqëritë projektuese “K...” SHPK, me administrator z. Y.K. e cila ka hartuar preventivin.

Gjithashtu ka përgjegjësi edhe z. M.K., me detyrë përgjegjës i sektorit të projektimit inxhinierik, (ndërprerë marrëdhëniet e punës në datën 01.05.2018), drejtorja e projektimit (pranë drejtorisë së përgjithshme të planifikimit dhe zhvillimit të teritorit), sepse bazuar në detyrat e përcaktuara në rregulloren e brendshme të Bashkisë Tiranë, sektori i projektimit “Siguron kontrollin e përgjithshëm të preventivave që shoqërojnë projektet e hartuara nga studio private”.

2- Për tenderin me objekt “Furnizim vendosje me makineri e pajisje mekanike e të tjera, i ambienteve/godinave të Tirana Olimpik Park”, me fond limit 153,421,354 lekë, zhvilluar në datën 30.11.2017.

Nga auditimi i preventivit të Autoritetit Kontraktor dhe ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik, konstatohet se për pajisjet është llogaritur TVSH, duke i konsideruar pajisjet si punime ndërtimi. Vlera e të gjithë zërit “Paisje” në ofertën e paraqitur nga BOE fitues: “I...” & “K...” & “E...” SHPK është si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Cmimi	Vlera
Analiz					
An.03	Administrata Njësi kondicionimiPompe Nxehtësie Ajer-Uje,184 kë ftohje, 197kë ngrohje,bashkememodulinhidraulikpompe	copë	1	9,950,000	4,812,000
An.05	F.V. Pompe qarkullues binjake , prurja 17m³/h, rënia e presionit 0.6 bar, bashke me flanaxha e	copë	2	243,000	486,000

An.17	Njësikondicionimi Pompe NxehtësieAjër - Ujë , 54 kë ftohje, 65 kë ngrohje , bashke me moduln hidraulik.	copë	1	2,508,434	2,508,434
An.21	Motogjenerator 200 kë Pallati i sportit	copë copë	1	4,650,000	4,650,000
An.109	CHILLER Nr. 2 - U.T.A, (Versioni pompe nxehtësie ajër/ujë komplet me kitin hidraulik).	copë	1	9,950,000	9,950,000
An.115	Pompa e ri qarkullimit te ujit te ngrohhte/ftohte për UTA Nr. 1 dhe 2.KarakteristikatTeknike:Tipi DPH 120/340.65T-0.37/4.Fuqia e Instaluar : (2 x0.37)kë. Intensiteti irrymës (2 x1.1)A. Tensioni i dhëne: 3F /400V,50Hz. Pruria 28m3/h.	copë	1	180,800	180,800
An.116	Pompa e ri qarkullimit te ujit te ngrohhte/ftohte për UTA Nr. 3 KarakteristikatTeknike: Tipi DPH 150/360.80T -2.2/2. Fuqia e Instaluar : (2x0.22) kë. Intensiteti i rrymës (2 x4.6)A.Tensioni i dhëne: 3F /400V,50Hz. Prurja28m3/h.	copë	1	188,695	188,695
An.117	Pompa e ri qarkullimit te ujit te ngrohhte/ftohte per UTA Nr. 4 KarakteristikatTeknike:Tipi DPL 180/340/65T- 2.2/2 Fuqia e Instaluar : (2x2.22) kë Intensiteti irrymës (2x4.6)A. Tensioni i dhëne: 3F/400V,50Hz. Prurja 28m3/h Prevalenca 13mkH2O Lidhjet: DN 65/DN16	copë	1	204,486	204,486
An.21	Motogjeneratorë 200kë	copë	1	4,650,000	4,650,000
An.139	CHILLER Nr. 1 - Ujin e ngrohhte sanitar dhe Rekuperoret. (Versioni pompe nxehtësie me 4 tuba, ajër/ujëpër rikuperim nxehtësie, komplet me kitin hidraulik). Kapaciteti ftohës / ngrohës ne temperaturën: 101/116kë Temp. e jashtësme vere/dimër 35°C / 7°C Fuqia elektrike / tensioni/intensiteti/ ushqimi:39.1 kë/400V/79A /3F ~50Hz. Kit hidraulik (akumulator, ene zgjerimi, pompe riqarkullimi, valvul etj...) Grup mbushje automatike, sensor komplet dhe mbrojtje automatike kundër ngrirjes. Kompletuar me strukture metalike mbështetëse me amortizator. Pesha	copë	1	5,300,000	5,300,000

An. 143	Pompa eriqarkullimitteujit tengrohtesanitar copë	1	194,606	194,606
	KarakteristikatTeknike: TipiTOP-Z40/7~RGPN16/10.			
	Fuqiae Instaluar:(2x0.18) kë.Intensiteti i rrymës			
	(2x1.62)A.Tensioniidhene:3F/400V,50Hz.			
An.217	Transformator 630kVA 20/0,4kV Rezine copë	2	2,450,000	4,900,000
	(I thate)			
	Shuma pa TVSH			38,025,021
	<b>TVSH</b>			<b>7,605,004</b>
	<b>Vlera totale me TVSH</b>			<b>45,630,025</b>

Vlerës së mësipërme prej 38,025,021 lekë i është llogaritur TVSH në vlerën prej 7,605,004 lekë, e cila padrejtësisht i është shtuar koston së preventivit total. Pra për të njëjtat paisje AK duhet të shpenzonte vlerën 38,025,021, por në fakt ka shpenzuar 45,630,025 lekë, ose 7,605,004 lekë më shumë, pjesa e TVSH së paisjeve, e cila nuk duhej të llogaritej në preventivë. Gjithashtu nga auditimi i preventivit të paraqitur nga autoriteti kontraktor, konstatohet se në pjesën më të madhe të zërave të preventivit, për paisjet, nuk është ndarë zëri furnizim nga zëri vendosje, duke e llogaritur në një të vetme vlerën e paisjes edhe vlerën e montimit.

Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi shoqëritë projektuese (BOE) “D...” SHPK, me administrator z. E.T., shoqërinë “I...” SHPK, me administrator z.R.S. si hartues të preventivit;

Gjithashtu ka përgjegjësi edhe z. M.K., me detyrë përgjegjës i sektorit të projektimit inxhinierik, drejtoria e projektimit (pranë drejtorisë së përgjithshme të planifikimit dhe zhvillimit të teritorit), ndërprerë marrëdhëniet e punës në datën 01.05.2018 për shkak të daljes në pension, sepse bazuar në detyrat e përcaktuara në rregulloren e brendshme të Bashkisë Tiranë, sektori i projektimit “*Siguron kontrollin e përgjithshëm të preventivave që shoqërojnë projektet e hartuara nga studio private*”.

3- Për tenderin me objekt “Ndërtim i sallës së koncerteve, pranë Auditorit të Liceut Artistik “Jordan Misja”, me fond limit 98,206,643 lekë, zhvilluar në datën 30.10.2017.

Nga auditimi i preventivit të Autoritetit Kontraktor dhe ofertës së paraqitur nga BOE fitues “F...” & “E...”& “X...” SHPK, konstatohet se për pajisjet është llogaritur TVSH, duke i konsideruar paisjet si punime ndërtimi. Vlera e të gjithë zërit “Paisje” në ofertën e paraqitur nga BOE fitues është si më poshtë:

Nr. Analiz	Emërtimi	Njësia	Sasia	Cmimi	Vlera
	“F.V CHILLER për CTA-ne dhe Fan - Coilat e dhomave te shtesës dy kateshe (Versioni pompe nxehtesie)”	copë	1	4,420,000	4,420,000
	Shuma pa TVSH				4,420,000
	TVSH				884,000
	<b>Vlera totale me TVSH</b>				<b>5,304,000</b>

Vlerës së mësipërme prej 4,420,000 lekë i është llogaritur TVSH në vlerën prej 884,000 lekë, e cila padrejtësisht i është shtuar kostos së preventivit total. Pra për të njëjtat paisje AK duhet të shpenzonte vlerën 4,420,000, por në fakt ka shpenzuar 5,304,000 lekë, ose 884,000 lekë më shumë.

Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi hartuesin e preventivit znj. A.B., me detyrë specialiste në sektorin e projektimit inxhinierik, z. M.K., me detyrë ish përgjegjës i sektorit të projektimit inxhinierik, (ndërprerë marrëdhëniet e punës në datën 01.05.2018), drejtorja e projektimit, në cilësinë e kontrollorit të projektit dhe nënshkrimit të tij.

4- Për tenderin me objekt "Rehabilitim i pjesëshëm dhe instalimi i sistemit të ngrohjes në shkollën 9-vjeçare "Dhora Leka" dhe ndërtimi i palestrës", me fond limit 63,254,523 lekë, zhvilluar në datën 25.08.2017.

Nga auditimi i preventivit të Autoritetit Kontraktor dhe ofertës së paraqitur nga OE fitues "K..." SHPK, konstatohet se për pajisjet është llogaritur TVSH, duke i konsideruar paisjet si punime ndërtimi. Vlera e të gjithë zërit "Paisje" në ofertën e paraqitur nga BOE fitues është si më poshtë:

Nr.	Nr. Analizës	Emërtimi i Zërit	Sasia	Cmimi	Vlera
	Analizë	F.V Pompë e mbrojtjes kundër zjarrit	1	225,300	225,300
P-3.2	Analizë	F.VPompe qarkullimi teke (Inverter) për qarkun primar ( kaldaja)	1	263,700	263,700
P-3.3	Analizë	F.V Pompe qarkullimi binjake (Inverter) për furnizimin e terminaleve të ngrohjes përshkollën.	1	395,100	395,100
P-3.4	Analizë	F.V Pompe qarkullimi binjake (Inverter) për furnizimin e terminaleve të ngrohjes përshkollën.	1	193,400	193,400
		Vlera pa TVSH			1,077,500
		<b>TVSH</b>		<b>215,500</b>	
		<b>Vlera totale në preventiv</b>		<b>1,293,000</b>	

Vlerës së mësipërme prej 1,077,500 lekë i është llogaritur TVSH në vlerën prej 215,500lekë, e cila padrejtësisht i është shtuar kostos së preventivit total. Pra për të njëjtat paisje AK duhet të shpenzonte vlerën 1,077,500 lekë, por në fakt ka shpenzuar 1,293,000lekë, ose 215,500 lekë më shumë.

Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi z.M.K., me detyrë përgjegjës i sektorit të projektimit inxhinierik, (ndërprerë marrëdhëniet e punës në datën 01.05.2018), drejtorja e projektimit (pranë drejtorisë së përgjithshme të planifikimit dhe zhvillimit të teritorit), sepse bazuar në detyrat e përcaktuara në rregulloren e brendshme të Bashkisë Tiranë, sektori i projektimit "Siguron kontrollin e përgjithshëm të preventivave që shoqërojnë projektet e hartuara nga studio private".

**Kriteri:**

Veprimet e mësipërme për llogaritjen e TVSH për paisjet, janë në kundërshtim me:  
 i) UKM nr. 2, datë 8.5.2003 "Për Klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit", Kreu I/I "Klasifikimi i punimeve të ndërtimit", germa "A", paragrafi i fundit, ku përcaktohet se nga punimet e ndërtimit, "Në të gjitha rastet përjashtohen pajisjet dhe aparaturat";  
 ii) VKM nr. 514, datë 15/8/2007 "Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e

manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, ndryshuar me VKM nr. 664, datë 26/9/2012, pika 8, ku përcaktohet se: “Analizat teknike do të përgatiten në përputhje me metodologjinë e përcaktuar në Kreun I të udhëzimit nr. 2, datë 08.05.2003 të Këshillit të Ministrave, .....”. Në udhëzimin në fjalë përcaktohet klasifikimi i punimeve të ndërtimit: a) punime ndërtimi; b) punime teknologjike dhe të montimit. Ky udhëzim sqaron se në punimet e montimit përfshihen punimet për montimin e pajisjeve dhe të makinerive. Pra struktura e kostos së preventivit duhet të pasqyrojë më vete, si zë të veçantë, vlerën që nevojitet për montimin e paisjes dhe më vete vlerën e paisjes.

iii) UKM Nr. 1, datë 16.6.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, pika 1, germa “c”, paragrafi i fundit, ku përcaktohet se: “Preventivin e plotë të projektit të zbatimit, duke përfshirë të gjitha vëllimet e punimeve të projekteve të lartpërmendura, hartuar nga projektuesit në përputhje me pikën 3.1 (formati tip bashkëlidhur këtij udhëzimi).

Nr.	Nr. Analizës	Emërtimi i punimeve	Njësia	Sasia	Cmimi	Vlera
		Zërat e punimeve				
		Shuma				
		TVSH				
		Shuma				
		Paisje				
		Shuma				

Ky format i miratuar nga Këshilli i Ministrave me udhëzimin e lartpërmendur parashikon emërtimin e zërave të punimeve, sasi, çmim, vlerë si dhe shuma e tyre, duke i shtuar TVSH, pastaj kësaj shume i shtohen vetëm pajisjet pa TVSH. Po me këtë udhëzim është miratuar edhe paraqitja e zërave të punimeve dhe pajisjeve në miratimin e strukturës së situacionit që paraqitet për likuidim.

**Ndikimi/Efekti:** **Llogaritja e TVSH për paisjet ka sjellë si efekt përdorim të fondeve publike pa efencë, pasi për të njëjtën paisje, AK Bashkia Tiranë ka shpenzuar më shumë fonde publike në vlerën totale 10,164,504 lekë, sipas 4 rasteve të trajtuar më lartë.**

**Shkaku:** Mos zbatim i kërkesave ligjore nga hartuesit e preventivit(studiot private dhe në një rast nga vetë AK), mos kontrolli i këtyre preventivave nga struktura përkatëse e njësisë vendore: sektori i projektimit.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandim:**

- 1) Për tenderin "Rehabilitimi dhe instalimi i sistemit të ngrohjes në shkollën 9 – vjeçare "Vasil Shanto, për arsye se nuk ka përfunduar likuidimi total i kontratës, por deri në këtë fazë të auditimit AK ka ende për likuidim edhe 21,064,769 lekë, vlera prej 1,460,000lekë nuk duhet ti likuidohet OE fitues "K..." SHPK.
- 2) Për tenderin "Furnizim vendosje me makineri e pajisje mekanike e të tjera, i ambienteve/godinave të Tirana Olimpik Park", për arsye se nuk ka përfunduar likuidimi total i kontratës, por deri në këtë fazë të auditimit AK ka ende për likuidim edhe 45,967,783 lekë, vlera prej 7,605,004lekë nuk duhet ti likuidohet BOE fitues: "I..."& "K..." & "E..." SHPK.
- 3) Për tenderin "Ndërtim i sallës së koncerteve, pranë Auditorit të Liceut Artistik "Jordan Misja", për arsye se nuk ka përfunduar likuidimi total i kontratës, por deri në këtë fazë të auditimit AK ka ende për likuidim edhe 8,452,418 lekë, vlera prej 884,000 lekë nuk duhet ti likuidohet BOE fitues: "F..." & "E..."& "X..." SHPK.
- 4) Për tenderin "Rehabilitim i pjesshëm dhe instalimi i sistemit të ngrohjes në shkollën 9-



vjeçare "Dhora Leka" dhe ndërtimi i palestrës", për arsye se nuk ka përfunduar likuidimi total i kontratës, por deri në këtë fazë të auditimit AK ka ende për likuidim edhe 12,568,983 lekë, vlera prej 215,500 lekë nuk duhet ti likuidohet OE fitues "K..." SHPK. Për të gjitha rastet e mësipërme situacionet dhe faturat midis bashkisë dhe subjektit të hartohen duke mos aplikuar TVSH.

Nga auditimi u konstatua se në një rast nga KVO është kualifikuar dhe shpallur fitues operatori ekonomik, i cili nuk plotëson kriteret e vendosura në dokumentet standarde të tenderit, si më poshtë vijon:

<p><b>Titulli Gjetjes:</b></p>	<p><b>i</b> Në tenderin me objekt "Rikualifikim urban i bllokut të kufizuar nga Rr."Llambi Bonata", Rr. "Haki Stermilli", "Musine Kokalari" dhe rikonstruksion i rrugës "Zyber Zeneli", vazhdim i rrugës "Ali Kelmendi", zhvilluar në datën 27.06.2017, me vlerë të fondit limit 101,887,644 lekë, është kualifikuar dhe shpallur fitues BOE "A..." &amp; "E..." SHPK, i cili nuk plotëson kriteret e vendosura në dokumentet standarde të tenderit (DST). Kualifikimi i operatorit ekonomik me vlerë të ofertës ekonomike 84,521,440 lekë është bërë në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik.</p>																																												
<p><b>Situata:</b></p>	<p>Operatorët pjesëmarrës në tender, kualifikimet dhe skualifikimet nga KVO:</p> <table border="1" data-bbox="367 929 1436 1310"> <thead> <tr> <th>Nr</th> <th>Operatorët ofertues</th> <th>Vlera e ofertës pa TVSH</th> <th>Kualifikimi</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>BOE "B..." &amp; "M..." SHPK</td> <td>79,854,633</td> <td>S'kualifikuar</td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>BOE "A..." &amp; "B...N"</td> <td>83,345,133</td> <td>S'kualifikuar</td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>BOE "B..." &amp; "P...s" SHPK</td> <td>84,074,923</td> <td>S'kualifikuar</td> </tr> <tr> <td><b>4</b></td> <td><b>BOE "A..." &amp; "E..." SHPK</b></td> <td><b>84,521,440</b></td> <td><b>Kualifikuar, Fitues</b></td> </tr> <tr> <td>5</td> <td>"H..." SHPK</td> <td>84,805,991</td> <td>Kualifikuar</td> </tr> <tr> <td>6</td> <td>"C..." SHPK</td> <td>88,214,712</td> <td>Kualifikuar</td> </tr> <tr> <td>7</td> <td>"B..." &amp; "A..." SHPK</td> <td>88,569,144</td> <td>Kualifikuar</td> </tr> <tr> <td>8</td> <td>"2..." SHPK</td> <td>89,704,066</td> <td>Kualifikuar</td> </tr> <tr> <td>9</td> <td>"G..." &amp; "S..." SHPK</td> <td>92,679,147</td> <td>Kualifikuar</td> </tr> <tr> <td>10</td> <td>"A..." SHPK</td> <td>92,702,523</td> <td>S'kualifikuar</td> </tr> </tbody> </table> <p>Në tender kanë marrë pjesë 10 operatorë ekonomik, nga të cilit është kualifikuar dhe shpallur fitues BOE "A..." &amp; "E..." SHPK, me vlerë të ofertës ekonomike 84,521,440 lekë, ose 17,366,204 lekë më pak se vlera e fondit limit. BOE i shpallur fitues është i renditur i katërti në radhë për nga vlera e ofertës dhe tre operatorët e tjerë, me vlerë më të vogël të ofertës, janë s'kualifikuar me të drejtë pasi nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DST. Nga auditimi konstatohet se edhe BOE "A..." &amp; "E..." SHPK, shpallur fitues, nuk i plotëson kriteret e vendosura në DST dhe duhej të skualifikohej nga KVO, duke vazhduar me operatorët e tjerë ekonomik në radhë. Nga auditimi është konstatuar se arsyet pse BOE "A..." &amp; "E..." SHPK, nuk plotëson kriteret për kualifikim dhe shpalljen fitues janë si më poshtë:</p> <p>a) Nuk plotëson kriterin e pikës (dh) të kriterëve të veçanta të kualifikimit të DST, ku përcaktohet se ofertuesi duhet të dorëzojë: "Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri".</p> <p>- Në vërtetimin e debisë për energjinë elektrike, nr. 16001/1, datë 20.06.2017, lëshuar nga OSHEE, përshkruhet se shoqëria "Edil-Al-IT" SHPK ka në total një vlerë detyrimesh të pa paguara të energjisë elektrike prej 1,954,016 lekë. Në vërtetim përshkruhet se "Vlera totale e detyrimit është në proces ankimimi".</p> <p>Në nenin 26, pika nr. 7, germa (c)–"Kontratat për punë publike", të VKM 914, datë</p>	Nr	Operatorët ofertues	Vlera e ofertës pa TVSH	Kualifikimi	1	BOE "B..." & "M..." SHPK	79,854,633	S'kualifikuar	2	BOE "A..." & "B...N"	83,345,133	S'kualifikuar	3	BOE "B..." & "P...s" SHPK	84,074,923	S'kualifikuar	<b>4</b>	<b>BOE "A..." &amp; "E..." SHPK</b>	<b>84,521,440</b>	<b>Kualifikuar, Fitues</b>	5	"H..." SHPK	84,805,991	Kualifikuar	6	"C..." SHPK	88,214,712	Kualifikuar	7	"B..." & "A..." SHPK	88,569,144	Kualifikuar	8	"2..." SHPK	89,704,066	Kualifikuar	9	"G..." & "S..." SHPK	92,679,147	Kualifikuar	10	"A..." SHPK	92,702,523	S'kualifikuar
Nr	Operatorët ofertues	Vlera e ofertës pa TVSH	Kualifikimi																																										
1	BOE "B..." & "M..." SHPK	79,854,633	S'kualifikuar																																										
2	BOE "A..." & "B...N"	83,345,133	S'kualifikuar																																										
3	BOE "B..." & "P...s" SHPK	84,074,923	S'kualifikuar																																										
<b>4</b>	<b>BOE "A..." &amp; "E..." SHPK</b>	<b>84,521,440</b>	<b>Kualifikuar, Fitues</b>																																										
5	"H..." SHPK	84,805,991	Kualifikuar																																										
6	"C..." SHPK	88,214,712	Kualifikuar																																										
7	"B..." & "A..." SHPK	88,569,144	Kualifikuar																																										
8	"2..." SHPK	89,704,066	Kualifikuar																																										
9	"G..." & "S..." SHPK	92,679,147	Kualifikuar																																										
10	"A..." SHPK	92,702,523	S'kualifikuar																																										

29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: *Për të provuar përmbushjen e kriterit për kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon:*

*c) një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mos shlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për s’kualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.*

Shoqëria “E....” SHPK nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për të vërtetuar se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike në vlerën 1,954,016 lekë, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Shprehja në vërtetimin e debisë lëshuar nga OSHEE, se “Vlera totale e detyrimit është në proces animimi”, nga vetë burimi i shkresës, pra institucioni që e ka lëshuar atë, vërteton se ky proces ankimi është brenda strukturave të OSHEE.

b)Nuk plotëson kriterin e pikës 2/8-Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës, të kriterëve tëveçanta të kualifikimit tëDST, ku përcaktohet:*Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, 1 (një) mjek të përgjithshëm, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, urdhër mjeku, diplomë, CV, librezë pune, si dhe të figurojë në listë-pagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit, Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm”.*

Shoqëria “A....”SHPK, për të plotësuar kriterin e mësipërm ka paraqitur dokumentacion për mjekun Kastriot Mema (ndodhet në listë-pagesën e shoqërisë), por nga auditimi rezulton se “Licensa për ushtrimin individual të profesionit për mjek”, nuk është e vlefshme, pasi është lëshuar në datën 28.09.2011, me afat vlefshmërie 5 vjet, pra deri më datën 28.09.2016. Mjeku nuk mund të ushtrojë profesionin e tij pa licensën përkatëse.

Shoqëria “E...” SHPK në datën 01.02.2016, ka lidhur kontratë pune me mjekun E.M., por nga auditimi rezulton se “Licensa për ushtrimin individual të profesionit për mjek”, për z. Emin Mezini nuk është e vlefshme, pasi është lëshuar në datën 12.4.2012, me afat vlefshmërie 5 vjet, pra deri më 12.04.2017, ndërkohë që tenderi zhvillohet në datën 27.06.2017.

Për sa më sipër, KVO duhet të kishte s’kualifikuar edhe BOE “A...” & “E...” SHPK, pasi nuk plotëson kriteret e vendosura në DST. Duhej të ishte shpallur fitues operatori tjetër në radhë i kualifikuar, “H...” SHPK, i cili plotëson kriteret e vendosura në DST, pavarësisht se ka ofertë ekonomike të lartë.

Për sa më sipër është përgjegjësi e anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave, z. T.T., kryetar, me detyrë drejtor i përgjithshëm i punëve publike, z. E.B., anëtar, me detyrë drejtor i drejtorisë së përgjithshme të objekteve në bashkëpronësi, z. E.P. me detyrë drejtor i drejtorisë së transportit dhe trafikut rrugor.

**Kriteri:**

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me:  
 - neni 46 - “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1, ku thuhet: *Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret ..., që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese.*  
 - neni 53 - “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 dhe pika 5 të ligjit nr. 9643, datë

	20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku thuhet: “3. Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, ...5. Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë: a) kur ofertuesi nuk është i kualifikuar; c) kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”;
<b>Ndikimi/ Efekti:</b>	Kualifikimi dhe shpallja fitues e operatorit ekonomik i cili nuk plotëson kriteret e vendosura në DST, nuk jep garanci për realizimin me sukses të kontratës, duke sjellë premisa të larta për përdorim të fondeve publike pa efektivitet. Kualifikimi i operatorit ekonomik me vlerë të ofertës ekonomike 84,521,440 lekë është bërë në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik.
<b>Shkaku:</b>	Mos zbatim i kërkesave ligjore nga KVO për kualifikimin dhe s’kualifikimin e operatorve ekonomik.
<b>Rëndësia:</b>	E mesme
<b>Rekomandim:</b>	Autoriteti kontraktor të analizojë situatën e mësipërme me qëllim eliminimin e rasteve të kualifikimeve dhe shpalljes fitues të operatorëve ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DST.

Nga auditimi u konstatua se në një rast, në dokumentacionin e paraqitur nga OE fitues për llogaritjen e fondit limit dhe të projektit, nuk u konstatua dokumentacion për të argumentuar mënyrën e përllogaritjes së fondit limit.

<b>Titulli Gjetjes:</b>	i Nga auditimi u konstatua se në tenderin me objekt "Furnizim vendosje me makineri e pajisje mekanike e të tjera i ambienteve / godinave të Tirana Olimpik Park”, me fond limit 153,421,354 lekë, zhvilluar në datën 30.11.2017, në dokumentacionin e paraqitur nga OE fitues për llogaritjen e fondit limit dhe të projektit, nuk u konstatua dokumentacion për të argumentuar mënyrën e përllogaritjes së fondit limit.
<b>Situata:</b>	Në tenderin e mësipërm llogaritjen e fondit limit është kryer nga shoqëria “D...” SHPK dhe nga auditimi u konstatua sepër llogaritjen e fondit limit, nuk u konstatua dokumentacion për të argumentuar mënyrën e llogaritjes së tij. Kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi kërkojnë që për llogaritjen e fondit limit të zbatohet një nga praktikatat e përcaktuara ligjore, si referenca e çmimeve të tregut, çmimeve të organeve doganore/tatimore, apo INSTAT-it, por deri në këtë fazë të auditimit një gjë e tillë nuk vërtetohet me dokumentacion. Gjithashtu nuk u konstatua dokumentacion se nga vetë autoriteti kontraktor, nëpërmjet strukturave përkatëse si sektori i projektimit inxhinierik, të jetë kryer kontrolli i preventivit të hartuar nga studioja private, nëse ky preventiv është në përputhje me çmimet e tregut (bazuar në rregulloren e brendshme të njësisë vendore ky sektor duhet të kryej këtë detyrë).
<b>Kriteri:</b>	Neni 59 të VKM 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku thuhet: <i>Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës autoriteti kontraktor duhet të referohet një apo më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/ dhe çmime të tjera zyrtare të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, manuale etj.; ose/dhe a) çmimet e tregut; b) çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga vet apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe c) çmimet ndërkombëtare të botuara.</i>

	<i>Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrimit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet</i>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mungesa e dokumentacionit për referencat e çmimeve për llogaritjen e fondit limit, nuk jep siguri të arsyeshme mbi saktësinë e çmimeve të preventivit për paisjet e për rrjedhojë për vlerën e fondit limit.
<b>Shkaku:</b>	Mos zbatim i kërkesave ligjore lidhur me hartimin e fondit limit, si nga studio private “D...” SHPK, ashtu edhe nga njësia vendore.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë
<b>Rekomandimi:</b>	Bashkia Tiranë, nëpërmjet strukturave përkatëse si sektori i projektimit inxhinierik etj., në rastin e hartimit të preventivit nga studio private, të kërkojë prej tyre dokumentacionin e nevojshëm ligjor, për argumentimin e fondit limit. Gjithashtu të bëhet kontrolli i preventivit të hartuar nga studioja private, nëse çmimet e pasqyruara në të janë rrjedhojë e studimit të tregut, apo në përputhje me çmimet e organeve doganore/tatimore, INSTAT, manualët përkatëse etj. Këto struktura kontrolluese të shprehen me shkrim për këtë kontroll dhe dokumenti të bëhet pjesë e dosjes së tenderit.

*Mos argumentim i kriterëve të vendosura nga njësia e prokurimit në dokumentet standarde të tenderit.*

<b>Titulli Gjetjes:</b>	<b>i</b> Mos argumentim i kriterëve të vendosura nga njësia e prokurimit në dokumentet standarde të tenderit. Nga auditimi u konstatua se në të gjithë tenderat e audituar, nga njësia e prokurimit e cila ka hartuar dokumentet standarde të tenderit, në procesverbalin e mbajtur prej saj për hartimin e kriterëve të veçanta të DST, nuk është dokumentuar argumentimi i kriterëve të vendosura. Në shumicën e rasteve edhe pse argumentimi nuk është dokumentuar, kriteret janë vendosur në përputhje me kërkesat ligjore, vlerën dhe natyrën e kontratës, ndërsa në shtatë raste këto kriterë janë hartuar jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Rastet e hartimit të kriterëve jo në përputhje me kërkesat ligjore, vlerën dhe natyrën e kontratës, janë si më poshtë:
<b>Situata:</b>	<i><u>1- Për tenderin me objekt "Rehabilitimi dhe instalimi i sistemit të ngrohjes në shkollën 9 – vjeçare "Vasil Shanto", zhvilluar në datën 18.4.2017.</u></i> Dokumentet e tenderit janë hartuar nga njësia e prokurimit ngritur me urdhrin nr. 10542 prot., datë 20.03.2017 të titullarit të AK. Nga auditimi i kriterëve të veçanta të kualifikimit konstatohet se: Në pikën 3, germa a-Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës, është vendosur kriteri se operatori ekonomik duhet të ketë në staf të punësuar: a.Inxhinier–Auditues energjie (1 person), i pajisur me “Certifikate për auditimin e energjisë). Për inxhinierin e eficensës së energjisë duhet të ketë këto dokumente: Kontrata e punës (e vlefshme për të paktën periudhën e parashikuar të ndërtimit), Certifikata (Dip) për eficensën e energjisë. Në procesverbalin e mbajtur nga NJP nuk janë mbështetur me argumente shpjeguese hartimi i kriterëve të veçanta të vendosura në DST. Veprimet e mësipërme lidhur me kriteret e DST, janë përgjegjësi e anëtarëve të njësisë së prokurimit e përbërë nga znj. Ledia Ramo z. Julian Kurti, z. Bojken Kurteshi.

2- Për tenderin me objekt "Furnizim vendosje me makineri e pajisje mekanike e të tjera i ambienteve / godinave të Tirana Olimpik Park", me fond limit 153,421,354 lekë, zhvilluar në datën 30.11.2017.

Dokumentet e tenderit janë hartuar nga njësia e prokurimit, ngritur me urdhrin nr.37575 prot., datë 16.10.2017 të titullarit të njësisë vendore.

Në pikën nr.11 të kriterëve të veçanta të DST, hartuar nga njësia e prokurimit, është kërkuar se OE duhet të paraqesin dokumentacion për:

- 2 kamion vetëshkarkues, kapaciteti mbajtës minimum 3.5 ton dhe maksimumi 5 ton për secilin kamion;
- 2 kamionçinë kapaciteti mbajtës për secilën kamionçinë deri në 2 ton.

Nga auditimi i preventivit konstatohet se nuk ka zë pune i cili të lidhet me nevojën e kamionit vetëshkarkues dhe të kamionçinave.

Meqenëse këto mjete janë kërkuar për të siguruar transportin e orendive dhe paisjeve, rastin e mallrave, sigurimi i transportit të mallit deri te AK është detyrë e kontraktorit dhe nuk është e nevojshme kërkesa për mjete transporti. Gjithashtu mjetet e kërkuara të transportit nuk janë të përshtatshme për këtë proces pune dhe natyrën e mallrave.

Kufizimi i vlerës maksimale të kapacitetit të mjeteve të mësipërme (deri në 5 ton për secilin kamion dhe deri në 2 ton për secilën kamionçinë) është një kriter i pa argumentuar, që nuk lidhet me ndonjë specifikë të objektit të prokurimit.

Në pikën nr.6 të kriterëve të veçanta të DST, është vendosur kriteri se OE duhet: Të ketë në stafin e punonjësve të pasqyruar në listë- pagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit të paktën 10 (dhjetë) punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të, ku nga këta të jene të paktën:

- Grupi III- 4(katër) punonjës
- Grupi IV-3 (tre) punonjës
- Grupi V- 3 (tre) punonjës).

Nga NJP nuk është përcaktuar se çfarë profili duhet të kenë punonjësit e mësipërm, duke e bërë kriterin jo të plotë dhe jo të qartë.

Në procesverbalin e mbajtur nga NJP nuk janë mbështetur me argumente shpjeguese hartimi i kriterëve të veçanta të vendosura në DST.

Veprimet e mësipërme lidhur me kriteret e DST, janë përgjegjësi e anëtarëve të njësisë së prokurimit: znj. L.R. juriste, me detyrë ish përgjegjëse e sektorit të prokurimeve të projekteve dhe infrastrukturës arsimore, aktualisht përgjegjëse e sektorit të prokurimeve në Shoqërinë Aksionere Ujësjetllës Kanalizime Tiranë, znj. I.K., me detyrë specialiste në sektorin e kontrollit të projekteve, z. A.S., me detyrë specialist në sektorin e statistikave të prokurimeve.

3- Për tenderin me objekt :Ndërtim i sallës së koncerteve, pranë Auditorit të Liceut Artistik "Jordan Misja", me fond limit 98,206,643 lekë, zhvilluar në datën 30.10.2017.

Dokumentet e tenderit janë hartuar nga njësia e prokurimit, ngritur me urdhrin nr. nr.33864 prot., datë 19.8.2017 të titullarit të njësisë vendore. Për hartimin e kriterëve të DST njësia e prokurimit ka mbajtur procesverbalin nr.1, datë 19.09.2017.

Nga auditimi i kriterëve të veçanta të kualifikimit konstatohet se:

Në pikën nr.3 - Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës është kërkuar: "Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një

deklarate (nga administratori i shoqërisë) drejtuesin teknik të punimeve në objekt,....si dhe të ketë eksperiencë pune minimumi 20 (njëzet) vjet. Ky kriter është i pa argumentuar.

Në pikën 3/5.2 të kriterëve të veçanta të kualifikimit - Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës është kërkuar: Operatori ekonomik te ketë ne staf te punësuar: a. Inxhinier – Auditues energjie (1 person) (i pajisur me “Certifikate për auditimin e energjisë). Vendosja e këtij kriteri është e paargumentuar, sepse në preventivin e hartuar nga AK nuk ka asnjë zë si rezultat i zbatimit të të cilit kërkohet auditues energjie.

Nuk janë bërë pjesë e DST argumentimet e nevojshme për kriteret e vendosura. Nuk janë dhënë shpjegime për shembull përse kapaciteti mbajtës për kamionçinë është kufizuar minimum 3.5 ton dhe maksimumi 5 ton për secilin mjet, etj.

Veprimet e mësipërme janë përgjegjësi e anëtarëve të njësisë së prokurimit, si hartues të kriterëve të veçanta të DST:znj. L.R., juriste, me detyrë ish përgjegjëse e sektorit të prokurimeve të projekteve dhe infrastrukturës arsimore, aktualisht, përgjegjëse e sektorit të prokurimeve në Ujësjellës Kanalizime SHA Tiranë, znj. F.S., me detyrë specialiste në sektorin e prokurimeve të projekteve dhe infrastrukturës arsimore, z. J.K., me detyrë specialist në sektorin e kontrollit të projekteve.

4-Për tenderin me objekt “Ndërtim i ri i shkollës 9 – vjeçare S.Maçi”, me fond limit 233,309,164 lekë, zhvilluar në datën 06.09.2017.

Dokumentet e tenderit janë hartuar nga njësia e prokurimit, ngritur me urdhrin nr.27634 prot., datë 20.07.2017 të titullarit të njësisë vendore.

Në procesverbalin e mbajtur nga njësia e prokurimit për hartimin e kriterëve të veçanta të DST, nuk janë dhënë argumentime për kriteret e vendosura.

Në DST midis të tjerash janë kërkuar: Kamion vetëshkarkues kapaciteti mbajtës minimum 5ton dhe maksimumi 10 ton për secilin kamion), tre copë; Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 3.5 ton dhe maksimumi 5 ton për secilin kamion, 2 copë, por nuk ka argumentime për vendosjen e kapacitetit maksimal të mjeteve.

Për mos argumentimin e kriterëve ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit: znj. L.R., znj.F.S., z. J.K..

5- Për tenderin me objekt: “Ndërtim palestre Shkolla e Mesme e Bashkuar Farkë”, me fond limit 51,278,786 lekë, zhvilluar në datën 19.12.2017.

Dokumentet e tenderit janë hartuar nga njësia e prokurimit, ngritur me urdhrin nr.36100 prot., datë 05.10.2017 të titullarit të njësisë vendore.

Në procesverbalin e mbajtur nga njësia e prokurimit për hartimin e kriterëve të veçanta të DST, nuk janë dhënë argumentime për kriteret e vendosura.

Në DST është kërkuar: Operatori ekonomik te ketë në staf të punësuar: a. Inxhinier – Auditues energjie (1 person), i pajisur me “Certifikatë për auditimin e energjisë.

Vendosja e këtij kriteri është e paargumentuar, sepse në preventivin e hartuar nga AK nuk ka asnjë zë si rezultat i zbatimit të të cilit kërkohet auditues energjie.

Veprimet e mësipërme janë përgjegjësi e anëtarëve të njësisë së prokurimit: znj. L.R., juriste, z. E.M.me detyrë specialist në sektorin e kontrollit të projekteve, z. A.S. detyrë specialist në sektorin e statistikave të prokurimeve.

6-Për tenderin me objekt: *Rehabilitim i pjesshëm dhe instalimi i sistemit të ngrohjes në shkollën 9-vjeçare "Dhura Leka" dhe ndërtimi i palestrës", me fond limit 63,254,523 lekë, zhvilluar në datën 25.08.2017.*

Dokumentet e tenderit janë hartuar nga njësia e prokurimit (NJP).

Nuk janë bërë pjesë e DST argumentimet e nevojshme për kriteret e vendosura.

Në DST është kërkuar: Operatori ekonomik të ketë në staf të punësuar: a. Inxhinier – Auditues energjie (1 person) (i pajisur me "Certifikate për auditimin e energjisë).

Vendosja e këtij kriteri është e paargumentuar, sepse në preventivin e hartuar nga AK nuk ka asnjë zë si rezultat i zbatimit të të cilit kërkohet auditues energjie.

Nuk janë dhënë argumentime përse vlera maksimale e kapacitetit mbajtës për kamionçinë është kufizuar në 5 ton (është kërkuar kamionçinë me kapacitet mbajtës minimum 3.5 ton dhe maksimumi 5 ton për secilin mjet) etj.

Për mos argumentimin e kriterëve ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit, si hartues të kriterëve të veçanta të DST: znj. L.R., z.B.K. me detyrë specialist në sektorin e prokurimeve të projekteve dhe infrastrukturës dhe z. A.B. me detyrë specialist në sektorin e kontrollit të projekteve.

7- *Për tenderin: "Shërbimi i Pastrimit të Zonës Tirana II", me fond limit 537,078,671 lekë, zhvilluar në datën 27.09.2017.*

NJP, njëkohësisht hartues të DST:

Dokumentet e tenderit janë hartuar nga njësia e prokurimit (NJP. Në pikën 1, të DST, seksioni kriteret e veçanta të kualifikimit, nga NJP është kërkuar që ofertuesi të paraqes "Shërbime të së njëjtës natyrë me objektin e prokurimit me vlerë 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet", në kundërshtim me kërkesat e nenit 28, pika 3 - Kontratat e shërbimeve, të VKM 914 datë 29.2.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, ku citohet: "Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit".

Argumentimi i kriterëve të vendosura nuk është dokumentuar në DST.

Për veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit: z. N.K., z. G.N., z. G.N., z. G.D., z. E.T.

**Kriteri:**

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me:

- Nenin 61 të VKM 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" pika nr.2, ku thuhet: *Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim ... duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre*".

- Nenin 26 "Kontrata për punë publike", pika 5, të VKM nr. 94, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, në të cilën thuhet: "*Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës;*

- Nenin 17, pika 3, germa b, të ligjit nr. 124/2015 "Për eficientësinë e energjisë", ku thuhet: *Auditimi energjetik nuk kryhet nga një auditues energjetik, i cili... b)*

	<i>është anëtar i një organi drejtues të entitetit, që ka kërkuar, ose të cilit i bëhet auditimi, ose është i punësuar nga personi që ka kërkuar auditimin.</i>
<b>Ndikimi/ Efekti:</b>	Vendosja e kriterëve të pa qarta dhe mos argumentimi i tyre, përveç se është mos zbatim i kërkesave ligjore lidhur me hartimin e DST, vë në vështirësi operatorët ekonomik në plotësimin e tyre, sjellë paqartësi dhe vështirësi për KVO gjatë vlerësimit të operatorëve ekonomik për plotësimin të kriterëve të DST, sidomos në aplikimin e nenit për “devijime të vogla”. Duke i shkruar argumentet e kriterëve që vendos, vetë njësia e prokurimit nëpërmjet këtij procesi (analizimit dhe përfshirjes së tyre në procesverbal), krijon një siguri më të lartë se kriteret e vendosura janë ato të duhurat. Duke mos i argumentuar rritet probabiliteti i gabimit.
<b>Shkaku:</b>	Mos zbatimi i kërkesave ligjore nga njësia e prokurimit në hartimin e kriterëve të veçanta të DST.
<b>Rëndësia:</b>	E mesme
<b>Rekomandim:</b>	Në hartimin e kriterëve të DST, njësia e prokurimit të jap argumente për secilin kriter dhe këto argumente të bëhen pjesë e procesverbalit që mbahet prej saj dhe pjesë e DST.

**Komente nga subjekti i audituar:** *Nga njësia e prokurimit me shkresën (të dhëna të subjektit) nr. 16399/1/2/3/4/5/6/7/8/9, datë 23.04.2019 janë bërë kundërshti lidhur me tenderin me objekt: Ndërtim palestere shkolla e mesme e bashkuar Farkë; “Rehabilitimi dhe instalimi i sistemit të ngrohjes në shkollën 9 – vjeçare ”Vasil Shanto”, “Ndërtim i ri i shkollës 9-vjeçare Servete Maçi”; ”Rehabilitim i pjesshëm dhe instalimi i sistemit të ngrohjes në shkollën 9-vjeçare ”Dhora Leka”; “Rikonstruksion i shkollës –vjeçare Dora D’Istra”; ”Furnizim vendosje me makineri e pajisje mekanike e të tjera i ambienteve / godinave të Tirana Olimpik Park”; “Paisje dhe orendi për shkollat, kopshte, çerdhe dhe qendra komunitare”; “Ndërtim i sallës së koncerteve, pranë Auditorit të Liceut Artistik ”Jordan Misja”; “Paisje dhe orendi per shkollat, kopshte, çerdhe dhe qendra komunitare”. Në komentet e njësisë së prokurimit kundërshtohen konkluzionet grupit të auditimit lidhur me faktin se nga kjo njësi nuk është argumentuar vendosja e kriterëve të veçanta të DST.*

**Qëndrim i grupit të auditimit:** *Konkluzioni i grupit të auditimit se argumentimi i kriterëve të vendosura nuk është dokumentuar në procesverbalin e mbajtur për këtë qëllim, ka dalë mbi faket reale, pasi në procesverbalin e mbajtur për këtë qëllim nga ana juaj nuk janë dokumentuar kriteret e veçanta të DST.*

*Nga kundërshtitë e njësisë së prokurimit konstatohet se janë dhenë shpjegime të gjata për të justifikuar vendosjen e kriterëve në DST të tenderit. Nga audituesi janë theksuar dy fenomene në hartimin e kriterëve: 1- në procesverbalin e mbajtur për hartimin e kriterëve të veçanta të DST, nuk janë dhënë argumente pse dhe si është gjykuar nga njësia e prokurimit për vendosjen e secilit kriter; 2- disa kriterë janë vendosur në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, nuk kanë lidhje me objektin e kontratës dhe, këto raste janë trajtuar hollësisht në aktin e konstatimit dhe projekt raport. Mos kryerja e argumentimeve të kriterëve është mos përmbushje e detyrimit ligjor që rrjedh nga neni 61, pika 2, e VKM 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” pika nr.1. nr.2, ku thuhet: “Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim ... duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.*

*Përsa i përket pretendimit se kriteri i vendosur nga njësia e prokurimit për auditues energjie është i nevojshëm për zbatimin e rregullave për ruajtjen e nxehtësisë në ndërtesa, ky argument nuk qëndron, sepse nuk është i argumentuar. Pra nuk ka nevojë për auditues, por*



*për inxhinier, aq më tepër që kuadri ligjor i sqaruar në akt konstatim dhe projekt raport, thekson se audituesi energjisë nuk mund të jetë pjesë e vetë operatorit ekonomik.*

*Pretendimi se kufizimi i kapacitetit të mjeteve që ju keni bërë, si për shembull kamiocina vetëshkarkues me kapacitet minimumi 3.5 ton dhe maksimumi 5 tonë, me argumentin për të ruajtur ndotjen akustike, ndotje mjedisi, kufizimin e qarkullimit të mjeteve të tonazhit të rëndë, etj., nuk qëndron sepse nuk jepni asnjë referencë ligjore në lidhje me rregullat e qarkullimit rrugor apo ndonjë fushe tjetër si mjedisi etj., për këto kufizime në nivelin e kapacitetit maksimal. Ka kuptim vendosja e një niveli minimal të kapacitetit, e cila edhe kjo duhet të ishte e argumentuar në lidhje me tre element: volumin e punimeve, kohëzgjatjen e tyre, numrin e mjeteve të kërkuara.*

*-Pretendimet tuaja se vjetërsia prej 15 dhe 20 vjetësh e drejtuesit teknik është e nevojshme, me justifikimin se AK me këtë kriter kërkon më shumë garanci për kapacitetet profesionale, nuk qëndron, pasi kjo nuk mbështetet me argumente ligjore nga ana juaj. Është licenca ajo që i jep të drejtën drejtuesit teknik të jetë në treg, jo numri i viteve pas marrjes së licensës. Nuk ka argument ligjor se në varësi të natyrës së objektit duhet të kërkohet eksperiencia e drejtuesit teknik. Përderisa drejtuesi teknik është licencuar, është testuar dhe marrja e licensës është dëshmi se plotëson kapacitetet e duhura profesionale për të kryer detyrën e drejtuesit teknik për çdo objekt.*

*- Kundërshtitë tuaja lidhur me faktin e konstatuar nga audituesi, se nuk ka qënë i nevojshëm vendosja e kriterit për një arkitekt dhe një inxhinier druri, në tenderin me objekt "Furnizim vendosje me makineri e pajisje mekanike e të tjera i ambienteve / godinave të Tirana Olimpik Park", merren në konsideratë. Prodhimi i mobiljeve nga një operatorë ekonomik, nga i cili do të kryhet furnizimi i AK, ka të nevojshme që ky proces të drejtohet dhe mbikëqyret nga arkitekti dhe inxhinieri i drurit.*

<p><b>16.Titulli i Gjetjes:</b></p>	<p>Në tenderin me objekt “Pastrimi i pjesës Perëndimore - 3 të Qytetit të Tiranës” zhvilluar në datën 29.03.2016, me vlerë të fondit limit 189,069,931lekë, është kualifikuar dhe shpallur fitues OE “A...”, i cili nuk plotëson kriteret e vendosura në dokumentet standarde të tenderit (DST).</p>
<p><b>Situata:</b></p>	<p>Në tender kanë marrë pjesë 10 operatorë ekonomik, nga të cilët janë kualifikuar 2 OE dhe shpallur fitues OE “A...”, me vlerë të ofertës ekonomike 184,834,584 lekë, ose 423,534.7 lekë më pak se vlera e fondit limit. Nga auditimi konstatohet se OE shpallur fitues, nuk i plotëson kriteret e vendosura në DST dhe duhej të skualifikohej nga KVO, duke vazhduar me operatorët e tjerë ekonomik në radhë. Nga auditimi është konstatuar se arsyet pse OE, nuk plotëson kriteret për kualifikim dhe shpalljen fitues janë si më poshtë:          OE A...” Degë e shoqërisë së huaj është kualifikuar dhe shpallur jo në përputhje të plotë me kërkesat e vendosura nga AK në DST përkatësisht:          -OE A...”Degë e shoqërisë së huaj për plotësimin e kërkesës 2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar pika 2 “Kopje të deklaratimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit ushtrimore (2013, 2014, 2015) lëshuar nga Autoriteti përkatës, vlera mesatare e së cilës duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit përkatësisht: 189,069,931 (njëqind e tetëdhjetë e nëntë milion e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e tridhjetë e një) lekë pa TVSH”          OE ka paraqitur vërtetimin nr.6010/1.prot, datë 11.03.2016 nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë për xhiron e tre viteve të fundit 2013, 2014, 2015 nga ku rezulton se xhiro mesatare për këtë periudhë është në vlerën 177 170 323 lekë ( viti 2013 – 80</p>

	<p>015 315 leke, viti 2014 -143 285 957 leke, viti 2015- 308 209 698 leke). Duke mos plotësuar kriterin e mësipërm.</p> <p>Për sa më sipër OE A...”Degë e shoqërisë së huaj duhej të skualifikohej dhe kontrata duhet ti akordohej OE “I...” shpk</p> <p>Akordimi i kontratës në mënyrë jo të drejtë OE A... të cilit i është akorduar dhe kontrata e pastrimit të pjeses perëndimore 3 për vitin 2015 është bërë duke shkelur të drejtat e OE I... shpk.</p>
<b>Kriteri:</b>	<p>Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me:</p> <p>- neni 46 - “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1, ku thuhet: <i>Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret ..., që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jo diskriminuese.</i></p> <p>- neni 53 - “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 dhe pika 5 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku thuhet:</p> <p>“3. Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, ...5. Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë: a) kur ofertuesi nuk është i kualifikuar; c) kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”;</p>
<b>Ndikimi/ Efekti:</b>	<p>Kualifikimi dhe shpallja fitues e operatorit ekonomik i cili nuk plotëson kriteret e vendosura në DST, nuk jep garanci për realizimin me sukses të kontratës, duke sjellë premisa të larta për përdorim të fondeve publike pa efektivitet.</p>
<b>Shkaku:</b>	<p>Mos zbatim i kërkesave ligjore nga KVO për kualifikimin dhe s’kualifikimin e operatorve ekonomik.</p>
<b>Rëndësia:</b>	<p>E mesme</p>
<b>Rekomandim:</b>	<p>Autoriteti kontraktor të analizojë situatën e mësipërme me qëllim eliminimin e rasteve të kualifikimeve dhe shpalljes fitues të operatorëve ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DST.</p>
<b>17.Titulli i Gjetjes:</b>	<p>Në tenderin me objekt “<i>Rikonstruksion i rruges Herman Gmeiner</i>” zhvilluar në datën 29.07.2016, me vlerë të fondit limit 32,420,453 lekë, është kualifikuar dhe shpallur fitues BOE “A...” &amp; “N...”, i cili nuk plotëson kriteret e vendosura në dokumentet standarde të tenderit (DST).</p>
<b>Situata:</b>	<p>Në tender kanë marrë pjesë 4 operatorë ekonomik, nga të cilët janë kualifikuar 3 OE dhe shpallur fitues BOE “A...” &amp; “N...”, me vlerë të ofertës ekonomike 27,017,044.2 lekë, ose 706,610 lekë më pak se vlera e fondit limit. Nga auditimi konstatohet se BOE shpallur fitues, nuk i plotëson kriteret e vendosura në DST dhe duhej të skualifikohej nga KVO, duke vazhduar me operatorët e tjerë ekonomik në radhë. Nga auditimi është konstatuar se arsyet pse BOE, nuk plotëson kriteret për kualifikim dhe shpalljen fitues janë si më poshtë:</p> <p>I. Kualifikimi i OE “A...” shpk &amp; “N...” shpk nuk është bërë në përputhje të plotë me kërkesat e vendosura në DST përkatësisht:</p> <p>A. Kriete të përgjithshme për kualifikim</p> <p>2.Një dokument që vërteton se (subjekti juaj):</p> <p>a) ka plotësuar detyrimet fiskale,</p> <p>b) ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore ,</p> <p>të lëshuar nga Administrata Tatimore.</p> <p>Për këtë kërkesë OE kryesuese A... shpk ka paraqitur Vërtetim nga Drejtoria E përgjithshme e Tatimeve nr.16540 date 22.06.2016 në të cilën përcaktohet se subjekti</p>

ka gjoba për TVSH dhe Tatim Fitim në vlerën 1,538,705 lekë dhe është në proces gjyqësor. Në bazë të këtij vërtetimi OE është subjekt i gjobës deri në momentin e shfuqizimit të tyre me vendim gjykate. Pra subjekti nuk plotëson kriterin e përgjithshëm pika 2.

B. Kriteria të veçanta të kualifikimit.

5.Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë drejtues teknik të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për:

- Inxhinier ndërtimi (1)
- Inxhinier mjedisi (1)
- Inxhinier topograf (1)
- Inxhinier elektrik (1)
- Inxhinier mekanik (1)
- Inxhinier hidroteknik (1)

OE Almo konstruksion ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar nga i cili rezulton se: inxhinieri hidroteknik R.L. dhe Inxhinieri mekanik E.B. nuk janë drejtues teknik siç kërkohet në pikën 5 dhe nuk figurojnë në liçensën e shoqërisë A.... Sqarojmë se në prevendivin e marëveshjes së bashkëpunimit A... (85%) ka marë përsipër realizimin e gjithë zërave të punimeve në sasi të plotë dhe pjesore dhe për këtë arsye kriteri i mësipërm duhet të plotësohet i plotë nga kjo shoqëri.

Për sa më sipër BO “A...” shpk & “N...” shpk duhej të skualifikohej për mosplotësim të kriterëve të vëna nga AK në DST.

II. Kualifikimi i BO “K... & N...” shpk është bërë në kundërshtim me kërkesat e vendosura nga AK në DT përkatësisht:

3.Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 9).

Fadroma me goma 2 copë Pronësi ose me qera

Janë paraqitur 2 makineri një fadrom me goma nga shoqëria “K...” e marë me qera nga shoqëria “M... shpk” dhe një fadromë me goma me kontrate qeraje dhe dokumenta të rregullta nga shoqëria “N... shpk”.

Fadroma e paraqitur nga shoqëria “K...” është me dokument justifikues fletë zhdoganimi në kundërshtim me kodin rrugor të republikës së shqipërisë i cili kërkon rregjistrimin dhe pasijen e kësaj makinerie me leje qarkullimi, certifikatë pronësie, kontroll teknik dhe siguracion:

-Neni 113

Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike,

2. Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike duhen regjistruar në zyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, që i lëshojnë lejen e qarkullimit atij që vërtëton se është pronari i mjetit.

4. Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike vetëlëvizëse dhe ato që tërhiqen, duhet të jenë të pajisura me një targë njohjeje, e cila përmban të dhënat e regjistrimit.

B. Në marëveshjen e bashkëpunimit të operatoreve është përcaktuar dhe preventivi pjesor i punimeve për shoqërinë “N...shpk”. Nga verifikimi rezulton se shoqëria “K...” do të realizojë punimet e betonit sipas zërave të preventivit. Kjo shoqëri nuk disponon asnjë makineri autobetoniere siç kërkohet në DST pika 2, këto makineri janë plotësuar nga shoqëria Noel në kundërshtim me VKM 914 ku thuhet:

Bashkimi i operatoreve ekonomik” pika 3 e cila përcakton:

3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP-së dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen

	nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Në konkluzion: Në përfundim të kësaj procedure kontrata i duhej akorduar OE “S... shpk” të cilës i është mohuar e drejta për tu shpallur fituese.
<b>Kriteri:</b>	Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me: - neni 46 - “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1, ku thuhet: <i>Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret ..., që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jo diskriminuese.</i> - neni 53 - “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 dhe pika 5 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku thuhet: “3. Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, ...5. Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë: a) kur ofertuesi nuk është i kualifikuar; c) kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”;
<b>Ndikimi/ Efekti:</b>	Kualifikimi dhe shpallja fitues e operatorit ekonomik i cili nuk plotëson kriteret e vendosura në DST, nuk jep garanci për realizimin me sukses të kontratës, duke sjellë premisa të larta për përdorim të fondeve publike pa efektivitet.
<b>Shkaku:</b>	Mos zbatim i kërkesave ligjore nga KVO për kualifikimin dhe s’kualifikimin e operatorve ekonomik.
<b>Rëndësia:</b>	E mesme
<b>Rekomandim:</b>	Autoriteti kontraktor të analizojë situatën e mësipërme me qëllim eliminimin e rasteve të kualifikimeve dhe shpalljes fitues të operatorëve ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DST.
<b>18.Titulli i Gjetjes:</b>	Në tenderin me objekt “Rikonstruksion i rrugëve të lagjeve Shirt-Pezëhelmës” zhvilluar në datën 07.11.2016, me vlerë të fondit limit 35,825,592 lekë, është kualifikuar dhe shpallur fitues BOE INA&COLOMBO”, i cili nuk plotëson kriteret e vendosura në dokumentet standarde të tenderit (DST).
<b>Situata:</b>	Në tender kanë marrë pjesë 7 operatorë ekonomik, nga të cilët është kualifikuar dhe shpallur fitues BOE I...&C...”, me vlerë të ofertës ekonomike 29,321,685 lekë, ose 6,503,907 lekë më pak se vlera e fondit limit. Nga auditimi konstatohet se BOE shpallur fitues, nuk i plotëson kriteret e vendosura në DST dhe duhej të skualifikohej nga KVO. Nga auditimi është konstatuar se arsyet pse BOE, nuk plotëson kriteret për kualifikim dhe shpalljen fitues janë si më poshtë: Skualifikimi i OE ““A...” shpk është bërë në kundërshtim me DST përkatësisht: 1. Paraqitje e çertifikatave të cilësisë në gjuhën shqipe. 2. Ka paraqitur në vend të makinerisë miniekskavator makinerinë ekskavator. Vlerësojmë së këto mangësi të konstatuara nga AK nuk përbëjnë mospërmbushje të kërkesave pasi paraqitja e çertifikatave nga OE në gjuhën angleze dhe jo në gjuhën shqipe vërteton se ky operator i gëzon këto çertifikata të kërkuara nga AK. Gjithashtu makineria miniekskavator dhe ekskavator janë makineri që kryejnë të njëjtat funksione dhe nuk çojnë në mosrealizim të kontratës nga operatori ekonomik. Vlerësojmë se ky operator duhet të ishte kualifikuar dhe shpallur fitues prokurimit. Kualifikimi i BO “I...” shpk & “C...” shpk është bërë në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit përkatësisht: Kriteri i veçantë për kualifikim pika 15 dëshmi për mjete dhe paisje ku është kërkuar

	<p>autobetoniere 2 copë.</p> <p>Për plotësimin e këtij kriteri BO ka paraqitur 2 autobetoniere me kontrate qeraje me palë qeradhënëse B... 2013 dhe palë qeramarrëse C... shpk të shoqëruar me dokumentacionin përkatës. Në marëveshjen e bashkëpunimit të nënshkruar ndërmjet shoqërisë Ina shpk mbajtëse e 51 % të punimeve të preventivit dhe C... shpk mbajtëse e 49 % të punimeve është përcaktuar se në preventivin e punimeve të mara përsipër nga Ina shpk seksioni B “Ndërtim mure betoni”. Kjo shoqëri duhet të kishte në pronësi ose me qera makinerinë autobetoniere për të përmbushur detyrimin e marë përsipër në marëveshjen e bashkëpunimit në plotësim të kërkesave për kualifikim. Kualifikimi i BO është bërë në kundërshtim me VKM 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 74 “Bashkimi i operatoreve ekonomik” pika 3 e cila përcakton:</p> <p>3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP-së dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përbindjet e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.</p> <p>Kualifikimi i padrejtë i BO I.. dhe C... shpk dhe skualifikimi i padrejtë i OE “Alb T...” shpk nuk ka siguruar efektivitetin e fondit të prokuruar në vlerën e diferencës së ofertave në shumën 4,607,496 lekë pa tvsh.</p>
<b>Kriteri:</b>	<p>Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- neni 46 - “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1, ku thuhet: <i>Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret ..., që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jo diskriminuese.</i></li> <li>- neni 53 - “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 dhe pika 5 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku thuhet: <i>“3. Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, ...5. Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë: a) kur ofertuesi nuk është i kualifikuar; c) kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”;</i> etj.</li> </ul>
<b>Ndikimi/ Efekti:</b>	Kualifikimi dhe shpallja fitues e operatorit ekonomik i cili nuk plotëson kriteret e vendosura në DST, nuk jep garanci për realizimin me sukses të kontratës, duke sjellë premisa të larta për përdorim të fondeve publike pa efektivitet.
<b>Shkaku:</b>	Mos zbatim i kërkesave ligjore nga KVO për kualifikimin dhe s’kualifikimin e operatorve ekonomik.
<b>Rëndësia:</b>	E mesme
<b>Rekomandim:</b>	Autoriteti kontraktor të analizojë situatën e mësipërme me qëllim eliminimin e rasteve të kualifikimeve dhe shpalljes fitues të operatorëve ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DST.
<b>19.Titulli i Gjetjes:</b>	Mos argumentim i kriterëve të vendosura nga njësia e prokurimit në dokumentet standarde të tenderi
<b>Situata:</b>	<p><u>1- Për tenderin me objekt ““Ndërtim parkim nëntokësor, Sheshi Skënderbej””, zhvilluar në datën 17.10.2016.</u></p> <p>Në kërkesat për kualifikim të hartuara nga NJP dhe miratuara nga kryetari i AK përkatësisht kriteret e veçanta për kualifikim</p> <p>4. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen</p>

	<p>në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 9).</p> <p>Fabrikë prodhimi betoni I copë Pronësi ose me qera</p> <p>Ky kriter është i pa nevojshme për realizimin e kontratës së punëve civile dhe të vendosura me qëllim mënjanimin e konkurrencës pasi këto fabrika nuk i disponojnë të gjitha shoqëritë në fushën e ndërtimit dhe nuk janë kritere licensimi për këto shoqëri. Këto kritere të panevojshme janë në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar, Kreu II Informacione të veçanta për kontratat, neni 26 kontrata për punë publike , pika 5, “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve”.</p> <p>Për sa më sipër mban përgjegjësi NJP sipas përcaktimeve në vkm VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar. neni 57 ku thuhet:</p> <p>2. Njësia e prokurimit është përgjegjëse për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme që u bashkëlidhen atyre, përfshirë hartimin e kritereve të veçanta për kualifikim dhe specififikimet teknike,nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme.</li> </ul> <p>Për sa më sipër, veprimet dhe mosveprimet për problematikat e trajtuara dhe qëndrimin strikt ndaj plotësimit të kritereve duke mos u udhëhequr nga qëllimi kryesor i prokurimit publik ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të përdorimit të fondeve publike, janë objekt i veprimtarisë së Njesisë së Prokurimit dhe KVO sipas rastit trajtuar në procedurat e mësipërme.</p> <p>Argumentimi i kritereve të vendosura nuk është dokumentuar në DST.</p> <p>Për veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e njesisë së prokurimit: znj. E.K., znj. A.N. dhe z. A.B.</p>
<b>Kriteri:</b>	<p>Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Nenin 26, pika 5 të VKM 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,</li> <li>- Nenin 46 të LPP,</li> </ul> <p><i>-Neni 57 të VKM 914, datë 29.12.2014 etj</i></p>
<b>Ndikimi/ Efekti:</b>	<p>Vendosja e kritereve të pa qarta dhe mos argumentimi i tyre, përveç se është mos zbatim i kërkesave ligjore lidhur me hartimin e DST, vë në vështirësi operatorët ekonomik në plotësimin e tyre, sjellë paqartësi dhe vështirësi për KVO gjatë vlerësimit të operatorëve ekonomik për plotësimin të kritereve të DST, sidomos në aplikimin e nenit për “devijime të vogla”.</p>
<b>Shkaku:</b>	<p>Mos zbatimi i kërkesave ligjore nga njësia e prokurimit në hartimin e kritereve të veçanta të DST.</p>
<b>Rëndësia:</b>	<p>E mesme</p>
<b>Rekomandim:</b>	<p>Në hartimin e kritereve të DST, njësia e prokurimit të jap argumente për secilin kriter dhe këto argumente të bëhen pjesë e procesverbalit që mbahet prej saj dhe pjesë e DST.</p>
<b>20.Titulli i Gjetjes:</b>	<p>Mangësi në përcaktimin e kritereve të kualifikimit nga Njësia e Prokurimit dhe vlerësimit të KVO.</p>

<b>Situata:</b>	<p><i>1- Në tenderin me objekt ““Rikonstruksioni shkollës së mesme të bashkuar “Ymer Lala”, Surrel ””</i> zhvilluar në datën 12.11.2016, me vlerë të fondit limit 45,832,598 lekë, është kualifikuar dhe shpallur fitues BOE “D...” &amp; “A...” shpk.</p> <p>Në përcaktimet e kriterëve teknike të kualifikimit nga Njësia e Prokurimit, u konstatuan mangësi, të cilat duhet të ishin përcaktuar me qartë nga ana e njësisë, konkretisht:</p> <p>Në pikën 2.3, pika që përcakton mjetet që duhet të disponojnë operatorët dhe dokumentet që duhet të disponojnë për këto mjete, rezulton se Njësia e Prokurimit, ndryshe nga praktika të ngjashme, nuk ka përcaktuar në DST kërkesën që OE të paraqesin dokumentin “Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit.....” kërkesë e cila është kërkuar nga Njësia e Prokurimit për punët e ngjashme siç është praktika me nr. Reference 95208 për rehabilitimin e pjesshëm të shkollës Dhora Distria; Praktika me nr. Reference 94503 për Rehabilitimin e e rrugës dhe qendrës së lgjes Sheheler, etj. Mos përcaktimi i kësaj pike në DST, ndryshe nga praktikat e ngjashme, rezulton favorizues për OE të kualifikuar dhe shpallur fitues, pasi nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkalidhur ofertës, rezulton se për një numër të caktuar mjetesh, mungon kjo certifikatë e nevojshme për mbarvajtjen e punës dhe seriozitetin e operatorëve.</p> <p>Shënim: rezulton se operatori ekonomik Ndrejoni shpk është skualifikuar në lidhje me shtojcën 10 për disponimin e makinerive, dhe konkretisht për ekzistencën e tyre në një procedurë tjetër prokurimi “Rikualifikim Urban i Bllokut që kufizohet nga rruga e Elbasanit-Stavri Vinjaku-Pjetër Budi dhe Ali Visha” të fituar nga ky operator në bashkinë e tiranës ku ka deklaruar të njëjtat mjete. Kontrata është e lidhur në Maj të 2018 pra 6 muaj përpara shpalljes së tenderit për rikonstruksionin e shkollës Ymer Lala, Surrel. Gjithashtu KVO ka skualifikuar OE N...shpk pasi njëri nga mjetet e deklaruara është 700 kg më pak sesa kapaciteti i kërkuar në DST ku janë kërkuar 4 kamioncina. OE kanë plotësuar kriteret për 3 të tilla dhe vetëm njëri ka 700 kg me pak kapacitet. Megjithatë duke parë diferencën ndërmjet ofertës se këtij operatori dhe ofertës se operatorit fitues e cila është 6,346,674 lekë me pak, ky OE nuk duhej skualifikuar.</p>
<b>Kriteri:</b>	<p>Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Nenin 26, pika 5 të VKM 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,</li> <li>- Nenin 46 të LPP,</li> </ul>
<b>Ndikimi/ Efekti:</b>	<p>Vendosja e kriterëve të paplota dhe mos argumentimi i tyre, përveç se është mos zbatim i kërkesave ligjore lidhur me hartimin e DST, sjellë paqartësi dhe vështirësi për KVO gjatë vlerësimit të operatorëve ekonomik për plotësimin të kriterëve të DST, sidomos në aplikimin e nenit për “devijime të vogla”.</p>
<b>Shkaku:</b>	<p>Mos zbatimi i kërkesave ligjore nga njësia e prokurimit në hartimin e kriterëve të veçanta të DST.</p>
<b>Rëndësia:</b>	<p>E mesme</p>
<b>Rekomandim:</b>	<p>Në hartimin e kriterëve të DST, njësia e prokurimit të jap argumente për secilin kriter dhe këto argumente të bëhen pjesë e procesverbalit që mbahet prej saj dhe pjesë e DST.</p>
<b>21.Titulli i Gjetjes:</b>	<p>Shpallja e OE fitues të kualifikuar jo në përputhje me kriteret e vendosura në DST duke sjellë si pasojë anulimin e prokurimit</p>
<b>Situata:</b>	<p><i>1. Në tenderin me objekt: 1. “Rikonstruksion i plotë i shkollës Speciale Luigi Gurakuqi”Rehabilitimi i pjesshëm dhe instalimi i sistemit të ngrohjes në shkollën 9 – vjeçare</i></p>

Dh. Leka dhe ndërtim i palestreës – Faza II”, zhvilluar në datën 24.12.2018, me vlerë të fondit limit 20,833,333 lekë, është kualifikuar dhe shpallur fitues OE “K...” shpk me ofertë 18,655,654 lekë.

1. Nga auditimi i ofertës së OE “K...” shpk me vlerë 18,655,654 lekë pa tvsh, rezultoi se KVO e ka kualifikuar dhe shpallur fitues ofertën e këtij operatori megjithëse rezultoi se nuk ka plotësuar të gjitha kriteret e përcaktuara nga DST, konkretisht si më poshtë:

a-Sipas kërkesave të pikës 2.3 të Kapacitetit Teknik të operatorëve, kërkohet që për punët e ngjashme, për kontratat e realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Deklaratën sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
2. Kontratë
3. Situacionin përfundimtar;
4. Çertifikaten e marrjes në dorëzim.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezultoi se OE ka paraqitur si Kontratë të suksesshme punësh të ngjashme, kontratën Nr. 24576/10 datë 20.10.2016 e lidhur me Bashkinë e Tiranës për Rikonstrukcionin e Shkollës Koreografike. Vlera e kontratës plotëson kushtet e përcaktuara nga NJP pasi është më shumë se 50% e vlerës, por në dokumentacionin mbështetës që kërkohet të paraqesi OE, mungon Certifikata e marrjes në dorëzim e objektit siç përcaktohet nga kërkesat e DST.

b-Sipas kërkesave të DST (shtojca 10), kërkohet që OE të paraqesi listën e mjeteve sipas tabelës vijuese:

Mjetet Sasia Gjendja

Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 3.5 (tre pikë pesë) ton dhe maksimumi deri 5 ton(pesë) 2 copë Pronësi ose me qera

Autovinç 1 copë Pronësi ose me qera

Gjenerator 1 copë Pronësi ose me qera

Eskavator me goma 0.25 m3 1 copë Pronësi ose me qera

Kamionçinë kapaciteti mbajtës për secilin kamionçinë nga 1.5 (një pikë pesë) ton deri në 2(dy) ton 2 copë Pronësi ose me qera

Autobetoniere 1 copë Pronësi ose me qera

Depozitë uji (5000) 1 copë Pronësi ose me qera

Skela metalike (forme H) të kompletuara me parapet mbrojtës, shkallë me rrijetë mbrojtëse për punime në fasadë) 1000 m2 Pronësi ose me qera

Matrapik 2 cope Pronësi ose me qera

Vibrator 1 copë Pronësi ose me qera

Asfaltoshtruese 1 cope Pronësi ose me qera

Autopompe betoni 1 copë Pronësi ose me qera

Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës deri minimum 7(shtatë) Ton dhe maksimumi 12(dymbëdhjetë) ton për secilin kamion 2 copë Pronësi ose me qera

Si dhe

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme) Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, duhet të shoqerohet me kontratën perkatese të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.

c) Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata perkatese noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.

d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.



e) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 9. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).

Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tirane. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qellim verifikimi).

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se OE fitues nuk ka plotësuar të gjitha pikat e kërkesave të DST pasi rezulton se për disa nga mjetet e mësipërme janë konstatuar mangësi dhe më konkretisht:

1. Autobetonierja me targë AA809MA nuk është e pajisur me Certifikatën për transport mallrash për të tretët dhe me qera brenda vendit siç përcakton pika a e kërkesës së mësipërme.

2. Autoboti me targa AA967HL nuk është e pajisur me Certifikatën për transport mallrash për të tretët dhe me qera brenda vendit siç përcakton pika a e kërkesës së mësipërme.

3. Autopomëbetoni me targë AA894KX nuk është e pajisur me Certifikatën për transport mallrash për të tretët dhe me qera brenda vendit siç përcakton pika a e kërkesës së mësipërme.

4. Kamionçina deri 2 ton me targa AA604BX nuk është e pajisur me Certifikatën për transport mallrash për të tretët dhe me qera brenda vendit siç përcakton pika a e kërkesës së mësipërme.

5. Kamioni me vinç me targa AA193OK nuk është e pajisur me Certifikatën për transport mallrash për të tretët dhe me qera brenda vendit siç përcakton pika a e kërkesës së mësipërme.

6. Asfaltbetoni i paraqitur nga OE, nuk ka bashkalidhur kontratën e qerave me subjektin "V..." shpik siç kërkohet nga pika c e kërkesës së mësipërme.

-Rezulton se KVO, për të njëjtat shkelje të konstatuara nga grupi i auditimit për subjektin K..., ka s'kualifikuar OE "E..." shpik me ofertë 15,482,024 lekë ose 3,173,630 lekë më të ulët se sa operatori fitues. Më konkretisht ky OE është skualifikuar për dëshminë e mjeteve e pajisjeve teknike që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion OE që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (shtojca 10).

1. Sipas vlerësimit të KVO, OE "E..." shpik nuk ka paraqitur certifikatën për transport mallrash për të tretët dhe me qera brenda vendit.... për kamionçinën me targa AA228JJ duke e konsideruar të paplotë dokumentacionin lidhur me këtë mjet.

2. 1. Sipas vlerësimit të KVO, OE "E..." shpik nuk ka paraqitur certifikatën për transport mallrash për të tretët dhe me qera brenda vendit.... për mjetin Autovinç me targa AA069FJ duke e konsideruar të paplotë dokumentacionin lidhur me këtë mjet.

3. Kamioni me targa AA790GY me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 2.6 Ton.

Kamionçina me targa AA562NS me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1.15 Ton. Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihen në dispozicion dy kamionçina me kapacitet mbajtës nga 1.5 deri 2 Ton dhe OE rezulton se këto dy mjete i ka paraqitur me diferenca që lëvizin nga 0.35 Ton më pak njëra dhe 0.6 Ton më tepër kamionçina tjetër, dhe sipas AK OE nuk ka përmbushur kapacitetin teknik të kërkuar.

Siç vihet re, KVO nuk ka ndjekur të njëjtin standard në vlerësimin e ofertave, pasi për të njëjtat kritere për të cilat është s'kualifikuar OE "E...", Operatori tjetër është kualifikuar.

KVO duke kualifikuar OE "K..." shpik dhe s'kualifikuar OE "E..." shpik duke mos siguruar efektivitetin e shpenzimeve në shumën 3,173,630 lekë, gjithashtu KVO mund të anulonte tenderin dhe praktika të prokurohej edhe një herë nga fillimi deri në plotësimin e kushteve të kërkuara nga Operatorët e interesuar.

2. Në tenderin me objekt: "Rehabilitim i rrugës dhe qendrës së lagjes Sheheler", zhvilluar në datën 19.12.2018, me vlerë të fondit limit 25,725,518 lekë, është kualifikuar e shpallur fitues OE "B..." shpik me ofertë 21,253,476 lekë ose 4,472,042 lekë më pak se FL ofertë e cila duhet të ishte skualifikuar për arsyet si më poshtë:

1. Në pikën 7 të kërkesave për Kapacitetin Teknik në DST kërkohet si më poshtë:

5. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve, si më poshtë:

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 1 (një) punonjës elektrikist</li> <li>• 1 (një) punonjës teknik ndërtimi</li> <li>• 6 (gjashtë) punonjës hekurkthyes</li> </ul> <p>-Nga shqyrtimi i dokumentacionit të OE fitues, rezulton se njëra nga pikat e kësaj kërkesë, konkretisht ajo që kërkon 6 (gjashtë) punonjës hekurthyer, nuk është plotësuar nga ana e këtij operatori pasi janë paraqitur dokumente vetëm për dy punonjës të tillë. Për të njëjtën mangësi, atë të mos plotësimin të numrit të punonjësve me profesion hekurthyes, janë s'kualifikuar edhe operatorët e tjerë në këtë procedurë prokurimi, si "E..." shpk, "I..." shpk etj. Në këto kushte, KVO duhej të s'kualifikonte edhe ofertën e këtij operatori për mos plotësimin e kërkesave të kërkuara në DST.</p> <p>2.Në pikën 16 të kërkesave në DST kërkohet nga operatorët fitues të paraqesin mjetin tip Autobitumatriçe. OE fitues ka paraqitur mjetin me targa AA782FA, i cili rezulton të jetë mjet i montuar kamion + bitumatriçe. KVO, për të njëjtin kriter të ngjashëm, ka s'kualifikuar operatorin ekonomik "E..." shpk për mjetin Autobot, pasi ky mjet ishte montim kamion + bot uji. Duke përdorur kriteret të njëjta vlerësimi, KVO duhej të s'kualifikonte edhe OE "B..." shpk për mos plotësim të kriterëve teknike të përcaktuara në DST.</p> <p>-Ky kriter për mos kualifikimin e mjetit Autobitumatriçe me Targa AA782FA, është ndjekur edhe ne procedura të mëvonshme nga KVO, konkretisht procedurën me numër reference 92943 Për Rikonstruksionin e rrugëve "Kel Kodheli" dhe "Skdënder Shtylla", ku KVO e ka s'kualifikuar këtë operator pikërisht mjetin Autobitumatriçe me Targa AA782FA.</p> <p>Nga sa u pasqyrua më sipër, KVO duhej të anulonte tenderin për "Rehabilitim e rrugës dhe qendrës së lagjes Sheheler", dhe procedura të fillonte sërish nga fillimi. Kualifikimi dhe shpallja fitues e OE "B..." shpk ka sjell shpenzime duke mos siguruar efektivitetin e duhur.</p> <p><u>3. Në tenderin me objekt: "Sistemim asfaltim i rrugës "Haxhi Brari", zhvilluar në datën 16.08.2018, me vlerë të fondit limit 11,666,659 lekë, është kualifikuar e shpallur fitues OE "K..." shpk me ofertë 10,374,735 lekë ose 1,291,924 lekë më pak se FL ofertë e cila duhet të ishte skualifikuar për arsyet si më poshtë:</u></p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit që OE "K..." shpk ka paraqitur, rezulton se nuk ka përmbushur të gjitha pikat e kërkuara në pikës 15, shtojca 10 e kriterëve mbi Kapacitetin Teknik që duhet të përmbushin OE ofertues.</p> <p>1.OE "K..." shpk, rezulton se nuk ka përmbushur kriteret sipas kërkesave të DST për mjetin Autobitumatriçe me Targa AA257MM i marrë me qira nga operatori. Ky rezulton të jetë mjet i montuar Kamion + Bitumatriçe. Gjithashtu këtij mjeti i mungon edhe certifikata për transport lëndësh të rrëzikshme, e nevojshme për kategorinë e këtyre mjeteve. KVO e këtij Autoriteti Kontraktor, në mënyrë përsëritëse, ka s'kualifikuar operatorët e tjerë në mënyrë të vazhdueshme në procedura të tjera prokurimi, përfshirë edhe këtë procedurë, si p.sh operatori "S..." shpk etj. KVO, duhej të s'kualifikonte këtë operator për mos përmbushje të Kriterëve mbi Kapacitetin Teknik të përcaktuara në DST.</p> <p>Në këto kushte, duke qënë se asnjëri nga Operatorët Ekonomik, nuk përmbushte kriteret e përcaktuara në DST, duke përfshirë edhe OE "K..." shpk, <b><u>KVO duhej të anulonte këtë praktikë prokurimi</u></b>, dhe ta shpallte atë nga fillimi.</p>
<b>Kriteri:</b>	<p>Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me:</p> <p>- neni 46 - "Kualifikimi i ofertuesve", pika 1, ku thuhet: <i>Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret ..., që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jo diskriminuese.</i></p> <p>- neni 53 - "Shqyrtimi i ofertave", pika 3 dhe pika 5 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ku thuhet:</p> <p><i>"3. Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të</i></p>

	<i>vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, ...5. Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë: a) kur ofertuesi nuk është i kualifikuar; c) kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”;</i>
<b>Ndikimi/ Efekti:</b>	Kualifikimi dhe shpallja fitues e operatorit ekonomik i cili plotëson kriteret e vendosura në DST, jep garanci për realizimin me sukses të kontratës, duke sjellë premisa të larta për përdorim të fondeve publike me efektivitet.
<b>Shkaku:</b>	Mos zbatim i kërkesave ligjore nga KVO për kualifikimin dhe s’kualifikimin e operatorve ekonomik.
<b>Rëndësia:</b>	E mesme
<b>Rekomandim:</b>	Autoriteti kontraktor të analizojë situatën e mësipërme me qëllim eliminimin e rasteve të kualifikimeve dhe shpalljes fitues të operatorëve ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DST.
<b>22. Titulli i Gjetjes:</b>	Kualifikimi i OE nga KVO, veprime të cilat kanë sjellë mos sigurimin me efektivitet të përdorimit të fondeve publike
<b>Situata:</b>	<p><u>1. Në tenderin me objekt: “Ndërtimi i rrugëve “Migjeni dhe Kadri Roshi, Në Njësinë Administrative Kashar, Faza II”,</u> Në tender kanë marrë pjesë 8 operatorë ekonomik, nga të cilët është kualifikuar dhe shpallur fitues OE “B...”, me vlerë të ofertës ekonomike 32,594,589 lekë, ose 7,245,040 lekë më pak se vlera e fondit limit. Nga auditimi konstatohet se OE shpallur fitues, nuk i plotëson kriteret e vendosura në DST dhe duhej të skualifikohej nga KVO. Nga auditimi është konstatuar se arsyet pse OE, nuk plotëson kriteret për kualifikim dhe shpalljen fitues janë si më poshtë:</p> <p>-Në lidhje me pikën 16 të kriterëve mbi Kapacitetin Teknik të operatorëve ofertues, është kërkuar në DST disponueshmëria e Autobitumatriçes. OE i kualifikuar dhe shpallur fitues, ka paraqitur mjetin me Targa AA782FA, në pronësi të tij, i cili është mjet i modifikuar Kamion + Bitumatriçe. Këtij mjeti i mungon certifikata e nevojshme për mjetet që kryejnë transport materialesh të rrezikshme brenda vendit, e nevojshme për sigurinë. Vlen të theksohet, se 2 prej anëtareve të kësaj KVO-je, vetëm pak muaj më mbrapa në procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksioni i rrugëve “Kel Kodheli” dhe “Skënder Shtylla”, për të njëjtin mjet transporti Autobitumatriçe, e ka s’kualifikuar OE “B...” shpk pikërisht me argumentin se ky mjet nuk mund të kualifikohet për shkak të këtyre cilësive. Dhe në këto kushte, KVO duhej të s’kualifikonte këtë operator për shkeljen e konstatuar.</p> <p>2.Nga auditimi i ofertës së OE “A...” shpk, me vlerë 27,111,821, rezulton se KVO e ka s’kualifikuar këtë ofertë për arsyen e mëposhtme:</p> <p>•Shoqëria “A...” shpk për të vërtetuar përvojën e suksesshme ka paraqitur kontratat me objekt: “Rikonstruksion i plotë + sistemim i ngrohjes për dy godinat e shkollës 9-vjeçare “Pjetër Arbtori”, Fushë Arrëz” dhe “Kapanon 2-3 kat për prodhim tenda dielli”. Këto kontrata nuk janë punime të ngjashme për faktin se këto kontrata hyjnë në kategorinë e punëve të infrastrukturës së objekteve dhe jo të infrastrukturës rrugore referuar situacioneve përfundimtare të punimeve ku zërat e punimeve të përcaktuar në bazë të preventivit nuk janë të ngjashme me zërat e preventivit të objektit që prokurohet. Më tej shoqëria “A...” shpk ka paraqitur edhe disa kontrata të tjera të ngjashme me objektin e prokurimit si më poshtë vijon:</p> <p>1-Kontratë nënsipërmarrje me objekt: “Asfaltim rruga Pistull – Pacran – Rrugë nacionale” me vlerë të kontratës 18,124,268 lekë pa TVSH;</p> <p>2-Kontratë nënsipërmarrje me objekt: “Sistemim i lagjes mbrapa Pallatit të Kulturës” me vlerë të kontratës 2,062,832 lekë pa TVSH;</p> <p>3-Kontratë nënsipërmarrje me objekt: “Rikonstruksion i rrugës “25- Nëntori”, Elbasan” me vlerë të kontratës 19,482,749 lekë pa TVSH;</p> <p>4-Kontratë nënsipërmarrje me objekt: “Riveshje asfalti në rrugën “Elbasan, Tregan” me vlerë të kontratës 7,047,160 lekë pa TVSH.</p> <p>•Sa më sipër konkludohet se Operatori ekonomik “A...” shpk në lidhje me kontratat e mësipërme të paraqitura për të vërtetuar përvojën e suksesshme nuk plotëson Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 1/a për një objekt të vetëm në vlerën</p>

19,919,814.74 lekë pa TVSH si edhe pikën 1/b ku shumatorja e të gjitha kontratave të ngjashme duhet të jetë në vlerën 79,679,258.96 lekë pa TVSH.

•Në këtë mënyrë, shoqëria “A...” shpk nuk plotëson Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 1 çka bie në kundërshtim me Ligjin Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) Neni 46, pika 1 gërma “b” si dhe me VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 6.

Siç konstatohet nga shqyrtimi i dokumentacionit, OE “A...” shpk ka paraqitur kontratën e ngjashme të nënsipërmarrjes me objekt “Rikonstruksion i rrugës “25 Nëntori, Elbasan” me vlerë të kontratës 19,482,749 lekë pa TVSH. Vlera e kësaj kontrate është 437,065 lekë pa TVSH më e vogël se sa vlera e kërkuar për një kontratë të vetme të ngjashme sa gjysma e vlerës së fondit limit, ku vlera e kërkuar duhej të jetë 19,919,814 lekë pa TVSH.

Diferenca prej 437,065 lekë duhej konsideruar si shmangie e vogël nga e KVO, pasi oferta OE plotësonte të gjitha kriteret tjera të kërkuara nga NJP dhe gjithashtu kishte eksperiencë të ndryshme të ngjashme. Oferta e këtij OE është dukshëm më e favorshme se ofertat tjera në këtë praktikë prokurimi, duke përfshirë edhe atë të shpallur fituese.

Si rezultat i s’kualifikimit të ofertës së OE “A...” shpk me vlerë 27,111,821 lekë pa TVSH, dhe kualifikimin dhe shpalljen fituese të ofertës së OE “B...” shpk me vlerë 32,594,589, nuk është siguruar efektiviteti i fondeve të prokuruar në vlerën 5,482,768 lekë pa TVSH.

2. Në tenderin me objekt: “Ndërtimi i rrugëve “Rikonstruksioni i rrugës “Fatmir Haxhiu”.

Në tender kanë marrë pjesë 9 operatorë ekonomik, nga të cilët është kualifikuar dhe shpallur fitues OE “B...”, me vlerë të ofertës ekonomike 25,563,746 lekë, ose 3,592,708 lekë më pak se vlera e fondit limit. Nga auditimi konstatohet se OE shpallur fitues, nuk i plotëson kriteret e vendosura në DST dhe duhej të skualifikohej nga KVO. Nga auditimi është konstatuar se arsyet pse OE, nuk plotëson kriteret për kualifikim dhe shpalljen fitues janë si më poshtë:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit që OE “B...” shpk ka paraqitur, rezulton se nuk ka përmbushur të gjitha pikat e kërkuara në pikës 15, shtojca 10 e kriterëve mbi Kapacitetin Teknik që duhet të përmbushin OE ofertues.

Mjetet sipas (shtojcës 10).

1.OE “B...” shpk, rezulton se nuk ka përmbushur kriteret sipas kërkesavë të DST për mjetin Kamionçinë me kapacitet mbajtës 3.5 – 5 Ton (2 copë), pasi mjeti me Targa AA517RZ del sipas lejes së qarkullimit me kapacitet 6 Ton, pra 1 Ton më tepër se sa kapaciteti i kërkuar në DST. Gjithashtu, fotot treguese të këtij mjeti, janë bërë në pozicion anësor, çka nuk pasqyron targën e mjetit.

IV. Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

-Në këto kushte, KVO nuk duhej të kualifikonte dhe shpallur fitues këtë operator pasi nuk përmbushte kriterin e kërkuar në DST për kamionçinën me kapacitet nga 3.5 – 5 Ton.

2. OE “B...” shpk, ka paraqitur sipas kërkesave të DST 1 Fadromë Fiat Hitachi E 170. Për këtë mjet operatori ka paraqitur deklaratën doganore për zhdoganimin e saj, dhe disa dokumente teknike bashkalidhur, por mungon siguracioni i këtij mjeti si dhe dokumentet e paraqitura janë të panoterizuara.

c) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit;b)leje qarkullimi; c)çertifikatën e kontrollit teknik; d)siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e)çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Për mjetet e marra me qera duhet të paraqitet: a)dokumentit qe verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c)çertifikatën e kontrollit teknik, d)siguracionin e mjetit,(i vlefshëm); e) çertifikatën e për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Mjetet të shoqerohen me kontratën perkatese te qerese/furnizimit, e vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te kontrates, objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e ç’doganimit ose faturat tatimore te blerjes.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

3.OE “B...” shpk, ka paraqitur sipas kërkesave të DST mjetin Autobot Uji me Targa

AA568SM. Dokumentet e paraqitura për këtë mjet, rezultojnë se kemi të bëjmë më një mjet të modifikuar Kamion + Bot Uji. KVO, për mjete të ngjashme të modifikuara në këtë procedurë, siç është Autobitumatriçja, ka vlerësuar se është në shkelje të kërkesave të DST duke s'kualifikuar operatorët e tjerë si "V..." shpk, "A..." shpk. Duke përdorur këtë kriter, KVO duhej të s'kualifikonte edhe OE B... pasi mjeti i paraqitur Autobot Uji, duket qartë edhe nëpërmjet fotografive të paraqitura se është një mjet i modifikuar.

2.Nga shqyrtimi i BOE "L..." shpk & "C..." shpk, me ofertë ekonomike me vlerë 23,559,853 lekë pa TVSH, rezulton se KVO e ka s'kualifikuar për arsyet e mëposhtme:

•Bashkimi i Operatoreve ekonomik "L..." shpk dhe "C..." shpk nuk plotëson Piken 6 të Kriteve të Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, ku përcaktohet që ofertuesit duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diplomë, CV, librezë pune dhe të figurojnë në listëpagesa, 1 (një) mjek të përgjithshëm. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se ky bashkim operatorësh, ka paraqitur dokumentacion vetëm për Mjekun e shoqërisë "L..." shpk, T.M. dhe dokumentacionin bashkëlidhur i cili është konform kërkesave të Njësisë. Është e vërtetë që Operatori tjetër nuk ka paraqitur dokumente për mjekun siç përcaktohet në DST, por KVO, duke analizuar ofertën më të favorshme të këtij bashkimi operatorësh, dhe duke qënë se edhe operatori fitues kishte të paktën 3 mangësi të konstatuara nga shqyrtimi i dokumentacionit mbi kapacitetin teknik, duhej të vlerësonte ofertën e këtij bashkimi operatorësh e cila është 2,003,893 lekë më e ulët se sa vlera e kontratës fituese duke mos siguruar efektivitetin e fondeve të prokuruar në këtë vlerë.

3. Në tenderin me objekt: "Ndërtimi i rrugëve "Kel Kodheli" dhe "Skënder Shylla, Në tender kanë marrë pjesë 14 operatorë ekonomik, nga të cilët është kualifikuar dhe shpallur fitues BOE "L..." & "M...", me vlerë të ofertës ekonomike 35,062,302 lekë, ose 6,237,698 lekë më pak se vlera e fondit limit. Nga auditimi konstatohet se BOE shpallur fitues, nuk i plotëson kriteret e vendosura në DST dhe duhej të skualifikohej nga KVO. Nga auditimi është konstatuar se arsyet pse BOE, nuk plotëson kriteret për kualifikim dhe shpalljen fitues janë si më poshtë:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorëve të kualifikuar nuk konstatohen mangësi sipas kërkesave të DST. KVO ka bërë vlerësimet e duhura në raport me ofertat e mësipërme dhe ka shpallur fituese ofertën më të favorshme e cila është oferta me e ulët e BOE "L..." shpk & "M..." shpk.

**2.Nga auditimi i ofertës së OE "B..." shpk, me vlerë 32,123,884 pa tvsh, rezulton se KVO e ka s'kualifikuar për arsyet e mëposhtme:**

1.Operatori ekonomik "B..." shpk nuk plotëson kushtin: "*Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim*" pasi për mjekun, diploma është paraqitur fotokopje e pashoqëruar me vërtetimin e njëhimit të fotokopjes me kopjen origjinale.

2.Operatori ekonomik "B..." shpk nuk plotëson pikën 16 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: "*Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10)/ Kamionçinë me kapacitet mbajtës 3.5 -5 ton*", pasi kamioncina me targë TR 3094 U ka kapacitet mbajtës 0,99 Ton, kamioncina me targë AA 057 N ka kapacitet mbajtës 0,99 Ton, kamioncina me targë AA 108 HK ka kapacitet mbajtës 3,475 Ton, kamioncina me targë AA 761 DH ka kapacitet mbajtës 3,760 Ton dhe kamioncina me targë VL 8838 C ka kapacitet mbajtës 1,2 Ton.

3.Operatori ekonomik "BE-IS" shpk nuk plotëson pikën 16 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: "*Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10)/ Autobitumatriçe*", pasi mjeti me targë AA 782 FA i

deklaruar në Shtojcën 10, si autobitumatrice, nga verifikimi i dokumentacionit rezulton mjet i montuar, kamion + bitumatrice.

Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për aftësinë teknike të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik “B...” shpk, referuar Shtojcës 10 nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit për ofertën e OE “B...”, me ofertë 32,123,884 lekë pa tvsh, rezulton se KVO nuk ka bërë një vlerësim objektiv të ofertës së këtij operatori dhe dokumentacionit bashkalidhur.

1.Në lidhje me pikën 1 të arsyeve të s’kualifikimit, për paraqitjen e diplomës së mjekut fotokopje të panoterizuar, nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se diploma e paraqitur nga OE është dukshëm me vulë të njomë, dhe krahas diplomës bashkalidhur është edhe Liçenca e lëshuar nga Urdhri i Mjekëve të Shqipërisë për ushtrimin individual të profesionit për mjekë, origjinale, si dhe mjeku pasqyrohet edhe në listpagesat e shoqërisë. Shkaku i mësipërm nuk duhej të përbente kusht për s’kualifikimin e këtij operatori.

2. Në lidhje me pikën 2 të arsyeve të s’kualifikimit, sipas të cilës OE nuk plotëson pikën 16 të Kapacitetit Teknik të DST, nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se KVO nuk ka bërë vlerësimin e duhur të kësaj pike. Në DST kërkohej konkretisht:

Siç konstatohet edhe në tabelën bashkalidhur, janë kërkuar 2 kamionçina me kapacitet nga 3.5 Ton deri në 5 Ton. OE ka paraqitur disa të tilla. Kamionçina me Targa AA108HK në pronësi të operatori ofertues ka kapacitet mbajtës prej 3.475 Ton, pra 25 kg poshtë kapacitetit të kërkuar, si dhe mjete me Targa AA761DH ka kapacitet mbajtës prej 3.8 Ton. Siç konstatohet, të dy mjetet kamionçina plotësojnë kushtet teknike, dhe diferenca prej 25 kg e njërit mjet nuk përbën shkak për skualifikimin e tij, vlerësim i cili është ndjekur edhe në praktika të tjera prokurimesh ku për diferenca edhe më të mëdha se sa kjo, mjetet janë kualifikuar.

3.Në lidhje me pikën 3 të arsyeve të s’kualifikimit për mos plotësimin e e pikës 16 të Kapacitetit Teknik të DST për mjetin Autobitumatrice, KVO e ka vlerësuar mjetin të pa kualifikueshëm pasi rezulton se mjeti me Targa AA782FA është mjet i montuar kamion + bitumatrice.

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se ky mjet është i montuar kamion + bitumatrice, por ky mjet ka ***Certifikatë Miratimi për mjetet (vetëm brenda vendit) që transportojnë disa mallra të rrezikshme***, si dhe pasaportën e verifikimit të Autobotit të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë e cila ka certifikuar bitumatricën bashkë me mjetin me Targa AA782FA. Gjithashtu, rezulton se të paktën 2 prej anëtarëve të kësaj KVO-je, në praktikën e prokurimit me nr reference 81993 për “Ndërtimin e rrugëve “Migjeni dhe Kadri Roshi” në Njësinë Administrative Kashar, Fazsa II”, kanë kualifikuar dhe shpallur fitues OE “B...” shpk duke pasur pjesë të makinerive të deklaruara të njëjtin mjet Autobitumatrice me Targa AA782FA, të cilës në atë praktik i mungonte madje edhe certifikata për transportin e mallrave të rrezikshme. Siç konstatohet kemi 2 vlerësime të ndryshme nga e njëjta KVO për të njëjtin mjet. Sa rezulton nga këto dokumente që ka paraqitur OE, ky mjet plotëson kushtet teknike për kryerjen e punëve të kërkuara, dhe në këto kushte ky mjet duhej të kualifikohej nga ana e KVO në praktikën e këtij prokurimi.

KVO, duke s’kualifikuar OE “B...” shpk, me ofertë ekonomike 32,123,884 pa TVSH, nuk ka mundur të siguroj efektivitetin e fondeve të prokuruar prej **2,938,418 lekë** si diferencë mes ofertës së këtij operatori dhe ofertës së BOE të kualifikuar dhe shpallur fitues.

**4. Në tenderin me objekt: “Rikonstruksioni shkollës Sabaudin Gabrani 1”**, Në tender kanë marrë pjesë 10 operatorë ekonomik, nga të cilët është kualifikuar dhe shpallur fitues BOE “K...” & “E...” shpk, me vlerë të ofertës ekonomike 45,453,275 lekë, ose 5,166,085 lekë më

pak se vlera e fondit limit. Nga auditimi konstatohet se BOE shpallur fitues, nuk i plotëson kriteret e vendosura në DST dhe duhej të skualifikohej nga KVO. Nga auditimi është konstatuar se arsyet pse BOE, nuk plotëson kriteret për kualifikim dhe shpalljen fitues janë si më poshtë:

Sipas kërkesave të DST (shtojca 10), kërkohet që OE të paraqesi listën e mjeteve sipas tabelës vijuese:

- Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10).

Te paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 60 copë
- Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 5 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 5 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 copë
- Kulle ndricimi – 1 cope
- Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 5 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 15 copë

*f) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (te vlefshme) Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, duhet të shoqërohet me kontratën perkatese të qerave/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.*

*g) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.*

*h) Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.*

*i) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*

*j) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 9. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*

*Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk jane te deklaruara ne procedurat te shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tirane. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku te deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi).*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se BOE të kualifikuar dhe shpallur fitues nuk kanë paraqitur listën e mjeteve bashkalidhur me dokumentacionin e kërkuar pasi rezulton me mangësi.

Konkretisht:

1. Autobetonierja me Targa AA809MA e marr me kontratë qeraje nga nga subjekti “L...” shpk, rezulton pa certifikatën për transport mallrash për të tretë sipas kërkesave të vendosura në DST. Gjithashtu, Siguracioni i këtij mjeti rezulton se ka skaduar 1 javë përpara përfundimit të dorëzimit të dokumenteve. Si rrjedhojë e këtyre mangësive KVO nuk duhet ta kualifikonte operatorin dhe shpallur fitues.

2. Autopompa e betonit me targa AA894KX, e marrë me kontratë qeraje nga subjekti “L...” shpk, i mungon certifikata për transport mallrash për të tretë sipas kërkesave të DST, dhe si rrjedhojë KVO nuk duhet ta kualifikonte operatorin dhe shpallur fitues.

3. Kamioni Autovinç me kapacitet nga 7.5 – 12 Ton me Targa AA193OK, i marrë me kontratë qeraje nga shoqëria “M...” shpk, i mungon certifikata për transport mallrash për të tretë sipas kërkesave të DST, dhe si rrjedhojë KVO nuk duhet ta kualifikonte operatorin dhe shpallur fitues.

4. Kamionçina me kapacitet nga 1.5 – 2 Ton me Targa AA604BX, e marrë me kontratë qeraje

nga shoqëria “M...”shpk, i mungon certifikata për transport mallrash për të tretë sipas kërkesave të DST, dhe si rrjedhojë KVO nuk duhet ta kualifikonte operatorin dhe shpallur fitues.

5. Kamioni me kapacitet 3.5 deri 5 ton me targa AA418LN, marrë me kontratë qeraje nga shoqëria “G...” shpk, ka certifikatën për transport mallrash për të tretë jashtë afateve të vlefshmërisë së saj. Kjo certifikatë ka skaduar më 02.09.2017 pra 15 muaj përpara hapjes së tenderit. Si rrjedhojë KVO nuk duhet ta kualifikonte operatorin dhe shpallur fitues.

6. Për mjete të kërkuara nga NJP si Rrul me Vibrim, Grajder, Alfaltoshtruese, në sistem ato janë të ngarkuara brenda paramentrave të kërkuar, por subjekti posedues i tyre, nuk ka kontratë qeraje me operatorët fitues për këto mjete sipas kërkesës së pikës c të kriterëve të mësipërme i cili kërkon që: *Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.* Si rrjedhojë KVO nuk duhet ta kualifikonte operatorin dhe shpallur fitues.

**2. Nga auditimi i ofertës së BOE “I...” shpk & “K...” shpk me vlerë 38,049,235 lekë pa tvsh, rezultoi se KVO e ka s’kualifikuar ofertën e këtyre operatorëve për të njëjtat shkelje të konstatuara edhe tek operatori fitues.**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi se:

KVO ka s’kualifikuar BOE “I...” shpk & “K...” shpk me argumentin se:

- d) Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion pesë kamionçina, **kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 1.5 ton dhe maximum 2 ton secila kamionçinë** për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomik ka paraqitur katër kamionçina me kapacitetin mbajtës të kërkuar nga AK nga pesë të kërkuara.
- e) Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion tre kamiona vetshkarkues **kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 7 ton dhe maximum 12 ton secili kamion** për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomik ka paraqitur në përmbushje të këtij kriteri dy kamiona me kapacitetin e duhur nga tre të kërkuar në shtojcën 10/Kriteret e Veçanta të Kualifikimit.
- f) Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion katër kamiona vetshkarkues **kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 3.5 ton dhe maximum 5 ton secili kamion** për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomik ka paraqitur në përmbushje të këtij kriteri tre kamiona me kapacitetin e duhur nga katër të kërkuar në shtojcën 10/Kriteret e Veçanta të Kualifikimit.

Për pikën a, rezultoi se operatorët ekonomik kanë paraqitur pesë kamionçina me kapacitet nga 1.5 ton deri në 2 ton sipas kërkesës së DST, konkretisht mjetet me Targa AA614IU, AA018BK, AA460PP, AA461PP, AA462PP. Këto mjete plotësojnë kushtet dhe kapacitetet e kërkuara nga DST.

Për pikën b, rezultoi se operatorët ekonomik kanë paraqitur 3 kamiona vetshkarkues me kapacitet nga 7 ton deri në 12 ton maksimumi sipas kërkesës së DST, dhe konkretisht mjetet me Targa AA378VA, AA186AG dhe AA942AG. Këto mjete plotësojnë kushtet dhe kapacitetet e kërkuara nga DST.

Për pikën c, rezultoi se operatorët ekonomik kanë paraqitur 4 kamionë vetshkarkues me kapacitet nga 3.5 ton deri në 5 ton maksimumi sipas kërkesës së DST, dhe konkretisht mjetet me Targa AA906GX, AA884GR, AA967JC dhe DR4052E. Këto mjete plotësojnë kushtet dhe kapacitetet e kërkuara nga DST.

Mangësitë e konstatuara për 3 nga këto mjete, për 1 kamionçinë me kapacitet nga 1.5-2 Ton, kamionin vetshkarkues me kapacitet nga 3.5-5 Ton dhe kamionin vetshkarkues me kapacitet nga 7-12 Ton, janë mangësi që lidhen me mungesën e certifikatës për transport mallrash për të tretë, mangësi e cila duhet të ishte konstatuar edhe tek vlerësimi i ofertës së operatorëve ekonomik “K...” shpk dhe “E...” shpk. Duke qënë para kushteve të tilla, KVO duhej të anulonte tenderin deri në plotësimin e kushteve nga operatorët. Në kushtet e vlerësimit të dhënë, rezultoi se **KVO për mangësi me natyrë të njëjtë dhe me pak të përhapura, duke s’kualifikuar ofertën e BOE “I...” shpk dhe “K...” shpk nuk ka siguruar efektivitet të fondeve të prokuruar prej 7,404,040 lekë pa TVSH, si rezultat i diferencës mes ofertës së**



	<b>Operatorëve fitues dhe ofertës së më të favorshme.</b>
<b>Kriteri:</b>	Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me: - neni 46 - “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1, ku thuhet: <i>Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret ..., që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jo diskriminuese.</i> - neni 53 - “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 dhe pika 5 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku thuhet: “3. Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, ...5. Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë: a) kur ofertuesi nuk është i kualifikuar; c) kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”; etj.
<b>Ndikimi/ Efekti:</b>	Kualifikimi dhe shpallja fitues e operatorit ekonomik i cili nuk plotëson kriteret e vendosura në DST, nuk jep garanci për realizimin me sukses të kontratës, duke sjellë premisa të larta për përdorim të fondeve publike pa efektivitet.
<b>Shkaku:</b>	Mos zbatim i kërkesave ligjore nga KVO për kualifikimin dhe s’kualifikimin e operatorve ekonomik.
<b>Rëndësia:</b>	E mesme
<b>Rekomandim:</b>	Autoriteti kontraktor të analizojë situatën e mësipërme me qëllim eliminimin e rasteve të kualifikimeve dhe shpalljes fitues të operatorëve ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DST.

*(Gjerësisht problemet mbi shkeljet e procedurave të prokurimit të vitit 2016, janë trajtuar në akt-konstatimin nr. 4, datë 15.04.2019, dorëzuar me protokoll në Bashkinë Tiranë nr. 16289 prot, datë 15.04.2019; për vitin 2017 janë trajtuar në akt-konstatimin nr. 7, datë 16.04.2019, dorëzuar me protokoll në Bashkinë Tiranë nr. 16399 prot, datë 16.04.2019; për vitin 2018, janë trajtuar në akt-konstatimin nr. 5, datë 15.04.2019, dorëzuar me protokoll në Bashkinë Tiranë nr. 16290 prot, datë 15.04.2019 )*

#### **B/1.4. Hartimi, zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve dhe zbatimit i kontratave të punëve publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve.**

Mangësitë e konstatuara nga auditimi i procedurave paraqitet si vijon:

**Nga auditimi për “Hartimin, zbatimin e kontratave deri në momentin e marrjes në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve dhe zbatimi i kontratave të punëve publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve” rezultoi si vijon:**

**I. Zbatimi i kontratës me objekt: “Rikualifikim i aksit Mbikalim-Kombinat”, ku rezultoi:**

Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës me objekt: “Rikualifikim i aksit Mbikalim-Kombinat” të lidhur ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe sipërmarrësit të punimeve “G.P.G Company” SHPK, u konstatua se zërat e punimeve si vijon: Shtresë betoni M-200, t=10 cm; Shtresë çakulli t=10/15 cm, makadam, përhapur e ngjeshur me makineri; Shtresë rëre t=4 cm për trotuar dhe Pllaka betoni gri t=6 cm për trotuar, janë likuiduar për punime të pakryera dhe diferenca në volume në shumën **725,972 lekë pa TVSH** duke shkaktuar efekt financiar negativ ndaj buxhetit të shtetit dhe njësië vendore. Sa më sipër nuk është në përputhshmëri me paragrafin e tretë të nenit 7, të ligjit nr.

8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” Kreu I, pika

Nga auditimi i dokumentacionit për përdorimin e fondit rezervë, u konstatua se në preventivin e ripunuar dhe të miratuar nga Kryetari i Autoritetit Kontraktor, Bashkisë Tiranë me V.K.T. Nr. 14/6, datë 28.09.2018, fondi rezervë në shumën 9,270,795 lekë pa TVSH është shkruar në preventivin e ripunuar, pa hartuar më parë procedurën e përdorimit të fondit rezervë (Preventiv për fondin rezervë, proces-verbal i sigluar nga Autoriteti Kontraktor, Zbatuesi i punimeve si dhe Mbikëqyrësi i punimeve), i cili kontrollohet dhe autorizohet vetëm nga mbikëqyrësi i punimeve. Ky veprim edhe pse nuk ka ndikuar në çmimin e kontratës është në kundërshtim me UKM Nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, pika 19.

Të përgjithshme: Projekti i zbatimit për objektin “Rikualifikim i aksit Mbikalim-Kombinat” është miratuar me V.K.T. Nr. 15/2, datë 24.08.2017 dhe është rishikuar dhe miratuar me VKT Nr. 14/6, datë 28.09.2018. Projekti i zbatimit, parashikon ndërtimin e aksit Mbikalim-Kombinat dhe punime për korsitë e biçkletave, zgjerimin e trotuarëve, asfaltimin e rrugës, ndërtimin e errjetit të ndiçimit elektrik si dhe punime për muret rrethues, majtës, hartimin e planimetrisë së shpronsimeve

#### **A. Mbi kontratën e zbatimit të punimeve, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve si dhe realizimit të grafikut të punimeve.**

- Kontrata e zbatimit me objekt: “Rikualifikim i aksit Mbikalim-Kombinat”, është lidhur me datë 13.03.2018 dhe nr. prot. 1189/3, ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Tiranë, përfaqësuar nga Z. E.V. dhe Operatorit Ekonomik “G...” SHPK, me licencë profesionale NZ.2309/12, përfaqësuar nga administratori (përfaqësuesi ligjor) Z. P.B.. Vlera e kontratës bazë është 233,624,034 lekë me TVSH. Afati i realizimit të punimeve do të jetë 34 (tridhjet e katër) javë kalendarikë nga data e lidhjes së kontratës. Periudha e garancisë do të jetë 24 muaj (neni 29, i kontratës), duke filluar nga data e marrjes në dorëzim të punimeve.

- Për kryerjen e shërbimit të mbikëqyrjes të punimeve të kontratës me objekt: “Rikualifikim i aksit Mbikalim-Kombinat” është lidhur kontrata e shërbimit me nr. prot. 8555/7, datë 13.03.2018, ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Tiranë, përfaqësuar nga Z. Erion Veliu dhe OE “T...” SHPK përfaqësuar nga Z. I.K., me licenc NR. MK 1431/6 dhe me vlerë të kontrate 1,890,400 lekë me TVSH.

-Lirimi i sheshit dhe akti i piketimit në objekt janë bërë me datë 15.03.2018. Lirimi i sheshit të ndërtimit është shoqëruar me problematika për shkak të prishjeve të planifikuara për shpronësim nga projekti i zbatimit ku dhe janë kryer procedura përkatëse midis palëve të përfaqësuara në realizimin e projektit, AK, Mbikëqyrës dhe Kontraktori. Aktualisht nuk janë prishur 2 objekte , km 0+1070 pasi janë në shqyrtim dokumentacioni hipotekor nga drejtoria përkatëse. Ende nuk kanë përfunduar prishjet në kryqëzimin rruga “3 Dëshmorët” dhe kryqëzimin me rrugën “Besim Alla”.

Punimet e ndërtimit kanë filluar me datë 15.03.2018 dhe duhet të përfundonin sipas kontratës bazë me datë 05.11.2018.

- Bazuar në akt-marrëveshjen me nr. prot. 40405/2, datë 02.11.2018 me objekt për zgjatjen e afatit të kontratës “Rikualifikim i aksit mbikalim-Kombinat” për një periudhë kohore 8 (tetë) javë kalendarike mbështetur në nenin 35 “Dëshmperblimi për vonesat” të kontratës , Nr. 1189/3 Prot, datë 13.03.2018, përfundimi i punimeve nga data 05.11.2018 do jetë data 31.12.2018.

- Mbikëqyrësi i punimeve OE “T...” SHPK me shkresën nr. prot. 47924/1, datë 28.12.2018 është kërkuar shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve për një periudhë kohore deri në 8 (tetë) javë kalendarike për shkak të mos prishjes së objektit 3 kat në km 0+050 (majtas) si dhe në km 0+320 deri km 0+375 (djathtas) dhe km 1+025 deri 1+060 (djathtas) nuk janë prishur objektet 1 kat nga I.M.T, që pengojnë realizimin e punimeve sipas projektit. Përfundimi i punimeve nga data 31.12.2018 do jetë data 24.02.2019 nisur nga fakti se shtesa e afatit të përfundimit të punimeve (24.02.2019) i përket jashtë periudhës së auditimit sipas programit të auditimit nr. 1268/2, datë 18.12.2018, auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit si dhe auditimi mbi realizimin e punimeve në terren, do të kryhet sipas situacionit pjesor nr. 1.

Preventivi është ripunuar sa vlera e kontratës (233,624,034 lekë me TVSH) dhe është miratuar nga Kryetari i Z. Erion Veliaj me VKT Nr. 14/6, datë 28.09.2018.

- DPPP në Bashkinë Tiranë me shkresë nr. prot. 1357, datë 06.04.2018 i është drejtuar Drejtorisë së përgjithshme Juridike të Aseteve dhe Liçensimit, Bashkia Tiranë, për fillimin e procedurave të shpronsimit.

- DPPP në Bashkinë Tiranë me shkresë nr. prot. 14076, datë 11.04.2018 i është drejtuar “Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 1 të Punëtorëve të Qytetit, Bashkia Tiranë, për bashkëpunim në realizimin e projektit “Rikualifikim i aksit Mbikalim-Kombinat”.

#### **B. Likuidimi i situacioneve për punimet e kryera, rezulton.**

Për punimet e kryera në objekt është paraqitur situacioni pjesor Nr. 1, si vijon:

- Situacioni pjesor nr. 1, me vlerë 156,236,000 lekë me TVSH.

Nga Autoriteti Kontraktor janë likuiduar: (Situacion 1 me USH 1005, datë 28.03.2019 me shumë 36,216,000 lekë; Situacion 2 me USH 1006, datë 28.03.2019 me shumë 23,784,000 lekë).

#### **C. Mbi auditimin e realizimit të punimeve në terren.**

Nga auditimi në terren për verifikimin e zërave të punimeve si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të administruara në dosjen teknike të zbatimit të vënë në dispozicion grupit të auditimit për punimet e kryera deri në periudhën e auditimit, rezultojnë diferenca në volume për punime të kryera në vlerën prej **725,972** lekë pa TVSH, argumentuar si vijon:

#### **PUNIME PËR TROTUARIN E RI**

Nga auditimi në terren mbi realizimin e punimeve për trotuarin e ri, përkatësisht për 2443.44 ml trotuar i ri (krahu i djathtë i rrugës) dhe 2099.3 ml trotuar (krahu i majtë i rrugës) për (punime të kryera në fakt, që i përkasin situacionit pjesor nr. 1, datë 30.10.2018) për zërat e punimeve:

- 3 (2.262/4) Shtresë betoni M-200, t=10 cm
- 14 (3.212) Shtresë çakulli t=10/15 cm, makadam, përhapur e ngjeshur me makineri
- 4 (2.261) Shtresë rëre t=4 cm për trotuar
- 5 (3.620) Pllaka betoni gri t=6 cm për trotuar,

na rezulton se, në volumet e situacionuara nuk janë zbritur sipërfaqet që zënë *pemët ekzistuese* në aksin Mbikalim-Kombinat.

Bazuar nga auditimi i kryer në fakt dhe nga rillogatitja e bërë, rezultojnë diferenca në volume, të argumentuara si vijon:

**Tabela nr. 1, për trotuarin e ri djathtas dhe majtas.**

Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni pjesor nr. 1	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
<b>Seksioni 4</b>	<b>Punime për trotuarin e ri (Djathtas)</b>							
3 (2.262/4)	Shtresë betoni M-200, t=10 cm	m <sup>3</sup>	11,000	820	820.3	797.81	22.19	244,090
14 (3.212)	Shtresë çakulli t=10/15 cm, makadam, përhapur e ngjeshur me makineri	m <sup>2</sup>	507	8,223	8,223	8001,03	221.97	112,538.79
4 (2.261)	Shtresë rëre t=4 cm për trotuar	m <sup>3</sup>	1,600	328	328	319.13	8.87	14,192
5 (3.620)	Pllaka betoni gri t=6 cm për trotuar	m <sup>2</sup>	1,600	8,223	8,223	8001.03	221.97	355,152
	<b>Total</b>							<b>725,972.79</b>

Sa më sipër trajtuar, sipërmarrësi i punimeve OE “G...” SHPK ka përfituar në mënyrë të pa drejtë **725,972 lekë pa TVSH.**

**Si përfundim në mënyrë të përmbledhur nga auditimi për objektin “Rehabilitimi i aksit Mbikalimi-Kombinat” rezulton se:**

1- Sipërmarrësit të punimeve “G...” SHPK i janë likuiduar tepër për punime të pakryera në vlerën **725,972 lekë pa TVSH, vlerë që përbën efekt financiar negativ** ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore Bashkisë Tiranë, dhe duhet të zhdëmtohet nga sipërmarrësi i punimeve “G...” SHPK.

2- Auditimi mbi realizimin e punimeve të ndërtimit i përket periudhës nga fillimi i punimeve datë 15.03.2018 deri me datë 31 dhjetor 2018, periudhë brenda programit të auditimit të KLSh-së që përkon me situacionin pjesore nr. 1. Në fakt nga auditimi i punimeve në terren rezultojn se kanë përfunduar punimet në masën rreth 96.67% ose në shumën 225,845,814 lekë dhe konkretisht janë kryer punimet sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Zëri i punimeve	Punime preventiv të ripunuar [në lekë]	Sipas të kryera sipas faktit [në lekë]	% e realizimit
1	Punime për trafikndarësen (5 zëra)	4,766,000	4,766,000	100.00
2	Punime për korsitë e biçikletave (7 zëra)	19,346,430	18,082,078	93.46
3	Punime për trotuarin e ri (21 zëra)	66,408,922	65,145,131	98.10
4	Punime për zgjerimin e rrugës (15 zëra)	15,353,636	14,382,836	93.68
5	Asfaltim rruge (7 zëra)	68,937,108	68,935,200	99.99
6	Punime për prishje për muret rrethuese dhe mbajtëse (3 zëra)	4,800,000	4,800,000	100.00
7	Punime për mure të rinj rrethues (11 zëra)	8,848,400	6,863,400	77.57
8	Punime për muret mbajtëse (6 zëra)	6,226,200	5,230,200	84.00
	<b>Totali pa TVSH</b>	<b>194,686,696</b>	<b>188,204,845</b>	<b>96.67%</b>

3- Mbikëqyrësi i punimeve “Z...” SHPK me shkresën me Nr. Prot. 14940, datë 05.04.2019 i është drejtuar Bashkisë Tiranë me një kërkesë për shtyrje afati për arsyt si vijon - Vonesave në lirim të ndërtimit.

- Bazuar në problematikat e paraqitura nga sipërmarrësi “G...” SHPK dhe mbikëqyrësi i punimeve “T...” SHPK me shkresën nr. 8857 prot, datë 21.02.2019, është kërkuar shtyrja e afatit të punimeve për një periudhë kohore prej 60 ditë kalanderike, me argumentimin se:

\* Prishjet e disa objekteve nuk kanë përfunduar akoma dhe mosprishja e tyre pengon kryerjen e punimeve.

\*\* Kohën e humbur për shkak të hapësirave që zënë pusët ose shaftet të cilat ndodhen në trupin e rrugës dhe nuk janë përfunduar nga kompania që zbaton projektin e K.U.Z për Tiranën, sipas progresivave të përcaktuara në kërkesën e kontraktorit. Përfundimi i punimeve nga data 24.02.2019 do jetë data 24.04.2019 dhe është miratuar me akt-marrvëshjen me nr. prot. 8857/2, datë 21.02.2019.

4. Në preventivin e ripunuar të miratuar nga Kryetari i AK, Bashkisë Tiranë me VKT Nr. 14/6, datë 28.09.2018 u konstatua se, fondi rezervë në shumën 9,270,795 lekë pa TVSH është shkrirë në preventivin e ripunuar, pa hartuar më parë procedurën e përdorimit të fondit rezervë (Preventiv për fondin rezervë, proces-verbal i sigluar nga Ak, Zbatuesi dhe Mbikëqyrësi i punimeve), i cili kontrollohet dhe autorizohet vetëm nga mbikëqyrësi i punimeve. Ky veprim është në kundërshtim me UKM Nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, pika 19.

**Nga ana e zbatuesit të punimeve nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në:** (-Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 8; -Kontratën e zbatimit me objekt “Rikualifikim i aksit mbikalim-Kombinat”, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë së Tiranës dhe Operatorit Ekonomik “G...” SHPK dhe -Udhëzimin Nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” Kreu I “Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit”, pika 3).

**Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:**

Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve Operatorit Ekonomik “T...” SHPK, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në: (-Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe

*Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7- Kontratën për kryerjen e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve të kontratës me objekt “Rikualifikim i aksit mbikalim-Kombinat” të lidhur midis Autoritetit Kontraktor Bashkisë Tiranë dhe shoqërisë mbikëqyrëse dhe - UKM Nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, të ndryshuar, pika 3.2).(Gjerësisht me personat përgjegjës problemet janë trajtuar në akt-konstatimin nr. 8, datë 16.04.2019)*

**II. Zbatimi i kontratës me objekt: “Rikualifikim urban i bllokut të kufizuar nga rruga “Rikonstruksion urban i bllokut kufizuar nga rruga e “Dibres”, “Njazi Meka”, “Niko Vrami”, “Grigor Perlecev”, ku rezultoi:**

**Të përgjithshme:** Projekti i këtij objekti është i ndarë në tetë zona: (-Zona 1. Parashikon ndëtimin e ujësjellësit, kanalizimeve të ujrave të zeza, kanalizimeve ujrave të shiut, rikonstruksioni i rrugëve të brendshme, trotuare, sistem ndriçimi, ambiente të gjelbëruara, parking makinash; -Zona 2. Parashikon rikonstruksion rruge, ndërtim lulishte, kënd lojrash për fëmijë, gjelbërim dhe parking makinash; -Zona 3. Parashikon rikonstruksion rruge, gjelbërim dhe parking makinash; -Zona 4. Mbjellje pemësh dhe ambiente pushimi dhe stola; -Zona 5. Kënd lojrash për fëmijë, ambiente të gjelbërta dhe stola; -Zona 6. Sistemim rruge të brendshme, amjente pushimi me stola gjelbërim, parkim mjetesh; -Zona 7. Fushë lojrash me dorë, kënd lojrash për fëmijë, gjelbërim, parking makinash, sistem ndriçimi dhe gjelbërim; -Zona 8. Gjelbërim, ambjente pushimi me stola).

Projekti i zbatimit është projektuar nga shoqëria “K...” SHPK me NIPT K... dhe licencë profesionale nr. N.4998/6, me drejtues ligjor dhe teknik Ing. Y.K.. Projekti i zbatimit “Rikonstruksion urban i bllokut kufizuar nga rruga e “Dibres”, “Njazi Meka”, “Niko Vrami”, “Grigor Perlecev” është miratuar me V.K.T Nr. 7, datë 07.03.2013 nga Z. T.Z.

**Mbi kontratën e zbatimit të punimeve, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve si dhe realizimit të grafikut të punimeve.**

Kontrata e zbatimit me objekt “Rikualifikim urban i bllokut të kufizuar nga rruga “Rikonstruksion urban i bllokut kufizuar nga rruga e “Dibres”, “Njazi Meka”, “Niko Vrami”, “Grigor Perlecev” është lidhur me datë 10.06.2013 dhe nr. prot. 36/6, ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë së Tiranës, përfaqësuar nga z. E.K., në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor (i autorizuar me anë të Autorizimit nr. 68, datë 05.01.2012) dhe Operatorit Ekonomik “S...” SHPK përfaqësuar nga Z. P.S. Vlera e kontratës është 127,169,998 lekë me TVSH. Sipas nenit 3 (Afati i kontratës) të kontratës, afati i realizimit të punimeve do të jetë 6 (gjashtë) muaj kalendarikë nga data e nënshkrimit të kontratës. Periudha e garancisë do të jetë 24 muaj nga data e kolaudimit të objektit.

Për kryerjen e shërbimit të mbikëqyrjes të punimeve të kontratës me objekt “Rikualifikim urban i bllokut të kufizuar nga rruga “Rikonstruksion urban i bllokut kufizuar nga rruga e “Dibres”, “Njazi Meka”, “Niko Vrami”, “Grigor Perlecev” është lidhur kontrata me nr. prot. 72/15, datë 10.06.2013, me OE “G...” SHPK, me licencë “Për mbikëqyrje dhe kolaudin punimesh” respektivisht me MK. 1735/9, përfaqësuar nga z. H.M.

Për shërbimin e kolaudimit të punimeve të kontratës me objekt “Rikualifikim urban i bllokut të kufizuar nga rruga “Rikonstruksion urban i bllokut kufizuar nga rruga e “Dibres”, “Njazi Meka”, “Niko Vrami”, “Grigor Perlecev” është lidhur kontrata me nr. prot. 23837/2, datë 29.08.2016, ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë së Tiranës, përfaqësuar nga z. Erion Veliaj dhe OE “I...” SHPK, me licencë me MK. 1706/5, datë 08.07.2016 me drejtues ligjore Zj. F.V.

- Me datë 09.10.2015 dhe nr. prot. 13816/2 është mbajtur Akt-Marrëveshje për zgjatje afati punimesh për 4 muaj nga data 12.10.2015 deri me datë 12.02.2016 të lidhur ndërmjet Autoriteti Kontraktor Bashkia Tiranë, përfaqësuar nga z. Erion Veliaj dhe sipërmarrësit të punimeve “S...” SHPK përfaqësuar nga z. P.S.

- Me datë 12.02.2016 dhe nr. prot. 4664/2 është mbajtur Akt-Marrëveshje për zgjatje afati punimesh për 3 muaj nga data 13.02.2016 deri me datë 12.05.2016 të lidhur ndërmjet Autoriteti Kontraktor Bashkia Tiranë, përfaqësuar nga z. Erion Veliaj dhe sipërmarrësit të punimeve “S...” SHPK përfaqësuar nga z. P.S.

- Me datë 12.05.2016 dhe nr. prot. 14237/2 është mbajtur Akt-Marrëveshje për zgjatje afati punimesh nga data 13.05.2016 deri me datë 30.07.2016 të lidhur ndërmjet Autoriteti Kontraktor Bashkia Tiranë, përfaqësuar nga z. Erion Veliaj dhe sipërmarrësit të punimeve “S...” SHPK përfaqësuar nga z. P.S. Të dhëna të përgjithshme mbi dokumentacionin tekniko-ligjor:

<b>Të dhëna të përgjithshme mbi dokumentacionin tekniko-ligjor</b>	<b>Nr. Prot.</b>	<b>Data</b>	<b>Palët e angazhuara dhe siglimet</b>
Kontrata e sipërmarrjes, vl=127,169,998 Lekë me TVSH	36/6	10.06.2013	- AK, përfaqësuar nga z. E.K. - OE “S...” shpk përfaqësuar nga Z. P.S.
Kerkesë për përdorimin e fondit rezervë vl=1,758,350 lekë me TVSH.		06.07.2016	- sipërmarrësi “S...” shpk përfaqësuar nga Z. P.S. dhe D.T ing. A.S. Për AK: - DPPP, z. T.T. - DIPP, z. E.P. (drejtor i deleguar).
Kontratë mbikëqyrjesh punimesh	72/15	10.06.2013	- AK, përfaqësuar nga z. E.K. - OE “G...” shpk përfaqësuar nga Z. H. M
Kontratë shërbim kolaudimi	23837/2	29.08.2016	- AK, përfaqësuar nga z. Erion Veliaj - Kolaudatori “I...” shpk përfaqësuar nga dhe D.T & D.L, Ing. F.V.
Njoftim fillim punimesh nga sipërmarrësi	26	11.06.2013	- sipërmarrësi “S...” shpk përfaqësuar nga Z. P.S.
Njoftim për fillim punimesh nga mbikëqyrësi	147	11.06.2013	- mbikëqyrësi “G...& Co” shpk përfaqësuar nga Ing. Rezident Z. R.K.
Akt-dorëzimi i sheshit të ndërtimit	-	11.06.2013	- sipërmarrësi “S...” shpk përfaqësuar nga Z. P.S. - mbikëqyrësi “G & Co” shpk përfaqësuar nga Z. H. M. Nga Investitori: - DPPP z. T.Z - DIPP z. R. B
Proces-verbal mbi fillimin e punimeve	-	11.06.2013	- sipërmarrësi “S...” shpk përfaqësuar nga Z. P.S. - mbikëqyrësi “G & Co” shpk përfaqësuar nga Z. R.K. Nga Investitori: - DPPP z. Taulant Zeneli - DIPP z. Rigels Balla
Proces-verbal mbi akt-piketimin në objekt	-	11.06.2013	- sipërmarrësi “S...” shpk përfaqësuar nga D. Teknik Ing. A.S.. - mbikëqyrësi “G... & Co” shpk përfaqësuar nga D.T, Z. .K.
Projekt Fillestar i Zbatimit	V.K.T Nr. 7	07.03.2013	Miratur nga Z. T.Z.
Proces - verbal për Përfundimim punimevesh nga sipërmarrësi	438	30.07.2016	- sipërmarrësi “S...” shpk përfaqësuar nga Administratori z. P.S.
Njoftim për Përfundimim punimevesh nga mbikëqyrësi i punimeve	23837 (1174)	02.08.2016	- mbikëqyrësi “Gjeokonsult & Co” shpk përfaqësuar nga D.T, Z. Rusland Kallabaku.
Proces-verbal mbi përfundimin e punimeve	438	30.07.2016	- sipërmarrësi “Salillari” shpk përfaqësuar nga D.T Ing. Arjan Skënderi. - mbikëqyrësi “Gjeokonsult & Co” shpk përfaqësuar nga D.T, Z. Rusland Kallabaku.
Relacion përfundimtar i mbikëqyrësit të punimeve	-		- sipërmarrësi “Gjeokonsult & Co” shpk përfaqësuar nga D.T, Z. Rusland Kallabaku.
Deklarate Teknike e sipërmarrësit	-	30.07.2016	- sipërmarrësi “Salillari” shpk përfaqësuar nga D.L z. Pëllumb Salillari dhe D.T Ing.

			Arjan Skënderi.
Proces-verbali i kolaudimit të punimeve	-	28.09.2016	- Sipërmarrësi “Salillari” shpk përfaqësuar nga D.T Ing. Arjan Skënderi. - Mbikëqyrësi “Gjeokonsult & Co” shpk përfaqësuar Administratori z. Hamit Mustafa dhe nga D.T, Z. Rusland Kallabaku. - Kolaudatori “Infratech” shpk përfaqësuar nga dhe D.T & D.L, Ing. Filjana Veizaj.

### Likuidimi i situacioneve për punimet e kryera, rezulton.

Punimet e kryera në objekt për kontratën bazë, janë paraqitur në situacionet pjesore si vijon: (- Situacioni pjesor nr. 1 me vlerë 14,221,800 lekë me TVSH; - Situacioni pjesor nr. 2 me vlerë 10,134,229 lekë me TVSH; - Situacioni pjesor nr. 3 me vlerë 9,697,001 lekë me TVSH; - Situacioni pjesor nr. 4 me vlerë 20,689,938 lekë me TVSH; - Situacioni pjesor nr. 5 me vlerë 21,750,346 lekë me TVSH; - Situacioni nr. 6 (përfundimtar) me vlerë 44,620,970 lekë me TVSH). Nga Autoriteti Kontraktor janë likuiduar të gjitha situacionet si dhe shuma e mbajtur për garancin e punimeve (5%).

Shqyrtimi dhe vlerësimi i komenteve të mbikëqyrësit të punimeve përcjellë në KLSH dhe me datë 02.05.2019 dhe nr. prot. 229) mbi Akt-Konstatimin Nr. 9, datë 16.04.2019 të mbajtur nga grupi i auditimit të KLSH-së, në zbatim në nenit 32, të Rregullores së Procedurave të Auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit (miratuar me vendim të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit Nr. 107, datë 08.08.2017 “Për miratimin e rregullores së procedurave të auditimit në kontrollin e lartë të shtetit” është trajtuar si vijon:

#### a-Argumente dhe komente nga subjekti i audituar u trajtua si vijon:

- Mbikëqyrësi i punimeve shoqëria “G...& CO” sh.p.k shpjegon se, duke u bazuar në pikën 27.8 të kontratës së sipërmarrësit: “Nëse volumet përfundimtare të punimeve të kryera, ndryshojnë nga volumet në preventiv dhe vlera e tyre është brenda preventivit të objektit dhe fondit rezervë, Autoriteti Kontraktor ngarkon Mbikëqyrësin e punimeve për të sistemuar volumet dhe për të dokumentuar ndryshimet e mundshme dhe mandej i miraton ato”. Për sa i përket mospërcaktimit të kuotës së gërmimit me 80 cm, duhet të theksojmë se në këto zona është ruajtur dhe respektuar kuota e gërmimit të projektit në përputhje me paketën e paracaktuar në projekt.

#### b-Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Grupi i auditimit pasi e lexoi me kujdes observacionin sqaron se:

Është e vertetë se ndryshimet janë paraqitur në vizatimet që shoqërohen me librezat e masave, por proces-verbali i mbajtur për miratimin e volumeve që shtohen dhe volumeve që zbriten, nuk na rezulton i argumentuar me skica apo vizatime, nuk ka projekt të ndryshuar në kuptimin e këtij proces-verbali dhe mbi të gjitha në asnjë dokument teknik si proces-verbale mbi punimet e maskuara, akt-kontrollet, etj, nuk është përcaktuar kuota e gërmimit me 80 cm. Autoriteti Kontraktor ka miratuar vetëm preventivin e ndryshuar pa dokumentacion plotësues dhe argumentues. Grupi i auditimit në këtë observacion priste dokumente shtesë si: planimetri me sipërfaqet e shtuara dhe detaje, të miratuara nga AK. Gjithsesi, nisur nga fakti se këto volume janë realizuar në fakt, observacioni Juaj merret në konsideratë duke zbritur shumën 388,400 lekë si efekt financiar negativ:

#### Si përfundim mbas shqyrtimit të observacionit nga auditimi rezulton se:

Në mënyrë të përmbledhur për objektin “Rikualifikim urban i bllokut të kufizuar nga rruga “Rikonstruksion urban i bllokut kufizuar nga rruga e “Dibres”, “Njazi Meka”, “Niko Vrami”, “Grigor Perlecev” rezultoi se nuk konstatohen diferenca në punime dhe në volume dhe se punimet e ndërtimit janë kryer sipas projektit të zbatimit dhe kushteve të kontratës *me objekt* “Rikualifikim urban i bllokut të kufizuar nga rruga “Rikonstruksion urban i bllokut kufizuar nga rruga e “Dibres”, “Njazi Meka”, “Niko Vrami”, “Grigor Perlecev”, të lidhur me datë 10.06.2013 dhe nr. prot. 36/6, ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë dhe zbatuesit të punimeve të ndërtimit, OE “S...” SHPK.

(Për sa trajtuar më sipër, më gjerësisht është trajtuar në akt-konstatimi nr. 9, datë 16.04.2019)

### III. Zbatimi i kontratës me objekt: “Ndërtim parkim nëntokësor, Sheshi Skënderbej”, ku rezultoi:

Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës me objekt: “Ndërtim parkim nëntokësor, Sheshi Skënderbej” të lidhur ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe sipërmarrësit të punimeve “F...” SHPK, u konstatua se zërat e punimeve si vijon: Shtresë me rezinë epokside e komponente në tualete dhe koridor; Parapet shkalle e ballkone me tuba xingato dhe zëri Bojatisje me bojë betoni plintuese, janë likuiduar për punime të pakryera dhe punime në kundërshtim me specifikimet teknike të tenderit dhe të kontratës së zbatimit në shumën **496,140 lekë pa TVSH** duke shkaktuar efekt financiar negativ ndaj buxhetit të shtetit dhe njësië vendore. Sa më sipër nuk është në përputhshmëri me paragrafin e tretë të nenit 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” Kreu I, pika 3.

**Të përgjithshme:** Projekti i zbatimit është miratuar nga Bashkia Tiranë me V.K.T. Nr. 15, datë 29.08.2016 dhe rishikimit të mëvonshëm të Projekt Preventivit është miratuar Bashkia Tiranë me V.K.T. Nr. 9, datë 10.05.2017. Për objektin “Sheshi Skënderbej Tiranë” Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT) ka lëshuar Leje Ndërtimi me Nr. 983/2, datë 24.11.2016 me afat 24 muaj, me zhvillues Bashkia Tiranë me NUIS K11729002L, datë 29.05.2001, me këto të dhëna: (Sipërfaqe e përgjithshme e truallit është 94,050 m<sup>2</sup>; Sipërfaqe e përgjithshme e territorit ku do të kryhen punimet është 94,050 m<sup>2</sup>; Koeficienti i shfrytëzimit të truallit për rrugë dhe hapsira publike, 100%; Sipërfaqe e gjelbër është 13,629 m<sup>2</sup> dhe Sipërfaqe e shtruar është 60,720 m<sup>2</sup>).

#### A. Mbi kontratën e zbatimit të punimeve, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve si dhe realizimit i grafikut të punimeve.

**Kontrata bazë:** Kontrata e zbatimit me objekt “Ndërtim parkim nëntokësor, Sheshi Skënderbej”, është lidhur me datë 11.11.2016 dhe nr. prot. 28253/11, ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë së Tiranës, përfaqësuar nga z. Erion Veliaj, Kryetar dhe Operatorit Ekonomik “F...” SHPK me licencë me Nr. NZ. 1163/15, përfaqësuar nga Z. S.F. Vlera e kontratës është 267,263,903.33 lekë me TVSH. Sipas nenit 3 (Afati i kontratës) të kontratës, afati i realizimit të punimeve do të jetë 7 (shtatë) muaj kalendarikë nga data e lidhjes së kontratës. Periudha e garancisë do të jetë 24 muaj kalendarik nga data e kolaudimit të objektit. Kontraktori ka caktuar drejtuesin teknik z. R.M.i përfshirë në licencën profesionale të shoqërisë “F...” SHPK

- Për kryerjen e shërbimit të mbikëqyrjes të punimeve të kontratës me objekt “Ndërtim parkim nëntokësor, Sheshi Skënderbej” është lidhur kontrata e shërbimit me nr. prot. 29693/7, datë 11.11.2016, ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë së Tiranës, përfaqësuar nga z. Erion Veliaj, Kryetar me BOE “5...” Degë e shoqërisë së Huaj, me licencë “Për mbikëqyrje dhe kolaudin punimesh” MK. 2895 e përfaqësuar nga Përfaqësuesi Ligjor i Degës së shoqërisë z. J.A. & shoqërinë “G...” SHPK me licencë “Për mbikëqyrje dhe kolaudin punimesh” MK. 0802/7 me seli në Tiranë, e përfaqësuar nga Përfaqësuesi Ligjor i Degës së shoqërisë Znj. M.H.

Me anë të prokurës së posaçme të datës 10.10.2016, me Nr. 6329 Rep., Nr. 4253 Kol, Tiranë, shoqëria “G...” SHPK, autorizon shoqërinë “5....a 7” Degë e shoqërisë së Huaj, me përfaqësues Ligjor të Degës së shoqërisë z. J.A. të jetë përfaqësues i bashkimit të shoqërive në realizimin e objektit të kontratës, i mëposhtëquajtur “Mbikëqyrësi i punimeve”. Vlera e plotë e mbikëqyrjes së objektit është 2,442,372 lekë me TVSH.

- Për shërbimin e kolaudimit të punimeve të ndërtimit të kontratës me objekt “Ndërtim parkim nëntokësor, Sheshi Skënderbej” është lidhur kontrata me nr. prot. 43966/2, datë 20.12.2017, ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë së Tiranës, përfaqësuar nga z. Erion Veliaj dhe OE “T...” SHPK, me licencë me MK. 2454/4, datë 27.04.2017 me përfaqësues drejtues ligjore Z. D.Ç. Kontrata është lidhur me vlerë totale 106,906 lekë me TVSH me financim nga buxheti i Bashkisë.

Informacioni i përgjithshëm mbi zbatimin e kontratës jepet siaps tabelës:

Nr.	Të përgjithshme mbi dokumentacionin	Data	Nr. Prot.	Përfaqësuesit sipas palëve
-----	-------------------------------------	------	-----------	----------------------------



	<b>tekniko-ligjor</b>			
1	Njoftim fillim punimesh	11.11.2016		JV "51N4E" b.v.b.a & "Geosat sh.p.k" Ardian Rrapo
2	Njoftim fillim punimesh	11.11.2016	126	Fusha sh.p.k Shkëlqim Fusha
3	Akt-dorëzimi i sheshit të ndërtimit	12.11.2016	-	- JV "51N4E" b.v.b.a & "Geosat sh.p.k" Ardian Rrapo - Fusha sh.p.k Shkëlqim Fusha - DIPP përfaqësuar nga Z. Rigels Balla - DPPP, përfaqësuar nga Z. Taulant Tusha
4	Proces-verbal mbi akt-piketimin në objekt	12.11.2016	-	- JV "51N4E" b.v.b.a & "Geosat sh.p.k" Ing. Ardian Rrapo - Fusha sh.p.k Adm. Shkëlqim Fusha
5	Proces-verbal mbi fillimin e punimeve	12.11.2016	-	- JV "51N4E" b.v.b.a & "Geosat sh.p.k" Ing. Ardian Rrapo - Fusha sh.p.k Adm. Shkëlqim Fusha - DIPP përfaqësuar nga Z. Rigels Balla - DPPP, përfaqësuar nga Z. Taulant Tusha
6	Preventiv i ripunuar	10.05.2017	V.K.T. Nr. 9	- JV "51N4E" b.v.b.a & "Geosat sh.p.k" Ing. Ardian Rrapo - Fusha sh.p.k Adm. Shkëlqim Fusha - AK, Z. Erion Veliaj
7	Projekti i rishikuar	10.05.2017	V.K.T. Nr. 9	- JV "51N4E" b.v.b.a & "Geosat sh.p.k" Ing. Ardian Rrapo - Fusha sh.p.k Adm. Shkëlqim Fusha - AK, Z. Erion Veliaj
8	Akt marrëveshje për zgjatjen e afatit të kontratës me <b>tre muaj</b> , nga 12.06.2017 deri 12.09.2017	12.06.2017	21846/2	- Fusha sh.p.k përfaqësuar nga Adm. Shkëlqim Fusha - AK, Bashkia Tiranë përfaqësuar nga Kryetari Z. Erion Veliaj
9	Akt marrëveshje për zgjatjen e afatit të kontratës me <b>tre muaj</b> , nga 12.09.2017 deri 12.12.2017	07.09.2017	32174/2	- Fusha sh.p.k përfaqësuar nga Adm. Shkëlqim Fusha - AK, Bashkia Tiranë përfaqësuar nga Kryetari Z. Erion Veliaj
10	Njoftim për Përfundimim punimevesh nga zbatuesi i punimeve FUSHA shpk	06.12.2017	43966	Fusha sh.p.k përfaqësuar nga Adm. Shkëlqim Fusha
11	Njoftim për Përfundimim punimevesh nga mbikëqyrësi i punimeve JV "51N4E" b.v.b.a & "Geosat sh.p.k".	06.12.2017	43966	JV "51N4E" b.v.b.a & "Geosat sh.p.k" Ing. Ardian Rrapo
12	Proces-verbal i dorëzimit të punimeve	06.12.2017	-	- Fusha sh.p.k përfaqësuar nga Adm. Shkëlqim Fusha dhe D.T ing. Ramazan Myrto. - JV "51N4E" b.v.b.a (degë e shoqërisë së huaj & "Geosat sh.p.k" përfaqësuar nga Ing. Ardian Rrapo
13	Deklaratë teknike e sipërmarrësit			- D. Ligjor z. Shkëlqim Fusha - D.T i objektit z. Ramadan Myrto - Drejtuesi i punimeve, z. Genc Golemi
14	Proces-verbali i <b>kolaudimit</b>	19.01.2018	-	- Fusha sh.p.k përfaqësuar nga Adm. Shkëlqim Fusha - JV "51N4E" b.v.b.a (degë e shoqërisë së huaj & "Geosat sh.p.k" përfaqësuar nga Ing. Ardian Rrapo - "Tesla Vizion" shpk përfaqësuar nga D.L dhe D.T, Ing. Dëfrim Çelami
15	Akt-Marrje në dorëzim të objektit	-	-	-

Nga zbatuesi i punimeve “F...” SHPK si dhe nga mbikëqyrësi i punimeve JV “5...” b.v.b.a & “G...t sh.p.k” për punimet e ndërtimit të kryera që i përkasin situacionit përfundimtar janë mbajtur me korrektësi dokumentacioni si vijon: ( Proces-verbal mbi punimet e maskuara; Akte kontrolli 26 copë; Raport analize për materialet: - Materiale për recetë betoni, agregate; - Shufra Fe me diametër të ndryshëm; - Kube betoni për tratë themeli; kollona; mure b/a; muret pus i ajrimit; muret shkalla; muret dhe soleta dhoma teknike; soleta; pllaka, soleta dhe muret e rampes së makinave; muret dhe soleta lidhja me galerinë; soleta e koridorit Parkim-Korridor; muret shkalla; muret ashensori; shtresë betoni dysHEME; - Procesverbal miratim materialesh; - Ditari i objektit që përfshin periudhën nga data 11.11.2016 deri datë 06.12.2017; - Foto gjatë dhe pas pune; - Relacion përfundimtar i mbikëqyrësit, i mbajtur nga mbikëqyrësi i punimeve JV “5,...” b.v.b.a & “G...t sh.p.k” ku është nënshkruar nga Drejtuesi Teknik Ing. A.R).

**Nga auditimi i kontratës shtesë rezultoi:** Shtesë kontrate sipërmarrje me objekt “Ndërtim parkim nëntokësor, Sheshi Skënderbej”, është lidhur me datë 19.04.2018 dhe nr. prot. 11233/06, ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë së Tiranës, përfaqësuar nga z. Erion Veliaj, Kryetar dhe Operatorit Ekonomik “F...” SHPK me licencë me Nr. NZ. 1163/15, përfaqësuar nga Z. S.F. Vlera e shtesës së kontratës është 53,451,621.60 lekë me TVSH. Sipas nenit 3 (Afati i kontratës) të kontratës, afati i realizimit të punimeve do të jetë 3 (tre) muaj kalendarikë nga data e lidhjes së kontratës. Periudha e garancisë do të jetë 24 muaj kalendarikë nga data e kolaudimit të objektit. Kontraktori ka caktuar drejtuesin teknik z. R.M. i përfshirë në licencën profesionale të shoqërisë “F... SHPK

- Për kryerjen e shërbimit të mbikëqyrjes të punimeve të kontratës me objekt “Ndërtim parkim nëntokësor, Sheshi Skënderbej” është lidhur kontrata e shërbimit me nr. prot. 11235/7, datë 19.04.2018, ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë së Tiranës, përfaqësuar nga z. Erion Veliaj, Kryetar me BOE “51N4E” Degë e shoqërisë së Huaj, me licencë “Për mbikëqyrje dhe kolaudin punimesh” MK. 2895 e përfaqësuar nga Përfaqësuesi Ligjor i Degës së shoqërisë z. Johan Anrys & shoqërinë “G....” SHPK me licencë “Për mbikëqyrje dhe kolaudin punimesh” MK. 0802/7 me seli në Tiranë, e përfaqësuar nga Përfaqësuesi Ligjor i Degës së shoqërisë Znj. M. H.

Me anë të prokurës së posaçme të datës 10.10.2016, me Nr. 6329 Rep., Nr. 4253 Kol, Tiranë, shoqëria “G....” SHPK, autorizon shoqërinë “51N4E bvba 7” Degë e shoqërisë së Huaj, me përfaqësues Ligjor të Degës së shoqërisë z. Johan Anrys të jetë përfaqësues i bashkimit të shoqërive në realizimin e objektit të kontratës, i mëposhtëruar “Mbikëqyrësi i punimeve”. Vlera e plotë e mbikëqyrjes së objektit është 488,474 lekë me TVSH.

- Për shërbimin e kolaudimit të punimeve të ndërtimit të kontratës me objekt “Ndërtim parkim nëntokësor, Sheshi Skënderbej” është lidhur kontrata me nr. prot. 28049/2, datë 06.08.2018, ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë së Tiranës, përfaqësuar nga z. Erion Veliaj dhe OE “T...” SHPK, me licencë me MK. 2454/4, datë 27.04.2017 me përfaqësues drejtues ligjore Z. D. Ç. Kontrata është lidhur me vlerë totale 22,000 lekë me TVSH me financim nga buxheti i Bashkisë.

Informacioni i përgjithshëm mbi zbatimin e kontratës jepet siap tabelës:

Të përgjithshme mbi dokumentacionin tekniko-ligjor	Data	Nr. Prot.	Përfaqësuesit sipas palëve
Kontraë zbatimi, Shtesë kontrate	19.04.2018	11233/6	- Bashkia Tiranë, përfaqësuar nga Kryetari z. Erion Veliaj - Kontraktori “Fusha” shpk, përfaqësuar nga D. L. Z. Shkëlqim Fusha
Kontratë mbikëqyrje, Shtesë kontrate	19.04.2018	11235/7	- Bashkia Tiranë, përfaqësuar nga Kryetari z. Erion Veliaj - BOE “51N4E” b.v.b.a përfaqësuar nga z. Johan Anrys & “Geosat sh.p.k” Ardian Rrapo përfaqësuar nga Znj. Majlinda Haloçi
Kontratë kolaudimi, Shtesë kontrate	06.08.2018	28049/2	- Bashkia Tiranë, përfaqësuar nga Kryetari z. Erion Veliaj - OE “Tesla Vizion” shpk, përf nga z. Dëfrim Çelami

Njoftim fillim punimesh	20.04.2018	15392	JV "51N4E" b.v.b.a & "Geosat sh.p.k" Ardian Rrapo
Njoftim fillim punimesh	20.04.2018	-	Fusha sh.p.k Shkëlqim Fusha
Akt-dorëzimi i sheshit të ndërtimit	20.04.2018	-	- JV "51N4E" b.v.b.a & "Geosat sh.p.k" Ardian Rrapo - Fusha sh.p.k Shkëlqim Fusha - DIPP përfaqësuar nga Z. Rigels Balla - DPPP, përfaqësuar nga Z. Taulant Tusha
Proces-verbal mbi akt-piketimin në objekt	20.04.2018	-	- JV "51N4E" b.v.b.a & "Geosat sh.p.k" Ing. Ardian Rrapo - Fusha sh.p.k Adm. Shkëlqim Fusha & Ing. Ramazan Myrto
Proces-verbal mbi fillimin e punimeve	20.04.2018	-	- JV "51N4E" b.v.b.a & "Geosat sh.p.k" Ing. Ardian Rrapo - Fusha sh.p.k Adm. Shkëlqim Fusha & Ing. Ramazan Myrto - DIPP përfaqësuar nga Z. Rigels Balla - DPPP, përfaqësuar nga Z. Taulant Tusha
Preventiv i ripunuar me vlerë 53,451,621.60 lekë me TVSH	10.05.2017	V.K.T. Nr. 9	- JV "51N4E" b.v.b.a & "Geosat sh.p.k" Ing. Ardian Rrapo - Fusha sh.p.k Adm. Shkëlqim Fusha - AK, Z. Erion Veliaj
Projekti i rishikuar	10.05.2017	V.K.T. Nr. 9	- JV "51N4E" b.v.b.a & "Geosat sh.p.k" Ing. Ardian Rrapo - Fusha sh.p.k Adm. Shkëlqim Fusha - AK, Z. Erion Veliaj
Njoftim për Përfundimim punimevesh nga zbatuesi i punimeve "FUSHA" shpk	19.07.2018	125	Fusha sh.p.k përfaqësuar nga Adm. Shkëlqim Fusha
Njoftim për Përfundimim punimevesh nga mbikëqyrësi i punimeve JV "51N4E" b.v.b.a & "Geosat sh.p.k".	19.07.2018	-	JV "51N4E" b.v.b.a & "Geosat sh.p.k" Ing. Ardian Rrapo
Proces-verbal i dorëzimit të punimeve	19.07.2018	-	- Fusha sh.p.k përfaqësuar nga Adm. Shkëlqim Fusha dhe D.T Ing. Ramazan Myrto. - JV "51N4E" b.v.b.a (degë e shoqërisë së huaj & "Geosat sh.p.k" përfaqësuar nga Ing. Ardian Rrapo
Deklaratë teknike e sipërmarrësit			- D. Ligjor z. Shkëlqim Fusha - D.T i objektit z. Ramadan Myrto - Drejtuesi i punimeve, z. Genc Golemi
Relacion përfundimtar i Mbikëqyrësit, për shtesën e kontratës.			JV "51N4E" b.v.b.a (degë e shoqërisë së huaj & "Geosat sh.p.k" përfaqësuar nga Ing. Ardian Rrapo
Proces-verbali i kolaudimit	17.08.2018	-	- Fusha sh.p.k përfaqësuar nga Adm. Shkëlqim Fusha dhe D.T Ing. Ramazan Myrto - JV "51N4E" b.v.b.a (degë e shoqërisë së huaj & "Geosat sh.p.k" përfaqësuar nga Ing. Ardian Rrapo - "Tesla Vizion" shpk përfaqësuar nga D.L dhe D.T, Ing. Dëfrim Çelami
Akt-Marrje në dorëzim të objektit	-	-	-

Nga zbatuesi i punimeve "F..." SHPK si dhe nga mbikëqyrësi i punimeve JV "51N4E" b.v.b.a & "Geosat sh.p.k" për punimet e ndërtimit të kryera që i përkasin situacionit përfundimtar për shtesën e kontratës, janë mbajtur me korrektësi dokumentacioni si vijon: (Proces-verbal mbi punimet e maskuara; Akte kontrolli; Raport analize për materialet; Libreza e masave; Ditari i objektit; Foto gjatë dhe pas pune; Relacion përfundimtar i mbikëqyrësit, i mbajtur nga mbikëqyrësi i punimeve JV "51N4E" b.v.b.a & "G...h.p.k" ku është nënshkruar nga Drejtuesi Teknik Ing. Ardian Rrapo; Libri i sigurimit teknik).

**B. Likuidimi i situacioneve për punimet e kryera, rezulton.**

Punimet e kryera në objekt për kontratën bazë, janë paraqitur në situacionet pjesore si vijon: ( Situacioni pjesor nr. 1 me vlerë 31,576,800 lekë me TVSH; Situacioni pjesor nr. 2 me vlerë 158,835,720 lekë me TVSH dhe Situacioni përfundimtar me vlerë 76,850,728 lekë me TVSH).

Punimet e shtesës së kontratës, janë paraqitur në situacionin përfundimtar me vlerë 53,451,621.6 lekë me TVSH.

Nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë, është kryer likuidimi për kontratën bazë si vijon: (- Situacioni nr. 1, me USH nr. 1494, datë 20.06.2017 dhe shumë 29,997,960 lekë; -Situacioni nr. 2, me USH nr. 2822, datë 07.11.2017 dhe shumë 40,002,040 lekë; -Situacioni nr. 2, me USH nr. 816, datë 13.03.2018 dhe shumë 60,000,000 lekë; -Situacioni nr. 2, me USH nr. 1325, datë 23.04.2018 dhe shumë 40,000,000 lekë; -Situacioni nr. 2, me USH nr. 2508, datë 30.07.2018 dhe shumë 10,891,894 lekë; -Situac përfundimtar, me USH nr. 2509, datë 30.07.2018 dhe shumë 28,108,106 lekë). Situac përfundimtar, me USH nr. 3303, datë 15.10.2018 dhe shumë 10,625,208 lekë. Situacioni nr. 1, me USH nr. 650, datë 01.03.2019 dhe shumë 34,274,878 lekë

Nga situacionet e mësipërme për të dy kontratat është mbajtur 5 % e shumës për garancinë e punimeve për një periudhë 24 muaj.

### **C. Mbi auditimin e realizimit të punimeve në terren.**

Nga auditimi në terren për verifikimin e zërave të punimeve si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të administruara në dosjen teknike të zbatimit të vënë në dispozicion grupit të auditimit për punimet e kryera, rezultojnë diferenca në volume për punime të kryera në shumën prej **496,140 lekë pa TVSH**, argumentuar si vijon:

#### **PUNIME SHITESASH**

##### **Zëri 6(An) Shtresë me rezinë epokside e komponente në tualete dhe koridor.**

Në situacionin përfundimtar janë pasyruar 62.6 m<sup>2</sup> shtresë me rezinë me çmim 1500 lekë. Libreza e masave pasqyron 62.6 m<sup>2</sup> shtresë me rezinë.

Në fakt nga verifikimi mbi realizimin e këtij zëri në objekt, rezulton që ky zë punimi në sajë të cilësisë së dobët, pothuaj rezulton pa gjurmë.

Sa më sipër mos realizimi i këtij zëri sipas specifikimeve teknike, ndërkohë që është situacionuar është përfituar në mënyrë të pa drejtë nga sipërmarrësi i punimeve “Fusha” SHPK në shumën 93,900 lekë pa TVSH (62.6 m<sup>2</sup> x 1,500 lekë).

#### **PUNIME TË NDRYSHME**

##### **Zëri 1(2.410/a) Parapet shkalle e ballkone me tuba xingato.**

Në situacionin përfundimtar janë pasyruar 136.8 ml tubo me çmim 2800 lekë/ml. Libreza e masave pasqyron 136.8 ml tubo.

Në fakt nga verifikimi mbi realizimin e këtij zëri në objekt, rezulton që ky zë punimi është realizuar në kundërshtim me specifikimet teknike të përcaktuara në Dokumentet Standarde të Tenderit (DST) dhe me kushtet e kontratës së nënshkruar, sepse tubot nuk janë vendosur me material xingato siç është specifikuar dhe deklaruar për t'u zbatuar nga sipërmarrësi i punimeve.

Sa më sipër realizimi i këtij zëri, në kundërshtim me specifikimet teknike të tenderit dhe kontratës, sipërmarrësi i punimeve OE “F...” SHPK ka përfituar në mënyrë të pa drejtë 383,040 lekë pa TVSH (136.8 ml tubo x 2800 lekë/ml).

##### **Zëri 8(2.404) Bojatisje me bojë betoni plintuese.**

Në situacionin përfundimtar janë pasyruar 48 m<sup>2</sup> bojatisje me boje me çmim 400 lekë/ml. Libreza e masave pasqyron 48 m<sup>2</sup> bojatisje.

Në fakt nga verifikimi mbi realizimin e këtij zëri në objekt, rezulton që ky zë punimi nuk është realizuar fare.

Sa më sipër mos realizimi i këtij zëri, ndërkohë që është situacionuar është përfituar në mënyrë të pa drejtë nga sipërmarrësi i punimeve “F...” SHPK në shumën 19,200 lekë pa TVSH.

Për sa më sipër mosrealizimi i zërave [Zëri 6(An) Shtresë me rezinë epokside e komponente në tualete dhe në koridor; Zëri 1(2.410/a) Parapet shkalle e ballkone me tuba xingato; Zëri 8(2.404) Bojatisje me bojë betoni plintuese] sipas kushteve të kontratës dhe specifikimeve teknike në shumën **496,140** lekë pa TVSH do të konsiderohet dëm ekonomik deri në riparimin e plote të tyre brenda periudhës së garancisë së defekteve. Sipërmarrësi i punimeve “F...” SHPK duhet të vetëtojë pranë Bashkisë Tiranë, realizimin e plotë të këtyre zëra punimesh dhe realizimi të bëhet në periudhën e garancisë së punimeve. Sa më sipër nuk është në përputhshmëri me kontratën e nënshkruar dhe Dokumentet Standardte të Tenderit.

**Si përfundim në mënyrë të përmbledhur nga auditimi i dokumentacionit tekniko-ligjor të administruar në dosje dhe nga auditimi i realizimit të punimeve të ndërtimit në objekt, për kontratën “Ndërtim parkim nëntokësor, Sheshi Skënderbej” rezulton se:**

**C.1** - Sipërmarrësit të punimeve “F...” SHPK, i janë pasqyruar në situacionin përfundimtar për likuidim në shumën **496,140 lekë** pa TVSH për punime të pakryera, diferenca në volume dhe punime jo në përputhje me specifikimet teknike. *Problematikat e konstatuara nga auditimi i grupit të KLSH-së, duhet të realizohen në objekt brenda periudhës së garancisë së defekteve (Në rast të kundërt, moskryerja e punimeve sipas PZ dhe specifikimeve teknike për zërat e punimeve të pakryera, do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të zhdëmtohet nga sipërmarrësi i punimeve “F...” SHPK).*

Sa më sipër, nga ana e zbatuesit të punimeve nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në: (- *Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 8;* - *Kontratën e zbatimit me objekt “Ndërtim parkim nëntokësor, Sheshi Skënderbej”, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë së Tiranës dhe Operatorit Ekonomik “F...” SHPK dhe - Udhëzimin Nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” Kreu I “Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit”, pika 3).*

Gjithashtu, për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve Operatorit Ekonomik “51N4E” b.v.b.a & “Geosat” SHPK, sepse nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në: (- *Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7;* - *Kontratën për kryerjen e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve të kontratës me objekt “Ndërtim parkim nëntokësor, Sheshi Skënderbej” të lidhur midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë dhe shoqërisë “51N4E” b.v.b.a & “G...t” SHPK dhe - UKM Nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, të ndryshuar, pika 3.2).*

**C.2.** Objekti “Ndërtim parkim nëntokësor, Sheshi Skënderbej” është ndërtuar sipas projektit të zbatimit, kushteve teknike dhe specifikimeve teknike të evidentuara në kontratën e sipërmarrjes nr. 28253/11, datë 11.11.2016 dhe shtesës së kontratës me nr. prot. 11233/6, datë 19.04.2018 si dhe nuk ka shmangie në drejtimin funksional, të qëndrueshmërisë dhe të destinacionit.

- Janë zbatuar kondicionet urbane të përcaktuara në lejën e ndërtimit me Nr. 983/2, datë 24.11.2016 dhe është kryer sistemimi i territorit sipas gen-planit të miratuar.

- Objekti në formë, dimension, sipërfaqe e vëllim është zbatuar sipas projektit të miratuar dhe ndryshimeve të miratuara nga investitori me VKT Nr. 9, nga projektuesi dhe mbikëqyrësi i punimeve.

- Zërat e punimeve janë realizuar sipas preventivit të miratuar dhe ndryshimeve të miratuara nga projektuesi, investitori dhe mbikëqyrësi.

- Strukturat bazë/mbajtëse (seksioni punimet e betonit, beton armesë, etj) janë realizuar sipas kërkesave, materialeve e produkteve të parashikuara në projekt.

- Punimet e maskuara janë vertetuar me proces verbalet përkatëse të mbajtura midis Mbikëqyrësit dhe Sipërmarrësit të punimeve.

- Çmimet e zbatuara në situacionin përfundimtar, janë sipas çmimeve të preventivit të ofertës dhe preventivit të rishikuar të miratuar, pjesë integrale e kontratës bazë Nr. 28253/11, datë 11.11.2016.

**C.3.** Nga auditimi i dokumentacionit teknik për kontratën bazë, u konstatua se në dosje nuk është dokumentacioni mbi marrjen në dorëzim të punimeve të ndërtimit, për punimet që i përkasin kontratës bazë dhe shtesës së kontratës. Ky veprim është në kundërshtim me kontratën nr. prot. 28253/11, datë 11.11.2016, neni 38/5 ku përcaktohet se: “...Me përfundimin e procedurës së kolaudit Autoriteti Kontraktor lëshon certifikatën e marrjes në dorëzim të punimeve të kryera dhe do të fillojë garancinë e sigurimit të kontratës...”. Sa më sipër, Autoriteti Kontraktor Bashkia Tiranë, Mbikëqyrësi i punimeve, Zbatuesi i punimeve, grupi i marrjes në dorëzim si dhe kolaudatori i punimeve, të plotësojnë dosjen teknike me certifikatën e marrjes në dorëzim të punimeve të kryera në mënyrë të përkohshme dhe me kontratën nr. prot. 11233/6, datë 19.04.2018, neni 28/5 ku përcaktohet se: “...Me përfundimin e procedurës së kolaudit Autoriteti Kontraktor lëshon certifikatën e marrjes në dorëzim të punimeve të kryera dhe do të fillojë garancinë e sigurimit të kontratës...”. Sa më sipër, Autoriteti Kontraktor Bashkia Tiranë, Mbikëqyrësi i punimeve, Zbatuesi i punimeve, grupi i marrjes në dorëzim si dhe kolaudatori i punimeve, të plotësojnë dosjen teknike me certifikatën e marrjes në dorëzim të punimeve të kryera në mënyrë të përkohshme. (Gjerësisht me personat përgjegjës problemet janë trajtuar në akt-konstatimin nr. 10, datë 16.04.2019)

**IV. Zbatimi i kontratës me objekt: “Rikonstruksion i rrugës së Dibrës (farmacia 10 - Oxhaku)”, ku rezultoi:**

Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës me objekt: “Rikonstruksion i rrugës së Dibrës (farmacia 10 - Oxhaku)” të lidhur ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe sipërmarrësit të punimeve “C...” SHPK, u konstatua se zëri i punimeve “Zëri 3 (3.158/5a ) Transport dheu me auto deri në 5 km” në seksionin e preventivit (Punime të ndryshme, prishje, spostime, dhe punime asfaltimi), është likuiduar për punime të kryera dy herë, përkatësisht si zë punimi më vetë dhe nën zë punime në shumën **421,824 lekë pa TVSH** duke shkaktuar efekt financiar negativ ndaj buxhetit të shtetit dhe njësië vendore. Sa më sipër nuk është në përputhshmëri me paragrafin e tretë të nenit 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” Kreu I, pika 3.

**A. Mbi kontratën e zbatimit të punimeve, mbikëqyrjes të punimeve si dhe realizimi i grafikut të punimeve.**

- Kontrata e zbatimit me objekt: “Rikonstruksion i rrugës së Dibrës (farmacia 10 - Oxhaku)”, është lidhur me datë 09.06.2017 dhe nr. prot. 12719/6, ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Tiranë, përfaqësuar nga Z. Erion Veliaj dhe Operatorit Ekonomik “C...” SHPK përfaqësuar nga përfaqësuesi i posaqëm i shoqërisë z. Kujtim Kola. Vlera e kontratës bazë është 80,703,912 lekë me TVSH. Afati i realizimit të punimeve do të jetë 6 (gjashtë) muaj kalendarikë duke nisur nga data e lidhjes së kontratës. Periudha e garancisë do të jetë 24 muaj, duke filluar nga data e marrjes në dorëzim të punimeve.

- Për kryerjen e shërbimit të mbikëqyrjes të punimeve të kontratës me objekt: “Rikonstruksion i rrugës së Dibrës (farmacia 10 - Oxhaku) është lidhur kontrata e shërbimit me nr. prot. 22467/2, datë 06.06.2017, ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Tiranë, përfaqësuar nga Z. Erion Veliaj dhe OE “Z...” SHPK përfaqësuar nga z. R.T me liçencë NR. MK 1208/8.

- Për kryerjen e shërbimit të kolaudit të punimeve të kontratës me objekt: “Rikonstruksion i rrugës së Dibrës (farmacia 10 - Oxhaku) është lidhur kontrata e shërbimit me nr. prot. 9867/2, datë 13.03.2018, ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Tiranë, përfaqësuar nga Z. Erion Veliaj dhe OE “D...” SHPK përfaqësuar nga zj. S.G. me liçencë NR. MK 3019.

Informacioni i përgjithshëm mbi zbatimin e kontratës bazë jepet siap tabelës:

Të dhëna të përgjithshme mbi dokumentacionin tekniko-ligjor	Nr. Prot.	Data	Palët e angazhuara dhe siglimet
Kontrata e sipërmarrjes, vl =80,703,912 Lekë me TVSH	12719/6	09.06.2017	- AK, përfaqësuar nga z. Erion Veliaj - sipërmarrësi “Company Riviera 2008” SHPK përfaqësuar nga Z. Kujtim Kola.
Akt-Marrëveshje për zgjatje afati punimesh për 4 muaj kalendarik deri me	42551/2	05.12.2017	- AK, përfaqësuar nga z. Erion Veliaj - sipërmarrësi “Company Riviera 2008” SHPK

datë <b>09.01.2018</b>			përfaqësuar nga Z. Kujtim Kola.
Akt-Marrëveshje për zgjatje afati punimesh për 4 muaj kalendarik deri me datë <b>09.02.2018</b>	916/1	08.01.2018	- AK, përfaqësuar nga z. Erion Veliaj - sipërmarrësi “Company Riviera 2008” SHPK përfaqësuar nga Z. Kujtim Kola.
Akt-Marrëveshje për zgjatje afati punimesh për 4 muaj kalendarik deri me datë <b>09.03.2018</b>	4390/2	09.02.2018	- AK, përfaqësuar nga z. Erion Veliaj - sipërmarrësi “Company Riviera 2008” SHPK përfaqësuar nga Z. Kujtim Kola.
Kontratë mbikëqyrjesh punimesh	22467/2	06.06.2017	- AK, përfaqësuar nga z. Erion Veliaj - mbikëqyrësi “Zenit & CO” SHPK përfaqësuar nga Z. Rexhep Tarba.
Kontratë shërbim kolaudimi	9867/2	13.03.2018	- kolaudatori “Diper” SHPK përfaqësuar nga D.L Zj. Stela Guxo
Njoftim fillim punimesh nga sipërmarrësi	-	09.06.2017	-Sipërmarrësi “Company Riviera 2008” shpk, D. Ligjor z. Agim Kola
Njoftim për fillim punimesh nga mbikëqyrësi	-	09.06.2017	- mbikëqyrësi “Zenit&CO” SHPK përfaqësuar nga Z. Rexhep Tarba.
Akt-dorëzimi i sheshit të ndërtimit	-	09.06.2017	-Sipërmarrësi “Company Riviera 2008” shpk, D. Ligjor z. Agim Kola - mbikëqyrësi “Zenit& CO” SHPK përfaqësuar nga Z. Rexhep Tarba. - Për investitorin: DPPP z. Taulant Tusha dhe DIPP z, Rigels Balla
Proces-verbal mbi fillimin e punimeve në objekt (sipërmarrës + mbikëqyrës)	-	09.06.2017	-Sipërmarrësi “Company Riviera 2008” shpk, D. Ligjor z. Agim Kola - mbikëqyrësi “Zenit& CO” SHPK përfaqësuar nga Z. Rexhep Tarba.
Proces-verbal mbi Akt-piketimin në objekt	-	09.06.2017	-Sipërmarrësi “Company Riviera 2008” shpk, D. Ligjor z. Agim Kola dhe D.T Ing. Ilir Kaçaku. - mbikëqyrësi “Zenit&CO” SHPK përfaqësuar nga Z. Rexhep Tarba.
Projekt fillestar i Zbatimit i Miratuar	VKT Nr. 7/1	12.01.2017	Miratuar nga Kryetari i AK, Z. Erion Veliaj. -Hartuar nga “C.E.C Group” shpk dhe “Argi” shpk
Projekti i zbatimi i rishikuar	VKT Nr. 22/2	15.12.2017	Miratuar nga Kryetari i AK, Z. Erion Veliaj.
Preventiv i rishikuar, VL = 80,703,912 lekë me TVSH.	VKT Nr. 22/2	15.12.2017	- Miratuar nga Kryetari i AK, Z. Erion Veliaj. Hartuar nga: -Sipërmarrësi “Company Riviera 2008” shpk, D. Ligjor z. Agim Kola dhe D.T Ing. Ilir Kaçaku. - mbikëqyrësi “Zenit & CO” SHPK përfaqësuar nga Z. Rexhep Tarba.
Njoftim për Përfundimim punimevesh nga zbatuesi i punimeve	-	09.03.2018	-Sipërmarrësi “Company Riviera 2008” shpk, D. Ligjor z. Agim Kola
Njoftim për Përfundimim punimevesh nga mbikëqyrësi i punimeve	-	09.03.2018	- mbikëqyrësi “Zenit-06” SHPK përfaqësuar nga Z. Rexhep Tarba.
Proces - verbal për Përfundimim punimevesh	-	09.03.2018	-Sipërmarrësi “Company Riviera 2008” shpk, D. Ligjor z. Agim Kola dhe D.T Ing. Ilir Kaçaku. - mbikëqyrësi “Zenit & Co” SHPK përfaqësuar nga D.L Zj. Luiza Tarba dhe D.T Ing. Gani Shehaj.
Deklarate Teknike e sipërmarrësit	-	09.03.2018	-Sipërmarrësi “Company Riviera 2008” shpk, D. Ligjor z. Agim Kola dhe D.T Ing. Ilir Kaçaku
Relacion përfundimtar i mbikëqyrësit			- mbikëqyrësi “Zenit & Co” SHPK përfaqësuar nga D.L Zj. Luiza Tarba
Proces-verbali i kolaudimit të punimeve	-	30.03.2018	- kolaudatori “Diper” SHPK përfaqësuar nga D.L Zj. Stela Guxo

## **B. Likuidimi i situacioneve për punimet e kryera, rezulton.**

Për punimet e kryera në objekt janë paraqitur në ditacionin pjesor nr. 1, me vlerë 29,821,302 lekë me TVSH. Situacioni përfundimtar i punimeve për periudhën nëntor 2017 deri Mars 2018 ka shumën 50,882,609 lekë me TVSH.

## **C. Mbi auditimin e realizimit të punimeve në terren.**

Nga auditimi në terren për verifikimin e zërave të punimeve si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolauditimit të administruara në dosjen teknike të zbatimit të vënë në dispozicion grupit të auditimit për punimet e kryera, rezultojnë diferenca në volume për punime të kryera në vlerën prej **421,824** lekë pa TVSH, argumentuar si vijon:

### **PUNIME TË NDRYSHME (PRISHJE, SPOSTIME, Etj)**

#### **Zëri 3 (3.158/5a ) Transport dheu me auto deri në 5 km.**

Situacioni përfundimtar, pasqyron 1,505 m<sup>3</sup> transport dheu gjithsej, me çmim 208 lekë. Volumi i transportit të dheut prej 1,505 m<sup>3</sup> paraqitet: (1,420 m<sup>3</sup> “prishje trotuar, bordura dhe kuneta betoni” + 85 m<sup>3</sup> “shrishje shtresa betoni”).

Libreza e masave pasqyron volumin 1,505 m<sup>3</sup> transport dheu, ku trajtohet në mënyrë të detajuar.

Nga auditimi i analizës së çmimit të zërit 1(2.426/5) “Prishje trotuar, bordura dhe kuneta betoni” dhe i zërit 2(2.426/3) “Prishje shtresa betoni”, konstatohet se transporti është përfshirë si nën zë punimi brenda çmimit të analizave të mësipërme, si rrjedhojë zëri i punimeve transport nuk mund të paguhet 2(dy) herë përkatësisht: si nën zë punimi tek analiza e zërave “Prishje trotuar, bordura dhe kuneta betoni” dhe “Prishje shtresa betoni” si dhe zëri “Transport dheu me auto deri 5.0 km”

Sa më sipër trajtuar, ky zë punimi është librezuar dy herë, dhe është përfituar në likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë të parregullt nga sipërmarrësi “Company Riviera 2008” SHPK në vlerën **313,040 lekë pa TVSH** [1,505 m<sup>3</sup> x 208 lekë].

### **PUNIME ASFALTIMI**

#### **Zëri 8 (3.158/5a ) Transport dheu me auto deri në 5 km.**

Situacioni përfundimtar, pasqyron 523 m<sup>3</sup> transport dheu gjithsej, me çmim 208 lekë. Volumi i transportit të dheut prej 523 m<sup>3</sup> paraqitet materialin e skarifikuar për sipërfaqen 13,075 m<sup>2</sup> të zërit 1 “Skarifikim shtresë asfalti t= 4 cm me makineri (asfalt ekzistues”).

Libreza e masave pasqyron volumin 523 m<sup>3</sup> transport dheu, ku trajtohet në mënyrë të detajuar.

Nga auditimi i analizës së çmimit të zërit 1 “Skarifikim shtresë asfalti t= 4 cm me makineri”, konstatohet se transporti është përfshirë si nën zë punimi brenda çmimit të analizës së mësipërme, si rrjedhojë zëri i punimeve transport nuk mund të paguhet 2(dy) herë përkatësisht: si nën zë punimi tek analiza e zërit “Skarifikim shtresë asfalti t= 4 cm me makineri” si dhe zëri “Transport dheu me auto deri 5.0 km”

Sa më sipër trajtuar, ky zë punimi është librezuar dy herë, dhe likuidimi i tij në situacionin përfundimtar në vlerën **108,784 lekë pa TVSH** [523 m<sup>3</sup> x 208 lekë] do të ishte i parregullt.

### **Si përfundim në mënyrë të përmbledhur nga zbatimi i punimeve për objektin “Rikonstruksion i rrugës së Dibrës” (farmacia 10 - OXHAKU) rezulton se:**

Sipërmarrësit të punimeve “C...” SHPK i janë likuiduar tepër për punime të pakryera në vlerën **421,824 lekë pa TVSH, vlerë që përbën efekt financiar negativ** ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, dhe duhet të zhdëmtohet nga sipërmarrësi i punimeve.

Nga ana e zbatuesit të punimeve nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në: (-Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 8; -Kontratën e zbatimit me objekt “Rikonstruksion i rrugës së Dibrës (farmacia 10 - OXHAKU), të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë së Tiranës dhe Operatorit Ekonomik “C...” SHPK dhe -Udhëzimin Nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” Kreu I “Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit”, pika 3).

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve Operatorit Ekonomik “Z...” SHPK, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në: (-Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin



dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7; -Kontratën për kryerjen e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve të kontratës me objekt “Rikonstruksion i rrugës së Dibrës (farmacia 10 - Oxhaku) të lidhur midis Autoritetit Kontraktor Bashkisë Tiranë dhe shoqërisë “Z...” SHPK dhe -UKM Nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, të ndryshuar, pika 3.2).

Shqyrtimi dhe vlerësimi i komenteve të mbikëqyrësit të punimeve (përcjellë në mënyrë elektronike me datë 23.04.2019 dhe nr. prot. 51) mbi Akt-Konstatimin Nr. 11, datë 16.04.2019 të mbajtur nga grupi i auditimit të KLSH-së, në zbatim në nenit 32, të Rregullores së Procedurave të Auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit (miratuar me vendim të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit Nr. 107, datë 08.08.2017 “Për miratimin e rregullores së procedurave të auditimit në kontrollin e lartë të shtetit” është trajtuar si vijon:

**a-Argumente dhe komente nga subjekti i audituar u trajtua si vijon:**

Mbikëqyrësi i punimeve shoqëria “Z...” sh.p.k pretendon se lidhur me diferencat në volume për punime të kryera në shumën 421,824 lekë pa TVSH, nuk është dakord se nga mbikëqyrësi nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore kontraktuale dhe se mbikëqyrësin nuk e ngarkon me përgjegjësi.

**b-Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:**

Grupi i auditimit pasi e lexoi me kujdes observacionin sqaron se:

Mbikëqyrësi i punimeve pavarësisht se ka zbatuar preventivin e punimeve të kontratës, është personi kryesor përgjegjës mbi miratimin ose jo të ndryshimeve në preventivin e punimeve si dhe në projektin e zbatimit. Ju kujtojmë se sipërmarrësi i punimeve ka propozuar disa ndryshime në projektin e zbatimit dhe preventivin e punimeve, propozime të cilat janë miratuar nga Mbikëqyrësi i punimeve dhe në vijim janë miratuar nga Këshilli Teknik i Bashkisë me V.K.T Nr. 22/2, datë 15.12.2017 dhe bazuar në KPK, Neni 25 (Preventivi) kontrata përfshin një preventiv për njësi dhe preventivi i ndryshuar(ripunuar) do të përdoret për të llogaritur vlerën e kontratës. Kontraktori paguhet me sasinë e punës së kryer sipas projektit (bazë/ripunuar) bazuar për çdo zë pune të preventivit me çmimin në njësi për secilin zë punimesh. Pra mbikëqyrësi i punimeve për zërat e punimeve që dublohen (në rastin konkret, zëri transport dheu), duhet të kryejë sistemimet në preventivin e ndryshuar me volumet e punimeve që shtohen dhe që zbriten, pra mbikëqyrësi i punimeve mund të propozojë heqjen e zërave të përsërituara ose mund të shtojë zëra të rinjë me analiza teknike për çdo zë të ri pune e cila i paraqitet mbikëqyrësit të punimeve nga kontraktori dhe mbikëqyrësi ia çon për miratim Autoritetit Kontraktor. Sa më sipër shpjeguar, observacioni Juaj nuk merret në konsideratë.

(Gjerësisht me personat përgjegjës problemet janë trajtuar në akt-konstatimin nr. 11, datë 16.04.2019)

**V. Zbatimi i kontratës me objekt: “Parkimi Nëntokësor te Sheshi Italia”, ku rezultoi:**

Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës me objekt: “Parkimi Nëntokësor te Sheshi Italia” të lidhur ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe sipërmarrësit të punimeve “A...” SHPK, u konstatua se zëri i punimeve “Zëri 4 (3.158/5a ) Transport dheu me auto deri në 5 km, është likuiduar për punime të pakryera, duke u likuiduar dy herë, përkatësisht si zë punimi më vetë dhe nën zë punimi, në shumën **233,722 lekë pa TVSH** duke shkaktuar efekt financiar negativ ndaj buxhetit të shtetit dhe njësië vendore. Sa më sipër nuk është në përputhshmëri me paragrafin e tretë të nenit 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” Kreu I, pika

Të përgjithshme: Projekti i zbatimit për objektin “Parkimi Nëntokësor te Sheshi Italia” është hartuar nga studiot e projektimit si vijon: (-Projekti arkitektonik, është hartuar nga studio “S...” SHPK, përfaqësuar nga Ark. D.G. dhe nga studio “A...” Firenze Italy, përfaqësuar nga arkitetët: M.C.dhe G.P.; -Projekti struktural, është hartuar nga studio “A...” SHPK, Tiranë, Albania, përfaqësuar nga: Ing. A..D dhe Ing. E.P.; -Projekti i impianteve/hidroteknik, është hartuar nga studio “A...” SHPK, Tiranë, Albania, përfaqësuar nga: Ing. A.K.; -Projekti elektrik, është hartuar nga shoqëria “E...” SHPK, Tiranë, përfaqësuar nga Ing. S.A.; -Projekti MNZSH, është hartuar nga shoqëria “E...” SHPK, Tiranë, përfaqësuar nga Ing. A.D.). Projekti i zbatimit është miratuar me V.K.T. Nr. 19, datë 27.10.2017. Lidhur me PZ është bërë një studim i rrezikut sizmik të sheshit të ndërtimit të stadiumit të

ri në Tiranë dhe përreth në periudhën Maj-Qershor 2016, nga shoqëria “G...” SHPK Tiranë, me Licencë Nr. 6399/2 me përfaqësues logjor z. N.K. dhe drejtues teknik z. L.D.. Specifikimet teknike dhe relacioni teknik për objektin “Parkimi Nëntokësor te Sheshi Italia” janë përgatitur si vijon: (Ark. D.G., Ark G.P> dhe Ark. M.C. për Punime Arkitektonike; Ing. A.D. dhe Ing. E.P.për Punime Konstruksioni; Ing. A.K.për Punime Hidroteknike; Ing. Se.A. për Punime Elektrike;Ing. A.D. për Punime MNZSH).

**A. Mbi kontratën e zbatimit të punimeve dhe mbikëqyrjes të punimeve si dhe realizimi i grafikut të punimeve.**

- Kontrata e zbatimit me objekt “Parkimi Nëntokësor te Sheshi Italia”, është lidhur me datë 23.03.2018 dhe nr. prot. 3306/3, ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë së Tiranës, përfaqësuar nga z. Erion Veliaj dhe Operatorit Ekonomik “A...” SHPK përfaqësuar nga Z. E.S. Vlera e kontratës është 396,846,381 lekë me TVSH. Sipas nenit 3 (Afati i kontratës) të kontratës, afati i realizimit të punimeve do të jetë 12 (dymbëdhjetë) muaj kalendarikë nga data e nënshkrimit të kontratës. Periudha e garancisë së punimeve (neni 29 i kontratës) do të jetë 24 muaj kalendarik. Drejtuesi teknik i punimeve në objekt është ngarkuar z. T.O..

- Për kryerjen e shërbimit të mbikëqyrjes të punimeve të kontratës me objekt “Parkimi Nëntokësor te Sheshi Italia” është lidhur kontrata e shërbimit me nr. prot. 8555/16, datë 19.04.2018, me OE “Z/////” SHPK, me objekt “Mbikëqyrja e punimeve të disa objekteve të infrastrukturës në qytetin e Tiranës për vitin 2017, Loti i dytë: “Parkimi Nëntokësor te Sheshi Italia” me MK. 1208/8 me drejtues ligjor z. F/T. Vlera e mbikëqyrjes në objekt është 2,340,900 lekë me TVSH.

- Mbikëqyrësi i punimeve “Z...” SHPK me datë 23.05.2018 i është drejtuar me shkresë AK, lidhur me problematikën e konstatuar nga zhornimi paraprak, ku ka rezultuar se Plan vendosja e parkimit në perendim të objektit mbivendoset me shkallët e Muzeut Arkeologjik, Rektoratit dhe Sheshit midis kollonave duke u bërë pengesë për ndërtimin e pilotave sepse hapësira për kryerjen e punimeve kërkon çmontimin e të gjitha shkallëve. Sa më sipër ka patur një shkëputje të punimeve deri me datë 18.06.2018.

Informacioni i përgjithshëm mbi zbatimin e kontratës jepet siaps tabelës:

Të dhëna	Data	Nr. Prot.	Palët e angazhuara dhe siglimet
Kontratë e zbatimit të punimeve	23.03.2018	3306/3	- Bashkia Tiranë, përfaqësuar nga Kryetari z. Erion Veliaj - Kontraktori “ALB-STAR” shpk, përfaqësuar nga D. L, Z. Edmond Spahiu
Kontratë mbikëqyrje punimesh	19.04.2018	8555/16	- Bashkia Tiranë, përfaqësuar nga Kryetari z. Erion Veliaj - Mbikëqyrësi “ZENIT&Co” përfaqësuar nga z. Fejzulla Tarba
Kontratë kolaudimi	-	-	-
Njoftim fillim punimesh nga mbikëqyrësi	23.03.2018	-	-mbikëqyrësi “ZENIT&Co” përfaqësuar nga z. Fejzulla Tarba
Njoftim fillim punimesh, nga sipërmarrësi	07.05.2018	175	- Kontraktori “ALB-STAR” shpk, përfaqësuar nga D. L, Z. Edmond Spahiu
Akt-dorëzimi i sheshit të ndërtimit	19.04.2018	-	- Kontraktori “ALB-STAR” shpk, përfaqësuar nga D. L, Z. Edmond Spahiu - OE “ZENIT&Co” përfaqësuar nga z. Fejzulla Tarba
Proces-verbal mbi akt-piketimin në objekt	19.04.2018	-	OE “ZENIT&Co” përfaqësuar nga zj. Luiza Tarba dhe D.T, ing. Gani Shehaj - Kontraktori “ALB-STAR” shpk, përfaqësuar nga D. L, Z. Edmond Spahiu dhe Ing. Gjeodet, Top. Petraq Dhemi.
Proces-verbal mbi fillimin e punimeve	19.04.2018	-	- OE “ZENIT&Co” përfaqësuar nga z. Fejzulla Tarba - Kontraktori “ALB-STAR” shpk, përfaqësuar nga D. L, Z. Edmond Spahiu - DIPP përfaqësuar nga Z. Rigels Balla - DPPP, përfaqësuar nga Z. Taulant Tusha

Nga zbatuesi i punimeve "A//'" SHPK si dhe nga mbikëqyrësi i punimeve për punimet e ndërtimit të kryera që i përkasin situacionit pjesor nr. 1 dhe nr. 2, janë mbajtur me korrektësi dokumentacioni si vijon: [Pashaportë Ankerat me ø 140 mm; Test raportet për kubikët e betonit për (Pilota; pllaka e themelit; shtresë nën pllakën e themelit; kollonat; mure b/a, murin hark;), testuar në laboratorin e akredituar SARP & LAB; Test raportet për shufrat e çelikut për beton, testuar në laboratorin e akredituar SARP & LAB; Ditari i punimeve; Procesverbalet mbi punimet e maskuara; Pashaportë teknike për pilotat; Libri i instruktimit periodik të punonjësve mbi rregullat e sigurisë në punë].

#### **B. Likuidimi i situacioneve për punimet e kryera, rezulton.**

Punimet e kryera në objekt janë paraqitur në situacionet pjesore si vijon: (Situacioni pjesor nr. 1 me vlerë 57,606,459 lekë me TVSH dhe Situacioni pjesor nr. 2 me vlerë 88,919,489.88 lekë me TVSH). Nga situacionet pjesore është mbajtur 5% e shumës për garancinë e punimeve për një periudhë 24 muaj. Nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë, është kryer likuidimi si vijon: (-Situacioni nr. 1, me Urdher Shpenzimi nr. 3644, datë 05.11.2018 dhe shumë 54,726,136 lekë; -Situacioni nr. 2, me Urdher Shpenzimi nr. 932, datë 19.03.2019 dhe shumë 84,473,515 lekë). Nga zbatuesi dhe mbikëqyrësi i punimeve janë hartuar situacioni nr. me vlerë 88,867,908.39 lekë dhe situacioni nr. 4 me vlerë 42,331,631,31 lekë.

#### **C. Mbi auditimin e realizimit të punimeve në terren.**

Nga auditimi në terren për verifikimin e zërave të punimeve si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të administruara në dosjen teknike të zbatimit të vënë në dispozicion grupit të auditimit për punimet e kryera, rezultojnë diferenca në volume për punime të kryera në vlerën prej **233,722** lekë pa TVSH.

Argumentimi i kësaj difference në volume punimesh, pasqyrohet si vijon:

#### **Zëri 4 (3.158/5a ) Transport dheu me auto deri në 5 km.**

Situacioni pjesor nr. 1, pasqyron volumin 18,201.45 m<sup>3</sup> transport dheu gjithsej, me çmim 402 lekë pa TVSH. Volumi i transportit të dheut prej 18,201.45 m<sup>3</sup> paraqitet: (581.4 m<sup>3</sup> "prishje shtresa të ndryshme betoni" + 17,620.05 m<sup>3</sup> "Germim dheu themele e plinta me h>2m, eskavator dhe zinxhirë 1.0 m<sup>3</sup>, shkarkim në tokë").

Libreza e masave pasqyron volumin 18,989.45 m<sup>3</sup> transport dheu, ku trajtohet në mënyrë analitike.

Nga auditimi i analizës së çmimit të zërit "Prishje shtresa të ndryshme betoni" konstatohet se transporti është përfshirë si nën zë punimi brenda çmimit të analizës, si rrjedhojë zëri i punimeve transport nuk mund të paguhet 2(dy) herë përkatësisht: si nën zë punimi tek analiza e zërit "Prishje të ndryshme betoni" dhe në zërin (3.158/5a) "Transport dheu deri në 5 km".

Sa më sipër trajtuar, ky zë punimi është libezuar dy herë, dhe është përfituar në likuidimin e situacionit pjesor nr. 1, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi "A..." SHPK në vlerën **233,722.8 lekë pa TVSH** [581.4 m<sup>3</sup> x 402 lekë].

Shqyrtimi dhe vlerësimi i komenteve të mbikëqyrësit të punimeve (përcjellë në mënyrë elektronike me datë 23.04.2019 dhe nr. prot. 50), në zbatim në nenit 32, të Rregullores së Procedurave të Auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit (miratuar me vendim të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit Nr. 107, datë 08.08.2017 "Për miratimin e rregullores së procedurave të auditimit në kontrollin e lartë të shtetit" është trajtuar si vijon:

#### **a-Argumente dhe komente nga subjekti i audituar u trajtua si vijon:**

1. Mbikëqyrësi i punimeve shoqëria "Z..." sh.p.k pretendon se pavarësisht se kontrata e sipërmarrësit është lidhur me datë 23.03.2018, kjo kontratë hyn në fuqi dhe fillon efektet tekniko-ligjore-financiare në datën e nënshkrimit të kontratës së mbikëqyrjes, me afat 12 muaj kalendarike nga data e hyrjes në fuqi, dhe meqenëse kontrata me mbikëqyrësin është lidhur me datë 19.04.2018 dhe në zbatim të nenit 3, të kontratës për punimet e ndërtimit, punimet duhet të përfundojnë me datë 19.04.2019.

2. Gjithashtu mbikëqyrësi pretendon se referuar analizës teknike të projektuesit diferenca në volume për punime të kryera në vlerë 233,722 lekë pa TVSH, nuk qëndron:

#### **b-Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:**

Grupi i auditimit pasi e lexoi me kujdes observacionin sqaron se:

**1.** Në dosjen teknike të zbatimit u gjenden dokumente të ndryshme, ku u vërejt se punimet e ndërtimit kishin filluar me datë 23.03.2018 sipas mbikëqyrësit “Z...” përfaqësuar nga z. F.T.; kishin filluar me datë 07.05.2018 sipas zbatuesit të punimeve shoqërisë “A...” shpk, përfaqësuar nga D. L, Z. E. S.; kishin filluar me datë 19.04.2018, etj..pra nga grupi i auditimit u vërejt një parregullsi në mbajtjen e dokumentacionit mbi fillimin e punimeve.

**2.** Kerkesat e mbikëqyrësit të punimeve drejtuar Bashkisë Tiranë për shtyrje të afatit të punimeve përkatësisht me shkresën nr. prot. 14940, datë 05.04.2019 dhe shkresën nr. prot. 15337, datë 09.04.2019 për miratimin e ndryshimeve të projekt preventivit janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II “Zbatim i punimeve të ndërtimit”, pika 9 ku thuhet se: “Në rastet kur sipërmarrësi nuk është në gjendje të respektojë afatin e kryerjes së punimeve për shkaqe që nuk varen prej tij, ai i paraqet mbikëqyrësit, të paktën dy muaj para përfundimit të afatit, një kërkesë propozim për shtyrje afati dhe seksionit përkatës të urbanistikës një kërkesë për zgjatjen e afatit të lejes së ndërtimit”. Sa më sipër edhe pse kerkesat janë bërë brenda afatit të përfundimit të punimeve (datë 19.04.2019) bie në kundërshtim me udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005. Gjithashtu, Ju kujtojmë se periudha nga data 09.04.2019 deri 19.04.2019 përfundimi i kontratës, është kohë e pamjaftueshme për të miratuar ndryshimet e projektit dhe preventivit të punimeve, nga Këshilli Teknik i Bashkisë. Observacionit i janë bashkëlidhur dokumente, të cilat janë audituar nga grupi i auditimit të KLSH-së, por janë dhëne argumente se si është vepruar pas datës së përfundimit të punimeve 19.04.2019!

**3.** Emertimi i analizës teknike nga shoqëria projektuese “AVE Consulting” SHPK për zërin “Analize. Prishje shtresa të ndryshme (Asfaltike + beton nën të)” me çmim 3,505.78 lekë pa TVSh është emërtuar ndryshe në preventivin e punimeve dhe konkretisht “Analize. Prishje shtresa të ndryshme betoni, me çmim 2,139 lekë pa TVSH”. Gjithashtu në zërin (3.158/5a) përfshihet vetëm transport dheu me auto deri në 5 km. Sa më sipër trajtuar, grupi i auditimit nuk e merr në konsideratë observacionin Tuaj, sepse nuk ka fakte dhe argumente që provojnë të kundërtën.

**Si përfundim në mënyrë të përmblodhur mbas shqyrtimit të observacionit të paraqitur nga mbikëqyrësi i punimeve, nga auditimi për objektin “Parkimi Nëntokësor te Sheshi Italia” rezulton se:**

1- Sipërmarrësit të punimeve i janë likuiduar tepër për punime të pakryera në vlerën **233,722 lekë pa TVSH, vlerë që përbën efekt financiar negativ** ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore Bashkisë Tiranë, dhe duhet të zhdëmtohet nga sipërmarrësi i punimeve “A...” SHPK.

2- Auditimi mbi realizimin e punimeve të ndërtimit i përket periudhës nga fillimi i punimeve datë 23.03.2018 deri me datë 31 dhjetor 2018, periudhë për përkon me situacionet pjesore 1, 2 dhe 3. Në fakt nga auditimi i punimeve në terren rezulton se kanë përfunduar punimet në masën rreth 70 % ose në shumën 277,725,488.110 lekë dhe konkretisht janë kryer:

Nr.	Zëri i punimeve	Vlera preventivit Sipas në lekë	Vlera Sipas faktit në lekë	% e realizimit
1	Punime për mbrojtjen e objekteve	40,833,922.2	38,035,180.598	93.15
2	Punime dheu dhe prishje asfalti	16,183,349.4	15,271,235.80	94.36
3	Punime shtresash nën themel	3,473,848	3,368,866.7	96.98
4	Punime betoni dhe betonarmeje	179,742,898.70	168,216,803.10	93.59
5	Punime shtresash dhe hidroizolimi	13,396,471	6,545,820.56	48.86
6	Punime dyer dhe dritare	18,838,090.3	-	0.00
7	Punime hidroteknike Sistemi i kullimit	1,804,135	-	0.00
8	Pajisjet për hidroteknike	2,274,698	-	0.00
9	Punime elektrike: -a. Kabinat elektrike -b. Kabllot e shperndarjes	11,152,569.00	-	0.00

	-c. Të përgjithshme. Priza, Ndrëçim dhe Rrjet -d. Sistemi i detektimit të zjarrit. -e. Sistemi i detektimit CO & NO2 -f. Evakuimi zanor -g. Sistemi i menaxhimit të parkingut -h. Sistemi CCTV -i. Sistemi i Ekuipotencialit dhe Tokëzimit			
10	Punime elektrike	17,811,759.00	-	0.00
11	A. Impjanti MNZ B. Tubacione të impjantit MNZ C. Pajisje të impjantit MNZ D. Punime montimi të pajisjeve të Impjantit të Ventilimit Mekanik E. Pajisje të Impjantit të Ventilimit Mekanik	11,610,652	-	0.00

3- Mbikëqyrësi i punimeve “Z...” SHPK me shkresën me Nr. Prot. 14940, datë 05.04.2019 i është drejtuar Bashkisë Tiranë me një kërkesë për shtyrje afati për arsyet si vijon  
- Vonesave në lirim të sheshit të ndërtimit

- Ndërprerjes së punimeve për shkak të kushteve atmosferike reshje shiu gjithsej 33 ditë, dhe sa më sipër kërkohet shtyrja me 60 ditë kalenderike nga data e përcaktuar sipas kontratës.

3.1- Mbikëqyrësi i punimeve “Z...” SHPK me shkresën me Nr. Prot. 15337, datë 09.04.2019 i është drejtuar Bashkisë Tiranë me një kërkesë për miratim të ndryshimeve të projekt preventiv, ku: janë paraqitur për shqyrtim në Këshillin Teknik këto materiale teknike: ( Relacion teknik mbi projekt preventivin e ndryshuar; Projekti i ndryshuar; Tabela e ndryshimeve të volumeve brenda vlerës së kontratës; Preventivi i rishikuar brenda vlerës së kontratës dhe Analiza çimesh për zërat e rinj).

3.2- Firma projektuese “A...” SHPK me shkresën Nr. Prot. 13767, datë 28.03.2019 ka përcjellë shkresën me 3 kopje të dokumentacionit si më poshtë:

- Relacion shpjegues mbi ndryshimin e projektit të parkimit të Sheshit Italia.
- Projektin Arkitektonik i Rishikuar.
- Projektin Konstruktiv të Rishikuar
- Projektin Elektrik të Rishikuar
- Projektin Hidroteknik të Rishikuar
- Projektin MNZ të Rishikuar

Sa më sipër lidhur me pikat (3; 3.1 dhe 3.2) është në kundërshtim me kontratën e nënshkruar ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë dhe sipërmarrësit të punimeve “A...” SHPK, sepse të gjitha propozimet për ndryshime janë bërë jashtë afatit të përfundimit të punimeve.

Nga ana e zbatuesit të punimeve nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në: (- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 8; - Kontratën e zbatimit me objekt “Parkimi Nëntokësor të Sheshit Italia”, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë së Tiranës dhe Operatorit Ekonomik “A...” SHPK dhe -Udhëzimin Nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” Kreu I “Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit”, pika 3).

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve Operatorit Ekonomik “Z...” SHPK , sepse nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në: (- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7; - Kontratën për kryerjen e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve të kontratës me objekt objekt “Parkimi Nëntokësor të Sheshit Italia” të lidhur midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë dhe shoqërisë “Z...” SHPK dhe - UKM Nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, të ndryshuar, pika 3.2).

(Gjerësisht me personat përgjegjës problemet janë trajtuar në akt-konstatimin nr. 12, datë 16.04.2019)

**VI.** Zbatimi i kontratës me objekt: “Ndërtimi dhe rikonstruksioni i rrugës “Selaudin Bekteshi”, ku rezultoi:

Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës me objekt: “Ndërtimi dhe rikonstruksioni i rrugës “Selaudin Bekteshi” të lidhur ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe sipërmarrësit të punimeve “A...” SHPK, u konstatua se zërat e punimeve si vijon: Zëri 4 (3.212/c) Shtresë stabilizanti t=15 cm dhe Zëri 6 (3.226/1) Shtresë asfaltbetoni me granil gur kave, 4 cm, me makineri, janë likuiduar për punime të pakryera dhe diferenca në volume në shumën **699,396 lekë pa TVSH** duke shkaktuar efekt financiar negativ ndaj buxhetit të shtetit dhe njësië vendore. Sa më sipër nuk është në përputhshmëri me paragrafin e tretë të nenit 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” Kreu I, pika 3.

Të përgjithshme: Objekti “Ndërtimi dhe rikonstruksioni i rrugës “Selaudin Bekteshi” shtrihet në pjesën lindore të qytetit të Tiranës dhe ka një gjatësi prej 750 ml. Nga pikëpamja urbane bën pjesë në zonat informate dhe objektet janë të vendosur në formë të çrregullt, densiteti i ndërtimit është i lartë dhe hapësirat publike pothuaj mungojnë tërësisht.

#### **A. Mbi kontratën e zbatimit të punimeve, mbikëqyrjes dhe kolaudit të punimeve si dhe realizimit të grafikut të punimeve.**

- Kontrata e zbatimit me objekt “Ndërtimi dhe rikonstruksioni i rrugës “Selaudin Bekteshi”, është lidhur me datë 29.12.2016 dhe nr. prot. 33964/7, ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë së Tiranës, përfaqësuar nga z. Erion Veliaj dhe Operatorit Ekonomik “A...” SHPK përfaqësuar nga Znj. R. B. Vlora e kontratës është 65,045,860 lekë me TVSH. Sipas nenit 3 (Afati i kontratës) të kontratës, afati i realizimit të punimeve do të jetë 6 (gjashtë) muaj kalendarikë nga data e nënshkrimit të kontratës. Periudha e garancisë do të jetë 24 muaj kalendarik nga data e kolaudit të objektit.

- Për kryerjen e shërbimit të mbikëqyrjes të punimeve të kontratës me objekt “Ndërtimi dhe rikonstruksioni i rrugës “Selaudin Bekteshi” është lidhur kontrata e shërbimit me nr. prot. 34050/16, datë 26.12.2016, me OE “Z...” SHPK, me licencë “Për mbikëqyrje dhe kolaudin punimesh” me MK. 1208/8 me drejtues ligjor z. R.T. Objekti i kësaj kontrate është drejtimi i punimeve të zbatimit me objekt “Mbikëqyrja e punimeve për objektin”.

- Për shërbimin e kolaudit të punimeve të ndërtimit të kontratës me objekt “Ndërtimi dhe rikonstruksioni i rrugës “Selaudin Bekteshi” është lidhur kontrata me nr. prot. 22164/4, datë 04.07.2017, ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë së Tiranës, përfaqësuar nga z. Erion Veliaj dhe OE “S...” SHPK, me licencë me MK. 1678/1, datë 17.09.2012 me përfaqësues drejtues ligjore Znj. A.R. Objekti i kësaj kontrate është shërbimi i kolaudit të punimeve në objektin “Ndërtimi dhe rikonstruksioni i rrugës “Selaudin Bekteshi”.

- Projekti është hartuar nga shoqëria projektuese “M...” SHPK në vitin 2016 dhe është miratuar nga titullari i bashkisë së Tiranës z. Erion Veliaj me VKT Nr. 18/7, datë 23.09.2019.

- Lirimi i sheshit, akti i piketimit në objekt dhe punimet kanë filluar me datë 05.01.2017. Sipas njoftimit për përfundimin e punimeve me nr. prot. 73, datë 21.06.2017 punimet e ndërtimit kanë përfunduar 21.06.2017.

- Preventivi bazë është ndryshuar dhe është miratuar me procesverbalin me objekt: për ndryshimin e disa zërave punimesh në objekt (punime që shtohen dhe hiqen), me datë 12.05.2017 me shumë 65,045,286.20 lekë me TVSH.

- Me datë 25.07.2017, është mbajtur procesverbal-kolauidimi për “Ndërtimi dhe rikonstruksioni i rrugës “Selaudin Bekteshi” dhe rezultoi në nënshkruar nga sipërmarrësi i punimeve “A...” SHPK, nga mbikëqyrësi i punimeve “Z...” SHPK, nga koladatori shoqëria “S...” SHPK.

#### **B. Likuidimi i situacioneve për punimet e kryera, rezultoni.**

Punimet e kryera në objekt janë paraqitur në situacionet pjesore/përfundimtare si vijon:

- Situacioni pjesor nr. 1 me vlerë 23,669,888.38 lekë me TVSH. (Fatura Tatimore Nr. 06, 27.02.2017).

- Situacioni pjesor nr. 2 me vlerë 16,200,667.740 lekë me TVSH.

- Situacioni përfundimtar me vlerë 25,175,304 lekë me TVSH.

Nga Autoriteti Kontraktor është likuiduar si vijon: (Situacion nr. 1 me USH nr. 1330, datë 06.06.2017 me shumë 22,486,394 lekë; Situacion nr. 2 me USH nr. 2242, datë 11.09.2017 me shumë 12,513,606

lekë; Situacion nr. 2 me USH nr. 1842, datë 06.06.2018 me shumë 2,877,028 lekë; Situacion përfund me USH nr. 1843, datë 06.06.2018 me shumë 12,122,972 lekë dhe Situacion përfundimtar me USH nr. 2928, datë 13.09.2018 me shumë 11,793,596 lekë).

Nga situacionet e mësipërme është mbajtur 5% e shumës për garancinë e punimeve për një periudhë 24 muaj.

### **C. Mbi auditimin e realizimit të punimeve në terren.**

Nga auditimi në terren për verifikimin e zërave të punimeve si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të administruara në dosjen teknike të zbatimit të vënë në dispozicion grupit të auditimit për punimet e kryera, rezultojnë diferenca në volume për punime të kryera në vlerën prej **699,396** lekë pa TVSH.

Argumentimi i kësaj difference në volume punimesh, pasqyrohet si vijon:

#### **PUNIME PËR TRUPIN E RRUGËS**

##### **Zëri 4 (3.212/c) Shtresë stabilizanti t=15 cm**

Preventivi bazë dhe i rishikuar pasqyron volumin 5,319 m<sup>2</sup> shtresë stabilizant.

Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 5,319 m<sup>2</sup> shtresë stabilizanti gjithsej me çmim 617 lekë/m<sup>2</sup>. Libreza e masave pasqyron volumin 5,319 m<sup>2</sup> shtresë stabilizant, e cila është trajtuar në mënyrë të detajuar.

Nga auditimi i realizimit të këtij zëri në objekt si dhe të Projektit të Zbatimit të Azhurnuar, rezulton se ka mospërputhje të volumeve, sepse për rrugët hyrëse (5 rrugë hyrëse majtas dhe 3 rrugë hyrëse djathtas) në projektin e zbatimit të azhurnuar me faktin nuk ka profile tërthore tip ku është parashikuar shtresë stabilizanti, dhe nga auditimi në objekt rezulton që kjo shtresë nuk është realizuar fare dhe konkretisht për 350 m<sup>2</sup> pasqyruar në tabelën si vijon:

Zëri i punimeve	Gjatësi (m)	Gjerësi (m)	Sipërfaqe (m <sup>2</sup> )
PK 10 (0+225) majtas rrugë hyrëse	10	7.6	76
PK 23 (0+550) majtas rrugë hyrëse	8.29	3.85	31.92
PK 24 (0+575) djathtas rrugë hyrëse	7.7	6.48	49.90
PK 26 (0+640) majtas rrugë hyrëse	13.15	3.89	51.15
PK 27 (0+663) majtas rrugë hyrëse	8.92	5.42	48.35
PK 28 (0+670) majtas rrugë hyrëse	5	4.5	22.50
PK 28 (0+675) djathtas rrugë hyrëse	6.63	3.50	23.21
PK 29 (0+675) djathtas rrugë hyrëse	12	3.87	46.44
			349.47

Sa më sipër diferenca në volumin prej 349 m<sup>2</sup> shtresë stabilizanti është librezuar dhe situacionuar më tepër dhe është përfituar në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi "A..." sh.p.k., në vlerën **215,333** lekë pa TVSH [349 m<sup>2</sup> x 617 lekë].

##### **Zëri 6 (3.226/1) Shtresë asfaltbetoni me granil gur kave, 4 cm, me makineri.**

Preventivi bazë dhe i rishikuar pasqyron volumin 4,532 m<sup>2</sup> shtresë asfaltbetoni + 118 m<sup>2</sup> shtresë asfaltbetoni në pasqyruara në fondin rezervë, pra në total ky zë paraqitet në volumin 4,650 m<sup>2</sup> asfaltbeton. Situacioni përfundimtar pasqyron volumin volumin 4,650 m<sup>2</sup> asfaltbeton me çmim 1387 lekë/m<sup>2</sup>. Libreza e masave pasqyron volumin 4,650 m<sup>2</sup> asfaltbeton, e cila është trajtuar në mënyrë analitike.

Nga auditimi i realizimit të këtij zëri në objekt, rezulton se ka mospërputhje të volumeve, sepse për rrugët hyrëse (5 rrugë hyrëse majtas dhe 3 rrugë hyrëse djathtas) në projektin e zbatimit të azhurnuar me faktin nuk ka profile tërthore tip ku është parashikuar shtresë stabilizanti, dhe nga auditimi në objekt rezulton që kjo shtresë nuk është realizuar fare por është realizuar vetëm një shtresë asfaltme.

Zëri i punimeve	Gjatësi (m)	Gjerësi (m)	Sipërfaqe (m <sup>2</sup> )
PK 10 (0+225) majtas rrugë hyrëse	10	7.6	76

PK 23 (0+550) majtas rrugë hyrëse	8.29	3.85	31.92
PK 24 (0+575) djathtas rrugë hyrëse	7.7	6.48	49.90
PK 26 (0+640) majtas rrugë hyrëse	13.15	3.89	51.15
PK 27 (0+663) majtas rrugë hyrëse	8.92	5.42	48.35
PK 28 (0+670) majtas rrugë hyrëse	5	4.5	22.50
PK 28 (0+675) djathtas rrugë hyrëse	6.63	3.50	23.21
PK 29 (0+675) djathtas rrugë hyrëse	12	3.87	46.44
			349.47

Sa më sipër diferenca në volumin prej 349 m<sup>2</sup> shtresë asfaltobetonit është librezuar dhe situacionuar më tepër dhe është përfituar në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi "A..." sh.p.k., në vlerën **484,063 lekë pa TVSH** [349 m<sup>2</sup> x 1387 lekë].

*Shqyrtimi dhe vlerësimi i komenteve të mbikëqyrësit të punimeve (përcjellë në mënyrë elektronike me datë 23.04.2019 dhe nr. prot. 52) mbi Akt-Konstatimin Nr. 13, datë 16.04.2019 për objektin: Ndërtim dhe rikonstruksion i rrugës "Selaudin Bekteshi" të mbajtur nga grupi i auditimit të KLSH-së, në zbatim në nenin 32, të Rregullores së Procedurave të Auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit (miratuar me vendim të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit Nr. 107, datë 08.08.2017 "Për miratimin e rregullores së procedurave të auditimit në kontrollin e lartë të shtetit" është trajtuar si vijon:*

**a-Argumente dhe komente nga subjekti i audituar u trajtua si vijon:**

*Mbikëqyrësi i punimeve shoqëria "Z..." sh.p.k në observacionin e paraqitur sqaron se projekti i zbatimit është plotësuar me rrugica në pk 23 (0+550) majtas, pk 24 (0+575) djathtas, pk26(0+640) majtas, pk27(0+663) majtas, pk27(0+670) majtas, pk 28(0+675) djathtas, pk 29(0+675) djathtas të cilat janë pasqyruar në projektin e azhurnuar. Të gjitha rrugicat janë trajtuar me shtresë stabilizanti, shtresa asfaltike binder dhe asfaltobeton dhe nuk ka efekt financiar negativ prej 699,396 lekë pa TVSH.*

**b-Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:**

*Grupi i auditimit pasi e lexoi me kujdes observacionin sqaron se:*

*-së pari: Fotot e paraqitura si argument, nuk krijojnë ide të qarta mbi rrugicat, por më tepër krijojnë idenë e trupit të rrugës.*

*-së dyti: Konkluzioni i arritur nga grupi i auditimit, është arritur nga auditimi në fakt mbi kryerjen e punimeve të ndërtimit, në prezencë të përfaqësuesit të mbikëqyrësit të punimeve, ku rezultoi se punimet e ndërtimit në rrugicat nuk janë kryer sipas një pakete të rregullt dhe të parashikuar në projekt zbatimin e objektit. Në objekt, në rrugët hyrëse (5 rrugë hyrëse majtas dhe 3 rrugë hyrëse djathtas) na rezulton se nuk është hedhur stabilizant dhe është hedhur vetëm një shtresë asfaltike (binder), dhe kjo është lehtësisht e dukshme dhe e verifikueshme. Sa më sipër shpjeguar, mendojmë se nga ana Juaj në rolin e mbikëqyrësit të punimeve, nuk janë paraqitur argumente bindëse, për të ndryshuar konkluzionin e grupit të auditimit, prandaj observacioni nuk merret në konsideratë.*

**Problematika të konstatuara nga auditimi:**

Nga auditimi i dokumentacionit teknik, u konstatua se në dosje nuk është dokumentacioni mbi marrjen në dorëzim të punimeve të ndërtimit, që i përkasin kontratës. Ky veprim është në kundërshtim me kontratën nr. prot. 33964/7, datë 29.12.2016, neni 35/5 ku përcaktohet se: "...Me përfundimin e procedurës së kolaudimit Autoriteti Kontraktor lëshon certifikatën e marrjes në dorëzim të punimeve të kryera dhe do të fillojë garancinë e sigurimit të kontratës...". Sa më sipër, Autoriteti Kontraktor Bashkia Tiranë, Mbikëqyrësi i punimeve, Zbatuesi i punimeve, grupi i marrjes në dorëzim si dhe kolaudatori i punimeve, të plotësojnë dosjen teknike.

**Si përfundim, nga auditimi rezulton se:**



Në mënyrë të përmbledhur për objektin “Ndërtimi dhe rikonstrukcioni i rrugës “Selaudin Bekteshi” rezultoi se sipërmarrësit të punimeve i janë likuiduar tepër për punime të pakryera në vlerën **699,396 lekë pa TVSH, vlerë që përbën efekt financiar negativ** ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, do të konsiderohet efekt financiar negativ dhe duhet të zhdëmtohet nga sipërmarrësi i punimeve “A...” SHPK).

*Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 8: Kontratën e zbatimit me objekt “Ndërtimi dhe rikonstrukcioni i rrugës “Selaudin Bekteshi”, të lidhur me datë 29.12.2016 dhe nr. prot. 33964/7; Udhëzimin Nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” Kreu I “Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit”, pika 3.*

Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve Operatorit Ekonomik “Z...” SHPK, me licencë “Për mbikëqyrje dhe kolaudin punimesh” me MK. 1208/8, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në: (Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7; Kontratën për kryerjen e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve të kontratës të lidhur midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë dhe shoqërisë “Z...” SHPK dhe UKM Nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, të ndryshuar, pika 3.2). (Gjerësisht me personat përgjegjës problemet janë trajtuar në akt-konstatimin nr. 13, datë 16.04.2019)

**VII. Zbatimi i kontratës me objekt: “Ndërtim dhe rikonstrukcion i rrugës që lidh rrugën “Reshit Petrela” me rrugën “Skënder Kosturi” (paralel me rrugën “Jordan Misja”, ku rezultoi:**

Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës me objekt: “Ndërtim dhe rikonstrukcion i rrugës që lidh rrugën “Reshit Petrela” me rrugën “Skënder Kosturi” (paralel me rrugën “Jordan Misja” të lidhur ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe sipërmarrësit të punimeve “A...” SHPK, u konstatua se Piketën 0+290 deri në Piketen 0+400 janë dëmtuar kangjellat metalike dhe nuk janë të bojatisuara me antiruxhë.

Sa më sipër nuk është në përputhshmëri me kushtet e përgjithshme të kontratës si dhe specifikimet teknike të tenderit.

**A. Mbi kontratën e zbatimit të punimeve, mbikëqyrjes të punimeve si dhe realizimi i grafikut të punimeve.**

- Kontrata e zbatimit me objekt: “Ndërtim dhe rikonstrukcion i rrugës që lidh rrugën “Reshit Petrela” me rrugën “Skënder Kosturi” (paralel me rrugën “Jordan Misja”, është lidhur me datë 22.09.2017 dhe nr. prot. 26443/7, ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Tiranë, përfaqësuar nga Z. Erion Veliaj dhe Operatorit Ekonomik “A...” SHPK përfaqësuar nga administratori (përfaqësues ligjor) z. X. I. Vlera e kontratës bazë është 53,359,488 lekë me TVSH. Afati i realizimit të punimeve do të jetë 4 (katër) muaj kalenderikë duke nisur nga data e lidhjes së kontratës. Periudha e garancisë do të jetë 24 muaj, duke filluar nga data e marrjes në dorëzim të punimeve.

- Për kryerjen e shërbimit të mbikëqyrjes të punimeve të kontratës me objekt: “Ndërtim dhe rikonstrukcion i rrugës që lidh rrugën “Reshit Petrela” me rrugën “Skënder Kosturi” (paralel me rrugën “Jordan Misja” është lidhur kontrata e shërbimit me nr. prot. 30897/13, datë 13.09.2017, ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Tiranë, përfaqësuar nga Z. Erion Veliaj dhe OE “Z...” SHPK përfaqësuar nga z. R.T.me licencë NR. MK 1208/8.

- Për kryerjen e shërbimit e kolaudimit të punimeve të kontratës me objekt: “Ndërtim dhe rikonstrukcion i rrugës që lidh rrugën “Reshit Petrela” me rrugën “Skënder Kosturi” (paralel me rrugën “Jordan Misja” është lidhur kontrata e shërbimit me nr. prot. 28503/2, datë 06.08.2018, ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Tiranë, përfaqësuar nga Z. Erion Veliaj dhe OE “D...” SHPK përfaqësuar nga zj. S.G. me licencë NR. MK 3019.

Informacioni i përgjithshëm mbi zbatimin e kontratës bazë jepet siap tabelës:

Të dhëna të përgjithshme mbi dokumentacionin tekniko-ligjor	Nr. Prot.	Data	Palët e angazhuara dhe siglimet
Kontrata e sipërmarrjes, vl =53,359,488 Lekë me TVSH	26443/7	22.09.2017	- AK, përfaqësuar nga z. Erion Veliaj - sipërmarrësi “Alba Konstruksion” shpk përfaqësuar nga

			Z. Xhavit Ismaili.
Akt-Marrëveshje për zgjatje afati punimesh për 4 muaj kalendarik deri me datë <b>22.05.2018</b>	3100/2	22.01.2018	- AK, përfaqësuar nga z. Erion Veliaj - sipërmarrësi “Alba Konstruksion” shpk përfaqësuar nga Z. Xhavit Ismaili.
Akt-Marrëveshje për zgjatje afati punimesh për 4 muaj kalendarik deri me datë <b>22.07.2018</b>	18477/2	15.05.2018	- AK, përfaqësuar nga z. Erion Veliaj - sipërmarrësi “Alba Konstruksion” shpk përfaqësuar nga Z. Xhavit Ismaili.
Kontratë mbikëqyrjesh punimesh	30897/13	13.09.2017	- AK, përfaqësuar nga z. Erion Veliaj - mbikëqyrësi “Zenit - 06” shpk përfaqësuar nga Z. Rexhep Tarba
Kontratë shërbim kolaudimi	28503/2	06.08.2018	- AK, përfaqësuar nga z. Erion Veliaj - kolaudatori “Diper” shpk përfaqësuar nga Zj. Stela Guxo.
Njoftim për fillim punimesh nga mbikëqyrësi	-	22.09.2017	- mbikëqyrësi “Zenit - 06” shpk përfaqësuar nga Z. Rexhep Tarba
Njoftim fillim punimesh nga sipërmarrësi	-	22.09.2017	- sipërmarrësi “Alba Konstruksion” shpk përfaqësuar nga Z. Xhavit Ismaili.
Akt-dorëzimi i sheshit të ndërtimit	-	22.09.2017	- sipërmarrësi “Alba Konstruksion” shpk përfaqësuar nga Z. Xhavit Ismaili. - mbikëqyrësi “Zenit - 06” shpk përfaqësuar nga Z. Rexhep Tarba - Për investitorin: DPPP z. Taulant Tusha dhe DIPP z, Rigels Balla
Proces-verbal mbi fillimin e punimeve në objekt (sipërmarrës + mbikëqyrës)	-	22.09.2017	- sipërmarrësi “Alba Konstruksion” shpk përfaqësuar nga Z. Xhavit Ismaili. - mbikëqyrësi “Zenit - 06” shpk përfaqësuar nga Z. Rexhep Tarba - Për investitorin: DPPP z. Taulant Tusha dhe DIPP z, Rigels Balla
Proces-verbal mbi Akt-piketimin në objekt	-	24.09.2017	- sipërmarrësi “Alba Konstruksion” shpk përfaqësuar nga Z. Xhavit Ismaili Drejtuesi teknik ing. Merkur Kamo dhe inxhinieri topograf z. Shyqyri Kurti. - mbikëqyrësi “Zenit - 06” shpk përfaqësuar nga Z. Rexhep Tarba
Projekt Zbatimi i Miratuar	VKT nr. 9/4	10.05.2017	Miratuar nga Kryetari i AK, z. Erion Veliaj
Projekti i zbatimi i rishikuar	VKT 22/8	15.12.2017	
Preventiv i rishikuar, VL = 53,340,228 lekë me TVSH.	VKT Nr. 22/8	15/12/2017	- Miratuar nga Kryetari i AK Z. Erion Veliaj - Hartuar nga: - Kontraktori “Alba Konstruksion” shpk - mbikëqyrësi “Zenit-06” shpk
Njoftim për Përfundimim punimevesh nga zbatuesi	28503	23.07.2018	- sipërmarrësi “Alba Konstruksion” shpk firmosur nga Administratori z. Atnand Koni.
Njoftim për Përfundimim punimevesh nga mbikëqyrësi i punimeve	28503	23.07.2018	- mbikëqyrësi “Zenit-06” shpk firmosur nga zj. Luiza Tarba
Proces - verbal për Përfundimim punimevesh	-	23.07.2018	- sipërmarrësi “Alba Konstruksion” shpk firmosur nga Administratori z. Atnand Koni dhe D.Teknik ing. Merkur Kamo. - mbikëqyrësi “Zenit-06” shpk firmosur nga D.L zj. Luiza Tarba dhe D.T ing. Gani Shehaj.
Deklarate Teknike e sipërmarrësit	-	-	- sipërmarrësi “Alba Konstruksion” shpk firmosur nga Administratori z. Atnand Koni dhe D.Teknik ing. Merkur Kamo.

Raport përfundimtar i mbikëqyrësit	-	-	- mbikëqyrësi “Zenit-06” shpk firmosur nga D.L zj. Luiza Tarba.
Proces-verbali i kolaudimit të punimeve	-	22.08.2018	- sipërmarrësi “Alba Konstruksion” shpk firmosur nga Administratori z. Atnand Koni. - mbikëqyrësi “Zenit-06” shpk firmosur nga D.L zj. Luiza Tarba. -Kolaudatori i punimeve “Diper” shpk firmosur nga D.L ing. Stela Guxo.

### **B. Likuidimi i situacioneve për punimet e kryera, rezulton.**

Për punimet e kryera në objekt janë paraqitur në ditucionin pjesor nr. 1, me vlerë 26,722,033.20 lekë me TVSH. Realizimi i punimeve për këtë situacion pjesor paraqitet në masën 50.07 %. Situacioni përfundimtar i punimeve për periudhën 22.09.2017 deri 22.07.2018 ka shumën 23,950,921.20 lekë me TVSH duke zbritur 5% garanci punimesh.

Nga Autoriteti Kontraktor janë likuiduar situacionet si vijon:

- Situacion nr. 1, me USH nr. 2780, datë 29.08.2018 dhe shumë 25,273,321 lekë.

### **C. Mbi auditimin e realizimit të punimeve në terren.**

Mbas shqyrtimit të observacionit, grupi i auditimit me faktet dhe argumentet e paraqitura e merr në konsideratë observacionin dhe heq vlerën e konsideruar si efekt financiar negativ në shumën 387,700 lekë pa TVSH.

Nga auditimi në terren për verifikimin e zërave të punimeve si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të administruara në dosjen teknike të zbatimit të vënë në dispozicion grupit të auditimit për punimet e kryera deri në periudhën e auditimit, na rezulton se sipërmarrësi i punimeve duhet të plotësojë dhe të riparojë dëmtimet e kangjallave të vendosura, përkatësisht në Pk 0+290 deri 0+400, deri në përfundim të periudhës së garancisë me datë 22.08.2019.

*Shqyrtimi dhe vlerësimi i komenteve të mbikëqyrësit të punimeve (përcjellë në mënyrë elektronike me datë 23.04.2019 dhe nr. prot. 52) mbi Akt-Konstatimin Nr. 14, datë 16.04.2019 për objektin: “Ndërtim dhe rikonstruksion i rrugës që lidh rrugën “Reshit Petrela” me rrugën “Skënder Kosturi” (paralel me rrugën “Jordan Misja” të mbajtur nga grupi i auditimit të KLSH-së, në zbatim në nenit 32, të Rregullores së Procedurave të Auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit (miratuar me vendim të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit Nr. 107, datë 08.08.2017 “Për miratimin e rregullores së procedurave të auditimit në kontrollin e lartë të shtetit” është trajtuar si vijon:*

#### **a-Argumente dhe komente nga subjekti i audituar u trajtua si vijon:**

*Mbikëqyrësi i punimeve shoqëria “Z...” sh.p.k në observacionin e paraqitur shpjegon se:*

*- Projekti i tenderuar parashikonte në pk. 0+125 deri 0+200 në krahun e djathtë të saj (ngjitur me murin e prokurorisë) punime në trotuar dhe se gjatë punimeve në k’të segment ka pasur kundërshtime nga nga autoritetet përkatëse të cilat nuk kanë pranuar shtrimin e pllakave të trotuarit për arsye sigurie dhe si pasojë shtresa e trotuarit nuk është aplikuar aty.*

*- Lidhur me problematikën mbi zërin “Parapeti i njëanshëm për beton, mbikëqyrësi i punimeve sqaron se, parapeti i njëanshëm metalik është vendosur nga Pk. 0+200 deri në piketën 0+490 dhe nuk ka në asnjë vend ndërprerje, por me të drejtë janë konstatuar dëmtime.*

#### **b-Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:**

*Grupi i auditimit pasi e lexoi me kujdes observacionin sqaron se:*

*Me argumentet e paraqitura në observacion, grupi i auditimit merr në konsideratë observacionin dhe zbret vlerën e konsideruar si dëm ekonomik prej 387,700 lekë pa TVSh.*

Si përfundim mbas shqyrtim të observacionit të bërë nga mbikëqyrësi i punimeve, për objektin “Ndërtim dhe rikonstruksion i rrugës që lidh rrugën “Reshit Petrela” me rrugën “Skënder Kosturi” (paralel me rrugën “Jordan Misja” rezulton se:

Nga auditimi në terren për verifikimin e zërave të punimeve si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të administruara në dosjen teknike të zbatimit të vënë në

dispozicion grupit të auditimit për punimet e kryera deri në periudhën e auditimit, na rezulton se punimet e ndërtimit janë realizuar dhe nuk ka diferenca në volume, por sipërmarrësi i punimeve duhet të plotësojë dhe të riparojë dëmtimet e kangjallave të vendosura, përkatësisht në Pk 0+290 deri 0+400, deri në përfundim të periudhës së garancisë me datë 22.08.2019. *Sa më sipër është në kundërshtim me Kontratën e zbatimit me objekt “Ndërtim dhe rikonstruksion i rrugës që lidh rrugën “Reshit Petrela” me rrugën “Skënder Kosturi” (paralel me rrugën “Jordan Misja”, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë së Tiranës dhe Operatorit Ekonomik “A...” SHPK dhe Specifikimet Teknike.*

*(Gjerësisht me personat përgjegjës problemet janë trajtuar në akt-konstatimin nr. 14, datë 16.04.2019)*

**VIII. Zbatimi i kontratës me objekt “Rehabilitimi Unaza e Mesme”, ku rezultoi:**

Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës me objekt: “Rehabilitimi Unaza e Mesme” të lidhur ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe sipërmarrësit të punimeve “A...” SHPK , u konstatua se zëri i punimeve (3.618) F.V bordura betoni 20x35 cm e re për trotuarin, nuk është zbatuar sipas projektit të zbatimit dhe specifikimeve teknike duke krijuar një efekt financiar negativ në shumën **172,190 lekë pa TVSH** ndaj buxhetit të shtetit dhe njësië vendore. Sa më sipër nuk është në përputhshmëri me projektin e zbatimit dhe specifikimet teknike.

Të përgjithshme: “Rehabilitimi Unaza e Mesme” konsiston në kryerjen e punimeve në: (Kryqëzimi i rrugës “Muhamet Gjollësia” me rrugën “Myslym Shyri”; Kryqëzimi i rrugës “Jordan Misja” me rrugën “Asim Vokshi”; Kryqëzimi i Bulevardit “Zogu I” me rrugën “Reshit Petrela”; Korsitë e biçikletave me BLV “Zhan D’Ark” dhe BLV “Gjergj Fishta”; Kryqëzimi i rrugës “Arkitekt Kasemi” me bulevardin “Zhan D’Ark”; Kryqëzimi i rrugës “5 Maji” me rrugën “Ferid Xhajko”; Kryqëzimi i rrugës “Bardhyl” me rrugën “Kongresi i Manastirit”; Kryqëzimi i rrugës “Siri Kodra” me bulevardin “Ferid Xhajko”).

Financimi i objektit “Rehabilitimi Unaza e Mesme” është bërë nga fonde të vëna në dispozicion nga Bashkia Tiranë.

**A. Mbi kontratën e zbatimit të punimeve, mbikëqyrjes të punimeve si dhe realizimi i grafikut të punimeve.**

- Kontrata e zbatimit me objekt: “Rehabilitimi Unaza e Mesme”, është lidhur me datë **04.06.2018** dhe nr. prot. 5325/10, ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Tiranë, përfaqësuar nga Z. Erion Veliu dhe Operatorit Ekonomik “A...” SHPK përfaqësuar nga administratori (përfaqësues ligjor) z. A. K. Vlera e kontratës bazë është 248,930,307.1 lekë me TVSH. Afati i realizimit të punimeve do të jetë 360 (treqind e gjashtëdhjetë) ditë kalanderikë duke nisur nga data e lidhjes së kontratës. Periudha e garancisë do të jetë 24 muaj, duke filluar nga data e marrjes në dorëzim të punimeve.

- Për kryerjen e shërbimit të mbikëqyrjes të punimeve të kontratës me objekt : “Rehabilitimi Unaza e Mesme” është lidhur kontrata e shërbimit me nr. prot. 14037/17, datë 04.06.2018, ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Tiranë, përfaqësuar nga Z. Erion Veliu dhe OE “Infratech ” SHPK përfaqësuar nga zj. Filjana Veizaj me liçenc NR. MK 1706/8. Objekti i kësaj kontrate është drejtimi i punimeve të zbatimit me objekt “Mbikëqyrja e punimeve për objektin ”. Vlera e kontratës së mbikëqyrjes është 2,174,469.6 lekë me TVSH.

Lirimi i sheshit dhe akti i piketimit në objekt janë bërë me datë 04.06.2018. Punimet e ndërtimit kanë filluar me datë 04.06.2018 dhe duhet të përfundojnë sipë kontratës me datë 03.06.2019.

- Bazuar në shkresë me nr. prot. 45677, datë 11.12.2018, PZ me objekt “Rehabilitimi Unaza e Mesme” është rishikuar dhe miratuar me VKT Nr. 13/9, datë 26.09.2018. Ndryshimi konsiston në prishjen e murit ekzistues dhe ndërtimin e murit të ri rrethues pranë godinës së Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, si rezultat i zgjerimit të rrugës dhe trotuarit në kryqëzimin e rrugës “Jordan Misja” me rrugën “Asim Vokshi”.

Nga ndryshimet e ndodhura dhe të miratuara në PZ, është hartuar preventivi i ripunuar i miratuar me VKT Nr. 13./9, datë 26.09.2018 me shumë 248,930,702.4 lekë me TVSH,

**B. Likuidimi i situacioneve për punimet e kryera, rezulton.**

Për punimet e kryera në objekt për periudhën 04.06.2018-18.12.2018 janë paraqitur në situacionin pjesor nr. 1, me vlerë 42,231,208.8 lekë me TVSH. Realizimi i punimeve për këtë situacion pjesor paraqitet në masën 16.90 %.

Nga situacionin e mësipërm është mbajtur 5% e shumës në vlerën 2,111,560.4 lekë me TVSH.

### **C. Mbi auditimin e realizimit të punimeve në terren.**

Nga auditimi në terren për verifikimin e zërave të punimeve si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të administruara në dosjen teknike të zbatimit të vënë në dispozicion grupit të auditimit për punimet e kryera deri në periudhën e auditimit, rezulton një efekt financiar në vlerën prej **172,190** lekë pa TVSH, argumentuar si vijon:

#### **Zëri (3.618) F.V bordura betoni 20x35 cm e re për trotuarin.**

a) Preventivi i ripunuar lidhur me zërin “**Zëri (3.618) F.V bordura betoni 20x35 cm e re për trotuarin**” pasqyron sasinë 1,193 ml, specifikuar për objektet si vijon:

- Kryqëzimi i rrugës “Muhamet Gjollësja” me rrugën “Myslym Shyri” sasinë 84 ml, me çmim 1500 lekë pa TVSH.

- Punime për ndërhyrjen me gjerësi 2.5 m dhe gjatësi 400 ml, sasinë 800 ml, me çmim 1500 lekë pa TVSH.

- Kryqëzimi i rrugës “Jordan Misja” me rrugën “Asim Vokshi” sasinë 51 ml, me çmim 1500 lekë pa TVSH.

- Kryqëzimi i rrugës “5 Maji” me rrugën “Ferit Xhajko” sasinë 120 ml, me çmim 1500 lekë pa TVSH.

- Kryqëzimi i rrugës “Bardhyl” me rrugën “Kongresi i Manastirit” punime për zgjerimin e korsisë në sasinë 102 ml, me çmim 1500 lekë pa TVSH.

- Kryqëzimi i rrugës “Bardhyl” me rrugën “Kongresi i Manastirit” punime për ishullin e trafikndarësit në sasinë 36 ml, me çmim 1500 lekë pa TVSH.

Libreza e masave për likuidimin e situacionit pjesor nr. 1, pasqyron 670 ml bordura betoni me çmim 1,500 lekë.

Në fakt nga auditimi i realizimit të këtij zëri punimesh në objekt rezultoi se, bordurat e betonit janë 20 x 25 cm dhe jo 20 x 35 cm, pra vendosja e tyre është bërë në kundërshtim me specifikimet teknike dhe kërkesat teknike të projektit të zbatimit.

Referuar analizës së çmimeve nr. 3.618 për zërin “Bordura betoni parafabrikat, 20 x 35 cm” çmimi total i këtij zëri është 1515 lekë, kurse zëri “Tiranëerial” i bordurës 20 x 35 cm është 900 lekë. Pra bordura përbën 60 % ( $900/1515 \times 100$ ) të çmimit total të zërit.

- Referuar çmimit të zërit “F.V Bordura betoni parafabrikat, 20 x 35 cm” në ofertën ekonomike dhe situacionin pjesor nr. 1, çmimi total i këtij zëri është 1,500 lekë, kurse çmimi i vetë bordurës 20 x 35 cm, duke konsideruar peshën e bordurës sipas analizës së manualit (në masën 60%) është 900 lekë ( $60\% \times 1500$  lekë).

Nisur nga fakti që sipërmarrësi ka përdorur bordura 20 x 25 cm, çmimi real i bordurës së përdorur duhet të ishte 643 lekë ( $900 / 35 \text{ cm} \times 25 \text{ cm}$ ) dhe diferenca e çmimit ka sjell një efekt financiar negativ prej 257 lekë ( $900 - 643$ ).

Sa më sipër realizimi i zërit “F.V Bordura betoni parafabrikat M-200, 20 x 25 cm”, sipas përlllogaritjes me interpolim linear është librezuar dhe situacionuar më tepër duke krijuar një efekt financiar negativ nga sipërmarrësi i punimeve “ALBA KONSTRUKSION” SHPK., në vlerën **172,190 lekë pa TVSH** [257 lekë x 670 ml bordurë].

b) Nisur nga fakti se punimet e ndërtimit janë në proces e sipër dhe brenda afatit të përfundimit të punimeve (referuar grafikut të punimeve) për pjesën që do të realizohet për zërin “Zëri (3.618) F.V bordura betoni 20 x 35 cm e re për trotuarin” i sugjerojmë zbatuesit të punimeve dhe mbikëqyrësit të punimeve që për sasinë 523 ml bordura betoni çmimi duhet të zbritet me 257 lekë/ml bordurë ose zëri i punimeve të realizohet duke vendosur bordura betoni 20 x 35 cm.

#### **Zëri 16(3.158/5a) Transport dheu me auto deri 5.0 km.**

Preventivi i ripunuar pasqyron volumin 2120 m<sup>3</sup> transport dheu me çmim 250 lekë.

Në zërin transport dheu me auto deri 5 km është përfshirë, transport nga prishjet e bordurave ekzistuese në volumin 56 m<sup>3</sup>, prishje shtresë betoni për fiksimin e bordurave në volumin 48 m<sup>3</sup> dhe

prishje shtresë betoni (kuneta tek parkimi) në volumin 70 m<sup>3</sup>, në fakt transporti duhet të pasqyrohet në preventivin e ripunuar në volumin 2002 m<sup>3</sup>, sepse referuar VKM Nr. 629, date 15.07.2018 “Për miratimin e manualeve teknike të ndërtimit dhe të analizave teknike” për zërin “2.426/1” rezulton i përfshirë edhe transporti i dheut.

Nisur nga fakti se punimet e ndërtimit janë në proces e sipër dhe brenda afatit të përfundimit të punimeve (referuar grafikut të punimeve) për pjesën që do të realizohet për zërin “Transport dheu me auto deri 5.0 km” i sugjerojmë zbatuesit të punimeve dhe mbikëqyrësit të punimeve që të pasqyrojnë në librezën e masave dhe në situacion pjesor të rradhës sasinë 2002 m<sup>3</sup> transport dheu dhe jo 2120 m<sup>3</sup>. Sasia prej 118 m<sup>3</sup> si transport është përfshirë në zërin 2.426/3, dhe sa më sipër nuk mundet që i njëjti zë punimi të paguhet dy herë, përkatësisht në zërin 2.426/3 si dhe në zëin 3.158/5a.

Zëri 11(3.158/5a) Transport dheu me auto deri 5.0 km. Preventivi i ripunuar pasqyron volumin 9750 m<sup>3</sup> transport dheu me çmim 250 lekë. Në zërin transport dheu me auto deri 5 km nuk është zbritur volumi prej 192 m<sup>3</sup> (2.426/3; prishje shtresa betoni kuneta ekzistuese), në fakt transporti duhet të pasqyrohet në preventivin e ripunuar në volumin 9558 m<sup>3</sup>, sepse referuar VKM Nr. 629, date 15.07.2018 “Për miratimin e manualeve teknike të ndërtimit dhe të analizave teknike” për zërin “2.426/1” rezulton i përfshirë edhe transporti i dheut. Nisur nga fakti se punimet e ndërtimit janë në proces e sipër dhe brenda afatit të përfundimit të punimeve (referuar grafikut të punimeve) për pjesën që do të realizohet për zërin “Transport dheu me auto deri 5.0 km” i sugjerojmë zbatuesit të punimeve dhe mbikëqyrësit të punimeve që të pasqyrojnë në librezën e masave dhe në situacion pjesor të rradhës sasinë 9558m<sup>3</sup> transport dheu dhe jo 9750 m<sup>3</sup>. Sasia prej 192 m<sup>3</sup> si transport është përfshirë në zërin 2.426/3, dhe sa më sipër nuk mundet që i njëjti zë punimi të paguhet dy herë, përkatësisht në zërin 2.426/3 si dhe në zëin 3.158/5a.

*Shqyrtimi dhe vlerësimi i komenteve të mbikëqyrësit të punimeve në observacionin me nr. prot. 30/4, datë 30.04.2019, mbi Akt-Konstatimin Nr. 15, datë 16.04.2019 për objektin: “Rehabilitimi Unaza e Mesme” të mbajtur nga grupi i auditimit të KLSH-së, në zbatim në nenit 32, të Rregullores së Procedurave të Auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit (miratuar me vendim të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit Nr. 107, datë 08.08.2017 “Për miratimin e rregullores së procedurave të auditimit në kontrollin e lartë të shtetit” është trajtuar si vijon:*

**a-Argumente dhe komente nga subjekti i audituar u trajtua si vijon:**

*Mbikëqyrësi i punimeve shoqëria “Infratech” sh.p.k në observacionin e paraqitur lidhur me problematikën për realizimin e zërit “F.V. Bordura betoni 20x35 cm e re për trotuarin sqaron se: Zbatuesi i punimeve deri në datën 18.12.2018, për këtë zë punimi kishte kryer këto punë:*

*- Të realizuara 670 ml bordurë betoni 20 x 30 cm.*

*- Të situacionuara 84 ml bordura betoni 20 x 35 cm, kjo për arsye se në treg nuk ka bordura të tilla.*

**b-Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:**

*Grupi i auditimit pasi e lexoi me kujdes observacionin sqaron se:*

*- së pari: nisur nga fakti se punimet e vendosjes së bordurave janë realizuar duke ruajtur kuotën e dhënë në projekt dhe shtuar shtresë betoni për shtrat bordure në lartësi 5 cm dhe gjithashtu meqenëse është propozuar nga Kontraktori dhe mbikëqyrësi i punimeve që kjo bordurë të bëhet sipas çmimit të negociuar për këtë zë punimi, grupi i auditimit e merr në konsideratë argumentimin e bërë në observacioni duke hequr shumën 172,170 lekë pa TVSh si dëm ekonomik dhe rekomandon që të kryhen sistemimet e kësaj shume në situacionet pjesore ose në situacionin përfundimtar të punimeve.*

*- së dyti: Lidhur me zbatimin e zërit të punimeve “Transport dheu me auto deri 5.0 km” grupi i auditimit nuk është shprehur se në zërin 3.89/a transporti është përfshirë transporti, por jemi shprehur se në zërin 2.426/3 “Prishje shtresa betoni ekzistuese, ka të përfshirë si nën zë edhe transportin, kështu që sa më sipër shpjeguar, rekomandojmë që në situacionet në vazhdim pjesore ose përfundimtar, të mos likuidohet i njëjti zë dy herë, por të kryhen sistemimet për të mos patur dublime të zërit të transportit.*

**Si përfundim, mbas shqyrtimit të observacionit në mënyrë të përmbledhur për objektin “Rehabilitimi Unaza e Madhe” nga auditimi rezulton se:**

- 1- Sipërmarrësi i punimeve "A..." SHPK dhe mbikëqyrësi i punimeve, të bëjnë sistemimet në situacionet pjesore ose në situacionin përfundimtar në vlerën **172,190 lekë pa TVSH**, për zëvendësimin e bordurës nga 20 x 35 cm në 20 x 30 cm, brenda afatit kohor të përfundimit të punimeve të ndërtimit parashikuar në kontratë. Në rast të kundërt mos realizimi i punimeve sipas bordurës me seksion 20x30 cm, shuma 172,190 lekë pa TVSH do të konsiderohet dëm ekonomik dhe do të trajtohet si punim i kryer në kundërshtim me projektin e zbatimit dhe specifikimet teknike dhe ngarkon me përgjegjësi mbikëqyrësin e punimeve.
- 2- Auditimi mbi realizimin e punimeve të ndërtimit i përket periudhës nga fillimi i punimeve datë 04.06.2018 deri me datë 31 dhjetor 2018, periudhë që përkon me situacionet pjesore 1. Në fakt nga auditimi i punimeve në terren rezulton se kanë përfunduar punimet në masën rreth 70 % ose në shumën 277,725,488.110 lekë dhe konkretisht janë kryer:

Nr.	Zëri i punimeve	Vlera Sipas preventivit të ripunuarnë lekë	Vlera Sipas faktit në lekë	% e realizimit
<b>(1) - Kryqezimi i rruges "Muhamet Gjollësja" me rrugen "Myslym Shyri"</b>				
1	Punime per prishje te hundeve	2,255,228	2,255,556	100.00
2	Punime per nderhyrjen me gjeresi 2,5 ml dhe gjatesi 400 ml	15,688,338	15.688.266,50	99.99
3	Punime elektrike	48,750	48.750,00	100.00
4	Punime per sistemin K.U.B	3,059,900	3.059.200,00	99.99
5	Sinjalistika horizontale	3,561,200	1.983.300,0	55.69
6	Punime per korsine e biçikletave	5,651,600	2.759.050,00	48.81
<b>(2) - Kryqezimi i rruges "Jordan Misja" me rrugen "Asim Vokshi"</b>				
1	Pershkrimi i punimeve	302,000	225.000,00	74.50
2	Punime prishje per muret rrethuese	136,700	136.000,00	99.99
3	Punime per sistemim te territorit dhe murin mbajtes	5,743,866	1.547.500,00	26.94
4	Punime per prishje te hundeve dhe zgjerim te korsise	1,210,300	1.118.150,00	92.38
5	Punime ne trotuarin ekzistues dhe ishullin	654,530	652.650,00	99.71
6	Punime ne trotuarin e ri	393,750	293.490,00	74.53
7	Punime per sistemin K.U.B	185,850	185.850,00	100.00
<b>(4) - Korsite e Biçikletave ne BLV "Zhan D'Ark" dhe BLV "Gjergj Fishta"</b>				

1	Punime per korsine e biçikletave	22,895,850	17.277.000,00	75.45
<i>(9) - Asfaltim rruge S=32609 m2</i>				
1	Punime per asfaltim rruge	134,250,720	65.090.350,0	48.48
<b>Totali i realizuar</b>		<b>195,458,982</b>	<b>112,320,112.5</b>	<b>54.14</b>

- 3- Nga tabela e mësipërme vërehet se ecuria e punimeve të ndërtimit paraqitet e ngadaltë në raport me grafikun e kryerjes së punimeve dhe zbatim të kushteve të kontratës, deri me datë 31.12.2018 janë realizuar punime në shumën 112,320,112.5 lekë pa TVSH kundrejt shumës së kontratës 207,442,252 lekë pa TVSh, ose në masën 54.14 %. Autoriteti Kontraktor duhet të ushtrojë kontrolle dhe t'i kërkojë sipërmarrësit të punimeve përshpejtimin e realizimit të kontratës në afatin e përcaktuar.

*(Gjerësisht me personat përgjegjës problemet janë trajtuar në akt-konstatimin nr. 15, datë 16.04.2019)*

**IX. Zbatimi i kontratës me objekt: “Rikualifikim urban i bllokut të kufizuar nga rruga “Muhamet Gjollësja” – “Myslym Shyri” – “Rruga e Kavajes” me Kufirin e Njësisë Bashkiake Nr. 10”, ku rezultoi:**

Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës me objekt: “Rikualifikim urban i bllokut të kufizuar nga rruga “Muhamet Gjollësja” – “Myslym Shyri” – “Rruga e Kavajes” me Kufirin e Njësisë Bashkiake Nr. 10” të lidhur ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe sipërmarrësit të punimeve “ARIFAJ” SHPK, u konstatua se zëri ipunimeve “5 (3.243) Strukturë monolite betoni C 16/20 (për shtresë trotuari)” është likuiduar për punime të pakryera dhe diferenca në volume në shumën **1,289,110 lekë pa TVSH** duke shkaktuar efekt financiar negativ ndaj buxhetit të shtetit dhe njësië vendore. Sa më sipër nuk është në përputhshmëri me paragrafin e tretë të nenit 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” Kreu I, pika 3.

Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës me objekt: “Rikualifikim urban i bllokut të kufizuar nga rruga “Muhamet Gjollësja” – “Myslym Shyri” – “Rruga e Kavajes” me Kufirin e Njësisë Bashkiake Nr. 10” të lidhur ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe sipërmarrësit të punimeve “ARIFAJ” SHPK, u konstatua se:

- Përsa i përket punimeve mbi vizimet me bojë bikomponente me gjerësi (d=12 cm) nga auditimi në fakt, u konstatua se për gjatësinë 1000 ml është përdorur bojë në kundërshtim me specifikimet teknike dhe pothuasje boja është fshirë fare.

- Në 10 puseta në rrjetin e K.U.Z, u konstatua se, mbingritja e pusetave ekzistuese në trupin e rrugës nuk është bërë në kuotën e përcaktuar në projekt dhe ka filluar shkatërrimi i tyre.

Për sa më sipër është në kundërshtim me DST dhe kontratën e nënshkruar, cilësia e punimeve në ndërtim.

Të përgjithshme: Blloku shtrihet në pjesën qendrore të Tiranës dhe ka një sipërfaqe prej rreth 12 ha. fillon në kufirin e Njësisë Bashkiake Nr. 10 Tiranë në anën lindore, me rrugën “Myslym Shyri” në anën jugore, me rrugën “Muhamet Gjollësja” në anën perendimore dhe me rrugën e “Kavajës” në anën veriore të tij. Kjo zonë është me intensitet të lartë urban, me ndërtime kryesisht shumë katërshe të ndërtuara para dhe pas viteve 1990.

**A. Mbi kontratën e zbatimit të punimeve, mbikëqyrjes dhe kolauditimit të punimeve si dhe realizimit i grafikut të punimeve.**

- Kontrata e zbatimit me objekt “Rikualifikim urban i bllokut të kufizuar nga rruga “Muhamet Gjollësja” – “Myslym Shyri” – “Rruga e Kavajes” me Kufirin e Njësisë Bashkiake Nr. 10”, është lidhur me datë 07.06.2016 dhe nr. prot. 11082/7, ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë së Tiranës, përfaqësuar nga z. Erion Veliaj dhe Operatorit Ekonomik “A...” SHPK përfaqësuar nga Znj. R. B.



Vlera e kontratës është 105,142,356 lekë me TVSH. Sipas nenit 3 (Afati i kontratës) të kontratës, afati i realizimit të punimeve do të jetë 8 (tetë) muaj kalendarikë nga data e nënshkrimit të kontratës. Periudha e garancisë do të jetë 12 muaj nga data e kolaudimit të objektit.

Bazuar në shkresën nr. 826, datë 10.01.2017 të mbikëqyrësit të punimeve është kërkuar shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve me 30 ditë kalendarike për mos lirim sheshi në disa akse. Në vijim, kërkesa është marrë në konsideratë me aktmarrëveshjen për zgjatjen e afatit të kontratës me datë 06.02.2017 dhe nr. prot. 926/2. Afati është shtyrë nga data 07.02.2017 deri në datë 09.03.2017.

- Shtesë kontratë mbi zbatimin e punimeve me objekt shtesë kontrate për objektin “Rikualifikim urban i bllokut të kufizuar nga rruga “Muhamet Gjollësja” – “Myslym Shyri” – “Rruga e Kavajes” me Kufirin e Njësisë Bashkiake Nr. 10”, është lidhur me datë 13.04.2017 dhe nr. prot. 10206/5, ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë së Tiranës, përfaqësuar nga z. Erion Veliaj dhe Operatorit Ekonomik “A...” SHPK përfaqësuar nga Znj. Rezarta Bokçiu. Vlera e kontratës është 19,428,735 lekë me TVSH. Sipas nenit 3 (Afati i kontratës) të kontratës, afati i realizimit të punimeve do të jetë 2 (dy) muaj kalendarikë nga data e nënshkrimit të kontratës. Periudha e garancisë do të jetë 12 muaj nga data e kolaudimit të objektit.

Bazuar në shkresën nr. 21481, datë 30.05.2017 të mbikëqyrësit të punimeve është kërkuar shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve me 45 (dyzet e pesë) ditë kalendarike për mos lirim sheshi në disa akse. Në vijim, kërkesa është marrë në konsideratë me aktmarrëveshjen për zgjatjen e afatit të kontratës me datë 13.04.2017 dhe nr. prot. 10206/5.

- Për kryerjen e shërbimit të mbikëqyrjes të punimeve të kontratës me objekt “Rikualifikim urban i bllokut të kufizuar nga rruga “Muhamet Gjollësja” – “Myslym Shyri” – “Rruga e Kavajes” me Kufirin e Njësisë Bashkiake Nr. 10” është lidhur kontrata me nr. prot. 12132/15, datë 06.06.2016, me BOE “Infratech” SHPK & “Vler Invest” SHPK, me licencë “Për mbikëqyrje dhe kolaudin punimesh” respektivisht me MK. 1706/4 & MK. 1554/6 për mbikëqyrjen e punimeve në objekt, përfaqësuar nga OE “Infratech” SHPK me drejtuese ligjore znj. Filjana Veizaj.

Për kryerjen e shërbimit të mbikëqyrjes të punimeve të shtesës së kontrates kontratës me objekt “Rikualifikim urban i bllokut të kufizuar nga rruga “Muhamet Gjollësja” – “Myslym Shyri” – “Rruga e Kavajes” me Kufirin e Njësisë Bashkiake Nr. 10” është lidhur kontrata me nr. prot. 13123/6, datë 13.04.2017, me BOE “Infratech” SHPK & “Vler Invest” SHPK, me licencë “Për mbikëqyrje dhe kolaudin punimesh” respektivisht me MK. 1706/4 & MK. 1554/6 për mbikëqyrjen e punimeve në objekt, përfaqësuar nga OE “Infratech” SHPK me përfaqësues ligjor znj. Filjana Veizaj dhe z. Bashkim Sali.

- Për shërbimin e kolaudimit të punimeve të kontratës me objekt “Rikualifikim urban i bllokut të kufizuar nga rruga “Muhamet Gjollësja” – “Myslym Shyri” – “Rruga e Kavajes” me Kufirin e Njësisë Bashkiake Nr. 10” është lidhur kontrata me nr. prot. 10418/2, datë 27.03.2017, ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë së Tiranës, përfaqësuar nga z. Erion Veliaj dhe OE “Zenit-06” SHPK, me licencë me MK. 1208/8 me drejtues ligjore Z. Rexhep Tarba.

- Projekti është hartuar nga shoqëria projektuese “Gjeokonsult & Co” SHPK në vitin 2014 dhe është miratuar nga z. Etion Kapedani me VKT Nr. 14, datë 17.10.2014.

- Lirimi i sheshit dhe punimet kanë filluar me datë 08.06.2016. Sipas njoftimit për përfundimin e punimeve me nr. prot. 10/3, datë 10.03.2017 punimet e ndërtimit kanë përfunduar 10.03.2017.

- Preventivi i rishikuar është miratuar me VKT nr. 34/9, datë 23.11.2016 nga Titullari i Bashkisë së Tiranës pa ndryshuar shumën totale prej 105,142,356 lekë me TVSH.

- Me datë 03.04.2017, është mbajtur procesverbal-kolaudimi për “Rikualifikim urban i bllokut të kufizuar nga rruga “Muhamet Gjollësja” – “Myslym Shyri” – “Rruga e Kavajes” me Kufirin e Njësisë Bashkiake Nr. 10” dhe rezultoni i nënshkruar nga sipërmarrësi i punimeve “A...” SHPK, nga mbikëqyrësi i punimeve “Infratech” SHPK, nga koladatori shoqëria “Zenit-06” SHPK.

#### **B. Likuidimi i situacioneve për punimet e kryera, rezultoni.**

Për punimet e kryera në objekt për kontratën bazë dhe shtesë, janë paraqitur situacionet pjesore dhe përfundimtare, si vijon:

Nr.	Situacionet pjesore/përfundimtare	Urdher Shpenzimi	Data	Vlera
	Kontrata bazë			
1	Situacion 1	2331	28.12.2016	21,000,000
2	Situacion 1	558	29.03.2017	430,405
3	Situacion 2	558	29.03.2017	15,914,509
4	Situacion 2	712	13.04.2017	16,344,915
5	Situacion 3	1654	04.07.2017	31,310,171
6	Situacion 3	212	30.01.2018	7,327,997
7	Situacion 3	1295	23.04.2018	430,405
8	Situacion përfundimtar	214	30.01.2018	2,070,877
	Shtesë kontrate			
1	Situac përfundimtar	622	06.03.2019	18,447,062

### C. Mbi auditimin e realizimit të punimeve në terren.

Nga auditimi në terren për verifikimin e zërave të punimeve si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të administruara në dosjen teknike të zbatimit të vënë në dispozicion grupit të auditimit për punimet e kryera, rezultojnë diferenca në volume për punime të kryera në vlerën prej **1,289,110 lekë pa TVSH**.

Argumentimi i kësaj difference në volume punimesh, pasqyrohet si vijon:

#### IV. PUNIME PËR TROTUARËT (kontrata bazë)

##### Zëri 5 (3.243) Strukturë monolite betoni C 16/20 (për shtresë trotuari).

Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 253 m<sup>3</sup> beton me çmim 8,500 lekë. Libreza e masave pasqyron volumin 253 m<sup>3</sup> beton detajuar në mënyrë analitike.

Nga kontrolli i punimeve në objekt rezulton se paketa e trotuarit është realizuar me 4 shtresa dhe konkretisht: ( Pllaka betoni me t= 6 cm; Rërë 4 cm; Beton 10 cm; Çakëll 15 cm).

Po t'i referohemi VKM Nr. 629, date 15.07.201 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre" mbi analizën për zërin me nr. analize 3.620 është parashikuar që brenda çmimit 1305 lekë të përfshihet edhe një shtresë betoni me trashësi 6 cm. Nga auditimi i librezës së masave na rezulton se struktura monolite betoni C 16/20 është pasqyruar dhe librezuar me trashësi 10 cm dhe jo me trashësi 4 cm.

Sa më sipër rritja e volumit të shtresës së pllakave me 6 cm, ka shkaktuar rritjen e volumit të betonit me 151.66 m<sup>3</sup> (2,527.7 m<sup>2</sup> trotuar x 6 cm). Pra është realizuar shtresë betoni në volumin 101 m<sup>3</sup> (2,527.7 m<sup>2</sup> x 0.04 m) dhe jo 253 m<sup>3</sup> (2,527.7 m<sup>2</sup> x 0.1 m).

Diferenca e volumit prej 151.66 m<sup>3</sup> është librezuar dhe situacionuar më tepër dhe është përfituar në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi "Arifaj" sh.p.k., në vlerën **1,289,110 lekë pa TVSH** [151.66 m<sup>3</sup> x 8500 lekë].

#### Problematika të konstatuara nga auditimi:

1. Si përfundim në mënyrë të përmbledhur nga auditimi i zbatimit të punimeve për objektin "Rikualifikim urban i bllokut të kufizuar nga rruga "Muhamet Gjollesha" – "Myslym Shyri" – "Rruga e Kavajes" me Kufirin e Njësisë Bashkiake Nr. 10" rezulton se:

Sipërmarrësit të punimeve i janë likuiduar tepër për punime të pakryera në vlerën **1,289,110 lekë pa TVSH, vlerë që përbën efekt financiar negativ** ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore dhe duhet të zhëdmtohet menjëherë nga zbatuesi i punimeve "A..." SHPK.

2. Përsa i përket punimeve mbi vizimet me bojë bikomponente me gjerësi (d=12 cm) nga auditimi në fakt, u konstatua se për gjatësinë 1000 ml është përdorur bojë në kundërshtim me specifikimet teknike dhe pothuasje boja është fshirë fare.

3. Në 10 puseta, u konstatua se, mbingritja e pusetave ekzistuese në trupin e rrugës nuk është bërë në kuotën e përcaktuar në projekt dhe ka filluar shkatërrimi i tyre.

*Shqyrtimi dhe vlerësimi i komenteve të mbikëqyrësit të punimeve në observacionin me nr. prot. 30/4, datë 30.04.2019, mbi Akt-Konstatimin Nr. 16, datë 16.04.2019 për objektin: "Rikualifikim urban i*

bllokut të kufizuar nga rruga Muhamet Gjollësja-Myslym Shyri-Rruga e Kavajës, me kufirin e Njësisë Bashkiake Nr. 10 ” të mbajtur nga grupi i auditimit të KLSH-së, në zbatim në nenit 32, të Rregullores së Procedurave të Auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit (miratuar me vendim të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit Nr. 107, datë 08.08.2017 “Për miratimin e rregullores së procedurave të auditimit në kontrollin e lartë të shtetit” është trajtuar si vijon:

**a-Argumente dhe komente nga subjekti i audituar u trajtua si vijon:**

Mbikëqyrësi i punimeve shoqëria “Infratech” sh.p.k në observacionin e paraqitur pretendon se, realizimi i shtresës së beton është kryer me trashësi 16, dhe se problematika e ngritur duhet të rishikohet edhe njëherë.

**b-Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:**

Grupi i auditimit pasi e lexoi me kujdes observacionin sqaron se:

pretendimi Juaj se shtresa është realizuar me t= 16, bie në kundërshtim me Librin e masave që ju keni pasqyruar dhe me argumentet e paraqitura në observacion, grupi i auditimit nuk e merr në konsideratë observacionin dhe e konsideron si efekt financiar negativ shumë prej 387,700 lekë pa TVSh.

Nga ana e zbatuesit të punimeve nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në:

- **Ligjin nr. 8402**, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 8, ku përcaktohet se: “ ... Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose evropiane...”.

- **Kontratën e zbatimit me objekt** “Rikualifikim urban i bllokut të kufizuar nga rruga “Muhamet Gjollësja” – “Myslym Shyri” – “Rruga e Kavajës” me Kufirin e Njësisë Bashkiake Nr. 10”, të lidhur me datë 07.06.2016 dhe nr. prot. 11082/7, ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë dhe zbatuesit të punimeve të ndërtimit, OE “A...” SHPK.

- **Udhëzimin Nr. 2**, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” Kreu I “Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit”, pika 3 ku përcaktohet se: “Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit detyrohet të zbatojë punimet, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit e të zbatimit, normat e kushtet e legjislacionit të ndërtimit e të kontraktimit...”.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

**1. Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve** BOE “Infratech” SHPK & “Vler Invest” SHPK nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në:

- **Ligjin nr. 8402**, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7.

- **Kontratën për kryerjen e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve të kontratës me objekt** “Rikualifikim urban i bllokut të kufizuar nga rruga “Muhamet Gjollësja” – “Myslym Shyri” – “Rruga e Kavajës” me Kufirin e Njësisë Bashkiake Nr. 10” të lidhur midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë dhe BOE “Infratech” SHPK & “Vler Invest” SHPK.

- **UKM Nr. 3**, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, të ndryshuar, pika 3.2.

**2. Nga ana e kolaudatorit të punimeve** OE “Zenit-06” SHPK nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në:

- **Ligjin nr. 8402**, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 12.

- **Kontratën për kryerjen e shërbimit të kolaudimit së punimeve të kontratës me objekt** “Rikualifikim urban i bllokut të kufizuar nga rruga “Muhamet Gjollësja” – “Myslym Shyri” – “Rruga e Kavajës” me Kufirin e Njësisë Bashkiake Nr. 10” ndërmjet OE “Zenit-06” SHPK dhe Bashkisë Tiranë.

- **UKM Nr. 3** datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.

**X. Mbi auditimin e zbatimit të kontratës me objekt: “Ndërtim Palestre Shkolla e Mesme e Bashkuar Farkë”, u konstatua se:**

**A. Mbi kontratën e zbatimit të punimeve dhe mbikëqyrjes të punimeve si dhe realizimi i grafikut të punimeve.**

- Kontrata e zbatimit me objekt “Ndërtin palestre “Shkolla e Mesme e Bashkuar Farkë”, është lidhur me datë 08.03.2018 dhe nr. prot. 7747/4, ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë së Tiranës, përfaqësuar nga z. Erion Veliaj dhe Operatorit Ekonomik “A...” SHPK përfaqësuar nga administratori Z. A.B. Vlera e kontratës është 50,339,875 lekë me TVSH. Sipas nenit 3 (Afati i kontratës) të kontratës, afati i realizimit të punimeve do të jetë 7 (shtatë) muaj kalendarikë nga data e nënshkrimit të kontratës. Periudha e garancisë do të jetë 24 muaj kalendarik nga data e kolaudimit të objektit.

- Për kryerjen e shërbimit të mbikëqyrjes të punimeve të kontratës me objekt “Ndërtin palestre “Shkolla e Mesme e Bashkuar Farkë” është lidhur kontrata e shërbimit me nr. prot. 39467/12, datë 7.12.2017, me OE “Taulant” SHPK, me licencë “Për mbikëqyrje dhe kolaudin punimesh” me MK. 0382/4 me drejtues ligjor Znj. Ditika Qatipi. Objekti i kësaj kontrate është drejtimi i punimeve të zbatimit me objekt “Mbikëqyrja e punimeve për objektin”.

- Lirimi i sheshit, akti i piketimit në objekt dhe punimet kanë filluar me datë 08.03.2018.

- Drejtoria Arsimore Rajonale Qarku Tiranë me shkresën me nr. prot. 380, datë 1.10.2018 (protokolluar në bashkinë Tirane me nr. prot. 38863, datë 19.10.2018) ka bërë kërkesë për rritjen e lartësisë së palestres me 2 metër.

Bashkia Tiranë me nr. prot. 34594/3, datë 23.10.2018 i drejtohet me kërkesë për ndryshim porosie, mbikëqyrësit dhe zbatuesit të punimeve.

Mbikëqyrësi i punimeve me datë 30.10.2018 njofton AK për ndërprerje punimesh, për shkak të ndryshimit të porosisë kërkuar nga bashkia me shkresën nr. prot. 34594/3.

- Nga mbikëqyrësi i punimeve shoqëria “Taulant” SHPK me shkresën nr. prot. 271, datë 18.09.2018 (Protokolluar në Bashkinë Tiranë me nr. prot. 34524, datë 19.09.2018) është propozuar zgjatja e afatit me 95 ditë, si pasojë e motit të keq.

Sipas shkresë me nr. prot. 34524/2, datë 05.10.2018 është nënshkruar akt-marrëveshje, ku bashkia Tiranë vendosi shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve për një periudhë kohore 95 (nëntëdhjetë e pesë) ditë, duke filluar nga data 08.10.2018 deri në datë 10.01.2019.

Mbikëqyrësi i punimeve “Taulant” SHPK me shkresën me nr. prot. 373, datë 14.11.2018 i dërgon dokumentacionin teknik për ndryshimin e porosisë, mbështetur edhe në kërkesë-propozim për plotësim dhe përmirësim të projekt-preventivit të objektit “Ndërtim palestre shkolla e mesme e bashkuar Farkë”.

- Drejtoria e Investimeve të Punëve Publike me shkresë me nr. prot. 936/1, datë 10.01.2019 i drejtohet z. Taulant Tusha, mbështetur në propozimin e mbikëqyrësit të punimeve për shtyrjen e afatit të përfundimit të kontratës me 73 ditë, ( që vjen nga shtyrja e 95 ditëve të shtuara) për të mbyllur projektin fillestar dhe nëse miratohet kontrata shtesë, ajo të ketë afatet e saja përkatëse.

- Sipërmarrësi i punimeve shoqëria “Arifaj” SHPK si dhe Mbikëqyrësi i punimeve me shkresën me nr. prot. 86, datë 20.03.2019 (protokolluar në Bashkinë e Tiranës me nr. prot. 12781, datë 20.03.2019) ka vënë në dijeni Investitorin Bashkia Tiranë dhe për dijeni sipërmarrësin shoqërinë “Arifaj” SHPK mbi përfundimin e afatit të ndërprerjes së punimeve; ku në bazë të Akt-Marrëveshjes së dytë Nr. 936/2, datë 10.01.2019 sipërmarrësit të punimeve iu caktua afati i përfundimit me datë 24.03.2019 (72 ditë). Ndërkohë punimet vazhdojnë të jenë të ndërprera deri në miratimin e Ndryshim Porosie nga AK. Në k’ të shkresë kërkohet shtyrje afati me të njëjtën afat 73 ditë.

Në vijim, Drejtoria e Investimeve të Punëve Publike (DIPP) me memon me nr. prot. 12781/1, datë 21.03.2019, paraqet pranë DPPP informon Drejtorin e DPP mbi kërkesën e mbikëqyrësit të punimeve për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve:

- Lidhur me propozimin teknik për ndryshimin e porosisë si dhe nga fakti që pa miratim e këtyre ndryshimeve, nuk mund të vazhdohet zbatimi i punimeve të ndërtimit, me 29 tetor 2018, mbikëqyrësi i punimeve dhe sipërmarrësi kanë vendosur ndërprerjen e punimeve deri

në momentin e njoftimit të Vendimit të Këshillit Teknik të Bashkisë, lidhur me ndryshimet në fjalë, dhe më pas miratimit të shtesës së Kontratës në APP.

**Likuidimi i situacioneve për punimet e kryera, rezulton.**

Punimet e kryera në objekt janë paraqitur në situacionet pjesore si vijon:

- Situacioni pjesor nr. 1 mbi periudhën nga fillimi deri në datë 17.12.2018, me vlerë 12,371,500 lekë me TVSH. Nga ana e Autoritetit Kontraktor nuk është bërë likuidimi i këtij situacioni.

**C. Si përfundim në mënyrë të përmbledhur nga auditimi i kontratës “Ndërtim Palestre Shkolla e Mesme e Bashkuar Farkë” rezulton se:**

1. Nga auditimi në terren i realizimit të punimeve të ndërtimit që i përkasin situacionit pjesor nr. 1 për periudhën nga fillimi i punimeve datë 08.03.2018 deri në datë 31.12.2018 (brenda periudhës së auditimit) si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të administruara në dosjen teknike të zbatimit të vënë në dispozicion grupit të auditimit për punimet e kryera, nuk rezultojnë diferenca në volume për punime të kryera dhe të situacionuara në situacionin pjesor nr. 1, me shumë 12,371,500 lekë me TVSH.
2. Nga auditimi i punimeve në terren për periudhën e auditimit deri me datë 31.12.2018, rezulton se, punimet e ndërtimit kanë përfunduar në masën rreth 30 %, pra vërehet se ecuria e punimeve të ndërtimit paraqitet e ngadaltë në raport me grafikun e kryerjes së punimeve dhe zbatim të kushteve të kontratës.
3. Autoriteti Kontraktor duhet të ushtrojë kontrole dhe t’i kërkojë sipërmarrësit të punimeve përshpejtimin e realizimit të punimeve sipas shtyrjeve të afateve dhe grafikut të ri të punimeve. Autoriteti Kontraktor aktualisht nuk ka dalur me një Vendim të Këshillit Teknik se si do të veprohet për projektin e ndryshuar.
4. Pas vlerësimit nga ana jonë konstatohet se, problematikat e ngritura në lidhje me vonesat për përfundimin e punimeve sipas afatit të kontratës qëndrojnë.

Sa më sipër trajtuar Autoriteti Kontraktor në zbatim të kushteve kontraktuale dhe në përputhje me nenin 23, pika 5 të kontratës së sipërmarrjes, duhet të marrë një vendim mbi shtyrjen apo lidhjen e shtesës së kontratës.

**XI. Mbi auditimin e zbatimit të kontratës me objekt: “Rehabilitim i pjesshëm dhe instalim i sistemit ngrohjes në shkollën 9-vjeçare “Dhora Leka”, u konstatua se:**

**A. Mbi kontratën e zbatimit të punimeve, mbikëqyrjes dhe kolaudit të punimeve si dhe realizimit të grafikut të punimeve.**

Kontrata e zbatimit me objekt: “Rehabilitim i pjesshëm dhe instalim i sistemit ngrohjes në shkollën 9-vjeçare “Dhora Leka”, është lidhur me datë 11.09.2017 dhe nr. prot. 27633/6, ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Tiranë, përfaqësuar nga Z. Erion Veliu dhe Operatorit Ekonomik “K...” SHPK, me licencë profesionale NZ.4838/15, përfaqësuar nga administratori (përfaqësuesi ligjor) Z. S. L. Vlera e kontratës bazë është 64,251,383 lekë me TVSH. Afati i realizimit të punimeve do të jetë 6 (gjashtë) muaj kalenderikë nga data e lidhjes së kontratës. Periudha e garancisë do të jetë 24 muaj, duke filluar nga data e marrjes në dorëzim të punimeve. Nisur nga shkresa Nr. 9849, datë 08.03.2018 të mbikëqyrësit të punimeve, është kërkuar shtyrja e afatit të punimeve me 2 (dy) muaj kalendarik me pretendimin se, temperaturat gjatë muajt dhjetor dhe janar kanë sjellë ndërprerje të betonimeve në objekt për shkak të ngricave të mëdha. Bashkia e Tiranës si AK, me akt-marrëveshjen me nr. prot. 9849/2, datë 08.03.2018, ka vendosur shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve duke filluar nga data 10.03.2018 deri në datën 09.05.2018.

Nisur nga shkresa Nr. 1825, datë 09.05.2018 të mbikëqyrësit të punimeve, është kërkuar shtyrja e afatit të punimeve me 45 (dyzet e pesë) ditë kalendarike me pretendimin se, koha e kërkuar për rishikimin e projektit dhe e pasqyrimin të ndryshimeve në preventivin e rishikuar si dhe miratimin e tyre. Bashkia e Tiranës si AK, me akt-marrëveshjen me nr. prot. 18285/2, datë 09.05.2018, ka vendosur shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve me 45 ditë, duke filluar nga data 09.05.2018 deri në datën 23.06.2018. Vlera e preventivit të rishikuar është 64,251,307 lekë me TVSH. Projekti i zbatimit i rishikuar është miratuar nga Kryetari i Bashkisë Tiranë me VKT Nr. 22/4, datë 15.12.2017.

Për kryerjen e shërbimit të mbikëqyrjes të punimeve të kontratës me objekt: Rehabilitim i pjesshëm dhe instalim i sistemit ngrohjes shkolla 9-vjeçare “Dhora Leka” është lidhur kontrata e shërbimit me nr. prot. 27501/12, datë 30.08.2017, ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Tiranë, përfaqësuar nga Z. Erion Veliu dhe OE “A & E Engineering” SHPK përfaqësuar nga Zj. Entela Çano, me licenc NR. MK 1476/8 dhe me Vlerë të kontrate 480,000 lekë me TVSH.

Për kryerjen e shërbimit të kolaudimit të punimeve të kontratës me objekt: Rehabilitim i pjesshëm dhe instalim i sistemit ngrohjes shkollën 9-vjeçare “Dhora Leka” është lidhur kontrata e shërbimit me nr. prot. 24594/2, datë 17.07.2018, ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Tiranë, përfaqësuar nga Z. Erion Veliu dhe OE “Tesla Vizion” SHPK përfaqësuar nga z. Defrim Çelami, me licenc NR. MK 2454/4, datë 27.04.2017 dhe me vlerë të kontrate 42,244 lekë me TVSH. Lirimi i sheshit dhe akti i piketimit në objekt janë bërë me datë 11.09.2017. Punimet e ndërtimit kanë filluar me datë 11.09.2017 dhe duhet të përfundonin sipas kontratës bazë me datë 03.06.2018, por bazuar në shtesat në dy shtesat të miratuara për zgjatjen e afatit të përfundimit të punimeve, vepra përfundon me datë 23.06.2018.

Me datë 03.08.2017 është mbajtur procesverbal, mbi kolaudimin e punimeve të objektit: “Rehabilitim i pjesshëm dhe instalim i sistemit ngrohjes shkollën 9-vjeçare “Dhora Leka” dhe është nënshkruar nga përfaqësuesi i OE “Klajger Konstruksion” SHPK, përfaqësuar nga z. Sadik Lumi nga Mbikëqyrësi i punimeve OE “A&E Engineering” SHPK, përfaqësuar nga Zj. Entela Çano dhe nga Kolaudatori i punimeve OE “Tesla Vizion” përfaqësuar nga z. Defrim Çelami.

#### **B. Likuidimi i situacioneve për punimet e kryera, rezulton.**

Për punimet e kryera në objekt janë paraqitur si vijon:

- Situacioni pjesor nr. 1, me vlerë 13,357,644.10 lekë me TVSH.
- Situacioni pjesor nr. 2, me vlerë 38,324,755.904 lekë me TVSH.
- Situacioni përfundimtar, me vlerë 9,356,341.950 lekë me TVSH.

Nga autoriteti Kontraktor Bashkia e Tiranës janë likuiduar situacionet si vijon:

- Situacion nr. 1, me USH nr. 2505, datë 30.07.2018 dhe shumë 12,850,276 lekë.
- Situacion nr. 1, me USH nr. 3711, datë 07.11.2018 dhe shumë 507,368 lekë.
- Situacion nr. 2, me USH nr. 3712, datë 07.11.2018 dhe shumë 14,725,983 lekë.
- Situacion nr. 2, me USH nr. 361, datë 08.02.2019 dhe shumë 23,598,773 lekë.

Nga situacionin e mësipërm është mbajtur 5% e shumës së preventivit të rishikuar.

#### **C. Mbi auditimin e realizimit të punimeve në terren.**

Si përfundim në mënyrë të përmbledhur nga auditimi mbi realizimin e punimeve të ndërtimit për objektin: “Rehabilitim i pjesshëm dhe instalim i sistemit ngrohjes në shkollën 9-vjeçare “Dhora Leka” na rezulton se:

1- Objekti është ndërtuar sipas projektit të zbatimit bazë dhe të rishikuar dhe të miratuar me V.K.T Nr. 22/4, datë 15.12.2017, kushteve teknike të detyrueshme në zbatim, specifikimeve teknike të evidentuara në kontratën e sipërmarrjes nr. 27633/6, datë 11.09.2017.

2- Objekti është zbatuar plotësisht dhe nuk ka shmangie në drejtimin funksional, të qëndrueshmërisë dhe të destinacionit.

3- Objekti në formë, dimension, sipërfaqe e vëllim është sipas projektit të hartuar dhe ndryshimeve nga investitori.

4- Volumet dhe klasat e betoneve janë sipas llojeve të punimeve në objekt.

5- Zërat e punimeve janë realizuar sipas preventivit të rishikuar dhe të miratuar V.K.T Nr. 22/4, datë 15.12.2017. Punimet e maskuara janë vertetuar me proces verbalet përkatëse të mbajtura midis Mbikëqyrësit dhe Sipërmarrësit të punimeve.

6- Çmimet e zbatuara në situacionin përfundimtar, janë sipas çmimeve të preventivit të ofertës dhe preventivit të rishikuar të miratuar, pjesë integrale e kontratës bazë Nr. 27633/6, datë 11.09.2017.

7- Nga auditimi në terren për verifikimin e zërave të punimeve si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të administruara në dosjen teknike të zbatimit të vënë në dispozicion grupit të auditimit për punimet e kryera, nuk rezultojnë diferenca në volume për punimet e kryera, por u konstatuan 2 problematika si vijon:

- Në dosje nuk është dokumentacioni mbi marrjen në dorëzim të punimeve të ndërtimit, që i përket kontratës. Ky veprim është në kundërshtim me kontratën nr. prot. 27633/6, datë 11.09.2017, neni 38 ku përcaktohet se: "...Me përfundimin e procedurës së kolaudimit Autoriteti Kontraktor lëshon certifikatën e marrjes në dorëzim të punimeve të kryera dhe do të fillojë garancinë e sigurimit të kontratës...". Sa më sipër, Autoriteti Kontraktor Bashkia Tiranë, Mbikëqyrësi i punimeve, Zbatuesi i punimeve, grupi i marrjes në dorëzim si dhe kolaudatori i punimeve, të plotësojnë dosjen teknike.

- Në preventivin e ripunuar sa vlera e kontratës të miratuar nga Kryetari i AK, Bashkisë Tiranë me VKT Nr. 22/4, datë 13.12.2017 u konstatua se, fondi rezervë në shumën 2,162,310 lekë pa TVSH është shkruar në preventivin e ripunuar, pa hartuar më parë procedurën e përdorimit të fondit rezervë (Preventiv për fondin rezervë, proces-verbal i sigluar nga AK, Zbatuesi dhe Mbikëqyrësi i punimeve), i cili kontrollohet dhe autorizohet vetëm nga mbikëqyrësi i punimeve. Ky veprim është në kundërshtim me UKM Nr. 3, datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, pika 19.

8- Sipërmarrësi i punimeve "Klajger Konstruksion" SHPK ka zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në: (Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar, Kreu III, neni 8; Kontratën e zbatimit me objekt "Rehabilitim i pjesshëm dhe instalim i sistemit ngrohjes në shkollën 9-vjeçare "Dhura Leka", të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë së Tiranës dhe "K..." SHPK; Udhëzimin Nr. 2, datë 13.5.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit" Kreu I "Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit", pika 3).

**XII. Mbi auditimin e zbatimit të kontratës me objekt: "Rikualifikim Urban i zonës që kufizohet me rrugën e Durrësit, Teodor Keko, Lumi Lana, Anesti Lubonja si dhe parku tek ish pista e aviacionit, Njësia Bashkiake Nr. 7", u konstatua se:**

**Të përgjithshme:** Objekti "Ndërtimi dhe rikonstruksioni i rrugës "Rikualifikim Urban i zonës që kufizohet me rrugën e Durrësit, Teodor Keko, Lumi Lana, Anesti Lubonja si dhe parku tek ish pista e aviacionit, Njësia Bashkiake Nr. 7" synon në përmirësimin e infrastrukturës së Bashkisë Tiranë, gjendjen e trafikut të mjeteve dhe kushtet e banimit për banorët që banojnë në territorin e këtij blloku dhe më gjerë. Ky bllok ka një formë të shtrirë në trajtë drejtëndëshi pothuaj paralelisht me Lumin e Lanës dhe rrugën nacionale Tiranë-Durrës, Unazës së madhe të Tiranës me sipërfaqe rreth 14.7 ha. Rikonstruksioni i këtij blloku i shërben 5,000 qytetarëve të zonës. Projekti i zbatimit është miratuar me V.K.T Nr. 8, datë 20.03.2013 (Referuar deklaratës teknike të sipërmarrësit).

**A. Mbi kontratën e zbatimit të punimeve, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve si dhe realizimit të grafikut të punimeve.**

Kontrata e zbatimit me objekt "Ndërtimi dhe rikonstruksioni i rrugës "Rikualifikim Urban i zonës që kufizohet me rrugën e Durrësit, Teodor Keko, Lumi Lana, Anesti Lubonja si dhe parku tek ish pista e aviacionit, Njësia Bashkiake Nr. 7", është lidhur me datë 10.06.2013 dhe nr. prot. 62/6, ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë së Tiranës, përfaqësuar nga z. Etion Kapedani dhe Operatorit Ekonomik "C..." SHPK përfaqësuar nga Z. F.C. Vlera e kontratës është 96,139,323 lekë me TVSH. Sipas nenit 3 (Afati i kontratës) të kontratës, afati i realizimit të punimeve do të jetë 8 (tetë) muaj kalendarikë nga data e nënshkrimit të kontratës. Periudha e garancisë do të jetë 24 muaj kalendarik nga data e kolaudimit të objektit.

Për kryerjen e shërbimit të mbikëqyrjes të punimeve të kontratës me objekt "Ndërtimi dhe rikonstruksioni i rrugës "Rikualifikim Urban i zonës që kufizohet me rrugën e Durrësit, Teodor Keko, Lumi Lana, Anesti Lubonja si dhe parku tek ish pista e aviacionit, Njësia Bashkiake Nr. 7" është lidhur kontrata e shërbimit me nr. prot. 72/27, datë 10.06.2013, ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë së Tiranës, përfaqësuar nga z. E.K dhe OE "G..." SHPK, me licencë "Për mbikëqyrje dhe kolaudim punimesh" me MK. 1735/10 me drejtues ligjor z. Hamit Mustafa. Objekti i kësaj kontrate

është drejtimi i punimeve të zbatimit me objekt “Mbikëqyrja e punimeve për objektin ”. Vlera e kontratës së mbikëqyrjes është 1,167,600 lekë me TVSH.

Për shërbimin e kolaudimit të punimeve të ndërtimit të kontratës me objekt “Ndërtimi dhe rikonstruksioni i rrugës “Rikualifikim Urban i zonës që kufizohet me rrugën e Durrësit, Teodor Keko, Lumi Lana, Anesti Lubonja si dhe parku tek ish pista e aviacionit, Njësia Bashkiake Nr. 7” është lidhur kontrata me nr. prot. 33050/2, datë 25.11.2016, ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë së Tiranës, përfaqësuar nga z. Erion Veliaj dhe OE “Rean-95” SHPK, me licencë me MK. 1506/6, datë 17.09.2012 me përfaqësues drejtues ligjore Znj. Razie Naipi. Objekti i kësaj kontrate është shërbimi i kolaudimit të punimeve në objektin “Ndërtimi dhe rikonstruksioni i rrugës “Rikualifikim Urban i zonës që kufizohet me rrugën e Durrësit, Teodor Keko, Lumi Lana, Anesti Lubonja si dhe parku tek ish pista e aviacionit, Njësia Bashkiake Nr. 7”.

- Projekti është hartuar nga shoqëria projektuese “Klodioda” SHPK në vitin 2013, i përbërë nga grupi i inxhinierëve: Ing. Ylli Karapici; Ing. Nikollaq Aleks; Ing. Xhevahir Aliu; Ing. Blerta Merdini dhe Ing. Najada Mustafaj dhe është miratuar nga Bashkia Tiranë.

-Punimet e ndërtimit janë ndërprerë në datë 15.07.2013, ndërprerja është urdhëruara nga investitori, Bashkia Tiranë, për shkak se sheshi i ndërtimit nuk është i lirë, dhe për këtë duhen bërë shpronsime të pronarëve dhe për shkak se objekti nuk ka qenë i pajisur me leje zhvillimore. Në vijim sipas akt-marrveshjes me nr. prot. 13325/2, datë 05.05.2016, afati i përfundimit të punimeve është shtyrë për një periudhë kohore 8 (tetë) muaj duke filluar nga data e lidhjes së Akt-Marrëveshjes.

-Punimet rifilluan me datë 27.04.2016, sipas njoftimit të bërë nga mbikëqyrësi “Gjeokonsult & Co” SHPK. Sheshi i ndërtimit të punimeve u lirua me datë 03.05.2016. Procesverbal mbi fillimin e punimeve është mbajtur me datë 09.05.2016. akti i piketimit në objektin “Rikualifikim Urban i zonës që kufizohet me rrugën e Durrësit, Teodor Keko, Lumi Lana, Anesti Lubonja si dhe parku tek ish pista e aviacionit, Njësia Bashkiake Nr. 7” është mbajtur me datë 10.05.2016.

Punimet e ndërtimit, sipas proces verbalit mbi përfundimin e punimeve të objektit: “Rikualifikim Urban i zonës që kufizohet me rrugën e Durrësit, Teodor Keko, Lumi Lana, Anesti Lubonja si dhe parku tek ish pista e aviacionit, Njësia Bashkiake Nr. 7” nënshkruar nga mbikëqyrësi i punimeve dhe sipërmarrësi i punimeve, kanë përfunduar me datë 27.10.2016.

- Preventivi bazë me vlerë 96,139,323 lekë me TVSH është ndryshuar dhe është miratuar me procesverbalin me objekt: për ndryshimin e disa zërave punimesh në objekt (punime që shtohen dhe hiqen), me shumë 95,742,870 lekë me TVSH.

Me përfundimin e punimeve të objektit “Rikualifikim Urban i zonës që kufizohet me rrugën e Durrësit, Teodor Keko, Lumi Lana, Anesti Lubonja si dhe parku tek ish pista e aviacionit, Njësia Bashkiake Nr. 7” me datë 27.10.2016, është mbajtur Akt-Kolaudimi pa datë dhe pa nr. prot. Ky akt-kolaudimi është nënshkruar nga Kolaudatori shoqëria “Rean 95” SHPK përfaqësuar nga Ing. Razie Naipi; nga sipërmarrësi i punimeve “Curri” SHPK, përfaqësuar nga Ing. Faik Curri dhe nga mbikëqyrësi i punimeve “Gjeokonsult & CO” SHPK, përfaqësuar nga Drejtuesi Ligjor Z. Hamit Mustafa.

## **B. Likuidimi i situacioneve për punimet e kryera, rezulton.**

Punimet e kryera në objekt janë paraqitur në situacionet pjesore si vijon:

- Situacioni pjesor nr. 1 me vlerë 81,020,598 lekë me TVSH. (Fatura Tatimore Nr. 06, 27.02.2017).
- Situacioni i fondit rezervë nr. 1 me vlerë 4,576,170 lekë me TVSH. Për përdorimin e fondit rezervë është mbajtur proces verbal, i cili është nënshkruar nga sipërmarrësi i punimeve “Curri” SHPK, nga Mbikëqyrësi i punimeve, nga përfaqësuesit e investitorit dhe është hartuar preventivi i fondit rezervë.
- Vlera e Situacionit përfundimtar është 91,166,700 lekë pa TVSH + Fondi rezervë 4,756,170 lekë pa TVSH, është 95,742,870 lekë me TVSH.

Nga Autoriteti Kontraktor janë bërë likuidimet si vijon:

- Situacioni nr. 1, me USH nr. 2259, datë 28.09.2017 dhe shumë 46,000,000 lekë.
- Situacioni nr. 1, me USH nr. 244, datë 31.01.2018 dhe shumë 10,311,759 lekë.
- Situacioni përfundimtar, me USH nr. 243, datë 31.01.2018 dhe shumë 34,643,968 lekë.
- 5% Garanci punimesh, me USH nr. 232, datë 01.02.2019 dhe shumë 4,787,143 lekë.



### **C. Mbi auditimin e realizimit të punimeve në terren.**

Si përfundim në mënyrë të përmblodhur nga auditimi mbi realizimin e punimeve të ndërtimit për objektin: “Ndërtimi dhe rikonstruksioni i rrugës “Rikualifikim Urban i zonës që kufizohet me rrugën e Durrësit, Teodor Keko, Lumi Lana, Anesti Lubonja si dhe parku tek ish pista e aviacionit, Njësia Bashkiake Nr. 7”, na rezulton se:

1. Objekti: “Ndërtimi dhe rikonstruksioni i rrugës “Rikualifikim Urban i zonës që kufizohet me rrugën e Durrësit, Teodor Keko, Lumi Lana, Anesti Lubonja si dhe parku tek ish pista e aviacionit, Njësia Bashkiake Nr. 7” është ndërtuar sipas projektit të rishikuar të miratuar, kushteve teknike të detyrueshme në zbatim, specifikimeve teknike të evidentuara në kontratën e sipërmarrjes.

2. Gjatë zbatimit të objektit, janë respektuar kondicionet urbane të përcaktuara sipas plan vendosjes..

3. Objekti është zbatuar plotësisht dhe nuk ka shmangie në drejtimin funksional, të qëndrueshmërisë dhe të destinacionit.

- objekti në formë, dimension, sipërfaqe e vëllim është sipas projektit të hartuar dhe ndryshimeve të miratuara nga investitori.

- volumet dhe klasat e betoneve janë sipas llojeve të punimeve në objekt.

4. Zërat e punimeve janë realizuar sipas preventivit të rishikuar dhe të miratuar V.K.T Nr. 8. Punimet e maskuara janë vertetuar me proces verbalet përkatëse të mbajtura midis Mbikëqyrësit dhe Sipërmarrësit të punimeve.

5. Çmimet e zbatuara në situacionin përfundimtar për kontratën bazë, janë sipas çmimeve të preventivit të ofertës dhe preventivit të rishikuar të miratuar, pjesë integrale e kontratës bazë.

6. Nga auditimi në terren për verifikimin e zërave të punimeve si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të administruara në dosjen teknike të zbatimit të vënë në dispozicion grupit të auditimit, na rezulton se:

- Aksi nr. 10, Prof 96 në ( 0+120 m) deri Prof 97 (0+135 m), si dhe në Prof 188 në (0+61.88 m) deri Prof 189 m në (0+63 m), janë dëmtuar shtresat asfaltike (binder + asfaltobeton) në sasinë 20 m<sup>2</sup>.

7. Sipërmarrësi i punimeve “CURRI” SHPK ka zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në: (Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 8; Kontratën e zbatimit me objekt: “Ndërtimi dhe rikonstruksioni i rrugës “Rikualifikim Urban i zonës që kufizohet me rrugën e Durrësit, Teodor Keko, Lumi Lana, Anesti Lubonja si dhe parku tek ish pista e aviacionit, Njësia Bashkiake Nr. 7”, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë së Tiranës dhe “CURRI” SHPK dhe Udhëzimin Nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” Kreu I “Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit”, pika 3).

**XIII. Mbi auditimin e zbatimit të kontratës me objekt: “Rikonstruksion i rrugës “Mihal Grameno” dhe degëzimit të rrugës “Budi” – Depo e ujit” (Faza e dytë)”, u konstatua se:**

Të përgjithshme: Objekti i kontratës “Rikonstruksion i rrugës “Mihal Grameno” dhe degëzimit të rrugës “Budi” – Depo e ujit” (Faza e dytë)”, Tiranë shtrihet në pjesën jug-lindore të qytetit të Tiranës dhe kanë një gjatësi prej 600 m, i cili ka rëndësi për lëvizjen e banorëve të kësaj zone dhe si aks kryesor lidhës midis periferisë së Tiranës me Bulevardin “Petro Nini Luarasi” si dhe dy degëzimet e saj me gjatësi rreth 485 ml.

**A. Mbi kontratën e zbatimit të punimeve, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve si dhe realizimit të grafikut të punimeve.**

Kontrata e zbatimit me objekt : “Rikonstruksion i rrugës “Mihal Grameno” dhe degëzimit të rrugës “Budi” – Depo e ujit” (Faza e dytë)”, Tiranë është lidhur me datë 09.06.2017 dhe nr. prot. 10059/6, ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë së Tiranës, përfaqësuar nga z. Erion Veliaj dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomik “Kacdedja” SHPK përfaqësuar nga Z. Skënder Kacdedja & “Agri Konstruksion” SHPK, përfaqësuar nga D.L z. Petrit Patushi. Vlera e kontratës është 82,962,607 lekë me TVSH. Sipas nenit 3 (Afati i kontratës) të kontratës, afati i realizimit të punimeve do të jetë 6 (gjashtë) muaj kalendarikë nga data e nënshkrimit të kontratës. Periudha e garancisë do të jetë 24 muaj kalendarik nga data e kolaudimit të objektit.

Për kryerjen e shërbimit të mbikëqyrjes të punimeve të kontratës me objekt : “Rikonstruksion i rrugës “Mihal Grameno” dhe degëzimit të rrugës “Budi” – Depo e ujit” (Faza e dytë)”, Tiranë është lidhur kontrata e shërbimit me nr. prot. 22461/1, datë 06.06.2017 me OE “Toëer” SHPK, me licencë “Për mbikëqyrje dhe kolaudim punimesh” me MK. 1431/6 me drejtues ligjor z. Irdi Kulla. Objekti i kësaj kontrate është drejtimi i punimeve të zbatimit me objekt “Mbikëqyrja e punimeve për objektin ”.

Për shërbimin e kolaudimit të punimeve të ndërtimit të kontratës me objekt “Rikonstruksion i rrugës “Mihal Grameno” dhe degëzimit të rrugës “Budi” – Depo e ujit” (Faza e dytë)” është lidhur kontrata me nr. prot. 3019/2, datë 27.04.2017, ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë së Tiranës, përfaqësuar nga z. Erion Veliaj dhe BOE “Diper” SHPK, me licencë MK. 1678/1, datë 17.09.2012 me përfaqësues drejtues ligjore Znj. Stela Guxo.

- Projekti është hartuar nga shoqëria projektuese “Klodioda” SHPK në vitin 2013 dhe është miratuar nga përfaqësuesi i Bashkisë së Tiranës z. Etion Kapedani me VKT Nr. 3/7, datë 19.03.2014.

Informacioni i përgjithshëm mbi zbatimin e kontratës jepet siap tabelës:

<b>Të përgjithshme mbi dokumentacionin tekniko-ligjor</b>	<b>Nr. Prot.</b>	<b>Data</b>	<b>Palët e angazhuara dhe përfaqësuesit e tyre</b>
Kontrata e sipërmarrjes, vl =82,962,607 Lekë me TVSH	10059/6	09.06.2017	- AK, përfaqësuar nga z. Erion Veliaj - zbatues “Kacdedja” shpk & “ Agri Konstruksion” shpk, përfaqësuar nga Z. Skënder Kacdedja.
Akt-Marrëveshje për zgjatje afati punimesh për 2 muaj deri me datë <b>09.02.2018</b>	43897/2	07.12.2017	- AK, përfaqësuar nga z. Erion Veliaj - zbatues “Kacdedja” shpk & “ Agri Konstruksion” shpk
Akt-Marrëveshje për zgjatje afati punimesh për 20 ditë kalendarike deri me datë <b>28.02.2018</b>	5688/2	08.02.2018	- AK, përfaqësuar nga z. Erion Veliaj - mbikëqyrës “Toëer” shpk & “ Agri Konstruksion” shpk
Kontratë mbikëqyrjesh punimesh	22461/1	06.06.2017	- AK, përfaqësuar nga z. Erion Veliaj - mbikëqyrës “Toëer” shpk, përf nga z. Irdi Kulla.
Kontratë shërbim kolaudimi	8682/2	08.03.2018	- AK, përfaqësuar nga z. Erion Veliaj - kolaudatori “Diper” shpk, përf nga zj. Stela Guxo.
Njoftim fillim punimesh		12.06.2017	- zbatues “Kacdedja” shpk & “ Agri Konstruksion” shpk
Akt-dorëzimi i sheshit të ndërtimit	-	12.06.2017	- AK, përfaqësuar nga DIPP, z. Rigels Balla dhe DPPP, z. Taulant Tusha. - zbatues “Kacdedja” shpk & “ Agri Konstruksion” shpk, përfaqësuar nga Z. Skender Kacdedja - mbikëqyrës “Toëer” shpk, përf nga z. Irdi Kulla.
Proces-verbal mbi akt-piketimin në objekt		12.06.2017	- AK, përfaqësuar nga drejtori i DIPP, z. Rigels Balla dhe, -drejtori i DPPP, z. Taulant Tusha. - zbatues JV “Kacdedja” shpk & “ Agri Konstruksion” shpk, përfaqësuar nga Z. Skender Kacdedja - mbikëqyrës “Toëer” shpk, përf nga z. Irdi Kulla
Akt-piketimi	-	12.06.2017	- zbatues JV “Kacdedja” shpk & “ Agri Konstruksion” shpk, përfaqësuar nga Z. Skender Kacdedja - mbikëqyrës “Toëer” shpk, përf nga z. Irdi Kulla
Procesverbal mbi fillimin e punimeve	-	12.06.2017	- AK, përfaqësuar nga Drejtori i DIPP, z. Rigels Balla dhe Drejtori i DPPP, z. Taulant Tusha. - zbatues JV “Kacdedja” shpk & “ Agri Konstruksion” shpk, përfaqësuar nga Z. Skender Kacdedja - mbikëqyrës “Toëer” shpk, përf nga z. Irdi Kulla
Preventiv i ofertës fituese	-	82,962,607	- zbatues “Kacdedja” shpk & “ Agri Konstruksion” shpk, përfaqësuar nga Z. Skender Kacdedja
Projekt Zbatimi i Rishikuar	VKT nr. 22/1	15.12.2017	Vendimi i Këshillit Teknik
Preventiv i ripunuar, VL = 82,962,066 lekë me TVSH.	VKT nr. 22/1	15.12.2017	-Miratuar nga Kryetari i Bashkisë z. Erion Veliaj - zbatues JV “Kacdedja” shpk & “ Agri Konstruksion” shpk, përfaqësuar nga Z. Skender Kacdedja - mbikëqyrës “Toëer” shpk, përf nga z. Irdi Kulla
Deklarate Teknike e sipërmarrësit	-	28.02.2018	- zbatues “Kacdedja” shpk & “ Agri Konstruksion” shpk, përfaqësuar nga Z. Skender Kacdedja - Drejtuesi teknik, Zj. Zuzana Mullahaj
Njoftim për Përfundim punimevësh nga	51	28.02.2018	- zbatuea “Kacdedja” shpk & “ Agri Konstruksion” shpk, përfaqësuar

zbatuesi i punimeve “Kacdedja” shpk			nga Z. Skender Kacdedja - Drejtuesi teknik, Zj. Zuzana Mullahaj
Njoftim për Përfundimim punimevesh nga mbikëqyrësi i punimeve “Toëer” shpk	36/31	28.02.2018	Mbikëqyrësi “Toëer” shpk, përfaqësuar nga z. Idri Kulla dhe Ing. Myslim Sejati.
Relacion përfundimtar i mbikëqyrësit “Toëer” shpk	-	26.03.2018	Mbikëqyrësi “Toëer” shpk, përfaqësuar nga z. Idri Kulla.
Proces-verbal i dorëzimit të punimeve	M136	28.02.2018	- Mbikëqyrësi “Toëer” shpk, përfaqësuar nga z. Idri Kulla - zbatues “Kacdedja” shpk & “Agri Konstruksion” shpk, nënshkruar nga Drejtuesi teknik, Zj. Zuzana Mullahaj
Proces-verbali i kolaudimit të punimeve	-	14.03.2018	- zbatuesi “Kacdedja” shpk & “Agri Konstruksion” shpk, përfaqësuar nga Z. Skender Kacdedja - Drejtuesi teknik, Zj. Zuzana Mullahaj - Mbikëqyrësi i punimeve OE “Toëer” shpk, përf nga z. Irdi Kulla - Kolaudatori OE “Diper” shpk, përfaqësuar nga Ing. Stela Guxo.

### **B. Likuidimi i situacioneve për punimet e kryera, rezulton.**

Punimet e kryera në objekt janë paraqitur në situacionet pjesore/përfundimtare si vijon:

- Situacioni pjesor nr. 1 me vlerë 27,990,300 lekë me TVSH.
- Situacioni pjesor nr. 2 me vlerë 31,396,152 lekë me TVSH.
- Situacioni përfundimtar me vlerë 23,575,614 lekë me TVSH.

Nga Autoriteti Kontraktor janë likuiduar si vijon:

- Situacion 1, me USH nr. 2813, datë 30.10.2017 me shumë 21,599,982 lekë.
- Situacion 2, me USH nr. 818, datë 13.03.2018 me shumë 4,990,803 lekë.
- Situacion 2, me USH nr. 1873, datë 07.06.2018 me shumë 16,911,547 lekë.
- Situacion 2, me USH nr. 3637, datë 06.11.2018 me shumë 11,515,282 lekë.
- Sit. Përfundimtar me USH nrrr. 3638, datë 06.11.2018 me shumë 4,336,614 lekë.
- Sit. Përfundimtar me USH nrrr. 371, datë 11.02.2019 me shumë 18,060,219 lekë.
- Sit. Përfundimtar me USH nrrr. 375, datë 11.02.2019 me shumë 1,399,515 lekë.

Nga situacionet e mësipërme është mbajtur 5% e shumës për garancinë e punimeve për një periudhë 24 muaj.

### **C. Mbi auditimin e realizimit të punimeve në terren.**

Si përfundim në mënyrë të përmbledhur për objektin : “Rikonstruksion i rrugës “Mihal Grameno” dhe degëzimit të rrugës “Budi”- Depo e ujit” (Faza e dytë)” nga auditimi rezulton se:

1. Objekti : “Rikonstruksion i rrugës “Mihal Grameno” dhe degëzimit të rrugës “Budi” – Depo e ujit” (Faza e dytë)” është ndërtuar sipas projektit të rishikuar të miratuar, kushteve teknike të detyrueshme në zbatim, specifikimeve teknike të evidentuara në kontratën e sipërmarrjes nr. 10059/6, datë 09.06.2017.

2. Gjatë zbatimit të objektit, janë respektuar kondicionet urbane të përcaktuara sipas terrenit.

3. Objekti është zbatuar plotësisht dhe nuk ka shmangie në drejtimin funksional, të qëndrueshmërisë dhe të destinacionit.

- objekti në formë, dimension, sipërfaqe e vëllim është sipas projektit të hartuar dhe ndryshimeve nga investitori.

- volumet dhe klasat e betoneve janë sipas llojeve të punimeve në objekt.

4. Zërat e punimeve janë realizuar sipas preventivit të rishikuar dhe të miratuar V.K.T Nr. 22/1, datë 15.12.2017. Punimet e maskuara janë vertetuar me proces verbalet përkatëse të mbajtura midis Mbikëqyrësit dhe Sipërmarrësit të punimeve.

5. Çmimet e zbatuara në situacionin përfundimtar për kontratën bazë dhe për shtesën e kontratës, janë sipas çmimeve të preventivit të ofertës dhe preventivit të rishikuar të miratuar, pjesë integrale e kontratës bazë Nr. 10059/6, datë 09.06.2017.

6. Nga auditimi në terren për verifikimin e zërave të punimeve si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të administruara në dosjen teknike të zbatimit të vënë në dispozicion grupit të auditimit për punimet e kryera, nuk rezultojnë diferenca në volume për punimet e kryera.

7. Sipërmarrësit të punimeve JV “Kacdedja” SHPK & “Agri Konstruksion” SHPK janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në: (Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 8; Kontratën e zbatimit me objekt : “Rikonstruksion i rrugës “Mihal Grameno” dhe degëzimit të rrugës “Budi” – Depo e ujit” (Faza e dytë)”, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë së Tiranës dhe JV “Kacdedja” SHPK & “Agri Konstruksion” SHPK dhe Udhëzimin Nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” Kreu I “Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit”, pika 3).

<b>1.Titulli i Gjetjes</b>	Efekt financiar negativ për punime të kryera në zbatimin e projektit për punime të pakryera në zbatimin e kontratës me objekt “Rikualifikim i aksit Mbikalim-Kombinat”.
<b>Situata:</b>	Nga verifikimi i preventivit të ofertës, projektit të zbatimit, librit të masave, situacionit pjesor dhe verifikimit në terren të punimeve të ndërtimit për periudhën e auditimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor me pasojë efekt financiar negativ ndaj buxhetit të bashkisë në vlerën <b>725,972 lekë pa TVSH</b> .
<b>Kriteri:</b>	Nuk janë zbatuar kërkesat e ligjit nr. 8402, neni 7 dhe neni 8, të ndryshuar dhe kushteve të kontratës së zbatimit të punimeve datë 13.03.2018 dhe nr. prot. 1189/3.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Efekt financiar negativ duke rritur vlerën e kontratës.
<b>Shkaku:</b>	Mos kryerje punimesh në volumet e përcaktuara sipas preventivit, objekt i kontratës së lidhur midis palëve.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandime:</b>	Të merren masa nga Bashkia e Tiranës, që t’i kërkojë sipërmarrësit të punimeve “G...” SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjyqimit arkëtimin e shumës <b>725,972 lekë pa TVSH</b> , të përfituar tepër për punime të pakryera në zbatimin e kontratës me objekt “Rikualifikim i aksit Mbikalim-Kombinat”.
<b>2.Titulli i Gjetjes</b>	Mos zbatim procedure në përdorimin e fondit rezervë.
<b>Situata:</b>	Nga verifikimi i preventivit të rishikuar dhe projektit të zbatimit të ndryshuar, rezulton se nuk janë zbatuar procedurat sipas UKM Nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, pika 19.
<b>Kriteri:</b>	UKM Nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, pika 19.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mos zbatim i pika 19 të UKM Nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar.
<b>Shkaku:</b>	Mos njohje nga mbikëqyrësi me procedurat e përdorimit të fondit rezervë.
<b>Rëndësia:</b>	I mesëm.
<b>Rekomandime:</b>	Të merren masa nga Bashkia e Tiranës, që për rastin konkret dhe në vazhdimësi, t’i kërkojë sipërmarrësit të punimeve si dhe mbikëqyrësit të punimeve, për përdorimin e fondit rezervë ta mbështesin në procedurat e hartimit të, preventivit të fondit rezervë, relacionit teknik dhe procesverbalit të përdorimit të nënshkruar nga të gjitha palët.
<b>3.Titulli i Gjetjes</b>	Efekt financiar negativ për likuidime për punime të pa kryera dhe punime të realizuara në kundërshtim me specifikimet teknike të tenderit dhe të kontratës së zbatimit
<b>Situata:</b>	Nga verifikimi i preventivit të rishikuar, projektit të zbatimit të rishikuar, librit të masave, situacionit përfundimtar dhe verifikimit në terren të punimeve të ndërtimit për periudhën e auditimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultojnë likuidime për punime të pa kryera dhe punime të realizuara në kundërshtim me specifikimet teknike të tenderit dhe të kontratës së zbatimit me pasojë efekt financiar negativ

	ndaj buxhetit të baskisë në vlerën <b>496,140 lekë pa TVSH</b> .
<b>Kriteri:</b>	Nuk janë zbatuar kërkesat e ligjit nr. 8402, neni 7 dhe neni 8, të ndryshuar dhe kushteve të kontratës së zbatimit të punimeve datë 19.04.2018 dhe nr. prot. 11233/6.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Efekt financiar negativ duke rritur vlerën e kontratës.
<b>Shkaku:</b>	Mos kryerje punimesh në volumet e përcaktuara sipas preventivit, dhe përdorimit të materialeve në kundërshtim me specifikimet teknike.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandime:</b>	Të merren masa nga Bashkia e Tiranës, që t'i kërkojë sipërmarrësit të punimeve "F..." SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative që, shuma prej <b>496,140 lekë pa TVSH</b> duhet të realizohet në objekt brenda periudhës së garancisë së defekteve. Realizimi i punimeve duhet të konfirmohet zyrtarisht nga AK, Bashkia e Tiranës, Mbikëqyrësi i punimeve si dhe Kolaudatori i punimeve të objektit (Në rast të kundërt, moskryerja e punimeve sipas Projektit të Zbatimit dhe specifikimeve teknike, do të konsiderohet efekt financiar negativ dhe duhet të zhdëmtohet nga sipërmarrësi i punimeve).
<b>4.Titulli i Gjetjes</b>	<b>i</b> Efekt financiar negativ për punime të kryera në zbatimin e projektit me objekt "Rikonstruksion i rrugës së Dibrës (farmacia 10 - Oxhaku).
<b>Situata:</b>	Nga verifikimi i preventivit të ofertës, projektit të zbatimit, librit të masave, situacionit pjesor dhe verifikimit në terren të punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan se zëri i punimeve, Transport dheu me auto deri në 5 km" në seksionin e preventivit (Punime të ndryshme, prishje, spostime, dhe punime asfaltimi), është likuiduar për punime të kryera dy herë, përkatësisht si zë punimi më vetë dhe nën zë punime në shumën <b>421,824 lekë pa TVSH</b> duke shkaktuar dëm ekonomik.
<b>Kriteri:</b>	Nuk janë zbatuar kërkesat e ligjit nr. 8402, neni 7 dhe neni 8, të ndryshuar dhe kushteve të kontratës së zbatimit të punimeve datë 13.03.2018 dhe nr. prot. 1189/3.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Efekt financiar negativ duke rritur vlerën e kontratës.
<b>Shkaku:</b>	Mos kryerje punimesh në volumet e përcaktuara sipas preventivit, objekt i kontratës së lidhur midis palëve.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandime:</b>	Të merren masa nga Bashkia e Tiranës, që t'i kërkojë sipërmarrësit të punimeve "C...." SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës <b>421,824 lekë pa TVSH</b> , të përfituar tepër për punime të dubluar në zbatimin e kontratës me objekt "Rikonstruksion i rrugës së Dibrës (farmacia 10 - Oxhaku)".
<b>5.Titulli i Gjetjes 1:</b>	Efekt financiar negativ për punime të kryera në zbatimin e projektit me objekt "Parkimi Nëntokësor te Sheshi Italia".
<b>Situata:</b>	Nga verifikimi i preventivit të ofertës, projektit të zbatimit, librit të masave, situacionit pjesor dhe verifikimit në terren të punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan se zëri i punimeve, Transport dheu me auto deri në 5 km" është likuiduar dy herë, përkatësisht si zë punimi më vetë dhe nën zë punime në shumën <b>233,722 lekë pa TVSH</b> duke shkaktuar efekt financiar negativ.
<b>Kriteri:</b>	Nuk janë zbatuar kërkesat e ligjit nr. 8402, neni 7 dhe neni 8, të ndryshuar dhe kushteve të kontratës së zbatimit të punimeve datë 23.03.2018 dhe nr. prot. 3306/3.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Efekt financiar negativ duke rritur vlerën e kontratës.
<b>Shkaku:</b>	Mos kryerje punimesh në volumet e përcaktuara sipas preventivit, objekt i kontratës së lidhur midis palëve.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandime:</b>	Të merren masa nga Bashkia e Tiranës, që t'i kërkojë sipërmarrësit të punimeve "A..." SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative për arkëtimin e shumës <b>233,722 lekë pa TVSH</b> , të përfituar tepër për punime të dubluara në zbatimin e kontratës me

		objekt “Parkimi Nëntokësor te Sheshi Italia”.
<b>6.Titulli Gjetjes</b>	<b>i</b>	Efekt financiar negativ për punime të kryera në zbatimin e projektit me objekt “Ndërtimi dhe rikonstruksioni i rrugës “Selaudin Bekteshi”.
<b>Situata:</b>		Nga verifikimi i preventivit të ripunuar, projektit të zbatimit, librit të masave, situacionit përfundimtar dhe verifikimit në terren të punimeve të ndërtimit për periudhën e auditimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor me pasojë efekt financiar negativ ndaj buxhetit të baskisë në vlerën <b>699,396 lekë pa TVSH.</b>
<b>Kriteri:</b>		Nuk janë zbatuar kërkesat e ligjit nr. 8402, neni 7 dhe neni 8, të ndryshuar dhe kushteve të kontratës së zbatimit të punimeve datë 29.12.2016 dhe nr. prot. 33964/7.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>		Efekt financiar negativ duke rritur vlerën e kontratës.
<b>Shkaku:</b>		Mos kryerje punimesh në volumet e përcaktuara sipas preventivit të punimeve, objekt i kontratës së lidhur midis palëve.
<b>Rëndësia:</b>		E lartë.
<b>Rekomandime:</b>		Të merren masa nga Bashkia e Tiranës, që t’i kërkojë sipërmarrësit të punimeve “A...” SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës <b>699,396 lekë pa TVSH</b> , të përfituar tepër për punime të pakryera në zbatimin e kontratës me objekt “Ndërtimi dhe rikonstruksioni i rrugës “Selaudin Bekteshi”.
<b>7.Titulli Gjetjes</b>	<b>i</b>	Dëmtime kangjellash dhe punime jo sipas specifikimeve teknike.
<b>Situata:</b>		Nga verifikimi i realizimit të punimeve në objekt, situacionit përfundimtar, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan punime me defekte të kangjellave metalike.
<b>Kriteri:</b>		Nuk janë zbatuar kërkesat e kontratës dhe specifikimet teknike.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>		Ulje e cilësisë së punimeve mbi kryerjen e zërit të kangjallave metalike.
<b>Shkaku:</b>		Mos kryerje punimesh me cilësi si dhe dëmtime me ose pa dashje nga komuniteti.
<b>Rëndësia:</b>		I mesëm.
<b>Rekomandime:</b>		Të merren masa nga Bashkia e Tiranës, që t’i kërkojë sipërmarrësit të punimeve “Alba Konstruksion” SHPK , duke ndjekur të gjitha procedurat dhe kërkesat e kontratës, riparimin dhe zëvendësimin e pjesëve të dëmtuara të kangjallave metalike deri në përfundim të periudhës së garancisë me datë 22.08.2019.
<b>8.Titulli Gjetjes</b>	<b>i</b>	Efekt financiar negativ për punime të kryera jo në përputhje me zbatimin e projektit dhe specifikimet teknike.
<b>Situata:</b>		Nga verifikimi i preventivit të ofertës, projektit të zbatimit, librit të masave, situacionit pjesor nr. 1 dhe verifikimit në terren të punimeve të ndërtimit për periudhën e auditimit, lidhur me volumet e punës në këtë situacion si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan se mos vendosja e bordurës sipas projektit ka shkaktuar një efekt financiar negativ ndaj buxhetit të baskisë në vlerën <b>172,190 lekë pa TVSH.</b>
<b>Kriteri:</b>		Nuk janë zbatuar kërkesat e projektit të zbatimit si dhe specifikimet teknike.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>		Efekt financiar negativ duke rritur vlerën e kontratës.
<b>Shkaku:</b>		Mos kryerje punimesh sipas projektit dhe specifikimeve teknike.
<b>Rëndësia:</b>		I mesëm.
<b>Rekomandime:</b>		Autoriteti Kontraktor, Bashkia e Tiranës, t’i kërkojë sipërmarrësit të punimeve “A...” SHPK, të bëjë sistemimet në situacionet pjesore ose në situacionin përfundimtar të vlerës <b>172,190 lekë pa TVSH</b> , për zëvendësimin e bordurës nga 20 x 35 cm në 20 x 30 cm, brenda afatit kohor të përfundimit të punimeve të ndërtimit parashikuar në kontratë. Në rast të kundërt mos realizimi i punimeve sipas bordurës me seksion 20x30 cm, shuma 172,190 lekë pa TVSH do të konsiderohet dëm ekonomik si punim i kryer në kundërshtim me projektin e

	zbatimit dhe specifikimet teknike.
<b>9.Titulli i Gjetjes</b>	Efekt financiar negativ për punime të kryera në zbatimin e projektit me objekt “Rikualifikim urban i bllokut të kufizuar nga rruga “Muhamet Gjollësia” – “Myslym Shyri” – “Rruga e Kavajes” me Kufirin e Njësisë Bashkiake Nr. 10”.
<b>Situata:</b>	Nga verifikimi i preventivit të ndryshuar, projektit të zbatimit të azhurnuar, librit të masave, situacionit përfundimtar dhe verifikimit në terren të punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor me pasojë efekt financiar negativ ndaj buxhetit të bashkisë në vlerën <b>1,289,110 lekë pa TVSH.</b>
<b>Kriteri:</b>	Nuk janë zbatuar kërkesat e ligjit nr. 8402, neni 7 dhe neni 8, të ndryshuar dhe kushteve të kontratës së zbatimit të punimeve datë 07.06.2016 dhe nr. prot. 11082/7.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Efekt financiar negativ duke rritur vlerën e kontratës.
<b>Shkaku:</b>	Mos kryerje punimesh në volumet e përcaktuara sipas preventivit, objekt i kontratës së lidhur midis palëve.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandime:</b>	Të merren masa nga Bashkia e Tiranës, që t’i kërkojë sipërmarrësit të punimeve “A...” SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjyqimit arkëtimin e shumës <b>1,289,110 lekë pa TVSH</b> , të përfituar tepër për punime të pakryera në zbatimin e kontratës me objekt “Rikualifikim urban i bllokut të kufizuar nga rruga “Muhamet Gjollësia” – “Myslym Shyri” – “Rruga e Kavajes” me Kufirin e Njësisë Bashkiake Nr. 10”.
<b>10.Titulli i Gjetjes</b>	Efekt financiar negativ për punime me cilësi të dobët.
<b>Situata:</b>	Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt.
<b>Kriteri:</b>	Kontrata, preventivi, situacioni dhe krahasimi me faktin kundrejt së cilës krahasohet situata e cila paraqet këtë parregullsi.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Efekt negativ duke rritur vlerën e kontratës.
<b>Shkaku:</b>	Mos kryerje punimesh në cilësinë e parashikuar në DST..
<b>Rëndësia:</b>	I mesëm.
<b>Rekomandime:</b>	Bashkia e Tiranës, t’i kërkojë sipërmarrësit të punimeve “ARIFAJ” SHPK, të marrë masa për riparimin e defekteve të konstatuara në punimet e sinjalistikës dhe rrjetin e K.U.Z në përputhje me specifikimet teknike brenda periudhës së garancisë së defekteve.

*(Gjerësisht problemet mbi shkeljet e zbatimit të kontratave për prokurimet e kryera, janë trajtuar në akt-konstatimet nr. 8-16, datë 16.04.2019, dorëzuar me protokoll në Bashkinë Tiranë datë 16.04.2019)*

#### **IV.C Mbi vlerësimin e auditimit të brendshëm publik**

Organizimi dhe funksionimi i njësisë së auditit të brendshëm publik.

I. Organizimi dhe funksionimi i njësisë së auditit të brendshëm publik.

Drejtorja e Auditit të Brendshëm në Bashkinë e Tiranës është e organizuar si drejtori në varësi të drejtpërdrejtë të Kryetarit të Bashkisë.

Funksionimi i saj bazohet në ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, urdhëri i Ministrit të Financave nr.69, datë 29.09.2010 “Për miratimin e Manuali i Auditit të Brendshëm”, udhëzimi nr.12, datë 05.06.2012 “Mbi procedurat e

*kryerjes së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik” VKM nr.83, datë 3.2.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë të auditimit brendshëm në sektorin publik”, VKM nr.160, datë 2.3.2016 “Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e komitetit të auditimit të brendshëm në njësinë publike”, urdhëri i M.F nr.86, datë 10.12.2015 “Për miratimin e kodit të Etikës për Audituesit e Brendshëm në sektorin publik”, urdhëri i Kryetarit të Bashkisë nr.12620, datë 14.09.2015 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së aparatit të Bashkisë së Tiranës” i ndryshuar, rregullorja e brendshme të bashkisë Tiranës miratuar me VKB nr.14, datë 02.05.2012 “Për miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së aparatit të bashkisë së Tiranës i ndryshuar”.*

## 1.2 Planifikimi dhe miratimi i programeve vjetore dhe strategjike të auditimeve, realizimi i programit vjetor të auditimit nga ana sasiore dhe analiza sipas llojeve dhe gjetjeve si dhe kapacitetet audituese të sektorit të auditimit.

Për vitin 2016 për miratimi i planit vjetor dhe strategjik 2016-2020 të veprimtarisë së Auditit të Brendshëm me shkresë nr. 13578, datë 28.09.2015 e Drejtorisë së Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Ministria e Financave, e protokolluar në Bashkinë e Tiranës nr. 13848, datë 29.09.2015. Në shkresën me nr. 29480/1prot, datë 30.09.2016 i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Ministrinë e Financave i është dërguar Plani Strategjik 2016-2018 dhe plani vjetor të ndryshuar.

Në bashkinë Tiranë me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr.12620, datë14.09.2015 për “Miratimin e strukturës organik të aparatit të Bashkisë së Tiranës” struktura e drejtorisë së Auditit të brendshëm publik është miratuar me 1 drejtor dhe 7 inspektor, por aktualisht ka funksionuar me personel të reduktuar deri në fillim të muajt nëntor të 2016 me 1 drejtor dhe 3 inspektor.

Me ndryshimin e strukturës së Bashkisë së Tiranës me urdhër nr. 18953, datë 20.06.2016 është miratuar dhe bërë ndryshimi i strukturës së Auditit të Brendshëm prej 10 vetë (drejtori, 2 kryeinspektor dhe 7 inspektor). Nga 7 persona të punësuar në DAB, 6 janë të certifikuar si “Auditues të brendshëm” dhe 1 nuk është i certifikuar si auditues i brendshëm në sektorin publik Lllazar Tereziu (emëruar 17.10.2016 dhe ka ndërprerë mardhëniet financiare 4.6.2018). *Në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në Sektorin Publik” neni 11.*

Nga këta inspektor 1 (drejtor i deleguar me urdhër nr. 1192, datë 15.01.2016) fakulteti ekonomik, dega financë, 5 inspektorë fakulteti ekonomik dhe 1 inspektor fakulteti inxhinjerik.

Auditi i Brendshëm nga periudha janar 2016-23.04.2018 nuk ka patur drejtor të emëruar, por këtë funksion i është deleguar një inspektori për të ushtruar funksionin e drejtorit të auditit.

Punësimi i 1 punonjësi të Njësisë Auditit të Brendshëm publik është në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”

### **Neni 11**

#### **Punësimi i audituesit të brendshëm**

c) audituesi i brendshëm duhet të jetë i certifikuar si “Auditues i brendshëm” dhe të ketë përvojë pune 5 vjet në profesion ose si auditues i brendshëm apo i jashtëm;

ç) punonjësi, që nuk zotëron certifikatën si “Auditues i brendshëm”, por ka përvojë pune 3 vjet në profesion, punësohet në njësinë e auditimit të brendshëm dhe gjatë 2 viteve të para punon nën mbikëqyrjen e eprorit të drejtpërdrejtë. Brenda kësaj periudhe ky punonjës duhet t’i nënshtrohet detyrimisht procedurës së certifikimit si “Auditues i brendshëm”. Në rast se brenda këtij afati punonjësi nuk certifikohet si “Auditues i brendshëm”, **punonjësit i ndërpriten marrëdhëniet e punës në njësinë e auditimit të brendshëm, të cilat konsiderohen se janë ndërprerë për shkak**



të këtij ligji.

Për këtë vit janë planifikuar dhe realizuar 5 auditime të llojit të kombinuara (përputhshmërie, financiar).

Për vitin 2016 janë realizuar auditimet e mëposhtme.

Nr	Subjekte	Niveli i vlerësimit të riskut	Llojet e auditimeve	Subjekte të pa audituar mbi 2 vjet	Realizimi
1	Qendra Ekonomike e Zvillimit dhe edukimit të fëmijëve	I lartë	Përputhshmërie e financiar	po	po
2	Klubi i Futbollit "Tirana".	I lartë	Përputhshmërie e financiar	jo	po
3	Njësia administrative Nr. 4	I lartë	Përputhshmërie e financiar	po	po
4	Njësia administrative Nr. 6	I lartë	Përputhshmërie e financiar	po	po
5	Njësia Administrative nr.8	I lartë	Përputhshmërie e financiar	po	po
	<b>Totali i auditimeve</b>				

Për vitin 2017 për planin strategjik 2017-2019 dhe vjetor për veprimtarinë e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm në Bashkinë e Tiranës, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Ministrinë e Financave me shkresë nr. prot 32967/1, datë 31.10.2016.

Plani i Auditimit Brendshëm vjetor dhe Plani Strategjik për vitet 2017-2019, janë miratuar nga Titullari i Bashkisë dhe me shkresën nr. 32967 prot, datë 31.10.2016, i janë dërguar Drejtorisë së Harmonizimit për Auditimit e Brendshëm Tiranë.

Për periudhën 2017 - 2018 Drejtoria e Auditit të Brendshëm, ka funksionuar me një strukturë organike të pa plotësuar.

Për vitin 2017 janë planifikuar e realizuar 21 auditime nga ku ka patur ndryshime në mënyrën e planifikimit të auditimit si p.sh. nga auditimi performance në auditimi përputhshmërie dhe financiar.

Për vitin 2017 janë realizuar auditimet e mëposhtme.

Nr	Subjekte	Niveli i vlerësimit të riskut	Llojet e auditimeve	Subjekte të pa audituar mbi 2 vjet	Planifikimi	Realizimi	Shënim
1	Drejtorja e Monitorimit të Qendrave dhe institucioneve	lartë	Përputhshmërie	po	po	po	
2	Drejtorja e monitorimit të strehimit	lartë	Përputhshmërie	po	po	po	
3	Drejtorja e monitorimit të Sh.a-ve	lartë	Përputhshmërie	po	po	po	
4	Drejtorja e Administrimit të kontratave	lartë	Përputhshmërie	po	po	po	
5	Drejtorja e shpronësimeve	lartë	Përputhshmërie	po	po	jo	
7	Drejtorja Konviktete e Shkollave Mesme	lartë	Performancë	po	po	po	
8	Drejtorja Nr. 1 e Punëtoreve të Qytetit	lartë	Performancë	po	po	po	

9	Drejtoria Nr. 2 e Punëtoreve te Qytetit	lartë	Performancë	po	po	po	
10	Drejtoria Nr. 3 e Punëtoreve te Qytetit	lartë	Performancë	po	po	po	
11	Drejtoria e Parqeve dhe Rekreacionit	lartë	Performancë	po	po	jo	KLSH
12	Shkolla Speciale Luigj Gurakuqi	mesëm	Performancë	po	po	jo	Ndryshuar llojin e auditimit (i kombinuar)
13	Qendra Kulturore Tirana	lartë	Përputhshmërie dhe financiar	po	po	po	
14	Qendra Sociale të Qëndrojmë së bashku	lartë	Përputhshmërie dhe financiar	po	po	po	
15	Shkolla Speciale Luigj Gurakuqi	i mesëm	Përputhshmërie dhe financiar	po	jo	po	Pl. performanc
16	Ndërmarrja Dekor	i lartë	Përputhshmërie dhe financiar	po	po	jo	
17	Ofiçina e automjeteve	i mesëm	Përputhshmërie dhe financiar	po	po	po	
18	Uzina Mekanike	i mesëm	Përputhshmërie dhe financiar	po	po	po	
19	Qendra Rekreative e kulturës	i mesëm	Përputhshmërie dhe financiar	po	po	po	
20	Qendra sportive pishinat	i mesëm	Përputhshmërie dhe financiar	po	po	po	
21	Parku i Transportit Urban i Udhëtareve	i mesëm	Përputhshmërie dhe financiar	po	po	po	
22	UPNA	i mesëm	Përputhshmërie dhe financiar	po	po	po	
23	Uzina Metalike	i mesëm	Përputhshmërie dhe financiar	po	po	jo	
24	Njësia Administrative nr. 5	i lart	Përputhshmërie dhe financiar	Po	jo	po	Shtuar me kërkesë të DP menaxhimi financiar.
25	Njësia Administrative nr. 11	i lartë	Përputhshmërie dhe financiar	Po	jo	po	Shtuar me kërkesë të DP menaxhimi financiar.
26	Njësia Administrative Farkë	i lartë	Përputhshmërie dhe financiar	Po	jo	po	Shtuar me kërkesë të DP menaxhimifinanciar.
27	Njësia Administrative Bërzhitë	i lartë	Përputhshmërie dhe financiar	Po	jo	po	Shtuar me kërkesë të DP menaxhimi financiar.
					21 (po)	21 (po)	

Për vitin 2018, për planin strategjik 2018-2020 dhe vjetor për veprimtarinë e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm në Bashkinë e Tiranës, janë raportuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Ministrinë e Financave me shkresë nr. prot 38139/1, datë 20.10.2017.

Plani i Auditimit Brendshëm vjetor dhe Plani Strategjik për vitet 2018-2020, janë miratuar nga Titullari i Bashkisë dhe me shkresën nr. 38139 prot, datë 20.10.2017, i janë dërguar Drejtorisë së Harmonizimit për Auditimit e Brendshëm Tiranë.

Raporti i veprimtarisë së Drejtorisë së Auditit të Brendshëm për vitin 2018 i ka raportuar Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të kontrollit të brendshëm financiar publik, Ministria e Financave dhe Ekonomisë shkresën me nr. prot 1404/1, datë 15.02.2019.

Për vitin 2018 janë realizuar auditimet e mëposhtme.

Nr	Subjekte	Niveli i	Llojet e auditimeve	Subjekte të pa
----	----------	----------	---------------------	----------------

		<b>vlerësimi të riskut</b>		<b>audituar mbi 2 vjet</b>	<b>Realizimi</b>	<b>Shënim</b>
1	Drejtoria e Pronës së Paluajtshme	i lartë	Përputhshmëri	po	po	Në proces nga viti 2017
2	Drejtoria e Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit.	i lartë	Përputhshmëri	po	po	
3	Njësia administrative Nr. 4	i lartë	Përputhshmëri dhe financiar	po	po	
4	Njësia administrative Nr. 7	i lartë	Përputhshmëri dhe financiar	po	po	
5	Inspektorati i mbrojtjes së Territorit	i lartë	Përputhshmëri	po	po	
6	Drejtoria e Financës	i lartë	Përputhshmëri dhe financiar	po	po	
7	Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe tarifave vendore	i lartë	financiar	po	po	
8	Drejtoria e Përgjithshme Nr.2 e Punëtorëve të Qytetit	i lartë	Përputhshmëri dhe financiar	po	po	
9	Drejtoria Nr.3 e Punëtorëve të Qytetit	i lartë	Përputhshmëri dhe financiar	po	po	
10	Qendra e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve	i lartë	Përputhshmëri dhe financiar	po	po	
11	Tirana Parking	i lartë	Përputhshmëri dhe financiar	po		Në proces.

1.1 Ndjekja e zbatimit të masave të rekomanduara nga Njësia e Auditimit të Brendshëm publik të Bashkisë.

**U audituan dosjet si më poshtë:**

**1-Dosja për auditimin: “Klubi i Futbollit Tirana”**

Programi i auditimit nr. 12607 prot date 5.5.2016.

Periudha e auditimit.01.01.2014 deri më 31.12.2015.

Auditues: F.K., L.H., M.D.

Lloji i auditimit: Auditim i pajtueshmërisë dhe financiar.

Numri i rekomandimeve të dhëna 10 dhe të pranuar 10

Rekomandimet e dhëna janë të ndara sipas prioriteteve të mëposhtëme :

Rekomandime janë me prioritet të lartë.

***Ka këto mangësi në dosjen e auditimit:***

-Në memon nga audituesit drejtuar titullarit mbi auditimin e vlerësimit të veprimtarisë është e pa protokolluar.

-Në njoftimin për përfundimin e auditimit është e pa protokolluar.

-Mungon autorizimi për fillimin dhe përgatitjen e angazhimit për auditim

***Mungon evadimi nga Kryetari për gjetjet e konstatuara.***

**2-Dosja për auditimin: “Njësia Administrative nr.4”**

Programi i auditimit nr. 28249/1 prot date 22.09.2016.

Periudha e auditimit 01.07.2012 deri më 31.07.2015.

Auditues: Flutura Kapedani, Leonora Himçi, Marte Doçaj

Lloji i auditimit: Auditim i pajtueshmërisë dhe financiar.

Numri i rekomandimeve të dhëna 2 dhe të pranuar 2

Rekomandimet e dhëna janë të ndara sipas prioriteteve të mëposhtëme :

Rekomandime janë me prioritet të lartë

***Ka këto mangësi në dosjen e auditimit :***

***Mungon evadimi nga Kryetari për gjetjet e konstatuara.***

**3-Dosja për auditimin: “Njësia Administrative nr.8”**

Programi i auditimit nr. 33372/1 prot date 14.11.2016.

Periudha e auditimit 01.07.2012 deri më 31.07.2015.

Auditues: Flutura Kapedani, Robert Bodeci

Lloji i auditimit: Auditim i pajtueshmërisë dhe financiar.

Numri i rekomandimeve të dhëna 2

Rekomandimet e dhëna janë të ndara sipas prioriteteve të mëposhtëme :

Rekomandime janë me prioritet të lartë

***Ka këto mangësi në dosjen e auditimit :***

***Mungon evadimi nga Kryetari për gjetjet e konstatuara.***

**4-Dosja për auditimin: “Qendra rekreative e Kulturës, Uzina Metalike Tirana dhe Parku i Transportit Urban të Udhëtarëve”**

Programi i auditimit nr. 33501/1 prot date 14.11.2016.

Periudha e auditimit 01.01.2015 deri më 31.10.2016.

Auditues: Marte Doçaj dhe Llazar Tereziu

Lloji i auditimit: Auditim i përputhshmërisë dhe financiar.

Numri i rekomandimeve të dhëna 10

Rekomandimet e dhëna janë të ndara sipas prioriteteve të mëposhtëme :

Rekomandime janë me prioritet të lartë

***Ka këto mangësi në dosjen e auditimit:***

***Mungon evadimi nga Kryetari për gjetjet e konstatuara.***

**Viti 2017**

**1. Dosja për auditimin: “Qendra Sociale të qëndrojmë sëbashku”**

Programi i auditimit nr. 8833/1 prot date 9.3.2017.

Periudha e auditimit 01.06.2012 deri më 31.12.2016.

Auditues: Marta Doçaj, Leonora Himçi, Llazar Tereziu, Levan Shehu

Lloji i auditimit: Auditim i pajtueshmërisë dhe financiar.

Numri i rekomandimeve të dhëna 13 dhe të pranuar 12 dhe 1 e pa pranuar

Rekomandimet e dhëna janë të ndara sipas prioriteteve të mëposhtëme :

Rekomandime janë me prioritet të lartë

***Ka këto mangësi në dosjen e auditimit :***

-Mungon në dosje shkresa përcjellëse e projekt-raportit.

***-Mungon evadimi nga Kryetari për gjetjet e konstatuara.***

**2. Dosja për auditimin: “Drejtorja e pronës së Paluajshme”**

Programi i auditimit nr. 1482/1 prot date 25.01.2017.

Periudha e auditimit 01.01.2013 deri më 31.12.2016.

Auditues: Marta Doçaj, Llazar Tereziu.

Lloji i auditimit: Auditim i përputhshmërisë.

Numri i rekomandimeve të dhëna 9 dhe të pranuar 12 dhe 1 e pa pranuar

Rekomandimet e dhëna janë të ndara sipas prioriteteve të mëposhtëme :

Rekomandime janë me prioritet të lartë 7 dhe 2 të mesëm.

***Ka këto mangësi në dosjen e auditimit :***

***-Mungon evadimi nga Kryetari për gjetjet e konstatuara.***

**3. Dosja për auditimin: “Drejtorja e Përgjithshme e pnëtorëve të Qytetit Nr.3”**

Programi i auditimit nr. 20186/1 prot date 26.05.2017.

Periudha e auditimit 01.01.2014 deri më 31.12.2016.

Auditues: Robert Bodeci, Llazar Tereziu.

Lloji i auditimit: Auditim i performanc.

Numri i rekomandimeve të dhëna 23 dhe të zbatuara 17, në proces 3 dhe 3 e pa zbatuar

Rekomandimet e dhëna janë të ndara sipas prioriteteve të mëposhtëme :

Rekomandime janë me prioritet të lartë 20 dhe 3 të mesëm.

***Ka këto mangësi në dosjen e auditimit :***

***-Mungon evadimi nga Kryetari për gjetjet e konstatuara.***

**4. Dosja për auditimin: “Qendra Kulturore “Tirana”**

Programi i auditimit nr. 8832/1 prot date 9.3.2017

Periudha e auditimit 01.01.2012 deri më 31.12.2016.

Auditues: Flutra Kapedani përgjegjëse grupi e Robert Bodeci anëtar.

Lloji i auditimit: Auditim i përputhshmrisë dhe financiar.

Numri i rekomandimeve të dhëna 16 të zbatuara.

Rekomandimet e dhëna janë të ndara sipas prioriteteve të mëposhtëme :

Rekomandime janë me prioritet të lartë 12 dhe 4 të mesëm.

***Ka këto mangësi në dosjen e auditimit :***

***-Mungon evadimi nga Kryetari për gjetjet e konstatuara.***

**Viti 2018**

**1. Dosja për auditimin: “Njësia Administrative Nr.7”**

Programi i auditimit nr. 943/1 prot date 10.01.2018

Periudha e auditimit 01.01.2016 deri më 31.12.2017.

Auditues: Levan Shehu përgjegjës grupi e Llazar Tereziu anëtar.

Lloji i auditimit: Auditim i përputhshmrisë.

Numri i rekomandimeve të dhëna 4 të zbatuara.

Rekomandimet e dhëna janë të ndara sipas prioriteteve të mëposhtëme :

Rekomandime janë me prioritet të lartë 1 dhe 3 të mesëm.

***Ka këto mangësi në dosjen e auditimit :***

***-Mungon evadimi nga Kryetari për gjetjet e konstatuara.***

**2. Dosja për auditimin: “Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit”**

Programi i auditimit nr. 569/1 prot date 15.02.2018

Periudha e auditimit 01.01.2016 deri më 31.12.2017.

Auditues: Robert Bodeci përgjegjës grupi e Levan Shehu anëtar.

Lloji i auditimit: Auditim i përputhshmrisë.

Numri i rekomandimeve të dhëna 18 të zbatuara.

Rekomandimet e dhëna janë të ndara sipas prioriteteve të mëposhtëme :

Rekomandime janë me prioritet të lartë 17 dhe 1 të mesëm.

***Ka këto mangësi në dosjen e auditimit :***

***-Mungon evadimi nga Kryetari për gjetjet e konstatuara.***

**3. Dosja për auditimin: “Njësia Administrative Nr.4”**

Programi i auditimit nr. 944/1 prot date 10.01.2018

Periudha e auditimit 01.01.2016 deri më 31.12.2017.

Auditues: Marte Doçaj përgjegjës grupi e Shqipe Ismalaja, anëtar.

Lloji i auditimit: Auditim i përputhshmrisë.

Numri i rekomandimeve të dhëna 2 të zbatuara.

Rekomandimet e dhëna janë të ndara sipas prioriteteve të mëposhtëme :

Rekomandime janë me prioritet të lartë 1 dhe 1 menjëherë.

***Ka këto mangësi në dosjen e auditimit :***

***-Mungon evadimi nga Kryetari për gjetjet e konstatuara.***

Grupet e auditimit në auditimet financiare ose të kombinuar (përputhshmëri dhe financiar), nuk kanë dalë me opinion për pasqyrat financiare sipas kërkesave të të Standarteve Ndërkombëtare të Auditimit dhe manualit të auditimit të brendshëm të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 Kap. II, pika 2.4.2. ku citohet: “Gjatë kryerjes së auditimit financiar duhet t’i kushtohet rëndësi faktit, nëse pasqyrat financiare janë hartuar në mbështetje të dokumenteve të sipërcituar dhe në përputhje me kërkesat specifike për raportimin financiar. Nëse arrihet në përfundimin se pasqyrat financiare kanë gabime materiale, audituesit duhet të kenë evidencë të mjaftueshme për ta provuar këtë gjetje. Nxjerja e bilancit kontabël në afat dhe plotësimi i pasqyrave financiare përkatëse”.

Nga auditimi i praktikave sa më sipër rezulton se nga grupet e auditimit nuk është bërë praktikë dokumentimi dhe vlerësimi real i riskut me qëllim sigurimin e evidencës për auditim

sa më të mjaftueshme nga pikëpamja sasiore dhe cilësore duke rritur nivelin e garancisë së siguruar për menaxhmentin e institucionit.

Auditimet janë kryer në përgjithësi sipas kërkesave dhe udhëzimeve të ligjit për auditimin e brendshëm dhe manualit për auditimin e brendshëm në sektorin publik si dhe të standardeve të auditimit por më së shumti nga pikëpamja formale zyrtare e dokumentimit.

Specialistët e Auditimit të Brendshëm kanë marrë pjesë në trajnimet të programuara nga Njësia Qëndrore e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm pranë Ministrisë së Financave nga ASPA/OSBE etj, dhe për çdo vit dhe në përfundim janë vlerësuar dhe pajisur me certifikatë përkatëse.

***Nga sa konstatuar më sipër nuk përputhen plotësisht me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi për auditimin e brendshëm në sektorin publik si:***

\*Auditues të brendshëm nuk është i certifikuar si auditues i brendshëm në sektorin publik. Në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në Sektorin Publik” neni 11.

\*Në të gjitha dosjet e dokumentave të audituara nga auditi i brendshëm janë të inventarizuara, por nuk janë të arshivuara në arshivë gjë që bie në kundërshtim me ligjin e arshivave nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” si dhe zbatimin e rregullores “Për punën dhe dokumentet administrative në organet shtetërore dhe jo shtetërore”.

Edhe pse i janë dërguar Kryetarit të Bashkisë Memot për përfundimet e secilit subjekt, nga ana e Kryetarit të Bashkisë në asnjë rast nuk janë miratuar.

\*Në të gjitha dosjet e audituara nga auditi i brendshëm nuk ka dalë urdhëri me shkrim nga Titullari i Bashkisë për zbatimin e rekomandimeve të grupit të auditimit për të marrë titull ekzekutivi, por është mjaftuar vetëm me memorandumin, në kundërshtim me kërkesat e e Manualit të Auditimit të Brendshëm. Kap. IV, pika 4.1.6. dhe ligjit nr. 44/2018 “Kodi i procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë” neni 22.

***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:***

**1.znj.** V.Ç. me detyrë, Drejtor i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm emëruar më datën 15.01.2016.

**2.z.** L.T., inspektor në Njësinë e Auditimit të Brendshëm Publik filluar punë më datën 24.10.2016-05.06.2018 larguar nga puna.

**3.znj.** F.K., inspektor në Njësinë e Auditimit të Brendshëm Publik filluar punë më datën 06.10.2015.

**4.znj.** M.D., inspektor në Njësinë e Auditimit të Brendshëm Publik filluar punë më datën 05.03.2014 e në vazhdim.

**5.z.** R.B., inspektor në Njësinë e Auditimit të Brendshëm Publik filluar punë më datën 24.10.2016 e në vazhdim.

**6.z.** L.H., k/inspektor në Njësinë e Auditimit të Brendshëm Publik filluar punë më datën 23.02.2009 e në vazhdim.

**7.znj.** S.I., inspektor në Njësinë e Auditimit të Brendshëm Publik filluar punë më datën 08.11.2017.

**8.z.** L.S., inspektor në Njësinë e Auditimit të Brendshëm Publik filluar punë më datën 24.10.2016 e në vazhdim.

**9.znj.** D.J., Drejtor i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm emëruar më datën 23.04.2018.

1-Në zbatim të pikës C, të programit të auditimit “Nr. 1268/2 datë 18/12/2018”, u grumbullua dhe u shqyrtua evidenca e mjaftueshme nga ana sasiore dhe cilësore si më poshtë:-

-Dosjet e procedurave të auditimit për vitin 2018 (Auditimi në Drejtorinë e Përgjithshme nr. 2 e Punëtorëve të Qytetit (këtu e në vazhdim DPN2PQ) .

**Objekti i këtij akt verifikimi është** verifikimi i informacionit të vënë në dispozicion të

auditimit nga DPN2PQ me burimin e krijimit të tij, Raporti i auditimit dërguar nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm, Bashkia Tiranë, me nr. 17151/6, datë 19.04.2018 (Prot. i DPN2PQ)

Nga verifikimi rezultoi se grupi i auditimit të Auditit të Brendshëm në Bashkinë Tiranë bazuar në ligjin nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik” dhe Urdhërin e MF nr. 100 datë 25.10.2016 “Për miratimin e manualit të auditit të brendshëm në sektorin publik” kreu misionin e auditimit në bazë të programit të auditimit të miratuar për periudhën 01.01.2016 deri në 31.12.2017 në DPN2PQ me objekt “Auditim mbi funksionimin e gjithë sistemeve të DPN2PQ” i cili përfshin përdorimin e fondeve dhe realizimin e objektivave të veprimtarisë së DPN2PQ dhe dhënien e rekomandimeve për të përmirësuar veprimtarinë në të ardhmen.

Lloji i auditimit është i *kombinuar*, auditim financiar dhe përputhshmërie.

Auditimi u krye në bazë të programit të auditimit nr. 17151/2, datë 11.05.2018, dhe përfshiu 2 periudha buxhetore, viti 2016 dhe viti 2017 përqëndruar kryesisht në tre drejtime, vlerësimi i funksionimit të kontrolleve të brendshme, veprimtaria kontabël dhe saktësia e paraqitjes së pasqyrave financiare dhe përputhshmëria e procedurave të prokurimit publik me kërkesat dhe kriteret e kuadrit rregullator në fuqi.

Nga auditimi i dosjes së auditimit rezulton se raporti final i auditimit dhe plani i veprimit janë dërguar në DPN2PQ me nr. 17151/6, prot. datë 19.11.2018 protokolluar në DPN2PQ me nr. 3198/1, prot. datë 20.11.2018. Përgjithësisht nga auditimi janë evidentuar dhe adresuar 23 gjetje në total dhe mbi bazën e tyre janë dhënë 12 rekomandime me prioritet të lartë dhe 8 rekomandime me prioritet të mesëm.

Grupi i auditimit nuk ka dal me opinion për pasqyrat financiare si dhe me opinion përputhshmërie mbi procedurat e prokurimit por e ka evidentuar sigurinë dhe bindjen nga auditimi nëpërmjet konkluzioneve për çdo drejtim auditimi pas përshkrimit të punës audituese të kryer për çdo pikë të programit. Metoda e ndjekur e auditimit e miratuar në program përshkruan qëllimin e auditimit i cili është të egzaminoj nëse veprimtaritë kryen në përputhjen me kërkesat ligjore, politikat, rregullat dhe procedurat e vendosura si dhe me parimet e menaxhimit të shëndosh financiar. Në këtë aspekt grupi i auditimit ka përdorur metodën e ekzaminimit të letrave të punës, rishikimin e dokumentave, e evidencave të ndryshme, ndjekjen, gjurmimin dhe rishikimin e dokumentacionit, intervista, pyetësor etj.

Auditimi është kryer në bazë të kërkesave dhe udhëzimeve të ligjit për auditimin e brendshëm dhe manualit për auditimin e brendshëm publik si dhe të standarteve të auditimit, ku për shkak të burimeve të mjaftueshme të auditimit nuk është përdorur materialiteti dhe vlerësimi i riskut pasi më së shumti është përdorur metoda e njëpasnjëshme duke përfshirë të gjithë evidencën e nevojshme për auditim. Në të gjitha hapat e auditimit mbështetur dhe në ballafaqimin me administratën e DPN2PQ grupi i auditimit ka respektuar etikën në auditim si dhe ka ushtruar gjykimin profesional dhe transparencën në komunikimin me subjektin dhe me Bashkinë Tiranë si njësi e prore.

Duke qënë se auditimi është kryer mbi bazën e standarteve të auditimit që aplikon dhe KLSH konkluzionet janë bazuar në kryerjen e një auditimi korrekt edhe gjetjet argumentohen në përshkrimin e punës së auditimit, KLSH në bazë të nenit 16 “**Vlerësimi i sistemeve të kontrollit dhe auditimit të brendshëm**” të **ligjit nr. 154/2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"** pika 3 ku citohet se : “... *Konrolli i Lartë i Shtetit i merr në konsideratë këto gjetje, vetëm në rast se standardet e përdorura për këto auditime janë në përputhje me standardet e veta dhe ato ndërkombëtare*

*të auditimit...”, grupi i auditimit i konfirmon konkluzionet, gjetjet dhe rekomandimet e auditimit të brendshëm në këtë subjekt dhe përqëndroi auditimin për vitin 2018 duke përjashtuar 2 vitet buxhetore 2016, 2017 mbi bazën e punës së bërë nga auditimi i brendshëm. Nga auditimi i raportit sa më sipër u evidentuan 2 gjetje dhe rekomandimet përkatëse të adresuara për të cilat auditimi i brendshëm duhet të kishte marrë në konsideratë observacionet e DPN2PQ. Konkretisht për rekomandimin nr. 8 ku kërkohet që të kthehen lekët e mara nga punonjësit e administratës për punën e turnit të dytë dhe të tretë e cila duhej të përqëndrohej vetëm për 2-3 funksione që nuk justifikojnë shpërblimin dhe, rekomandimi nr. 10, për anulimin e akt-marrëveshjeve për përdorimin e automjeteve personale me qera pasi veprimtaria e DPN2PQ është e mbështetur në akte ligjore për këto 2 gjetje si dhe për shkak të natyrës dhe dinamikës së veprimtarisë së subjektit në ofrimin e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe riparimit në çdo kohë.*

2- Në zbatim të pikës C, të programit të auditimit “Nr. 1268/2 datë 18/12/2018”, u grumbullua dhe u shqyrtua evidenca e mjaftueshme nga ana sasiore dhe cilësore si më poshtë:-

-Dosjet e procedurave të auditimit për vitin 2018 (Auditimi në Tirana Parking) .

**Objekti i këtij akt verifikimi është** verifikimi i informacionit të vënë në dispozicion të auditimit nga Tirana Parking me burimin e krijimit të tij, Raporti i auditimit dërguar nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm, Bashkia Tiranë, me nr. 5607/2, datë 27.02.2019 (Prot. i Tirana Parking nr. 196/2, datë 01.03.2019)

Nga verifikimi rezultoi se grupi i auditimit të Auditit të Brendshëm në Bashkinë Tiranë bazuar në ligjin nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik” dhe Urdhërin e MF nr. 100 datë 25.10.2016 “Për miratimin e manualit të auditit të brendshëm në sektorin publik” kreu misionin e auditimit në bazë të programit të auditimit të miratuar për periudhën 22.12.2015 deri në 31.12.2017 në Tirana Parking me objekt “Auditim mbi funksionimin e gjithë sistemeve të Institucionit Tirana Parking”.

Lloji i auditimit është *i kombinuar*, auditim financiar dhe përputhshmërie.

Auditimi u krye në bazë të programit të auditimit nr. 34285/1, datë 25.10.2018, dhe përfshiu 2 periudha buxhetore, viti 2016 dhe viti 2017 përqëndruar kryesisht në tre drejtime, vlerësimi i funksionimit të kontrolleve të brendshme, veprimtaria kontabël dhe saktësia e paraqitjes së pasqyrave financiare dhe përputhshmëria e procedurave të prokurimit publik me kërkesat dhe kriteret e kuadrit rregullator në fuqi.

Nga auditimi i dosjes së auditimit rezulton se raporti final i auditimit dhe plani i veprimit janë dërguar në Tirana Parking me nr. 5607/2, prot. datë 27.02.2019 protokolluar në Tirana Parking me nr. 196/2, prot. datë 01.03.2019. Përgjithësisht nga auditimi janë evidentuar dhe adresuar 18 gjetje në total dhe mbi bazën e tyre janë dhënë 12 rekomandime me prioritet të lartë dhe 5 rekomandime me prioritet të mesëm.

Grupi i auditimit nuk ka dal me opinion për pasqyrat financiare si dhe me opinion përputhshmërie mbi procedurat e prokurimit por e ka evidentuar sigurinë dhe bindjen nga auditimi nëpërmjet konkluzioneve për çdo drejtim auditimi pas përshkrimit të punës audituese të kryer për çdo pikë të programit. Metoda e ndjekur e auditimit e miratuar në program përshkruan qëllimin e auditimit i cili është të egzaminoj nëse veprimtaritë kryen në përputhjen me kërkesat ligjore, politikat, rregullat dhe procedurat e vendosura si dhe me parimet e menaxhimit të shëndosh financiar. Në këtë aspekt grupi i auditimit ka përdorur metodën e ekzaminimit të letrave të punës, rishikimin e dokumentave, e evidencave të



ndryshme, ndjekjen, gjurmimin dhe rishikimin e dokumentacionit, intervista, pyetësor etj.

Auditimi është kryer në bazë të kërkesave dhe udhëzimeve të ligjit për auditimin e brendshëm dhe manualit për auditimin e brendshëm publik si dhe të standarteve të auditimit, ku për shkak të burimeve të mjaftueshme të auditimit nuk është përdorur materialiteti dhe vlerësimi i riskut pasi më së shumti është përdorur metoda e njëpasnjëshme duke përfshirë të gjithë evidencën e nevojshme për auditim. Në të gjitha hapat e auditimit mbështetur dhe në ballafaqimin me administratën e Tirana Parking grupi i auditimit ka respektuar etikën në auditim si dhe ka ushtruar gjykimin profesional dhe transparencën në komunikimin me subjektin dhe me Bashkinë Tiranë si njësi e prore.

Duke qënë se auditimi është kryer mbi bazën e standarteve të auditimit që aplikon dhe KLSH konkluzionet janë bazuar në kryerjen e një auditimi korrekt edhe gjetjet argumentohen në përshkrimin e punës së auditimit, KLSH në bazë të nenit 16 “**Vlerësimi i sistemeve të kontrollit dhe auditimit të brendshëm**” të ligjit nr. 154/2014 “**Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit**” pika 3 ku citohet se : “... *Kontrolli i Lartë i Shtetit i merr në konsideratë këto gjetje, vetëm në rast se standardet e përdorura për këto auditime janë në përputhje me standardet e veta dhe ato ndërkombëtare të auditimit...*”, grupi i auditimit i konfirmon konkluzionet, gjetjet dhe rekomandimet e auditimit të brendshëm në këtë subjekt dhe përqëndroi auditimin për vitin 2018 duke përjashtuar 2 vitet buxhetore 2016, 2017 mbi bazën e punës së bërë nga auditimi i brendshëm.

**Gjetjet kryesore që u konstatuan në auditimin funksionimit të Auditit të Brendshëm përmbledhurazi janë si vijon:**

<b>1.Titulli Gjetjes</b>	Nga KLSH është konstatuar në të gjitha dosjet e dokumentave të audituara nga auditimi i brendshëm janë të inventarizuara, por nuk janë të arshivuara në arshivë.
<b>Situata:</b>	Për të gjitha vitet e auditimit sipas programit të KLSH nr.1268/2 prot, datë 18.12.2018 nga ana e sektorit të Auditit të Brendshëm të gjitha dosjet e auditimit nuk janë të arshivuara në arshivë, por mbahen në ambientet e brendshme të Drejtorisë së Auditit të Brendshëm.
<b>Kriteri</b>	Ligji e arshivave nr. 9154, datë 06.11.2003 “ <i>Për arkivat</i> ” si dhe zbatimimi i rregullores “ <i>Për punën dhe dokumentet administrative në organet shtetërore dhe jo shtetërore</i> ”. Ligji nr.114/2015, datë 22.10.2015 “ <i>Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik</i> ”, urdhëri i Ministrit të Financave nr.69, datë 29.09.2010 “ <i>Për miratimin e Manuali i Auditit të Brendshëm</i> ”.
<b>Ndikimi/Efekt</b>	Nuk jep siguri të mjaftueshme për përmbushjen dhe zbatimin rregullores për arshivimin e dokumentacionit.
<b>Shkaku</b>	Nga neglizhenca dhe nga mos këmbëngulja në zbatimin e ligjit për arshivimin e dokumentacionit të Auditimit të Brendshëm.
<b>Rëndësia:</b>	<b>E lartë</b>
<b>Rekomandimi</b>	Drejtori i Auditit të Brendshëm të marrë masa të menjëhershme duke ju drejtuar Titullarit të Institucionit të Bashkisë Tiranë në përmisimin e gjendjes, duke u arshivuar të gjitha dosjet e kryera nga Auditimi i Brendshëm në arshivë dhe jo në ambientet e auditit të brendshëm.
<b>2.Titulli Gjetjes</b>	Nga KLSH është konstatuar në të gjitha dosjet e audituara nga auditimi i brendshëm në auditimet financiare ose të kombinuar (përputhshmëri dhe financiar), nuk kanë dalë

	me opinion për pasqyrat financiare.
<b>Situata:</b>	Për të gjitha vitet e auditimit sipas programit të KLSH nr.1268/2 prot, datë 18.12.2018 nga ana e sektorit të Auditit të Brendshëm të gjitha dosjet e auditimit në auditimet financiare ose të kombinuar (përputhshmëri dhe financiar), nuk kanë dalë me opinion për pasqyrat financiare sipas kërkesave të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe manualit të auditimit të brendshëm të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 Kap. II, pika 2.4.2. ku citohet: “Gjatë kryerjes së auditimit financiar duhet t’i kushtohet rëndësi faktit, nëse pasqyrat financiare janë hartuar në mbështetje të dokumenteve të sipërcituar dhe në përputhje me kërkesat specifike për raportimin financiar. Nëse arrihet në përfundimin se pasqyrat financiare kanë gabime materiale, audituesit duhet të kenë evidencë të mjaftueshme për ta provuar këtë gjetje. Nxjerra e bilancit kontabël në afat dhe plotësimi i pasqyrave financiare përkatëse”.
<b>Ndikimi/Efekt</b>	Nuk jep besueshmëri të mjaftueshme në përmbushjen e kryerjes së auditimit për pasqyrat financiare në bazë të standardeve ndërkombëtare dhe urdhëresave nga Ministria e Financave.
<b>Shkaku</b>	Nga neglizhenca për mos dhënien e një opinionit të saktë të pasqyrave financiare.
<b>Rëndësia:</b>	<b>E lartë</b>
<b>Rekomandimi</b>	Auditi i Brendshëm në auditimet financiare ose të kombinuar (përputhshmëri dhe financiar), të dalë me opinion për pasqyrat financiare.

*(Gjerësisht trajtuar në akt-konstatimin nr. 3, datë 10.04.2019, prot subjekti nr. 15510, datë 10.4.2019)*

#### **IV/D. Auditim mbi proceset administrative në fushën e zhvillimit dhe mbrojtjes së territorit.**

Në zbatim të pikës D, të programit të auditimit u grumbullua dhe u shqyrtua evidenca e mjaftueshme nga ana sasiore dhe cilësore si më poshtë:-

- Rregulloret e brendshme të organizimit dhe funksionimit të Njësisë.
- Strategjitë e përgjithshme dhe sektoriale.
- Informacione me shkrim nga drejtuesit e nivelit të lartë mbi veprimtarinë e sektorëve që mbulojnë si dhe objektivat e planet periodike të punës.
- Manualet përkatëse.
- Praktikat e proceseve administrative për leje zhvillimi, ndërtimi dhe përdorimi për periudhën 2016-2018.
- Të dhënat në sistemin elektronik e-leje.

Për qëllim të auditimit, sa më sipër, u përdorën teknika auditimi për grumbullimin e evidencës dhe auditimin si fizike, dokumentare, verbale dhe analitike.

Nga auditimi i evidencës së grumbulluar rezulton se veprimtaria e Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, për periudhën 2016-2018, është orientuar nga Strategjia e zhvillimit të qëndrueshëm 2015-2018 miratuar me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 22409, datë 24.12.2015; Strategjia e zhvillimit të qëndrueshëm të bashkisë Tiranë 2018-2022; Planet e veprimit në zbatim të strategjive dhe rregullave të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të B. Tiranë kryesisht duke qëndruar strikt në zbatimin e kuadrit rregullator në fuqi dhe VKB në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit përbëhet nga Sektori i Makroplanifikimit me Përgjegjës Sektori dhe 19 specialistë; Drejtoria e Projektimit me Drejtor Drejtorie, Përgjegjës Sektori dhe 14 specialistë; Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, me Drejtor Drejtorie, tre Përgjegjës Sektori dhe 31 specialistë; Drejtoria e Kadastrës me Drejtor Drejtorie, dy Përgjegjës Sektori dhe 10 specialistë dhe, Drejtoria e Inovacionit dhe të Dhënave me Drejtor Drejtorie, një Përgjegjës Sektori dhe 5 specialistë.

Në Rregulloren e ndryshuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë nr. 25661, datë 02.07.2018 për organizimin, Funksonimin, Detyrat dhe Përgjegjësitë e Administratës së Institucionit të Bashkisë Tiranë janë përcaktuar qartë dhe në mënyrë koncize misioni dhe detyrat në bazë të kompetencave ligjore të Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për çdo drejtori vartëse dhe sektor në faqet 33-45 të rregullores ku ndër të tjera janë përcaktuar dhe linjat e varësisë, raportimit dhe komunikimit si horizontalisht ashtu dhe sipas hierarkisë në strukturë. Janë vendosur saktë kontrollet e brendshme dhe është testuar funksionimi i tyre nga i cili nuk janë evidentuar mospërputhje materiale.

Baza ligjore ku mbështetet veprimtaria e Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit është kryesisht kuadri rregullator në fuqi në fushën planifikimit dhe zhvillimit të territorit të cilin kjo drejtori e ka bërë transparente për publikun dhe subjektet e interesuara në faqen zyrtare të bashkisë në internet duke parashikuar dhe manuale mbi procedurat që duhet të ndjekin subjektet për aplikime në këtë strukturë si përsa i përket procedurave administrative që operohen nëpërmjet sistemit online e-leje ashtu dhe për procedura që ende nuk janë përfshirë në sistemin online e-leje.

Grupi i auditimit kërkoi për qëllim auditimi akses auditimi në sistemin e-leje për verifikimin e akteve të prodhuara nga kjo drejtori dhe, në kuadër të bashkëpunimit dhe komunikimit korrekt, në plotësim të kërkesës së Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit drejtuar me e-mail AZHT (Agjencia e Zhvillimit të Territorit), u mundësua aksesimi për auditim në sistem për grupin e auditimit.

Nga evidenca e vënë në dispozicion të grupit të auditimit dhe verifikimi me zgjedhje në sistemin elektronik e-leje rezulton se nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit janë proceduar administrativisht dhe janë miratuar 33 leje zhvillimi dhe ndërtimi për vitin 2016, 109 leje për vitin 2017 dhe 184 leje për vitin 2018, sipas anekseve bashkëlidhur aktkonstatimit. Gjithashtu janë proceduar për periudhën objekt i auditimit kërkesat për certifikatë përdorimi dhe janë miratuar 387 kërkesa, aneksi bashkëlidhur. Për qëllim të auditimit u përzgjedhën për verifikim të përputhshmërisë së procedurës administrative me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi, procedurat për Miranda Sali-ind; Tedi –ind; Brillant Line-pallat; Denisa Kamberi-vile; Mivita – pallat për vitin 2016; Park konstr-pallat; Mason-pallat; Desla-Pallat; Samone-ind; Noar-ind; Florian Shima-vile; AV Kons – pallat; FAB Constr-vile për vitin 2017 dhe, TDT-pallat; Bega 07-pallat; Andi Konstruksion-pallat; Edlira bicolli – rikonstruksion; Mon Amor-pasticeri; Mangalemi – kompleks; Eurocol - kompleks vilash; Fufarma – magazine për vitin 2018.

Nga auditimi nuk u konstatuan mospërputhje materiale me kërkesat dhe kriteret e kuadrit rregullator në fuqi për procedurat e verifikuara sa më sipër.

***Gjetjet kryesore që u konstatuan në auditimin mbi proceset administrative në fushën e zhvillimit dhe mbrojtjes së territorit përmbledhurazi janë si vijon:***

<b>1. Titulli Gjetjes</b>	Nga KLSH është konstatuar se në Drejtorinë IMTV Tiranë nuk ka të hartuar dhe të
---------------------------	---

	miratuar një Rregullore të Brendshme për funksionimin e saj.
<b>Situata:</b>	Për të gjitha vitet e auditimit sipas programit të KLSH nr.1268/2 prot, datë 18.12.2018 nga ana e Drejtorisë IMTV Tiranë nuk ka të hartuar dhe të miratuar një Rregullore të Brendshme për funksionimin e brendshëm të saj.
<b>Kriteri</b>	Ligji nr.9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar, ligjin nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, VKMnr.408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar.
<b>Ndikimi/Efekti</b>	Nuk jep siguri të mjaftueshme për përmbushjen e detyrave funksionale nga ana e inspektoratit IMTV.
<b>Shkaku</b>	Nga mos impenjimi dhe nga mos këmbëngulja në zbatimin e ligjit për për miratimin e rregullores së brendshme nga ana e IMTV.
<b>Rëndësia:</b>	<b>E lartë</b>
<b>Rekomandimi</b>	K/Inspektori i IMTV të marrë masa të menjëhershme duke hartuar e miratuar një rregullore të brendshme për organizimin e funksionimin e Drejtorisë së IMTV në përputhje me ligjet përkatëse.
<b>2.Titulli Gjetjes</b>	Nga KLSH është konstatuar se në Drejtorinë IMTV Tiranë ka një nivel të ulët arsimor dhe janë në kundërshtim me ligjin.
<b>Situata:</b>	<p>Nga verifikimi rezulton se një pjesë e konsiderueshme e personelit ka një nivel të ulët arsimor.</p> <p>Në disa raste emërimet e inspektorëve të IMT, janë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, neni 11, arsimimi i kryeinspektorëve dhe inspektorëve të inspektoratit të mbrojtjes së territorit. Kryeinspektorët dhe inspektorët në nivel kombëtar dhe qeverisjeje vendore duhet të kenë arsimin e lartë të nevojshëm profesional në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogjeologjisë dhe mjedisit.</p> <p>Një pjesë e personelit përbërës të kësaj drejtorie vihet re se janë me arsim të mesëm dhe kanë kryesisht rolin e specialistit pranë kësaj njësie. Punonjësit pjesë e drejtorive kryesore të kësaj njësie siç janë: Drejtoria e Kontrollit, Sektori i kontrollit të veprave të mëdha apo dhe Drejtoria e koordinimit të projekteve etj, nuk mund të kenë në përbërje të tyre pozicione me emërtimin “specialist” për vetë natyrën e punës së kryer. Si rezultat i këtij veprimi janë shkelur përcaktimet e bëra në ligjin nr. 183/2014 ”Për disa shtesa dhe ndryshime” në ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, neni 11 ku përcaktohet qartë arsimit i inspektorëve dhe kryeinspektorëve në nivel qëndror ose vendor.</p>
<b>Kriteri</b>	Ligji nr.9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar, ligjin nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, VKMnr.408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, 183/2014 ”Për disa shtesa dhe ndryshime”
<b>Ndikimi/Efekti</b>	Duke qenë se janë me një arsim jashtë kriterëve që jep ligji rezulton në mos përmbushjen e detyrave funksionale e profesionalizëm nga ana e inspektoratit IMTV.

<b>Shkaku</b>	Kjo vjen nga rekrutimi i këtyre inspektorëve nga Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore në kundërshtim me ligjin.
<b>Rëndësia:</b>	<b>E Lartë</b>
<b>Rekomandimi</b>	K/Inspektori i IMTV në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore të ndërmarr të gjitha masat për të siguruar që klasifikimi i vendit të punës sipas arsimit përkatës të përputhet me përcaktimin e ligjit në fuqi .
<b>3.Titulli Gjetjes</b>	Nga KLSH është konstatuar se në Drejtorinë IMTV Tiranë nuk ka plane strategjike dhe plane përmbledhëse vjetore për veprimtarinë e kryer.
<b>Situata:</b>	Për periudhën e auditimit ka rezultuar se nga ana e IMT nuk janë përgatitur plane strategjike për vendosjen e objektivave të punës së kryer, nuk janë përgatitur plane përmbledhëse vjetore për veprimtarinë. Gjatë periudhës 2016-2018 nga IMTV nuk janë hartuar raporte, analiza periodike, vlerësim performance si dhe mungon një strategji për identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin e riskut. Nga ana e IMT dërgohet periodikisht informacion pranë IKMT mbi vendimet e mara e cila nga ana e saj në kontrollet e ushtruara pranë IMT ka konstatuar në disa raste mos kthim përgjigje dhe mos veprime nga ana e IMT për shkresa dhe praktika të kryera nga IMTV Bashkia Tiranë.
<b>Kriteri</b>	Ligji nr.9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar, ligjin nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, VKM nr.408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, 183/2014 ”Për disa shtesa dhe ndryshime”
<b>Ndikimi/Efekti</b>	Duke qenë se nuk kanë plane strategjike e vjetore nuk ka të përcaktuar prioritete dhe objektiva në ushtrimin e veprimtarisë në bazë të vlerësimit dhe vlerësimit të riskut.
<b>Shkaku</b>	Kjo vjen neglizhenca dhe mosnjohja e rëndësisë së veprimtarisë së këtij institucioni.
<b>Rëndësia:</b>	<b>E Lartë</b>
<b>Rekomandimi</b>	K/Inspektori i IMTV duhet të marrë masa që çdo vit të përgatisë planet strategjike e vjetore të veprimtarisë së drejtorive në varësi, ku të jenë të përcaktuar objektivat kryesore të veprimtarisë së IMTV.
<b>4.Titulli Gjetjes</b>	Nga KLSH është konstatuar se në Drejtorinë IMTV Tiranë nuk ka një raport në lidhje me veprimtarinë vjetore mbi realizimin e detyrave.
<b>Situata:</b>	Në lidhje me detyrat funksionale të strukturës së IMTV (ish INUV), nga kryeinspektori i IMT nuk u paraqitën të dhëna dokumentare mbi plane pune javore dhe vjetore mbi aktivitetin e kësaj strukture, për kryerjen e kontrollit në territorin administrativ të bashkisë, për periudhën objekt auditimi.  Në lidhje me auditimin e kryer të dokumenteve të vëna në dispozicion nga zyra e IMT, për ushtrimin e kontrollit në terren të kontrollit mbi territorin e bashkisë, nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Bashkia Tiranë për periudhën 01.01.2016 deri 31.12.2018 rezultoi se janë marrë gjithsej 1598 “Vendime për Gjoha” nga të cilat 284 për vitin 2016, për vitin 2017 janë 678 dhe 636 për vitin 2018. Janë marrë gjithsej 809 “Vendime Prishje“ nga të cilat 353 vendime për vitin 2016, për vitin 2017 janë 205 vendime dhe 251 vendime për vitin 2018, në zbatim të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, për të cilat kanë vijuar procedurat e mëtejshme ligjore.
<b>Kriteri</b>	Ligji nr.9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga

	ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar, ligjin nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, VKM nr.408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, 183/2014 ”Për disa shtesa dhe ndryshime”
<b>Ndikimi/Efekti</b>	Duke qenë se nuk kanë nuk ka një raport në lidhje me veprimtarinë vjetore të këtij institucioni, kjo sjell një efikasitet jo të mirë në menaxhimin dhe vlerësim të riskut
<b>Shkaku</b>	Nga mosnjohja dhe indiferentizmi në përmbushjen e objektivave të rëndësishme të veprimtarisë së këtij institucioni.
<b>Rëndësia:</b>	<b>E Lartë</b>
<b>Rekomandimi</b>	K/Inspektori i IMTV duhet të marrë masa për çdo drejtori të varësisë për hartimin e raporteve periodike e vjetore të veprimtarisë mbi realizimin detyrave përkatëse dhe performancës në përmbushjen e objektivave të IMTV.

*(Gjerësisht trajtuar në akt-konstatimin nr. 2, datë 10.04.2019, prot subjekti nr. 15509, datë 10.4.2019)*

## V.REKOMANDIMET

Në përfundim të trajtimit të çështjeve sa në sipër për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë:

### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Për vitin 2016 nuk janë hartuar pasqyrat financiare të konsoliduara, pasi mungon struktura e posaçme për pranimin, kontrollin dhe përpunimin të informacionit kontabël të sjellë nga 19 njësi të varësisë së Bashkisë Tiranë. Si rezultat i mungesës së strukturës edhe në rregulloren e brendshme të miratuar me vendimin e kryetarit nr.429 datë 08.01.2016 “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së institucionit të Bashkisë Tiranë”. Kjo detyrë nuk është parashikuar në përcaktimet e detyrave dhe përgjegjësiive në rregulloren e organizimit dhe funksionimit të bashkisë.

*(Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1 Rekomandimi:** Bashkia Tiranë të krijojë një strukturë të veçantë për pranimin, kontrollin e pasqyrave financiare të njësiive të varësisë, si dhe përpunimin dhe hartimin e pasqyrave financiare të konsoliduara, duke pasqyruar njëkohësisht në Rregulloren e Brendshme detyrat dhe përgjegjësitë e kësaj strukture, të cilat të miratohen nga titullari i institucionit dhe të raportohen në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë në fund të cdo viti ushtrimor, duke respektuar afatet e miratuara në dispozitat ligjore në fuqi.

### **Menjëherë**

**2. Gjetje nga auditimi:** Kontabilizimi i veprimeve ekonomike për kontrata të lidhura blerje mallrash apo investimesh nuk është bërë për vlerë të plotë të kontratës, por në momentin e mbërritjes së faturave për blerje malli e shërbimesh dhe investime të shoqëruar me situacion për punime të kryera. Efektet e veprimeve ekonomike dhe të ngjarjeve të tjera ekonomike të kryera nuk janë evidentuar në llogari në kohën e kryerjes së veprimit apo të ndodhjes së ngjarjes, por me mbërritjen e faturës dhe celjen e fondeve. Pra regjistrimet kontabël nuk janë kryer në kohën e lindjes të një detyrimi për t'u paguar nga njësi ekonomike, detyrime këto që sjellin pagesa, dhe që kanë sjellë për ushtrimin e dhënë shpenzime.

(Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Financës në Bashkinë Tiranë të kryejë veprimet e kontabilizimit për vlerë të plotë të kontratave për mallra e shërbime në momentin e nënshkrimit të tyre.

### Në vazhdimësi

**3. Gjetje nga auditimi:** Njësia e Menaxhimit të Projekteve PIU deri në nëntor të vitit 2015 ka qenë njësi shpenzuese me vete dhe ka menaxhuar 3 projekte investimi me financim të huaj (kredi). Meqenëse në vitin 2015 kjo njësi është përfshirë në strukturat e Bashkisë Tiranë si Drejtori brenda Aparatit të bashkisë, edhe mbyllja e llogarive vjetore të vitit 2015 nga PIU është bërë pjesë e pasqyrave financiare të Bashkisë Tiranë të vitit ushtrimor 2015.

Ky bilanc u trashëguar me disa paqartësi në gjendjet e disa llogarive, llogari të cilat deri në fund të vitit 2018 nuk kanë funksionuar sipas parimeve të kontabilitetit . Për këto gjendje llogarish nuk është ndërmarrë asnjë veprim rregullues kontabël, për arsye të mungesës së informacionit kontabël, të dhënave analitike mbi llogaritë dhe mungesës së dokumentacionit bazë e justifikues. Në mënyrë të detajuar këto llogari si pjesë të PF të Aparatit të Bashkisë Tiranë në mbyllje të vitit ushtrimor 2016 paraqiten si më poshtë:

**a. Gjendja e llog. 232 “Shpenzime proces per transferime kapitale”** në vlerën **1,157,802,262 lekë**, për të cilën nuk ka analizë dhe mungon informacioni kontabël si dhe dokumentar, se çfarë ka të përfshirë dhe çfarë përfaqëson kjo shumë.

**b. Gjendja e llog. 409 “Furnitorë (debitorë), parapagime pagesa pjesore”** në vlerën **58,702,072 lekë**, për të cilën nuk ka analizë dhe mungon informacioni kontabël si dhe dokumentar, se çfarë ka të përfshirë dhe çfarë përfaqëson kjo shumë.

**c. Gjendja e llog. 45 “Marrëdhënie me institucione Brenda dhe jashtë sistemi”** në vlerën **6,538,746 lekë**, e cila duhet të ishte mbyllur, pasi nuk duhej të paraqitej në bilanc me gjendje. Për këtë gjendje nuk ka asnjë informacion kontabël se çfarë përfaqëson e për rrjedhim për këtë vlerë nuk ka analizë.

**d. Gjendja e llog. 511 “Vlera për t’u arkëtuar”** në vlerën **81,204,163 lekë**, për të cilën nuk ka asnjë informacion kontabël se çfarë përfaqëson, e cila sipas rregullit kontabël duhet të përfaqësojë vlerën e letrave të pagesave që janë të depozituara në bankë në pritje për t’u arkëtuar, si interesa të paguara ose të maturuara.

**e. Pjesë e gjendjes së llog. 512 “Llogari në bankë”** është edhe **vlera prej 13,950,271 lekë**, për të cilën Bashkia nuk disponon ekstrakt apo “dokument bankar që të konfirmojë këtë shumë. Për këtë shumë nuk ka informacion se çfarë është dhe si ka vazhduar ecuria e saj deri më tani, çfarë veprimesh janë kryer me këtë gjendje të trashëguar që nga viti 2013.

**ë. Gjendja e llog. 477 “Diferenca konvertime aktive”** në vlerën **1,563,808 lekë**, për të cilën nuk ka asnjë informacion kontabël se si ka rezultuar kjo shumë, që sipas funksionimit të kësaj llogarie kjo llogari duhej të ishte mbyllur me shpenzimet dhe jo me fondin themeltar, pasi pasqyron diferencat aktive që lidhen me konvertimet nga vlersimi i kerkesave debitorë dhe detyrimet të shprehura në monedhe të huaj.

**f. Gjendja e llog. 17 “Huamarrje e huaj”** për vlerën pjesore prej **1.382.417.487 lekë** të trashëguar nga PIU, e cila përfaqëson vlerën e disbursimeve nga tre kreditë për pagesat e

furnitorëve për faturat e investimeve në masën 80%. Për këtë shifër nuk ka analiza sipas projekteve të investimeve e disbursimeve (sipas burimeve të financimit të huaj) të kredive.

*(Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 70-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1 Rekomandimi:** Bashkia Tiranë të krijojë mundësinë me specialist të fushës të jashtëm dhe të brendshëm për gjetjen dhe përpunimin e të dhënave e dokumentacionin bazë e justifikues për shpjegimin dhe analizimin e gjendjeve të këtyre llogarive, si dhe kryerjen e veprimeve përkatëse sistemuere kontabël, duke i reflektuar ato në PF e mbylljes së vitit ushtrimor 2019.

**Deri më 31.12.2019**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i programimit, aprovimit, realizimit dhe monitorimit të buxhetit për vitin 2016, u konstatua se:

**a.** Mungojnë metodologjitë e planifikimit sipas produkteve dhe qendrave të kostos, të cilat ndihmojnë subjektet publike që jo vetëm të përlllogarisin saktë nevojat për planifikim, por edhe të monitorojnë saktë dhe drejtë realizimin e objektivave të njësisë. Vetëm nëpërmjet aplikimit të këtyre metodave, Institucioni (dhe si pasojë palët e interesuara) mund të zbulojnë nëse aktivitetet e njësisë janë në linjë me qëllimet dhe objektivat strategjike të saj.

**b.** Buxheti për vitin 2016 paraqitet me një performancë jo të kënaqshme në lidhje me nivelin e ulët të realizimit të fondeve në masën 60 %, ndërkohë që në datë 31.12.2016 detyrimet e papaguara janë në nivel të lartë në shumën 3,374,968,459 lekë ose në masën 23% të shpenzimeve totale të planifikuara. Akumulimi i një borxhi të konsiderueshëm në fund të vitit 2015 në vlerën prej 5,504,207,407 lekë, ka ndikuar që edhe në fund të vitit 2016 niveli i borxhit të jetë në nivel të lartë, pavarësisht shlyerjes në masën 52% të detyrimeve të trashëguara nga viti 2015.

**c.** Nëpunësi autorizues ka paraqitur në mënyrë periodike, në Këshillin Bashkiak, raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit, për performancën financiare, aktivitetet dhe objektivat e realizuara për çdo projekt, të përcaktuara në vitin e parë të dokumentit përfundimtar të projektit buxhetor afatmesëm”, nga ku konstatojmë se ka mangësi për sa i takon analizës së aktiviteteve në bazë produktesh për çdo program. Programimi i projekteve të reja të investimeve për vitin ushtrimor pa përfunduar financimin e projekteve të investimeve në vazhdim, duke zgjatur punimet dhe financimet e tyre përtej kontratave nga 1-3 vjet, realizimi në masën 21% i fondeve për investime nga FZHR si dhe ndryshimet e vazhdueshme nëpërmjet procedurave të sipërpërmendura janë tregues i planifikimeve jo të qëndrueshme, të mefshtësisë dhe mosefektivitetit në përdorimin e fondeve, të cilat gjatë vitit ushtrimor kanë riskuar dhe nxitur shkurtimin e mosrealizimit shpenzimeve të miratuara, ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke e kthyer procesin e buxhetimit, të përlllogaritjes së kostos së produkteve dhe realizimin e tyre, në një mjet të paqëndrueshëm dhe efektiv.

*(Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1 Rekomandimi:** Strukturat drejtuese të këtij institucioni, në bashkëpunim me Grupet e Menaxhimit të Programeve dhe me strukturat që mbulojnë planifikimin dhe monitorimin e buxhetit, të përcaktojnë qartë në programimin e PBA, por dhe në planifikimin vjetor, mënyrat dhe metodologjinë e përlllogaritjes së kostos së aktiviteteve në bazë produktesh për çdo program me qëllim arritjen e objektivave dhe minimizimin e shmangieve nga këto objektiva.



Procesi i planifikimit të buxhetit të kryhet në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme me qëllim rritjen e transparencës, përgjegjshmërisë në përdorimin e fondeve publike si dhe përmirësimin e planifikimit dhe ekzekutimit të buxhetit të vitit korent në arritjen e objektivave. Shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve dhe të sigurojë një përdorim eficient të burimeve financiare, si dhe të ruajë stabilitetin makroekonomik e fiskal.

**b.** Nevojitet të gjurmohet saktë dhe drejtë konsumimi i burimeve të nevojshme, duke synuar shpërndarjen e shpenzimeve (kostove) sipas aktiviteteve që i “shkaktojnë” këto kosto, me qëllim ndjekjen e kujdesshme të kostove për efekte buxhetore duke synuar minimizimin e rishpërndarjeve mes zërave buxhetore brenda vitit ushtrimor. Të rritet performanca e realizimit të buxhetit në nivel të kënaqshëm në termat e produkteve, si dhe të merren angazhime për të marrë veprimet e duhura korrigjuese për të përmirësuar situatën dhe aty ku është e nevojshme të ndërhyhet.

### Në vazhdimësi

**5. Gjetje nga auditimit:** Bashkia Tiranë ka akumuluar në fund të vitit 2018 **një borxh prej 2,538,930,790.37 lekë** (i konvertuar 20.571.469,70EUR), kur në PBA dhe buxhetet e viteve 2009-2018 janë programuar fonde në artikullin 55 “Interesa, komisione dhe principal për t’u paguar” në mënyrë të pjesshme dhe realizim minimal për detyrimet për shërbimin e borxhit ndaj Ministrisë së Financave të Ekonomisë për nën-Huatë e marra:

- Nga BERZH për **Projektin “Zhvillimi i Rrugëve të Tiranës”** me vlerë kredie 1,096,258,000 lekë (8,200,000 EUR), planifikuar në vitet 2009-2017 në shumën 1,004,116,826 lekë dhe realizuar në fakt në shumën 278,431,797 lekë ose në masën 28%, kur në fund të vitit 2018 rezulton **detyrimi i akumuluar 656,546,192.15 lekë** (5,319,609 EUR).

- Nga CEB për Projektin **“Programi i Zhvillimit dhe Rehabilitimit të Shkollave”** me vlerë kredie 1,096,258,000 lekë (8,200,000 EUR), planifikuar në vitet 2011-2017 në shumën 384,200,000 lekë dhe i realizuar në masën 0 %, kur në fund të vitit 2018 rezulton **detyrimi i akumuluar 776,723,195.88 lekë** (6,293,333 EUR).

- Nga Abu Dhabi për Projektin “Ndertimi i Bulevardit Verior dhe Rehabilitimi i Lumit të Tiranës” me vlerë kredie 7,367,928,000 lekë (240,000,000 AED ose 57,429,392.1 EUR ), planifikuar në vitet 2015 e 2018 në shumën 104,000,000 lekë, i cili është realizuar në masën 0 %, kur në fund të vitit 2018 rezulton **detyrimi i akumuluar 832,019,515.14 lekë** (28,172,175 AED ose 6,741,367 EUR).

- Nga CEB për projektin “Ndertimi i banesave me qëllim social” me vlerë kredie 848,530,000 lekë (6,347,000 EUR), i pa planifikuar në asnjë vit buxhetor, kur në fund të vitit 2018 rezulton **detyrimi i akumuluar 273,641,887.2 lekë** (2,217,160 EUR).

*(Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar të marrë masa për përfshirjen në programimin e buxhetit të fondeve dhe të sigurojë likuiditetin e nevojshëm me qëllim shlyerjen e detyrimeve të lindura për borxhin vendor dhe shërbimin e tij në përputhje me kushtet dhe afatet e kontraktuara për 4 kreditë e nën-huazuara nga MFE me financim të huaj, për të ulur nivelin e këtij borxhi të akumuluar nga mospagesat në vite me ndikim direkt në borxhin publik të Shtetit Shqiptar.

**Deri më 31.12.2019**

**6. Gjetje nga auditimi:** Në Bashkinë Tiranë, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë elektronike sipas programit “Alfa” i cili mundëson regjistrimin e veprimeve kontabël në përputhje me planin kontabël të miratuar me VKM nr. 248, datë 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe të njësisve që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.1.2001.

Për vitin 2017, nga Drejtoria e Finacës të Bashkisë Tiranë, ***nuk është ndjekur praktika e kontabilizimit të detyrimeve të angazhimit*** financiar bazuar në kontratat e lidhura me subjektet sipërmarrëse sipas procedurave të prokurimit si dhe ***nuk janë kontabilizuar detyrimet për shpenzimet e pa paguara të faturave të mbritura për energjinë elektrike dhe për ujën e pijshëm.***

Mos kontabilizimi i detyrimeve të angazhimit dhe ato të konstatuara, janë në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabël”, Kapitulli I - Mbajtja e kontabilitetit, pika 1-Parimet e përgjithshme (*trajtuar më hollësisht në faqet 10 dhe 117 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**6.1 Rekomandimi:** Të merren masat që të evidentohen në mënyrë kontabël, të gjitha detyrimet financiare të angazhimit dhe ato të konstatuara në zbatim të kërkesave ligjore, me qëllim:

- njohjen e detyrimeve financiare në kohën e krijimit,
- programimin e likuidimit të detyrimeve ndaj të tretëve dhe
- zvogëlimin e borxhit financiar.

#### **Në vazhdimësi**

**7. Gjetje nga auditimi:** Në pasqyrat financiare, janë pasqyruar disa llogari të cilat nuk janë llogari bilanci dhe si të tilla ***duhej të ishin mbyllur në fund të vitit*** ushtrimor duke i sistemuar në llogari të tjera sipas përmbajtjes ekonomike të tyre, konkretisht:

***Llogaria 477 “Diferencë konvertimi aktive”*** për vlerën kontabël 1,563,808 lekë. Kjo vlerë është e trashëguar nga ish bilanci i Njesisë së Menaxhimit të Projekteve me Investime të Huaja (PIU) në vitin 2015. Për këtë llogari, nuk ka të dhëna analitike mbi përmbajtjen e saj.

***-Llogaria 45 “Marëdhënie me institucionin brenda dhe jashtë sistemit”*** për vlerën kontabël 6,538,746 lekë. Edhe kjo vlerë është e trashëguar nga ish bilanci PIU në vitin 2015 por nga Drejtoria e Finacës, nuk disponohen dokumenta kontabël mbi përmbajtjen e kësaj llogarie.

Kjo praktikë është në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për Organet e Pushtetit Lokal, Institucionet Shtetërore, Qendrore dhe Lokale si dhe të Njësive që varen prej tyre” i ndryshuar dhe UMF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për Institucionet Qendrore, Organet e Pushtetit Vendor dhe Njësive që varen prej tyre si dhe njësisve të menaxhimit /zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj” i ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007, Kap. II, pikat 1- Procedura të përgjithshme, pika 2- Funkzioni i disa llogarive specifike të planit kontabël (*trajtuar më hollësisht në faqet 4-5 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**7.1 Rekomandimi:** Të merren masa për të sistemuar sipas procedurave ligjore, llogaritë e pa mbyllura dhe të trashëguara nga viti 2015 ish-bilanci PIU duke u bazuar nga dokumentacioni kontabël i arkivuar i Njësisë së Menaxhimit të Projekteve me Investime të Huaja (PIU).

**Deri më 31.12.2019**

**8. Gjetje nga auditimi:**-Llogaria e bilancit 24 “Aktive të qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara” për vlerën kontabël 530,023,434 lekë, nga të cilat për vlerën 525,960,955 lekë përfaqëson vlera inventariale të indentifikuara të vjedhura në periudhën e viteve parardhëse, në ish Stacionin Hekurudhor të Tiranës. Për këto aktive të konsideruara të vjedhura, nga auditimi i kaluar nga KLSH-ja, është rekomanduar:

*“Të bëhet vlerësimi me komision i aseteve të tjera të konstatuara të vjedhura si: 276 ml gardh hekuri, 488 ml linjë hekurudhore dhe 22 copë ndrruesa shinash dhe të nxirret përgjegjësia administrative dhe ligjore ndaj personave të ngarkuar për ruajtjen dhe marrjen në dorëzim.*

*Të miratohen me vendim të Këshillit të Bashkisë diferencat për tu shkarkuar nga kontabiliteti në zbatim të kërkesave të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore” i ndryshuar neni 32, duke kryer veprimet e duhura në kontabilitetin e Bashkisë”.*

Lidhur me këtë rekomandim, nuk u paraqitën dokumenta për procedurat administrative dhe ligjore për sistemimin e kësaj llogarie duke nxjerë edhe përgjegjësitë ndaj personave që i kanë pasur në administratim këto vlera inventariale.

Në këto kushte, pasqyrat financiare, nuk japin informacionin e nevojshëm mbi ekzistencën ose jo të aktiveve të pasqyruara në këtë llogari, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për Institucionet Qendrore, Organet e Pushtetit Vendor dhe Njësive që varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit /zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj” i ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007, Kap. II, pika 3- Procedurat e rakordimit dhe mbylljes së llogarive.

*(Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 11 dhe 119 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**8.1 Rekomandimi:** Të merren masa për të saktësuar gjendjen reale të aktiveve të pasqyruara në llogarinë 24 “Aktive të qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara” për vlerën kontabël 530,023,434 lekë nëpërmjet inventarizimit fizik të tyre.

Bazuar në rezultatet e inventarizimit, të ndiqen procedurat ligjore për sistemimin e kësaj llogarie dhe për personat përgjegjës, të procedohet në zbatim të rekomandimit të KLSH-së në auditimin e kaluar.

**Deri më 31.12.2019**

**9. Gjetje nga auditimi:** -Llogaria e bilancit 468 “Debitorë të ndryshëm” për vlerën kontabël 332,981,900 lekë, nga të cilat për vlerën **206,707,769 lekë**, përfaqëson detyrime debitorë për tatim taksa dhe tarifa vendore të pa vjela të trashëguara nga bilancet e Njësive Administrative (Ish Komuna) deri më datën 31.07.2015.

Në Bashkinë Tiranë, për arkëtimin e detyrimeve për Tatim Taksat Lokale, është organizuar dhe funksionon Drejtoria e Përgjithshme e Tatim Taksave Vendore.

Drejtoria e Përgjithshme e Mexhanimit Financiar, nuk ka marë masat e nevojshme për mbylljen e kësaj llogarie duke ja kaluar të drejtën për arkëtimin e kërkesës debitore, Strukturës që është krijuar për këtë qëllim e cila është Drejtoria e Përgjithshme e Tatim Taksave Vendore.

*(Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 236 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**9.1 Rekomandimi:** Të merren masat e nevojshme me qëllim sistemimin e llogarisë 468 “*Debitorë të ndryshëm*” për vlerën 206,707,769 lekë, duke e transferuar kërkesën debitore për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatim Taksave Vendore. Të bëhet rakordimi përkatës sipas procedurave ligjore kontabile.

**Deri më 31.12.2019**

**10. Gjetje nga auditimit:** -Disa llogari të pasqyrave finnaciare janë marë (trashëgur) nga bilanci i ish projektit PIU që nga viti 2015 por për këto llogari, mungojnë të dhënat analitike mbi përmbajtjen e tyre. Këto llogari, nuk janë sistemuar dhe prej vitesh mbahen në këtë gjendje në pasqyrat financiare, të Bashkisë Tiranë, konkretisht:

-Llogaria 409 “*Furnitorë (Debitorë), parapagime pagesa pjesore*” për vlerën kontabël 58,702,072 lekë, përfaqëson paradhënie të disbursuara për projekte me financim të huaj.

-Llogaria 511 “*Vlera për tu arkëtuar*” për vlerën kontabël 81,204,163 lekë, përfaqëson vlera për tu arkëtuar nga paradhënie të disbursuara për projekte me financim të huaj.

-Llogaria 512 “*Llogari në bankë*” për vlerën kontabël 24,651,518 lekë, nga të cilat për vlerën 13,950,271 lekë e trashëguar nga bilanci i PIU-t për të cilën nuk ka dokumentacion për përmbajtjen e saj e trashëguar që nga viti 2013, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për Institucionet Qendrore, Organet e Pushtetit Vendor dhe Njësive që varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit /zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj” i ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007, Kap. II, pika 3- Procedurat e rakordimit dhe mbylljes së llogarive dhe VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabël”, Kapitulli I - Mbajtja e kontabilitetit, pikat 1-Parimet e përgjithshme dhe 2- Dokumentat kontabël, Kap. II, pika 1.1- Pasqyrat financiare vjetore.

*(Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 5 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**10.1 Rekomandimi:** Të merren masa për të saktësuar vërtetësinë e llogarive; 409 “*Furnitorë (Debitorë), parapagime pagesa pjesore*”, 511 “*Vlera për tu arkëtuar*” dhe 512 “*Llogari në bankë*” bazuar në dokumentacionin kontabël ligjor të bilancit të Njesisë së Menaxhimit të Projekteve me Investime të Huaja (PIU). Të bëhen sistemimet kontabël të nevojshme bazuar në procedurat ligjore dhe për cdo rast pasaktësie ose shkelke ligjore, të nxiren përgjegjësitë përkatëse ligjore.

**Deri më 31.12.2019**

**11. Gjetje nga auditimit:** Në trasankSIONET e shpenzimeve, u konstatuan në dy raste mangësi proceduriale si vijon:

-Financimi i situacioneve të subjekteve sipërmarrëse, bëhen mbi bazën e dokumentacionit që Drejtoritë Përkatëse të Menaxhimit të shpenzimeve, I paraqësin për financim Drejtorisë së Financës.

Megjithatë, në praktikën e ndjekur për pagesën e fatuarave të paraqitura në Drejtorinë e Financës, konstatohet se nga Drejtoritë përkatëse që ndjekin zbatimin e kontratave, në përfundim të investimit, nuk është deklaruar me shkrim për Drejtorinë e Financës, nëse ka pasuar mos zbatim në afat të kontratave dhe për rjedhojë llogaritje të penaliteteve të mundshme.

-Gjatë vitit 2017, janë paguar shpenzime për telefonat celularë për punonjësit e administratës gjithësej në shumën 2,649,206 lekë. Për këto pagesa nuk na u paraqitën urdhëra nga Titullari i Bashkisë për miratimin e listës për personat përfitues të këtij shërbimi, në zbatim të kërkesave të VKM nr. 864, datë 23.07.2010 “Për paisjen me telefon celular të personave juridikë publikë” neni 11 “ *Drejtesit e organeve të pushtetit vendor kanë të drejtë të urdhërojnë pajisjen me numër telefoni celular të personave zyrtarë, bazuar në detyrën që kryejnë dhe brenda fondeve të parashikuara në buxhetin vjetor, sipas specifikimeve të mësipërme. Shpenzimet për këtë shërbim, në nivel vjetor, të jenë në çdo rast, jo më shumë se 2% e totalit të shpenzimeve për mallra dhe shërbime, të miratuara për çdo institucion në buxhetin vjetor përkatës.*” (trajtuar më hollësisht në faqen 237 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**11.1 Rekomandimi:** Të meren masa për të përmirësuar procedurat për kontrollin e financimit të investimeve sipas kontratave të lidhura. Për këtë me urdhër të vecantë të Titullarit të Bashkisë ose duke e sanksionuar në rregullorën e funksionimit të brendshëm të institucionit, të parashikohet që për çdo rast, në përfundim të investimit, të bëhet rakordimi me midis Drejtorisë së Financës dhe Drejtorisë Përkatëse të Zbatimit të Kontratave për fatuarat e paraqitur dhe të paguara, vlerës së situacionit përfundimtar si dhe për llogaritjen e penaliteteve të mundshme ndaj sipërmarrësit të shërbimit apo punimeve.

Titullari i Bashkisë, të miratojë listën për personat që do të jenë përfitues të shpenzimeve për telefon celular sipas kërkesave të VKM nr. 864, datë 23.07.2010 “Për paisjen me telefon celular të personave juridikë publikë”.

**Deri më 31.12.2019**

**12. Gjetje nga auditimit:** Përgjithësisht gjendja e llogarive debitorë dhe kreditorë, janë të analizuar sipas përmbajtjes së tyre dhe përiudhës së krijimit, konkretisht:

-Llogaria 468 “*Debitorë të ndryshëm*” për vlerën kontabël 332,981,900 lekë, kjo llogari është e analizuar me të dhënat si më poshtë vijon:

-86,724,972 lekë, janë kontabilizuar debitorë persona fizikë dhe juridikë sipas rekomandimeve të KLSH-së nga auditimet e mëparshme dhe të tjera,

-35,603,512 debitorë të trashëguara nga njësitë administrative,

-3,945,648 lekë debitorë për taksat e pullës për gjendjen civile dhe

-206,707,769 lekë debitorë trashëguar nga ish komunat.

-Llogaritë 401-408 “*Furnitorë dhe llogari të lidhura me to*” për vlerën kontabël 4,442,437,198 lekë. Gjendja e kësaj llogarie është e analizuar sipas kreditorëve ku:

-592,422,444 lekë i përkasin llogarisë 401 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to” për blerje mallra e shërbime dhe

-3,850,014,754 lekë i përkasin llogarisë 404 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to” për investime.

-Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” për vlerën kontabël 1,461,411,756 lekë. Kjo llogari është e analizuar:

-888,459,192 lekë detyrime për tu paguar për shpronësimet sipas VKM,

-22,136,362 lekë; për detyrime për shpenzime varrimi veteranë lufte (LANÇ), “Shpenzime për honorare”, shpenzime për ndihma dhe fatkeqësi etj.,

-82,070,000 lekë detyriem për tu paguar për bonus lindje fëmijë dhe

-468,746,202 lekë detyrime sipas vendimeve të gjykatave.

Nga analiza e llogarisë 467 ku janë kontabilizuar detyrimet sipas vendimeve gjyqësore të formës së prerë, konstatohet diferencë e madhë në kohë në disa raste mbi 5 vite, midis vendimit të formës së prerë të gjykatës dhe Urdhërit Ekzekutiv të Titullarit të Bashkisë, për kontabilizimin e detyrimit.

-Në vitin 2017, krahasuar me vitin 2016, referuar pasqyrave financiare, treguesit financiarë të Bashkisë Tiranë, janë përkeqësuar pasi:

Në vitin 2016, detyrimet kreditore, janë më të mëdha se kërkesat për arkëtime për diferencën  $9,312,129,578 - 401,939,584 = 8,910,189,994$  lekë, kurse në vitin 2017, detyrimet kreditore, janë shumë më të mëdha se kërkesat për arkëtime, për diferencën  $11,359,371,261 - 399,818,678 = 10,959,552,583$  lekë.

Kjo tregon se nga Bashkia Tiranë, nuk është respektuar kërkesa ligjore që në programimin buxhetor të vitit, të programohet pagesat e borxhit të vitit paraardhës, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabël”, Kapitulli I - Mbajtja e kontabilitetit, pika 1-Parimet e përgjithshme, UMF nr. 1, datë 4.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme në llogari të Thesarit” pikat 2, 3, 4, 6, UMF nr. 2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standart të zbatimit të buxhetit” Kap. II, pika 102 dhe UMF nr. 8, datë 13.01.2017 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2017” pikat 81, 84 (trajtuar më hollësisht në faqe 238 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**12.1 Rekomandimi:** Nga Bashkia, të merren masa që në programet buxhetore, të programohen financimi i detyrimeve ndaj të tretëve me qëllim që të ulet borxhi financiar.

Në programet buxhetore vjetore dhe afat mesëm, të parashikohen pagesat për detyrimet gjyqësore të formës së prerë si dhe të kontabilizohen këto detyrime në momentin e konstatimit.

**Deri më 31.12.2019**

**13.Gjetje nga auditimi:** Në tenderin me objekt “Rikualifikim urban i bllokut të kufizuar nga Rr.”Llambi Bonata”, Rr. ”Haki Stermilli”,”Musine Kokalari” dhe rikonstruksion i rrugës ”Zyber Zeneli”, vazhdim i rrugës ”Ali Kelmendi”, zhvilluar në datën 27.06.2017, me vlerë të

fondit limit 101,887,644 lekë, është kualifikuar dhe shpallur fitues BOE “A...” & “E...” SHPK, me vlerë të ofertës ekonomike 84,521,440 lekë, ose 17,366,204 lekë më pak se vlera e fondit limit, i cili nuk plotëson kriteret e vendosura në dokumentet standarde të tenderit (DST). Në tender kanë marrë pjesë 10 operatorë ekonomik dhe BOE i shpallur fitues është i renditur i katërti në radhë për nga vlera e ofertës. Tre operatorët e tjerë, me vlerë më të vogël të ofertës, janë s’kualifikuar me të drejtë, por KVO duhet të kishte s’kualifikuar edhe BOE “A...” & “E...” SHPK, duke përzgjedhur si fitues njërin nga operatorët e tjerë në radhë i cili plotëson kriteret e vendosura në DST. Kualifikimi dhe shpallja fitues e operatorit ekonomik i cili nuk plotëson kriteret e vendosura në DST, është veprim në kundërshtim me kërkesat ligjore dhe nuk jep garanci për realizimin me sukses të kontratës, duke krijuar premisa për përdorim të fondeve publike pa efektivitet. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me neni 46 - “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1, neni 53 - “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 dhe pika 5 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

*(Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 16 dhe 146 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**13.1. Rekomandimi:** Autoriteti kontraktor të analizojë situatën e mësipërme me qëllim eliminimin e rasteve të kualifikimeve dhe shpalljes fitues të operatorëve ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DST.

**Deri më 31.12.2019**

**14. Gjetje nga auditimi:** Në tenderin me objekt "Furnizim vendosje me makineri e pajisje mekanike e të tjera i ambienteve / godinave të Tirana Olimpik Park", me fond limit 153,421,354 lekë, zhvilluar në datën 30.11.2017, llogaritja e fondit limit është kryer nga shoqëria “D...” SHPK. Për llogaritjen e fondit limit, nuk u konstatua dokumentacion për të argumentuar mënyrën e llogaritjes së tij.

Kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi kërkojnë që për llogaritjen e fondit limit të zbatohet një nga praktikat e përcaktuara ligjore, si referenca e çmimeve të tregut, çmimeve të organeve doganore/tatimore, apo INSTAT-it, por një gjë e tillë nuk vërtetohet me dokumentacion. Gjithashtu nuk u konstatua dokumentacion se nga vetë autoriteti kontraktor, nëpërmjet strukturave përkatëse si sektori i projektimit inxhinierik, të jetë kryer kontrolli i preventivit të hartuar nga studioja private, nëse ky preventiv është në përputhje me çmimet e tregut (bazuar në rregulloren e brendshme të njësisë vendore ky sektor duhet të kryej këtë detyrë).

Mungesa e dokumentacionit për referencat e çmimeve për llogaritjen e fondit limit, nuk jep siguri të arsyeshme mbi saktësinë e çmimeve të preventivit për paisjet e për rrjedhojë për vlerën e fondit limit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 59 të VKM 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

*(Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 148 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**14.1. Rekomandimi:** Bashkia Tiranë, nëpërmjet strukturave përkatëse si sektori i projektimit inxhinierik etj., në rastin e hartimit të preventivit nga studio private, të kërkojë prej tyre dokumentacionin e nevojshëm ligjor, për argumentimin e fondit limit. Gjithashtu të bëhet kontrolli i preventivit të hartuar nga studioja private, nëse çmimet e pasqyruara në të janë rrjedhojë e studimit të tregut, apo në përputhje me çmimet e organeve doganore/tatimore, INSTAT, manualët përkatëse etj. Këto struktura kontrolluese të shprehen me shkrim për këtë kontroll dhe dokumenti të bëhet pjesë e dosjes së tenderit.

**Në vazhdimësi**

**15. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i tendrave të vitit 2017 (gjithsej 24) u konstatua se në të gjitha këto procedura, nga njësia e prokurimit e cila ka qenë njëkohësisht edhe hartuese e kriterëve të veçanta të DST, në procesverbalin e mbajtur për këtë qëllim nuk janë dhënë argumentime për kriteret e vendosura, veprim në kundërshtim me nga neni 61, pika 2, e VKM 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Duke argumentuar kriteret e vendosura, njësia e prokurimit jo vetëm përmbush një detyrim ligjor, por krijon edhe një hallkë vetëkontrolli, e cila garanton që çdo kriter i vendosur të jete në përputhje me natyrën, vlerën e kontratës dhe kuadrin rregullator në fuqi.  
(Më hollësisht trajtuar në faqe nr. të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**15.1. Rekomandimi:** Njësia e prokurimit, apo çdo strukturë tjetër e cila ngarkohet me hartimin e kriterëve të DST, në procesverbalin e mbajtur për këtë qëllim, të dokumentojë argumentimin e të gjitha kriterëve të vendosura. Argumentimi të bëhet duke dhënë shpjegime konkrete në lidhje me nevojën e vendosjes së secilit kriter, mbi bazën e zërave konkret të preventivit, kohëzgjatjes së kontratës, natyrës së saj dhe kuadrin rregullator.

#### Në vazhdimësi

**15. Gjetje nga auditimi:** Nga testimi i funksionimit të kontrolleve të vendosura në kuadrin e menaxhimit financiar dhe kontrollit raportohet se strukturat drejtuese janë përfshirë në vendimmarrje në masën 49% të të intervistuarve; kanë marrë pjesë në trajnime të ndryshme rreth 69% e të intervistuarve; janë njohur me strategjitë e Bashkisë Tiranë për periudhën 2018-2022 80% e të intervistuarve nga të cilët 29% raportojnë se strategjia është reflektuar tek buxheti vjetor, 42% tek plani strategjik, 20% tek përshkrimi i kompetencave dhe përgjegjësi dhe 9% nuk e kanë plotësuar; në procesin e rekrutimit janë përfshirë vetëm 26% e drejtuesve dhe, pyetjes “Në cilën pjesë të analizës SWOT gjatë vitit 2018 keni kontribuar?” 26% kanë komentuar rubrika të ndryshme dhe pjesa tjetër nuk e ka plotësuar. Raportohet gjithashtu nga niveli i mesëm specialist se kanë qenë pjesë e trajnimeve të ndryshme për rritjen profesionale gjatë vitit 2018 vetëm 61% e të intervistuarve dhe, pyetjes “A jeni njohur me strategjinë e B. Tiranë për vitin 2018?” raportojnë pozitivisht 61% e të intervistuarve, 28% nuk janë njohur, 7% janë njohur pjesërisht dhe 4% vetëm cfarë kanë dëgjuar. Gjithashtu pyetjes “Nëse përgjigja e pikës më sipër është po ose pjesërisht ku është reflektuar strategjia për vitin 2018?” raportojnë 44% tek buxheti, 17% tek përshkrimi i punës për cdo vend pune, 44% tek plani strategjik dhe 13% nuk e kanë plotësuar.

(Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 239 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**15.1 Rekomandimi:** Drejtorja e Përgjithshme për Planifikimin dhe Menaxhimin Strategjik të marrë masa në bashkëpunim me Burimet Njerëzore për rivlerësimin e situatës në bazë të rishikimit të menaxhimit dhe kontrollit të riskut për shkallën e realizimit të objektivave sipas strategjisë, përfshirjen e strukturave drejtuese në vendimmarrjet relevante, plotësimin në masë më të madhe të nevojave për trajnime si të stafit drejtues dhe ai i nivelit specialist.

#### Menjëherë

**16. Gjetje nga auditimi:** Për të gjitha vitet e audituara nga ana e Drejtorisë IMTV Tiranë nuk ka të hartuar dhe të miratuar një Rregullore të Brendshme për funksionimin e brendshëm të saj. Nga verifikimi rezulton se një pjesë e konsiderueshme e personelit ka një nivel të ulët arsimor. Në disa raste emërimet e inspektorëve të IMT, janë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, neni 11, arsimimi i kryeinspektorëve dhe inspektorëve të



inspektoratit të mbrojtjes së territorit. Kryeinspektorët dhe inspektorët në nivel kombëtar dhe qeverisjeje vendore duhet të kenë arsimin e lartë të nevojshëm profesional në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogeologjisë dhe mjedisit. Një pjesë e personelit përbërës të kësaj drejtorie vihet re se janë me arsim të mesëm dhe kanë kryesisht rolin e specialistit pranë kësaj njësie. Punonjësit pjesë e drejtorive kryesore të kësaj njësie siç janë: Drejtoria e Kontrollit, Sektori i kontrollit të veprave të mëdha apo dhe Drejtoria e Koordinimit të projekteve etj, nuk mund të kenë në përbërje të tyre pozicione me emërtimin “specialist” për vetë natyrën e punës së kryer. Si rezultat i këtij veprimi janë shkelur përcaktimet e bëra në ligjin nr. 183/2014 ”Për disa shtesa dhe ndryshime” në ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, neni 11 ku përcaktohet qartë arsimi i inspektorëve dhe kryeinspektorëve në nivel qëndror ose vendor.

Për periudhën e audituar ka rezultuar se nga ana e IMTV nuk janë përgatitur plane strategjike për vendosjen e objektivave të punës së kryer, nuk janë përgatitur plane përmbledhëse vjetore për veprimtarinë. Gjatë periudhës 2016-2018 nga IMTV nuk janë hartuar raporte, analiza periodike, vlerësim performance si dhe mungon një strategji për identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin e riskut. Nga ana e IMTV dërgohet periodikisht informacion pranë IKMT mbi vendimet e mara e cila nga ana e saj në kontrollet e ushtruara pranë IMTV ka konstatuar në disa raste mos kthim përgjigje dhe mos veprime nga ana e IMTV për shkresa dhe praktika të kryera nga IMTV Bashkia Tiranë.

Në lidhje me detyrat funksionale të strukturës së IMTV, nga kryeinspektori i IMTV nuk u paraqitën të dhëna dokumentare mbi plane pune javore dhe vjetore mbi aktivitetin e kësaj strukture, për kryerjen e kontrollit në territorin administrativ të bashkisë, për periudhën objekt auditimi.

Në lidhje me auditimin e kryer të dokumenteve të vëna në dispozicion nga zyra e IMT, për ushtrimin e kontrollit në terren të kontrollit mbi territorin e bashkisë, nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Bashkia Tiranë për periudhën 01.01.2016 deri 31.12.2018 rezultoi se janë marrë gjithsej 1598 “Vendime për Gjoha” nga të cilat 284 për vitin 2016, për vitin 2017 janë 678 dhe 636 për vitin 2018. Janë marrë gjithsej 809 “Vendime Prishje” nga të cilat 353 vendime për vitin 2016, për vitin 2017 janë 205 vendime dhe 251 vendime për vitin 2018, në zbatim të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, për të cilat kanë vijuar procedurat e mëtejshme ligjore.

*(Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**16.1 Rekomandimi:** K/Inspektori i IMTV të marrë masa të menjëhershme për përmirësimin e punës për:

-hartimin dhe miratimin e një rregullore të brendshme për organizimin e funksionimin e Drejtorisë së IMTV në përputhje me ligjet përkatëse.

-në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore të marrë të gjitha masat për të siguruar që klasifikimi i vendit të punës sipas arsimit përkatës të përputhet me përcaktimin e ligjit në fuqi.

-përgatitjen e planit strategjik dhe të planeve vjetore të veprimtarisë së drejtorive në varësi, ku të jenë të përcaktuar objektivat kryesore të veprimtarisë së IMTV.

-për hartimin e raporteve periodike e vjetore të veprimtarisë mbi realizimin detyrave përkatëse dhe performancës në përmbushjen e objektivave të IMTV.

**Menjëherë**

**17. Gjetje nga auditimi:** Për të gjitha vitet e audituara nga ana e sektorit të Auditit të Brendshëm të gjitha dosjet e auditimit nuk janë të arshivuara në arshivë, por mbahen në ambientet e brendshme të Drejtorisë së Auditit të Brendshëm si dhe në auditimet financiare ose të kombinuar (përputhshmëri dhe financiar), nuk kanë dalë me opinion për pasqyrat financiare sipas kërkesave të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit.

*(Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**17.1 Rekomandimi:** Drejtori i Auditit të Brendshëm të marrë masa të menjëhershme për të arkivuar në institucion dosjet e auditimit dhe të aplikojë opinione auditimi sipas standardeve të auditimit dhe manualit për auditimin në sektorin e brendshëm publik.

**Menjëherë**

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:**

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b) dhe (c) -*Të drejtat e KLSH*, dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, dhe pikën 93 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga ana e Titullarit të njësisë publike (Bashkia Tiranë), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqësorit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **4,038,354 lekë**, si më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës me objekt: “Rikualifikim i aksit Mbikalim-Kombinat” të lidhur ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe sipërmarrësit të punimeve “G...” SHPK, u konstatua se zërat e punimeve si vijon: Shtresë betoni M-200, t=10 cm; Shtresë çakulli t=10/15 cm, makadam, përhapur e ngjeshur me makineri; Shtresë rëre t=4 cm për trotuar dhe Pllaka betoni gri t=6 cm për trotuar, janë likuiduar për punime të pakryera dhe diferenca në volume në shumën **725,972 lekë pa TVSH** duke shkaktuar efekt financiar negativ ndaj buxhetit të shtetit dhe njësië vendore. Sa më sipër nuk është në përputhshmëri me paragrafin e tretë të nenit 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” Kreu I, pika 3.

*(Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 171 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1 Rekomandimi:** Të merren masa nga Bashkia e Tiranës, që t’i kërkojë sipërmarrësit të punimeve “G...” SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjyqësorit arkëtimin e shumës **725,972 lekë pa TVSH**, të përfituar tepër për

punime të pakryera në zbatimin e kontratës me objekt “Rikualifikim i aksit Mbikalim-Kombinat”.

#### Menjëherë

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës me objekt: “Ndërtim parkim nëntokësor, Sheshi Skënderbej” të lidhur ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe sipërmarrësit të punimeve “F...” SHPK, u konstatua se zërat e punimeve si vijon: Shtresë me rezinë epokside e komponente në tualete dhe koridor; Parapet shkalle e ballkone me tuba xingato dhe zëri Bojatisje me bojë betoni plintuese, janë likuiduar për punime të pakryera dhe punime materiale në kundërshtim me specifikimet teknike të tenderit dhe të kontratës së zbatimit në shumën **496,140 lekë pa TVSH** duke shkaktuar efekt financiar negativ ndaj buxhetit të shtetit dhe njësië vendore. Sa më sipër nuk është në përputhshmëri me paragrafin e tretë të nenit 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” Kreu I, pika 3.

*(Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 177 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1 Rekomandimi:** Të merren masa nga Bashkia e Tiranës, që t’i kërkojë sipërmarrësit të punimeve “F...” SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative që, shuma prej **496,140 lekë pa TVSH** të realizohet në objekt brenda periudhës së garancisë së defekteve. Realizimi i punimeve duhet të konfirmohet zyrtarisht nga AK, Bashkia e Tiranës, Mbikëqyrësi i punimeve si dhe Kolaudatori i punimeve të objektit (Në rast të kundërt, moskryerja e punimeve sipas Projektit të Zbatimit dhe specifikimeve teknike, do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të zhdëmtohet nga sipërmarrësi i punimeve).

#### Menjëherë

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës me objekt: “Rikonstruksion i rrugës së Dibrës (farmacia 10 - Oxhaku)” të lidhur ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe sipërmarrësit të punimeve “C...” SHPK, u konstatua se zëri i punimeve “Zëri 3 (3.158/5a ) Transport dheu me auto deri në 5 km” në seksionin e preventivit (Punime të ndryshme, prishje, spostime, dhe punime asfaltimi), është likuiduar dy herë si punim i kryer, përkatësisht si zë punimi më vetë dhe nën zë punime, në kundërshtim me preventivin për njësi, në shumën **421,824 lekë pa TVSH** duke shkaktuar efekt financiar negativ ndaj buxhetit të shtetit dhe njësië vendore. Sa më sipër nuk është në përputhshmëri me paragrafin e tretë të nenit 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” Kreu I, pika 3.

*(Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 242 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1 Rekomandimi:** Të merren masa nga Bashkia e Tiranës, që t’i kërkojë sipërmarrësit të punimeve “C...” SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës **421,824 lekë pa TVSH**, të përfituar tepër për likuidim punime të dubluar të zërit transport dheu, të kontratës me objekt “Rikonstruksion i rrugës së Dibrës (farmacia 10 - Oxhaku)”.

#### Menjëherë

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës me objekt: “Parkimi Nëntokësor te Sheshi Italia” të lidhur ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe sipërmarrësit të punimeve “A...” SHPK, u konstatua se zëri i punimeve “**Zëri 4 (3.158/5a ) Transport dheu me auto deri në 5 km**, është likuiduar për punime të pakryera, duke u përfshirë përkatësisht si zë punimi më vetë dhe nën zë punimi, në shumën **233,722 lekë pa TVSH** duke shkaktuar efekt financiar negativ ndaj buxhetit të shtetit dhe njësië vendore. Sa më sipër nuk është në përputhshmëri me paragrafin e tretë të nenit 7, të ligjit nr. 8402, datë

10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” Kreu I, pika 3.  
(Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 187 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1 Rekomandimi:** Të merren masa nga Bashkia e Tiranës, që t’i kërkojë sipërmarrësit të punimeve “A...” SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative për arkëtimin e shumës **233,722 lekë pa TVSH** në situacionin përfundimtar, të përfituar tepër për punime të pakryera në zbatimin e kontratës me objekt “Parkimi Nëntokësor te Sheshi Italia”.

#### Menjëherë

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës me objekt: “Ndërtimi dhe rikonstruksioni i rrugës “Selaudin Bekteshi” të lidhur ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe sipërmarrësit të punimeve “A...” SHPK, u konstatua se zërat e punimeve si vijon: Zëri 4 (3.212/c) Shtresë stabilizanti t=15 cm dhe Zëri 6 (3.226/1) Shtresë asfaltobetoni me granil gur kave, 4 cm, me makineri, janë likuiduar për punime të pakryera dhe diferenca në volume në shumën **699,396 lekë pa TVSH** duke shkaktuar efekt financiar negativ ndaj buxhetit të shtetit dhe njësië vendore. Sa më sipër nuk është në përputhshmëri me paragrafin e tretë të nenit 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” Kreu I, pika 3.

(Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 191 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1 Rekomandimi:** Të merren masa nga Bashkia e Tiranës, që t’i kërkojë sipërmarrësit të punimeve “A...” SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës **699,396 lekë pa TVSH**, të përfituar tepër për punime të pakryera në zbatimin e kontratës me objekt “Ndërtimi dhe rikonstruksioni i rrugës “Selaudin Bekteshi”.

#### Menjëherë

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës me objekt: “Rehabilitimi Unaza e Mesme” të lidhur ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe sipërmarrësit të punimeve “A...” SHPK, u konstatua se zëri i punimeve (3.618) F.V bordura betoni 20x35 cm e re për trotuarin, nuk është zbatuar sipas projektit të zbatimit dhe specifikimeve teknike duke krijuar një efekt financiar negativ në shumën **172,190 lekë pa TVSH** ndaj buxhetit të shtetit dhe njësië vendore. Sa më sipër nuk është në përputhshmëri me projektin e zbatimit dhe specifikimet teknike.

(Më hollësisht trajtuar në faqe nr. të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**6.1 Rekomandimi:** Autoriteti Kontraktor, Bashkia e Tiranës, t’i kërkojë sipërmarrësit të punimeve “A...” SHPK, të bëjë sistemimet në situacionet pjesore ose në situacionin përfundimtar të shumës **172,190 lekë pa TVSH**, për zëvendësimin e bordurës nga seksioni 20 x 35 cm në seksionin 20 x 30 cm, brenda afatit kohor të përfundimit të punimeve të ndërtimit parashikuar në kontratë. Në rast të kundërt mos realizimi i punimeve sipas bordurës 20x30 cm, shuma 172,190 lekë pa TVSH do të konsiderohet dëm ekonomik dhe do të konsiderohet si punim i kryer në kundërshtim me projektin e zbatimit dhe specifikimet teknike.

#### Menjëherë

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës me objekt: “Rikualifikim urban i bllokut të kufizuar nga rruga “Muhamet Gjollësja” – “Myslym Shyri” – “Rruga e Kavajes” me Kufirin e Njësisë Bashkiake Nr. 10” të lidhur ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe sipërmarrësit të punimeve “A...” SHPK, u konstatua se zëri i punimeve

“5 (3.243) Strukturë monolite betoni C 16/20 (për shtresë trotuari)” është likuiduar për punime të pakryera dhe diferenca në volume në shumën **1,289,110 lekë pa TVSH** duke shkaktuar efekt financiar negativ ndaj buxhetit të shtetit dhe njësië vendore. Sa më sipër nuk është në përputhshmëri me paragrafin e tretë të nenit 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” Kreu I, pika 3.

*(Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 197-198 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**7.1 Rekomandimi:** Të merren masa nga Bashkia e Tiranës, që t’i kërkojë sipërmarrësit të punimeve “A...” SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës **1,289,110 lekë pa TVSH**, të përfituar tepër për punime të pakryera në zbatimin e kontratës me objekt “Rikualifikim urban i bllokut të kufizuar nga rruga “Muhamet Gjollësia” – “Myslym Shyri” – “Rruga e Kavajes” me Kufirin e Njësisë Bashkiake Nr. 10”.

**Menjëherë**

### **C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.**

**1.Gjetje nga auditimi:** Në tenderin me objekt “Rehabilitimi dhe instalimi i sistemit të ngrohjes në shkollën 9 – vjeçare ”Vasil Shanto”, me fond limit 53,108,324 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 18.04.2017, në preventivin e paraqitur nga Autoritetit Kontraktor dhe ofertën e operatorit ekonomik fitues “Kronos Konstruksion” SHPK, për pajisjet është llogaritur TVSH në vlerën 1,460,000 lekë, duke i konsideruar paisjet si punime ndërtimi e duke shtuar koston e preventivit total. Vlera prej 1,460,000 lekë konsiderohet përdorim i fondeve publike pa efikasitet, pasi për të njëjtën paisje janë shpenzuar më shumë fonde publike, e cila është pjesa e TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me:

a) UKM nr. 2, datë 8.5.2003 “Për Klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, Kreu I/I “Klasifikimi i punimeve të ndërtimit”, germa “A”, paragrafi i fundit;

b) VKM nr. 514, datë 15/8/2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, ndryshuar me VKM nr. 664, datë 26/9/2012, pika 8; c) UKM Nr. 1, datë 16.6.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, pika 1, germa “c”, paragrafi i fundit.

*(Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 17-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1. Rekomandim:** Për arsye se nuk ka përfunduar likuidimi total i vlerës së kontratës, por deri në këtë fazë të auditimit autoriteti kontraktor (AK) Bashkia Tiranë ka ende për likuidim edhe 21,064,769 lekë, nga AK të bëhet verifikimi i faturës së blerjes së paisjeve nga ana e operatorit ekonomik “K...” SHPK. Nëse operatori nuk ka kryer blerjen e paisjeve me TVSH, nga Bashkia Tiranë të kërkohej që edhe likuidimi i faturës për këto paisje të kryhet pa TVSH, duke bërë të mundur kursimin e fondeve të njësisë vendore prej 1,460,000 lekë.

**Menjëherë**

**2. Gjetje nga auditimi:** Në tenderin me objekt “Furnizim vendosje me makineri e pajisje mekanike e të tjera, i ambienteve/godinave të Tirana Olimpik Park”, me fond limit 153,421,354 lekë, zhvilluar në datën 30.11.2017, në preventivin e paraqitur nga Autoritetit Kontraktor dhe ofertën e BOE fitues “I...” & “K...” & “E...” SHPK, për pajisjet është llogaritur TVSH në vlerën 7,605,004 lekë, duke i konsideruar paisjet si punime ndërtimi e duke shtuar koston e preventivit total. Vlera prej 7,605,004 lekë konsiderohet përdorim i

fondeve publike pa eficencë, pasi për të njëjtën paisje janë shpenzuar më shumë fonde publike, e cila është pjesa e TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me:

a) UKM nr. 2, datë 8.5.2003 “Për Klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, Kreu I/I “Klasifikimi i punimeve të ndërtimit”, germa “A”, paragrafi i fundit;

b) VKM nr. 514, datë 15/8/2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, ndryshuar me VKM nr. 664, datë 26/9/2012, pika 8; c) UKM Nr. 1, datë 16.6.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, pika 1, germa “c”, paragrafi i fundit.

(Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1. Rekomandim:** Për arsye se nuk ka përfunduar likuidimi total i vlerës së kontratës, por deri në këtë fazë të auditimit autoriteti kontraktor (AK) Bashkia Tiranë ka ende për likuidim edhe 45,967,783 lekë, nga AK të bëhet verifikimi i faturës së blerjes së paisjeve nga ana e BOE fitues “I...” & “K...” & “E...” SHPK. Nëse operatori nuk ka kryer blerjen e paisjeve me TVSH, nga Bashkia Tiranë të kërkohet që edhe likuidimi i faturës për këto paisje të kryhet pa TVSH, duke bërë të mundur kursimin e fondeve të njësisë vendore në vlerën 7,605,004 lekë.

**Menjëherë**

**3. Gjetje nga auditimi:** Në tenderin me objekt “Ndërtim i sallës së koncerteve, pranë Auditorit të Liceut Artistik ”Jordan Misja”, me fond limit 98,206,643 lekë, zhvilluar në datën 30.10.2017, në preventivin e paraqitur nga Autoritetit Kontraktor dhe ofertën e BOE fitues “F...” & “E...” & ” X...” SHPK, për pajisjet është llogaritur TVSH në vlerën 884,000 lekë, duke i konsideruar paisjet si punime ndërtimi e duke shtuar koston e preventivit total. Vlera prej 884,000 lekë konsiderohet përdorim i fondeve publike pa eficencë, pasi për të njëjtën paisje janë shpenzuar më shumë fonde publike, e cila është pjesa e TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me:

a) UKM nr. 2, datë 8.5.2003 “Për Klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, Kreu I/I “Klasifikimi i punimeve të ndërtimit”, germa “A”, paragrafi i fundit;

b) VKM nr. 514, datë 15/8/2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, ndryshuar me VKM nr. 664, datë 26/9/2012, pika 8; c) UKM Nr. 1, datë 16.6.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, pika 1, germa “c”, paragrafi i fundit.

(Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 143-146 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1. Rekomandim:** Për arsye se nuk ka përfunduar likuidimi total i vlerës së kontratës, por deri në këtë fazë të auditimit autoriteti kontraktor (AK) Bashkia Tiranë ka ende për likuidim edhe 8,452,418 lekë, nga AK të bëhet verifikimi i faturës së blerjes së paisjeve nga ana e BOE fitues “F...” & “E...” & ” X...” SHPK. Nëse operatori nuk ka kryer blerjen e paisjeve me TVSH, nga Bashkia Tiranë të kërkohet që edhe likuidimi i faturës për këto paisje të kryhet pa TVSH, duke bërë të mundur kursimin e fondeve të njësisë vendore në vlerën 884,000 lekë.

**Menjëherë**

**4. Gjetje nga auditimi:** Në tenderin me objekt ”Rehabilitim i pjesshëm dhe instalimi i sistemit të ngrohjes në shkollën 9-vjeçare ”Dhora Leka” dhe ndërtimi i palestrës”, me fond limit 63,254,523 lekë, zhvilluar në datën 25.08.2017, në preventivin e paraqitur nga Autoritetit Kontraktor dhe ofertën e OE fitues “K...” SHPK, për pajisjet është llogaritur TVSH në vlerën 215,500 lekë, duke i konsideruar paisjet si punime ndërtimi e duke shtuar koston e preventivit total. Vlera prej 215,500 lekë konsiderohet përdorim i fondeve publike pa eficencë, pasi për të njëjtën paisje janë shpenzuar më shumë fonde publike, e cila është pjesa e TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me:

a) UKM nr. 2, datë 8.5.2003 “Për Klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, Kreu I/I “Klasifikimi i punimeve të ndërtimit”, germa “A”, paragrafi i fundit;

b) VKM nr. 514, datë 15/8/2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, ndryshuar me VKM nr. 664, datë 26/9/2012, pika 8; c) UKM Nr. 1, datë 16.6.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, pika 1, germa “c”, paragrafi i fundit.

*(Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1. Rekomandim:** Për arsye se nuk ka përfunduar likuidimi total i vlerës së kontratës, por deri në këtë fazë të auditimit autoriteti kontraktor (AK) Bashkia Tiranë ka ende për likuidim edhe 12,568,983 lekë, nga AK të bëhet verifikimi i faturës së blerjes së paisjeve nga ana e OE fitues “K...” SHPK. Nëse operatori nuk ka kryer blerjen e paisjeve me TVSH, nga Bashkia Tiranë të kërkohet që edhe likuidimi i faturës për këto paisje të kryhet pa TVSH, duke bërë të mundur kursimin e fondeve të njësisë vendore në vlerën 215,500 lekë.

**Menjëherë**

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit për përdorimin e fondit rezervë, u konstatua se në preventivin e ripunuar dhe të miratuar nga Kryetari i Autoritetit Kontraktor, Bashkisë Tiranë me V.K.T. Nr. 14/6, datë 28.09.2018, fondi rezervë në shumën 9,270,795 lekë pa TVSH është shkruar në preventivin e ripunuar, pa hartuar më parë procedurën e përdorimit të fondit rezervë (Preventiv për fondin rezervë, proces-verbal i sigluar nga Autoriteti Kontraktor, Zbatuesi i punimeve si dhe Mbikëqyrësi i punimeve), i cili kontrollohet dhe autorizohet vetëm nga mbikëqyrësi i punimeve. Ky veprim edhe pse nuk ka ndikuar në çmimin e kontratës është në kundërshtim me UKM Nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, pika 19.

*(Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 171 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.1 Rekomandimi:** Të merren masa nga Bashkia e Tiranës, që për rastin konkret dhe në vazhdimësi, t’i kërkojë sipërmarrësit të punimeve si dhe mbikëqyrësit të punimeve, për përdorimin e fondit rezervë ta mbështesin në procedurat e hartimit të preventivit për fondin rezervë, argumentimit në relacionin teknik dhe procesverbalit të përdorimit të fondit, të nënshkruar nga të gjitha palët.

**Në vazhdimësi**

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës me objekt: “Ndërtim dhe rikonstruksion i rrugës që lidh rrugën “Reshit Petrela” me rrugën “Skënder Kosturi” (paralel me rrugën “Jordan Misja” të lidhur ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe sipërmarrësit të punimeve “A...” SHPK, u konstatua se Piketën 0+290 deri në Piketën 0+400 janë dëmtuar kangjellat metalike dhe nuk janë të bojatisuara me antiruxhë.

Sa më sipër nuk është në përputhshmëri me kushtet e përgjithshme të kontratës si dhe specifikimet teknike të tenderit.

*(Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 195 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**6.1 Rekomandimi:** Të merren masa nga Bashkia e Tiranës, që t’i kërkojë sipërmarrësit të punimeve “A...” SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat dhe kërkesat e kontratës, riparimin dhe zëvendësimin e pjesëve të dëmtuara të kangjallave metalike deri në përfundim të periudhës së garancisë me datë 22.08.2019.

**Menjëherë**

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës me objekt: “Rikualifikim urban i bllokut të kufizuar nga rruga “Muhamet Gjollesha” – “Myslym

Shyri” – “Rruga e Kavajes” me Kufirin e Njësisë Bashkiake Nr. 10” të lidhur ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe sipërmarrësit të punimeve “A...” SHPK, u konstatua se:

- Përsa i përket punimeve mbi vizimet me bojë bikomponente me gjerësi (d=12 cm) nga auditimi në fakt, u konstatua se për gjatësinë 1000 ml është përdorur bojë në kundërshtim me specifikimet teknike dhe pothuasje boja është fshirë fare.

- Në 10 pusetat në rrjetin e K.U.Z, u konstatua se, mbingritja e pusetave ekzistuese në trupin e rrugës nuk është bërë në kuotën e përcaktuar në projekt dhe ka filluar shkatërrimi i tyre.

Për sa më sipër është në kundërshtim me DST dhe kontratën e nënshkruar, cilësia e punimeve në ndërtim.

*(Më hollësisht trajtuar në faqe nr. 202 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**7.1 Rekomandimi:** Bashkia e Tiranës, t’i kërkojë sipërmarrësit të punimeve “A...” SHPK, të marrë masa për riparimin e defekteve të konstatuara në punimet e sinjalistikës dhe rrjetin e K.U.Z në përputhje me specifikimet teknike brenda periudhës së garancisë së defekteve.

**Menjëherë**

**Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.**

**GRUPI I AUDITIMIT TË KLSH**

**A.T.**

**B.M.**

**I.S.**

**J.L.**

**G.H.**

**A.G.**

**S.M.**

**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**



